KALOSH ÇELIKU

LAVDI

“heronjve” të Xhadisë

Biblioteka
XHA DERALLA

Redaktor letrar
GANI XHAFOLLI

Redaktore gjuhësore
LAURA ÇUKA

Ballina
ASDREN ÇELIKU

Ilustrimet
ZENI BALLAZHI
ADEM KASTRATI
RAMADAN RAMADANI – BALLAZHI
AGIM RAMADANI

Copyright by Asdreni

Kalosh Çeliku

LAVDI

"heronjve" të Xhadisë

Ardreni

Shkup, 2014

**(*Prill, bre vëlla,/ m'i jep tri ditë hua,*
ta shuej plakën me gjithëçka ka!…)**

Popullore

Në vend të parathënies
LIBRI "RRUFJANI", SAGË QË NDERON LETËRSINË SHQIPE

Durrës - Korfuz, 08. 09. 2013 - Refleksione për librin "Rrufjani" të shkrimtarit Kalosh Çeliku – "(Ah, ky njeriu i shkretë! Rrënjë - s'ka po është i lidhur me tokën më fort se rrapi shekullor… Jakov Xoxa, "Lumi i vdekur") - Tek lexon librin më të fundit të shkrimtarit dhe poetit Kalosh Çeliku, kupton se ke të bësh me një doracak të mirfilltë që paraqet jetën e shqiptarëve jo vetëm në Maqedoninë e sotme. Ky libër është fakti dhe vërtetimi i tij mbi gjithçka reale dhe abstrakte që ndodh atje çdo ditë.

Pa asnjë lloj pretendimi nga ana e autorit për këtë libër, ai përkundrazi jep gjithçka shpirti i tij mban, gjithçka që sheh dhe analizon, duke kaluar mbi pendën e tij njerëz, vende dhe ngjarje. Libri "Rrufjani" është shpërthimi paraqitës i çdo gjëje shqiptare nga më të ndryshmet e të fokusuara në një vend të shenjtë: nën hijen e Rrapit të Shkupit.

Faqe pas faqeje lexuesi takon herë Fan Nolin e herë Nonda Bulkën (Chri – Chri) e viteve '30 -ta, duke dalluar jo vetëm origjinalitetin e paraqitjes së problemeve shqetësuese të kohës sonë, por dhe stile të fuqishme, madje tronditëse

edhe pse shumica janë nën okielon e humorit. Por lexuesi gjen akoma dhe Don Kishotët dhe Sanço Pançot shqiptarë, Nastradinët e popullit, Xha Dërrallën e famshëm dhe një galeri të tërë pasuese me emra të njohur të kulturës dhe historisë popullore.

I ngërthyer nga ide madhore të lirisë së shqiptarëve, Kalosh Çeliku është unikal në krijimtarinë e tij artistike.

Por tek studjon këtë vepër, gjen se dikush, apo më shumë se një dikush ia ndajnë jetën e tij në dy pjesë, atë të bohemit e atë të shkrimtarit, një mendim i padrejtë, jo normal sepse në trupin e Kalosh Çelikut ka vetëm një shpirt e vetëm një mendje. Ndryshe nuk do të kishim këtë shkrimtar, poet, humorist, botues, organizator, atdhetar, qytetarin shqiptar etj. Ndryshe nuk do të kishim as Frederik Reshpen për të cilin Kaloshi ka një respekt të veçantë në shkrimet e tij në këtë libër.

Dhe, kam dëshirë të citoj një pjesë monologuese të Kalosh Çelikut nga libri që po diskutoj:

"Vonë. Shumë vonë njeriu i sheh këmbët e padukshme që duan ta shkelin, shtypin në baltë si mizën. Njerëzit e sëmurë janë krijesa të cilëve etja për shkëlqim ua jep trajtat dhe format sipas dëshirës. I tjetërson. Dikënd e bën të ecë këmbdorës, dikënd të fluturojë në qiell…"

Autori ka shumë të drejtë! Por nuk mërzitet, se Franc Kafka ja ka bërë metamorfozën këtyre

qënieve plasteline dhe jo vetëm Kafka, por dhe njerëzit rreth e përqark, edhe ata që e kanë lexuar veprën e shqiptarit Çeliku.

Për aq më tepër ky autor kështu duke i njohur vetitë e shumë njerëzve të mirë e të këqinj ka arritur të krijojë një metodë origjinale për të mpleksur artin letrar të poetit dhe shkrimtarit të sotëm e të djeshëm në jetët e gjithë popullsisë shqiptare. Pikërisht këtë metodë dhe artificet e saj ai i shpërthen, i nënshkruan në "Takimet nën Rrap" e më shumë se një herë në vit.

Ai di të përgjithësojë me një zemër të madhe nëpërmjet veprimtarive të shumta, krijimet e kolegëve të tij të njohur e të panjohur. Kalosh Çeliku të kujton testamentin poetik të Uollt Uitmanit që thotë se": … surb ajër për vete por le dhe për të tjerët".

Në shkrimet e shumta dhe të goditura artistikisht të këtij autori, lexuesi megjithmënd dallon shpirtin bohem të tij por jo shpirtin cingun, miopik, cmirëprodhues. Kushdo që i ka këto vetitë e fundit, të këqija, sigurisht nuk do bënte punën madhore të Kaloshit.

Ky shkrimtar shqiptar i Maqedonisë ka ditur ta vendosë në këmbë vezën e Kolombit.

Këto ditë duke kaluar brigjeve shkëmbore të Sarandës, andej nga kam dhe origjinën, shihja fiqtë e detit tek kuqëlonin në ngjyrën e pjekjes. Nëse dikush kërkon t'i shijojë në fillim tek i prek, i çpohen duart dhe më tej kur fruti hapet, zemra e

tij është aq e ëmbël… A nuk është dhe Kalosh Çeliku brenda kësaj metafore?

Por ironia intelektuale e këtij shkrimtari të madh e transkriptuar në kaq shumë libra të tij, shpaloset së bashku me krenarinë e të qënit shqiptar e bëhet njësh me flladin që fryn fletët e degët e Rrapit dhe tashmë simbioza poezi – Rrap, ka lindur.

Kalosh Çeliku ka arritur të ndërtojë stilin e vet, tepër racional, me doza radikaliteti, por gjithmonë duke u mbështetur me këmbë në tabanin popullor. Si i tillë ai krijon një lloj të ri proze, prozë që kultivohet gati në tridhjetë libra të larmishëm.

Në se ai në nëntitullin e librit "Rrufjani" shkruan Libër për nesër bën shumë mirë e unë do ta përqafoj si ide. Dhe ja se çfarë shkruan ai në shkrimin përkushtuar poetit, studjuesit dhe përkthyesit Perikli Jorgoni:

Faleminderit o burrë për ndihmën tënde në luftën me trusakatët. Ende kemi rrugë. Tyrbja e Baba Shehut është larg. Baba Tomorri edhe më larg. Miqtë e tu të penës që e vazhdojnë rrugën, patjetër një ditë do të hypin në majë, Baba Tomorr. Vendin e Perëndive, Tyrben ku pihet verë, shkruhet poezia… Dhe, bëhet dashuri…

Kaloshi pret një të ardhme të madhe hyjnore për shqiptarët, bazuar në idetë e bëmat e profetëve të mëdhej shqiptarë. Por ai si gjithnjë kthehet në tokë me miq si Gani Xhafolli, Gjergj

Qamili, Haxhi Shabani, nëpërmjet një udhëtimi europian duke përhapur kulturën shqiptare në Gjermani, Zvicërr, Bruksel… e deri në Durrës.

Kalosh Çeliku në një vend në libër thotë se Rrapi e ndjek si hije, e ndërkohë unë do thoja të kundërtën: Kaloshi e ndjek Rrapin virtualisht, duke e kthyer në një Muzë, dashnore të përjetëshme, edhe kur i vjen krejt si Mikja me katruven e djersitur, mbushur plot me freski për ta frymëzuar më tej shkrimtarin…

Por Rrapi teksa ndrit me rrezatimin e tij fluror Dritëro Agollin, Xhevahir Spahiun, Visar Zhitin, Vahit Nasufin e Gani Xhafollin di dhe të fshehë (tjetërlloj, të demaskojë) "ngatërraçët e tredhur "futur zgafellave të Rrapit.

Kalosh Çeliku në librin "Rrufjani" ka shumë shkrime të sensit politik. Por në saj të një strategjie të menduar mirë, autori i tejkalon sherret me situatat poltike midis partive e grupimeve maqedonase e shqiptare, ku tharmi artistik është ai i qesëndisjes, humorit zekthian. Pa dashje për krahasim të kësaj rrëmuje që nuk ndodh vetëm në Maqedoni, më kujtohen vargjet e një kënge ruse të viteve '60 -ta: "Moskva, Kalluga, Los Anxhelos, sojedinilis vodin kolkoz" (Moska, Kallug, Los Anxhelos, u bashkuan në një kolkoz.)

Si mjeshtër i humorit, realizon dhe pamflete aq të kuptueshme për këdo dhe aq abstraktë për dikë. Të njëjtën taktikë sjell Kaloshi në shumë shkrime

të këtij libri për problemet e feve të ndryshme në Maqedoni.

Nëpërmjet sjelljes së figurave të letërsisë botërore si Don Kishoti dhe Sanço Pança, ai si kritiku i madh amerikan Harold Blum di të sokëllijë e pastaj t'i bjerë fyellit i qetë me një muzikë korijesh të gjelbra ku delet kullosin lirshëm.

Në sagën "Rrufjani" ndjehen krahët e saj jashtë kufirit, fluturojnë e ndalen në Kosovë e në Sarandë, në Gjakovë e në Elbasan e për të bërë pushimin e madh në Korçën e bukur. Saga e Kalosh Çelikut është amebë e ditëve të sotme të shqiptarëve, ku ngjizen miqësitë e vërteta të njerëzve të mirë, burrave të mendjes krijuese të arit të madh e jo burrave të zgiqeve ku vetëm minjtë sorrollaten.

Pano Taçi dhe Perikli Jorgoni, Milianov Kallupi, e pa harruar Frederik Reshpen, poetë që sot s'janë më, kanë lënë lëndën e tyre që recitohet me shpirt jo vetëm në Takimet nën Rrap. Kalosh Çeliku është i nderuar tek kujton të ndjerin Perikli Jorgoni, për të cilin pak shkruhet sot në Shqipëri dhe bëhet simbiozë me kujtimin e Pano Taçit duke na dhënë faqe të veçanta analitike në librin e tij. Kështu Kaloshi gjatë faqeve të sagës na sjell aromën e një romani me kaq shumë personazhe, duke e kthyer librin në një roman – sagë. Eshtë një udhërrëfyes që të çon tek shpirtrat e mirë jo vetëm të poetëve e të prozatorëve.

Nëse dikush mund ta quaj një antologji, unë nuk do ta quaja të tillë, thjeshtë nga shpirti që gëlon aty brenda, shpirt që është larg katalogimit antologjik. E ky roman – sagë, edhe pa lidhje lineare, e ka gjithë "Luftën e paqen" të popullit shqiptar, aty brenda, në 600 faqet e tij.

Si për të mos u mjaftuar me figura reale të jetës shqipatre andej e këndej trojeve shqiptare, në këtë sagë do të lexojmë kapitullin Trëndafilja dhe facebooku. Një pamflet i llahtarshëm ku ironia shumë therëse intersekton shpotitjen me burrat e gratë e papuna fejbukse. Prandaj i vjen shumë për mbarë të bëjë skanera serialë të jetës shoqërore shqiptare.

Çdo kapitull në librin "Rrufjani" është një (anti) telenovelë, ku shpërthimin e merr në shkrimin brilant Kakademiku duke futur një monolog të përsosur që më kujton Migjenin:

"… M'i zgjidhni sytë!... Sytë… Dua vetë ta shoh botën kaq të bukur, kaq të mjerë! Kaq të pasur, kaq të varfër! Kaq të bukur, kaq të shëmtuar!..."

Në këtë sagë të bukur, të gjallë, autori tashmë e ka ngritur kalorësinë e shkrimtarëve dhe poetëve, i ka marrë besën atyre e është gati t'i turret kujtdo që e lëndon sado pak zemrën e vërtetë shqiptare. Ata që mund të mos e pranojnë, do kenë kohë edhe për të ndryshuar.

"Rrufjani" është një libër që do hapë probleme, diskutime në kritikën e mirëfilltë të

letërsisë. Eshtë një libër që kritika do t'ja gjejë shpejt hyrjen në apartamentin kryesor të këtij pallati letrar. Por fati i librit është në mendjen e lexuesit dhe fati i autorit në faqet e librit.

Kompozimi i humoristikes me seriozen, na jep një hibridizim të mrekullueshëm, gjë që shkakton optimizëm jo vetëm te lexuesit shqipatrë. Në një lloj mënyre Kalosh Çeliku ka fituar statusin e opozitarit të vërtetë. Ndërsa në tejkalimet e guximshme letrare ai ka fituar statusin e kritikut të kohës, i cili edhe nga lart e dëgjon rrahjen e këmbëve në tokë. Kështu ai ka ndërtuar institucionin virtual të kohës nga ku dalin libra, mendime, takime, kritika e forma të tjera të kulturës shqiptare. Janë universitete të gjallë! Edhe në se kanë aromën e bohemes!

Stili bohem, stili i thjeshtë i Kalosh Çelikut, i formuar nga mendime të prera, pa ekuivoke, me frazë të ëmbël, të shkurtër, me lakonizëm të përhapur gjithandej librit "Rrufjani" si një pelerinë mbrojtëse nga fjalët e stërgjatura të ndonjë mundësie tjetër.

Drejt Kalosh Çelikut, lexuesit do të rikthehen më shpejt se të Niçeja…

Shtator 2013 - Durrës – Korfuz **Fatmir Minguli**
Gazeta BULEVARD (13 shtator 2013)

Prolog

PYKË shelgu

Jo, rastësisht e nisa këtë shkrim me vargjet e një poezie satirike të Spiro Çomorës. Autorit të komedisë „*Karnevalet e Korçës*". Trungu i lisit malit, kur i thotë pykës: Inati nuk më vjen nga sëpata që është nga hekuri, po nga pyka që është pjesë e trungut tim nga druri.

Shqiptarët nëpër shekuj i kanë pasur pykat e tyre të një trungu nga gjaku, që armiqtë shekullor

me qytë të sëpatës ia kanë rrasur sa më thellë në trup, i kanë çarë copë-copë mes tokës e qiellit. Populli thotë: „*pyka nxjerrë pykën*“. Fatkeqësisht, popullit shqiptar, pak veta përpiqen t‘ia nxjerrin pykën, po pyka i bën vend pykës tjetër për t’i hyrë sa më thellë në palcë. Edhe sot si dje, përçudi u lindi pas porte një Pykë shelgu. Vetëm se, kësaj radhe jo një pykë nga lisi ose hekuri, po një Pykë shelgu në emër të „bashkimit“ të shoqatave joqeveritare nën një çati si „*Lëvizje politike-patriotike*“. Dorën në zemër, shoqëria shqiptare gjithmonë ka hapsirë për të gjitha veprimet për ndryshime politike. E, sidomos në kohën e sotshme demokratike, kur secili ka të drejtë të thirret në shprehjen e lirisë të fjalës dhe mendimit politik ndryshe. Ama, jo qorrazi si miza në qumësht, ose të rreshtohen si delet e nënkryeme qafërjepura pas Dashit me një brirë të thyer pa bari t’u prijë lëndinave „demokratike“ për në gojë të Ujkut.

Themeluesit e kësaj „*Lëvizje*“ (Pyka) dihen nga populli shqiptar me emër e mbiemër, kalorës të arratisur që deri më sot nuk zunë vend në asnjë Parti Politike Shqiptare. Ose, siç thotë Fishta i Madh te „*Gomari i Babatasit*“:

„Ani kush pra, me i pri kombit
Ju do pyka bijtë prej llomit
Që „Shqiptarë“ vedit thoni.

Jo pse ju Shqipninë doni.
Jo pse ju ndo' send kuptoni
Shka asht Atdheu e shka është Lirija.
Shka asht Vllaznija e Parasija
Përpraimi e Qytetnia.
Por, veç pse ende der më sot
Një tyran s'po e gjeni dot.
Nën këmbë t'cilit ju me u shtrue.
Se un ma tash jam regjë me jue.
E jau njof shpirtin der m'palc:
Pleh i ndytë, me u bartun m'shkale
E me u qitë jashta Shqipnije.

Dudumët, që i shëtitën të gjitha Partitë Politike dhe fondacionet „humanitare" duke rrëmbyer me të dyja duart mjete materiale e poste politike: Drejtorë, zv/drejtorë, kryetarë të shoqatave „joqeveritare", anëtarë të komisioneve, këshilltarë e hoxhallarë të xhamive. Syrin, përsëri e kanë të urët, pak siç duket i kishin këto shpërblime për „flijime artistike", burrat e botës, fesë dhe kombit meritojnë më tepër si „dëshmorë" lufte. Hapi i tyre „shpëtimtar" (njerëz të sotshëm me tru të moçëm), pse të mos themelojnë edhe një „Lëvizje qytetare myslimane-shqiptare"?! Nesër, sipas veprimit të disa shoqatave „joqeveritare" ta shpallin veten edhe si Parti Politike Myslimane

në mes të Shqipërisë Etnike. Shkupin ta mbushin me flamuj partiak fetar turko-arab gjatë fushatës parazgjedhore për pushtet.

„... Formimi i lëvizjes për bashkimin e shoqatave dhe tradhtia e disa shoqatave brenda lëvizjes“ i ndiqte prapa si Ismail Qemalin historia?! Duartrokitje, „patriotë“ bythëgrisur të kombit: ide e vjetër myslimane-komuniste me veprim të sotshëm tekenefes neokomunist: „*Një tokë, një kokë*“. Vallë, po si do të kemi veprime e mendime për ndryshime politike me këta „patriotë“ të vonuar në prehërin e „vëllezërve“ të Njerkës?! E patëm dikur një Parti Komuniste, çka na duhet tashti një tjetër neokomuniste?! Edhe, shqiptarët ia „panë“ mjaftë hajrin asaj pjelle mushke si popull demokratik në Ballkan, që nga koha e Fan Nolit, malli i mori ta provojnë edhe këtë melezen neokominste. Turren me të katra, e fusin kokën në thesin me arna: Shoqata Islame e joqeveritare shqiptare. Kokë më kokë bashkë: speca, patate, domate, qepë e banane. Thirrje u bëjnë „çafirëve“ t‘u kërkojnë „hallallëk“ myslimanëve për „zullumin“. E ngrejnë zërin kundër „njerëzve negativ dhe të djegur te muslimanët, që i japin një notë negative lëvizjes“. Edhe, e vajtojnë „Lëvizjen“ (*Pykën e shelgut*), për „tradhtinë“, që ia bënë „çafirët“ pas shpine duke ua përmendur „*Ditën e Gjykimit*“...

Trurin e tyre të sëmurë me çallmë turku në kokë, nateditë nuk e merr gjumi: me kokën në xhami e bythën te partitë politike. Tregtinë në emër të popullit shqiptar e kanë në shpirt e gjak.

Moti përpiqen të na e ulin çmimin e pazarit politik, shesin sa më lirë te „vëllazërit" në Bit-Pazar. Herë pas here i sheh nëpër organizime kulturore e sofra partiake si dele të nënkryeme. Krah për krahu në „protesta qytetare" me fjalime demagogjike përpara Qeverisë për lirinë e shtypit. Debate televizive me veteveten para kamerave televizive. Organizatorë të fshehtë të protestave politike me petk fetar në Shkup. Përditë manipulojnë rininë dhe popullin shqiptar, që nesër ta shesin shumë lirë, mos them pa pare te Partia Neokomuniste për një karrige, për një post partiak në Qeveri, për një emërim imami në xhami me këmbët dhe trutë në legen.

Dudumët, që sot nuk i do edhe vetë Zoti. Trusakatë, që nuk e dinë çka është pyka. Llojet e pykave: pykë druri dhe pykë hekuri. Kohën e fundit si „ideologë politik-fetar" na e zbuluan edhe një lloj pyke: *Pykë shelgu*. Funksionin që lujnë ato në jetën e përditshme të malësorit. Në mes të ditës para syve të popullit shqiptar themelojnë „Lëvizje" qytetare me pagëzim humuristiko-satirik „PYKA". Haptas, vjedhin pa vend dhe arsye simbolin e një poezie satirike të Spiro Çomorës. Ose, titullin e një reviste

humoristike-satirike „Pyka“ që dilte herë pas here në Strugë. Pavetëdije, dalin në sipërfaqe si pyka teknefese shelgu myslimane-shqiptare.

Nënçmojnë këtë popull duke menduar se ende hanë bar livadheve, mund ta kullosësh edhe në të ardhmen me thirrjen e „ezanit“ nga minaret e xhamive turko-arabe mes livadheve.

Trungut tij plak plot plagë, rrasësh me qytë të Sëpatës Neokomuniste të „vëllezërve“ edhe pykën e drurit të shelgut. Përçash pikë e pesë popullin shqiptar edhe në këtë Njëqindvjetor të Pavarsisë së Shqipërisë. Edhe atë, me „Pykën“ e vet të një trungu, gjaku e me qytën e Sëpatës Neokomuniste, që na i polli Xhadia natën këta kopila e na i la ditën pas porte.

Falë Zotit, janë pyka shelgu. Nuk janë pyka hekuri. Përndryshe, do të na merrnin më qafë si popull demokratik shqiptar në mes të Ballkanit, jo sot po edhe Nesër...

I ATDHEU NGA SHIU
RA NË BRESHËR

SHKUPI HISTORIK
I SHQIPTARËVE

Ditë e vite krekosen nëpër fushata parazgjedhore lokale e parlamentare politikanët shqiptar se do ta bëjnë sheshin "Skënderbeu" më të madhin në Shkup. Jo, o burra mejdani! Shesh të madh ka bërë Gruevski: Aleksandrin e Madh të Maqedonisë mbi çati të pallateve, matanë Urës Gurit. Në anën shqiptare, te këmbët e urës mitropolitë të Beogradit: Shën Klimentin dhe Shën Naum Ohërin me kryqa e Biblën në duar. Para porte, në Bit – Pazar Filipin e Maqedonisë me gjithë gra e fëmijë në gji. E, jo Izet Mexhiti që mezi i ka shtruar disa pllaka betoni mbi çati të shtëpizave, në Bit – Pazar.

Inatin ia ki "armikut", ama mos ia ha hakun. Vërtet ka ndërtuar një ndër sheshet më të bukur të Shkupit, rrethuar nga të katër anët me katunde shqiptar. Përmëtepër, e zgjëroi edhe në këtë anë të Vardarit. E hapi qytetin nga qielli të marr lirisht frymë. Edhe me fontana gjigante, që syri t'i sheh vetëm nëpër metropolet e mëdha të botës.

Skënderbeut tonë mes parkingut të makineve, përditë i zihet fryma. Asnjë pëllëmbë livadh nuk ka për ta kullotur kalin. E ku më ta shalojë me të katra nëpër Çarshi te ndonjë fontanë t'i japi ujë. Hasan Prishtina para semaforëve në udhëkryq, pret ta kaloj udhën më këmbë. Ngjyra e kuqe ia ka lidhur këmbët mes makinave në trotuar. Kalit të tij në breg të Vardarit i ka hipur në shpinë Karposhi.

Rasti ma kujtoi Xhangon, kur erdhi nga Amerika në Shkup. Autobusin me të cilin duhej të ktheheshim në shtëpi. Biletën që donte të ma paguaj atë ditë. Jo, i them: unë kam "meseçna" (mujore), që të më kuptojë ai me katër vjet shkollë fillore. Aty për aty tërbohet: çka është ajo "meseçna", nuk e kuptoj fare këtë fjalë?! Mujore, i them unë. Ëhë, fol shqip bre vëlla të të marrë vesh edhe Zoti! Ne shqiptarët në Amerikë, kemi sjellur vendim për të gjithë ata që përdorin barbarizma, nëse gabojnë t'i dënojmë me nga një shuplakë. Xhango atë ditë ma kujtoi edhe një histori interesante. Vëllain e tij, që punonte dhe jetonte me gjithë familje në Zvicër, kur ndërtoi shtëpi moderne me strehimore në Katund. Një ditë, kur edhe përpara oborrit ndërtonte pishinë. I them unë Xhangos: Çka i duhet pishina, ai në Katund vjen për pushime vetëm dy javë. Edhe ato pak ditë i kalon në Ulqin ose Greqi. Para me thasë derdhë kot për tulla e mure betoni (kapital të

vdekur), në vend që të ndërtojë hotel në ndonjë bregdet turistik. Heshtë, më thotë Xhango. Mos i thuaj atij asgjë, ne do të na mbesë edhe shtëpia edhe pishina t'i kalojmë ditët e nxehta me vapë gjatë verës duke u freskuar në Katund.

E kanë thënë moti pleqtë tanë se, shqiptarët shum pak kanë punuar dhe punojnë për vete (Atdheun) si popull më i moçëm i Ballkanit. Historikisht kanë luftuar për të tjerët, pushtuesit. Punën më të madhe mes të këqijave, shqiptarëve ua kanë bërë "miqtë" historik si "çlirimtarë". Gjermanët dhe italjanët i bënë edhe "Shqipëri të madhe" (Marrëveshja historike bullgaro – shqiptare). Tashti, kjo nuk ka gjithaq rëndësi, me vetëdije apo pa vetëdije. E rëndësishmja është se, koha sot po punon me të madhe për shqiptarët. Përçudi, shqiptarët nuk punojnë për kohën. Mos e teproj ta them: Zoti i do shqiptarët. Punë tjetër është ajo se, shqiptarët nën hije të Rrapit si te ajo vjersha e Çajupit: *lozën kuvendojnë. Pika që s'u bie se nga "vëllezërit" rrojnë*. Armikun gjithë jetën e vrasin nëpër dasma, restorante e kanale televizive me çifteli, këngë e valle.

Edhe sot si dje, dal unë për të zënë në grep ndonjë temë interesante për gazetë ose libër. Asgjë. Shadërvanët e Gruevskit plot me ujë Vardari, nuk kanë asnjë peshk. Në Bit – Pazar, hipur mbi kalë më pret Skënderbeu me shpatën në brez: *Ndaluni, o burra! Për ku jeni nisur?! I*

përgjigjem: Vendin ta çlirojmë. Pak më tej, Filipi i Maqedonisë me gratë e tija azgane me fëmijë në gji e ka ngritur dorën lartë si dikur Xhaxhi Enver. Ndaluni, o shqiptarë, këtu është kufiri natyror! Mu te këmbët e Urës, mitropilitët e Beogradit: Shën Klimenti dhe Metodi. Matanë Urës Gurit, Aleksandri i Maqedonisë me Goce Dellçevin dhe Nikolla Karevin hipur mbi kuaj shale.

Mirë, u them unë rrugës. Në rregull disi, vetëmse nuk i dorëzoj armët. Lufta vazhdon me penë. Po, ku i keni shqiptarët?! E dini se, pa shqiptarët ju deri më sot nuk e keni bërë asnjë luftë?! Shtet në Ballkan. Edhe në kohën e Serbisë, edhe në kohën e Turqisë, edhe në kohën e Gjermanisë, edhe në kohën e Jugosllavisë. Jo, më përgjigjen në heshtje heronjt e sotshëm që me ndihmëm e shqiptarëve e kanë pushtuar sheshin e Shkupit. Atëherë, si do të bashkëjetojmë ne në një shtet të përbashkët si "vëllezër"?! Ku i keni edhe heronjt shqiptar?! Vargjet e Naim Frashërit që i kishit para fushatës zgjedhore në ballë të ish "Ilindenit" (Shtëpisë së mallërave), në Bit – Pazar: "*Dhe drita e diturisë përpara do na shpjerë*"?! Nuk i shoh më ato vargje pas "fitoreve" të zgjedhjeve lokale në ballë të pallatit nën një çati me studentët e Universitetit Shtetëror të Tetovës?! Frikë kam se, një ditë nuk do ta shoh as Skënderbeun në parkingun e makinave, në Bit – Pazar. Ani. Vetëm se, le ta hipin së paku atje ku

e ka vendin, në Kala heroin tonë kombëtar legjandar.

Megjithatë, e di: vështirë e ka sot për sot Skënderbeu në Bit – Pazar. Hasan Prishtina edhe më vështirë si diplomat shqiptar. Intelektualët e vërtetë shqiptar të marrin lirisht frymë mes këtij bërlloku Stambolli. Dorën në zemër, e them

publikisht: Vërtetë, Nëna Parti shumë pak ka bërë për shqiptarët dhe Atdheun, ama punë të madhe ka bërë që e solli Skënderbeun tinëz dudumëve në mes të Bit – Pazarit, në Shkup. U lumtë! E vetmja punë patriotike që meriton duartrokitje.

Urat e gurit mbi lumë, hamamët, shtëpitë publike, xhamitë dha kalatë i trashëguam nga Perandoria osmane. Nesër, do t'i trashëgojmë edhe përmendoret, sheshet, teatrot, institucionet arsimore e kulturore të "vëllezërve", që sot mbijnë si këpurdha.

Vite me radhë "vëllezërit" jemi duke i bërë shtet. Fatkeqësisht, siç duket "vëllezërit" nuk duan shtet. Prandaj, kështu siç e kanë nisur "bashkëjetesën" nën një çati me shqiptarët, nesër "vëllezërit" edhe nuk do të kenë shtet. Një burrë i mençur (Mahmut Dumani), që ka punuar e vepruar në këto anë, gjatë Luftës së Dytë Botërore ka thënë: Shqiptarët, patjetër një ditë do të bashkohen në një shtet. E, ajo ditë nuk është larg, mvaret nga ecuria e proçeseve historike në Ballkan. Nëse çështja shqiptare zgjidhet me luftë, do të ndodhë së shpejti bashkimi kombëtar i shqiptarëve. E, nëse me penë, do të zgjasë edhe pak kohë për të arritur te qëllimi i shekullit, Shqipëria Etnike.

Shkupi historik dhe shteti, nesër do t'u mbetet shqiptarëve…

HAJDUTI "HALLALL"

Ditë e bukur pranvere me diell. Qielli i kaltërt lot mes dy-tri reve që thyejnë qafën matanë maleve. Një mik i imi shkrimtar më telefon për një kafe. Moti nuk e kisha ngritur dolli një gotë raki rrushi. Mos të flasim për dy shtamba me verë ose për "lëngun e turshisë", pijen e preferuar të partizanëve të partive tona politike "demokratike", që herët me hebet në krah kanë dalë për gjah t'i plaçkisin shqiptarët nëpër Bit – Pazar para këmbëve të Kalit të Skënderbeut.

Edhe, dalim me mikun shkrimtar në një "oazë paqe" të Shkupit nën "Sheshin e madh Skënderbeu", në Bit - Pazar. Ballë për ballë me Hasn Prishtinën, që këto ditë me shi e diell nuk ka para këmbëve asnjë lule. Miku shkrimtar sot ka lekë vetëm për dy birra "hallall". Edhe atë, pa meze. Merreni me mend, birrën ta pish së paku pa një copë mish viçi të palëpi. Zorrët në bark gjithë ditën e gjatë të të këndojnë këngë patriotike me dajre. E di, Skënderbeu ushqimin e tij të preferuar e ka pasur përsheshin me mish qengji. Gjatë një Paniri të libtit e kam provuar edhe unë autori i këtij shkrimi në restorantin e xhaxhit Enver në Tiranë, rreth oxhakut të viteve '70 –ta te Zogu i Zi. Këmbëkryq me popullin në fotografi nëpër

mure mes kazmave, traktorëve e pushkëve. Fytyrave të buzëqeshura të aksionistëve: në njërën dorë pushkën, në tjetrën kazmën. Këngën e asaj kohe: *Me gëzim po shkoj në punë*. Katastrofë e sotshme kombëtare, kur i krahason ato gra e burra mejdani me gjelat tanë "krynegritës" gjatë fushatave parazgjedhore sesi krekosen mbi pleh duke thirrur agimin ende pa hipur në gardh. Pajtohem me ralitetin pas shpine para këmbëve të kalit të Skënderbeut. Ditën, sot do ta përfundoj vetëm me një birrë "hallall".

Miku im shkrimtar, dikur shkaku obligimeve familjare të përditshme vazhdon rrugën për në shtëpi, ndërsa unë rrokem fytas në dylyftim me birrën "hallall", që mbi tavolinë më ka shpallur luftë fetare mes ferexhezezave. Kamarieri, dikur më thotë matanë tavolinave: E do edhe një "hallall"? Jo, i përgjigjem. Mjaftë e kam një sot në këtë vapë politike, sipas porosive të një "analisti" dudum. E dua "haramin", e jo "hallallin" e dudumëve. Dikur, për inat dalë nëpër qytet para grave të begatshme me fëmijë në gji përballë Filipit të Maqedonisë t'i rrokullis bythekrye edhe dy shtamba me "hallall". Rrugës padashtas nga "pastërtia e madhe", që gjatë natës kaluar e ka sulmuar qytetin, më rrëshqasin këmbët shkallëve: "se spasiv", (shpëtova), rënkova në gjuhën e "vëllezërve". "Patriotët kuqezi" e di, do të thonë: ja, ku e keni

nacionalistin e madh shqiptar para këmbëve të Kalit Skënderbeut, e ju e kërkoni në xhami para këmbëve të Hoxhës Allahut ta shpallni taliban. Ama, hiç nuk ma ndi për theshethemet dhe shpifjet e tyre të përgjumshme me këmbët dhe trutë në legen. Pesë "vakte" që përditë i falin në sexhadet e Persisë me kokën në xhami e bythën në polici. Nateditë para popullit flasin jerm marrëzira, shesin moral. Moti e kam thënë: Internacionalist nuk mund të jeshë, pa qenë nacionalist. Ose, ndryshe: nuk mund ta duash më shumë tjetrin, pa e dashur vtëveten. Vetë, përsëri ngrihem më këmbë për ta vazhduar rrugën me gropa mes gjithë këtij bërlloku dhe ndërtimeve pa leje, që mbijnë si këpurdha në mes të parkut (gjelbërimit). Inati më vjen, pse sot nuk e kam pi as një gotë raki rrushi e rrëzohem shkallëve të Nënës Parti. Përmëtepër, dy të rinj studentë shqiptar disa metra më larg më përkrahin me fjalë: Qoftë e kaluar, o burrë! Me siguri janë lexues të shkrimeve mia të "egra" publicistike anë e mbanë Atdheut për Ditën e Nesërme.

Rruga është rrugë. Patjetër, duhet vazhduar përmes Shkupit historik të shqiptarëve. Kryeqendrës, që përderisa Gruevski matanë e në këtë anë të Urës Gurit, ndërton sheshe me përmendore e fontana, partizanët tanë partiak shqiptar edhe atë pak hapsirë që ka Çarshia me gjelbërim dhe beton e kanë mbushur me parkingje

të makinave. Përçudi, vetja të duket se jeton në ndonjë shkretirë arabe. Merreni me mend, heroin tonë legjendar Skënderbeun me gjithë kalë e kanë dënuar t'u bëjë roje me shpatën në brez, sikur të ishte Tarzani në mesin e majmunëve. E di, vështirë e ka pasur dje me turqit, edhe më vështirë e ka sot me dudumët mes varrezave të automobilave që e kanë rrethuar nga të katër anët mu si dikur ushtria Osmane te Kështjella e Krujës. Mjerisht, edhe Universiteti i Tetovës mezi merr frymë mes këtij bërlloku të makinave shkatrraçe të parkuara para dere. Studentët gjatë pushimit pas ligjëratave kërkojnë shpëtim për ta kaluar kohën e lirë në ndonjë birucë betoni të partive politike. Aty për aty, më kujtohet vendasi im shakaxhi Xha Duli i Riu, kur në kohën e komunizmit me shokë i veshur me tirqi, xhamadan e kësula të bardha në kokë me flamur në dorë, lodra e valle i bienin krah për krahu përmidisi Çarshisë Kërçovës si në kohën e "Shqipërisë Madhe". Natën e bënin ditë. Këmbëkryq uleshin para restorantit "Slloboda" (Liria), kafenesë më të njohur në atë kohë të qytetit. Vite ato, kur sot më kujtohet edhe Babai me "nagantin" më brez e bombat nëpër xhepat e strukes hedhur krahëve. Kamarieri kur pasi e paguante dëmin, i thoshte: "Falla, pak da dojdete utre" (faleminderit, përsëri të vini nesër). E Babai, aty për aty në gjuhën shqipe i përgjigjej

me buzëqeshje te pragu i derës: kurrë, më nuk do të më shihni në këtë konak të hajdutëve. Djemtë e mi mund t'i mashtroni me "çaj rusi", bozë gostivari, "hallall" Bit – Pazari, ose ndonjë nuse qyteti, por mua kurrën e kurrës!

Edhe pas kaq viteve, ne shqiptarët përsëri rrotullohemi bythekrye nëpër çajtore e konaqe "rreth oxhakut" me këngë e valle patriotike. Popull më të lumtur se na në ditën e sotshme, nuk besoj se ka në botë. Armik të gjallë nuk lamë pa vra me çifteli e lodra mbi tokë. Qosh më qosh e kërkojmë "çajin e rusit", kur dehemi keq me bozë në mes të Bit – Pazarit, e hajdutët e pulave na prinë për në liri. Edhe atë, tashti kur më nuk kanë të vjedhin pula si dje në katund, i sulen pas shpine Skënderbeut dhe intelektualëve shqiptar. I ndejkin këmba – këmbës nëpër qytet si "armiq" të fesë islame, Partisë dhe shtetit. Rasti ma kujton çetën partizane mbi katund në Luftën e Dytë Botërore. Partizanin që e dërgojnë shokët të vjedhë pula. E, ai në vend që të vjedhë pula te koteci, bie "heroikisht" dhe vritet në telat e elektrizuar të ushtrisë gjermane. Shokët partizan pas lufte e shpallin hero kombëtar. Kohë kjo shterpë, kur unë fatkeqësisht për dudumët e kërkoj ta ngrej dolli Lotin e Shën Mërisë Virgjër ose gjakun e Isu Krishtit (azreti Isait). E ata, "çajin" e rusit mbi tavolinë me të cilin i ka shpërblyer pas lufte dhe stërvitur në këtë

profesion të “rrezikshëm” nëpër lëmë Nëna Parti me nga një post “shefi” në Qeveri dhe vende të merituara pune.

Pas pak kohe, përsëri më paraqitet në telefon miku im shkrimtar: A je ende aty në tavernë? Jo, i përgjigjem, posa dola të marr pak frymë para këmbëve të Filipit të Maqedonisë. Tashti për tashti, i pushoj sytë e lodhur te gratë e tij të “rrezikshme” me fëmijë në gji e prehër. Bërlloku i Bit – Pazarit m’i ka qerruar sytë. Qelbet nëpër kontenierët e partive politike. Nëntë sahat larg i vjen era. Përveç bakshishit, më thotë matanë telit miku im shkrimtar, kamarieri m’i ka vjedhur plus njëqind denar. Hi-hii-hiii, qesha unë përmes telefonit. Prandaj, edhe më pyeti: a, dua ta pi edhe një “hallall”?! Vertetë, qenka burrë si te ajo kënga popullore: *Shka po i thotë Dema – Kadrisë, a ia di bre emnin burrnisë*?! Edhe, Kadriu i përgjigjet po në atë këngë popullore: *Ia kam dijtë. O s’i nuk ia kam dijtë/ qe dy herë për mik jam fik*. Po, rri rehat - fli pa brekë, nuk e rrokullisa edhe një “hallall” në atë shtëpi të Zotit. Sot, u përpoqa të ecë përmes Bit – Pazarit me një këmbë. Babai po të ishte gjallë do të thoshte: nuk lërohet ara me një ka rrëzë Çukës. E di, i përgjigjem unë sot në këtë shkrim: po, nuk kam zgjidhje tjetër mes arave që na i kanë mbuluar ferrat. Shkak ky, që edhe rrëshqita teposhtë

shkallëve partiake bythekrye para këmbëve të Kalit të Skënderbeut.

Megjithatë, rrofshin kamarierët! Vërtetë, sot për sot janë më të mirë se politikanët. Partizanët e tyre që në emer të partisë përditë e plaçkisin popullin shqiptar. Edhe atë pak hapsirë me gjelbërim e beton që ka Çarshia e kanë shndërruar në parkingje të makinave. Biznesi i vetëm në këtë qytet për partizanët e Nënës Parti siç duket për ta mbajtur veten e familjen gjallë, u ka mbetur plaçkitja e shqiptarëve në mes të Ditës madhe. Edhe atë, nga "myslimanët" që natë e ditë i luten Zotit në xhami me këmbët dhe trutë në legen. Përderisa, Gruevski ndërton sheshe dhe fontana, rrugaçët tanë politik "kuqezi" i sulen gjelbërimit: uzurpojnë parqet dhe sheshet e qytetit për parkingje duke i plaçkitur qytetarët si në kohën e Turqisë. Suksese të pakëpërcyera në këtë biznes ka arritur njëfarë "shefi mysliman" i parkingut afër kishës Shën Dhimitri, rrëzë kalasë në Bit – Pazar. Mendja ma thotë se, i njëjti e ka nën "përkujdesje" edhe sheshin "Skënderbeu", në Shkup. Rrugaçi politik, përveçse që i palaçkitë shoferët përmes telefonave celular ua bllokon edhe rrotat e makinave. Dënimi dihet, përveç kohës së parkingut që ua merr përmes telefonit celular, plus edhe 910 denarë denim policor. Dëshmitar i gjallë, është vetë autori i këtij shkrimi, që përveç pagesës përmes telefonit

celular të kohës së parkingut, ia pagoi edhe dënimin me gjithë kafe "shefit mysliman" për idenë e këtij shkrimi në vend të shpërblimit, hiç më pak me gjithë kafe një mijë denarë. Dënim, shkaku i një shkrimi të mëhershëm, që autori e kishte publikuar në mjetet informacionit për sheshin (parkingun) më të madh "Skënderbeu" të Shkupit: *Shkupi historik i shqiptarëve*. Porosinë që ia dërgonte rrugaçi politik për Dadën Hajri mu si te ajo kënga popullore, *që nuk e ka shoqen në shtatë krajli*, e ia lyp në kafe Beqir aga *veç një natë me të të rri*. Prandaj, edhe Beqir agës të sotshëm me këtë shkrim ia pagova dy kafe "sheqerli", se sot e kam zënë një "mik" të ri.

Qëllimi i këtij shkrimi, nuk është për ta shkundur këtë rrugaç politik me shokë nga "hallalli" që e ka mbuluar këmbë e kokë, i cili do të pasurohet brenda një nate me djersën e huaj në kurriz të shqiptarisë, por për t'ua bërë me dije liderve tanë partiak "mallin" dhe bagazhin e sotshëm që e kanë nëpër radhët e partive politike. Farën e hajdutit të pulave, të cilit për disa vota të vjedhura gjatë zgjedhjeve lokale e parlamentare ia kanë hapur dyert krah më krah në plaçkitjen e qytetarëve. Njëkohësisht, duke i zhveshur lakuriq nga "hallalli" para syve të shoferëve e popullit: Kujdes, ku i parkoni makinat: te "hallalli", apo te "harami"! Hajduti partiak me diplomë universitare nuk është sot më "marimanga" e

dikurshme komuniste, po dudumi "hallall" që në emër të ligjit dhe shtetit ju plaçkitë edhe më zi se shkau në mes të Ditës Madhe para syve të policisë të Shtetit "përbashkët"…



ATDHEU NGA SHIU RA NË BRESHËR

Kohën e fundit lexoj lloj-lloj marrëzirash politike e fetare. I hurit dhe i litarit, siç thotë populli shet mend me "analiza" politike. Larg e parasheh edhe prejardhjen e tij ortodokse, që deri dje haptas e deklaronte veten në mjetet e informacionit si shkrimtar maqedonas. Përmëtepër, nuk dinte asnjë fjalë në gjuhën shqipe, po krenohej me gjuhën e ardhshme të perspektivës intelektuale. Shkollimin që e kreu në gjuhën e "Njerkës", afirmimin në atë gjuhë si shkrimtar maqedonas i stolisur me dy-tre vende pune, çmime letrare e poste politike. Vonë, shumë vonë i doli gjumi mes ëndrrave karrieriste si "patriot shqiptar": filloi ta mësojë gjuhën shqipe dhe përkthejë librat e tij në gjuhën e "dytë zyrtare". Rolin ta luaj si Kalë Troje në mesin e shqiptarëve. I pari ngutet t'ia urojë "fitoren" mikut Pandeli Majko. Edhe, atë: kohën e fundit, kur Gruevski filloi ta mveshi Shkupin shqiptar me kulturë sllave e antike. Rrënjët e Shtetit Ri t'i kërkojë në antikë, te vëllezërit ortodoks shqiptar. Bythekrye me shokë, turr kalorësit e arratisur shqiptar në "zbulimin" e shqiptarëve ortodoks të "harruar" nëpër institucionet e "Shtetit të

përbashkët". Rikthimin e tyre pas një gjysmë shekulli tek rrënja e stërgjyshërve.

Përçudi, nga ku i gjithë ky "interesim" për shqiptarët ortotodoks, që moti e kanë humbur veten me vite në këtë shoqëri "demokratike" dhe e kanë gdhirë mëngjesin në çerdhen e sorrave si qyqe fushe. Dorën në zemër, secili ka të drejtë të deklarohet dhe t'i përkasi sipas dëshirës atij populli ku merr lirisht frymë. Vallë, çka duam ne shqiptarët në Ditën e sotshme, kur me vete rrugës për në Baba Tomor nuk i kemi as shqiptarët dudumë: disa deklarohen myslimanë, disa ortodoks e tjerët turq "ehamdurila" duke

protestuar në Gostivar, Shkup e Tiranë ta "shpëtojnë" kryeminstrin turk, Erdogan nga populli i vet, në mesin e Turqisë. Luftë pakrye bëjnë për pushtet e interesa fetare. O Imzot, tashti kur qerrja na është thyer në rrugë! Nusja me koçi na ka mbetur mes maleve. Krushqit na i kanë ngrirë në mes të udhës. Aman, mos o Zot edhe kësaj radhe të na fusin në koçi tjetër Nuse. Përsëri, e ka thënë populli: pasi të thyhet qerrja, gjenden plot rrugë për në shtëpi. Burrat e botës nuk lënë faqe të zbrazët në mjetet e informacionit pa i rënë me shqelm kusisë plot me qumësht si lopa e nënkryeme në mes të Lëmës. Tjetër punë është ajo se, e kanë derdhur tambëlin dhe i kanë lënë shumë fëmijë shqiptar nëpër djepa pa ushqim. Ardhmërinë e Nesërme të Atdheut. Vërtetë lirë, shumë lirë na kanë shitur te "vëllezërit". Kulminacioni, ndonjëri më azgani edhe të vret pas shpine, dhe që të nesërmen të kërkon falje publike. Realiteti, sot nuk është gjallë plaku i urtë Anton Çetta të bëjë pajtimin kombëtar mes shqiptarëve, po ka të tjerë pajtimtarë të gjaqeve mes popujve të Ballkanit. Punemadhe që ti ke vdekur, rrëzë Çukës bën çerepë në varr për ta pjekur bukën me saçin e arnuar të skuqur nga shpuza, i ndezur flakë nga degët e Rrapit, në Katund. E, për ringjallje të duhen Tri Zana të të japin gji, zgjojnë nga varri.

Dorasi, "herët" është penduar pas atentatit politik, plot gojën të kërkon falje publike.

Fatkeqësi e madhe kombëtare është, kur dorasi kërkon falje publike. Nuk ka vra një njeri, pesë ose njëqind, po "toptan" një popull. Ngutet të rrëmbej çmime kombëtare dhe republikane për merita patriotike dhe "flijime artistike". E pabesueshme, papritmas shqiptari ortodoks para syve ia rrëmben nga duart. Sançoja shqiptar, nuk mund të pajtohet me këtë veprim të Presidentes Kosovës. Zërin e ngre në një intervistë: Çmimi kësaj radhe është dashur t'i takojë Don Kishotit Shqiptar të tij ideologjik, që gjithë jetën bën luftë heroike për Dylqinenë e Tobozës. Tjetri, merr guximin të kërkojë falje në mjetet e informacionit. Rast ky, tragjik. Nuk e di a mund ta ketë fatin e këtillë unikat ndonjë popull tjetër i Ballkanit. "Vëllai" pasi të vret, pushton me shekuj, dhe t'i bën nëntëdhjetenëntë të këqija, të kërkon falje publike. Përmëtepër, heq veten edhe si "çlirimtar". Jo, s'ma merr mendja. Shkaku se, nuk është njësoj të vrasësh një, dy, disa vetë… dhe një popull. "Heroi" ynë e ka vra nëpër kabinete të Qeverisë dhe parti politike një popull shqiptar. Dhe, turr i kërkon falje një kryetari dhe një partie politike. E politika shqiptare është e mbushur plot e përplot me kësi partizanësh partiak të harruar nëpër kabinete të Qeverisë së presidentit të republikës. Aktorja, kur bëhet edhe

anëtare sigurimi e Kabinetit. Kandari i Çajupit nuk i mbanë tradhëtitë e tyre në dëm të zgjidhjes së çështjes shqiptare.

Mbarë e prapë, bëjnë "politikë madhore". E shesin popullin shqiptar për një vend pune, titull shkencor, post në Qeveri. Nateditë sharrojnë shelgje mes livadheve ende të pakositura rrëzë Çukës. Edhe atë, përderisa nuk u hasë sharra në gozhdë. Ditën, që sharra has në gozhdë, ata janë si rriqërat e deleve. I ngjiten edhe kalit, edhe gomarit. Dhashtë Zoti, nuk i luten Mushkës me të katra këmbët në batak t'i nxjerrë në rrugë.

Shpëtimtari sigurtë si gjithmonë, është kali i "vëllezërve". Vetëmse, jo ai i Skënderbeut dhe Aleksandrit të Madh mes Shkupit me të dyja këmbët e para në qiell. Punemadhe, që kali i tyre nuk ka shalë. Edhe Karposhi në breg të Vardarit e shalon kalin me të katra pa shalë, po nuk u bë nami. Shkak ky, që turqit e hodhën në Vardar. Pse, edhe këta burra mejdani të mos i hipin një "kali" me samar?! I ka hipur Nastradin Hoxha për së prapthi ditën e pazarit për në qytet. Xha Deralla i Cërvicës, kurrë nuk i ka besuar gomarit. Kalë me shalë nuk ka pasur asaj kohe, por e ka pasur Çiflikun me ferra. Pronë, që edhe sot e kësaj dite e njohim si Çifliku i Xha Derallës. Dardhat e egra gorrice, që ai me sharrë në dorë i shartonte nateditë te Jasakët e Tikeve dhe Përroni i Thanës mbi Katund.

Ujë si gjithmonë na ka dhënë Natyra e Zoti, kemi me bollëk, Vardarin që buron matanë Gostivarit, në Vrutok. Burim që mbi pesëdhjetë vjet i ka mbajtur ende "gjallë" shqiptarët ortodoks të asaj ane. Këmbeduar të "lidhur" nga politika komuniste të mos e deklarojnë përkatsinë e tyre të vërtetë kombëtare. Problemi i njëjtë është edhe me torbeshët dhe goranët e Kosovës, që gjatë fushatave zgjedhore lokale e parlamentare brenda një nate marrin nënshtetsi maqedonase, ja sot thonë: ne jemi "maqedonas mysliman". Mirë them unë, po çka janë djemtë tuaj, vajzat e juaja, nipërit?! Ku i keni ato sot, në cilën përkatësi kombëtare?! Tekefundit, a e dini se ia bëni varrin Shtetit më të Ri në Ballkan?! Baçishti, një fshat afër Zajazit, luftë të madhe ka bërë me vite në atë kohë (komunizëm) për shkollë shqipe. E ka detyruar Nijazi Limanin me disa prapashtesa të mbiemrit (ovski, ov, an), në "zbulimin e maqedonasve mysliman" ta vjellë edhe kafenë. Vonë, shumë vonë siç duket u ka dalë gjumi. Gabim historik, të cilin disa kalorës të arratisur shqiptar, përpiqen edhe sot e kësaj dite t'i kthejnë me çdo kusht te burimi për intersa dhe përfitime partiake e fetare. Edhe më të vonuara janë partitë politike shqiptare, që në ditën e sotshme e mashtrojnë veten se numri i tyre simbolik do t'i shpëtojë nga rrëshqitja thyeqafe politike. Ende do t'i mbajë gjallë me pak shpirt në Qeveri. Rasti ma

kujton një familje të Brajeve në fshatin Zajaz. Kohë kur Turqia me të madhe përhapte myslimanizmin në këto anë shqiptare. Gati e gjithë Kërçova me dhunë e pa dhunë (përfitime personale e familjare) e kishte pranuar fenë e halldupit. Brajet një familje problematike e fshatit Zajaz, kurrësesi nuk u bindej urrdhërave të Sulltanit. Atëherë, Sulltani e ndryshoi planin e veprimit politik për asimilimin e shqiptarëve. Pleqtë, mos ngulni këmbë t'i bëni myslimanë, ato ashtu edhe ashtu do të vdesin një ditë. Përpiquni me të gjitha metodat t'i ktheni të rinjtë, ardhmërinë e Perandorisë Osmane! Dikur, e pyeti, plakun e katundit: Çfarë familje janë ata "pis" arnautë?! Plaku i katundit aty për aty iu përgjigjë: familje trimash, kaçakësh dhe kryngritës. Sulltani, zëshëm urdhëroi: atyre, rreptësisht u ndalohet hyrja në xhami!

Ditë më vonë, kur plaku i katundit u kthye nga Stambolli në Zajaz, Brajet i dolën para me setret krahëve te xhamia: Hë, çka tha Sulltani për ne të "pafetë"? Plaku i katundit me plot gojën u përgjigjë: Mjerisht, juve me urdhër të Sulltanit u ndalohet hyrja në xhami. Brajet i hudhën struket që i kishin krahëve dhe nxorrën koburet nga brezi. Kush është ai burrë nëne të na e ndalojë ne të mos hyjmë në xhami?! Njëri pas tjetrit me gjithë opinga hynë në xhami. Kështu, edhe familja e fundit në rrethin e Kërçovës që nuk e

pranonte me dhunë Fenë Islame, në mënyrë vullnetare u bë muhamedane.

Prandaj, edhe Gruevski ndërton një anije provizuese pranë bregut të Vardarit, që të lidhemi përmes rrugës ujore me Greqinë si "turistë". E, Greqia nëpër Preshevë me Serbinë përmes Danubit drejtë e në Beograd. Përmëtepër, të kemi ndonjë bashkëpunim fetar - politik ose si dikur krah pune "me sharrë në krah". Shqiptarët e fundit ortodoks as edhe për farë nuk i kemi me vete në anije. Punë tjetër është ajo se, ata gati të gjithë janë asimiluar (me përjashtim të dy-tre pleqëve), i japin shpresë Gruevskit t'i dalin zot Shtetit Ri. Ani, shqiptarët historikisht më shumë me të dyja duart u kanë dhënë të tjerëve sesa vetes duke i bërë shtet në mes të ballkanit, po vaj halli nëse kthehen tek rrënja edhe bullgarët, vllehët, serbët, turqit, goranët e romët?! Atëherë, kujt do t'i mbetet Shteti Ri i "përbashkët" si popull shumicë? E di, tinëz qeshni me ironi pas kamerave televizive: shqiptarëve.

Vëllezërit ortodoks gjatë këtyre viteve nuk kanë punuar fare për arsimin, kulturën dhe çështjen shqiptare. "Maqedonasit mysliman" e kanë shitur veten për një "qebaptore" me trutë dhe këmbët në legen. Djersën e kanë derdhur me vite në tjetër arë të kojshive. Në kohën e komunizmit, vullnetarisht janë deklaruar si "maqedonas mysliman" për vende pune dhe poste

politike. Shumica e tyre kanë qenë personalitete të njohura politike - intelektuale: gazetarë, shkrimtarë, shkenctarë, ambasadorë, ministra, deputetë, kryetarë të akadimeve të shkencave. Sot për sot, gjithë atë bagazh intelektual përpiqet t'i përvetësojë si heronj antik vetëm politika ditore e Gruevskit, jetë nate të bëjnë në Greqi, e ditën të freskohen me ujë Vardari mes grave të begatshme nëpër fontanat e Shkupit, nën këmbët e Filipit të Maqedonisë. Pse jo, edhe të fotografohen krah për krahu me turistë, kalimtarë rasti para përmendoreve mbi kuaj e më këmbë në të dy anët e Vardarit me thika e pushkë në duar.

Edhe unë autori i këtij shkrimi, shkaku shkrimeve të "egra", më në fund u "kërkoj" falje publike partive politike shqiptare dhe "vëllezërve" të Njerkës. E di se, lutjet për faljen e mëkateve bëhen në kishë para syve të priftit pas perdeve, ose në xhami para këmbëve të hoxhës, po ja unë vendosa kësaj radhe t'i kërkoj si shqiptarët në prehërin e Nënës Parti. Shkaku se, të zë një ditë nëma e Nënëmadhes dhe jo e Njerkës. Populli thotë: ndryshe të mallkon tambëli Nënëmadhes, e ndryshe ai i Njerkës.

Atdheu, kësaj radhe shpëtoi nga shiu, por ra në breshër. Faik Konica, po të ishte sot gjallë, përsëri do të thoshte: ***Shqipërinë, shpëtoje Zot nga Shqiptarët***!...

SHËRBETORI

Atdheu historikisht mbi krye ka patur mbretër, pashallarë, agallarë, kryetarë, presidentë, kaçakë, komandantë dhe shërbetorë. Populli dihet, gjithë jetën ka qenë në rolin e shërbetorit, ndërsa udhëheqesit politik e shpirtëror siç u ka hije në ballë. Teuta ishte Mbretëreshë ilire, po nuk ishte shërbetore. Aleksandri i Madh i Maqedonisë. Skënderbeu poashtu me shumë shokë lufte. Ali Pashë Tepelena. Bajram Curri e Isë Boletini. Kalosh Zajazi e Dervish Cara… Kurrë, nuk ka ndodhur në histrorinë shqiptare, popullit t'i pri shërbetori. Përmëkeq, në shekullin XXI, kur popullit shqiptar i digjet zjarr mbi krye. Nevojë ka për politikanë vizionar e jo për shërbetorë. Vërtetë, Don Kishoti i Mançes e kishte me vete shërbetorin e tij Sanço Pança, po betejave me mullinjt e erës dhe kopenë e deleve në mes të fushës, ai vetë u printe në ballë me shpatë për fitore heroike.

Ndodhë kjo, edhe atë, në Shqipëri. Atdheun dhe Mëmëdheun e Rilindasëve tanë: Sami Frashëri, Naim Frashëri, Jeronim De Rada, Asdreni, Zef Serembe, Mihal Grameno, Gjergj Fishta, Vaso Pashë Shkodrani, Filip Shiroka, Çajupi, Hil Mosi, Ndre Mjeda, Ali Asllani, Fan Noli, Faik Konica, Luigj Gurakuqi… Shtetin e

shqiponjave, që vitin e kaluar e festoi Njëqidvjetorin historik. Tortës së Pavarësisë iu sulë me legenë e karroca dore. Dhe, përçudi pas një fushate zgjedhore plot eufori e premtime (2013), populli e zgjodhi me "vota të lira" një shërbetor t'i pri nga "fitorja në fitore". Përmëkeq, një shërbetor të sprovuar me poste të larta politike: kryetar bashkie e kryetar partie, që vite me radhë i ngatërrohet si ferrë rruge nëpër këmbë Shtetit Shqiptar.

Mjerim kombëtar! E them me plot gojën: ne shqiptarët jemi popull i vonuar me shekuj. Historikisht, po na përsëriten gabimet politike: në kohën e Turqisë, kur e Sëmura e Bllkanit jepte shpirt në shtratin e vdekjes, ne shqiptarët e kërkonim Baba Dovletin, në kohën e fashizmit, kur Hitleri e humbi Berlinin, shqiptarët ende luftonin maleve të Zajazit, në kohën e Jugosllavisë, komunizmi humbte në Rusi, studentët shqiptar në Prishtinë u prinin demonstratave në ballë me fotografinë e shokut Tito. Përçudi, erdhi koha sot këtij populli t'i prijnë edhe shërbetorët. Lumë populli shqiptar. E kënaqën mbretërit, pashallarët dhe agallarët e turkut, tashti u ka mbetur radha ta provojnë veten edhe shërbetorët besnik të Partisë Neokomunsite. Vërtetë, siç duket çështjen shqiptare në Ballkan, më në fund do ta zgjidhë Shërbetori i tyre neokomunist me votën e lirë të popullit shqiptar.

Dhashtë, Zoti! Duartrokitje, binu duarve! Vetëmse, nuk ma merr mendja mes këtyre veprimeve politike pakrye. Shkaku se, ky kalorës i arratisur njëzetë vjet me radhë është në skenën politike. Gjurmët e thella që i ka lënë rrugës me "protesta demokratike" nuk i fshin dot, asnjë stuhi, borë e madhe. Gjithë bota zgjedh në krye të Shtetit, mbretër, krajli, kryetarë shteti, presidentë republike… Shqiptarët për t'u pri në ballë nëpër beteja historike, zgjedhin shërbetorë.

Mirë, do të thoni ju si zakonisht pas dështimeve politike, nuk kemi pasur rrugë tjetër për "Ndryshime – Rilindje": nga dy të keqijat kemi zgjedhur atë më të mirën (Partinë Neokomuniste). Ndonjëri me "analizat e tij profetike" para kamerave televizive edhe: "populli e ndëshkoi me votën e lirë Doktorin". Pavetëdije përbaltin Rilindjen Kombëtare, e cila ndodhë çdo Njëqindvjet. E, për një "Rilindje" të dytë partiake, duhet pritur të kalojnë edhe njëqindvjet të tjerë përmes betejave historike. Dihet, pa bagazhin e djeshëm komunist në shpinë. Mrekullitë historike ndodhin çdo njëqindvjet. Moti e kam thënë nëpër shkrimet e mia publicistike, e përsëris për të njëqindën herë: vërtetë, e ka pasur lehtë gomari me Nstradin Hoxhën (60 kg.) mbi samarë, por vështirë do ta ketë tashti kur do t'i hip në shpinë Nastradinica (120 kg), rrasë edhe më thellë me të katra këmbët

në batak deri në bark. Gabim historik, që nuk është arsye politike. Populli shqiptar në këto zgjedhje "historike" në garë nuk ka pasur vetëm dy parti politike shqiptare. Përmëtepër, dy liderë politik, që të zgjedhë ajkën intelektuale. Doktorin, keni mundur ta ndëshkoni "gabimisht" edhe me ndonjë parti tjetër politike, lider të ri që deri më sot nuk i ka pri mbrapsht popullit shqiptar. Duart nuk i ka përlyer me gjak dhe është mbytur deri në fyt me korrupsion shtetëror. Ndryshim politik ("Rilindje"), vetëm atëherë do të bënim si popull, e jo me kalorës të arartisur që me vite i kemi lidhur në grazhd për brirësh dhe mezi i mbajmë gjallë në skenën politike shqiptare. Burra të grave që e kanë rrokur për fyti, ngulfatë keq politikën shqiptare për të dalë faqebardhë para syve të botës. Nevojë e kohës është sot për një Lëvizje Politike Mbarëkombëtare t'i dalë zot Atdheut. Krah më krah t'ua hapë dyert në politikëbërje edhe rinisë shqiptare. Ardhmërisë, që nesër do të rroket fytas me politikëbërjen e Ballkanit për zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Napolon Bonaparta i madh ka thënë: Më mirë një brigadë gomarësh me luanin në krye, sesa një brigadë luanësh me gomarin në krye. Ose, një mençuri tjetër popullore, kur e kanë pyetur deven se, kur e ka pasur më së vështiri në jetë? Devja është përgjigjur: kur më ka pri gomari. E, nuk e di sa lehtë do ta ketë populli

shqiptar në Ditën e sotshme, kur në ballë do t'i pri katër vite me radhë Shërbetori?! Nesër, ndoshta Doktori. Herë njëri, herë tjetri i hipin e i zbresin gomarit të Nastradinit. E, asnjëri nuk e nxjerrë dot të shkretin nga balta, nuk i hedhë në grazhd së paku një krah kashtë.

Përsëri, nga zemra e plasur copë-copë, siç thotë Fan Noli:

Anës detit i palarë,
Anës dritës i paparë,
Pranë sofrës i pangrënë,
Pranë dijes i panxënë,
Lakuriq dhe i dregosur,
Trup e shpirt i sakatosur.

Them: Zoti i ndihmoftë Shqipërisë, se politikanët e sotshëm hë për hë, nuk e kanë mendjen ta zbresin nga koçia Nusen në Lëmë. Qerrja u është thyer në rrugë mes maleve. Hajdutët ua kanë ndërruar Nusen duke futur në koçi një Xhadi. Krushkat i mashtruan Ditën e Madhe, copë-copë nga gëzimi të mos i bëjnë dajret. Burrat të mos qesin pushkë para porte, hedhin valle krah për krahu me lodra atë këngën e krushqve për Nusen pa kurorë si te ajo vjersha e Vaso Pashë Shkodranit *O moj Shqypni*:

Hajdeni bini djemtë e Shalës, përmes Sarajeve të Pashës!...

DY BRESHKAT E KRYEMINISTRIT SHQIPTAR NË TIRANË

Populli shqiptar, vërtetë kësaj radhe ka bërë "ndryshime" të mëdha politike. Edhe atë, më në fund një "Rilindje Shqiptare". Lakmi t'ia ketë edhe bota. Qëllimin patriotik të cilin nuk e arritën Rilindasit tanë me vite, e arritën Rilindasit socialist brenda një nate me kutitë e votimit. Votën e lirë demokratike ia dhanë Partisë Socialiste (Edi Ramës) dhe Lëvizjes Sociliste për Integrim (Ilis Metës). E dënuan politikën madhore të Sali Berishës: ndërtimin e rrugëve dhe hapjen e tuneleve. Njëqindvjetorin e Pavarësisë të Shtetit Shqiptar. Edhe Bashkimin Kombëtar të Kreshnik Spahiut me aktivitete parazgjedhore me flamurin kuqezi në mes të detit në kufi me Greqinë, Qafë Morinë e Maqedoni. Bamir Topit, nuk i mjaftoi posti i presidentit, patjetër edhe ai duhej të dalë në skenën politike me ushtrinë e tij "strategjike". Veprime politike këto të politikanëve shqiptar, që pasi i humbin postet partiake, themelojnë parti politike për t'u kthyer përsëri në pushtet deri në vdekje. Punemadhe, që në skenën politike shqiptare vite me radhë rrotullohen të njëjtit partizanë fushe, të njëjtit aktivistë partiak të fundosur nëpër kabinete.

Politika, shumë burra kanë thënë se: është kurvë. Politikanët, "art" i së mundshmes në fushëbetejat politike. Edhe ajo Xhadia, përçudi i do vetëm kurvarët e jo burrat besnik të grave. Zgjedhjet e fundit (2013) na bindën se, politika shqiptare e zgjodhi për burrë Edi Ramën. Burrin, që shumë mjete të informacionit në Shqipëri i bënë fushatë parazgjedhore duke e nxjerrë lakuriq në plazhë si burrë i disa grave. Piktorin, që Fatos Nano e solli nga rrugët e Parisit me "thonj të paprerë" në politikën shqiptare. Vërtet, në Paris nuk arriti ndonjë famë të madhe botërore në fushën e artit pamor, ama në Tiranë e realizoi kryeveprën e tij artistike: *Dy breshkat politike në Kabinet*. E tejkaloi librin e tij "bestseller" *Kurban*, që e përuroi në Panirin e librit në Tiranë, Prishtinë e Shkup. Kundërshtarin politik, që Sali Berisha e raklamoi edhe në Facebook. "Letra dashurie" i shkruanin njëri-tjetrit përditë e përnatë plot "flijime artistike".

Politikani i " ri ", Edi Rama do ta ndryshojë Tiranën duke i rrënuar ndërtimet pa leje dhe ngjyrosur fasadat e ndërtesave të vjetra të Kryeqytetit shqiptar. Ndërtoi vendstrehimin e tij strategjik në politikë, për t'ia grabitur nga duart Fatos Nanos edhe Nënën Parti. Rasti ma kujtoi librin e shkrimtarit Stefan Cvajg: *Zhozef Fushe*. Prifti, që përpiqej me çdo kusht t'ia marrë pushtetin Napolon Bonapartës. E ky si politikan i

zgjuar që ishte, gjithmonë e shpërblenete me poste politike sa më larg vetes nëpër botë. Veprim politik të cilin nuk e bëri Fatos Nano, prandaj edhe ia vodhi Partinë Socialiste, miku i tij Edi Rama. Ferrë e keqe kjo që na mbiu te pragu i derës, në oborrin e Partisë Demokratike dhe Sali Berishës, qe me vite do t'i ngatërrohet nëpër këmbë Atdheut. Shqipërinë do ta përbaltin me veprimet e tyre politike pakrye duke bërë nateditë luftë për pushtet.

Kalorësi i arratisur, vite me radhë do t'i përdorë të gjitha "mjetet demokratike" për t'ia vjedhur pushtetin edhe Sali Berishës. Lufta do të zhvillohet në Kuvend e rrugë para kamerave televizive me të gjitha armatimet e rënda tokësore e qiellore. Herë – herë, edhe përmes mjeteve informative elektronike në dylyftime. Ciu Ciu në betejat e përgjakshme historike "vdekje, ose pushtet" do ta sulmojë keq ballë për ballë Doktorin, i cili mendoi se lufta politike është një komedi artistike e Çajupit: *Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër*, që luhet në Teatrin Kombëtar Shqiptar. Ose, gomarit në politikë duhet t'i hipësh si Nastradin Hoxha për së prapthi kur shkon në pazar përmes Fushë Krujës me grurë deri në brez. Nastradinica t'i pri gomarit rrugicës pas Çuke me dajre e këngë dasme duke e hequr për kërpeshi. Pavetëdije, se ajo në vend që t'i pri për në pazar, do ta shpie në gojën e ujkut në mes të malit me

shkurre. Politikën shqiptare, një ditë ta nxjerrë në rrugë nga bataku. Pushtetin ta rrëmbejë edhe me dhunë në mes të Ditës Madhe. Fitorja dihet: disa të plagosur dhe të vrarë para Qeverisë Shqiptare.

Humori i zi politik u vu në skenë në Teatrin e Parlamentit Shqiptar. Rolet u ndanë sipas Regjisorit. Edhe, u hapën perdet artistike para syve të popullit dhe botës, filloi shfaqja teatrore me dy role kryesore: Sali Berisha dhe Edi Rama. Rolet tjerë ua lanë aktorëve të vegjël që hynin e dilnin të pavërejtur nga publiku në skenë. Tema e dramës antologjike ishte "politika madhore" shqiptare. Duartrokitjet frenetike jehuan në sallë posa u ndezën dritat. Aktorët e përqafuan njëri – tjetrin para kamerave televizive dhe e përgëzuan për "fitore historike".

Natën e premierës prapa skene, drama edhe fitoi çmimin e festivalit teatror. Edi Rama u shpallë aktori më i mirë i vitit me gjithë autobus. Nga të katër anët e Mëmëdheut i arritën edhe përurimet e para përmes gazetave të "pavarura". E përgëzuan Hashim Thaçi e Ali Ahmeti. Daçiqi e Gruevski. Analistët servil e Patrioti i vonuar.

Burri i botës nga gëzimi i "fitores historike", në Kabinetin e tij për këshilltare i mori edhe dy breshka. Kohë qorre kjo, kur shumë artistë janë të pa punë, vdesin edhe për bukën e gojës. Nuk funksionon siç duhet edhe një Lidhje e Shkrimtarëve Shqiptar në Tiranë, që

"demokracia" ia mori edhe shtëpinë. Kulminacioni i ironisë: njërën e pagëzoi me emër e mbiemër Sali Berisha dhe tjetrën Fatos Nano. Populli shqiptar, kur i pa para kamerave televizive Dy breshkat këshilltare të Kryeministrit Ri në vend të ndonjë "artisti të papunë", nuk e përmbajti veten nga "gëzimi", po u ra durve shuplakë: Ja, më në fund erdhi koha ta kemi Kryeministrin evropian të veshur me tirqi e xhamadan, mu si Mic Sokoli që dikur e kapi topin për fyti, burrin që i duhet Shtetit Shqiptar. Kryeministrin, që përmes Facebookut u bënë thirrje shqiptarëve, "kuadrit të aftë politik e shkencor" t'i luten para këmbëve për vende pune krah për krahu me dy breshkat artistike si shefe kabineti. Vendin e shqipeve mbi shpinën e Dy breshkave ta shpjerë në Evropë, nxjerrë nga kriza politike e ekonomike Shtetin e "Rilindjes së vonuar Shqiptare".

Publiku gjatë ngjarjes së premierës, vetëm i hapi sytë e përgjumur duke u dalldisur pas mizanskenave artistike për të pritur çthurejn e dramës në Kuvendin Shqiptar. Cili do ta marrë Çmimin e karrierës "artistike". Shkaku se, në konkurrencë momentet e fundit hyri edhe një aktor i Holivudit: Ilir Meta. Momente historike këto për popullin shqiptar, kur nuk u dihet fundi ndarjeve të çmimeve "artistike" në nivel shtetëror. Artisti me famë botërore, në momentet

kritike ndodhë t'ia rrëmbejë nga duart Çmimin e krrierës Edi Ramës, kryeartistit të skenës shqiptare. Autorit të muzeut historik: "Art Bunker". Ekspozitës historike të Shekullit: Kryeveprës artistike botërore me Dy breshka kokë më kokë në Kabinet…

DALLDISJE PARTIZANE

Përçudi, pas publikimit të shkrimit tim publicistik: *Dy breshkat e Kryeministrit kokë më kokë në kabinet*, m'u ndërsye me të gjitha "forcat politike e intelektuale" Kopeja me zgjebe e "patriotëve kuqezi". Gurë e dru hudhën mbi mua si shkrimtar. Qysh kisha marrë guximin t'ua "urrej" publikisht Kryeminstrin e shekullit, Edi Ramën. Burrin e botës, që para kamerave televizive i kishte marrë si "këshilltare" dy breshka në kabinet. Kokë më vete i pagëzoi edhe me emrat e dy paraardhësve të tij (në Parti e Shtet): Sali Berisha dhe Fatos Nano. Haptas e ofendoi më tepër se gjysmën e popullit shqiptar brenda e jashta kufijve politik të Atdheut. Fatkeqësi kombëtare. Burri i botës luajti me iluzionin e tyre që një kohë gjatë ndryshimeve demokratike kishin fituar besimin e popullit shqiptar, udhëhequr me Shqipërinë.

Edhe atë, kush mu turrën me sharje e ofendime?! Partizanët e Nënës Parti, dje si socialistë ose demokratë të Fatos Nanos e Sali Berishës, sot "rilindasë" të Edi Ramës. Pavetëdije, se me pagëzimin e dy breshkave në kabinet me emrat e ish kryeministrave shqiptar, bythekrye u rrokullisën në thesin me arna edhe ata vetë si partizanë partiak në histori. Në vend,

që kësaj radhe pas "fitores historike" t'ia "tërheqin veshin" Kryeministrit në pritje për dalldisje politike në pagëzimin e breshkave me emrat e dy ish kryeministrave, ashtu siç ia "tërhoqi" veshin ai një diplomati shqiptar para syve të botës, ata turren të fundosen me gjithë heroin e tyre mbi gomar në fund të hurdhës. Thanë, e çka nuk thanë për mua si shkrimtar: i sëmurë psiqik, pseudoshkrimtar, idiot e spiun serb. Edhe, nëse jam i "sëmurë", mua më ka hije si shkrimtar, po nuk i ka hije një politikani (Kryeministri në pritje) që duhet të udhëheq me Shqipërinë drejtë Europës.

Etiketime rrugaçësh "kuqezi" me gjuhën kërcnuese plotë urrejtje, që mendojnë se më mirë ato më njohin mua si shkrimtar, sesa unë vetveten dhiareve për në Baba Tomor. Thashetheme partizanësh të kotecit pulave, vetëm e vetëm për një shami të kuqe pionierësh përqafe si shpërblim për "flijime artistike" për pushtet. Veprim tërbimi shqiptar, që na e bën me dije se, edhe gjatë kohë na duhet punë me këta rrumaducë melez për Bashkim Kombëtar. Shqipëri Etnike.

Unë, sipas "trurit" të tyre teknefes, isha "antishqiptari" që kisha dalë të pastrojë "oborrin e kojshive" (Shqipërinë). Qesharake, ë? Mentalitet i çuditshëm shqiptar, që të lexon për së prapthi e të komenton në vend të trurit me palarenë në "hava" mes livadheve. Netedité, duke u thirrur në

"demokraci", përpiqen me çdo kusht të më imponojnë mendimin e Kopesë të një partie politike "Ndryshe". Ndryshime politike nuk bëhen vetëm me dy parti politike njëzetë vjet me radhë në pushtet, herë i hip njëra e herë tjetra në shpinë popullit shqiptar. Përmëkeq, edhe gjatë fushatave parazgjedhore pjellin viça të palëpi në grazhd të kalit. Dorën në zemër, jam i vetëdijshëm se kështu nuk mendon dhe gjykon shumica e populli shqiptar. Përndryshe, vaj halli për Shqipërinë e Faik Konicës që edhe sot duhet ta shpëtojmë nga shqiptarët.

Popullin shqiptar, sot për sot nuk mund ta përfaqsojë një – dy, ose tri parti politike. Ashtu, siç nuk mund të flasin e t'i dalin zot krye më vete në emër të tij edhe bashkësitë fetare në vend (Xhamia islame, Kisha katolike dhe Kisha ortodokse). Përjashtim këtu, mund të bëjnë Xhamia shqiptare dhe Kisha shqiptare e Fan Nolit në shërbim të kombit dhe Shtetit shqiptar. Kurrsesi, partizanët e dalldisur shkurtpamës me "pushkën në krah" të një partie politike neokomuniste, që janë pakicë në krahasim me një popull mbi dhjetë miljonë shqiptar të shparndarë nëpër botë si Kashta e Kumbarës: në Shqipëri, Kosovë, IRJ të Maqedonisë, Mal të Zi, Çamëri, Serbi, Turqi e në Diasporë.

Populli shqiptar, sot për sot ka nevojë për bashkim kombëtar e jo për përçarje politike

partiake e fetare. Nuk e them këtë unë, historia shqiptare e ka dëshmuar moti me kohë: Ismail Qemali, nuk do ta valonte flamurin kombëtar kuqezi në Vlorë, shpallë Pavarësinë e Shqipërisë, po të mos i vinte në ndihmë Isë Boletini me kosovarët trima. Tjetër punë është ajo se, dy forcat më të mëdha politike në Shqipëri, Njëqindvjetorin e Pavrësisë e festuan njëra në Tiranë e tjetra në Vlorë. Punemadhe, shqiptarët e dinë rrugën qoftë ditën, qoftë natën për në Baba Tomor, Atdheun e perëndive.

Trusakatët partiak, që e kanë gjetur sofrën e shtruar nga Rilindasit shqiptar, mendojnë se ajo dhuratë lufte me penë e pushkë u erdhi nga qielli. Shqipërinë nuk e bëri një parti politike, prandaj edhe nuk mund t'i dalin zot vetëm partizanët e një partie politike, po mbarë populli shqiptar. Përmëkeq, këta partizanë të arratisur me vite nëpër parti politike për interesa personale e familjare, Shqipërisë njëzet vjet me radhë i janë ngatërruar nëpër këmbë. Mendja ende i rren edhe në Ditën e sotshme se mund ta nxjerrin në Pazar si plaçkë lufte, shesin me pare. Vdiq koha kur për Shqipërinë vendoste vetëm Partia e Punës, populli që jetonte brenda kufijve politik. Tashti, Shqipëria nuk ka kufi me Kosovën. Nesër nuk do të ketë as edhe me IRJ të Maqedonisë e Malin e Zi. Dhashtë Zoti, ajo ditë të vijë sa ma parë Rrugës së Kombit. Përndryshe, kështu siç e kanë

nisur disa kalorës të arratisur shqiptar, Kosova një ditë do ta "pushtojë" Shqipërinë.

Rilindasët tanë nga të gjitha trojet shqiptare të bashkuar mezi e bënë atë copë Shqipëri, që sot disa trusakatë me veprimet e tyre politike qorre, përpiqen t'ia sakatojnë gjymtyrët e trupit. Gabim e keni, o partizanë mejdani të Nënës Parti! Farën që e mbollën dikur Rilindasët tanë anembanë Atdheut, sot ka shpërthyer dhe lëshuar shtat në të gjitha trojet etnike shqiptare.

Shqipëria, sot për sot nuk ka mbetur grua e vejë vetëm në mëshirën e një partie politike, një Kryeministri që ende pa u ulur në shkam, nuk e di se ku e ka kokën e ku bythën, ofendon përgjumshëm më shumë se gjysmën e popullit shqiptar anembanë Atdheut.

Publikisht e them: Partizanët e këtij soji turren brenda stazave politike të shkurtëra partiake vetëm për një shami të kuqe përqafe. Nuk shohin më larg se kabineti i tyre, ku janë fundosur deri në fyt me korrupsion qafë për qafe me dy breshkat e Kryeministrit. E, unë shoh pak më larg, matanë Lëmës. Bërlloku shqiptar, që ende nuk e di se nga kemi ecur, kemi lënë me vite gjurmë aq të thella rrugës deri në brez, sa që nuk i fshin dot asnjë stuhi, dëborë e madhe. Koha është sot, dudumët t'i hapin rrugë krah më krah gjenaratës së re të politikanëve shqiptar.

E përsëris: Shqipëria në Ditën e sotshme, nuk bëhet me hajni e theshetheme partizanësh të një Kryeministri në pritje, që luan rolin e Arushës me dajre me një shami të kuqe pionierësh përqafe të xhaxhit Enver, por me punë dhe vepra madhështore kombëtare...

DEXHALLI ARAPIT

Edhe, si zakonisht ulem t'i marrë "ilaçet" e mia krah për krahu me gratë azgane të Filipit të Maqedonisë me fëmijë në gji e prehër, përballë Kishës Ortodokse "Shën Dhimitri" te këmbët e Urës Gurit. Herë pas here, sipas tingujve të muzikës triumfale, njëra nga gratë e hazdisura të Filipit Maqedonisë i ndezë-shuan dritat e të gjitha ngjyrave festive. Shatërvaneve gjigante që në këto ditë vere me vapë gushti, përpiqen me ujin e Vardarit t'ia shuajnë "zjarrin" e ndezur me flakë Shkupit. Qytetin me dy stinë të vitit: Verë dhe Dimër. Pranverë dhe Vjeshtë, moti nuk kanë parë këta banorë të harruar nga Bashkimi Evropian dhe Zoti, rrëzë Kalasë Dardane.

Matanë tavolinave, sytë më ikin te shatërvani me katër luanë që vjellin ujë nateditë. Përçudi, vetëm njëri e ka hapur gojën, i ka nxjerrë dhëmbët dhe thonjtë nga Çarshia shqiptare. Tre të tjerët gojëhapur, nuk vjellin asnjë pikë uji nga ana maqedonase, matanë Vardarit. Në anën tjetër të Urës Gurit, kuaj pa kalorës me shalët e bishtin nën beton e këmbët në qiell, sikur duan ta shkelin pasmesnate Çarshinë. Edhe atë, në këtë vapë të madhe, herë pas here nuk kanë as një kovë ujë në bark për ta shuar etjen. Luanët, matanë mbi urë në hyrje - dalje, bythë më bythë bëjnë roje rrëzë

Kalasë. Mitropolitët e Beogradit me Biblën e kryqa në duar, moti janë nisur më këmbë drejtë Shkupit shqiptar. Aleksandri Madh i Maqedonisë e ka shaluar kalin me shpatën lartë në dorë për luftë. Filipi Maqedonisë i delë para me grushtin te koka duke e përshëndetur si xhaxhi Enver. Skënderbeu mes parkingut të makineve, fillkat vetëm i pret vëllezërit antik me shpatën në brez mbi kalë e dorën lartë për paqe: Ndaluni, o burra e gra azgane, këtu është kufiri natyror! Vështirë e keni ta kaloni Vardarin mbi Urën e Gurit pa dy anijet e Gruevskit që ndërtohet matanë lumit, pranë bregut për t'ju përcjellur me trumbeta e muzika në Greqi. Hasan Prishtina, falë "historinëve" shqiptar, siç duket gjatë muajit të Ramazanit iu lutë Zotit në mes të parkut për Rumelinë. Interesant, kujt t'i teket për të dalë në "syrret artistik" me nga një tufë lule në dorë fotografohet para kamerave televizive. Zhurmë politike e pak punë për Shqipëri Etnike. Pavetëdije, e vrasin trimin historik për së dyti herë jo me pesë plumba në Selanik, po me një "tufë lule" në mes të Shkupit.

Një grusht "patriotësh kuqezi" të dalldisur e të arratisur nëpër Çarshi, në shënimin e pesëdhjetëvjetorit të tërmetit katastrofal në Shkup, debatuan plot zhurmë historike krah për krahu me "vëllezërit" në një librari të Bit - Pazarit se, Shkupi deri para tërmetit katastrofal ka qenë i

banuar me shumicë shqiptare?! Jerm, "vajtojnë" e derdhin lot krokodili para kamerave televizive, plasojnë dezinformata historike dhe huti në opinion, se: shqiptarët i shpërnguli në Turqi tërmeti katastrofal (1963) e jo Regjimi komunist me dhunë, përmes strukturave pushtetare e sidomos UDB –së jugosllave. Dukuri teknefese kjo e llojit të vet "patriotik" anadollak në Ditën e sotshme, nën direktivat e politikës trumbetuese ditore për "bashkëjetesë" që e shpie Historinë shqiptare në qorrsokak politik. Shkaku se, shpërngulja masovike dhe dëbimi i shqiptarëve me gjithë familje në Turqi, nuk ka filluar pas tërmetit katastrofal (1963) në Shkup, por shumë më herët që nga Marrëveshja e Turqisë Kemaliste që pati bërë me Jugosllavinë Mbretërore (1938). Marrëvëshja tjetër mes Jugosllavisë dhe Turqisë për shpërngulejn masive me dhunë të shqiptarëve në Anadoll, u nënshkrua në Split të Kroacisë në vitin 1953 mes Josip Broz Titos dhe minsitrit të jashtëm turk Mehmet Fuat Kypryly.

Shqiptarët, si rezultat i këtij presioni politik u regjistruan si turqë dhe pati një rritje të ndjeshme të pakicës turke në Kosovë e Maqedoni. Serbia shpërngulejn e shqiptarëve për në Anadoll e bënte haptas para syve të Evropës, e cila në atë kohë si Njerkë e shqiptarëve, përfitonte prona dhe shtëpi të braktisura për kolonistët serb. Proces ky, i turqizimit masovik të shqiptarëve, që

fatkeqësisht zgjatë aty - këtu heshturazi edhe në Ditën e sotshme përmes misionarëve fetar "mysliman" - psikopatë antishqiptar, që nateditë rrinë në YoTube dhe Facebook duke "vajtuar" e derdhur lotë krokodili për popullin "vëlla" turko-arab. Faji i atyre dy marrëveshjeve politike, shqiptarët e fshatrave të Karshiakës së Shkupit deri në regjistrimin e vitit 1981, ishin të regjistruar si turqë "ehamdurila". "Zbulim" i ri ky, i një grushti "patriotësh kuqezi" pa kokë të arratisur nëpër parti politike, që përpiqen të përurojnë në Shkup "përralla turko-arabe" me trumbeta të grisura arnë përmbi arnë si "zbulim shkencor historik", se: shqiptarët me gjithë familje u shpërngulën vullnetarisht rrugës natyrore nga tërmeti për në Turqi?!

Vetëmevete, them: kujt i është kujtuar kjo "ide madhore" e pushtimit të Shkupit me vepra antike e dezinformata historike: artistëve dhe historianëve, apo Gruevskit e Erdoganit?! Përpiqen me këmbëngulje ta "zbusin" Historinë Shqiptare nëpër plan-programet shkollore. Papritmas, më kujtohet edhe thënia e Hazreti Muhamedit a. s.: nëse bregu nuk vjen te Muhamedi, atëherë Muahamdi shkonë te bregu. Që, sipas gjuhës politike evropiane të pajtimit me "vëllezërit" e Njerkës do të thotë: Nëse, Ali Ahmeti nuk shkonë te Gruevski, atëherë Gruevski dhe Erdogani vijnë te Ali Ahmeti.

Çarshia shqiptare si për inatë, përditë e më shumë gjallërohet verë e dimër. Përveç banorëve të asaj ane e vizitojnë edhe shumë turistë. Përkarshi rakisë së rrushit deri në "syfyr", çohen dolli edhe gotat e çajit të rusit "hallall". Lokalet nuk mbyllen në mes të ditës si në kohën e LSDM –së dhe PPD -së, po punojnë edhe natën deri në agim. Shqiptarët, si zakonisht flejnë në mes të ditës, janë ende në gjumë. Gjatë muajit të Ramazanit punuan sipas orarit të punës në harmoni me ligjet e shtetit edhe Zotit. Hoxha i YouTube dhe Facebook nga Shkupi, Prishtina, Tirana e Londra përmes altoparlantëve në minare (shejtan arapëve) e thirrë "ezanin". Hoxha i Allahut, për inatë thirrë "sabahun": O "myslimanë", zgjohuni dhe rrokuni për pune! Përndryshe, Shejtani Allahut do t'ju përmjerë në gojë dhe nuk do të zgjoheni gjithë ditën. Fatkeqësisht, "myslimanët" nuk e dëgjojnë Hoxhën e Allahut, vazhdojnë me gjumin e arushës. Çarshia formalisht duket se merr lirisht frymë. Dexhalli Arapit me trumbeta i bie përmidisi Çarshisë shqiptare. Kurreshtarëve që dalin në rrugë ua vë nga një vulë në ballë. Punën ia lehtëson Xhebrahilit pas Përbmytjes së Madhe (Kiametit), dënojë besimtarët sipas mëkateve. Poetë servilë Oborri dhe minorë shqiptar marrin pjesë në Mbrëmjet e Poezisë Strugane, kur Kryetari i Komunës Strugës Zejadin Sela me

arsye e bojkoton festivalin, shkaku mosrespektimit të gjuhës shqipe. Krah për krahu të buzëqeshur dalin në fotografi me shpresë se nesër do të hyjnë edhe në histori si pishtarë të "vëllazërim-bashkimit". Artisti më i madh shqiptar, Xhevat Limani, kur i sheh kaq të lumtur e të dalldisur pas poezisë "patriotike", i përshendet me një koment te INA. Dexhalli Arapit, siç duket dudumë-shqiptarëve u ka hyrë në bark. Edhe, seç ma kujtojnë kohën e viteve shtatëdhjeta, "vëllazërim-bashkimin", kur e gjithë ana tjetër maqedonase matanë Vardarit, grupe-grupe dyndeshte në mbrëmje në këtë anë të Çarshisë shqiptare. Vite rinie, kur Skënderbeun e mbanim fshehurazi nën jakën e setres. Kohë e përndjekjeve të mëdha, kur një Mike "turke", guximtare e kojshive në atë kohë edhe ma qëndisi me penjë të zi në këmishën e kuqe gjak me jakë të zeza portretin e Skënderbeut. Fotografi artistike, të cilën e ruaj me xhelozi edhe sot e kësaj dite në këmishën e kuqe arnë përmbi arnë në albumin familjar. Kurrë, nuk më ka shkuar mendja se, Heroi ynë legjendar një ditë do ta shalojë kalin e tij me të katra edhe në Shkup. Tjetër punë është ajo se, sot dudumët ende nuk duan t'ia përmendin as emrin Kryetrimit legjendar Skënderbeu, po ende "takimet e punës" dhe sofrat e "iftarit" i lënë dhe shtrojnë te "Kali". E kënaqën Shqipërinë, Kosovën, IRJ të Maqedonisë e Malin e Zi me

ilahi, tashti u ka mbetur radha ta "çlirojnë Vatanin" dhe të bien "shehit" për Sirinë.

Rryma radikale të Fesë Islame dhe asaj Ortodokse nga të katër anët i sulen Skënderbeut dhe institucioneve kulturore të Shtetit Shqiptar. Përçudi, politika e sotshme shqiptare mbyllë gojën dhe veshët para bashibozukëve, nuk i merr në përgjegjësi halldupët e tërbuar në emër të Ligjit dhe Shtetit Shqiptar. Njëherë e përgjithmonë t'ua bëjë me dije se, sot për sot Trojet etnike shqiptare nuk janë Turqi e as Arabi. E, nëse i ka marrë malli për "vëllezërit" e Fesë Islame, mund të shkojnë kur të duan sipas vullnetit dhe dëshirës, jo si dikur me tren përmes Shkupit, po me aeroplan "xhamboxhet" nëpër qiell mbi "mjegulla" të përshëndetur edhe me rrufe. Serbët, në atë kohë ua hapën rrugën për në "Xhenet", sot do t'i përcjellim ne shqiptarët me lodra e cingana përmidis Pazarit Shkupit. Dihet, sipas traditës shqiptare: te pragu i Derës Madhe do t'ju vëmë një xhygim me ujë t'i bien me këmbë, derdhin ujin. Në fund, do t'ju hedhim edhe një gur përmbrapa, që kurrë më të mos kthehen në Shqipëri. Nuk na duhet kjo farë e keqe hithëre, që e barazon Skënderbeun me Sllobodan Millosheviqin dhe Sheshelin. Symëshelë kanë hipur bythëprapë në minare, ose janë shitur një pjesë e lidershipit fetar, është vënë në funksion të politikave të shteteve të jashtme islamike. Grupe

interesi personal e familjar në emër të Fesë Islame vazhdojnë të shfryejnë nateditë plot duf e mllef edhe në Ditën e Sotshme ndaj figurave kryesore kombëtare shqiptare.

"Përgëzime"! Hazreti Muhamedi a. s. ka ardhë te bregu. Fatkeqësia është, se: asgjë nuk ka të veshur në shpirt e trup shqiptare. Tekefundit, së paku ta kishte në kokë kësulën e bardhë të Bajram Currit në vend të çallmës "myslimane". "Iftari" i Ramazanit në mënyrë festive bashkë me ilahi u shtrua para këmbëve të Skënderbeut. "Myslimanët" edhe këtu si në Tiranë e Prishtinë, iu sulën me të gjitha focat grupe-grupe me "Allahu Akbar", sikur t'i suleshin Shejtanit Allahut. Bashkia e Kavajës (Shqipëri) gjatë festës së Bajramit e shtroi tortën e gjatë 25 metra "hallall". Tortë të ciliën e shtroi qindra herë më të madhe në sheshin e Tiranës Sali Berisha në Njëqindvjetorin e Pvarësisë të Shtetit Shqiptar, edhe siç duket asaj torte ia pa "hajrin". Tortës së Pavarësisë, shqiptarët iu sulën para syve të botës me legenë e karroaca dore. Tortë festive fetare "hallall" shtruan në sofër edhe shumë politikanë në Tiranë, Prishtinë, Shkup e Tetovë. Edhe pse, besimtarët e vërtetë të Fesë Islame ende e kërkojnë atë sofrën e dikurshme tradicionale shqiptare modeste gjatë festave fetare. Tjetër punë është ajo se, ato para që i derdhin sot me thasë nëpër rrugë e parqe mes bërllokut për

Ramazanin dhe dasmat familjare plot "salltanete", lirisht mund t'i derdhin për mëkambjen e arsimit dhe kulturës shqiptare.

Hije dikur na kishte si shqiptar, kur vinte Bajrami në trojet etnike shqiptare. Tashti dudumët i kanë banalizuar edhe festat fetare me simbole turko-arabe e ilahi patetike përsheshiane. Përditë, në mes të Shkupit organizojnë protesta politike-fetare t'ju dalin në ndihmë "vëllezërve myslaiman" me ushtarë vullnetar në Siri për "Vatanin dhe Imanin". Hoxha në atë kohë, kur hipte në minare, nuk çirrej përmes altoparlantëve (shejtan arapëve). Xha Habibi na zgjonte me lodër për "syfyr" shtëpi për shtëpi, përderisa i ndiznim dritat: Ooo Çelike, zgjohuni për "syfyr"! Përderisa, nuk ju ka mashtruar Dexhalli Arapit me gjumë "hallall"! Përsëprapthi, nuk shtronim sofra "iftari" nëpër sheshe e parqe, nuk i luteshim Allahut në mes të rrugës të na i falë mëkatet.

Dudumët, sot na e kanë bërë banal edhe Ramazanin, edhe Bajramin. Fenë Islame e kanë zhveshur lakuriq nga tradita shqiptare. "Myslimanët" e sotshëm thonë: kanë bërë "ndryshime" rrënjësore. E di, arabo-turqit do të na e marrin pak inatin, pse sofrën e "iftarit" e shtrojmë në rrugë para këmbëve të kalit të Skënderbeut, syve të botës. Dikur, zemërohem, edhe me Skënderbeun, si nuk e nxjerrë më në fund edhe ky burrë mejdani shpatën nga brezi dhe

me një të rame presë kokën dudumëve, hedhë para këmbëve të kalit si kunguj Stambolli.

Punemadhe. Përgjigje: në anën shqiptare, në mes të Çarshisë, grupi tjetër radikal i "myslimanëve" me Hoxhë YouTube e Facebook, në mes të rrugës i luten Zotit t'ua falë mëkatet në "Mekën maqedonase". Përveç xhamive, faltore të "Allahut" duan t'i shpallin edhe rrugët e Bit - Pazarit. Kalimtarët e rastit nëse nuk duan t'i bashkohen "xhematit" të tyre me "Din e Iman" për në "Xhenet", mund të presin të kryehet ceremonia fetare në mes të qiellit hapur me bythët në hava mes gjithë këtyre xhamive me dy e katër minare e me pak shkolla fillore në Shkup e nëpër katunde, që të përkujtojnë se ndodhesh në vendet arabe ose Stamboll e jo në Shkup, Kreqytetin më të madh të banuar me shqiptar pas Tiranës. Edhe, dëshpruese është në kohën e fundit kur dëgjon e lexon në mjetet e informacionit se, disa këngëtare deri dje "nuse pa koçi" të lokaleve të natës "mbajnë" Ramazan. Moti e kam ditur se këto këngëtare nuk janë të lindura, nuk e kanë dhunti këngën nga Natyra e Zoti. E kanë mashtruar veten dhe të tjerët se janë këngëtare me famë shqiptare. I hidhni një sy dhe veshë reportoarit të tyre që rrotullohen nateditë përmes valëve të radiostacioneve televizive të vendit dhe nëpër fushata parazgjedhore të partive politike, asgjë nuk kanë në gjak dhe shpirt origjinale, përveç

imitimeve të zbehta të muzikës rome, serbe, bullgare dhe turko-arabe.

Zoti u ndihmoftë! Po, jam i sigurt se këngët e tyre nuk do të jetojnë gjatë, edhe po të mbulohen këmbekrye me veshje arabe dhe t'i luten Zotit natediditë në xhami me bythët dhe "zogun" në "hava". Shkaku se, shumica e këtyre "hanëmëve" nuk e kanë dhunti nga natyra, po e kanë detyrim nga mamatë dhe baballarët e tyre, që patjetër fëmijët e tyre duhet të bëhen këngëtare. Dhe, nuk duhet të çuditemi, që kohën e fundit këngët tona popullore janë të mbushura përplot lule xheneti, xhanë, sheikë e ashikë turko-arabë. Fatkeqësisht, jemi bërë si popull edhe më zi se serbët, kemi filluar t'i festojmë humbjet e luftës, vrasjet dhe ditëvdekjet e heronjëve kombëtar, në vend të ditëlindjeve dhe fitoreve.

Edhe, për fund: Lamtumirë lexuesi im me "Din e Iman" mes dy zjarreve! "Mysliman" me kokën në xhami e bythën në polici dhe shtetet arabe. Ose, siç thotë populli shqiptar: Hipë se të vrava, zbrit se t'vrava! Koha është, tashti edhe për mua pak pushim i merituar vjetor. Edhe mua, në këto ditë me vapë të madhe në Shkup para këmbëve të Alaksandrit Madh mes luanëve që vjellin ujë "xheneti" me shtamba, më digjet zjarr mbi krye, më pret faltorja ime me nëntë minare: Xhamia shqiptare...

ÇIFLIKU I XHA DERALLËS

Poetët nga të katër anët e Atdheut erdhën në Kërçovën historike. Vendlindjen e Kalosh Zajazit, Sulltanë Qafës, Sadin Selmanit, Nezir Koxhës, Osman Gjinit, Sefer Zajazit, Xha Derallës, Emin Xhambazit (Çeliku), Nefruz



Çelikut që e mbyti ujkun me dorë… Dhe, e pyetën një plak para porte në fshatin Cërvicë: O plak, ku është Çifliku i Xha Derallës?

Plaku u ngritë më këmbë me gjithë mjekrën e bardhë dhe shkopin me kërrabë. Mirëse erdhët, o burra të grave! Çifliku i Xha Derallës është në Kërçovë, tek ajo Çuka pas malit, drejtoi plaku në vend të gishtit tregues shkopin me kërrabë. E shihni atë Çukë në mes të Qytetit? Atje, është Çifliku i Xha Derallës.

Po, i thamë ne gati njëzëri. Faleminderit, o plak. Dhe, morëm rrugën krah për krahu me gjithë poezi për te Çifliku i Xha Derallës.

Rrugës e takuam Date Koçin, që me Kryetarin e Komunës z. Fatmir Dehari për herë të parë në Kërçovë organizonin Javën Kulturore Kërçovare. I thamë: jemi nisur për te Çifliku i Xha Derallës. Qeshi, Date Koçi. Çifliku i Xha Derallës është afër Përronit të Thanës, në fshatin Cërvicë. E, kush ju dërgoi në këtë anë të Kalasë së Kërçovës historike?!

Një plak me mjekër e kësulë të bardhë në kokë, iu përgjigja.

Përsëri qeshi, Date Koçi. Ai me siguri ka qenë Xha Deralla. Përmëtepër, ju paska mashtruar, ka bërë pak shaka si gjithmonë edhe kësaj radhe me poetët. Gjatë një vizite, njëherë moti në katund është tallur edhe me xhandarët e serbit. Vite më vonë, gjatë ndryshimeve demokratike, pasardhësit e tij e kanë mashtruar edhe ministrin e arsimit, e kanë shti t'i mjeli dhentë e Agait të Çelike te Lugu i Ymerit.

Nuk prish punë, i thamë ne si burrat. I kuptojmë dhe e duam humorin me pak kripë, mashtrimet dhe shakatë e Xha Derallës. Po, vështirë e kemi t'i duam dhe kuptojmë "anekdotat" e politikanëve në Ditën e sotshme.

Date Koçi, aty për aty doli me një propozim: Meqenëse e keni bërë gjithë këtë rrugë, mos të ju shkojë mundi kot, pasi t'i përfundojmë Ditët e mërgimtarit, do të ngjitemi edhe deri te Shtëpia e Artit, mbi Kërçovë.

Moti, qysh në fëmijëri kisha dëgjuar dhe isha ngjitur në atë vend turistik gjatë festave të Një Majit. Xha Duli i Riu, kur e hiqte vallen shqiptare me lodra e cingana krah për krahu me shokë. Përmidisi i bienin Çarshisë Kërçovës me kësula të bardha, tirqi e xhamadanë. Vite me radhë edhe isha ngjitur dhiareve, qoftë pas ndonjë rrunze azgane, qoftë pas organizimeve të atëhershme letrare e muzikore të asaj kohe duke e përcjellur natën me rokenrol nëpër lokale nate e disko-klube.

Përçudi, si kishte ndodhur që kaq gjatë kohë të mos e kisha vizituar Krushinën, vendin turistik malor që gjatë festave të Një Majit na mbëlidhte të madh e të vogël nën krahët e saj sikur të ishte një pulë me zogjë. Fajin me siguri e kishte koha e studimeve në Prishtinë. E më vonë, edhe arratisja ime si mësues në Drenicë e Malësinë e Shkupit.

Krah për krahu si poetë iu ngjitëm malit. Rrugës herë pas here Date Koçi na rrëfente gjurmë të dhiareve ilire që ende nuk i kishte hëngër dhëmbi i kohës. Aty-këtu edhe ndonjë burim malor, rrap shekullor që i bënte hije mbi kokë. Majë, nga ku si në pasqyrë e shihnim Kalanë e Kërçovës, që me vështirësi e kishte shkelur këmba e serbit, edhe e romakut, edhe e turkut, edhe ajo partizane. Secili në këtë kala i kishte lënë të thella gjurmët deri në ditën e sotshme si pushtues. Vetëm, unë e mbaja në

mend fare mirë Kalanë e pas Luftës së Dytë Botërore, kohën e "artë" komuniste, kur ajo kala - parajsë ishte e rregulluar aq bukur e me kujdes si në përralla dhe mbuluar me lloj-lloj lule. Shatërvanë e karrike druri në çdo pesëdhjetë metra anësh rrugicave.

Ecëm edhe pak në heshtje rrugës kokë më kokë. Unë mendova me vete, me siguri do t'i shohim matanë pishave edhe sheshet me lule. Edhe pak, arritëm te Shtëpia e Artit rrethuar me gjelbërim dhe skulptura gjigante. Habia e radhës: në oborr na priste Don Kishoti i veshur këmbekokë me mburoje hekuri, por kësaj radhe vetëm, pa Sanço Pançon dhe Rosinantin. Poetët bënë një fotografi për kujtim me këtë kalorës të arratisur i veshur me armatim deri më dhëmbë, që përveç kopeve të deleve kishte bërë luftë edhe me mullinjt e erës. Tjetri, bënte roje me pushkë në qafë mes malit, përballë Shtëpisë Artit. Krokodili kishte "ikur" me gjithë trup e kokë nga lumi mes maleve. Oborri i Shtëpisë së Artit mes pishave e gjelbërimit ishte veshur me artin botëror. Emra e emra artistësh nga e gjitha bota, mes tyre edhe piktorë shqiptar: Omer Kaleshi me famë botërore. Aty për aty mu kujtua edhe përmendorja e Skënderbeut, që pas lufte trimat kërçovar e kishin hipur në kala. E më vonë, pas prishjes së miqësisë shqiptaro-jugosllave, e kishin tërhequr pushtetarët komunsitë për shkaqe politike. E kishin futur në

një kasollë të fshehtë brenda kalasë. Që, unë gjatë shkollës së mesme sa herë që ngjitesha me shokë në kala, e vizitoja tinës dhe e shihja se si "bënte" me dhunë gjumë shekullor heroi ynë legjendar Skënderbe i strukur në gjirin e Kalasë. Edhe, e prisja ta shoh heroin tonë legjender te Shtëpia e Artit me gjithë kalë e shpatën në brez si në Shkup. Pse jo, edhe Xha Derallën para porte. Ose, Kalosh Zajazin e Sulltanë Qafën. I kërkova edhe në atele mes pikturave, po nuk i pashë me sy, nuk i dëgjova me veshë. Përmëkeq, kur në mesin e artistëve botëror lexova plot emra të piktorëve shqiptar, po gjeta shumë pak gjurmë shqiptare. Përgjigja: Ishte muaji i Ramazanit dhe këto ditë vere, shqiptarët bënin për çdo ditë edhe deri nga njëzet dasma plot salltanete. Paratë që i fitonin me djersë gjatë gjithë vitit në kurbet, i harxhonin "rrush e kumbulla" brenda një nate. Asnjërit nuk iu kujtua të hedhë ndonjë euro edhe për arsimin e kulturën shqiptare. Dhashtë Zoti, herën tjetër kur do të ngjitemi te Shtëpia e Artit do t'i takojmë Skënderbeun me shokë, Kalosh Zajazin, Sulltanë Qafën, Sefer Zajazin e Sadin Selmanin krah për krahu me Xha Derallën.

Tashti, edhe e shoh realitetin me sy, pse Xha Deralla na paska dërguar në Krushinë. Çifliku i Xha Derallës, kur ne e vizitonim si fëmijë me dhenë, ishte plot ferra. Vështirë nga aty nxirrnim ndonjë shkop thane për t'i ruajtur

dhentë. Ose, fyell shtogu. Banorë të atij çifliku me nam ishin: zogjtë, laraskat, sorrat, korbat, breshkat, zhapinjt, gjarpërinjt dhe boat e rrezikshme me flokë. Edhe Krushinën, ne poetët për dallim nga dita e djeshme komuniste, sot e gjetëm plot bukuri e vlera artistike: lule, shatërvanë e karrike. Llambat elektrike na e tregonin rrugën. Dielli u binte mbi kokë. Fatmirësisht, rridhte uji i ftohtë për kalimtarët e rastit. Vend turistik, që sot falë pronarit të Shtëpisë së Artit z. Vladimir Toleski, që ka dhënë dhe jep mjaftë për kulturën shqiptare e vizitojnë grupe artistësh e turistësh nga e gjithë bota. Ballëlartë, pas një ore poetike zbritëm teposhtë malit në hotel. Pas dreke, dhe pushimit të mesditës, e hapëm Natën e Madhe me humor, satirë dhe një minutë heshtje për Mbretin e haikut shqiptar: Milanov Kallupi nga Elbasani. Mikun e Rrapit, që këto ditë papritmas iku nga mesi ynë latrar. Këngë e valle deri në agim. I hapëm portat poetike ta përcjellim Natën me Xha Derallën. Humoristin dhe satiristin e madh shqiptar, që edhe malin me dardha gorrice e kishte shartuar me ato verore për brezat e ardhshëm t'i mbushin xhepat për Ditën e Nesërme.

Pasdarke, nga malli për satiristin dhe humanistin poetët e shaluan fantazinë. Për disa çaste e sollën Xha Derallën në mesin tyre me humor dhe satirë. Orën simbolike satirike si

zakonisht e hapi Date Koçi me poezinë e Ali Asllanit: *Hani, pini dhe rrëmbeni*. Ferit Abdiu i përshëndeti të pranishmit me këngën origjinale kërçovare: *Të prêt poeti*. Date Koçi, të cilin gjatë këtij manifestimi kulturor e kishte kafshuar grerëza, i dha zjarr e flakë me një këngë dashurie. Poetët, pas tij e morën Natën e Madhe në duart e veta me humor, këngë dhe poezi satirike. Njëri pas tjetrit lexuan poezi, rrëfyen barcoleta, edhe anekdota. Dikur, çetës së tyre i erdhi në ndihmë edhe Xha Deralla me anekdotat e tij të egra: *Hoxha i katundit*, *Pajtimi me Kolibaret* dhe *Xhandarët e serbit*.

Ditën e nesërme, u bë edhe përurimi i librit të Skënder Rusit: *Ç'ditë e bukur për të vdekur*. Rreth krijimtarisë letrare të autorit dhe librit diskutuan kritikë letrar, poetë dhe miq të autorit: Skënder Demolli, Pandeli Koçi, Nikolla Spathari dhe Dhimitër Orgocka, Poashtu, u bë edhe përurimi i librave të poetëve strugan: Vahit Nasufit me *Diell mëngjesi* (tregime) dhe Besnik Lena, *Shiu më rrjedh nën mjekër* (haiku). Librat e autorëve i vlerësuan lartë si arritje artistike krijuesit: Qazim Shehu, Fadil Curri, Pandeli Koçi dhe Kalosh Çeliku. Tryeza satirike kërçovare u shtrua në mesin e poetëve: ***Humori dhe satira brez pas brezi në mes të Ballkanit e mbajtën gjallë popullin shqiptar.*** Atmosferën e ngrohtë satirike e ndezën me diskutimet e tyre rreth

humorit dhe satirës nëpër shekuj: Dhimitër Orgocka, Skënder Demolli, Pandeli Koçi e Nikolla Spathari. .

Nata e Madhe kërçovare i hapi dyert krah më krah me humor, satirë dhe këngë deri në agim. Poezitë e tyre i lexuan poetët: Dhimitër Orgocka (lirikat e Skënder Rusit), Nikolla Spathari, Pandeli Koçi, Jokida Mati, Begzat Rrahmani, Xhevdet Ukalli, Xhelal Ademi, Vlladimir Muça, Agim Bajrami, Qazim Shehu, Fadil Curri, Vahit Nasufi, Rexhep Bajrami, Besnik Lena, Rrahim Ganiu, Vesel Xhaferri - Çeliku, Shefik Sadiku, Selman Zendeli, Shaban Dalipi, Ibrahim Koça dhe Kalosh Çeliku.

Pasmesnate, juria profesionale e përbërë nga Fadil Curri (kryetar), Pandeli Koçi (anëtar) dhe Kalosh Çeliku (anëtar) i ndau edhe çmimet letrare: për vepër satirike, Skënder Demollit dhe për poezi të "egëra": Rexhep Bajramit dhe Vesel Xhaferrit - Çelikut.

Dita tjetër, e nesërmja poetët i përcolli disa në Qafë Thanë e Shkup. Pandeli Koçin deri në kufi me Kosovën, për t'u kthyer pas disa ditëve në Tiranë përmes Rrugës Arbërit. Vetëm satiristët kërçovar mbetën në Kërçovë me Xha Derallën. Që, vitin e ardhshëm, përsëri të na e shtrojnë sofrën satirike të miqësisë te Çifliku i Xha Derallës pranë Përronit Thanës me burime malore

në fshatin Cërvicë, mundësisht pranë përmendores së Xha Derallës.

Dhe, ashtu siç thashë një vit më parë: Ndodhi mrekullia. Viti historik i kërçovarëve. Kërçova si komunë për herë të dytë, pasë pesëdhjetë viteve "liri", ra përsëri në duart e një kryetari shiptar. Hapat e parë i keni në sipërfaqe: Kërçova për herë të parë me forcat e veta komunale, kryetarit të komunës z. Fatmir Dehari dhe poetëve nga të katër anët e Atdheut, e përfundoi javën kulturore shqiptare. Larg zemrës se, do t'i ngulfasë kulturat tjera në këtë qytet siç vepruan paraardhësit e saj të dikurshëm në pushtet, po në radhë të parë duhet ringjallur arsimi dhe kultura shqiptare e një populli shumicë, që pesëdhjetë vejt me radhë u nëpërkëmbë nga sistemi komunist. Themelet kryesore të një shoqërie, shteti demokratik janë arsimi dhe kultura. Edhe, Manifestimi Kulturor Tradicional Ndërkombëtar Ditët e Humorit dhe Sarirës: XHA DERALA, që nga dita e sotshme mbetet në duart e Komunës së Kërçovës. Komuna në bashkëpunim me ne (LSHSH) do të emërojë edhe dretjorin e këtij manifestimi tradicional kulturor. Xha Deralla, kësaj radhe e ka vështirë të na mashtrojë rrugës pas Çuke. Nesër, ne me një Orë miqësore poetike si para disa viteve do ta vizitojmë edhe vendlindjen e tij, katundin Cërvicë, vetëmse jo në stinën e verës kur

gjarpërinjt e shullanit kulaç rreziten në diell. Krah për krahu si poetë do të ngjitemi edhe deri te Çifliku i Xha Derallës, afër Përronit të Thanës. Ndodhë, nesër atje të ndërtojmë edhe ne ndonjë kolibe artistike për poetët.

Populli shqiptar, e di se i di këto themele kryesore për ngritjen e Shtëpisë Artistike, unë vetëm i përsërita që t'i nguliten në kokë. Punën tjetër e ka vetë në dorë. Dhashtë Zoti, një ditë përkrah fytyrave historike të kësaj ane e ngrejmë në vendlindje edhe permendoren e humoristit dhe satiristit të madh shqiptar: Xha Derallës, te Ureja. Ashtu qoftë!...

Në fund: e faleminderojmë Komunën e Kërçovës me kryetarin e saj z. Fatimir Dehari me shokë, i cili qe shkaktari kryesor që e bëri të mundur edhe këtë vit ta vazhdojë jetën kulturore - artistike në Kërçovën historike Manifestimi Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: Ditët e Humorit dhe Satirës XHA DERALLA.

Populli shqiptar, historikisht mbi të gjitha i di bijtë dhe bijat e veta që u flijuan për liri dhe vlerat e arrira arsimore e kulturore për Ditën e Nesërme. Përgëzime!...

NASTRADINECA

1. Ministri i tollumbave

Rrumaduci me shokë ("trim mbi trima"), që nuk la parti politike pa iu ngjitur si rriqër për rraçesh duke filluar nga Partia Komuniste, PPD, PDSH, RDK, BDK e deri te kjo e fundit BDI, kohën e fundit e ka parë veten ëndërr edhe në postin: Ministër i Tollumbave. E dalldisin shokët e arratisur gjithë ditën e gjatë me një kafe mbi tavolinë, si atë pulën e poetit për fëmijë te vjersha e Rexhep Hoxhës duke kakarrisur tra më tra, që e e ka bërë një ve dhe e çuditë "dynjanë", e tjetër më hiç. E rren mendja se duke ndejtur kokë më kokë me rrufjanë nëpër kafenet e Çarshisë Shkupit, më në fund do t'ia mbushë mendjen Ali Ahmetit që t'i japë edhe këtij farë bozaxhiu një post ministri të "merituar" në Qeveri, atë të Ministrit të Tollumbave. Nuk i mjaftuan shpërblimet e djeshme komuniste duke e shëtitur nëpër redaksi me poste politike, banesë të shtetit e as ky i fundit: Çmimi shtetëror i "vëllezërve" në letërsi për ta varrosur me nderime e kurora të luleve si "hero pas lufte për liri" në varrezat e "dëshmorëve të vëllezërve". Kurorëzojnë Trusaktin me përkrenaren e Sanço Panços shqiptar (një legen në kokë), kur shumica e shkrimtarëve shqiptar vdiqën në heshtje edhe për

bukën e gojës. Malli i ka marrë mjeranët të shëtisin në thesin komunist me arna plot zarzavate partiake, në pajtonin e Nënës Parti, përsëri nëpër redaksi e poste politike të stolisur me lule-lale partizane dhe të shtyhen me bërryla si dikur në kohën e "artë" komuniste.

Burri i botës është "tru" shqiptar, prandaj edhe merr guximin t'i tregojë Ali Ahmetit dhe BDI –së, se: ministrat i ka të dobët dhe duhet sa më parë ta marrë në "vijën e zjarrit" këtë farë "yrneku-tollumbë" me shokë që ta shpëtojë partinë nga "Përmbytja e madhe politike". Pavetëdije se, ky "burrë mejdani" pa brekë është me qindra kilometra larg, nënë nivelin e tyre moral, patriotik, politik e shkencor, që gjithë jetën deri në vdekje e mbanë për dore DoktorZiu. Përmëtepër, Rrumaduci merret edhe me parashikimet e motit për Nesër, sipas filxhanave të kafesë nëpër Bit – Pazar. Veç që nuk e ka shpallur veten fallxhore e fundit shqiptare, ose Hoxhë YouTube katundi në lagjen e romëve, tejkalojë azreti Muhamedin a. s. në profetizëm. Eshtrat e qenëve të cofur t'i përziejë në një enë me ujë duke shuajtur thëngjij të ndezur para pacientëve shqiptar me xhinde turko-arabe. E dikur, tresi plumb në enë, në mesin e eshtrave. Hajmali të na varin përqafe. Trusakati që nuk e di se pas verës, vjen Vjeshta me brymë dhe Dimri. Bora na mbulon këmbekokë. Çatitë

vështirë e mbajnë barrën mbi shpinë, që përditë ua hanë krimbat. Oxhakët mezi e përcjellin tymin mbi çati në qiell. Shkurt, ky soj dudumi i shet mend Ali Ahmetit, që e ka djegur tambëli, tashti i fryn edhe kosit. Përpiqet me metoda neokomuniste me afat të skaduar përdorimi politik t'i afrojë "kuadro të aftë shkencor" të nivelit të tij "intelektual", se këta të tanishmit nuk mund t'i dalin zot postit partiak në Qeveri.

Edhe, në vend të miellit bluan krunde në mulli, që nuk e hanë dot sot as lopët e Koperativës Bujqësore Komunsite. E rren mendjen me këtë bagazh politik në shpinë se, përsëri do të fitojë ndonjë post politik ose një torbë taxhi në ndonjë redaksi neokomuniste qafë për qafe me "vëllezërit". Ose, ndonjë çmim letrar nga "probatimat" për shkarravina patetike teknefese "artistike". E rren mendja se, ndonjëri, nga partizanët e Ali Ahmetit do ta marrë nën sjetulla si këshilltar partie (kungull Stambolli), që ta mbjellë nëpër Çarshi në ndonjë park për farë meleze me bythën në tokë e lënjët në degë "përhava". Ose, do ta mbajnë gjallë edhe në këtë ditë Rreziku këtë trusakatë që mezi i lëvizë këmbët dhe bythët e breshkës në shoqërinë shqiptare, fusë kotnasikoti ferrë në këmbë. Përmëtepër, harron se, shkaku i tij duke u arratisur dje nëpër poste të Partisë Komuniste, sot nëpër parti "demokratike", ne shqiptarët edhe sot

e kësaj dite nuk mund ta çojmë kokën, dalim në "selamet", siç thonë "vëllezërit myslimanë" në xhami. Rrufjanët, që gjatë ndryshimeve demokratike kanë gëlltitur fonde të shtetit, botërore e të SOROS –it, e mësojnë Ali Ahmetin se ku duhet të ikë, te Zaevi apo te Gruevski. Burrin e Zajazit, që zbriti nga malet me shokë në Shkup me automatik në krah e jo nga nëntoka antishqiptare me thesin e parave të pista "hallall" në shpinë për t'i dalë zot Maqedonisë.

Moti e kam thënë nëpër shkrimet e mia se, i keni përzier lëmsh profesionet. Rezultati, shihet që në stard (fillim): O shqiptarë, zgjohuni nga gjumi shekullor! Lesh Arapi i keni bërë profesionet. Edhe "politikën madhore", edhe fenë e Allahut (Zotit). Ditën që ju do derdhni djersë në profesionin tuaj jetësor, dobi do të ketë edhe kombi edhe Shteti Shqiptar. Partia e Ali Ahmetit (BDI), patjetër kësaj radhe duhet të bëjë luftë edhe për një ministri në Qeverinë e "Vëllazërim-bashkimit": Ministrinë e Tollumbave. Zanatin e vjetër me të cilin shqiptarët dikur e pushtuan Jugosllavinë. Përmëtepër, kënaqi ëndërrat dhe aspiratat e partizanëve të saj të pangopur me poste politike.

Eh, sa trima të arratisur kishim pasur ne shqiptarët nëpër institucionet e dikurshme komunsite e të harruar nëpër këto të sotshmet neokomuniste - "demokratike", dhe nuk kishim

ditur gjë për "vuajtjet dhe heroizmat" e tyre për zgjidhjen e Çështjes Shqiptare. "Flijimet e tyre artistike" në Qeveri, nëpër kabinete e redaksi komuniste të "vëllazërim - bashkimit" (Klubit të tollumbave). Përçudi, sot pas lufte (2001) të gjithë na dolën "patriotë kuqezi", qafë për qafe në sipërfaqe nëpër institucionet e Shtetit Ri duke e vrarë armikun me një plumb mu në lule të ballit me tollumba turko-arabe për Atdheun.

Amani, ju lutem në emër të Krishtit dhe Muhamedit a. s. edhe kësaj radhe ia jepni një post politik për "flijime artistike" këtij të arratisuri, atë të halesë pas shtëpie që ta mbyllë gojën si Ministër i Tollumbave në Qeveri! I ka marrë të gjitha shpërblimet e "vëllezërve" të Njerkës për së gjalli, le ta marrë edhe këtë të parafundit para vdekjes, Ministrit të Tollumbave me jurinë sakate - neokomuniste të partisë shqiptare në pushtet.

Përfundimi i "flijimit artistik": dihet, e pret këmbëkryq pas dere. Dhashtë Zoti një ditë ia sheh hajrin në botën tjetër me lule (Xhenet)?! Prognozat politike të "analitikëve" të Klubit të tollumbave dhe hoxhallarëve të rrejshëm me kësulë-lecka në YouTube për kohën, moti a do të jetë me diell, mjegulla, shi, breshër e borë, apo do të kemi "pranverë arabe" edhe në Shkup, nuk na dolën të sakta sipas kësaj fallxheshe me shoqet neokomuniste, edhe kësaj radhe e trumbetuar

nateditë në mjetet e informacionit me trumbetat e Dexhallit Arapit nëpër Bit-Pazar.

Edhe, përçudi shpejt kaloi vera me vapën e gushtit, siç thotë populli shqiptar. Erdhi vjeshta me brymë, shkollarët me çantat në krah e lapsat në brez. Ose, siç thotë në një këngë legjendare ai këngëtari popullor kërçovar: Librat nën sjetull, çantën në dorë. Shkaku, se: tekstet shkollore, Lektyrat shkollore i kanë marrë t'i lexojnë partizanët e Nënës Parti të arratisur në Ministrinë e Arsimit. Athua, edhe në Ditën e sotshme kërkojnë të zbulojnë mes atyre faqeve "nacionalistë dhe irredentistë"?! Ndodhë, ku ta di unë autori i këtij shkrimi.

Dhe, nesër vjen Dimri Madh me borën mbi çati, stuhi dhe furtunë. Përplasjen e dyerve, pasmesnate. Nuk e di, a keni dru për zjarr, a jeni përgaditur për Dimër…

2. Malli më ka marrë në Shkup për kësulën e Bajram Currit

Kohën e lirë si zakonisht e kaloj para këmbëve të Olimbisë. "Ilaçet" e mia të përditshme i kam të domosdoshme si fëmijët e saj tambëlin që u jep gji për luftë. Edhe, i kam arratisur sytë mbi Urën e Gurit. Asnjë kësulë të bardhë të Bajram Currit, asnjë grua me veshje shqiptare nuk kalon matanë Vardarit. Hë për hë, kalon Hojdodolja: leckat e zeza, shajkaçat,

shamizezat, ferexhetë turko-arabe dorë për dore… Vetëm, moti nuk e do Zoti të shoh një grua azgane me veshje kombëtare shqiptare. Vetmevete, them: O Imzot, ku humbën shqiptarët trima në Ditën e sotshme historike?!

Papritmas, edhe Hoxha i Allahut me kësulë-leckën turko-arabe e mjekrën e cjapit turret si "mysliman" pa kokë me të katra matanë Vardarit. Hojdodolja nën këmbët e Urës Gurit e ka nxjerrë "kalemin" nga dimijat me lule Xheneti, i shkruan pizi Qytetit që sipas saj "vdes" para këmbëve të Kalit të Aleksendrit të Maqedonisë?! Çarshinë, ua kanë lënë në duar bashibozukëve me tespihe kuqezi nëpër duar. Hoxhallarëve të rrejshëm dhe matrapazëve partiak me gotat e çajit të rusit mbi tavolinë duke bërë "politikë madhore".

Fatkeqësisht, Shkupi të lë përshtypje se në këtë Qytet historik si dikur jetojnë të gjithë kombet dhe kombësitë, por jo edhe shqiptarët. Ose, sipas deklaratave teknefese të Kryeminstrit shqiptar, Edi Rama në takimin e tij me Kryetarin Ivanov deklaron: "*por edhe si shprehje të një fakti të thjeshtë, që ne nuk u kërkojmë të tjerëve atë që ne vetë nuk jemi në gjendje ta plotësojmë për të tjerët*". Haptas para syve të botës bën krahasimin e shumicës shqiptare për të drejta të barabarta kombëtare me pakicën bullgare që jeton në Shqipëri?! Punemadhe, që Ali Ahmeti zbriti nga malet. BDI është me vite me "komandantët"

pas lufte dhe vetëm një "Asker" (Komandant "Askeri"), ai në Katund e këta në Qeveri, pushtet. Vallë, kush nuk e do Shkupin Shqiptar, çirret nëpër minare të xhamive me flamur turko-arab, kur e gjithë bota e di se, Shkupi ka qenë dhe është këmbekrye shqiptar. Dhe, shumë shpejtë do të vijë Dita, ku në minare të xhamive shqiptare do të valojë flamuri kombëtar kuqezi. Gojën plot them: vetë shqiptarët e dalldisur nëpër parti politike e çerdhe fetare të sorrave duke përkujtuar thënien e Faik Konicës: *Armiku më i madh i shqiptarëve, janë vetë shqiptarët*.

Fitorja e Vitit Madh Historik: Unë mezi e kreva pushimin e merituar vjetor mbi libra në bibliotekë. Tashti jam ballë për ballë me ju si lexuesë i ulur këmbëkryq në mjetet e informacionit. Po, nuk më pëlqen pasqyra historike që e keni vënë si politikanë të dalldisur mbi Urën e Gurit. Nuk e di pse, kur e pyes: pasqyrë - pasqyrë kush është më i bukuri në këtë botë?! E ajo, më përgjigjet: Gruevski. E unë i arratisuri mes librave, pres me ditë, javë, muaj e vite të më përgjigjet: Ali Ahmeti. Realitet, që nuk e përtyp dot lapsi im kryengritës, që e ka shaluar atin me të katra nëpër Bit-Pazar. Pasqyrë e rrejshme: Nateditë, që na trumbeton një gjysëm Teatri Shqiptar. Dhe, një Teatër të fëmijëve, në të cilën mund ta gjejsh "vëllazërim- bashkim", po jo edhe shfaqjet e fëmijëve. Institucione kulturore në

të cilën e përurojnë veten trusakatët, eksponentë skelet të "vëllazërim-bashkimit" me pak shpirt për vlera të "arrira kulturore" kombëtare. Zhurmë e dalldisur kulturore në Shkup, që lakmi sot do t'ia kishte edhe Partia e dikurshme Komuniste.

3. Shtojcë: Përgëzime Nastradinecën

Klubi i tollumbave, gati të gjithë shqiptarët e dimë anë e mbanë Atdheut se, ka prodhuar me shumicë e pakicë: kryetarë të partive politike, spiunë, politikanë, deputetë të popullit, ministra qeverie… Pse, të mos prodhojë sot edhe një Ministër të tollumbave?! Gazetarët dhe analistët, që sot për sot i kanë shqiptarët (me përjashtim të një pakice të cilët numrohen në gishta), që nuk mund të zënë vend pune as në hale, pas shtëpie mbuluar me hithëra dhe non-stop dërdëllisin jerm me orë të tëra mbi gotat e çajit të rusit mbi tavolinë: E duam ne shqiptarët, apo nuk e duam këtë Qeveri. Vite me radhë humbin kohë për "Shkupin 2014". E, në realitet kurrë nuk e peysin veten si "gazetarë e analistë" shqiptarë: Çka kanë bërë ato për një Ditë të Nesërme?! Tekefundit, nëpër çajtore kokë më kokë kur i analizojnë këto tema të "nxehta" politike me "vëllezërit" në emër të arsimit dhe kulturës shqiptare, që Rilindasit shqiptar dje e zbritën në fushë me penë e pushkë

nga malet, tekefundit së paku sot në këtë kohë Rreziku të paguajnë një kafe.

Dudumë, për të njëmijtën herë e them dhe përsëris: Përpara se të pastroni oborrin e kojshive, pastroni oborrin tuaj që e ka mbuluar bërlloku këmbekokë! Pajtohem: Gomarit, i zbriti Nastradini me 50 kg. mbi shpinë, i hipi Nastradinica me 120 kg. mbi samarë. Nuk e di, për të satën herë duhet ta përsërisë anekdotën e popullit: Nastradinin, që i ka hipur gomarit dhe e tërheq për kërpeshi Nastradineca me ferexhenë krahëve për në pazar. Rrugës e takojnë kalimtarët e rastit dhe e përshëndesin pazarxhiun krenar: O, Nastradin, zbriti pak gomarit, le t'i hipë Nastradineca! Tjetri: o Nastardin, a nuk e sheh se e cofe gomarin?! O burrë, zbriti më nga shpina, le t'i hipë pak edhe Nastradineca!

Dhe, rrugës pas Çuke i tjetri pazarxhi po me të njëjtën pyetje, sa që Nastradinit më i vjen shpirti te hunda: O burrë, nuk e cofë unë gomarin me 50 kg. mbi shpinë, po nëse i hipë Nastradineca me 120 kg. mbi samarë.

Nastradineca, posa i hipi gomarit në shpinë te Pazari Grave kërkoi që pakica bullgare në Shqipëri të ketë të drejta kombëtare të barabarta me shumicën shqiptare në Maqedoni?! Përgëzime, Nastradinecën!

Vërtetë, më në fund: Kësaj i thonë, "Rilindje shqiptare"???!!!…

HUTAT COFIN DUKE KËNDUAR

Herët si fëmij e kam dëgjuar nga im Atë një thënie kërçovare: *Nuk do të rrojmë me hutat e bardha*. Në atë kohë si fëmij nuk i kam vënë shumë rëndësi kësaj urtësie të popullit shqiptar. Përçudi, kësaj mençurie të popullit deri më sot nuk i janë qasur me seriozitet edhe studiuesit e letërsisë popullore. Mendja ma thotë se, kjo perlë e popullit e ka burimin në Kërçovë. Shkak ky, që nuk njihet dhe nuk është përhapur aq shumë me të madhe në popull.

Vite më vonë, në prag të Lirisë nuk e di se kush ma dërgoi nga qielli si porosi këtë thënie të popullit. Edhe, t'i vë gishtin kokës: Çka ka dashur

të thotë im Atë me këtë filosofi antologjike?! Nateditë e vrava mendjen, dhe më në fund mezi erdha në përfundim: Hutat rrojnë shumë gjatë nëpër pyje. Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe këtë fjalë e shpjegon disi në këtë mënyrë: HUT/Ë, a~A: f. sh. ~A, ~AT, 1. zool. Femra e hutit. Zogu i hutës. Ra huta në pula 2. Zool. Shpend grabitçar, me kokë dhe me gushë të mbuluar me pupla, me qafë të rrjepur, me kthetra, që rron nëpër pyje. Huta e bardhë kali i qyqes. Hutë deti pulëbardhë. 3. fig. Grua a vajzë e trashë nga mendja; femër e shushatur e matufe. Kishte marrë një hutë. 4. Dele me veshë shumë të vegjël. I humbi huta. Edhe, atë leximin mes rreshtave: vetëm hutat na i grabisin pulat para syve në lëmë, mes Ditës Madhe. Ose, ajo tjetra: nuk do të jetoj gjithë jetën, që t'ua baj gajlen në shoqëri. Lexuesin e kisha lutur të mos i përziej hutata e bardha të Kalosh Çelikut me hutën e bardhë krahinore të popullit shqiptar! Ose, llojin e pushkës të vjetër me një fishek...

Nateditë, unë gati gjithë jetën përmes shkrimeve të mia publicistike ju them me vite: ja, ku është ujku. Ju, jo janë gjurmët e ujkut. Unë, përsëri: ky është ujku. Jo, ju më përgjigjeni: janë gjurmët e egërsirës. Inatë çoni me vetëveten në këtë kohë rreziku për Atdheun. Përpiqeni, me këmbëngulje të më bindni se janë gjurmët e ujkut. Vazhdimi, është humbje kohe, që t'ua mbushë

mendjen edhe në të ardhmen se, është ujku me këmbën e lyer me miell pas porte, e nuk janë gjurmët e tij në Lëmë.

Askushët ende përpiqen me thashetheme e përralla arabe ta përqajnë popullin shqiptar nëpër katunde e qytete. Cili katund, apo qytet ka derdhë më shumë gjak për liri e ka shpallur më shumë komandantë e dëshmorë lufte në familjet e tyre mes varreve. Dudumët, që shtihen gjoja se nuk e dinë, kush e bëri Luftën e fundit në Kosovë e Maqedoni. Tekefundit, historikisht populli shqiptar nuk ka bërë luftë vetëm me pushkë maleve nëpër shekuj, po edhe me penë në mes të Stambollit. Një popull për të arritur te qëllimi historik, në ballë duhet t'i ketë burrat e ditur, pastaj vijnë të pasurit dhe në fund veten e tij si ushtri popullore. E, a i ka sot populli shqiptar këto tre faktorë kryesor?! Fatkeqësisht, ende jo. Nesër, me siguri do të flasë vetë koha. Sot për sot, dimë vetëm për "luftën e tyre heroike" flakë më flakë matanë gardhit, që soji i tyre kur krisi pushka e parë në Drenicë e Tanushë, ikën me të katra me gjithë familje në bregdetin shqiptar dhe pas lufte erdhën të parët të na "çlirojnë" nga hordhitë barbare për poste politike.

Gjenitë lindin dhe vdesin një ditë, po nuk jetojnë aq gjatë siç thoshte shpesh im Atë, me hutat e bardha, që t'i bindin këto fundërrina anadolli se, ujku na troket pas porte. Dorën në

zemër, jetojnë veprat e tyre nëpër shekuj. Populli shqiptar jeton gjatë kohë me shekuj maleve me hutat me veshë për zgjidhjen e Çështjes shqiptare në Ballkan. Kulminacioni i këtij shkrimi: herë pas here e kam përsëritur nëpër shkrimet e mia se, mua më lejohet edhe "gabimi i rastit" si shkrimtar, po jo edhe politikanëve teknefesë që janë sot në ballë të popullit shqiptar. Fundi i fundit, më mirë të gaboj unë si shkrimtar, sesa udhëheqësit tanë politik në ballë të popullit. Shkaku se, nëse gaboj unë, pasojat kombëtare do të jenë më të vogëla në krahasim me ato të politikanëve shqiptar. Tjetër punë është ajo se, ai në Ditën e sotshme udhëhiqet nga hutat me veshë. Fatkeqësi kombëtare.

Hutat me veshë ma kujtojnë edhe një ngjarje historike në shkollën fillore "Liria", në Shkup. Kuvendin e jashtëzakonshëm zgjedhor të Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptar, i thirrur para kohe (1998), kur një grusht i arratisur komunistësh deshën me dhunë të më shkarkojnë nga posti i kryeatarit, i fituar në atë kohë me punë dhe vota të lira demokratike. Ministrin e atëhershëm të informatave (R. Z.), që nxirrte edhe shkumë nga goja për shkarkimin tim si kryetar. Këlyshin e Llagut, që e kisha rritur gjithë jetën me bukë misëri te mulliri i Arapit, Këlysh Langaçin me një asht në gojë, që para syve tanë u rrok fytas me poetin e ndjerë Ramadan Sinani.

Hojdodolen, që bënte "luftë heroike" në atë kohë qorre duke lëvizur bishtin t'i kërcejë një Qen Sharri në shpinë. Këlysh Sharri i Nënës Parti me gjuhën jashtë dy pëllëmbë nga vapa, që edhe atij i kisha hudh në atë kohë të vështirë një copë buke pas porte. Ngjarje historike, të cilën unë do ta përjetësoj në bibliotekë te libri im me drama: *Kopeja me zgjebe ndjek Autorin* (2000).

Situatën e asaj lufte të ashpër "artistike e qetësoi" shkrimtari Murat Isaku, edhe atë, pas ndërhyrjes të bashkëvendasit të tij Ramadan Sinani, kur tha më në fund i zemëruar se: do t'i hapim letrat. Poeti i ndjerë Ramadan Sinani, nuk është më në mesin tonë, poashtu edhe Murat Isaku. Megjithatë, e njihnin mirë njëri-tjetrin si studentë të Beogradit. Doktorziu, edhe ky student Beogradi, që e udhëhiqte betejën policore pas dere duke i ndërsyer me gisht këlyshët me zgjebe, ende është gjallë me dy-tre pensione shtetërore e honorare si anëtar i tre akademive shkencore. Këlyshët me zgjebe me nga një asht në gojë, poashtu ende janë gjallë me bishtin ndër këmbë (me përjashtim të ndonjërit që zvarritet ende para cofjes rrugëve të Bit-Pazarit), dhe si dje edhe sot turren me të katra pas partive politike, posteve në Qeveri si dhelpëra pas dashit mos i bien udhës.

Realiteti sot, është në duart e Komisionit Lustrues, i cili i ka nëpër duar dosjet policore dhe duhet t'i nxjerrë rrufjanët në sipërfaqe si kunguj

Stambolli. Përsëri, mu si sot më kujtohet ajo kohë e gjuajtjeve të "irredentistëve", atëherë kur ndërhyri Murat Isaku për ta qetësuar situatën, hedhë një kovë ujë zjarrit: Kryetari i tanishëm (K. Ç.) le ta vazhdojë mandatin e kryetarit edhe një vit, me kusht që në fund të vitit para kohe ta thirrë Kuvendin zgjedhor. Rrumaduci, edhe ky një këlysh besnik komunist i tyre me zgjebe (trim pas lufte), u ngritë si një spec i skuqur Kopështi në Katund dhe vendosi "pajtimin kombëtar". Tek tashti, unë e pash se me cilët "shkrimtarë" oborri kam punë organizative krijuese në gojë të Ujkut. Gabimin tim si kryetar, që nuk desha të merrem me të kaluarën e tyre komuniste "të flijimeve artistike" për të mos shkaktuar përçarje edhe në mesin e shkrimtarëve, po me të tashmen dhe të ardhmen artistike për Ditën e Nesërme. Nuk desha të krijoj në Shoqatë hendeqe të thella krijuese. Po, e gjithë kjo përpjekje për t'i bërë bashkë të gjithë krujuesit nën një çati, qe e kotë mes këtij bërlloku shqiptar i grumbulluar me vite në sistemin komunist. Populli thotë: Uji fle, po hasmi nuk fle. Dudumët, pas disa viteve vullnetarisht e lëshuan Shoqatën e Shkrimtarëve Shqiptar, kaluan në atë maqedonase për përfitime e interesa personale.

Vite më vonë gjatë lustrimit të bashkëpuntorëve të UDBA –ës jugosllave, Ministri i informatave na doli spiun si kungull i

kalbur fushe mbi ujë. Spiunë na dolën dhe vazhdojnë të na dalin edhe disa "shkrimtarë" të tjerë oborri, që në kohën komuniste e kishin shitur veten lirë: një vend pune në redaksi, një banesë ose një torbë taxhi. Doktorziun, përpiqen me çdo kusht ta shpëtojnë "vëllezërit" nga "përmbytja e madhe", po vetëm përkohësisht edhe ndonjë ditë, bythët i kanë dalë moti mbi ujë. E di, denoncime me thasë kanë dërguar në polici duke i spiunuar krijuesit. Ndonjëri me direktiva policore do t'i sulet në gazetë edhe Ismail Kadaresë. Shumica e rebelëve, do të përfundojnë edhe në burg. Ose, do t'i përzënë nga vendi i punës: Sadudin Gjura, Mehmedali Hoxha, Abdulazis Islami, Vahit Nasufi, Teki Dërvishi, Fadil Bekteshi, Shaqir Sadiku e ndonjë tjetër poet. Daut Gurrën do ta përcjellin para kohe në varr. Radhën e presin ato "patriotët kuqezi" të strukur nëpër parti politike, hiç më pak 20 halldupë në numër me emër e mbiemër, që në atë kohë me nënshkrimet e tyre më dërguan në "bisedë informative" në polici si armik i shtetit, gjoja se: unë qënkam i dërguar nga Kosova të veproj në këto anë: i paskam patur disa takime të fshehta në Bullgari, i kam dërguar me dhjetra mijëra marka Partisë Socialiste në Shqipëri, dhe Çështjen shqiptare dua ta zgjidhë me luftë (1993)?! Kopeisht m'u sulën me shkrime serike policore në gazetën *Flaka e vëllazërimit* (gazetën

e tyre të famshme neokomuniste). Sulmet e tyre pas shpine, ende "flejnë" mes faqeve të asaj gazete policore, në bibliotekë. Përveç etiketimeve të lartëpërmendura, kësaj radhe edhe se, unë kisha shkruar nëpër libra: "Kur'ani është burim i gënjeshtrave". Linçe itelektuale e fizike, të kurdisura mirë në zyrat e radaksisë policore nga kulturofagët për të më shti mes dy zjarreve: Policisë së Shtetit dhe Bashkësisë Fetare, në Maqedoni. Sigurimi policor i shteteve nuk shtihet në një thes. Tjetër është të jesh spiun i shtetit shqiptar (Shqipërisë), e tjetër është të jeshë spiunë i shtetit jugosllav. Arsye kjo, që spiunëve nuk mund t'ua lidhim grykën e thesit, rrasim me këmbë në një hambar. Përçudi, "ajka intelektuale" shqiptare ende si nuk delë në sipërfaqe?! Gjurmët e thella i kanë shti rrugës deri në fyt, cila dhelpër ua fshin sot me bisht?!

Interesante. Dhe, është shumë aktuale edhe në Ditën e sotshme kjo puna e hutave me veshë që rrokan kësaj radhe jo nëpër pyje, po në mesin e shqiptarëve. Krah për krahu me Zogun e Keq edhe sot duke na kënduar këngë kobëzeza vajtuese mbi çati. Përmëtepër, kur patjetër brez për brezi duhet të hipim në Baba Tomor. Malin e shenjtë të Perëndive. Tyrben, ku pihet vera me shtamba, shkruhet poezia dhe bëhet dashuri…

II DITË ZIE PËR GOMARIN E HAXHI RRENCIT

KUNGUJ STAMBOLLI
(*YuoTube dudumëve*)

Vërtetë, më lodhët me myslimanizmin e rrejshëm në Ditën e Madhe të Sotshme. Edhe me dalldisjet patriotike shqiptare të shekullit: "Amerika i ka autorizuar turqit që të kujdesen për Shtetin e Kosovës." Mirë, them unë: po le të "kujdesen" për Kosovën, edhe për IRJ të Maqedonisë, edhe për Shqipërinë. Mos e teproj me thashetheme, po të duan le të "kujdesen" edhe për Malin e Zi. Hise kemi edhe në Serbi e Greqi. Pse të mos "kujdesen" edhe për këto troje shqiptare të coptuara nëpër Ballkan si Kashta e Kumbarës?! Ndoshta, atë që nuk e bënë "vëllezërit" gjatë pesqind vjetëve për shqiptarët si pushtuesë, e realizojnë në Ditën e Sotshme si "çlirimtarë" të Babadovletit. Dorën në zemër, tashti e shoh se shqiptarët nëpër shekuj paskan pasur shumë "vëllezër" dhe kanë nevojë për miq, por jo edhe zgjidhjen e çështjes shqiptare ta lënë nëpër këmbë, siç vepruan deri më sot, në duart e "vëllezërve politik strategjik". E dini edhe se, më villet në këtë Ditë Historike Shqiptare?! Zorrët

dua t'i nxjerr jashtë si "bërdhoqe" para këmbëve. Turreni me të katra dhe "vajtoni" Sirinë, në vend që të vajtoni Shqipërinë, Kosovën dhe IRJ të Maqedonisë se, gjithë jetën jetuat dhe po vdisni si argatë të shitur shqiptarë me një torbë taxhi përqafe. Fajin, gjithmonë jua kanë të tjerët, armiku i pabesë: sllavët dhe grekët, e kurrë nuk e vënduat gishtin e fajit në vete, kokë. Çka keni bërë dhe jeni duke thirrë me "Allahu Akber" në dobi të shqiptarëve majë minareve?! Vallë, mos e valvitni flamurin kuqezi me shqiponjën dykrenare?! Jo. Atëherë, flamurin e kujt e valvitni me thirrjen e ezanit: "Allahu Ekber?! Mirë bre dudumë "të soçëm me tru të moçëm", që gjithë jetën u turreni përmbrapa partive politike si dhelpëra herdheve të dashit. Populli shqiptar sipas juve, lindi dhe duhet të vdes, fusi kokën në varr duke hëngër bar në grazhd ose livadheve të huaja pa gardh?! Përçudi, ju një grusht hoxhallarësh YuoTube, që nga koha komuniste deri në Ditën e Sotshme Historike ju bëhen padrejtësi fetare?! Dudumëve, të shtëtiur nëpër poste komunsite, redaksive, kabineteve qeveritare dhe "shoqatave humanitare"?! Sot, poshtu të shitur pa pare e me pare si kunguj Stambolli. Zërin e ngreni në kupë të qiellit se, ju ka fyer "njëfarë Kalosh Çeliku"?! Gabim. Askush nuk mund t'ju fyej juve si "myslimanë" shqiptar me "Din e Iman", përveçse ju veten që e "shpërlani" nga mëkatet me këmbët

dhe trutë në legen. Mjaftëni më, o dudumë me brekët mbi pantollona, që në vend të veshëve e keni lidhur çallmën! E dini se, nuk ju beson njeri i gjallë kur hipni në minare. Aq më pak kur çirreni e "qani" në YoTube para xhematit. Ndoshta, ndonjë i vdekur mes varreve po, por ai më moti bënë "politikë madhore" mbi varrin e Babashehut, në Natën e gjykimit.

Vetëm ju si "misionarë të Allahut" për të drejtat e shqiptarëve, lindët dhe po cofni me "shqiptarizëm" në gojë nëpër kabinete të Qeverive të "vëllazërim-bashkimit", ne të tjerët kotnasikoti i paskemi rënë fyellit të bariut mes maleve. E dini, edhe se: "patriotizmi juaj fetar" më ka ardhë në fyt?! Dita-ditës po ma zë frymën. Përditë po më villet, po nuk kam çka të vjell pëveç zorrëve. Nateditë ma kujtoni Dexhallin me trumbeta para Ditës Kiametit, kur tri ditë përpara Përmbytjes Madhe, delë me muzika në rrugë t'i mashtrojë kalimtarët (pastrojë botën nga mëkatarët). Vallen e heq krah për krahu me shokë. Vulën e tij famëmadhe, që "besimtarëve" të Allahut me "Din e Iman" ua vë mu në ballë. Mirë do të bënit ta mbyllni gojën, palarenë e keni të lirë ta ngreni për "hava" e në hale pas shtëpisë Zotit. E vetmja e drejtë e juaj legjitime qytetare. Shkaku se, falë "flijimeve të juaja patriotike - fetare", ne shqiptarët e Skënderbeut edhe sot e kësaj dite nuk mund ta çojmë kokën në mes të

Atdheut. Përpiletimi ende në pelena si popull më i vjetër i Ballkanit me traditë historike i lidhur në djep, e kurrësesi të ngritemi më këmbë, dalim në Lëmë si e gjithë bota përparimtare, ecim me kohën. Ose, siç thotë populli: Nateditë përpiqemi si krimbi në dru per Ditën e Nesërme Shqiptare.

"Vatanin dhe Imanin", jua njeh e gjithë bota nëpër shekuj me trutë dhe këmbët në legen. Tjetër punë është ajo, nëse jua njoh unë si shkrimtar. Vallë, a nuk po e shihni se gjithë jetën mbetët nëpër "istikame" politike – fetare". Varre, duke i shpallur familjarët "shehitë" dhe trima pas lufte larg Atdheut?! Shumë pak jeni rrokur fytas me vetveten si "pejgamberë" lufte?! Nateditë vajtoni Lirinë, e në anën tjetër e keni rrokur për fyti, jeni duke ia nxjerrë edhe shpirtin, e shtini të gjallë me gjithë tesha në varr. Ende nuk e dini se, u është thyer rrota e Koçisë mes maleve: Nusen ua ka ndërruar Dexhalli me shokë. Tjetër Nuse u kanë shti në koçi, zbritur në lëmë me dajre. Babai, siç duket kotnasikoti ka shkrepur pushkë, nën hijen e Lisit midis livadhit. Hoxha i Dexhallit me zërin e Shejtanit ka hipur në minare! E mua, sot më ka marrë malli për Hoxhën me kësulën e bardhë të Bajram Currit, që pesë herë në ditë hipte si burrat e zbriste shkallëve teposhtë nga minaret, nuk çirrej përmes altopralantëve të Shejtanit ta shurdhojë qiellin e të na i trembë fëmijët në

gjumë. Ëndërrat e Ditës së Nesërme, pasmesnate për Atdheun.



Zeni Ballazhi

Tmerrohem në Ditën e Sotshme kur trumbetoni se, nuk keni Liri fetare: jua mbyllin

gazetat, gojën dhe xhamitë?! Palarenë, së paku ua lënë të lirë. Palarenë. Vetëmse, jo edhe atë se, të gjitha këto jua bënë "armiku" i pabesë. Përmëtepër, kur ju vetë jeni armiku më i madh i vetvetes, popullit shqiptar. Kokën hidhni pas, çka bëtë ju si parashikues të Ditës së Nesërme?! Asgjë. E shitët dhe e shitni veten një torbë taxhi. Hoxhallarë, gazetarë, analistë dhe fotografë teknefesë, që i "zbuluat" para syve të botës tangat e Presidentes Kosovës. "Zbulim shkencor" historik Shqiptar, ë?! Nateditë "vajtoni" (nën duvakun turko-arab) për "sexi xhihad", përpiqeni t'i "zgjidhni" me ilahi problemet e grumbulluara shqiptare. E dini pse, shkaku se: gjithmonë ma kujtoni Fishtën e Madh, burrin e Zanave të Maleve. Gomarin e tij të Babatasit me samarë në shpinë:

„Ani kush pra, me i pri kombit
Ju do pyka bijtë prej llomit
Që „Shqiptarë" vedit thoni.
Jo pse ju Shqipninë doni.
Jo pse ju ndo' send kuptoni
Shka asht Atdheu e shka është Lirija.
Shka asht Vllaznija e Parasija
Përpraimi e Qytetnia.

Edhe, një askush tjetër me „Din e Iman", turret me të katra të dalë në skenë, Adamat

Theranda (me siguri pseudonim halldupi), i cili në *Lajm* shkruan: „Thotë shumë fakti që historiani më autoritativ rreth Kosovës është një anglez, dhe ky anglez (jo turk) thotë se shqiptarët i ka lënë mbrapa komunizmi, jo Perandoria Osmane. Qesharake, ë?! Shqiptarët në kohën e komunizmit sa di unë (jo me të gjitha nishanet shqiptare), kanë pasur Shtet, edhe shkolla, edhe universitete, por jo edhe në Perandorinë Osmane. Historinë shqiptare nuk mund ta shkruajnë të tjerët, po vetë historianët shqiptar. Tjetër punë është ajo se, politikanët shqiptar historikisht e kanë shitur Atdheun, po jo edhe popullin shqiptar. Fishta i madh e ka thënë shumë bukur, përsëri te Gomari i Babatasit:

Por, veç pse ende der më sot
Një tyran s'po e gjeni dot.
Nën këmbë t'cilit ju me u shtrue.
Se un ma tash jam regjë me jue.
E jau njof shpirtin der m'palc:
Pleh i ndytë, me u bartun m'shkale
E me u qitë jashta Shqipnije.

Askushi, përsëri me gojën plot thotë: "Qeveritë tona kanë dështuar plotësisht në këtë aspekt, jo për shkak të ndonjë presioni të veçantë nga Ankaraja, por se janë servile ndaj çdokujt. E, shtoj unë si autor i këtij shkrimi: vërtetë janë

servilë me përjashtim të "vëllezërve" dhe "Turqisë mike". Kurrësesi, nuk pajtohem me mendimin e analistit, Mero Baze kur shkruan: "Tre Kryeministra për një komunë". Prizreni nuk është vetëm komunë, po qytet historik i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878 – 1881). Edhe, për këtë qytet pak janë tre kryeminstra të këtij kalibri politik. Shkaku se, në këtë qytet jeton nëpër shekuj historia shqiptare. Vetëmse, pajtohem kur thotë: "Ka një ekzaltim të tepruar nga dy kryeministrat shqiptarë dhe ai turk, në Prishtinë dhe Prizren, rreth evokimit të historisë shqiptaro-turke, i cili në fakt bëhet jo për shkak të historisë, por për nevoja thjesht elektorale. Në këtë histori nuk ia vlen të qortojmë Erdoganin pse mësyu në Kosovë, pasi nuk është një lider që vjen nga delikatesa demokratike, por nga autoritarizmi." E, sidomos kur thotë: "Edi Rama nuk është i ngjashëm me Erdoganin. Nuk është as autoritar, as aq i pushtetshëm, as aq jetëgjatë në pushtet, dhe as me atë formim politik si ai. Përpjekja për t'u dukur "vëlla" me të, është sforcim i tepruar. Dhe, ku nuk pajtohem me Mero Baze, kur thotë: "Të përdorësh kryeministrin e Shqipërisë dhe atë të Turqisë, për të fituar një komunë, është sikur të marrësh tankun me vra një mizë." Unë e them pak më ndryshe, të kundërtën: Tanku është Prizreni historik i Rilindasëve të

vërtetë shqiptar, e Tre kryeministrat e arratisur në Kosovë janë mizat. Duartrokitje, Mero Baze!

Gomari i Babatasit është satirë antologjike, të cilën nëpër librat e mi publicistik e përsëris me qindra herë, por siç duket gabimisht kot trokas në derë të shërbetorëve të Dexhallit. Haramët nuk kanë sy, veshë e as tru në kokë. Rrugën e shenjtë ta vazhdojnë për në Baba Tomor. Malin e Perëndive. Tyrben, ku pihet vera, lindë poezia. Tyrben, ku bëhet dashuri me Hënën. Shkaku, se: Sot për sot, dhiareve ju pri në ballë me trumbeta përmidis Çarshisë Shkupit, Dexhalli i Allahut. Nesër, hë për hë nuk e di çka mund të ndodhë mes këtyre rreshtave, që moti me qerre janë nisur për në Baba Tomor. Dhashtë Zoti Madh, mëkatarëve jua kthen ato të shkreta në kokë.

Edhe, Hoxha i Allahut krah për krahu me Rrumaducin dhe në mes Hojdodolen si "patriote", nguten para Zotit Madh, më pyesin publikisht në mjetet e informacionit: Kur do të bëjë vetëvrasje?! Përçudi, i gëzohen fluturimit tim në qiell nga minarja e xhamisë si Azreti Isai, që ma parashohin edhe Ditën e Madhe, kur Zonja Vdekje do të më trokasë në derë. E unë, si njëfarë burri i grave azgane do t'ia hap krah më krah jo derën, po edhe portën. Gjithë natën e gjatë do të rrokullisim shtamba me verë nëpër dhomë. Pasmesnate, do të bëjmë edhe dashuri deri në agim. Vetëvrasjen, brez pas brezi nuk e kemi si

fis kaçakësh traditë. Kurrë! Shkaku se, sipas Kur'anit, është haram. Pastaj, fisit tim të kaçakëve të maleve nëpër damarë me shekuj i qarkullon gjak shqiptari.

Përçudi, si "myslimanë me Din e Iman" ma parashihni edhe Ditën e gjykimit, kur një natë Zonja Vdekje, pasmesnate do të më trokasë në derë, marrë në pyetje për mëkate. E unë, përsëri si mik dhe kojshi i Xha Derallës do t'ia hap derën krah më krah, edhe dritaret. Vetëmse, jo edhe oxhakun. E dini pse, shkaku se: oxhaku është derë qiellore vetëm e kaçakëve të malit. Kaçakëve të fushës, nuk u duhet oxhaku, u mjafton dera e madhe e shtëpisë. Kokë më kokë me të gjithë natën do të zbrazim e rrokullisim nëpër dhomë shtamba me verë të kuqe. Përderisa, Xhebrahili me trumbeta më pret dhe më ka vënë pusi te xhamia e Katundit të më përcjellë me "nderime fetare" në Xhehnem, unë do ta mashtroj si dikur Xha Deralla në katundin Cërvicë, rrëzë Çukës. Tinëz, dhiareve pas Çuke duke u përshkuar te Dy Lisat binjak mistik, shtatstolisur nga Nuset e reja do t'i hyjë me lodra e dajre të cucave azgane, këngë e valle në Xhehnet…

"PATRIOTËT" DHE SPIUNËT

Mend dhe ide kanë plot shqiptarët, me thasë. Zoti u ka dhënë edhe tri-katër fe si popull me traditë patriotike. Edhe kishë e xhami. Shtëpi të Zotit. Tjetër punë është se, edhe në shekullin e XXI ende nuk kanë me të gjitha "nishanet" Shtet Shqiptar. Italjanët moti kanë thënë për ne shqiptarët: Tuto albanezi, tuto komandanti. Thënje antologjike për popullin shqiptar nga "çlirimtarët" e djeshëm dhe këta të sotshmit, që çdo katër vjet dalin në zgjedhje lokale e parlamentare për t'ua dhënë votën e "lirë demokratike" me pare e pa pare politikanëve të arratisur në mes të Lëmës. Realitet historik, që na u përsëritë edhe në Luftën e fundit (2001), ne shqiptarëve të IRJ të Maqedonisë që zbritëm nga malet.

Gomarit, e kam thënë moti: vite me radhë i hip Nastradini me 60 kg. dhe i zbret kur t'i teket popullit shqiptar nga samari, t'i hipë Nastradineca me 120 kg. në shpinë. "*Vaj Vatani e mjerë mileti*", do ta ngriste zërin edhe sot si Dje po të ishte gjallë Noli i Madh. E them këtë se, e kam gjithë jetën samarin arnë përmbi arnë shqiptar mbi shpinë. Nuk e di, a e ka Kryministri shqiptar, Edi Rama i zgjedhur me "votën e lirë demokratike"?! Nuk e pyes në këtë shkrim

Hashim Thaçin e as Ali Ahmetin në Qeveri. Pavetëdije, kur emërojnë këshilltar kulturor nga Kosova dhe IRJ e Maqedonisë, emëra publik me afat për një përdorim, që i njeh mirë populli shqiptar anembanë Atdheut, kur në Shtëpinë e tyre zyrtare bredhin e heqin valle minjtë me dajre.

Jo, them me vete mes këtyre rreshtave, që nateditë më rrinë mbi kokë! Përderisa, ky politikan "ashik" shqiptar nuk e pastron Oborrin e vet përpara Shtëpisë, e bënë "luftë" për Oborrin e kojshisë, matanë avlisë pa tjegulla, që përditë e mbulojnë ferrat. Pavetëdije, kërkon jerm rregulla drejtëshkrimi të gjuhës shqipe në Qeverinë Shqiptare, kur ne ato rregulla drejtëshkrimi të gjuhës shqipe ende nuk i kemi sot në Institucionet arsimore e kulturore të Shtetit Shqiptar. Emëron partizanë të partive politike si këshilltarë "kulturor" Qeverie, në Kosovë e IRJ të Maqedonisë. Fatkeqësi kombëtare për një Qeveri Shqiptare në pushtet, që nuk mundet me vite të arrijë nivelet e Shtetit Shiptar të "diktatorit" Enver Hoxha. Shtetit Shqiptar, që gjithë jetën investoi me të gjitha forcat politike e arsimore në arsim, kulturë dhe emancipimin e femrës shqiptare. Duartrokitje historike, jo pse e kam dashur ndonjëherë marrëzisht dhe e dua, po nga zemra e plasur sot për xhaxhin Enver. Ose, siç thotë populli: më ka djegur tambëli, tashti i fryej edhe kosit.

Mirë, po çka janë duke bërë këta nxënësit e tij të përkëdhelur në prehërin e nëneve dhe baballarëve të tyre komunistë të rritur e ushqyer në prehrërin e Enver Hoxhës?! Asgjë. Përmëtepër, e di se do të më përgjigjeni: edhe këta kanë bërë vepra historike, si nuk kanë bërë "vapra pariotike". E shkatrruan arsimin dhe kulturën shqiptare me themele. Lidhjen e Shkrimtarëve Shqiptarë me shtëpi në kohën e Enver Hoxhës, e lanë pa çati në rrugë. Manifestimet kulturore në mëshirën e individëve pa punë e mjete materiale. Shkrimtarët shqiptar të vdesin rrugëve në heshtje edhe pa bukën e gojës. Përçudi, seç ma kujtojnë mikun tim të penës Frederik Reshpen, kur erdhi ne fillim të viteve '90 –ta në Shkup me makinë "Mercedes" vetë i treti me "djemtë" e tij dhe një poete, sot të arratisur në Amerikë. Kohë kjo, kur intelektualët shqiptar në Shqipëri nuk kishin para as për kafe. Frederiku, në atë kohë ishte i "pasur": vetë e pagoi hotelin më të shtrenjtë në Shkup, kafen edhe drekën mbretërore. Edhe, më tha në Teatrin e Pakicave në Shkup: Enver Hoxhën kurrë s'e kam dashur si politikan, ama veprën e tij në arsimin, kulturën dhe emancipimin e femrës shqiptare, nuk mund t'ia mohoj kurrë. Unë, kam qenë ai, që kur ka dalë Ai në televizor e kam thyer edhe televizorin, më ka rrasur edhe në burg.

Vetëmse, kur e shajnë këta shërbetorët e tij besnik servilë për pushtet, unë e dua marrëzisht!

Vetmevete, thashë: I falen Frederikut të gjitha, për aq vite (17) që i ka bërë burg në kohën e Enverit. Pak vetë dalin nga burgu me mend në kokë. Burgu nuk është Univeristet Shqiptar, por vend përmisimi dhe edukimi në shoqëri. Ndonjëri delë i çmendur, tjetri homoseksual, shumica spiunë e pak veta me mendtë në rradake. Si është e mundur të duhet kaq shumë "armiku", që të ka rrasur edhe në burg, e pyes vehten me kokën dhe trutë mbi tavolinë. Edhe pse, përmes valëve të Radio Tiranës i përcillja me vëmëndje të gjitha ngjarjet politike, arsimore e kultorore në Shqipëri. Fatmirësisht, kur isha edhe student i Prishtinës, isha në kontakt me ngjarjet politike të asaj kohe, arsimore e kultrurore të Tiranës. Kohë qorre ajo, kur në këtë anë të Atdheut për moskujdesin shkoje si qeni në rrush. Vite, kur nga ana e spiunëve të UTBA -as jugosllave të jepeshte romani "*Tradhtaia*" i Kapllan Resulit, e pasmesnate paprtimas të trokiste policia ne derë duke të akuzuar si "nacionalistë dhe irredentisë", armik i shtetit jugosllav?!

Inati më erdhi atë ditë, kur Frederiku më hipi në makinën e tij personale të cilën e shalonte njëri nga "djemtë" e tij me të katra si Gjokun e Gjergj Elez Alisë përmes Shkupit dhe më dërgoi në Tetovë, që ta vizitojmë edhe shkrimtarin e

mirënjohur Murat Isaku. Nuk ia prisha qejfin poetit rebel dhe të madh shqiptar, me të cilin isha njohur përmes poezive në Prishtinë në vitet e '70 – ta, kur një libër i tij me poezi: *Enise, enise* (përzgjedhje) më ra në dorë si botim i Rilindjes (1975). Dikur, arritëm në Tetovë. Në derë na priti e shoqja e Murat Isakut dhe na ftoi sipas traditës në shtëpi për kafe. Hë për hë, Frederiku e refuzoi kafen. Jo, iu përgjigjë gruas së shkrimtarit, do ta pimë në kafene përballë shtëpisë. Vetëmse, i thuaj Muratit që do ta presim poshtë në lokal.

Pas pak kohe zbriti Murat Isaku dhe pasi u përshëndet dhe u përqafua me ne, u ulë në tavolinë. Frederiku iu sulë rrufeshëm me fjalë. Unë, gjatë gjithë kohës vetëm heshta. Muratit i shkonin djerëstë rrëke ballit e fytyrës. Tek tashti, e kuptova qëllimin e vizitës së Frederik Reshpes në shtëpinë e Murat Isakut, në të cilën nuk donte të pijë as kafe. Herë pas here, vëtëm ndërhynte Murati me fjalë për të dalë nga rrethimi: unë e kam mik Kaloshin. Kokës sa mundesha vetmevete i bija me grushta: si është e mundur Frederiku t'i dijë më mirë se unë veprimet politike, arsimore dhe kulturore në IRJ të Maqedonisë?! Në fund, Murat Isaku u përpoq t'i paguaj kafet, nuk e la Frederiku i pagoi të gjitha duke i lënë një "bakshish" të majmë edhe kamarierit.

Falë Zotit Madh dhe përkudesjes sime (porosisë së Babait), romanin "*Tradhtia*" nuk e lexova në Kosovë. Vite më vonë e huazova në Bibliotekën Universitare në Shkup (1980), bashkë me "*Ushtimën e Korabit*" dhe "*Gjarpërin*". Vetëmse, kësaj radhe nuk ma jepnin bashkëpunëtorët e sigurimit jugosllav, po punëtorët e Bibliotekës Universitare, në Shkup. E dija edhe këtë se, përsëri hynim me emra e mbimemra në evidencë policore, në listat e tyre "nacionaliste dhe irredentiste", po kjo shumë pak kishte rëndësi dhe pasoja politike për ta shpëtuar kokën. Dyshim, për t'i bërë vetvetes pyetje: Si është e mundur që "veprat e ndalura", për të cilat ne shkonim në burg më së paku pesë vjet, t'i lexosh pa frikë dhe në mënyrë ilegale në institucionet e shtetit jugosllav, në mes të Shkupit?!

Vitet ('80 –ta), kur unë u ktheva në Shkup dhe ndiqesha si i dëguar nga Kosova që të veproj në këto anë shqiptare. Dhe, çështjen shqiptare sipas tyre doja ta zgjidhë me luftë. Përmëtepër, unë kisha qenë ai kryesori "komandanti", i cili kisha pasur disa takime të fshehta në Bullgari dhe i kisha dërguar Partisë Socialiste në Shqipëri me dhjetëra mijëra marka?! Në aktakuzë, me emra e mbiemra figuronin edhe njëzetë nënshkrime si "armik i shtetit". A do t'i shohësh, më pyeti

inspektori? Jo, i thashë: I di dhe i marr me mend se kush janë këta rrufjanë.

Biseda informative në atë kohë, ma përkujtoi edhe rrëfimin personal kokë më kokë me poetin e ndjerë Adem Gajtani (mikun "besnik" të Kapllan Resulit, i cili në atë kohë ia rrëmbeu edhe gruan). Vite, kur unë plot vështirësi botoja librin e parë me poezi për fëmijë: *Zogu erdhi me një këngë* (1982). Libër, që pa ndihmën e Mehmadali Hoxhës dhe Abdylazis Islamit, nuk do ta shihte kurrë dritën. Ndoshta, edhe unë sot nuk do të isha shkrimtar, po do të përfundoja në burg ose si i çmendur rrugëve. Ademi, pasi shikoi anësh mos jetë dikush në zyrë, me tha me zë të ulët të mos dëgjojnë muret: Këtu në "*Flakën e Vëllazërimit*" gati të gjithë mendojnë dhe propagandojnë se unë jam spiun. E, në realitet këto në mesin e tyre kanë spiunë me qerre. Fatkeqësisht, "patriotët" më të mëdhenj të popullit shqiptar janë shpërblyer dhe shpërblehen me poste partiake në redaksi. Çmime letrare e shtetërore. Vetëmse, koha një ditë do ta thotë realitetin.

Nuk shkoi shumë kohë, dhe Kapllan Resuli ra në burg si spiun jugosllav. Vite më vonë doli me libër edhe kundër Ismail Kadaresë. Poashtu me shkrime kundër Ismail Kadaresë në kohën e sistemit komunist jugosllav, dolën edhe dy-tre shkrimtarë në Shkup e Prishtinë. Teki Dervishi, që nuk e hëngër grepin e politikës

ditore, nuk iu kundërvu me shkrime të porositura teknefese në vazhdime Ismail Kadaresë, e përzunë nga *Flaka e vëllazërimit*, në Shkup. Shkrimtarë Oborri, të cilët sot nderohen me çmime shtetërore për "merita të pakapërcyera" të "vëllazërim-bashkimit" për Ditën e djeshme, edhe pse të emëruar me data historike e të personaliteteve të "vëllezërve" të Njerkës. Çmime shtetërore, që nuk i morën për së gjalli personalitetet e dëshmuar të kulturës dhe letërisë shqiptare: Sadudin Gjura, Mehmedali Hoxha, Abdylazis Islami dhe Murat Isaku.

Prodhimi serik i gazetarëve të *Flakës së vëllalzërimit*, përçudi gjatë ndryshime "demokratike" në Kuvend e Qeveri "shiti" mend në politikën shqiptare dhe në mjetet e informacionit?! Fatkeqësisht, sot të vjen inati që shqiptarët nuk patën një Sartër që e ktheu prapë, nuk e pranoi edhe Çmimin Nobël. Artistëve shqiptarë këto çmime në nivel shtetëror do t'u kishin hije, sikur Shteti i "pëbashkët" në gjirin e vet t'i kishte edhe dy-tre çmime me emërime të datave historike dhe personaliteve shqiptare. Spiunë në Ditën e sotshme po na dalin edhe shumë politikanë, gazetarë e "patriotë" shkrimtarë shqiptar të strukur nëpër redaksi e institucione të shtetit komunist jugosllav. Frikë kam se, sot po na harxhohen eksponentët e "vëllazërim – bashkimit"! Nesër, ne shqiptarët

nuk do të kemi kandidatë të këtij soji për këto çmime letrare shtetërore t'i mbushim birucat e "flijimeve artistike" të partive politike. Shkaku se, dita-ditës po na paksohet bagazhi "artistik - kulturor" i "vëllazërim-bashkimit".

Zoti u ndihmoftë "martirëve" të politikës, gazetarisë dhe letërsisë shqiptare?!... Hë për hë, mua nuk më duhen si kuadër "deficitar", prodhim serik me shumicë e pakicë i partive politike "demokratike". Popullit shqiptar, nëse i duhen, ja ku i ka në disponim me të gjitha titujt shkencor e diplomat univrsitare dhe zotësitë personale profesionale, jua paftë hajrin përgjithmonë në këtë jetë e në atë jetë! Unë, si shkrimtar them: Koha është, ta thyejnë qafën në përrua… Vërtetë, ishin viça të palëpi me shumicë e pakicë të koperativave bujqësore me diploma të livadheve të Xha Derallës, pas Çuke…

ULU MAL TË DALË HËNA

Vargu i poezisë erotike, moti e ka tejkaluar plumbin e pushkës. Përçudi, qëllon jo në zemër, por në ballë. Edhe atë, dudumët që me vite na ngatrrohen nëpër këmbë. Fatkeqësisht, e them me plot gojën, se: populli shqiptar atë që e ka arrirë me vargun erotik, nuk e ka arrirë ende me pushkë. Dhiere këto, që të hipin në Baba Tomor.

Punë tjetër është ajo se, ne shqiptarët shesim plot "moral" dhe "trimëri" mejdani. Pajtohem, por pse nuk e provojmë edhe këtë "plumbin" erotik për ta bërë Atdheun. Historikisht, e kemi përdorë shpatën e Skënderbeut, Topin e Mic Sokolit. Gërshërët e dhenëve të Sulltanë Qafës. "Nagëntin" e Sefer Zajazit, Mauzerrin e Shotë Galicës. Koha është ta përdorim edhe "plumbin" artistik, që nuk të qëllon në zemër, por në lule të ballit. Këmbët, pas mullarit me bar t'i ngre përpjetë në "hava" mes livadhit.

Ditët e fundit në përdorim e kemi vënë edhe "Rilindjen" e Edi Ramës, por jo edhe Kanarin e Çajupit. Armën më moderne, që sot për sot e kanë shqiptarët me të cilën mund të krenohen si popull me traditë luftarake.

E dini pse? Shkaku se, ne kemi "moral e besë". Dhe, jemi trima. Edhe, fëmijët ne nuk i

kemi lind me gruan legjitime, por na i ka sjellë lejleku. E, në anën tjetër gjithë natën kacavjerremi kasollave e avlive pas Pjeshkës së Sulojcës.

Megjithatë, për t'i hipur në majë Pjeshkës së Sulojcës, duhet guxim, talent dhe trimëri kreshnikësh. Rilindasit tanë, moti i janë ngjitur kësaj pjeshke, edhe i kanë zbritur, që sot ne pasardhësit e tyre ta kemi plot me fruta gjirin. Tjetër punë është ajo se, "Rilindasët" e sotshëm nuk e kanë mbushur gjirin, por turren t'i mbushin xhepat.

Poetët janë ata që mbushin gjirin me fruta për Dimër, e jo politikanët që i hipin e i zbresidn gomarit të Nastradinit me "vota të lira demokratike". Shkak ky, që xhepat e tyre janë të grisur, arnë përmbi arnë. Vështirë i mbajnë frutat e Vjeshtës për Dimër. Thasët i ngarkojnë kotnasikoti mbi shpinë. Ose, e lëshojnë furrikun si pula në mes të lëmës. Momentet e fundit tra më tra e kërkojnë kotecin dhe u shpëtonë në kashtë.

Pjeshka e Sulojcës këtë vit me fruta degët i ka përtokë. Moment historik ky, që Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar nga Shkupi kësaj radhe Manifestimin Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: TAKIME NËN RRAP e strehoi në Kërçovë. Poetët iu turrën të mbushin gjirin dhe shpirtin. Vargun erotik ta shalojnë edhe mes këtyre maleve. Bora ku e zë borën. Erdhën nga të

katër anët e Atdheut, në Shkup dhe Kërçovë. Orën simbolike letrare e hapi artisti i popullit, Dhimitër Orgocka me poezinë e Pano Taçit: *Na bashkoi Rrapi*. Miqtë e pranishëm në sallë i përshëndeti kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar, Kalosh Çeliku. Gani Xhafolli, kësaj radhe erdhi pa 33 dashnore nga Prishtina… Nikolla Spathari me Zanën e Maleve… Fatmir Minguli doli në dyluftim me Rrufjanin. Skënder Demolli nga Korça (vendlindja ime e dytë) krah për krahu me Dhimitër Orgockën dhe Edmont Hoxhalli me kitarë, Rozeta Kreste me frymën e lirikave të Lasgush Poradecit, Vlladimir Muça me Gruaverën e Durrësit, Gjon Gjergjaj me mjekrën e Pjetër Bogdanit, Albina Idrizi pa pashterkë të kuqe, të cilën e ngjeshi në Kërçovë. Poezi erotike gjatë Natës Madhe deri në agim lexuan edhe poetët: Artur Balli, Fadil Curri, Eduart Sulollari, Ilir Shyta, Marina Shkurti, Festim Tomori, Istref Sulollari, Xhelal Tosku, Beatriçe Balliçi, Jokida Mati, Enea Ruci, Abdyl Kadolli, Shqipe Hasani, Rami Kamberi, Xhelal Ademi, Safet Hyseni, Begzat Rrahmani, Him Koça, Rexhep Bajrami, Adem Xheladini, Xhevdet Ukalli, Vesel Xhaferi – Çeliku etj.

Shtëpia e Artit mes maleve i hapi dyert krah më krah për poetët. Gani Xhafolli e hapi ekspozitën e pikturave mistike të Vesel Xhaferit – Çeliku. Dielli, që atë ditë ai mbante në duar,

derdhi rrezet mbi Kërçovën historike. Drejtori i Termoelektranës së Oslomesë, zoti Qerim Halili poetëve u shtroi edhe një drekë poetike. Gotat me verë u ngritën dolli. Skënder Demolli doli edhe në fotografi me Don Kishotin e Mançes.

Pasdite, poetët zbritën në qytet. Koha ishte për pak pushim, që në mbrërmje t'i jepnin poezisë zjarr. Natën e Madhe e hapi kantautori kërçovar Ferid Abdiu me këngën e tij të mirënjohur: *Të pret poeti*. Miqtë i përshëndeti edhe Kryetari i Komunës së Kërçovës, zoti Fatmir Dehari. Poetët i dhuruan Kryetarit të Komunës një Mirënjohje nga druri i Rrapit me emrat dhe mbiemrat e tyre në ballinë. Vargu krynegritës jehoi në sallë. Dhe, Gjatë kësaj nate u bë edhe përurimi i librave: *Individualitete letrare 2 – Teki Dërvishi* (studim) me autor Nahas Sopaj, *Gruaja me të zeza* (novela) me autor Him Koça dhe libri *Venela* (poezi) i Vesel Xhaferit – Çeliku. Për librat në fjalë folën: Fatmir Minguli, Safet Hyseni, Shaban Dalipi dhe Kalosh Çeliku. Pasmesnate, u ndanë edhe çmimet letrare: Çmimin për poezi më të bukur e fituan Rozeta Kreste dhe Albina Idrizi. Çmimin për vepër erotike botuar brenda dy takimeve e rrëmbeu Gjon Gjergjaj nga Klina e Kosovës. Çmimin për vepër jetësore, Fatmir Minguli. Juria profesionale e përbërë nga Gani Xhafolli (kryetar), Rami Kamberi dhe Kalosh Çeliku (anëtarë) ndau edhe dy çmime speciale:

Mikja e Rrapit, që i takoi Jokida Matit, dhe Miku i Rrapit - Xhelal Ademit.

Korça e serenatave (vendlindja ime e dytë), më doli zot Natën e Madhe. Burrat e dheut, vërtetë më bënë një befasi, që kurrë në jetën time nuk e kisha përjetuar si shkrimtar. Poezive të mia, përveç gjakut dhe shpirtit ju dhanë edhe zjarrin artistik me kitarë. Vendlindjen time mes maleve me vargje e kitarë e ngritën më këmbë. Nënën dhe Babain i ringjallën mes varreve, rrëzë Çukës dhe m'i sollën në Natën e Madhe. Vesel Xhaferi – Çeliku, më dhuroi një orë muri dhe një sharrë.

Him Koça dhe Argëton Dervishi, në mesin e poetëve e pritën agimin me këngën kërçovare: ***Në bahçe na ka ra bryma***. Ditë e Madhe për Kërçovën historike, që kurrë deri më sot nuk kishte pasur në gjirin e vet kaq shumë poetë nga të gjitha trojet etnike shqiptare. Qytetitin e kaçakëve të malit: Kalosh Zajazi me shokë dhe Sulltanë Qafa. Mefailave të Zajazit. Grave dhe burrave trima të këtyre anëve, që brez pas brezi i dolën zot dje dhe i dalin edhe sot Atdheut.

E përcollëm Natën e Madhe me poezi, valle e këngë kërçovare matanë Çelëvjollcës, majën me dëborë verë e dimër, ku lind Dielli. Edhe atë, me këngën popullore të dasmave shqiptare: **Ulu mal të dalë Hëna**!...

DASËM "ALLAFRANGA" ME NUSE MBI GOMAR

"Librat" e trusakatëve me urdhër të partive politike i mbushin sallat e përurimit të pispilosur e stolisur fundekrye duke u shtyerë me bërryla e fotografuar para kamerave televizive. Intelektualë të dy-tri Unioneve të viçave, doktorë shkence me tituj universitar (me shumicë e pakicë), Shkrimntarë oborri, analistë e gazetarë në rendin e parë rrinë paluar si kukubecë bostani. Vend të lirë nuk gjen nga "politikanët" e arratisur dhe argatët e tyre dudumë, që gjoja merren edhe me arsim dhe kulturë, e përfundojnë gjithë jetën e tyre "patriotike" në varr duke e lëvduar njëri-tjetrin për "flijime artistike". E, ti si shkrimtar rebel ku ta rehatosh së paku Kryengritësin shqiptar (veteran lufte), që deri më sot nuk e ka lidhur as Kral e as Mbret në ndonjë shpellë?! Kanarin e Çajupit mes këtyre kukullave shqiptare sa për sy e faqe?!

Vetëm Rrufjani përurohet me dhjetë burra e gra në Qendrën Informative Kulturore në Shkup, ku fatkeqësisht dhe fatmirësisht drejtoresha është shqiptare. Dhe, ekipin e RTV të Redaksisë në gjuhën shqipe. Edhe atë, në Kryeqytetin e shqiptarisë me gjithë këta "intelktualë,

shkrimtarë, analistë e gazetarë” me qerre, që e “kërkojnë” lirinë e fjalës në rrugë të stolisur me tituj shkencor e poste politike nëpër redaksi e kabinete partiake të Qeverisë. Unione të viçave, shoqata të historianëve, shkrimtarëve të Oborrit, Lidhje të arsimtarëve e Shoqata ”humaniatare”. “Aktorë - gjeni” Bit-Pazari, që e thyejnë kokën copë-copë duke vrapuar pas shpërblimeve (një torbë taxhi) me talent hutini qorr, dhuratë të partive politike në Qeveri.

Libri për Nesër, u doli në dyluftim në mes të Shkupit. Edhe atë: në Institucionin shtetëror, ku para autorit në fjalë janë përuruar edhe nga dy-tri herë me radhë partizanët e partive politike dhe i kanë mbushur sallat me dreka e darka të përkrahur edhe nga Komuna e Çairit. Rrufjani erdhi vetë i shtati në Qendrën Informative Kulturore në Shkup. Përçudi, nuk erdhën atë natë miqtë e tij të arratisur: Hojdodolja, Rrumaduci, Dudumi, Hoxha i Allahut dhe Këlyshi me zgjebe. Pse jo, edhe Kryetari i Komunës së Çairit, Izet Mexhiti?! Trëndafiles si “patriote” kuqezi t’i duatrokisin në skenë. Rrufjanin, Natën e Madhe e shtinë me dajre e këngë dhëndër pa Nuse. Dudumët, me siguri gjatë kësaj kohe pinin çaj rusi në Bit - Pazar, ose i luteshin Zotit për mëkate me bythët në “hava” në xhami e trutë në legen në mes të udhëkryqeve të Bit-Pazarit.

Dukuri e pazakontë shqiptare kjo në Ditën e sotshme, kur personazhet e dashur të librit Rrufjani, nuk patën guxim të ballafaqohen me veteveten, realitetin e hidhur artistik në skenë. Ironia më e madhe, vetë drejtoresha shqiptare nuk ishte prezente në "dasmën" e saj të "burrave e grave të kombit". Nikoçire, që fatkeqsisht siç duket nuk e di traditën e dasmave shqiptare brez pas brezi nëpër shekuj. Gjithë punën organizative ia lë në dorë zv./ drejtoreshës maqedonase. Apo, me siguri e kanë lodhur zhurmat e përditshme kulturore shkel e shko me përurime të librave dhe hapjen e ekspozitave figurative?! Moment historik ky, kur fabrika partiake non – stop prodhon mallëra serik me afat të skaduar me shumicë e pakicë të shkrimtarëve e piktorëve. Reklamimin e tyre institucional shtetëror, që kësaj radhe nuk flasim e as shkruajmë në këto çaste për këtë fenomen të çuditshëm shqiptar. Që, padashtas ma përkujton satiristin e madh shqiptar, Niko Nikolla i cili në një Akademi Përkujtimore për Mehmedali Hoxhën në Strugë tha: Nuk ka popull shqiptar, po ka popull shkrimtar. Punë me të cilën duhet patjetër të merret Ali Ahmeti me shokë, nëse vërtetë me gjithë mend ka vendosur të na shpie në Evropë. Alarm politik se, me kuadër të paaftë politik të marrë nga rruga pa kritere shkencore, trusakatë dhe qorra nuk bëhet politikë madhore, arsim dhe kulturë shqiptare.

Edhe atë, në kohën kur kuadri më i aftë shqiptar shkencor, shkaku kësaj "ajke të zgjedhur politike partiake", na bredh rrugëve pa punë nëpër Bit-Pazar. Përmëtepër, kuadri i tyre partiak është nën nivelin e organizimeve amatore kulturore të shoqërive artistike të dikurshme komunsite. Anësh t'i lëmë "akademikët", gjithë këta shkrimtarë Oborri të stolisur me çmime shtetërore, gazetarët dhe analistët politik, që natë e ditë na i shurdhuan veshët në mjetet e informacionit me zhurmë politike, arsimore e kulturore. Personazhet e gjallë dhe të vdekur të Rrufjanit, këmbëkryq ulur mes faqeve të këtij libri, që të marrin guximin kulturor e intelektual, të vijnë në përurimin e vetëvetes si dëshmorë lufte për liri. Pse jo, edhe t'u duartrokasin "fitoreve historike" të personazheve të këtij libri, kënaqen së qeshuri me vetëveten si "dëshmorë" lufte kokë më kokë në Librin për Nesër. Përmëtepër, t'u gëzohen duartrokitjeve frenetike në sallë krah për krahu me zonjat e rënda kuqezi të salloneve politike me Nusen mbi gomar. Gjumi Arushës t'u dalë në Shkupin historik, dëgjojnë mendimin e kolegëve të tyre të penës: Fatmir Minguli nga Durrësi, Nikolla Spathari nga Shkodra dhe Safet Hyseni nga Kërçova.

Burra e gra Bit - Pazari, hidhni ferexhetë dhe kësulëleckat në përrua se na morët më qafë, dilni në fushën e mejdanit ku përqafohen gushë më

gushë "hutat" letrare! Mjaftë më, gjithë jetën u strukët nën sjetullat dhe bythët e partive politike, në xhepat e grisur të "vëllezërve" arnë përmbi arnë! Vite e vite i turreni përmbrapa dashit me brirët e përdredhur shtatë herë me radhë rreth veshëve si dhelpëra dinake, mos i bien udhës. Publiksht, doni t'ua them edhe këtë: Dashit me këtë kapicitet politik, shkencor, arsimor dhe kulturor që keni ju, kurrën e kurrës nuk do t'i bien udhës. "Guximi" juaj intelektual, me shpatën e Skënderbeut në brez, hipur mbi kalin e shaluar në parkingun e makinave dhe Hasan Prishtinën të varrosur për së dyti herë pas vdekjes në një copë parku mes kafeneve në Shkup, të cilit i jeni ngjitur si rriqëra ta propagandoni veten para kamerave televizive si "patriotë", përfundon me zhurmë historike të "vëllazërim-bashkimit" duke shënuar përditë ditëlindje e ditëvdekje të personaliteve historike nëpër Bit-Pazar. Vallë, si politkanë shqiptar mos i keni duarëzuar armët e luftës?! E, ne shqiptarët ende nuk e dimë "strategjinë e juaj historike" pas Çuke në ribërjen e Atdheut?!

Jo! Atdheu nuk bëhet me trusakatë dhe partizanë të partive politike që nuk shohin më larg se, në Lëmë. Gra me pashterka të kuqe, që nuk e dinë ku e kanë kokën e ku bythën. Burra - gra të dasmave "allafranga", që dalin në skenë me ferexhetë krahëve. Nateditë fotografohen para

kamerave televizive me zhurmën e tyre të dalldisur arsimore, shkencore e kulturore. Përdridhen e hidhen gjithë natën e gjatë nëpër dasma me këngë "tallava" e u bijnë duarve shuplakë, herë më një anë e herë në tjetrën anë si sorra të zeza. Këngëtarët duke i mbuluar me para e hedhur dengje me dhjetëra mijëra euro e dollarë mbi kokën e tyre nëpër sallë. Shkrepin allti e kallashë në mes të Shkupit, kur vetëm një fishek kushton sa një libër. Kohë kjo, kur fëmijët e tyre janë pa tekste shkollore. Realitet, që na është ulur këmbëkryq në sofrën shqiptare. Nateditë përpiqet të na bind si popull se, tjerë burra e gra janë ata që punojnë për Atdheun. Trusakatët, gjithë jetën mbetën duke u marrë me tekste shkollore e përpilimin e lektyrave shkollore. Shkolla shqipe. Gjuhë shqipe. Turren me të katra pas shpërblimeve shtetërore me emërime të datave historike e personalitete të "vëllezërve" të Njerkës, pa e ngritur zërin se edhe shqiptarëve si popull shumicë në këtë shtet të "përbashkët" u takojnë dy-tre shpërblime shtetërore me emër e mbiemrër të datave historike e personaliteve shqiptare. Përditë trumbetoni shkolla shqipe gjysmake e flamur kuqezi të harruar pas fushatave zgjedhore nëpër "bandere". Kohë kjo, kur pala tjetër maqedonase veç më këto dëshira historike i ka realizuar në vepër, që në "kohën e

artë" komuniste dhe sot po e shpallë botërisht veten pronar Shtëpie.

O Imzot, po deri kur do të merren shqiptarët me vetveten, me "politikë madhore" të katundeve?! Dyluftime mes partive politike shqiptare për argatë në pushtet: Qytetin e Lidhjes së Prizrenit ta shpallin në Ditën e sotshme qytet të Turqisë?! Turren me të katra për interesa personale e pasuri materiale, e jo me rimëkëmbjen e Atdheut???!!!...

SHEJTANARAPËT

Herë pas here, kur e hap internetin në YuoTube më dalin para syve Shejtanarapët me kësulëlecka ose me çallma turku të lidhura përreth në vend të veshëve duke pëllitur para "xhematit" në mes të batakut. Kohën e fundit krah për krahu edhe tulumbaxhinjt e fabrikave komunsite (miq besnik të Haxhi Deputetit) me "hajmalitë" e tyre serike teknefese, që e kanë shitur veten një vend pune ose banesë shtetërore. Shkrime të mbështjellura e kënduara me "bismillah al-rahman al-rahim " në letër hallvaxhinjësh, të cilën duhet t'ia varim përqafe Lopës, që t'i shtohet tambëli dhe mbushë plot kusinë në Katund. Histori më vete, që padashtas ma kujton Hoxhën me kësulën e bardhë në kokë të Bajram Currit, kur një plakë i troket në derë për ndihmë: një hajmali për Lopën e larme. E dini se, si i përgjigjet Hoxha me kësulën e bardhë të Bajram Currit në kokë: Mirë do të ishte Lopës larme, që t'i shtohet tambëli t'i jepni edhe një thes me krunde. Pajtohem me Hoxhën e Çelvjollcës (mik i Asdrenit, i cili ka ardhë edhe në Kërçovë) pikë për pikë, por kush do t'ju jap një thes me krunde tullumbaxhinjve të sotshëm me diploma universitare?! Shejtanarapëve turko-

arab, që vetë "kalemi" Baba Dovletit i ka rrëzuar në kokërr të shpinës mes livadheve. Edhe atë, me të vetmin qëllim: Tulumbat e tyre me "farë të vëllezërve", mos të na dalin të papjekura në treg me shumicë e pakicë?! Tekefundit, së paku të arrinë "vlerat ekonomike" të Çobanit Sharrit, që 300 dele i "humbi" nga bombardimet e helikopterëve rusë në Luftën e fundit të 2001 - shit. Përplasje në sy e fytyrë: Edhe sot si dje, me gjithë "arsenalin artistik" (vërejtja e fundit), të mos ma ndërsejnë më pas shpine "policinë letrare"…

Nateditë vajtojnë pse, nuk kanë mjekra të dendura (dëllinja shullani) si Azreti Muhamedi a. s. e jo tru. Ose, Azreti Isai që fluturoi nga minarja e xhamisë në qiell. Përgjumshëm, i rrëfejnë popullit shqiptar përralla arabe të Netëve të gjata shqiptare: Plaka si e ka zbritur aeroplanin nga qielli, Kush sëmuret nga Sihiri, Exhinatë, Shpikjet e munafikëve ndaj muslimanëve, Kur të kaloni në kopshtet e Xhennetit, hyni në ato kopshte… Më kot i kërkon Profeti shqiptar nëpër lëmë (institucinet e shtetit), livadh ose kasollë t'i dërgojë në mal për dru, ose sjellin miell në Shtëpi. Shejtanarapët janë rrasur me të katra këmbët në batak dhe pëllasin e pëllasin nateditë për liri argati fetar nga strofullat "fetare" dhe minarja e xhamisë. Zërin e ngrejnë në Faccebook: o, vëllezër rrokni armët në vend të Kur'anit dhe

kalemit (lapsit)! Pranverën arabe ta sjellim me të gjitha “nishanet” edhe në Shkup. Paralajamërojnë “Njeriun e fundit që do të hyjë në Xhenet”. Përçudi, sipas parashikimeve të tyre më nuk do të ketë jetë. Bota do të vdesë, përmbyset mes varreve. Vetëm se, kur ia qëllojnë “nishanit” meritojnë duartrokitje: “Mosfalja e Namazit është gjunah më i madh se me pi raki”. Burra e gra të Kombit Shqiptar, bini armikut të pabesë rakisë sipas këtyre Shejtanarapëve, që dikur moti ka bërë thirrje edhe imami Omar Khajam për verën. Kulminacioni i profetizmit botëror: “Zbret Allahu në qiellin e dynjasë”. Dhe, u shpëton nga mëkatet me vargjet e Omar Khajamit:

Të Madhit Moamet i çon selam
Dhe e pyet Imami Omar Khajam:
"O Pejgamber, më thuaj, mor aman,
Pse dhallën bën hallall, Verën haram?

-212-
Përgjigjet Moameti me selam:
"S'më more vesh, Imam Omar Khajam!
Dhalla hallall për lolot, mor aman,
Verën për t'Urtët nuk e bëj haram!"

-213-
Kur pi, disa besnikë plot me Shpresë,
Më thonë: "Vera ësht' armik i Fesë",

O burrani, pra, Kupat mbushini
T'ia pimë gjakun qenit të pabesë!

Shejtanarapët harrojnë se, nuk shohin më larg se në lëmë, pas Pranverës vjen Dimri me fortunë, borë dhe akull. Lisat i bënë kokë më kokë. Pasmesnate, delë Ujku i përrallave në Abetare me këmbën e lyer me miell që e hëngër Kësulkuqen në mes të pyllit dhe pasmesnate na troket te porta e edhave. Soji tyre, pa menduar gjatë edhe në Ditën e sotshme ia hapin derën, na e fusin në Shtëpi. Nateditë u bien trumbetave të grisura copë – copë të Dexhallit: Dhe, "nuk e kuptojnë "rrapjanin" (sipas publicistit neokomunist që nateditë rri me shkrime "profetike" në Faccebook) se, çka ka dalldisur me haxhi Deputetin, më falni me haxhi Muhamedin."

E ne, shqiptarët me "Din e Iman" ende nuk kemi Gjuetar të Malësisë Madhe si dikur me armën me dy tyta krahut që ka dalë në mal për gjah, sot ta shpëtojë Kësulkuqen me shportën e luleve që do t'ia dërgojë Gjyshes për Ditëlindje në mes të Pyllit, nxjerrë me shpatën e Skënderbeut nga barku i Ujkut. Edhe sot, si dikur në kohën e Jugosllavisë të Shokut Tito t'i bëjë tulumba shqiptare, mos qajë në djep. Ose, ndonjë "hajmali me shkrola" arabe në vend të lektyrave shkollore t'ia varë përqafe.

Shkaku këtyre Shejtanarapëve si popull shqiptar, shohim ëndërra turko-arabe edhe sot, ne mes të Ditës Madhe. "Vëllezër" i kemi pushtuesit shekullor dhe argatët e tyre Shejtanarapët, që me anë të hajmalive përpiqen të na i "përzënë" xhindet. Topin e Mic Sokolit me gjoksin para gryke si trimat, ende e rrokim për fyti si dikur me çifteli nëpër dasma shqiptare. Skënderbeun me gjithë kalë me shalë në mes të Shkupit, dudumët edhe sot na e shpallin tradhtar. Takimet dhe manifestimet fetare-kulturore i organizojnë te "Kali", sipas programeve "artistike" të halldupëve. E kanë "Kalin", por shqiptarëve u mungon Skënderbeu, do të thotë një Shejtanarap "shqiptar", gjithë jetën me një torbë taxhi përqafe i shëtitur nëpër institucionet e Shtetit Vjetër e të Ri të "përbashkët". E, unë e them të kundërtën: Shqiptarët e kanë Skënderbeun, por u mungon Kali me shalë (Gjoku i Gjergj Elez Alisë) të hipë në Kalanë e Shkupit.

O Imzot, vërtetë edhe hidhërohem keq sot me Skënderbeun e Shkupit, si nuk e nxjerrë më në fund nga brezi atë shpatën famëmadhe historike dhe t'ua presë kokën dudumëve, flugë para këmbëve të Kalit si kunguj Stambolli?! Thasë - thasë t'i ngarkojë jo si dikur në tren nga Shkupi t'i përzë në Turqi, po hipë në qerre (pajton) me katër palë kuaj me kumbona përqafe e lodra e cingana te Sheshi "Skënderbeu".

Hingëllimë "Kali" të dëgjohet në mes të Bit-Pazarit, që di të qesë edhe shqelma dhe hudhë buthekrye halldupët matanë Kalasë Shkupit. Nateditë, mos të shpallim më dëshmorë lufte dhe mbesim duke vajtuar si qyqe gjithë jetën nëpër varre. Kohë kjo, kur "vëllezërit" tanë të Njerkës në trojet shqiptare shpallin Shtet të Ri pa banorë maqedonas, para syve të Botës me shumicë prezente shqiptare në mes të Ballkanit...

NESËR DO TË SHPALLIM EDHE NJË SHTET SHQIPTAR

Dorën në zemër, mjetet e informacionit duhet të rrasin plot barkun me krundet e Qeverisë, partive politike dhe reklamave ekonomike, po jo edhe ta dezinformojnë këmbekrye me thashetheme politike shoqërinë shqiptare. Dështim i përsëritur me vite i gazetarëve shqiptar me barkun dhe trutë në thesin e partive politike, ku kemi plot pordhë politike, reklama ekonomike, po shumë pak arsim dhe kulturë.

Shkaku se, gazetat tona në gjuhën shqipe janë themeluar nga partizanët e Partisë Komuniste me shumicë e pakicë, që sot në "demokraci" vetëm e kanë kthyer gunën nga fryen era me pak shpirt. Fatkeqësisht, edhe sot e kësaj dite nuk mund të dalin nga kënetat e thella politike ku kullosin bar me plaçka helmuese, nesër të ngjiten maleve të mbuluar me borë verë e dimër. Mjerim shqiptar nga të cilët ende presim ecje nga majat e larta në Çelvjollcë, kur nën këmbë po na shtrojnë "vëllezërit" me vite akull.

Gazetarët tanë (me përjashtim të një pakice) janë "shqiptarë dhe myslimanë me Din e Iman", ndonjëri edhe me emrin e Muhamedit a. s. si "parashikues" i Ditës Nesërme. trutë i fusin në një torbë përqafe dhe dalin të pinë kafe, "shesin"

mend në vende publike. Gazetarë, që më së shumti merren me punësimin e shqiptarëve krah për krahu me Partinë Politike në pushtet nëpër institucionet e Shtetit të "përbashkët", gjuhën shqipe nëpër autobusë urban, sesa me arsimin dhe kulturën shqiptare nëpër institucione të shtetit. Kokë më kokë me "vëllezërit" i tjerrin temat e ardhshme, bota t'i shohë se ku "fshihet truri shqiptar". "Fodullëk" i paparë Bit-Pazari se dje, kanë bërë intervistë me mbeturinat e Partisë Komunsite (politikanë e analistë), sot Neokomunsite, Kryetarin e Partisë më të madhe Politike Shqiptare në pushtet (BDI, Ali Ahmeti). Dhe, me çka?! Asgjë. I bënë pyetje Bit-Pazari Komandantit të UÇK -së. Ivanovi, a ulet ndonjëherë te këmbët e Olimbisë?! Përditë, siç fotografohen si "turiste" para Aleksandrit të Madh laraskat dhe çafkat e zeza. Guxim nuk kanë të dalin në fotografi me Filipin e Maqedonisë. Fat i madh, që me ferexhetë krahëve nuk i sulen te sheshi "Kalit" të Skënderbeut si "tradhtarë" historik. Ose, Gruevski a pi çaj rusi në Bit-Pazar?! Thaçi, a ulet këmbëkryq me të në një sofër?! Rufi Osmanin, a e kanë shok lufte për të drejtat e barabarta shqiptare?! Pse edhe atë nuk e kanë thirrë në "Darkën e gabuar" me Edi Ramën në "Aleksandër Palas"?! Përmëtepër, edhe Nevzat Halilin, Kastriot Haxhirexhën, Hysen Shaqirin e ndonjë tjetër si kryetar i partive

politike shqiptare. Lehtë e kanë politikanët shqiptar nga Shqipëria e Kosova t'i ulin bashkë në një sofër për darkë Ali Ahemtin me Menduh Thaçin, po shumë vështirë e kanë t'i ulin bashkë në pushtet në një Qeveri të "vëllazërim-bashkimit". Prandaj, edhe gjithë jetën pajtohen me gjuhën shqipe si gjuhë të dytë zyrtare. Përralla turko-arabe të Netëve të gjata shqiptare Verë e Dimër. E pyes veten unë si shkrimtar: A ka ndodhur ndonjëherë për kaq vite "demokracie", ndonjë gazatar "i madh" shqiptar ta rrëzojë nga posti politik ndonjë ministër qeverie?! Ose, mos e dhëntë Zoti, Kryeministrin e Shekullit, autorin e Shkupit 2014?! Kryetarin e shtetit të "përbashkët", siç ka ndodhur me plot raste nëpër botë. Jo. Atëherë, pse bëni petulla të djegura për vete në zjarr me ujë, për të rrëzuar nga posti një ministër shqiptar?! Gjithë kohën merreni si të tërbuar me Talat Xhaferin, kur shtëpitë e juaja i kanë mbuluar me themele e çati ferrat. Ministrin e parë të Mbrojtes në IRJ të Maqedonisë, që me kurora të luleve nderoi të rënët për liri të UÇK – ës, në Shkup, Kumanovë, Tetovë e Kërçovë?! Zhurmë propogandistike dhe pluhur politik, që në atë kohë e çuan edhe mjetet e informacionit në gjuhën maqedonase. Bërllok shqiptar, që nuk dini ku e keni kokën e ku bythën?! Ditën e sotme, më detyroni t'ua përplas të gjitha të palarat në sy e fytyrë: Çka doni ju trusakatë, një ushtar shqiptar

ose polic në institucionet e shtetit të "përbashkët", apo një Ministër shqiptar?! Populli shqiptar ju di mirë se kush jeni si batakçi, prandaj në Ditën e sotshme do të ishte mirë t'i mblidhni mendtë në kokë, ato të shkreta, ta mbyllni gojën edhe palarenë që e keni nxjerrë për mejdani ta rrezitni në diell!

Tjetër punë është ajo e Ali Ahmetit, që sipas gazetarit me "famë çarshie" (vetëbegenisur) me direktiva dhe tru të "vëllezërve", se: Patjetër, IRJ të Maqedonisë duhet ta shpie në Evropë "turisti" i arratisur me shokë nëpër botë. Edhe pse, Kryeminsitrin e "vëllezërve" deri më sot nuk e uli në tavolinë te emisioni "debativ" (policor), "vizionar - politik" para kamerave televizive "Rruga qorre". Në emisionin e tij të "vëllazërim-bashkimit", nuk mundi ta "provokojë" deri më sot as Menduh Thaçin, që kurrë deri më sot nuk ia shkeli pragun e derës. Burrin e partisë më të madhe shqiptare në opozitë, që disa herë u përpoq si "gazetar i madh" me shokë nga strofulla e tij "luftarake" ta rrëzoj nga "pushteti", në Tetovë. Vetëm se, e uli përballë në tavolinë Edi Ramën. Shkaktarin e "Darkës vëllazërore" me Ali Ahmetin dhe Menduh Thaçin, në të cilën mungonte "vëllai" tjetër i madh Erdogani. Porosinë e "vëllazërim - bashkimit" mes rreshtave nga "stoli" (karriga), që ua përcolli shqiptarëve në Shkup. Përgjigjeve të "kulturuara"

me tone paqe për bashkëjetesë në IRJ të Maqedonisë, që nuk i kishte në kokë këto "idetë patriotike" para një viti aq të zjarrta si opozitë, në kohën kur e bëri edhe përurimin e librit të tij bestseller "Kurban" në Teatrin e fëmijëve në Bit Pazar. Provokim politik, për të cilin aktivistët e Aleancës kuqezi në Tetovë e pritën me grafite të hartës së Shqipërisë Etnike anembanë mureve të këmbëve të urave duke përfunduar të nesërmen njëri pas tjetrit në biseda informative në polici si "armiq të Shtetit".

E, nëse nuk bëhet kjo: Maqedonia ta ndërrojë emrin, pyet gazetari "i madh" i Bit - Pazarit me torbën e madhe arnë përmbi arnë me taxhi të "vëllazërve" përqafe?! Gajle të madhe ka mbi kokë, burri botës?! Frikë ka se IRJ e Maqedonisë me "turlifarë" zarzavatesh në thesin me arna nuk do të shkojë në Evropë.

Komandanti Zajazit, i "zënë në pusi" nga halldupi i përgjigjet mes rreshtave: Shtetin, që ne e kemi "ndreq" natën, edhe mund ta prishim me themele, rrafshojmë me tokë ditën. Njëqind, banorë të IRJ të Maqedonisë kanë marrë pasaporta bullgare. Njëqind të tjerë pasaporta serbe. "Turqit" (shqiptarët) pasaporta të Turqisë. Vëllehet i madh e i vogël kthehen te rrënja e stërgjyshërve. Maqedonasit ortotoks deklarohen me të madhe si shqiptarë. Nesër, ku ta di unë si kryetar i Partisë më të madhe në pushtet (BDI),

shqiptarët dy herë më shumë mund të marrin pasaporta shqiptare. Atëherë, me cilët banorë do ta bëjmë këtë Shtet të Ri, në Ballakn?! Apo, do të pajtohemi me realitetin e popullit shumicë: shpallim sipas zakonit edhe një Shtet të Ri Shqiptar.

Nuk dua ta lodh lexuesin me argumente historike: Në këtë Shtet të Ri të "përbashkët", jetojnë me shekuj dy popuj shumicë: shqiptarët dhe bullgarët. Pastaj, vijnë sipas radhës: vllehët, serbët, "turqit", dhe maqedonasit e sotshëm ortodoks me prejardhje Ilire. Tjetër punë është ajo se, në sistemin komunist janë deklaruar si maqedonas për interesa personale e përfitime materiale. Pajtohem me këtë realitet të Natyrës sot për sot në këtë shtet multietnik, vetëmse kujt do t'ia lëmë nesër Shtetin e Ri "maqedonas"?! Përgjigjen e keni përsëri në mes të rreshtave në këtë shkrim parashikues.

Gazetari i Bit - Pazarit me torbën e madhe plot zarzavate politike të tregtarit përqafe e mbyllë i dëshpruar "emisionin debativ" politik - policor. I shkreti, e provokon Komandantin e UÇK -së që të rrëshqasë me opinga ogiçi në akull. Gjatë gjithë kohës sa zgjatë "emisioni debativ" policor. Përpiqet bashkëbiseduesin politik, që me shumë vështirësi zbriti nga malet shqiptare ta dalldisë, fusë hamllave të Katundit.

Vetëmse, Komandanti nuk rrëshqet sot me sajë, po me ski maleve të Zajazit.

Popull shqiptar, urime Ditën e "tregtarëve të lajmeve dhe intervistave policore ekskluzive"! Veten që e mbajnë gjallë para kamerave televizive me përurimin e librave të kalorësve të arratisur nëpër Çarshi, kur ne shqiptarëve sot na digjet zjarr mbi krye. I vetmi vend pune ku mund ta fotografoni veten lirshëm si politikanë me "vision kombëtar". "Fitore historike" e popullit shqiptar në Ditën e sotshme! Megjithatë, një gjë duhet ta dini: O, burra e gra të kombit, nuk ecet kundër Ligjeve të natyrës! E Nesërmja, duam nuk duam ne, u takon shqiptarëve. Kutadi unë i arratisuri mes librave, nesër mund të shpallim edhe një Shtet të Ri Shqiptar. Një popull me tre shtete në Ballkan?! Dhashtë Zoti, këtë lëmsh të ngatërruar politik e zgjidhë Amerika ose Gjermania, na bashkon Evropa në një Shtet Shqiptar, sesa për ne me këtë bagazh politik, me siguri kështu siç e kemi nisur do të kthehemi përsëri të jetojmë si në kohën e Turqisë të ndarë nëpër fise.

E ju, tregtarë të flamujve të Ernest Koliqit, vazhdoni ditenatë të pini çaj rusi në Bit - Pazar! "Pranverën arabe" ta thirrni me ilahi me këmbët dhe trutë në legen!...

TEKNEFESI

E di se, gjatë jetës tënde "politike" të argatit ke bërë para me thasë. Populli do të thoshte: aqsa, të hanë edhe qentë. Unë, të përgëzoj si partizan fushe: Zoti të dhashtë edhe tri herë më tepër, nëse je vërtetë "tru" shqiptar?! Vetëmse, Zoti kurrë nuk i jepë dy të mira bashkë: nëse ta jep pasurinë, nuk ta jepë trurin. Ose, anasjelltas: nëse ta jep trurin, nuk ta jepë pasurinë. Realaliteti, ashtu siç këndon Agron Llakaj me shoqe e shokë pas çdo "Al Pazari" me korin e tij te "Çifteteli": "Paret nuk i hanë as qeni". Unë, them: i hanë Teknefesi. Shkaku se, karrierën "politike" e ke filluar me një reçension për Shokun Tito në kohën e Partisë Komuniste. Fatkeqsisht, ti deri më sot nuk u bëre kritik letrar, as gazetar, as politikan katundi e as Çerçiz Topull. Edhe pse, përmbrapa i je turrur DoktorZiut mos i bien udhës. Përpiqesh, me gërshërë nga gazetat e "vëllezërve" t'i arnosh shkrimet e "analistit" me një asht në gojë. Pavetëdije se, të plasë barku. Punemadhe, që "vëllezërit" të dhanë edhe pushtet "kalemi" në Klubin e tullumbave. Meritat "patriotike" për gjithë këto "flijime artistike" i takojnë Haxhi Deputetit. Ideatorit të pavarësisë të Shtetit të Njerkës. Çaj rusi ke pi, edhe pi ende me gjygym

turku, që të flasësh sot jerm i kurdisur nga podrumi i Rrumaducit në Bit-Pazar.

Atdheun (Mëmëdheun), tashti më në fund mezi u binda se, Teknefesi e kishte dashur me mish e shpirt edhe me shumë se Njerkën e babait (Tatkoto) të Haxhi Deputetit. Teknefesi, që sot mua m'i rrëfen arat e Babait me kalë me shalë. Mirë do të ishte në Ditën e sotshme historike ta mbylli gojën, kënaqi veten me arnat e tia të përditshme vetëm për një përdorim. Ne të tjerët, populli vetëm ishim shti se e duam Atëdheun, gjatë gjithë kohës i kishim kënduar me çifteli, hequr valle të veshur këmbekokë me flamurin kuqezi. Shqiponjën dykrenare gjatë zgjedhjeve lokale e parlamentare, herë duke e bërë qyqe e herë sorrë të zezë trusakatët. Përçudi, edhe sot, ajo shkollë politike komuniste delë në sipërfaqe: Shqiptarët, nuk kanë pasur e as sot kanë rrezik nga mësimi i gjuhëve të huaja, por nga kalorësit e arratisur të Klubit të tullumbave që pijnë çaj rusi dhe dehen në mes të Ditës Madhe, në Bit-Pazar. Përinatë, seç më shtinë Trusakati kohën e fundit ta dua Edi Ramën, kur nuk është i natyrës sime si shkrimtar. I cili publikisht u thotë trusakatëve: kinezi e di më mirë gjuhën shqipe sesa një shqiptar trusakat. Megjithatë, ma përkujton përsëri Frederik Rreshpen: i cili në vitet e para të ndryshimeve demokratike në Teatrin e Kombësive në Shkup më thoshte plot gojën:

Enver Hoxha më ka rrasur në burg. Edhe, sa herë që dilte ai në televeizor, unë e kam thyer televizorin. Por, kur sot e shajnë servilët e tij që më së shumti i kanë shërbyer, unë kam filluar ta dua si poet marrëzisht. Tri ngjarje historike në kohën e Enver Hoxhës nuk mund t'i mohojnë shqiptarët: arsimin, kulturën dhe emancipimin e femrës shqiptare. Thashë, me vete: edhe pse, e dija realitetin përmes Radio Tiranës. Shqiptarët edhe sot e kësaj dite, fatkeqësisht ende nuk kanë arritur ta tejkalojnë nivelin e arsimit, kulturës dhe emancipimit të femrës shqiptare si në kohën e Enver Hoxhës. Vërtetë, jemi populli më i lumtur në botë dhe problematik për Ballkanin. Ose, siç thotë këngëtari popullor me çifteli: disa herë ia kemi vënë zjarrin. E çuam gjithë verën si ai cinxërri i përrave popullore me këngë e valle, saqë në Dimër milingona na e përplasi derën. Po, ja që trurin tim nuk e shes me pare, ende nuk e kam nxjerrë si "plaçkë lufte" në Bit - Pazar. Agron Llakaj do të thoshte: në "Al Pazar". Filizi: O ç'na ka gjetë belaja me Teknefesin! Përmëtepër, edhe i skuqur me bojën komuniste e jo me atë të Çerçiz Topullit nëpër çajtoret e Bit-Pazarit: "Analisti politik", që rri dhe merret me arnime nateditë në Facebook, duke përkujtuar Klubin e dikurshëm të tullumbave.

Aja: Filizin e shtifsha me këto dy duar në dhe se, kohën e fundit më tradhton me Sidën.

Grua, e përdalë në Shtëpinë publike, që i marrosi gati të gjithë politikanët shqiptar nëpër instirucione. Natën vjen vonë në shtëpi. Ditën rruhet e pispiloset përpara pasqyrës. Pasmesnate, harrohet me orë në Facebook. Nuk e di çka do thotë nesër ideatori i emisionit humoristiko-satirik në "Baj Past", kur do ta shoh të dehur Teknefesin me çaj rusi duke folur vetmevete nëpër Bit-Pazar"?! E ai e pret në pusi, Rrapjanin me dy shtamba verë krah për krahu me Miken. Përçudi, Teknefesi që dje shtiheshte si "mik" i imi në kohën komuniste, poashtu edhe sot pa fije turpi më shtihet si "mik" me gjithë bagazhin komunist edhe më delë në Ditën e sotshme në dyluftim në fushën e mejdanit. Mjerani, që nuk e ka traditë e as ka "haber" nga përdorimi i armëve strategjike.

Aja ka të drejtë: Vërtetë, më në fund edhe unë u binda se, Filizi (Teknefesi) na tradhton me SIDËN. Dje teknefes në Klubin e tullumbave, sot "analist" Bit-pazari i stimuluar me çaj rusi në Facebook. Nesër, pritet të dalë si kandidat i mundshëm për deputet i ndonjë partie politike "kuqezi". Nuk është dëshira ime, është e popullit shqiptar. Arsyeja, të cilën nuk e luan as topi i Mic Sokolit, se: gjithë kolegët e tij të Klubit të tullumbave si prodhime serike të Fabrikës komuniste u morën me politikë shqiptare: themeluesë partie, ministra, ambasadorë, deputetë në Kuvend. Ose, administratorë nëpër

institucionet e Shtetit të "përbashkët". Pothuajse, popullit shqiptar i ka rënë murtaja dhe nuk ka personalitete. Vetëm dy-tre "miq" të mij sipas tyre të deklaruar në mjetet e informacionit (edhe ndonjë tjetri të arratisuri): Hoxhën e Allahut, Teknefesin dhe Këlyshin me zgjebe, i harruan rrugës për pak kohë me ndonjë post politik argati, përderisa u doli gjumi i langaçëve të Bit-Pazarit. Megjithatë, Teknefesi duhet të jetë i kënaqur si partizan lufte: Nëna Parti i dha vende pune. Fëmijët të mos i vdesin rrugëve për bukë. Budallai, do të thoni ju si të fundosur me vite nëpër kolltuke partiake: ti jua jep gishtin si gjysmanalafabetë, e ata ta kërkojnë dorën dhe krahun. Partia u jepë para me thasë, e ata i turren përmbrapa Lopës larme nëpër Bit-Pazar: Tambël, po Tambël. Mirë bre viça të palëpi, ne u japim bar livadhi pas Çuke, rrasni barkun e ju vazhdoni me ato parullat komunsite të koperativave bujqësore: Tambël, po tambël! Të parët vini nëpër Akademi përkujtimore për dëshmorët e luftës në Teatrin Shqiptar. Përmëkeq, t'ju shohim me kollare kuqezi në çetën tonë mes varreve me një tufë lule në dorë para kamerave televizive. Teknefesi me gotën e çajit rusit në dorë. E, të mos flasim në përurimin e librave të partizanëve të arratisur të partive politike. Punë e juaja është ajo se, a do të vini me autobusin urban në turneun turistik të Panirin librit në Tiranë, kur "patriotët"

tanë, që kanë "dëshirë t'i skuqi Teknefesi me bojën e Shokut Tito, nuk e vizitojnë Panairin e librit te pragu i derës, në mes të Shkupit historik, rrëzë Kalasë. I mjeri "patriot kuqezi", që e krahason veten me Çerçiz Topullin pa e shkrepur një fishek në Bit-Pazar, nuk e di se ka punë me fisin e kaçakëve, që në vend të bojës të lyen me baltë.

Qesharake, ë?! Pse veten e krahason me Çerçiz Topullin e jo me Kalin me shalë të Skënderbeut në mes të Bit-Pazarit?! Përmëtepër, me atë gomarin e tredhur të Haxhi Deputetit, që ta flugu një asht ta lëpish në kohën komuniste, dhe moti të ka nxjerrë të të shesë si plaçkë lufte komuniste. Vetëmse, tashti të ka pagëzuar me një emër të ri: Teknefesi. Herë të hipë Nastradini me 60 kg. mbi samarë e herë Nastardinica me 120 kg. mbi shpinë. Mirë, po kush ta jep ty atë të drejtë se, ndonjëherë në jetë nuk ka të drejtë edhe gomari i Haxhi Deputetit, të cilit sot nuk i delë zot Teknefesi që i ka dhënë shpërblim një banesë shtetërore?! Ose, e keqja nuk është e mirë. Pse, gjithmonë të jetë e mirë vetëm e mira?! E, jo edhe e keqja?! Kotnasikoti, e fajësojni ujkun në Abetare se e hanë qengjin e jo Viçin e palëpi. Ose, sipas juve teknefesëve: Edi Ramën. E, kurrë, nuk e kemi pyetur veten: Vallë, mos qengji plasi nga dëshira që ta hajë ujku?!

Kulminacioni: krahasimi mes Lirisë dhe Robërisë. Fatkeqësia, që të dyja janë gra azgane. Historikisht, pika më e dobët e shqiptarëve, shkak ky që edhe i duam marrëzisht, që të dyja t'i kemi në shtrat, nuk duam t'i ndajmë si motra të një nëne dhe Babe. Luftë, ndoshta nuk nisim për Atdheun, ama për gratë dalim në dyluftim. Tjetër punë është ajo se, gjithë jetën dalldisemi pas Lirisë, e në realitet vdesim për Robërinë. Nuse, të cilën na e sjellin me koçi "vëllezërit" e Njerkës dhe na e zbresin krushkat me dajre në lëmë.

Hë, në këto pyetje dua të më përgjigjeni si tru shqiptar! Punë tjetër është ajo se, përpiqeni të më ikni dhiareve pas Çuke. Jo. E keni kot, nuk keni shtigje matanë malit. Dhiaret u janë zënë me ferra. Rruga e vetme për të më ikur, ju ka mbetur ajo pranë xhamisë së Katundit. Vetëmse, mos harroni, aty ju ka vënë pusi Xhebrahili. Dhe, i vetmi burrë shqiptar para porte me shkopin me kërrabë Xha Deralla, që deri më sot e ka mashtruar me anekdota, i ka hyrë pas Çuke dhe i është futur tinëz në Xhehnet. Ju të tjerët e keni vështirë si "myslimanë ehamdurila", bythekrye do të përfundoni në Xhehnem.

Dexhalli, moti ju pri me trumbeta nëpër Bit – Pazar. Edhe, të gjithë besimtarët që dalin në rrugë, e përshëndesin me parulla "demokratike", brohoritje dhe duartrokitje, aty për aty e fitojnë nga një vulë në ballë. Ditën e Kiametit, pas

Përmbytjes Madhe delë Xhebrahili dhe ua sheh me radhë ballin nën flokë. Gjithë "myslimanët", të cilët i ka mashtruar Dexhalli me muzika dhe e kanë vulën në ballë, përfundojnë bythekrye në Xhehnem. Viçat e palëpi të sojit të Teknefesit, njëri pas tjetrit te Kasapi.

Xha Deralla nuk do të vijë me ju si "mëkatar" në Xhehnet, është vonuar nëpër pusi rrugës që i keni vënë ju si "patriot kuqezi" pas Çuke. Punë ka pasur me xhandarët e humbur të serbit duke i shëtitur gjithë natën nëpër Katund, rrethepërqark xhamisë me flamurin turko-arab, duke kërkuar flamurin shqiptar kuqezi në minare të Xhamisë shqiptare, t'i dërgojë te shtëpia e Plakut "miqtë". Edhe me Kolibaret, për punën e ujit për vaditjen e fushës: të cilët i ka "mashtruar" Plaku mjekërbardhë, që tre muaj verë ta kenë ata, e gjashtë muaj dimër cërvicasit. Përmëkeq, Hoxha mendon se: gjithmonë do të jetë verë, e çka do të bëni o të mjerë në Dimër?! Kur, siç thotë Ndre Mjedja: Fryn murlani me stuhi. Mëkot, do t'i luteni përpara këmbëve Xha Derallës për pak zjarr në Xhehnem, por plaku mjekrëbardhë do t'ju përgjigjet: Rrini, mërdhihuni në Xhehnet!

Dhe, përderisa Xha Deralla të arrijë me gunën e ogiçit krahëve në Xhehnem, Teknefesi më veç do ta ketë shuar zjarrin…

EDHE KY 28 NËNTOR NË MINARE PA FLAMURIN SHQIPTAR

Bërlloku shqiptar me shekuj na ngatërrohet nëpër këmbë, në Lëmë. Dhe, nuk na e sjellë Evropa e as Amerika, po pjella jonë pas porte. Trojeve tona kanë ecur me ushtri barbare pushtues të tërbuar me shekuj: Perandoria Osmane (pesëqind vjet me radhë) dhe ajo sllave që edhe sot e kësaj dite e kemi mbi shpinë. Gjakun e pastër shqiptar e kanë përzierë me vite lëmsh, na kanë futur në puti si kos e na kanë nxjerrë dhallë në mes të Odës miqve. Prandaj, sot edhe i kemi këto probleme të pazgjidhura kombëtare: Dikushi deklarohet turk, dikushi arab, dikushi serb, dikushi grek, dikushi bërllok… Dikushi, mushkë me prejardhje të livadheve: Kryqzimi i pelës me gomarin. Nuk ka rrezik nga kjo sëmundje moderne e shekullit me simptome Beogradi, që na e mbollën të huajtë në Lëmë te pragu i derës, rrëzë Çukës. Fara biologjike, patjetër një ditë do të të kthehet te rrënja. Kush si të dojë le të deklarohet në këtë Shtet të Ri të "pëbashkët", (përsëri që e mëkambim ne shqiptarët). Nuk prish punë: Shqiptarët i njeh historia, të tjerët i kanë bërë shtete nëpër botë, po jo ende Shqipërinë. Pak rëndësi ka nëse është

shqiptar, mjafton realiteti se si e ndjen veten sot Dudumi me një torbë taxhi përqafe në një shoqëri demokratike, që synon Evropën, dalë me gjithë bagazhin arsimor, kulturor e shkencor nëpër botë. Kush si të dojë le t'i përkasë cilësdo feje, n'dashtë me këmbët dhe trutë në legen, ndashtë me kryqin mbi shpinë, n'dashtë me palarenë në hava në mes të Bit-Pazarit. Shqiptarët, janë shqiptarë. Vetëm, nuk na ka hije si popull demokratik edhe ky 28 Nëntor të na gëdhijë në minare të xhamive me flamuj turko-arab. Përjashtim këtu bën një xhami shqiptare në katundin Llagje të Kërçovës, që nateditë valon flamuri kuqezi në minare të xhamisë. Ndoshta, edhe në ndonjë xhami tëjetër në Trojet shqiptare. Histori tjetër është ajo se, ende deri në Ditën e sotshme festive nuk e shpallëm Xhaminë Shqiptare. Koha është, Shqipërinë ta lënë të ecë me Natyrën rrugës për në Baba Tomor. Rreziku më i madh, sot shqiptarëve u vjen nga bërlloku vetë që me shekuj u ngatërrohet nëpër këmbë, që të huajt ua kanë mbjellë te pragu i derës: Pelë Troje pas porte. E, ne si popull shqiptar me traditë historike, edhe sot e kësaj dite nuk mund ta heqim qafe, hudhim me gjithë samarë bythekrye në përrua. Përmëtepër, ai bërllok shqiptar sot çon krye (shetë mend edhe me fotografi "artistike" debili) në Trojet Etnike Shqiptare.

Qesharake është sot, kur dëgjojmë se në Shqipëri na i sjellin plehërat e botës përparimtare. Shkatërrimin e armëve kimike të Sirisë, kur bërllokun e madh edhe më të rrezikshëm e kemi brenda në Shqipëri dhe Trojet Etnike shqiptare. Atdheun, nuk mund ta shkatrrojë as Evropa e as Amerika sot për sot mike, perveç vetë shqiptarëve me "Din e Iman". Nuk e them unë, e kanë thënë moti Rilindasët tanë me penë e pushkë shumë më herët, atëherë kur e bënin shtet Nënën Shqipëri para syve të sulltanëve e shpatave të turkut krah për krahu me Serbinë. Tjetër punë është ajo se, në Konferencën e Londrës, Evropa na i futi gërshërët pa dëshirën tonë na qepi struke. Kohë, kur Serbia me dhunë shqiptarët si "turq ehamdurila" i shpërnguli në Turqi. Politikë asimiluese shekullore e konjukturave shtetërore të Beogradit e Shkupit. Fatkeqësisht, rol argati në atë kohë për ta bindur popullin shqiptar t'i lëshojë Trojet Etnike Shqiptare, luajtën edhe hoxhallarët. Misionarë fetarë, me maskë mysliamane e veprime antishqiptare në shrbim të Turqisë. Pak veta ishin ata që në atë kohë i dolën zot popullit shqiptar duke e bindur të mos i braktisin vatrat e të parëve. Vërtetë, numëroheshin në gishta. Falë kësaj "pakice të popullatës turke", Erdogani në librin e tij propagandistik, shqiptarët në trojet e tyre etnike i quan shqiptarët si "mbeturina të Turqisë". Jo rastësisht, në prezencën e

"vëllezërve" edhe në Prizren (Qytetin historik i shqiptarëve), trumbetoi se: Kosova është Turqi. Deklaratë teknefese qëllimkeqe si "mik i vëllezërve", të cilën më vonë me reagimin e shqiptarëve, e tërhoqi gjoja paska qenë gabim i përkthyesit. Unë, sot vetëm çuditem: sesi ky popull edhe sot e kësaj dite ende nuk e di se armiku më i madh i Shqipërisë, janë vetë shqiptarët me "Din e Iman" si në kohën e Turqisë.

Shqipërisë, Natyra ose Zoti, thuani ju si të doni ia ka dhënë të gjitha të mirat me lumenj, liqene, det, fusha e male mbi kokë. Shtet historik, që brenda një stine mund të ketë dy sezona turistike: edhe turizmin veror edhe atë dimëror. Vendlindje e Xha Naimit, ku mund të lulëzojë bujqësia dhe blegtoria. Qengji me zile, ku e lenë Kopenë. Edhe industria më moderne. Frikë kam se, Natyra (ju thuani Zoti) mes gjithë këtyre mrekullirave deri në Ditën e sotshme Shqipërisë, nuk ia ka dhënë politikanët e Ditës së Nesërme. Përsëri, dhashtë Zoti: unë qofsha gabim! Megjithatë, qetë nuk e tërheqin pllugun siç duhet në arë, ose qerren e ngarkuar me bar rrugës për në Baba Tomor. Rrotat e qerres si shpesh po na thyhen rrugës mes maleve. Nuse tjetër na fusin në koçi. Fushën, përditë e më tepër na e mbulojnë ferrat. Bujku i mirë, këtë e heton me kohë, dhe kaun që e tërheq vallain të dalë nga vija e ugarit,

e qetë ta shesë në Pazar. Çuditem me popullin shqiptar, pse deri më sot nuk e nxorri ta shesë në Pazar një politikan shqiptar?! Gjithmonë i shanë kur me votën e tyre vijnë në pushtet. Përsëri, në zgjedhjet e ardhshme ua jep votën "demokratike" po atyre individëve?! Njëzetë vjet me radhë në politikën shqiptare rrotullohen po të njëtët politkanë. Rrezik për një popull me traditë historike! Athua, populli shqiptar, nuk ka fytyra të reja si dikur t'u prinë punëve me pushkë e penë?! Jo, ka edhe më shumë se dje në Robëri. Edhe, kurrë s'ka pasur më shumë se në Ditën e sotshme. Vetëmse, shqiptarët sot duhet të çlirohen nga Vetëvetja. Thënja e dikurshme italiane për shqiptarët: *Tuto albanezi, tuto komandanti*. Hë për hë, të pushojnë të shpallin heronj e dëshmorë lufte familjarët, partizanë të partive politike! Ngjarjet historike t'ia lënë historisë. Problemi kryesor me të cilën do të merren në të ardhmen historianët. Shkaku se, u bëmë gazi i botës: mbetëm gjithë jetën nëpër varre duke shpallur heronj dhe dëshmorë lufte edhe spiunë me qerre, ende pa Shtet Etnik Shqiptar. Përçudi, ende nuk kemi ndryshime në politikën shqiptare. Kalibrin e politikanit parashikues të nivelit të Rilindasëve. Historia, si për inatë po na përsëritet me shekuj në këto troje të mallkuara nga turku (Baba Dovleti).

Vallë, mos diçka edhe në Ditën e sotshme nuk ecë rrugës siç duhet me popullin shqiptar. Burrat shqiptar, që popujt tjerë i bënë shtete me histori, u dhanë fuqi mbretërore: Skënderbeu si strateg lufte ta udhëheqi luftën. Ataturku, Turqinë fanatike e bëri shtet modern, Sami Frashëri u dhuroi turqëve gjuhë letrare. Sirinë e bëmë me Universitet. Vaso Pashë Shkodrani me shokë shkoi deri në Egjipt. Dijetari, që na atë kohë nga zemra e plasur, tha: ***Feja e shqiptarit, është shqiptaria***. Pyes veten sot, kush e ka fajin: politkanët apo shqiptarët si popull historik. Përsëri, vetë përgjijem mes këtyre rreshtave: edhe politikanët, edhe populli shqiptar që para fushatave zgjedhore e kanë gojën plotë "fitore", e pas numërimit të votave kuti për kuti "demokratike", përsëri kanë rënë në gropën e vetë të mbuluar me kashtë para syve të botës përparimtare.

Koha është, sot shqiptarët t'i lënë interesat personale e familjare, të ulen këmbëkryq si vëllezër të një nëne e babe në një sofër. Fetë t'i lënë anësh si prodhime propagandistike të asaj kohe në emër të Zotit. Mishin e egër ta hudhin nga trupi. Kancerin, që përditë tinëz na e pi gjakun dhe hanë trupin. Anësh t'i lënë inatet, euforinë dhe vrapimin e argatit pas posteve politike dhe pasurisë pa pushtet. Rreziku, nateditë me këmbën me miell na troket te porta. Unë, jam

nëna juaj, hapmani edha derën! Kësulkuqe më nuk kemi për "mikun historik", e as edha për Armikun pas porte. Patjetër, diç duhet të ndryshojë në politikën shqiptare: Ose, politikanët… Ose, populli…

Nuk e kam fjalën për disa "analistë" teknefesë me të cilët gjatë rrugës për në Baba Tomor kam humbur mjaftë kohë në mjetet e informacionit, që natëditë rrinë si papagallët në kafaz me këmbët dhe trutë në legen… Përmëtepër, t'i bind se muri është i bardhë. Humbje kohe: Muri është i zi. Përsëri, e pyes veten: Hë, a jeni tashti të lumtur?! Bërlloku shqiptar, që vazhdon të merret me arnime nga

gazetat sllave arnë përmbi arnë të brekëve tyre mbi pantollona, prapë të na qepi struke. I shkreti, që e rren mendja se: Atdheu bëhet me theshetheme e jo me punë. Komente anonime më shkruan poshtë shkrimeve të mia, kur e gjenë veten këmbekokë me këmbët dhe trutë në legen e bythët në hava para syve të Diellit. Dudumi, nuk merret me shkrimin e publikuar në mjetet e informacionit, po me kësulën time dhe rakinë. "Armikun e pabesë", pse nuk është çaj rusi ta ngrejë si unë dolli në Bit-Pazar?! Pëllasin e vjellin urrejtje nateditë përmes altoparlantëve të Shejtanit edhe në YooTube me vazhdimin e përçarjes të popullit shqiptar si në Kohën e Turqisë dhe Serbisë, që nuk i ka hije e shkon përshtati në Ditën e sotshme as Kur'anit e Muhamedit a. s., Librit të Allahut.

Nuk merren me fenomenin e përçuditshëm, që na është ulur me barkun plot si thes deri në fyt te pragu i derës, e rrezikon shoqërinë shqiptare, po u dalin zot bashibozukëve me çallma turku, të cilët me shekuj na ngatërrohen nëpër këmbë si popull shqiptar. Fjalë dhe vetëm fjalë. Natën i luten Azreti Muhamedit a. s me çallmën e turkut në kokë e ditën me shajkaçë serbi i rrëfehen Krishtit.

Rreziku: Mushka pëllet pas porte. Edhe ky 28 Nëntor, në Ditën e sotshme na gdhiu në minare të xhamive pa flamurin kuqezi shqiptar…

DITË ZIE PËR GOMARIN E HAXHI RRENCIT

E di se, përsëritem nëpër shkrimet e mia, po edhe unë nuk kam gjithaq faj. Shqiptarëve, u përsëritet me shekuj historia. Shkak ky, që edhe mua ndodhë të më përsëriten shkrimet publicistike letrare. Lexuesve të mi besnik, u kërkoj falje, e përsa u përket dudumëve, nuk e lodh fare as Kryengritësin, i cili e vazhdon luftën nëpër beteja të përgjakshme. Ende, nuk i ka dorëzuar armët e luftës. Fare pak merrem me shkarravinat e dudumëve me "Din e Iman" duke m'u kërcnuar se do të më varin "hajmali" përqafe, të mi përzënë xhindet, që edhe sot e kësaj dite më hudhin dorë më dorë majë lisave. Ose, me pëllitjet e tyre "profetike" plotë mallkime e diagnozë mjeksore "shkencore" në YooTube si "antimysliman". "Armik" të Fesë Islame. Etiketime e shpifje plot sharje të Shejtanarapëve me këmbët dhe trutë në legen.

Aspak, shkrimet e mia nuk kanë të bëjnë me antimyslimanizmin e as Fenë Islame, po me dudumët që nateditë i ngatërrohen nëpër këmbë popullit shqiptar duke u thirrur në myslimanizëm dhe Fe Islame, e në anën tjetër janë në shërbim të Dexhallit me trumbeta nëpër Bit-Pazar.

Interesant, ne siç duket mendojmë dhe gjykojmë me kokë të huaj në qafë, ose nën sjetulla: I festojmë humbjet historike. Vështirë e kam ta them në këtë shkrim, përplas në fytyrë kundërshtarëve historik: Fatkeqsisht, jemi popull i dalldisur pas "fitoreve" të posteve politike dhe përfitimeve materiale në emër të popullit shqiptar. E kam thënë edhe me herët: jemi bërë edhe me zi se serbët. Komandantët e Luftës të UÇK -ës i fusim në një thes, i shpallim "hajdutë", edhe nga kush: Trimat pas lufte. Profiterët e luftës, që pas ndryshimeve politike u turrën me të katra pas qeveritarëve, posteve politike duke rrëmbyer nga një asht për pjestarët e "familjes revolucionare" në Qeveri. "Patriotët", që në çdo sistem politik i kemi krah për krahu të parët në vrapime maratonike pas posteve politike dhe përfitimimeve të mjeteve materiale. Hajdutët e fondacioneve botërore si udhëheqës të shoqatave joqeveritare në kohë lufte, që në emër të fëmijëve të Kosovës gjatë Luftës (1999) në IRJ të Maqedonisë, grabitën shuma marramendëse për botimin e librave për fëmijë, dhjetë tituj me një tirazh prej dhjetë mijë kopjeve për secilin libër. Para me të cilat, blenë banesa e ndërtuan "Kulla" nëpër vende turistike. Haramët e sotshëm, që sot marrin guximin t'i sulmojnë të tjerët për hajdutllëk, pa e marrë veten si shembull unikat në shoqërinë shqiptare. Debilët, harrojnë se po t'i

kishin botuar ato libra për fëmijët shqiptar, sot shkollarët tanë nuk do të kishin vende të ulen as në karrige nga librat "e tyre" nëpër shkolla e biblioteka. Përmëtepër, askushi, deri më sot nuk pyeti se ku shkuan gjithë ato para dhe ai "tirazh" marramendës i librave për fëmijë?! Kulminacioni hajnisë në nivel "humanitar", me gjithë këta përgjegjës dhe të punësuar në Minsitrinë e Arsimit, njeri i gjallë deri më sot nuk e ngriti zërin, pyes kordinatorët e projektit me emër e mbiemër të mirënjohur për opinionin shqiptar, çka u bë me fatin e atyre librave të "përzgjedhur" nga hajdutët "artistik" për fëmijë?! Nuk flasim këtu për listën e shkrimtarëve të përfaqsuar në "projektin humanitar" e as për kriteret artistike të "patriotëve" shqiptar, honaret e shkrimtarëve të gjallë e të vdekur, që nuk morën asnjë lek shpërblim si autorë të librave.

Komandantët, kur i panë Trimat pas lufte se, çfarë malli janë (made in Jugosllavia) me kokën në grazhd e bythën te "vëllezërit" për hajni, i përzunë me gjithë djemtë dhe vajzat e tyre nga vendet e pamerituara të punës brenda një nate, ashtu edhe siç i fituan ato vende pune brenda një dite. Zemërimi me "mikun" e tij "Abazin" e maleve, tashti kohën e fundit e arriti kulminacionin. Pushtetin e luftës në kohë paqe "Abazit", po ia rrëmben Ali Ahmeti i fushës. Gurë e dru pas komandantëve të UÇK -ës.

Burrave të pushkës e penës, që vërtetë aqsa mundën dhe patën fuqi bënë ndryshime politike në Kosovë, IRJ të Maqedonisë dhe Luginën e Preshevës, që sot Askushi mori guximin t'i shpallë "hajdutë" të popullit shqiptar. Populli thotë: hajduti, të shpallë hajdut. Përçudi, seç ma kujtojnë anekdotën e dy vëllezërve të verbër që hanin së bashku petulla me kos në një sofër të Katundit. Vëllai i thotë vëllait: pse ti hanë nga dy petulla e unë mezi e rrëmbejë një petull? Vëllai Madh, i përgjigjet: jo, o burrë unë ha gjithë kohën vetëm nga një petull. Vetëm, çuditem me pyetjen tënde teknefese: ne, që të dy jemi të verbër, nga ti e sheh dhe e ke atë bindje se unë ha nga dy petulla. Shkaku se, unë i ha nga dy petulla, i përgjigjet vëllai Vogël plot gojën me dy petulla të tjera në dorë.

Patriotët e vonuar me prejardhje të dyshimtë jugosllave, që janë plot gojën për "ndryshime demokratike", plasën edhe në Ditën e sotshme si në kohën e ish Jugosllavisë të dalin me ndonjë Parti të Re Politike t'u prinë shqiptarëve për Liri. Arsyeja, ku ta di unë si shkrimtar: Vite me radhë kemi jetuar me "vëllezërit" e Njerkës në një Shtëpi pa çati mbi kokë. Edhe, kemi dhënë e kemi marrë nuse. E di, ju do të më akuzoni, se: nuk jam për "Ndryshime politike". Gabim i madh, moti jam për ndryshime në politikën shqiptare, po jo me bagazhin politik të këtyre trusakatëve të

arratisur nëpër parti politike që e kanë shitur dhe e shesin nëpër Bit-Pazar njëzetë vjet me radhë me pare e pa pare popullin shqiptar. Fatkeqësisht, populli shqiptar ende nuk ka vetëdije të lartë kombëtare për ndryshime politike, i zbret nga samari Nastardini me 60 kg., i hipë Nastardinica me 120 kg. mbi shpinë si "haxhuxhe e patuxhexheve" të Zajazit me ferexhenë krahëve.

Faji?! Fajin duhet kërkuar te Torba e taxhisë përqafe, përsëri si puna e jorganit të Nastradin Hoxhës. Nuk do t'ua përsërisë anekdotën në këtë shkrim parashikues për Nesër, besoj se e dini dhe nuk keni nevojë. Vetëm fjalinë e fundit: E gjithë puna kishte qenë për jorganin tim të ma vjedhin hajdutët. Qëllimi ishte t'ua përkujtoj se, disa individë me torbën e taxhisë përqafe, në Ditën e sotshme flasin jerm përpara pasqyrës: Pasqyrë, pasqyrë kush është më i bukuri mbi këtë botë? Pasqyra u përgjigjet: Ali Ahmeti. Njerka, menjëherë ia ndërsen Kopilin e lënë pas porte. Patrioti i vonuar pret t'i përgjigjet pasqyra: "Abazi". Përçudi, dudumët edhe sot, e kërkojnë me këmbëngulje atë torbë taxhi përqafe. Xhindihallët, që harrojnë se Shekull tjetër jemi sot, prandaj edhe duhet tjetër tru në arenën politike. Mjaftë më derdhëm lotë nëpër varre e mjetet e informacionit! Mjaftë më humbjet i shpallëm fitore. Mjaftë më shpallëm vend e pavend kotnasikoti Ditë Zie për Gomarin e Haxhi

Rrencit, që sipas Mark Krasniqit cofi rrugës ende pa mbërri në Kaçanik! Në vend që të shpallim Ditë zie për Xha Derallën dhe këngën e tij antologjike që e këndoi deri në vdekje: ***Turqia e ka shitur këtë Rumeli/ e ka blerë ç'aj Moskovi Zi/ me shtatë alltan xhemi***. Flamujt t'i ulim në gjysmështizë nëpër institucionet e Shtetit të "pëbashkët". Përgëzojmë Plakun e urtë, që i shëtiti xhandarët e Serbisë gjithë natën nëpër Katund. Kurrë, nuk i besoi Hoxhës, por sa herë që ai i kërcnohej me zjarrin e Xhehnemit i përgjigjej: Përderisa, unë të vij në Xhehnem, ti më veç do ta kesh shuar zjarrin. Pastaj, ti o hoxhë mendon se gjithmonë do të jetë verë, po çka do të bësh në dimër?! Mëkot do të vish të më kërkosh pak zjarr në mes të Dimërit, nuk do të të jap: rri mërdhihu në Xhehnet, do të të përgjigjem. Pse jo, t'i ndërtojmë edhe një përmendore madhështore te "Ureja", para portës së Xha Mazllëmit! Dihet, kur shpallen dhe në cilat raste Ditët e Zisë. Edhe, atë: për personalitete të dëshmuara të politikës kombëtare dhe kulturës shqiptare. Përmëkeq, jemi bërë për të qeshur e qarë, siç thotë populli me gra Zajazi: Gjithë jetën mbetëm duke festuar "fitore" dhe shpallur "Ditë zie" edhe nëpër katunde. Dhimbje kombëtare, për të cilët nuk i kemi shpallë deri më sot për shumë personalitete të dëshmuar me emër e mbiemër të politikës, arsimit dhe kulturës shqiptare.

O burrani, mjaftë më i patë të tjerët dhe i morët "yrnek" në vek të drurit anët negative (sipas jush armiqëve). Përvishuni mëngët dhe futjuni punës! Atdheu nuk bëhet me varreza kolektive, përmendore mbi gomarë, lotë dhe Ditë Zie. Po, me punë, tru dhe djersë rrëke mbi ballë në fushën e betejave politike nëpër Evropë e botë. Diplomaci shqiptare të cilën e kemi pasur edhe në kohën e Turqisë. Euforia kolektive, është rrezik për një popull që gërhet ne gjumë për Liri! Vallë, nuk e shihni se me vite mbetët nëpër varre dhe emisione të kota "debative" se të tjerët ua kanë fajin, e asnjë ditë në punë nëpër fabrika e "koperativa bujqësore". Dorën në zemër, do të pajtohesha me ju, por sikur Uji i rremës të rridhte pa pengesa pranë Shtëpisë së dajallarëve te Mulliri i Arapit. Fatkeqsisht, në Ditën e sotshme ne nuk kemi miell në hambar as për bukë. Maxhatorja nuk ka me çka ta gatuaj brumin, bukën për në çerep dhe strehojë në maxhe për familjen. Moti kohë nuk e kemi vënë kapakun e maxhes mbi kokë, fërkojmë barkun me dorë nga gëzimi, rrëmbejmë nga një copë buke misëri dhe turremi livadheve me pushkë shelgu. Euforia koletkive nuk shtrohet në sofër para miqëve me shkrime patetike politike. Shkaku se, nuk kemi bukë e kripë në sofër, sipas traditës shqiptare.

Përçudi, ende si nuk mbushemi mend si popull historik?! Kokës t'i biem me të dyja duart

me grushta: O burrani, ndaluni para portës Kalasë Shkupit! E dini pse, nuk hyhet brenda me "bismilahim e rrahim" me çallmën e turkut në kokë, e as me eufori patriotike, po me punë atdhetare brez pas brezi nëpër shekuj. Ende në Kalanë e Shkupit nuk ka hipur Skënderbeu me kalë me shalë, e ju para tij doni ta hipni Flamurin kuqezi Shqiptar me Shqiponjën dykrenare. Pala tjetër kundërshtare politike ju provokon me përmendoren e Car Dushanit në Shkup (pushtuesit të trojeve shqiptare), në kuadër të projektit "Shkupi 2014" në sheshish e kryeqytetit, që ju turrevrap t'i kërkoni përmendoret e Sulltanëve të Turqisë. Në vend, që sot t'i shpallni luftë librit në Bibliotekë. Mësimeve në shkollë. Studimeve në Universitet. Gabim i madh historik. Zemër ju dhanë patriotët e vonuar, populli thotë: para pampurrit një ditë përpara kalorës të arratisur: Malli i kishte marrë të fotografohen para kamerave televizive nga Shqipëria, Kosova e IRJ e Maqedonisë edhe në Shkup. Problemi kryesor, siapas të arratisurve: Çamëria. I ndreqëm punët me Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Luginën e Preshevës. Tashti, problem historik na ka mbetur sipas tyre, vetëm Çamëria?!

Interesant, gjithmonë kur shqiptarët do të jenë në hap me kohën, do të gjenden kalorës të arratisur t'ju ngatërrohen nëpër këmbë. Fatkeqësisht, edhe ndonjë tullumbaxhi në rolin e

Sanço Panços mbi gomar. Trusakatë, që vetëm para kamerave televizive shpallin Shqipëri Etnike. E, në anën tjetër gjithë jetën janë deklaruar si jugosllavë, familjarisht brez pas brezi kanë punuar kundër interesave historike shiqptare. Tashti, u doli gjumi si patriotë të vonuar me vite "shqiptarë": "Komandantët e UÇK -së, janë hajdutë". Amani, na jepni si kalorës të arratisur çka të doni ju si kunguj stambolli: përralla arabe, theshetheme politiko-fetare, punë të koperativave bujqësore në Katund, por jo edhe tru Gomari. Shkaku se, trurit tuaj deri më sot ia kemi parë dhe shohim ende sherrin në jetën politike për Shqipëri Etnike.

Përgëzime, Ali Ahmetit me shokë! Vërtetë, sot i ka hije të festojë fitore historike! Pasardhësit të kaçakëve të Zajazit, që e solli edhe në këto troje pas Skënderbeut në Shkup edhe Nënën Shqiptare, në Zajaz. Hije i kishte edhe "xhemati" në figurë madhështore shqiponje, simboli i flamurit kuqezi kombëtar. Edhe, kaçakët e Zajazit me kësula të bardha që zbritnin nga mali, kësaj radhe me armët në brez, ose pa armë fare. Unë, do të doja si shkrimtar, t'i shoh me armët në dorë. Trimit kija inatin, ama mos ia ha hakun, jepja dorën. Përmëtepër, atij burri që përsëgjalli i lanë borxhet ndaj vendlindjes. Vërtetë, përpiqet të bëjë ndryshime në politikën shqiptare. Edhe atë, në mesin e shqiptarëve të përçarë si Kashta e

Kumbarës, që historikisht shumë burra mejdani kanë pasur dhe kanë probleme t'i bëjnë bashkë si popull shqiptar. Që, në këtë përvjetor historik i bëri kokë më kokë para këmbëve të Nënës Shqiptare edhe krerët e Bashkësisë të Fesë Islame. Punë tjetër është ajo se, këta myslimanë me "Din e Iman", a do të vazhdojnë edhe në të ardhmen të luten me këmbët dhe trutë në legen para këmbëbeve të Kalit, apo Skënderbeut me shpatën në brez. Nesër, ndoshta prijësit fetarë flamurin kombëtar shqiptar do ta hipin edhe në minare. Dhashtë Zoti, përkrah Nënës Shqiptare e gjejnë rehatinë edhe Kalosh Zajazi me shumë burra pushke e gra shqiptare në vendet e tyre të luftës flakë më flakë me armikun shekullor. Vetëm, jo edhe këto personalitete të dëshmuara historike, po edhe shumë të tjera që ranë në fushën e betejes te pragu i derës anembanë Atdheut. Theshetheme janë ato të "ushtarëve" të UÇK -ës se kanë mbetur projektet e papërfunduara në Kumanovë e Tetovë. Vallë, kush ua ka lidhur duart si shqiptarë, përvishnjuni punës! Apo, pritni Ali Ahmeti të ju vizitojë shtëpi për shtëpi me thesin me miell në krah, t'ua ushqejë edhe fëmijët?! Vërtetë, Zajazit më shumë hije do t'i kishte kaçaku i maleve, Kalosh Zajazi mbi kalë të bardhë me shokë, që luftoi krah për krahu me Bajram Currin, sesa Nëna Shqiptare pa Babain Shqiptar në Zajaz me mauzerrin krahut.

Pastaj, kërçovarëve hije do t'ju kishte kësaj radhe në këtë Njëqindenjëvjetor të pavarësisë së Shqipërisë ta kthejnë në vendin e tij të dikurshëm historik, në Kalanë e Kërçovës: Permendoren e Skënderbeut të harruar e varrosur me vite diku në podrumet e Kalasë.

Historia shkruhet me gjak, e jo me një torbë taxhi argati përqafe nëpër insitucionet e

pushtuesve historik antishqiptar. Edhe, atë: duke shitur mend pa i nxjerrë fare në Pazar si plaçka lufte. Gjithëçka mund të bleni me para, po jo edhe mend në kokë. Shkaku se, deri më sot askushi nuk i ka nxjerrë t'i shesë në Bit-Pazar. Përndryshe, po të shiteshin në Bit-Pazar mendtë, shumë "analistë" e "politikanë" do t'i blenin me pare. Arsyetosh veten me komente teknefese se, nuk e ke mizën në kësulë. Punemadhe. O Imzot, po kush merret me komentet e juaja "kodër pas bregut", kur hiç pa i lexuar nga titulli, i di se çfarë "malli" jeni për analiza politike. Moti jua kemi lexuar mendtë dhe ua kemi parë fytyrën e vërtetë "patriotike" në veprime. Zoti ju ndihmoftë! Populli shqiptar, nuk e di a do të ketë kohë një grusht dhe nesër t'ju fluk mbi varr. Edhe kjo, nuk ka gjithaq rëndësi në Ditën e sotshme, ka halle edhe më të mëdha mbi kokë me shekuj. Dorën në zemër, historinë e shkruan vetë populli shqiptar.

Gomarit të Haxhi Rrencit, sot për sot nuk i kërkojmë tru, po samar dhe mund t'i japim dru për inatin me të katra këmbët e rrasura deri në bark në mes të batakut…

III DOLLI FESTIVE ME "TË DËRGUARIN E SHEJTANIT" NË SHKUP

QERRJA E DIELLIT IKU NË QIELL

Ikja e papritur nga mesi ynë letrar e poetit, shkrimtarit dhe studjeuesit të letërsisë Abdullah Konushevci (1958 - 2013), vërtetë është një humbje e madhe për familjen dhe Letërsinë Shqiptare. Poeti ishte një zë i lindur kryengritës në jetë dhe letërsi. Përçudi, edhe Zonja Vdekje siç duket i do këta burra të penës, që përditë na ikin në heshtje para syve.

Inati të vjen dhe do të plasësh nga pabesia, pse nuk i do burrat e reklamave para kamerave televizive, që gjithë jetën na ngatërrohen nëpër këmbë si popull. Pajtohem me thënjen e popullit, se: Edhe Zoti e bënë përzgjedhjen e miqve, nuk i do njerëzit e rrasur këmbekrye në mëkate, nuk do të ketë probleme në Mbretërinë e tij Qiellore.

Mirë, ta marrë deri diku se edhe unë pajtohem me këto ligje dhe veprime të Zotit ose Naryrës. Atëherë, pse kërkojnë përgjegjësi nga ne si besimtarë të poezisë deri në vdekje?! Tjetër punë është me politikanët, që siç duket më së tepërmi i kanë përqejfi: ua kanë dhënë pushtetin

dhe pasurinë, por jo edhe trurin në kokë. Ende vazhdojnë të na kërcnohen përmes misionarëve të tyre politik e fetar me Xhehnet dhe Xhehnem (Parajsë dhe Ferr). Vallë, a nuk do të ishte më mirë, Zoti politikanëve le t'ua japë pushtetin dhe pasurinë! Edhe, Xhehnetin! Falë u qoftë, edhe në këtë jetë, edhe në atë jetë! Vetëm, kurrë le të mos e mashtrojnë veten të na trokasin nesër te dera e Xhehnemit për ndihmë, nuk do t'u japim zjarr për Dimër. E kemi amanet dhe porosi nga plaku i urtë Xha Deralla. Burrë, që e ka pritur krahapur në vendlindje me shokë edhe poetin e Qerres së diellit, Abdullah Konushevcin me vargjet parashikuese:

Jam lodhur duke pritur
Zonja Mëmë
T'i nisësh shërbëtorët e Tu
(Dhe unë shërbëtor Yti jam)
Të m'i këputin hekurat

Jam bërë një ashtlëkurënajë
E ka rëndë
Dhe toka të më mbajë
Ku ta këput kokën
Mbështetur për muri

Ti Zonja Mëmë
Mos resht të m'i ledhatosh shpresat

Po mbahem për një fije floku
I bindur se është floku Yt i thinjur…

Miku i penës nëpër shkrimet e tia e la këtë porosi: … *Po mbahem për një fije floku/ I bindur se është floku Yt i thinjur*, ama armët (penën) pas mejdanit të m'i varni në një degë lisi. Amaneti është amanet, nuk mirret me vete në varr, po u lihet i lirë mbi tokë në sipërfaqe miqve të poetit. Zëri kryengritës t'i dëgjohet pas shtatë fushave e maleve në bibliotekë, shkolla e Universite. Dita e Nesërme do të vendosë se, kush do të hyjë në varr e kush do të arratiset në Qiell. Ligje të Natyrës janë këto, që vëshirë i realizon sot për sot edhe Zoti. O burrë, ky është fati ynë i artistëve: Nuk mund të dalim nga kjo lëkurë e qengjit, shkaku se, nuk kemi lekurë tjetër "artistike" derri.

Gëzohu miku im poet, që të ka marrë në mbrojtje dora e Zotit, e jo Dora e zezë kriminele. Përmëtepër, që nuk të kanë gjetur si kërcu në makinë lukzose me ndonjë dashnore ose disa kartele bankare me shuma marramendëse, në banka komerciale. E as, në ndonjë post politik! Përmëtepër, anëtar i tre Akademive të Shkencave me tre pensione të shteteve jugosllave e shqiptare.

Amaneti im, o mik është i një tjetër natyre shqiptare: Edhe, unë e di se nesër do të "cofë" edhe më zi se ti, si qen pas porte. Askushin nuk e pres në varrim, të më sjellë kurora të luleve rrëzë

Çukës. Telegrame ngushëllimi nga kryeministra, ministra e politikanë të arratisur nëpër kabinete të Qeverisë. Përveç, familjes sime të ngushtë dhe cucave kërçovare me dajre, këngë e valle shqiptare duke më përcjellur në varr, nuk dua të shoh me sy e dëgjoj me veshë, asnjë njeri tjetër të sojit të dudumëve mbi kokë duke derdhur lotë krokodili me fjalime të gjata patetike!

Aspak, nuk ka qenë dhe është e lehtë lufta me penë. E sidomos në kohën kur jetoi e veproi miku im, poeti Abdullah Konushevci. Autori i ***Qerres së Diellit***. Vargut që na trokiste nateditë mbi kokë, Shtëpi e Bibliotekë. Nuk ishte varg i Zogut Keq, e as Qyqes që e kërkonte të Vëllain lis më lis, po Bilbili i Ndre Mjedës. Paralajmërusit të Ditës së Nesërme: *A thue po kjan, se çerdhen/ Ta ka shkatrrue skyfteri?/ A thue po kjan, o i mjeri,\ Se me rrnue gjallë s'ke mel?*

Atdheu është Shtëpia e përjetshme e burrave dhe grave të Shqipërisë. Përsëgjalli, nuk e shiti veten me poste politike e as me pasuri, po i hapi krahët e Shqiponjës, flututoi si burrat në Qiell, jo nga minarja e xhamisë si Azreti Isai, po si Abdullah Konushevci nga Biblioteka Universitare e Prishtinës. Shpirti tij, i pastër dhe kryengritës prej poeti ende do të vazhdojë të bëjë dritë në Qiell.

O burra: Është vetë, ***Qerrja e Diellit,*** që iku papritmas në Qiell…

Abdullah Konushevci

CAR DUSHANI NË SHKUP U NGRITË LUGAT

Popull i çuditshëm jemi ne shqiptarët. Gjithë jetën kemi berë luftë, herë me Krajl e herë me Mbret. Ose, siç thotë këngëtari popullor: Për çdo vjet e kemi nisur nga një luftë. Shpërblimi pas "fitoreve": Robëria. Tjetër punë është ajo se, i kemi bërë shtete dhe mbajtur gjallë si popuj të tjerët "vëllezërit", po jo edhe veten si popull më i vjetër i Ballkanit. Derën çdo pushtuesi ia kemi hapur krah më krah, e kemi mbajtur në Shtëpi me bukë e kripë, po edhe e kemi ditur ta përzëmë nga Oborri Shtëpisë me pushkë. Interesant, vetëm gjurmët e tyre edhe sot e kësaj dite nuk mund t'i heqim qafe nga Shtëpia. Shpirtërat e tyre të vdekur, natën edhe në Ditën e sotshme na çohen lugetër.

Lugetër për çdo natë kemi pasur edhe në kohën e Serbisë, Turqisë, Gjermanisë dhe Jugosllavisë. Pasmesnate, kur gati të gjithë bienim në gjumë, Lugati me një këmishë të bardhë deri në fund të këmbëve, e hapte derën e madhe dhe na hynte në Shtëpi. Gjithë natën e gjatë rrokulliste kusia nëpër dhomë. Shpeshëherë ndodhte të na i thyente vorbat, shtambat dhe

ibrikët me ujë. Ndonjëherë, kur zemroheshte edhe na i hudhte për dritare.

Të nesërmen, kur zgjoheshim lëmsh e gjenim Shtëpinë. Lugati për gjithë natën e kishte bërë të veten si mysafir i paftuar, na e hante edhe tinarin me tëlyen, që mezi e mbëlidhnim gjatë verës. Natë për natë e vizitonte edhe Gruan e tij vejushkë. Fjala merrte dhenë: Lugati sonte pas një drite - vetëtëtimë mbi Çukë, e kishte kaluar

natën me gruan e tij legjitime të dashur. Punë tjetër ishte ajo, kur Lugati pillte edhe fëmijë me vejushkën në atë Shtëpi. Pasardhës, që ta vzhdojnë punën e tij "humanitare" nëpër Katund. Plakat gojëliga, ende pa lindur dielli e tirnin dhe e tirnin si shtëllungë leshi në furkë ngjarjen. Një Zot e di se, çka bënin me bosht, doreza ose çorapë me një shtizë.

Matanë gardhit, Nuset me pashterka të kuqe u bienin dajreve. Lugatin me këngë e valle e thirnin në Shtëpi. Edhe këtyre si vejushkës, t'u bënte fëmijë. Burra të pushkës e parmendës. Arat t'i lërojnë me pllug. Bukë të kemi për Dimër.

Shkak kryesor ky, që ne shqiptarët edhe sot e kësaj dite kemi punë me Lugatin. Probleme gjaku, them unë si shkrimtar. Gjithë jetën kemi jetuar me pushtuesit në një Shtëpi. Dhe, aspak nuk duhet të na vijë çudi, që sot na u ngritë Lugat edhe Car Dushani. Askushi nuk e di se kush e solli dhe na e vëndosi mbi urë para Vitit të Ri. Qyteti i Shkupit deklarohet: "Ne nuk kemi kompetenca për të vendosur përmendore". Komuna Qender, Poashtu plot gojën. Ministria e Kulturës, ne nuk i kemi ato mundësi që brenda natës ta sjellim Car Dushanin në Shkup. Minsitria e punëve të brendshme, ne nuk kemi dijeni se kush e solli Car Dushanin në Shkup. Partitë politike maqedonase, edhe ne nuk dimë asgjë për Car Dushanin, nuk është vepër e jona politike.

"Patriotët" e Shkupit shqiptar, turrevrap e sulmojnë natën me shkopinj druri para syve të botës Car Dushanin. Fatkeqësia, nuk arrijnë së paku t'ia rrëzonin kryqin nga dora. Tekefundit, t'u binim duarve si shqiptarë Edhe atë, kur kanë Parti Politike Shqiptare, përfaqsuesit e tyre në Kuvend, pushtet e Qeveri në Shtetin e "pëbashkët".

Qesharake, ë?! Përmendoren e Car Dushanit, që "vëllezërit" e sollën natën me kamion dhe e vënduan mbi Urën e Vardarit me makinerinë më moderne, "patriotët shqiptar" duan ta rrëzojnë me shkopinjt e barinjve të Sharrit. Kundërshtarët politik i përdorin të gjitha armët plolitike për të qëndruar e ardhur në pushtet. Populli shqiptar, si gjithmonë me këto provokime nëpër histori, mbeti viktima. Partitë politike shqiptare me disa shoqata joqeveritare vetëm në letër sa për sy e faqe, për të treguar se ende janë gjallë si "patriote", përgjumshëm me fjalë patetike i sulen Car Dushanit, që tashti më në mes të Ditës Madhe pushon i qetë në varrpërmendore mbi Urë, krah për krahu me "revolucionarët" maqedonas, në mes të Shkupit historik të shqiptarëve.

Atëherë, nga zemra e plasur them: Car Dushanin në Shkup na e solli Babadimëri si dhuratë për Vitin e Ri 2014. E di, trusakatët edhe kësaj radhe do të më sulmojnë me theshetheme:

Tradhti kombëtare, i delë zot Shkupit 2014 të Gruevskit. Përgjigjem unë përmes penës time rebele: Po, për Aleksandrin e Madh! Edhe, për Filipin e Maqedonisë, edhe për Olimbinë… Shkupit të Menduh Thaçit dhe Arifikmetit, kurrë nuk i dalë zot. Aspak, nuk dua të merrem me "veprat e tyre patriotike". Tekefundit, as edhe ma ndi çka do të thoni për mua: shpallni tradhtar, apo patriot. Unë e di rrugën time për në Baba Tomor. Rruga juaj qorre, nuk më çon në Shtëpi. Amani, ndalni lotët e krokodilit rrëke, vajtimet e qyqeve lis më lis duke kërkuar të Vëllain! Shami nuk kam sot për sot në xhep t'ua fshi lotët rrëke nga fytyra. Fajësimin e njëri-tjetrit me vite si politikan. Parti politike shqiptare që Lugatit, pasmesnate ia hapi portën. Kalë Troje na futi në Shkup.

Provokimeve, përgjigjuni me provokime e jo të bieni viktima të tyre politike si miza në kusinë e qumështit. Në një oborr shkolle, të nesërmen e dini se edhe Shoku Tito u ngritë lugat natën. Edhe këtë përmendore nuk e dini, kush e solli në mesin e nxënësve?! Veten e paçit më qafë, edhe në këtë jetë edhe në atë jetë!

Nesër, pritni kur të na zgjohen lugetër në Shkup edhe Sulltanët e Turqisë…

"SHEHITI"

Vertet, nuk e di Imzot, se po ta dija kush i dalldis shqiptarët edhe në Ditën e sotme për arratisje politike e fetare, do t'u thoja: mbyllni gojën, edhe bythën! E dini pse?! Shaku se gjithë shqiptarët nuk mund t'i fusim në një thes me arna, lidhim grykën me një kordhë kanapi. Përsëri, vetë përgjigjem: Në Ditën e sotshme historike nuk kemi nevojë: as për çekiçë, as për shkopinj shelgu, as për "analistë" me këmbët e trutë në legen e as për dalldisje të individëve me flamuj kombëtar në shpinë, që luajnë rolin e Arushës me dajre në Shkup ta "rrëzojnë" nga "Ura e Civilizimeve" Car Dushanin, hudhin bythekrye në Vardar, përcjellin me polici për në Greqi.

"Shehiti", pas një shkrimi teknefes në lidhje me themelet e Gjuhës Shqipe, publikisht me trutë dhe këmbët në legen, reagon për Car Dushanin, në Shkup: "Lidhur me përmendoren e Car Dushanit në Shkup, kanë heshtur bashkëkombëtarët tanë katolikë, kleri e bashkë me ta edhe opionistët e analistët filokatolikë gjithandej trojeve shqiptare".

"Shehiti", që moti e ka shitur veten një torbë taxhi, botimin e kompletit të "veprave" të tia në një shtëpi botuese në Shkup me anë të "ndihmave

humanitare” nga Turqia e Arabia Saudike. Dudumi, që merr nëpër gojë për përçarje besimet fetare të shqiptarëve, që në Ditën e sotshme nuk kanë lidhje me Car Dushanin, në Shkup. “Shehiti”, që gjatë kohës së “artë” komuniste jugosllave, gjithë kohën ka punuar si përkthyes në spitalin e Prishtinës. Pas Luftës fundit të Kosovës (1999, i njohur si “miku” më i ngushtë dhe dezertator i Ibrahim Rugovës me shokë), u bë brenda një nate “mysliman me Din e Iman”, poet dadaist, shkrimtar dhe analist politik-fetar duke doktoruar në “shkencat natyrore aziatike”. Kohë kjo, kur shumë poetë e shkrimtarë kosovarë shqiptar, njëqindëherë më të mirë se “Shehiti”, mezi i botonin veprat e tyre artistike, vdiqën rrugëve të Prishtinës edhe pa bukën e gojës.

Patjetër, jam i detyrur në këtë shkrim t’ua rrëfej edhe Arushën me dajre për dore kur na e sillte Xhypi i Prishtinës në Katund për të na e rrëmbyer miellin nga hambarët. Ne si fëmijë, gjithë qejf i dilnim para plot pordhë e piskamë. Xhypi i Prishtinës, i biente dajres, e Arusha i përdridhte bythët, na vallëzonte në mes të lëmës për shtëllungën e leshit të Nuses me pashterkë të kuqe, që e donte shumë burrin: Në të jap moj nëne, si s’ta japë -o. E, pak më vonë kur plaka e pyeti Nusen në valle, a pordhë xhenazja, moj Nënë? Nusja duke e hequr vallen me shami i përgjgjet: Pordhë moj nëne, si nuk pordhe-o. Në

fund, Nëna ose Babai ia mbushnin Xhypit të Prishtinës thesin me grurë ose miell. Rrëfim më vete është ai se, gjatë kohës së Luftës fundit në Kosovë (1999), Tre maxhupë e kanë përzënë gati gjithë Prishtinën. Përjashtim, këtu bëjnë Adem Demaçi dhe Gani Xhafolli. Teki Dërvishi, sipas dramës së tij: *Nesër nisem për në Parajsë*, e kaloi "Ditën e Kiametit" në një podrum të Prishtinës. Profesori im i nderuar, Latif Berisha u vra te pragu i derës. Ymer Elshani me gjithë familje u gri me thikat e traktorit përpara oborrit të Shtëpisë. "Vëllezërit", në atë kohë me automatikë vetëm kanë qitur në qiell, "patriotët" vetë kanë hyrë në autobus e kanë hipur në tren për të ikur nga sytë - këmbët. "Trimat", që me çifteli e vrisnin shkaun, e derdhnin gjakun deri në gju nëpër këngë popullore.

Car Dushani, nuk rrëzohet me një grusht njerëzish të partive politike shqiptare para kamerave televizive. E, as me "shehitë" të arratisur me këmbët dhe trutë në legen. Ndryshe, rrëzohet Car Dushani. Moti ata burra kanë vdekur dhe pushojnë të qetë mes varreve. Habiten me ne të gjallët, pasardhësit e tyre sesi, edhe sot e kësaj dite mirremi me vtëveten duke sulmuar njëri-tjetrin në baza politike, fetare e lokale. Asnjë tjegull deri më sot nuk ia qitëm Shtëpisë mbi çati. Përmëtepër, Car Dushani nuk rrëzohet me këtë bërllok shqiptar me këmbët dhe trutë në legen.

Burra të tjerë janë ata që e rrëzojnë Car Dushanin në Shkup. Fatkeqsisht, shqiptarët hë për hë nuk i kanë ata burra. Prandaj, mirë do të ishte në Ditën e sotshme: Car Dushanit, "patriotët" krah për krahu me "Shehitin" të mos i sulen me çekiç dhe shkopnj shelgu, po me kurora të luleve. Në vend të ferexhesë zezë, ta mbulojnë me flamurin kuqezi shqiptar. Shaku, se: patjetër, duhet ta dini si shqiptarë. Car Dushani, koha është t'i vetëdisojë shqiptarët në këtë shtet të "përbashkët". Mjaftë më vajtuan për Liri e të drejta kombëtare! Shqipëri Etnike. E dini se, gjithë këto parulla "patriotike" në emër të popullit dhe Zotit, janë ende grep i rrezikshëm për popullin shqiptar?! O burrani, populli shqiptar nuk është peshk, që mund ta mashtroni me një krimb. Koha është, grepin mos ta hudhni më në lumë. Liqen det, ose oqean! Po, në mes të popullit shqiptar, ta zeni peshkun e artë, t'ua plotësojë ato tri dëshira historike.

Porosia e fundit: Përvishni mëngët e këmishave! Edhe pantollonat deri mbi gjunj si shqiptarët, futnjuni punës. E them këtë se, e di se në Ditën e sotshme nuk vishni tirqi e xhamadan me dymbëdhjetë gajtana. Çorapë me një shqizë. Sahatin e xhepit me çostek përqafe. "Nagantin" në brez. Heroikisht, të rrokeni si dje fytas me topin e Mic Sokolit. Edhe, atë: jo me këmbët e trutë në legen, po me trutë dhe këmbët nëpër arat

pjellore të maleve të Shqipërisë: Universitet dhe Bibliotekë. Tek, atëherë do ta shini veten se kush jeni si shqiptarë. Momentalisht, në Ditën e sotshme, ju bëni jetën e peshkut në lum, që kur t'i teket peshkatarit ju gjuan me grep. Edhe, atë: vetëm me një krimb. Përgaditë me verë në tigan për darkë si plaçkë lufte.

Vallë, gjithë jetën e keni zgjedhur jetën e peshkut?! Përse, nuk provoni njëherë në jetë të zgjidhni edhe jetën e Ujkut të maleve? Amani, vetëm mos më thuani se nuk jua ka dhënë Zoti. Natyra. Vështirë e keni të më bindëni në Ditën e sotshme me këto përralla popullore. Mos u trembni se, Ujku e hanë qengjin si Kësulkuqe, vetë ia hapi derën Gjyshja. Ujku e hanë qengjin. Pastaj, ku ta dimë ne: mos vallë qëngji ka dëshirë që ta hajë Ujku, hyjë si hero në histori. Ose, i gëzohet flijimit të Kurbanit.

Populli shqiptar, për hir dhe dëshirë të disa politikanëve, nuk është Kurban. Vërtetë, të parët tanë kanë shti themelet, por ende Shtëpinë e kemi pa çati. Kurbanin, moti ata e kanë shti në themele. Politikanët e sotshëm nuk kanë nevojë për Kurban, po për Shtëpi. Prandaj, edhe këta politikanë nëse nuk janë të vetëdijshëm se si mund t'i përzëmë nga pushteti, le të mos na marrin më si qengja me një një zile në qafë varë. Nuk jemi ai qengji i vjershës së Rexhep Hoxhës nëpër Librat e këndimit të "vëllazërim-

bashkimit”: me brinja dap e dap, do të më qesë mua në trap, po nuk më qet se më ka shok, prandaj ecim të dy tok. Jo, qengji i sotshëm nuk do t’ju qesi në trap, po me të dy brinjat bythekrye në përrua. Burra, bëhuni ujqër të maleve për Liri, që zbresin nga majat me borë në mes të Qytetit jo me çekiç, e shkopinj shelgu. Veteranë dë dalldisur me flamurin kuqezi shqiptar mbi shpinë, e hoxhallarë me këmbët dhe trutë në legen, po me votën e lirë demokratike.

Në zgjedhjet e ardhshme, nëse nuk i dilni zot popullit shqiptar (vetëvetes) si politikanë që ju ka sjellë në pushtet, atëherë do të ikni ashtu siç keni ardhur me votën e lirë demokratike nga pushteti si kalorës të arratisur nga politika.

Unë, u dola borxhit si shkrimtar. Parashikues i Ditës së Nesërme. Veten e paçit më qafë! Hi-hii-hiii… Zoti u ndihmoftë, o “ptariotë” kuqezi, që edhe sot si dje me të njëjtat metoda e rrokni për fyti Topin e Mic Sokolit në fushën e mejdanit!...

Vallë, sipas “Shehitit” të Prishtinës në Ditën e sotshme, shqiptarët ende duhet të merren me lutje për faljen e mëkateve në xhami e kishë, shpëtimin ta kërkojnë te fetë e Zotit?! Cili është më patriot dhe fetar se shoku?! Gabim i madh historik! Shqiptarët, në Ditën e sotshme nuk duhet të mbeten nën nivelin e thirrjes historike të Vaso Pashë Shkodranit: ***Feja e shqiptarit, është shqiptaria***.

Rrugë kjo e Zotit! Natyrës. E Rilindasëve tanë për të hipur në Baba Tomor…

HAXHUZE

Rrezik i madh është, kur i hurit e i litarit, themi ne në Katund, shet mendë. E heq veten si "patriot i madh shqiptar, analist politik e dijetar". Përmëtepër, sipas arshinit të partive politike "vlerësojnë" veprimtarinë patriotike të fytyrave më të ndritura të popullit shqiptar. Burrave të pushkës e penës, që gjatë gjithë jetës e kanë vënë në shrëbim të zgjidhjes së çështjes shqiptare: trurin, veten dhe pasurinë. Shembull më i freskët, kësaj redhe është: Adem Demaçi dhe Ibraim Rugova. Punë tjetër është ajo se, kancerin (spiunët) i kanë pasur me vete në trup. Haxhuzet e partive politike shqiptare e rrejnë veten se këta burra të politikës shqiptare, që e ngritën veten me vite nëpër burgjet jugosllave, mund të rrëzohen brenda një nate. Pavetëdije se, edhe Shekspiri nuk është i përkryer. Njerëz jemi, dhe përderisa punojmë nateditë, bëjmë edhe gabime. Burrat për gabimet e tyre të rastit, herët ose vonë kërkojnë edhe falje. Mjaftë shembuj kemi kohën e fundit në mesin shqiptar. Ende është i freskët rasti me Ismail Kadarenë, që publikisht për vlerësimet e tia rreth këtij personaliteti kërkoi falje. Edhe pse, edhe Ibrahim Rugova nuk është pa faje (lule). Tjetër punë është ajo se, haxhuzet turren të parët në vend të ujit, zjarrit t'i qesin benzin. Aspak, ky

veprim i tyre pa kokë nuk është në dobi të popullit shqiptar: sot për sot të merren me këto përsonalitete. E nesërmja, shumë bërllog patriotik do të pastrojë nga Lëma shqiptare. Historianët janë ata që do ta thonë fjalën e fundit me argumente. Një gjë nuk e kam të qartë, pse ne shqiptarët në momentet më të vështira për popullin shqiptar, humbim shumë kohë dhe merremi me thashetheme, etiketime si haxhuze bostani: kush është më patriot se shoqi, cili e do më së shumti Atdheun. Vetëm, përçudi nuk e di pse s'mund të pajtohem me trutë e këtyre halldupëve duke e rrezitur palarenë në Diell?!

Zoti, kur e ka dhënë kokën në qafë, e ka dhënë edhe trurin. Fatkeqësia, disa kalorës të arratirur gjithë jetën të humbur nëpër xhepat e partive politike, e rrejnë veten se mund të rroken fytas me personalitete të dëshmuar historik për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Dudumin e masin me Burrat e kombit, që gjatë gjithë jetës së tyre e kanë vënë në rrezik, veten dhe familjen. Trusakatët, që janë larg tyre me qindra kilometra si Sanço Panço shqiptar në zhvillimet politike, turren me të katra të japin vlerësime politike. Askushët, që nuk e kanë gajlen e këtyre personaliteteve shqiptare, por veten që për së gjalli si kalorës të arratisur e kanë humbur rrugën në mes të oborrit, përpara Shtëpisë. Rrufjanë, që në sistemin komunist nateditë u janë ndërsyer pas

shpine këtyre personaliteteve, e sot turren t'i shpëtojnë nga shqgiptarët e Zajazit. Edhe, nuk ua marr për të madhe haxhuzeve, që nuk dinë të më lexojnë mes rreshtave si shkrimtar. Përpiqen me këmbëngulje shkrimeve të mia t'u japin karakter tjetër përçarës politik e fetar. Përmëtepër, të më shpallin se jam kundër kosovarëve. Haxhuzet, që nuk e dinë se unë si shkrimtar jam rritur e formuar ne mesin e tyre, bukë kam hëngër me ta gati një jetë në një sofër. Pavetëdije se, palarenë e maxhatores me pashterkë të kuqe këmbekokë në maxhe, nuk mund ta fshehin pas mullarit me kashtë, që u ka mbetur për mejdani mes livadheve në sipërfaqe para syve të Diellit. Përditë vjellë, edhe nuk kam çka të vjellë, përveç zorrëve t'i nxjerrë jashtë nga barku. Haxhuzet, po m'i vrasin sytë në çdo hap para botës përparimtare, që në vend të veshjeve kombëtare shqiptare, "stolisen" me shami e ferexhenë krahëve: shkolla, universitet, televizion, tubime shkencore e kulturore. Patjetër, sipas tyre "myslimanja" duhet të jetë me veshje dhe kulturë turko-arabe?! Populli thotë, si Delja e zezë në mes të Kopesë të dhenëve, rreth Vardarit e lëndinave të Sharrit.

Historisë nuk i lënë kohë të merret me heronjt e vdekur dhe të gjallë. Gabimet e tyre strategjike për Atdheun. Nguten, t'i shpallin heronj familajrët, miqtë dhe partizanët e partive politike. Aspak, pa e pyetur veten se, nesër a do

t'ju përballojnë ato burra e gra të penës dhe pushkës gjithë këtyre stuhive politike: ngritjes së përmendoreve nga partitë politike dhe rrëzimit të tyre nga vetë populli shqiptar. "Mbeturinat turke" (sipas Erdoganit në librin e tij politik), të cilët dikur u nisën për në Turqi shkaku marrëveshjes Serbi – Turqi (1938, 1953), dhe pas prishjes së marrveshjes mbetën në Shkup, sot ngrejnë krye si kunguj Stambolli, na ngatërrohen nëpër këmbë. I rrenë mendja e halldupit, se: Edhe pas pesqind viteve do të shpallin Turqi ose Serbi në trojet etnike shqiptare.

Zoti, siç duket ne shqiptarëve na kishte lindur vetëm për të ngritur dhe rrëzuar përmendore. Punemadhe, që gjithë këto "ndryshime" i bëjmë para syve të botës. Përmendoret historike, siaps meritave i ruan në vendin e vet Shteti ligjor duke i zbukuruar me lule. Gjurmët historike nuk mund t'i fshijë asnjë Dorë e Zezë. Vetëm shqiptarët, pas çdo ndryshimi politik ua fusin kazmat, i tërheqin zvarrë nëpër qytet, e rrënojnë historinë e lavdishme të popullit shqiptar, të ngritur me gjak nëpër shekuj. Historia shqiptare, duan të nisë me ta si parti politike. Shprehi antipopullore shqiptare, se: Gurë mbi gurë ndërtohet Kalaja. Vështirë, mund ta ngrisim të Sotshmen ne shqiptarët pa të Djeshmen?! Gurë e dru duke hedhur mbi personalitetet e dëshmuara historike, që i kemi ndërtuar me vite mes gurëve

të mullirit, e i rrënojmë brenda një dite. Kujt t'i teket merret me vlerësime rreth këtyre personalieteve. Ujë hudhin me kusi në tigan, kur gati të gjithë e dimë se petullat nuk bëhen me ujë, po me tëlyen e vaj lule dielli. Mundësisht, edhe ai të jetë vaj ulliri qindravjeçar. Askushi, përpiqet t'i shes mend popullit shqiptar, se: cili ka bërë më tepër si patriot, Adem Demaçi, apo Ibrahim Rugova. Populli thotë: rrahje kot e ujit në tavan. Unë them: që të dy e kanë vendin e merituar si veprimtarë për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Secili në radhët e tij ka pasur ushtarë të mençur e trima. Ibrahim Rugova në Kryesinë e LDK -ës: Numrin 2 të LDK, që përfundoi në Kabinetin e Kiro Gligorovit. Që, posa nisi lufta në Drenicë, dezertuan si ushtarë besnik, e lanë Kryetarin e tyre në baltë. Edhe, Adem Demaçi ka pasur gati po të njëjtin fat si viktimë politike. Autor i librit: *Gjarpinjt e gjakut*, roman i ndaluar në atë kohë, për të cilin vetëm pse e kanë lexuar tinëz shqiptarët, ose ua kanë gjetur në shtëpi me qindra studentë janë rrasur nëpër burgjet jugosllave, ku pak veta e kanë shpëtuar kokën.

Mirë, të themi: gjithë këto vuajtje për Liri t'ia lëmë të kaluarës (historisë), po ne shqiptarët në Ditën e sotshme, pse e kemi humbur rrugën në oborr si dele të nënkryeme, përpara Shtëpisë?! Kokës t'i biem me grushta, pyesim veten si popull, si eshtë e mundur brenda një nate

personalitete historike që i kemi ngritur me vite dhe i kalitëm si patriotë, të nesërmen i shpallim spiunë dhe tradhtarë. Fenomen i çuditshëm, qenkemi ne shqiptarët me të cilët nesër si popull duhet te merret historia dhe shkenca shqiptare.

Koha po na ikë padiktueshëm para syve si shqiptarë. Vagoni i fundit rrëshqet mbi binare për në Evropë. Treni fishkëllon në Beograd.

Udhëtarët me valixhe në duar presin në Prishtinë. E ne, ende nuk jemi në stacionin hekurudhor në Shkup, hipim trenit si popull shqiptar për në Histori. Vetëmse, kësaj radhe jo për në Turqi, që të mos këthehemi kurrë, po për në Evropë me dije e shkencë. Bagazh historik brez pas brezi për Liri. "Kapidanë" e "flamur" turko-jugosllav, "Kosmala", "Muslimani" e "Shkupjani", që po të mos ishin mësuesit kërçovarë, struganë, dibranë dhe kosovarë edhe sot e kësaj dite do të ishin të regjistruar dhe hynin në varr si turq "ehamdurila".

Viti 1981, këto halldupë i gjeti si "turq" e i regjistroi si shqiptar, që tashti siç duket përsëri i ka marrë malli për interesa personale, familjare e materiale të deklarohen si "turq", pa e ditur së paku një fjalë në gjuhën turqishte. Samiu i madh, që u bëri nga gjuha osmane një përshesh gjuhësh me kos, gjuhë letrare turke. Zajazi me shokë ua solli Skënderbeun në Shkup. Flamurin kombëtar kuqezi, që ta zvarrisin "patriotët" me valle dhe këngë tallava kur t'u teket nëpër dasma e harrojnë pas zgjedhjeve lokale e parlamentare nëpër bandere. Dhe, përderisa një grup "patriotësh" me çekiç përpiqet ta rrëzojë Car Dushanin në Shkup, grupi tjetër "mysliman" me mjekra i delë zot Burmali Xhamisë. Pala tjeter, shfrytzon mjegullën politike bashkë me ndotjen e ajrit në Shkup, ndërton Domin e Oficerëve serb dhe

mbjell në çdo hap përmendore këpurdha pas shiut.

Shkupi ka qenë, është dhe do të mbetet shqiptar. E përsëris: Nuk e kam thënë unë (edhe pse, përveç katër viteve të shkollës normale mbi pesëmbëdhjetë vite kam punuar nëpër këto fshatra të Malësisë së Shkupit, ku edhe jetoj deri në vdekje), e ka thënë Mahmut Dumani, një veprimtar i madh shqiptar në hepjen e shkollave shqipe. Kohë, kur Ministër i arsimit ka qenë Ernest Koliqi në këto anë: Herët a vonë ne si shqiptarë me këtë popullatë të Shkupit do të kemi probleme. Thënja e tij profetike në atë kohë, doli realitet në Ditën e sotshme. Ne si shqiptarë nuk kemi probleme me sllavët, po me "shqiptarët" e këtij qyteti historik, stacion i dikurshëm i shpërnguljeve të shqiptarëve për në Turqi. Tjetër punë është ajo se, rrugaçët kuqezi, ende na prinë për në "Liri". Autorët e komenteve anonime, që e hudhin gurin dhe e fshehin dorën. Provokimet e tyre politike në çdo hap dhe shkrim profetik. Askushët, që pa taxhinë e partive politike, do të cofnin në mes të rrugës. Gjithë jetën merren me njëri-tjetrin duke i shpallur familjarët patriotë dhe kundërshtarët – tradhtarë dhe spiunë. E, nuk lanë njeri të gjallë pa marrë nëpër gojë, i dalin zot Shtetit të Njerkës. Gërhasin, mu si dje edhe sot në gjumë mes Dimërit.

Car Dushani, kur u ngritet lugat mbi "Urën e civilizimeve", turr, partizanët e shokut Tito ta rrëzojnë me çekiç të muratorëve e shkopinj shelgu. Faj nuk kanë "patriotët" kuqezi, po Ali Ahmeti që ua ka varë një torbë me taxhi përqafe. Skënderbeun ua solli në Shkup. Flamurin kombëtar kuqezi, sot pa frikë ta zvarrisin nëpër dasma rrugëve me pluhur të Shkupit duke e harruar nëpër bandere. Poashtu, edhe Universitet shqiptar te pragu i derës. Dudumëve, që nuk turren si e gjithë bota pas dijes, po pas diplomave unievrsitare dhe titujve shkencor. Vendeve të punës në Unievrsitet dhe Qeveri, kur ne sot nuk kemi barinj të deleve dhe mjeshtër të tollumbave, që dikur me këtë "zanat" anembanë e pushtuam gjithë Jugosllavinë e shokut Tito, e sot nuk jemi në gjendje ta rrëzojmë Car Dushanin nga "Ura e Civilizimeve".

Rrezik i madh është për një popull, kur u bie Ujku ndër dele, përderisa haxhuzet me kokën në grazhdin e Shteteve Arabe e palarenë në Qeveri, nateditë shesin "patriotizëm" para kamerave televizive me brekët arnë përmbi arnë mbi pantollona…

BABADIMRI GRUSHTOHET NË SHKUP SI "I DËRGUARI SHEJTANIT"

Interesant, Babadimri ka pasaportë diplomatike (sa për sy e faqe) dhe nuk ka kufinj politik nëpër botë si ne shqiptarët. Mirë. do të ishte këtë pasaportë diplomatike ta kenë artistët, po ja që pak veta e kanë deri në Ditën e sotshme. Pajtimi ndërkombëtar: krahas politikanëve, mirë që e ka Babadimri. Edhe, mirë që nuk e kanë këtë dhuratë politike ndërkombëtare bashibozukët. Shkaku se, në Shkup do të mund të hynin me këtë dokument udhëtimi përveç artistëve të vërtetë, edhe të rrejshmit me shalla të larmë turko-arab përqafe. Dudumë, që kohën e fundit kur e gjejnë veten nëpër shkrimet e mia publicistike, tërbohen dhe marrin guximin të dalin me emër e mbiemër. Mendja i rren se, unë do merrem me ta si haxhuze Bit-Pazari që i ka falë Zoti, humbë kohë me shpifjet e tyre dhe sharjet e nënkryeme teknefese. Pavetëdije, të shkretët mbyten në hurdhë, nuk e dinë se nga kemi ecur kemi lënë gjurmë aq të thella, që nuk i fshinë dot asnjë stuhi, borë e madhe. Herë duan të duken shkrimtarë, kritikë letrar, fetarë e herë psikologë të "Shtëpive rehabilituese". Diagnozën e tyre shpallin haptas për mua si shkrimtar në rolin e "mjekut specialist", nguten të ma nxjerrin nga xhepi pa

"korrupsion", pa u trokitur kurrë në Ordinancën e tyre mjeksore.

Megjithatë, aspak nuk u hidhrohem të arratisurve politik, kur i shoh kaq "trima" mbi gomarë me kunguj Stambolli në kokë, që plasën të më dalin në dyluftim në fushën e mejdanit, t'i masim forcat krijuese. Ose, siç thotë këngëtari popullor: Hutat t'i puthim gushë më gushë. Hë për hë, nuk kam kohë. Nesër, ndoshta gjej pak hapsirë në Shtëpinë publike. Po, ato më do të jenë të vdekur, pushojnë në "paqe" mes varreve.

Hi-hii-hiii… Ujku, sot për sot nuk merret me këlyshë me zgjebe që i lehin me vite pas shpine, dhe kur e kthen prapa kokën, i sheh aq të mjerë e përlagur me një asht në gojë, vazhdon rrugën për në Baba Tomor. Malli më ka marrë për ujqër të maleve! E, jo për Këlyshin me zgjebe të Flakës së vëllazërimit dhe Shkollës Fillore "LIRIA" në Shkup, asaj kohe kur m'u ndërsye me shokë pas shpine me një asht në gojë. Heroikisht, si personazh letrar, hyri në librin tim me drama (satirë groteske): *Kopeja me zgjebe ndjek Autorin* (2000). Numri 2 i "Ditëve të Naimit", prej nga ku e përzunë me të gjitha "plaçkat kulturore" në fshat, jetojë mes kontenierëve të bërllokut. "Burrërisht", edhe sot me gjithë asht në gojë t'i turret përmbrapa DoktorZiut.

Përsëri, kam frikë se nuk më kuptoni, nuk dini të më lexoni mes rreshtave. Shkaku?! Vërtet,

më dhimbeni si buba rruge me bishtin ndër këmbë e gjuhën e nxjerrur jashtë dypëllëmbë nga vapa. Prandaj, do të përpiqem t'ju ndihmoj pak në këtë shkrim profetik. Kurrë, nuk e kam pasur torbën me taxhi përqafe, që t'u ndërsehem personaliteteve shqiptare sa herë që Qoftëlargu të ma bëj me gisht i fshehur pas porte. Tjetër punë është ajo se, Haxhuzja e ka mizën në kësulë. Male të larta kemi në mes njëri - tjetrit si krijuesë shqiptar. Larg jemi me qindra kilometra. Baba Tomori, Mali i Perëndive nuk zbret në "Vodno", po "Vodno" duhet të hip në Bab Tomor. E them këtë se, kët Vit të Ri iu muarr para syve të botës në kufi pasaporta edhe Babadimrit. Përmëtepër, edhe e sulmuan me grushta nëpër afishe në Çair dhe Butel të Shkupit. I thanë: mund të vijë Car Dushani, po të dojë në Shkup, Erdogani edhe Millosheviqi, po jo ti me thesin plot dhurata Natën e Vitit Ri. Ne, na sjellë dhurata Ferexhja e zezë Natën e Vitit Ri islam, kur Azreti Muhamedi a. s. u shpërngul nga Meka në Medinë (9 nëntor si festë myslimane).

Përinatë, "vëllezërit" e ringjallën dhe e sollën Car Dushanin në Shkup. Shqiptarët, në vend të duartrokitjeve dhe luleve, e pritën me çekiç, simbole komuniste. Drapëri mungonte dhe ylli i kuq komunist. Trupërojen, falë "patriotizmit" të shqiptarëve, Car Dushani e ka edhe më në nivel se gjatë pushtimeve dhe

sundimit të këtyre trojeve: policinë e shtetit të "përbashkët", nateditë të maskuar brigjeve të Vardarit.

Haxhuzja, pas teravisë shpërnda dhurata (afishe) para syve të policisë të Shtetit ligjor "demokratik", Partive politike maqedonase e shqiptare. Vitit të Ri 2014 do t'i vë kufi politiko-fetar duke u fshehur nën petkun politik antishqiptar. Askushi nuk guxon t'i ndalë veprimtaritë "humanitare" nëpër trojet etnike shqiptare. Dhuratat e Vitit të Ri, thirrjet (afishet) e shpërndara me Babadimër duke e grushtuar në mes të ditës në Shkup para syve të policisë Shtetit, që synon nesër të shkojë në Evropë. Njësoj si Haxhuzja "shehite", që del me emër e mbiemër nën shkrimet e mia profetike dhe kujton, e rren veten se është "Hanëm Haremi" me gjithë ashtin në gojë e ferexhenë krahëve.

Gomarin me samarë, në të cilin mezi e hipi Partia shqiptare në pushtet (BDI) e ka shaluar me të katra nëpër Bit-Pazar. Shtetin "demokratik", ku mund të hyjnë të gjithë edhe me qerre, po jo edhe shqiptarët me kësulën e bardhë dhe veshje kombëtare. Tashti, merreni me mend kur Babadimrit i ndalohet shfaqja në Shkup me veshje festive e thesin në shpinë për t'u shpërndarë fëmijëve dhurata si Babagjysh i Vitit të Ri, ose me një shfaqje argëtuese kulturore për fëmijët e vizitorëve të Qendrës Tregtare, ndalohet

dhe më pas dhunohet para syve të botës nga një grup "myslimanësh". Dudumët e ndaluar nga policia kanë deklaruar se: "Babagjyshi i Vitit të Ri, si e ka pranuar dhe shkenca, është i dërguari i shejtanit dhe për këtë duhet luftuar në çdo shfaqje të tij.

Thirrje (afishe) "revolucionare" e shpërndarë në Çair dhe Butel të Shkupit.

Përçudi, i menjëhershëm ka qenë dhe reagimi nga Forumi të Rinjve Mysliman të cilët

në një deklaratë për shtyp kanë theksuar se, "në zbatim të marrëveshjes së Ohrit, policia duhet të arrestojë të gjithë personat e maskuar si Babagjyshi i Vitit të Ri, duke i dhënë kështu fund provokimeve që çdo vit i nënshtrohen myslimanët".

Duartrokitje meriton distancimi i Bashkësisë Fetare Islame, në Shkup: "Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, distancohet nga kjo thirrje, duke thënë që feja islame nuk promovon dhunën. Neve si mysliman kemi festat tona që duhet t'i festojmë, por tani kemi fatin që të jetojmë në një shtet multikonfesional, por megjithatë ne nuk duhet t'i fyejmë, por ti respektojmë, madje edhe të ju urojmë festat e tyre. Feja jonë nuk promovon dhunën", tha Abaz Islami, zëdhënës i BFI-së."

Merreni me mend, çka do të ndodhte nëse Babadimri hynte në Shkup me veshje kombëtare shqiptare, kësulën e bardhë të Bajram Currit në kokë?! "Nagantin" në brez. Sahatin me çustek përqafe. Mos e dhashtë Zoti me Millosheviqin mbi kalë me shalë. E pasqyrë në ballë Përfreri duke e tërhequr Haxhuzja, pasmesnate të na fusë në qytet. Qindpërqind, do të niste Lufta e tretë botërore.

Parashikimi për Ditën e Nesërme: Edhe gjatë kohë, nuk do të ndodhë kjo dhuratë e Zotit. Luftë t'i shpallin Car Dushanit në prag të Vitit Ri, që na erdhi në Shkup pa dhurata, e jo Babagjyshit, sipas

tyre të dërguarit të Shejtanit. Shkaku se, shqiptarët ende e luftojnë armikun me gurë, sëpatë, çekiç e çaj rusi. Haxhuzja, me një torbë taxhi përqafe. Kohë kjo, kur në Ditën e sotshme këto armë të ftohta moti kanë dalë nga përdorimi i luftërave ballkanike. Ditën, kur shqiptarët do t'i ndërrojnë armët e luftës, atëherë edhe do të ndodhin çudirat mistike (ndryshimet) ballkanike. Shqiptarët do t'i dalin zot pragut të Shtëpisë. Momentalisht, e kanë vështirë mes këtij bërlloku para dere, kur në mes të Lëmës i kanë të gjitha gjallëresat me dy e katër këmbë.

Nesër?! Nesër, dihet: nis Dita e Re, që shqiptarët e presin me shekuj. Koha është, t'i dalim para me koçi, sipas zakoneve tradicionale. Pushkë të qesim në Katund. Lodrat dhe dajret t'i bëjmë copë-copë. Nusen me këngë e valle ta zbresim në Lëmë.

O, bini burrat e mejdanit, zot t'i dalim "Vatanit"!...

GËZUAR VITIN E RI 2014

Moti e rrah këtë temë të "rrezikshme" në mjetet e informacionit ballë për ballë: me bërllokun shqiptar, nuk bëhet Shtet shqiptar. Megjithatë, e kam pritur këtë Ditë të sotshme: Këmbëkryq të ulem para Vitit Ri (Shkupi 2014). Dudumët do të thonë: edhe me Babagjyshin që e grushtuan në Shkup?! Po, edhe me atë, si shqiptar. Vite me radhë halldupët na ngatërrohen nëpër këmbë. Herë si "myslimanë" e herë si "patriotë" shqiptar. Letra dashurie i shkruajnë Babadimrit. Përçudi, janë bërë si ajo Pula e Rexhep Hoxhës, e kanë bërë një ve e tjetër hiç. Dhe, tra më tra duke kakarrisur e çuditën gjithë Katundin. Car Dushani, pasmesnate u paska ardhë si Babadimri. Punemadhe. Dorën në zemër, sa për vetëdije: Rrëshqasim të gjithë në akull, e jo në borë majë Sharrit Plak! Babadimri mezi na tërheq me sajë përmes dëllinjave. Pak veta dinë të rrëshqasin me ski dhiareve politike sportive. Shumica rrëshqasin me sajë shkatërraçe teposhtë kodrës bythekrye në përrua si kunmguj Stambolli.

Qesharake është, kur askushët të shpallin "spiun" dhe të akuzojnë për plane madhore politike. Gjithë jetën nëpër fshatrat e malësisë së Shkupit të kanë spiunuar e ndjekur si i dërguar nga Kosova, se: Çështjen e shqiptarëve do ta

zgjidhësh me luftë (1993)?! Gurë e dru mu si dje edhe sot hedhin mbi ty si shkrimtar. Arnues të hartave politike. Karadakun dhe Kaçanikun krye më vete ia japin IRJ të Maqedonisë. Punemadhe, që ti nuk je as anëtar i partive politike. Spiunët e djeshëm pa argumente institucionale të shpallin sot "spiun". Edhe pse, vetëm ti e di vetë, a je apo nuk je spiun. Përmëtepër, askushët që për ty nuk kanë asnjë dëshmi institucionale policore.

Përpiqen me shpifje dhe etiketime ta fshehin veten e spiunit si macën e zezë në thes. Dudumët,

që duan të dalin mbi Komisionin Lustrues, shërbimeve të fshehta policore në IRJ të Maqedonisë, Kosovës, Sërbisë dhe Shqipërisë. Veten e rrejnë se, do të shpëtojnë pa asnjë ferrë në këmbë si partizanë të partive politike. Kurrë, mendja nuk u shkon halldupëve pak t'i vënë gishitin kokës se, dosjet tona nuk janë vetëm në Shkup, po edhe në Prishtinë, Tiranë e Beograd. Kot, përpiqen t'i njollosin personalitetet e dëshmuara të popullit shqiptar, ne i dimë dhe i njohim mirë ato fytyra historike. Populli shqiptar, sot nuk shkon pas gomarit. Prandaj, mirë në Ditën e sotshme do të ishte ta mbyllin gojën, mos të merren me shpifje, etiketime dhe përçarje pa argumente për personalitetet e dëshmuar shqiptar, që për çështjen shqiptare kanë vënë në rrezik veten, familjen dhe pasurinë.

Megjithatë, dudumëve ua bëj me dije: Ende nuk i kam humbur shpresat për t'u ngjitur në Baba Tomor. Malin e Perëndive. Tyrben e Babashehut, ku pas rrëshqitjes në akull e borë, do t'i fus një sy gjumë mbi Varrin e tij që i luten mbi kokë Dy Nuse të reja me pashterka të kuqe t'ua përzë xhindet. Azganeve t'u bëjë fëmijë. Bythekrye gjithë natën e lume t'i rrokullis dy shtamba me verë. Ditën e nesërme, pasi të më japin gji shtatë Zana nën Rrap, t'i hip kalit si Gjergj Elez Alia dhe të fluturoj në qiell. Përmes mjegullave t'i sulem Diellit me qerre. Edhe pse,

ne si shqiptarë kemi probleme historike: pesqind vjet kemi qenë nën Perandorinë Osmane, vite e vite jetojmë së bashku me sllavët. Vite të plota e kemi ndarë historinë edhe me gjermanët e italjanët, e bëmë "Shqipërinë e Madhe". Vallë, a nuk u shkon ndonjëherë në mend ta pyesni veten se, mos ne shqiptarët jemi mësuar me "vëllezërit" pushtues si "çlirimtarë" dhe e duam Robërinë?!

Atëherë, pse nuk bashkoheni o shqiptarë me mua si i "sëmurë patelogjik", dhe "kundërshtar" i Njerkës dhe Zotit, së paku në parashikimet profetike për Nesër?! Tekefundit, për analizat e "Frojdit", kundërshtarve të mi "shqiptarë", teknefesë nën sjetullat e Partisë Politike në pushtet, të cilëve ua dhashë të gjitha mundësitë për të ecur përpara në jetë, po është humbje kohe të merresh në Ditën e sotshme me këta kalorës të arratisur të dalldisur grazhdeve të partive politike. Shkaku, se: ende djali vazhdon ta vrasë babain. Vëllai, vëllanë. Burri, gruan. Miku, mikun. Frojdi nuk është gjallë, por kundërshtari im i kalemit që thirret në emër të tij, ende përpiltet në pelena (nuk u rritë burrë), që ta marrin për analiza në kabinet si krijesë të çuditshme me brekët nëpër këmbë shkenctarët shqiptar, që me pak shpirt po u vdes në duar si eksponent i "vëllazërim- bashkimit". Shurrën ende e bën në djep. Frikë kam se, Nesër nuk do të ketë njeri të gjallë ta përkund në djep me ninulla. Netedité, shet mend sipas thirrjeve të

disa “analistëve” të shitur shqiptarë me kokën në grazhd të partive politike e bythën në Qeveri. Vërtetë, ma kënaqi Lapsin. O, burra mblidhni mendtë në kokë dhe punoni për Atdheun, ky është Xheneti juaj i përjetshëm që do t’ju shpie në Parajsë. Rrena, janë të tjerat të You Tube hoxhallarëve se, do t’ju dalin zot Ditën e gjykimit në Natën e varrit. Urën e Xhehnemit, kur do të kaloni si besimtarë të Allahut pa “mëkate”. Ndodhë, Ura të ju lëshojë mu në mes flakës të zjarrit të Xhehnemit.

Qëllimi është: Patjetër, duhet të hipet në Baba Tomor! Rruga ka, edhe dhiare. Rreziqe. Tjtetër punë është ajo se, ju a do ta gjeni dhiaren kryesore, kapërceni gardhin, dilni në Livadhe mes luleve. Fatkeqësia, e dini ku është: pak veta do t’i ngjiten asaj maje të Perëndive. Shumica do ta humbin rrugën në oborr në mes të Ditës Madhe. Shejtani i Allahut u pri në ballë për në Xhenet. Rretherrotull do të sillen sokaqeve të Bit - Pazarit. Skënderbeu krah për krahu me Çajupin, moti jua ka treguar rrugën e Baba Tomorit. Mjerisht, hë për hë, ju e ndiqni rrugën e Shejtanit të Allahut. Përkohësisht, unë nuk jam në atë rrugë, nuk mund t’ju dal në ndihmë. Nesër, nuk e di çka të ju them si shkrimtar. Përpiqem kot t’jua tregoj rrugën me gisht, kur ju veç e keni humbur moti më në mes të oborrit, përpara Shtëpisë. Prandaj, sipas

pejgamberit të fundit Muahmedit a. s. bini në "Din e Iman", pa "Vatan" nuk ka "Iman"!

Problemin historik, gjithmonë kërkojeni në vetvete e jo te tjetri, armiku. Mjaftë më me vajtime si qyqe lis më lis, me çekiç në dorë e "protesta politike" u dalldisët brigjeve të Vardarit! Përvishni mëngët, edhe pantollonat deri më gju. Tirqi e xhamadanë, e di se nuk keni veshur moti kohë. Brekët, ende i keni nëpër këmbë. Flamurin kombëtar kuqezi e keni hedhur krahëve, e zvarritni si leckë, përdhosni nëpër Bit – Pazar. Faji, nuk është i juaji, po i pushtetarëve që ju kanë hazdisur me taxhinë në grazhd. Ditën e sotshme jeni bërë si Qengji i vjershës të librit të këndimit që hanë bar. Dhe, "me brinja: dap e dap, do të më qes mua në trap." Babai, i cili do me e çue në Koperativë. Megjithatë, "nuk më qet se më ka shok. Prandaj, ecim të dy tok."

Edhe, më në fund u binda se jeni qengja që hani bar me një zile në qafë varë. Dhashtë Zoti, nuk ju hanë Ujku që ju troket te Porta e edhave. Veten e patshit më qafë. Ujkut, që jua tregon këmbën e lyer me miell për dritare, hapjani derën! Atëherë, do ta gjeni rrugën e vërtetë Parajsës (Xhehnetin). Momentalisht, piqeni në zjarr të Xhehnemit. Kur do të dilni nga çerepi e saçi i skuqur që është duke ju pjekur si kulaç, do ta thonë mysafirët që i keni në sofër. E di, do të më përgjigjeni: Po, ne gjithë jetën mbetëm në çerep

me saçin mbi kokë. E vërtetë, po ktheni kokën prapa shpine! Nuk kemi qenë aty ku ishim Dje. Dorën në zemër, nuk kemi ecur me hapa të pritur, por kjo nuk do të thotë se nuk do të ecim Nesër. Krah për krahu të hipim në Baba Tomor. Malin e Perëndive Shqiptare. Tyrben ku pihet vera, shkruhet poezia. Dhe, bëhet dashuri.

Ditën e sotshme, unë vetëm mund t'ju them: ky është realiteti hidhur shqiptar. Mysafirin, që ju troket te porta, pritnje në sofër me bukë e kripë sipas traditës shqiptare. Edhe, armikun e paftuar në derë. Nuk e kam fjalën, kësaj radhe për Car Dushanin. Miqëve të kësaj natyre, përplasjuani derën! Punemadhe, që ndonjëherë i suleni edhe me çekiç. Flamurin kombëtar kuqezi krahëve. Kryesorja është, që të bëni zhurmë patriotike. Ku ta dimë ne, Nesër mund të na dalë si mik edhe armiku, Babadimri që e grushtuat në Shkup. Viti i Ri, tjerë mysafirë të paftuar do të na sjellë në Shtëpi. Këmbëkryq do të na i uli në sofër. Moti e kam thënë: Çështjen shqiptare, nëse nuk e zgjidhin miqtë tanë amerikanët, do ta zgjidhin gjermanët. Dihet, të mos keqkuptohemi edhe me ndihmën tonë politike e shkencore. Punë tjetër është ajo, nëse armiku historik e ka marrë porosinë.

Gëzuar Vitin e Ri, 2014!...

PARTIA TY DO TË TË BËJË PLAK KATUNDI

E përcollëm Vitin Plak 2013 me një thes dështime politike e "fitore" në shpinë! Dhe, e pritëm Vitin e Ri (Shkupi 2014) me një thes të grisur arnë përmbi arnë plot dhurata Qeveritare. Provokime alla komuniste. Shqiptarët, dikur në kohën e "artë" komuniste i provokonin me Skënderbeun, ndonjë libër të ndaluar në gjuhën shqipe, flamurin kombëtar kuqezi, Kosova – Republikë. Dhe, të nesërmen i arrestonin si "nacionalistë", "irredentistë", "armiq" të popullit dhe shtetit të "përbashkët". Përçudi, sot i kanë ndryshuar metodat policore dhe veprimet e arrestimeve. I provokojnë shqiptarët me flamuj turko-arab, xhamia e Car Dushanin mbi "Urën e Civilizimeve", në Shkup.

Provokimi radhës, në prag të Vitit Ri: grushtimi i Babadimrit si " I dërguari i Shejtanit" në mes të Qytetit. Ditën e nesërme, Babadimri i rrejshëm bënë biznes nëpër Bit – Pazar duke u shitur dhurata (fishekëzjarre) fëmijëve shqiptar. Shitësit e fishekëzjarrave sulmohen nga "Alfat" në Çershinë e Shkupit. "Alfat", si në filmat kriminalistik "Spagetti Western", shkrepin kallashnikovët në ajër mes popullit. Turr mjetet e

informacionit në gjuhën shqipe me storie "ekskluzive" televizive: Policia speciale "Alfat" i kanë sulmuar shitësit shqiptar duke ua marrë edhe kafshatën e gojës. Shqiptarët i madh e i vogël në rrugë, të gjithë në protesta "paqësore" qytetare. Rast interesant ky, që nuk besoj se, mund të ndodhë në ndonjë qytet tjetër të botës përparimtare, kur ditën e nesërme në një gazetë në gjuhën shqipe ta vret syrin shkrimi: "Alfat pësuan fiasko në Bit – Pazar".

Në numrat festiv të tri gazetave të "pavarura" shqiptare në prag të Vitit Ri 2014, (kësaj radhe pa kalendarë me Skënderbe e flamur kuqezi me Shqiponjën e zezë dykerenare), bien në sy përurimet me nga një faqe gazete në kolor: e zv/kryeministrit shqiptar të Qeverisë, Kryetarit të Komunës së Çairit, Komuna e Strugës, Komuna e Tetovës (me dy faqe kolor gazete të cilën e mbyti bërlloku dhe ndotja e ajërit). Larg, nuk mbeten edhe Ministri i Ekonomisë me komunat shqiptare. Mjerisht, sipas asaj thënies së popullit, "këmbët shtrij sa e ke jorganinin" me nga një gjysëm faqeje: Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Minsitri i Drejtësisë, kryetari i Komunës së Gostivarit, Komuna e Dibrës, Komuna e Sarajit, Komuna e Kërçovës dhe disa firmave private. Nuk mungon në këtë Vit të Ri edhe intervista e deputetes Ermira Mehmeti, që "me shumë qejf i gatuan djalit". Interesante, sa

për sy e faqe edhe një intervistë me kryetarin e RDK –së z. Rufi Osmani: "Marrëveshjes së Ohrit i ka skaduar afati". Dhe, ku arrihet kulminacioni i ironisë: Intervista qesharake me drejtorin e Teatrit Shqiptar: "Jam i revoltuar me publikun" dhe me atë të Drejtorit tjetër të Festivalit Ndërkombëtar të Teatrove pa Teatër Shqiptar: "Rikthim me një çmim". Kohë kjo, kur shkollarët tanë nuk kanë libra të këndimit dhe lektyra shkollore.

Askund, mes faqeve të këtyre gazetave të përditshme në gjuhën shqipe nuk të zë syri një varg poezie, një fragment proze. Gjysëm faqeje humori e satire. Befasia e radhës, shpërblehet nga Qyteti i Shkupit me mirënjohje Shoqata e Historianve Shqiptar të Maqedonisë, për

kontributin e dhënë në shënimin e 60 vjetorit të tërmetit katastrofal që e goditi Shkupin (1963). Shprëngulejn e shqiptarëve me dhunë në Turqi, që ia mveshi Natyrës e jo politikës shoveniste antishqiptare jugosllave të asaj kohe.

Përfundimi. "Artisët" tanë që dalin me intervista "bombastike" nëpër faqet e gazetave të "pavarura" në gjuhën dhqipe, dalin sa për sy e faqe të strukur në xhepat e partive politike shqiptare. Mjerisht, plasojnë në opinion dezinformata të shastisura partiake dhe huti në popull. Gazetat e "pavarura" me plot reklama propagandistike, që i mbyllin faqet këtë fundvit me urimet e kryetarit të BDI – së z. Ali Ahmeti dhe zv. Minsitrit të Qeverisë z. Musa Xhaferi nga ku e marrin krahun me kashtë dhe e kanë futur kokën me gjithë brinja në grazhd.

Mëkot, populli shqiptar me këtë bagazh politikanësh, intelektualësh e gazetarësh pret ndryshime politike, do të dalë nga ky qorrsokak politik në sipërfaqe. Gazetarët e këtij soji me pronarët e tyre në krye, që e kanë shitur veten një torbë taxhi te partitë politike në pushtet ia kanë zënë frymën popullit shqiptar.

E përkundin në djep me ninulla partiake: Nina – nana po të përkundi. / Në djep prej druri./ Biro flej, se po të bënë mirë gjumi. Partia ty do të të bëjë Plak katundi…

DOLLI FESTIVE ME "TË DËRGUARIN E SHEJTANIT" NË SHKUP

Babadimri në mes të Shkupit, para syve të gjithë botës u grushtua si: "I dërguari i Shejtanit". Porosia e Forumit Rinor Islam: Kudo që të shfaqet të ndiqet si armik i Allahut. Edhe, atë: merreni me mend, pas kaq shumë viteve që e kishte vizituar Shkupin me thesin plot dhurata në shpinë. Fëmijët, i kishte gëzuar vite me radhë nëpër Çerdhe të fëmijve e shkolla fillore. Vit historik, kur në Shangai (qytet mysliman), sipas numrit të fishekzjarreve të shkrepura në qiell zuri vendin e parë në botë. Përçudi, kësaj radhe, këtë Vit të Ri nuk erdhi në Shkup me helikopter të zbresë nga qielli në sheshin e qytetit "Makedonija". Shkaqet dihen, janë të shumta (Shkupi 2014): Aleksandri i Maqedonisë, Car Samoili, Dame Gruevi, Nikolla Karevi e Goce Dellçevi me shokë, nuk i kanë lënë as një metër shesh për aterim me thesin plot dhurata në tokë.

Babadimri me thesin mbi shpinë, nuk pati vend për aterim as në Bit-Pazar, para këmbëve të Skënderbeut fëmijëve t'u shpërndajë dhurata. Shkaku se, këtë Vit të Ri nuk gjeti asnjë tezgë të lirë tregtie në Anën shqiptare, fëmijve t'u shpërndajë dhurata. Tekefundit, në mes të

"qeseve me bonbone" edhe ndonjë libër ose revistë letrare të ilustruar për fëmijë. Makinat e partizanëve (politikanëve) e kishin pushtuar parkingun në pritjen e Natës së Vitit Ri. Edhe, vetë Skënderbeu me shpatën në brez, mezi rrinte në mesin e këtyre varrezave të automobilave, njëra përmbi tjetrën në Bit - Pazar.

Personalitetet politike shqiptare, kotnasikoti në prag të Vitit Ri u përpoqën ta "zbusin" pak situatën e "acaruar" festive duke u vënë këtë fundvit në rolin e Babadimrit me shpëndarjen e dhuratave nëpër Çerdhe të fëmijve dhe shkolla fillore. Fatkeqësia, dhuratat e tyre kishin ngjyra politike. Fëmijëve tanë këtë Vit të Ri u mungoi Babadimri me thesin plot dhurata në shpinë, mes bonboneve edhe me ndonjë libër pa ngjyra partiake. "Alfat" t'i sulmonin papritur dhe t'ua konfiksonin librat dhe revistat për fëmijë. Në shenjë "përkujdesje" të mbajtjes të rendit në Bit - Pazar, mes të popullit t'i shkrepnin edhe disa fishekë automatiku, t'i dalin zot Shtetit të "përbashkët".

Madhorja historike, në vend të tij, pasmesnate i vizitoi si lugat Car Dushani që e gëdhiu mëngjesin mbi "Urën e Civilizimeve" si kukubec bostani. Kohë nuk kishte pasur të hyjë në varr. Dielli i mëngjesit me rreze e kishte zënë si hajdut të përmbysjeve të kusiave nëpër dhomë dhe tinarëve të tëlyenit në mes të Shkupit. Natën,

i maskuar si Babadimër kishte ardhur në Shkup dhe fëmijëve shqiptar në mes të ditës u shiste pa frikë fishekëzjarre në Bit – Pazar, te pragu i Shtëpisë policore.

Drejtori i Teatrit Shqiptar, në vend të ndonjë shfaqjeje për fëmijë me Babadimër, jep intervistë "bombastike" në një gazetë të përditshme, se është: "I revoltuar me publikun"?! Tjetri drejtor, i Festivalit Ndërkombëtar të Teatrove e

faleminderon Ministren e Kulturës për angazhim të projekteve kulrurore shqiptare. Që, shqiptarët sipas tyre në çdo katund duhet të kenë nga një Festival të Teatrove për ta kënaqur veten, pa Teatër Shqiptar e shfaqje teatrore. Nateditë, rrinë para kamerave televizive duke bërë zhurmë kultuore në çdo fundvit, e shumë pak punë artistike. Asgjë nuk kanë të "hajrët" edhe këtë Fund - Vit të Ri (2014) për t'u lëvduar para syve të popullit. Çati, ende nuk kanë mbi kokë. Oxhakun moti e kanë nxjerrë nga përdorimi për ta përcjellur tymin në qiell. Zoti, e dhashtë edhe ndonjë xixë mes reve. E ku sot, më të flasin për themele kulturore shqiptare.

Shkupi sot për sot, nuk ka nevojë për Babadimër të rrejshëm, kur rolin kryesor ia kanë marrë këta "artistë gjeni" me vula partiake në ballë duke i shëtitur fëmijët shqiptar nëpër ministri e firma private për një "najlon-kese" bombone me afate të skaduara përdorimi. Në vend që t'u përgadisin ndonjë shfaqje teatrore edhe pse: me Teatër të Fëmijve, që ua dhuruan "vëllezërit" në mes të Bit-Pazarit. Falë Zotit, sot duhet të jemi të lumtur që u kanë dhënë nga një gazetare për përgaditjen e emisoneve televizive, që i shëtitën para Vitit Ri derë më derë me atë gjuhën e tyre përshesh Bit-Pazari me nga një Babadimër rruge që i përshëndeti fëmijët para kamerave televizive me një "mashalla" shqiptare.

Dorën në zemër, vërtetë emisione të arrira edukative - arsimore Natën e pritjes të Motit Madh, në prag të Vitit Ri.

"Hajde, fëmija shkojmë"! I merr për dore autorja e emisionit televiz "kombëtar" me një gjuhë Bit - Pazari duke u dhënë shembull se si duhet të flitet gjuha letrare shqipe plot gabime. Mjerimi më i madh: i shëtisin vetëm fëmijët e familjes, kolegëve të punës dhe politikanëve. Tjetër punë është ajo se, këto fëmijë të "zgjedhur" nga stafi i tyre propfesional duhet t'i shohin në ekranin e "Televizionit Nacional Kombëtar", fëmijët e popullit shqiptar pa ngjyra të dalldisura politike.

Gazetarin e sojit të këtillë të "vëllazërim-bashkimit" e njoh mirë këmbekrye që nga koha komuniste, në fillim si redaktor gazete e më vonë si kryredaktor i gazetës së "Vëllazërim-bashkimit", që moti është shuar dhe pushon e qetë mes varrezave historike kulturore shqiptare. Asaj kohe, m'i jepte që t'ia lexoj shkrimet nën Rrap për mendim para se t'i dërgonte në Redaksi. Ose "analistin" e madh politik shqiptar, që nuk shkruan më për gazetat shqiptare që e shohin dritën në IRJ të Maqedonisë, po për gazetat në Kosovë dhe Shqipëri. Shkrime të cilat i sjellë në gazetën e tij në IRJ të Maqedonisë me shënimet e burimeve nga ku janë marrë si "analiza ekskluzive". Gazetë me pak shpirt në gjuhën

shqipe, e sila nuk e di ku e ka kokën e ku bythën. Zoti ua faltë mëkatet gazeteve të "vëllazërim-bashkimit, le të prehen të qeta në Parajsë! Gjatë "ndryshimeve demokrarike", partizanin e kalemit do ta shohim edhe si drejtor i një gazete të "pavarur", ku shkrimet e mia publicistike që i dërgoja në redaksi, në vend që t'i publikonte mes atyre faqeve të gazetës, ia përcillte kryetarit të Partisë Demokratike Shqiptare të asaj kohe në pushtet: z. Menduh Thaçi. Shpërblimi dihet, unë vetëm mund ta marr me mend si shkrimtar. Kohën e fundit edhe si përkrahës i flaktë i ringjalljes të partisë politike, që moti pushon e qetë në varr. Shkollës politike shqiptare, që i mbushi me partizanë edhe partitë e sotshme shqiptere. Tashti, ta them të vërtetën: nuk e di se ku ndodhen për momentin dhe nga cilat istikame politike "atdhetare" bëjnë luftë këto të arratisur politik për "liri" (vende pune në Qeveri). Ose, e kanë strukur kokën pa brinja në ndonjë grazhd të partive politike shqiptare. Herë pas here japin shenja gjallëruese me ndonjë "analizë politike" në mjetet e informacionit. Pak rëndësi ka kjo, siç thotë Jakup Kalliri i "Al Pazarit" në këtë shkrim profetik për Ditën e Nesërme. Pasqyrë për ta parë veten shqiptarët, është "By Pass" i Agim Bajko. Zoti i shpëtoftë nga Zjarri i Xhehnemit "besimtarët" e Allahut! "Ishalla" nuk i bëjnë arnë

kazani në atë jetë si dëshmorë lufte të "vëllazërim-bashkimit!

Babadimri, kësaj radhe erdhi vetëm nëpër Çerdhet e fëmijëve, në ndonjë shkollë fillore dhe në ekranet e emisoneve televizive të fëmijëve. Përsëri, me të njëtin qëllim: t'i plaçkisi fëmijët shqiptar. I mashtroi si gjithmonë me nga një "najllon kese" bonbone: nuk u solli libra, tekste mësimore, lektyra shkollore e as revista letrare plot ilustrime si gjithë fëmijëve të botës. Mëkot kamera televizive kërkonte të zë "rob lufte" ndonjë Abetare, libër, lektyrë shkollore, revistë letrare për shkollarë.

Car Dushani, i maskuar në përmendore si Babadimër i rrejshëm, ua solli shqiptarëve këtë Vit të Ri në vend të dhuratave, thasët plot me fishekzjarre, për të bërë tregti ekonomike plot zhurmë politike, arsimore dhe kulturore. Pasmesnate, u doli edhe në pritë me revole në dorë i maskuar si Babadimër duke i plaçkitur në mes të rrugës. Skënderbeut i tha: Shpata të paska hije në brez, rri se mirë qënke mes varrezave të automobilave, nuk ke nevojë të hipësh në Kala. Përmëtepër, ta kalosh Vardarin, dalësh matanë Urës gurit. Mjaftë e ke këtë copë beton (livadh), pasardhësit e tu "patriotë" pa frikë të organizojnë manifestime "kultuore" sa herë që dehen me çaj rusi nëpër Bit – Pazar të më sullen me çekiç në xhep. Edhe unë jam mirë, falë pasardhësve tu

"trima", që nateditë më ruajnë me polici të mos më mungojë as një "qime floku". Flamurin kombëtar kuqezi me shqiponjën e zezë dykrenare nuk e preku, e la të kalbet nëpër bandere duke pritur fushatën parazgjedhore të Presidentit të Republikës.

Parkut të Çairit, Natën e Vitit Ri i dha jetë festive me fishekzjarre, në vend të zhurmave të dalldisura kulturore, këngëve e valleve plot ashikë, të veshur këmbekrye me rroba festive partiake deri në agim. Punemadhe, që edhe në Çair nuk gjeti vend për t'u shprëndarë dhurata fëmijve. Parkun e bukur të dikurshëm të Çairit dhe gjelbërimet para ndërtesave, moti i kishin "zaptuar" partizanët e partive politike. Ndrëtesat dhe xhamitë brenda një nate kishin mbirë si këpurdha pas shiut. Kohë kjo, kur shqiptarët sipas standardeve botërore nuk kanë çerdhe për fëmijët e tyre dhe shkolla fillore.

Qiellit me mjegulla mbi kokë, në prag të Vitit Ri 2014, Babadimri i rrejshëm ia vu zjarrin me fishekzjarre. Dolli festive ngriti me të "dërguarin e Shejtanit"…

DUSHK PËR GOGLA

Njësiti policor "Alfa", mori aksion për konfiksim të mjeteve piroteknike nga ana e shitësve të rregulltë në Bit-Pazar. Pamjet, ishin një kaos i vërtetë, ndërsa është vërejtë masë e madhe qytetarësh të cilët mbetën të frikësuar tek sa rridhte aksioni policor. Situata u tensinua, kur njësiti policor "Alafa" shkrepi disa fishekë nga automatiku në ajër. Veprim policor, që i nxehu gjakrat e disa shqiptarëve të cilët i bllokuan rrugët duke rrethuar policinë. "Heroizëm" i pashoq, për të cilin një gazetë e përditshme në gjuhën shqipe publikoi lajmin: "Alfat" pësuan fiasko në Bit-Pazar?! E, unë prisja këmbëkryq në këtë prag të Vitit Ri (2014), ndalimin e ndonjë shfaqjeje teatrore të "rrezikshme", në Teatrin Shqiptar. Ose, konfiksimin e ndonjë pjese teatrore në Teatrin e Fëmijëve, në Bit – Pazar.

Përfundimi i kacafytjeve me bllokim të rrugëve dhe policisë, u kurorëzua me kompromis, që të ndërpritet aksioni policor dhe shitësve t'u kthehet malli i konfiksuar. Ditën e nesërme, "Babadimri" fëmijëve shqiptar në vend të librave, lektyrave shkollore, revistave për fëmijë dhe shfaqjeve teatrore, u shetë fishekzjarre me thasë.

Zyrtarisht, policia edhe konfirmoi aksionin e mbledhjes të mjeteve piroteknike. Vetëm se, edhe

sot e kësaj dite nuk e di se cili polic shkrepi plumba në mes të popullit. Fushata parazgjedhore vazhdon në Teatrin Shqiptar. Drejtori thotë: "E kemi ulur çmimin e biletës në minimum dhe akoma nuk jemi të kënaqur me jehonën e publikut, ndërsa më ndodh të shoh sallatat e tjera të teatrove në Shkup plotë – me bileta që kushtojnë sa dhjetëfishi i biletës në Teatrin tonë, e përfundon fjalinë drejtori i Teatrit Shqiptar, në Shkup gjatë një interviste "ekskulzive", në gazetën e përditshme "Koha".

Edhe, vazhdon me "vajtimin" në intervistë: Kthimin e publikut shqiptar. Fije turpi nuk ka, lëvdohet me çmimet e fituara: 8 çmime (???!!!...). Fatkeqësisht, i mjeri nuk e di se, i mungon edhe një çmim, i nënti: Çmimi i publikut.

Interesant, që të dy drejtorët shqiptar, ballë për ballë me intervista në gazetë, nuk do ta lënë pa e përmendur Ministren e Kulturës, Zonjën Elizabeta Kançevska – Milevska: Realizimin e projektit kapitull të Qeverisë së Maqedonisë: "Rikonstruimi, sanimi dhe adaptimi i Teatrit Shqiptar – Shkup. Njëherit, shprehim nderime drejtë të gjitha personaliteteve politike shqiptare që mbështetën idenë tonë dhe kontribuan në realizimin e këtij projekti me vlerë mbarëshqiptare.

Mjerim kombëtar, për një drejtor Teatri Shqiptar, që fajin ia hudhë dhe revoltohet me

publikun shqiptar?! Kulminacioni i ironisë: Ndarja e çmimeve për role më të mirë dy drejtorëve (aktorëve) shqiptar: Adem Karaga dhe Muzbajdin Qamili – Muçi në Festivalin e Teatrove, në Ferizaj.

Edhe, vazhdon dalldisja kulturore shqiptare: "Gjeniu" shqiptar thotë publikisht në mjetet e informacionit, kur gazetari e pyet: Cili është

vlerësimi për kulturën shqiptare në përgjithësi dhe teatrin në veçanti. "Gjeniu", përgjigjet: Disa segmente të rëndësishme pothuajse janë shuar, mungon kritika, mungojnë revistat, mungojnë festivalet… Megjithatë, burri i botës di edhe të lëvdohet: Fatmirësisht, po rritet numri i regjisorëve, skenografëve, kompozitorëve, kostumografëve që përsosen në shkolla të mirënjohura dhe sjellin risi në skenat tona.

O Imzot, nuk e dua çekanin e "patriotëve" kuqezi që para kamerave televizive iu sulën Car Dushanit mbi "Urën e Civilizimeve", po tokmakun e vathës të Bariut të Sharrit Plak me gunën hedhur krahëve! Mendtë njëherë e përgjithmonë t'ua kthejë në kokë dudumëve. Delen se si, e zë me kërlug në mes të kopesë. Merreni me mend: "Gjenitë" kanë kërkuar nga Ministria e Kulturës t'ua mundësojë realizimin e tri premierave, vazhdimin e projektit: "Teatri Shqiptar në qytetin tuaj". Amani, mosni se na kënaqët me "vlera artisike" në Shkup, dhe mos e merrni më qafë edhe publikun e harruar me vite nëpër Parti politike të qyteteve tjerë shqiptar!

"Gjenitë" nuk ndalen me kaq, kanë kërkuar mjete për të realizuar katër pjesmarrje në festivalet jashtë vendit, mes të cilëve "Festivali i Teatrove" në Loçe të Italisë. Krah për krahu me "Gjeniun" tjetër Muzbajdin Qamili – Muçi, sipas gazetës "Koha" edhe pse i punësuar në Teatrin e

Dramës Shqipe, aktori Muzbajdin Qamili – Muçi, kthehet në skenën e këtij teatri pas gjashtë viteve ndërprereje, që nga koha kur ishte drejtor në këtë institucion. Dhe, kthimi i tij për të nuk ka qenë dosido, por me një rol që i ka sjellë edhe një çmim, atë për rol më të mirë dytësor në Festivalin e Teatrove, në Ferizaj me shfaqjen "Jetë me qira" të autorit Refet Abazi, çmim ky që e ndanë së bashku me aktorin Adem Karaga, i cili aktualisht është edhe drejtor i Taetrit amë.

Teatër Shqiptar ky në Shkup, që në kohën e komunizmit i luante në skenë, dramat e shkrimtarëve disidentë shqiptar: Teki Dërvishi, Ymer Shkreli, Musa Ramadani, Beqir Musliu e Anton Pashku. Shfaqje teatrore për të cilat sot na ka marrë malli, për së dyti herë t'i shohim në skenën shqiptare. Ditë e sotshme kjo, kur "gjenitë" e partive politike shqiptare gëzohen me drama të arnauara nga shkrimtarë Oborri dhe miqt e tyre familjarë të arratisur nëpër parti politike. Pavetëdije se, këto lecka artistike të arnuara arnë përmbi arnë, nuk ua sheh me sy njeri i gjallë në skenë.

Punemadhe, edhe që i ndajnë çmimet me "juri profesionale" partiake, klanore e familjare njëri - tjetrit, janë larg problemeve që i ngatërrohen nëpër këmbë me vite popullit shqiptar. Inati të vjen, kur e kthen prapa kokën dhe sheh se, këtë gjysëm Teatri në Bit – Pazar e

kanë kthyer drejtorët e emëruar nga Partitë Politike Shqiptare nën nivelin e të arriturave të drejtorëve të Partisë Komuniste. Publiku kur e mbushte sallën duke ndejtur edhe më këmbë për të parë shfaqjet tetrore të asaj kohe. Bileta për shfaqje teatrore nuk kishte falas, po kishte vlera të arrira artistike.

Sot për sot, gjysmë Teatrin Shqiptar në Shkup e kanë sakatuar Partitë politike Shqiptare me partizanët e tyre partiak, dhe jo ato maqedonase me emërimin e aktivistëve të tyre profesional si drejtorë të "vëllazërim-bashkimit". Komunizmi, vërtetë kishte censurë dhe ishte i rreptë me kundërshtarët politik (i emëronte edhe ai partizanët partiak), ama nuk ta vëndonte në krye të të pri gomari. Neokomunizmi e ka dyfishuar cenzurën, dhe në krye ta vë të të pri gomari me samarin mbi shpinë.

Suksesi nuk duhet t'i mungojë dhe faleminderimi drejtorit shqiptar, "pasi këtë vit kaluam shumë mirë", thotë Muzbajdin Qamili - Muçi. Dudumët, që falë partive politike shqiptare, vazhdojnë edhe në Ditën e sotshme festive (2014) me të gjitha "forcat artistike" politike të na shesin dushk për gogla…

HAJRICA

Hajricat janë haxhuze me fytyrë gruaje, që populli shqiptar i njeh që nga sistemi komunist si "sekretarica". Kohën e findit "demokratike, "Hajricat i shohim edhe nëpër institucionet kulturore të Shtetit të "përbashkët". Vendeve të punës, u dalin zot duke "punuar" për kulturën dhe Letërsinë Shqiptare. Edhe, haxhuzet e hazdisura, ashtu siç i ka falur Zoti e Natyra, fundekrye të bukura, përpiqen t'i shërojnë komplekset e tyre tek kultura dhe Letësia Shqiptare. Nateditë rrinë përpara pasqyrës: Pasqyrë, pasqyrë kush është më e bukura në këtë botë?! Pasqyra pa hamendje u përgjigjet: Buça e Katundit. Edhe atë, nëse i shkonë përmbrapa ndonjë Qen Sharri me zgjebe. Një Zot e di si erdhën dhe kush i solli nëpër ato vende pune pa dituri elementare e fije meritash njerëzore: nëna, babai, ose ndonjë shofer i Nënës Parti. Vetëm një gjë e di, dhuratën e një ministri shqiptar, mos t'ia përmend emrin se do të më zë goja qelb, i solli në ministri në rolin e Babadimrit. Haxhuze, që edhe gjatë kohë shqiptarëve do t'u ngatërrohen nëpër këmbë e ndërsehen pas shpine. Nuk e di, a posedojnë ndonjë diplomë univeritare të ndonjë Universiteti Shtetëror ose privat, shkolle fillore te Hoxha në Katund.

Haxhuzet, gjysmanalfabete, mjafton të ulen në karrige, pranë tavolinës edhe shpien në vend urdhërat e atyre "patriotëve", që i kanë ulur nëpër ato vende si endacake rruge nëpër Bit-Pazar. Interesant është, haxhuzet që nuk i njeh as nëna e vet, e ku më mëhalla shtëpi përmbi shtëpi, kur përpiqen të shesin mend si autoritative. Edhe, nga njerëzit e kulturës kërkojnë dëshira të përrallave arabe. Qilima fluturues. Ose, Shkopin magjik të Babashehut, tua përzë xhindet mbi varr, të mos mbesin përjetë shterpa. Llambën e Aladinit, nuk e duan se, gjithë këto rrotullime akrobatike duan t'i bëjnë natën.

Kohë kjo, kur shumë shkrimtarë e poetë me diploma universitare sillen rrugëve si të papunë, Hajricat na janë ulur këmbëkryq nëpër institucione pa bagazh letrar dhe vendosin për kulturën shqiptare, vlerat artistike të krijuesve shqiptar. Punemadhe, që në jetën e tyre nuk kanë lexuar një libër, shkruajtur as një varg, asnjë rresht së paku në fletore. Përditë e përnatë, të veshura "kuqezi" duke marrë pjesë nëpër dreka e darka si dashnore të shoferëve të ministrave. Hanëm mëdhaja, që për nga bukuria përrallore, si hëna kur bënë dritë në qiell, ta plasin syrin. Njëqind vjet, nuk të shkon mendja për grua, po t'i shohësh me sy këto bukuroshe çarshie të përrallave shqiptare.

Edhe Hajrica, është rrugaçe e sojit të vet me diplomë, që në atë vend pune e solli Nëna Parti për maltertimin e krijuesve shqiptar, gjoja se është në shërbim të tyre si administratore e kulturës shqiptare. Haxhuzja harron se, edhe copën e bukës e fiton falë krijuesve shqiptar e jo shteteve turko-arabe. Vendin e punës pa merita ia ka zënë krijuesit shqiptar. Dibidusja nuk ka faj, faj ka Ali Ahmeti, që me kësi malli të kalbur vetëm për një përdorim në Bit-Pazar, pretendon të na shpie në Europë. Kulturën shqiptare ta nxjerrë me pak shpirt nga fundosja e hurdhave partiake. Vite me radhë duke punësuar e emëruar nëpër komisione kulturore partizanë të partive politike pa asnjfarë bagazhi kulturor e letrar. Herë hoxhallarë, herë tollumbaxhinj e herë partizanë të partisë politike. Nëse, Ali Ahmeti është nga Kërçova për bërllokun shqiptar lokalist, nuk kanë faj: Safet Hyseni, Xhelal Ademi e as Begzat Rrahmani të cilët edhe ata janë nga Kërçova. Faj, përsëri ka Ali Ahmeti me shokët partizanë dhe bërllokun klanor me torbën e taxhisë përqafe, që pranon të shkojë atje ku nuk e ka vendin, vendosë për kulturën dhe Letërsinë Shqiptare.

Edhe, një ditë Hajrica më merr në telefon, më thotë: Mezi e lexon kërkesën me belbëzime, më duket se bëhet fjalë për Manifestimin Kulturor Ndërkombëtsar, Ditët e Humorit dhe Satirës: Xha Deralla, në Kërçovë?! Urdhëroni, zonjë! Çfarë

është problemi?! Përveç, kërkesës nuk keni asnjë dokument tjetër në Ministri. E pamundur, i përgjigjem. Vërtet, një dukuri e këtillë më ka ndodhur edhe herët tjera, po nuk ia kam vënë gjithaq veshin. Me siguri, edhe kësaj radhe i keni "humbur" mes gjithë atyre kërkesave dorë më dorë nëpër komisione?! Zonjë, a mund të më tregoni për cilët dokumente bëhet fjalë?! Përgjigja erdhi përmes telefonit: Programin e Manifestimit dhe vërtetimin në Regjistrin qëndror të Republikës së Maqedonisë. Nuk ka problem, unë e kam edhe kopjen tjetër të kompletuar të Manifestimit dhe do t;ua sjellë nesër. Ama, zotëri ti tallesh me mua si grua serioze?! Sekretari Shterëror i Minsitrisë së Kulturës më ka porositur që të të marrë në telefon dhe meqenëse së shpejti bëhet shpallja e konkursit, mirë është sa më shpejtë të m'i sillni edhe vërtetimin e Regjistrit qëndror, edhe programin e manifestimit. Jo, zonjë i thashë: Unë nuk tallem me ty, por ti tallesh siç duket me kulturën shqiptare. Dikur, më plasi marrja. Zonjë, vërtetë unë i dua gratë, por jo edhe Hajricën e Nënës Parti. Megjithatë, nesër do të ta sjelli edhe kopjen e dytë komplet me gjithë program. E di, më tha azganja, ti je i privilegjuar në Ministri të Kulturës. Qesha. E vërtetë, kam vend pune mu pranë zyrës tënde në Minsitri me sekretare personale. Përmëtepër, nëse do ta dish këtë vit e "mora edhe një çmim shtetëror" duke

përfituar edhe pension jetësor nga Minsitria e Kulturës. Ditën e mirë bukuroshe, dhe mirëupafshim nesër pa xhinde që të paskan pushtuar natën, ia mbylla telefonin.

Ditën e nesërme, trokita në zyrën e Hajricës. E hapa derën dhe i pashë tri adminstratore me kokën mes grumbullit të letrave mbi tavolinë. Vetëm Hajricën e gjeta me pasqyrë në dorë. Hajrica, më duhej i them njërës nga gratë. Unë jam, u ngritë matanë një tavoline Hajrica. I solla, ja ku e keni të gjithë dokumentacionin faqe për faqe. Hajrica, e mori fletëparaqitjen e projektit, që për ta arsyetuar veten e kishte ndarë me kohë, por padashtas e pash se, e kishte ngatërruar edhe me dokumntacionin tjetër të manifestimit. E zbuloi veten para meje pavetëdije si shkrimtar. Unë u shtiva se nuk pashë gjë me sy në atë zyrë. Në rregull, ky është programi, por jo këtë vërtetim nga Regjistri qëndror, por një vërtetim tjetër, ja mu si ky që kam unë mbi tavolinë. E, marrëveshjen me hotelin, ku e keni, zotëri? Zonjë, i them: unë u jam përmbajtë kërkesave të konkursit. Askund, nuk figuron një gjë e tillë në konkurs. Po, të doni, ja shikoni konkursin. Hajrica e zgjati qafën bashkë me kokën. E pashë se, Hajrica nuk e kishte lexuar as konkursin. Mirë, po statutin ku e keni të Shoqatës?! Zonjë, në konkurs nuk kërkohet edhe statuti. Tekefundit, ne nuk jemi Lidhje e panjohur për ju si ministri

pa adresë, veprojmë dhe punojmë në këtë shtet të "përbashkët" mbi njëzetë vite si institucion. Hajrica nga zemërimi u bë tymeflakë. Nuk pata rrugë tjetër, dola jashtë duke ia përplasur derën dhe duke e lënë me pasqyrë në dorë në mesin e atij grumbulli të madh të letrave mbi tavolinë.

Tri ditë më vonë, Ministria e Kulturës e shpalli Programin në veb - faqen e vet administrative. Përçudi, mes atyre menifestime, nuk e pashë Xha Derallën. Plakun me mjekër të bardhë, që këtë grua teknefese me siguri në mes të Dimrit Madh do ta nxirrte pas Çuke ta dërgojë te prindërit si mysafire, që të shoh një ditë të bardhë. Edhe revistën letrare Stili 97, një zë i ri në letërsinë shqipe e cila krijuesve të rinj ua hapi dyert krah më krah. Sidomos, femrës krijuese shqiptare. Revistë letrare që deri më sot kishte dalë në kohë edhe më të vështira (57 numra), Hajricat e Minisitrisë Kulturës po ia zenin frymën, e ngulfatnin para syve të lexuesve. Mes atyre emrave nuk e hasa as emrin e një krijuesi të burgosur politik, Safet Hyseni. Mëkot e kërkova edhe emrin e një krijuesi tjetër kërçovar, Xhelal Ademi, që vite me radhë mu si në kohën komuniste edhe sot ia merrnin të drejtën e botimit. Edhe Begzat Rrahmanin me krijuesë të tjerë kërçovar, që sipas konkursit kishin konkuruar me projekte personale. Kotnasikoti e kërkova me sy edhe vendasin e tyre, Remzi

Salihun. Bujar Gania Plloshtanin të fsheur mes atyre projekteve. Përçudi, nuk ma zuri syri as Fadil Currin me shtëpi në Shkup. Shkrimtarin e përndjekur ende pa nënshtetësi, edhe pse i rritur dhe shkolluar në Shkup me diplomë universitare të "Shën Kirili dhe Metodi". "Irredentistin e rrezikshëm", që gjatë Luftës së fundit të Kosovës (1999), policia maqedonase pas një nate që e kishte marrë në "bisedë informative" nga Shkupi e depërtoi në Kosovë mes bandave kriminele serbe. Jo, në vend të tyre e hasa një aktor të "vëllazërim-bashkimit", që edhe ky kur kishte parë katundarët e tij se si me libra e pushtojnë Ministrinë e Kulturës, turr si kolegët e tij aktorë Bit-Pazari, kishte vendosur të bëhet shkrimtar. Dramat e tia arnë përmbi arnë t'i vë edhe në skenë. Kulminacioni artistik, t'i botojë edhe si libër. Sytë filluan të më dhëmbin nga emrat e sojit anonim të Katundit Madh të "shkrimtarëve". Anëtari i komisionit kishte qenë nga Katundi Madh i tyre dhe e kishte mbushur programin me "vepra" të arnuara leckë përmbi leckë nga letërsia botërore. Që, po ua hoqe emrat nga ballina, të duket se librat e tyre i ka shkruajtur vetëm një autor. Realiteteti, bota sot për sot njeh vetëm kërcime në letërsi. E, jo "shkrimtarët", që me përjashtim të dy - tre emrave, ende janë nën nivelin e krijuesve të mirënjohur shqiptar: Sadudin Gjura, Mehmadali Hoxha, Nexhat

Pustina, Abdylazis Islami e Murat Isaku. Nuk u zemrova me Hajricën, ecejaket në Minsitrinë e Kulturës paskan edhe përfitime. Faleminderit Hajricës, përndryshe nuk do të kishte lindur ky shkrim i gatuar me kaq zjarr artistik. Përgëzime!

Fajin nuk e ka Ministrja e Kulturës, po Ali Ahmeti me shokët partizanë krah për krahu me Shoqatën e Botuesve Shqiptar dhe Lidhjen e Botuesve Shqiptar, që këtyre të arratisurve ua ka hedhur nga një asht para këmbëve. Goditja kulturës dhe Letërsisë Shqiptare nuk i vjen nga pala maqedonase, por nga mashat tinëzare shqiptare. Metodë e njohur kjo historike, siç thotë populli: hidhe gurin dhe fshihe dorën! Vite me radhë duke nëpërkëmbë kulturën dhe librin shqip. Herë me Hoxhë, herë me Tollumbaxhi e herë me rrugaçë Bit-Pazari (Askushë), që në jetën e vet nuk kanë hedhur në letër ndonjë varg, as rresht në fletore, partitë shqiptare në pushtet u japin guximin që si anëtarë komisioni të vendosin për kulturën dhe Letërsinë Shqiptare. Fatkeqësia, të ulen ballë për ballë me dy shkrimtarë të palës tjetër maqedonase, në një tavolinë. Kulminacioni i ironisë, njëra shoqatë e sulmon Ministrinë e Kulturës e tjetra i delë në mbrojtje në mjetet e informacionit. Fenomen i çuditshëm shqiptar, që ndodhë vetëm në mesin e këtij populli. Përndryshe, për nga veprimet kulturore të këtyre shoqatave, kape njërën dhe bjeri tjetrës sa të

mundesh me të dyja duart nateditë. Fajin duke e kërkuar te pala tjetër, e jo te vetëvetja që vite me radhë janë duke organizuar vetëm pazare e "karavane të librit". Përçajnë botuesit shqiptar në dy shoqata botuese, kur ne në IRJ të Maqedonisë nuk kemi shtëpi botuese as për një shoqatë. Tri-katër shtëpi botuese më në zë i kanë shqiptarët në këtë Shtet, të tjerat dalin në skenë vetëm kur partia e tyre vjen në pushtet ose ndonjë anëtar komisioni me Auto Shkolla, librari e shtypshkronja. Njëra nga këto shtëpi botuese "Albas", moti ka heq dorë nga Ministria e Kulturës për ndihmë materiale.

O Imzot, Katundin e Madh me gjithë këta "shkrimtarë, poetë e doktorë të shkencave", po e mbulon pamëshirë bërlloku. Kohë qorre kjo, kur sot më së shumti kemi nevojë për tollumbaxhinj e barinj të deleve, sesa për doktorë shkence e shkrimtarë…

DASMAT POLITIKE

Moti e kam thënë: Manifestimet kulturore si shënime historike ose Akademi përkujtimore, janë politizuar nga partizanët e partive politike deri në palcë. E them këtë me plot gojën, shkaku se: Që, nga fillimi kam qenë bashkëthemelues i disa manifestime kulturore të asaj kohe me shokë. Ditët më të vështira të jetës sime, kur për një "gabim" të vogël politik, shkoje si qeni në rrush. Kohë, kur i organizonim këto veprime të "rrezikshme" edhe nëpër katunde malore, thirrnim sa për sy e faqe për të mbuluar veten nga Qoftëlargu, t'i fusim në lojë e të fotografohen para kamerave televizive edhe individë të dyshimtë me dosje policore komuniste - kriminalistike. Vetëm e vetëm, që të hapnim derën e mbyllyr me shtatë dryna për kulturën shqiptare. Tinëz t'u shpëtonim përcjelljeve të tyre në çdo hap nateditë pa asnjë ferrë në këmbë.

E të mos flasim për gjemba rruge (spiunë), të cilët sot nderohen edhe me çmime nga organizatorët (politikanët) e këtyre manifestimeve pa derdhur pikë djerse deri më sot për kulturën dhe popullin shqiptar. Mos them, "patriotë kuqezi" që për kulturën shqiptare nuk kanë dhënë deri më sot, as edhe një kafe. Larg qoftë se, bëjmë

gjumë të rehatshëm nga këta dudumë në mesin e librave. Shkaku se, paraqiten rrufjanët në telefon t'i ndërrojnë dy-tri fjalë me ty si shkrimtar dhe duan të blejnë "pula". E ti u përgjigjesh, se: shet gjela. Bashkëpiseduesi anonim nervozohet: a, ti tallesh me mua si tregtar? Jo, i përgjigjesh: ti tallesh me veten si "blerës i pulave". E kam shënuar numrin tënd, por kam harruar ta shënoj emrin, me çfarë profesioni merreni ju, zotëri? Thashë: me atë të gjelave. E ti me çfarë profesioni merresh tezgaxhi? Përgjigjet Këlyshi me zgjebe: Mirë, që nuk e di profesionin tim në këtë Shtet. Megjithatë, vazhdo të tallesh ti si shkrimtar, do ta shohësh më vonë një ditë, dardhës kur do t'i dalë bishti. Ëhë, tashti i them: dolëm te profesioni yt si "artist i popullit". Ditën e mirë, "Blerës i pulave"!

Fatkeqësisht, shqiptarët në Ditën e Sotshme (2014), përsëri kthehen nëpër fise dhe katunde. Përmëtepër, në atë kohë kanë folur e shkruar në gjuhën e perspektivës të Njerkës dhe janë deklaruar nëpër intervista të gazetarëve si melezë të "vëllazërim – bashkimit". Gjuhën shqipe e kanë mësuar pas ndryshimeve "demokratike" (1990) për interesa personale e materiale. Veten e kanë shitur te Pazari grave dje, e shesin sot, kush do t'u besojë se nuk do ta shesin edhe nesër?! Shenjat e nisjes i keni në sipërfaqe: Debati, që u mbajtë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, rreth

zgjedhjeve presidenciale dhe kandidatit për president. Habia, në atë tribunë pa fije turpi merrnin pjesë përveç të tjerëve edhe Lubomir Përçkovski, ish kandidat konsensual për president si ish dhëndër i shqiptarëve, i cili tha para disa viteve për Universitetin e Tetovës se, lindi:"foshnjë e vdekur", krah për krahu me mikun e tij, Kim Mehmeti (analistin politik), që në atë debat i doli zot vëllait, tha: "Maqedonisë i duhet një president i tipit të Hamdi Bajramit - deputetit rom, që nuk i urren as shqiptarët as maqedonasit që s'ka dilema të shkojë tek cili do në dasëm, hyn pa komplekse edhe në xhami edhe në kishë, unë kështu e kuptoj këtë president që do jetë i natyrës i pranueshëm për të gjithë', theksoi analisti dhe publicisti Kim Memeti. Punemadhe, që shqiptarët në kohën e komunizmit e kanë pasur presidentin shqiptar edhe të Jugosllavisë (Sinan Hasani), pse sot kënaqen me një president të IRJ të Maqedonisë rom, është rast studimi si fenomen shqiptar?! Inati të vjen, të plasësh jo nga barku, po nga kurrizi me këto kalorës të arratisur, siç thotë populli, që me vite i ngatërrohen nëpër këmbë popullit shqiptar. Përsëri, vetë populli thotë: atë që ia bën dikushi vetes, kurrë nuk mund të ta bëjë armiku. Tjetër punë është ajo se, në atë system komunist, ne nuk na ndihmonte shteti i "përbashkët", po na ndiqte këmba – këmbës dhe na luftonte me gjithë arsenalin e tij policor e

ushtarak edhe maleve. Mos them se, në atë kohë kanë qenë më të arrira si organizime kulturore për nga patriotizmi me vlerta artistike, sesa sot plot zhurmë kulturore në mes të Shkupit.

Metodat e përndjekjeve policore të personaliteteve shqiptare, sot nuk kanë ndryshuar shumë nga ajo kohë e egër komuniste. Dallimi: në atë kohë na ndiqnin "vëllezërit" maqedonas, e sot na ndjekin "patriotët" shqiptar. Sot, shteti manifestimet e këtilla kulturore i ndihmon sa për

sy e faqe edhe me restaurimin e shtëpive të kulturës ku ta fusim kokën, edhe me mjete materiale sa për sye e faqe, por fatkeqësisht nuk i kemi ato vlera të arrira artistike dhe djema të zjarrtë me taban kombëtar, të cilët në atë kohë nuk i mbyste politika ditore e partive politike. Fatkeqësia, që këto manifestime të politizuara deri në palcë, hë për hë sot u duhen vetëm partive politike në pushtet për t'i mbuluar dështimet e tyre politike. Përmëtepër, puna e këtyre manifestimeve "kulturore", është si ajo puna e përrallës popullore me dhelprën dinake kur bie në përrua, që i thotë ujkut: lësho "rrënjën" dhe kapu për këmbe të mos biesh bythekrye në greminë.

U lumtë, burra të mejdanit, më duket se na thonë edhe sot e kësaj dite "vëllezërit" e Njerkës: Përditë, sa të mundeni themeloni parti politike shqiptare, sidomos të këtij sojit të fundit duke e ngritur lugat PPD –në, që të na pjellë edhe dy binjake me të njëjtin emër. E kënaqi skenën politike shqiptare në kohën e vet kur na erdhi si Nuse pa koçi. Pasmenate, ku ta dimë ne me cilin Kazanovë i polli PDSH-në dhe BDI-në dhe për një kohë mbeti shterpë, nuk polli më viça të palëpi në grazhd të Lopës. Rrenë është ajo se, në Tetovë këto ditë i polli edhe dy viça të palëpi binjak. Politikanët e këtij soji, ju nuk u kanë munguar as në ish Jugosllavi me postet më të larta politike deri në Beograd. Palletet e Kulturës,

i keni pasur me bollëk më të mirat sipas standardeve evropiane, të mos them edhe më të mira se ne "vëllezërit". Vetëm udhëheqsit dhe drejtorët shqiptar të "ndershëm" jua kemi emëruar ne, Partia Komuniste. Truri u ka munguar ju shqiptarëve gjithë jetën. Truri. Fatkeqësisht, u mungon edhe sot e kësaj dite. Asgjë, nuk ka ndryshuar shumë nga ajo kohë qorre, edhe në Ditën e sotshme, përsëri me argatët tuaj në Qeveri, ne ua emërojmë partizanët e partive politike që duhet t'u prinë për në liri. Punemadhe, që nuk kanë aftësi profesionale, e rëndësishmja janë të dëgjueshëm dhe përshtatshëm për "vëllazërim-bashkim" në shtetin e "përbashkët".

Përçudi, gjatë ndryshimeve "demokratike" manifestimet e këtilla kulturore, që nuk mund t'i shuante dje sistemi socialist, sot i ngulfasin partitë politike "demokratike" shqiptare dhe na i rrëmbyen nga duart partizanët e tyre posa erdhën në pushtet. Ani, ndashtë. Mirë, që e vazhdojnë traditën e atyre "nacionalistëve" dhe "irredentistëve" shqiptar. Manifestimet e dikurshme të "rrezikshme" për shtetin (Njerkën), sot të marrin lirisht frymë nëpër përvjetore e Akademi përkujtimore. Vetëmse, nuk mund të pajtohem me ta kurrë, kur ua veshin këmbekrye petkun partiak para kamerave televizive. Zjarr e flakë nxjerrin nga goja duke u shtyrë me bërryla,

kush i pari të hipi në binë duke iu sulur mikrofonit. Nuk i lënë të marrin frymë lirshëm, ashtu siç kanë lindur para përndjekjeve të mëdha me "vajet" e Çajupit në djep, në kohën komuniste.

Dorën në zemër, nuk jam kundër tyre, që t'i ndihmojnë sipas mundësive këto manifestime kulturore tradiconale, por jo edhe t'i përvetsojnë dhe politizojnë për qëllime të ngushta personale, familjare, miqësore e partiake. Arsyeja, janë manifestime kulturore që i takojnë mbarë popullit shqiptar dhe jo vetëm një partie politike kudo qoftë ajo dje ose sot në pushtet, këtej ose matanë gardhit. E dini, edhe pse e them këtë: padashtas me veprimet e juaja "atdhetare" ma kujtoni sistemin e egër komunist. Festat e tyre plot lule e fjalë të zjarrta para kamerave televizive. Duartrokitjet frenetike, posa dilnin në skenë ato burra të stolisur me dekorata lufte e lule që ua hidhte populli mbi kokë.

Atdheu shqiptar është i ndarë copë-copë nëpër disa shtete. Fatmirësisht, shqiptarët sot i kanë dy shtete. Nesër, mund të ndodhë t'i kenë edhe tri shtete. Ose, vetëm një shtet të përbashkët historik shqiptar. Nuk i dihet Ditës së Nesërme, a do të na vijë me shi, breshër ose me Diell. Në çdo qytet, këto parti politike shqiptare kanë lëmë katundi për të themeluar manifestime kulturore të dalin në dyluftime partiake duke u rrokur me

njra-tjetrën fytas, masin forcat në arenën politike. Pse jo, edhe ta fotografojnë veten natë e ditë para kamerave televizive për fushatë parazgjedhore lokale e parlamentare. Vetëm, le të mos i përdhosin Datat Historike Shqiptare, që kanë lindur në rrethana të tjera dhe në një kohë tjetër para syve të policisë serbojugosllave. Situata këto të nxehta politike, kur i ndjeri Fadil Bekteshi me një copë buke në dorë dhe dy-tri domate në xhep, i shtinte plot vështirësi rrënjët e këtyre manifestimeve kulturore në mesin e shqiptarëve, që sot pa fije turpi i nëpërkëmbin partizanët e partive tona politike.

Ne kemi qenë edhe në Sërmnovë të Gostivarit, mes përndjekjeve të policisë së asaj kohe. Revistën letrare "Doruntina" pa ndihmën e shtetit të "përbashkët", ua kemi shprëndarë pjesmarrësve para syve të policisë së fshehtë komuniste pa para. Revistë letrare, që sot vazhdon të dalë në dritë edhe me ndihmën e Minsitrisë së Kulturës kur t'u teket trusakatëve pa asnjafarë bagazhi letrar, po fatkeqësisht jo me atë vullnet dhe vlera të arrira artistike si zë kryengritës në atë kohë. Rebelit të kulturës shqiptare (Fadil Bekteshi), sot askush nuk ia përmend as emrin. Përmëkeq, as shokët e tij që i mbante me vete kudo anembanë trojeve etnike shqiptare dhe mezi i bëri shkrimtarë të struken nëpër institucione dhe në Qeveri, të fundosen në

kolltuke të lëkurës me rroga të shtetit e me honorare marramendëse. Vendlindja e tij, të cilën e bëmë së bashku në kohët më të vështira me Klub të Shkrimtarëve Shqiptar, Manifestim Kulturor Tradiconal: Jehona e Karadakut e me revistë letrare (Doruntina), ende heshtë e pagojë para zhurmës kulturore të partive politike. Ende, nuk gjeti kohë dhe hapësirë ta përkujtojë me një portret letrar, Orë letrare poetike, e ku më me ndonjë Akademi përkujtimore në vendlindje. Ose, pagëzojë Klubin e Shkrimtarëve me emrin e tij si themeleues dhe Kryetar.

Shqiptarët, nuk e di pse e kam mendimin se, janë si dhentë e nënkryeme pa çoban: një dele kërcen në ujë, dhe të gjitha të tjerat njëra pas tjetrës bythekrye hidhen në hurdhë. E kam fjalën këtu, për manifestimet kulturore me veshje politike, asaj kohe në Vendlindje, turr pas një kohe me një manifestim të këtillë me të njëjtin emër edhe nëpër disa qytete. Shoqata të ndryshme në Zvicër e Gjermani… Secili kryetar komune, secili patriot në qytetin e vet ku jeton ose punon, sot organizon nga një manifestim kulturor- politik dhe e reklamon veten para kamerave televizive si patriot krah për krahu me zonjat e rënda kuqezi. Dhe, secila parti, kur vjen në pushtet, ose pas zgjedhjeve lokale e fiton ndonjë komunë ia shton këtij manifestimi edhe heronjtë e vetë familjarë e partiak. Populli shqiptar u mbushë plot heronj

familjar, farefisi e partiak, prandaj edhe është në këtë gjendje i përçarë pikë e pesë nëpër parti politike duke shpallur republika shqiptare edhe nëpër katunde. Dalldisje folklorike shqiptare fundekrye, që nga mbrëmja deri në mëngjes me këmgë e valle patriotike duke e derdhur gjakun deri në gju e vra shkaun me çifteli. Homazhe euforike duke u bërë dëshmorëve në Gostivar, Kërçovë, Tetovë e nëpër Kosovë për të mos i lënë të qetë as mes varreve.

Kotnasikoti, përdhosin qëllimin e themelimit të këtyre institucioneve kulturore dhe manifestimeve të nevojshme për atë kohë qorre. Pavetëdije, nëpërkambin fytyrat historike të popullit shqiptar. Nuk kërkojnë rrugë të tjera mes fushës dhe malit, dhiare të hipin në Baba Tomor. Malin e Perëndive. Ndonjë dele, pse edhe të mos kërcejë në përrua. Ose, në livadh, mes luleve. Buçës së Katundit, gjithmonë i kanë shkuar përmbrapa mos i bie udhës. E them këtë mendim nga përvoja jetësore: një shqiptar të hapi një dyqan me perime, pompë benzini, vetëshërbim… Menjëherë, të nesërmen përkrah tij kanë mbirë si këpurdhat pas shiut, po të njëjtët dyqane me prodhime të njëjta tregtare e bujqësore. Në vend, që pranë tyre të lind një fabrikë, hotel, Shtëpi Kulture, Teatër Shqiptar.

I njëjti veprim ndodhë sot edhe me institucionet kulturore shqiptare: shqiptarët nuk

duan të themelojnë diçka të re në mesin e tyre ku jetojnë si banorë me shekuj, por përpiqen t'i imitojnë "vëllezërit" ose vjedhin njëri - tjetrin në ide dhe veprime "patriotike". Turr festiv bëjnë në të katër anët e Atdheut. Edhe pse, herët është themeluar ndonjë manifestim tradicional kulturor, kohë kur pas disa viteve shqiptarët nisin në çdo qytet të themelojnë nga një manifesim kulturor këmbekrye veshur me rroba politike. Dorën në zemër, vit kur i doli zot si gjithmonë Vendlindja. Përgëzime partizanëve partiak për ndarjen e mirënjohjeve ideologjike familjes dhe farefisit, kujt si ti teket para syve të popullit shqiptar. E, për sa u përket disa qyteteve shqiptar, nuk e di pse sivjet në këto organizime nuk u përmend Skenderbeu, kur gjatë gjithë këtyre viteve ai ka qenë tabani kryesor kombëtar i këtij manifestimi kulturor që i mori dëshmorët e kombit si Nëna fëmijët nën sjetullat historike. Përjashtim, bëri Shkupi Dardan me iniciativë të një Shoqate joqevritare "Zgjohu", ku u mbëlodhën dhjetra politikanë vetëm të një partie politike dhe dy-tre intelektualë të arratisur të rastit duke vënë kurora të luleve para këmbëve të kalit të Skënderbeut, në Bit - Pazar. Duartrokitje. Mos them: një shënim historik shumë i zbehtë për heroin tonë legjendar kombëtar Skënderbeu, përkarshi dasmave politike për dëshmoët e kombit të familjes, farefisit e Partisë politike. Manifestimeve të politizuara deri

në palcë, kësaj radhe u mbajtën në Gjilan, Gostivar, Gjermani, Zvicër e nëpër Kosovë.

Rrezik i madh ky, për një popull historik me gjithë këto parti politike, që sa herë vijnë në pushtet merren me vetëveten se: çdo gjë ka filluar me ta si politikanë dhe ka përfunduar me "bashkimin e trojeve shqiptare" në një Shtet Shqiptar. Paralajmërim teknefes i Partisë Socialiste të Edi Ramës për "Rilindje" kombëtare. Qëllim patriotik të improvizuar, që mezi e "realizuan" me Thaçin në një takim të përbashkët të dy qeverive shqiptare përpara Shtëpisë historike të Lidhjes së Prizrenit. Nuk do të merrem këtu dhe humbë kohë me devijimin e lumit Radika, Arusha është ende në thes pas dere në stilin e Kalit të Trojës. Projektin, a e ka aprovuar Qeveria e Maqedonisë dhe, a e ka ndihmuar Banaka Botërore. E, as me qeverinë e Ramës, që një projekt të këtillë a e ka nëpër dorë mbi tavolinë. Mjerimi, gjithë jetën u morën me provokime politike, që pala tjetër ua hudhë në mes të lëmës për t'i realizuar pa pengesa projektet e tyre historike.

Vallë, mos Historia Shqiptare nis me partitë politike shqiptare sot për sot në pushtet?! Përmëkeq, me ndihmën e partive politike në skenë t'i rrënojnë ato institucione "ilegale" historike të themluara edhe me gjak në ato kohë të vështira, kur zjarr na digjej mbi krye, e sot jemi

të detyrurar këto manifestimet kulturore t'ua lëmë në duar t'i nëpërkambin partizanët e partive politike. Përshtypje përpiqen të lënë, se: Historia Shqiptare ka filluar me ta si "rilindasë" dhe do të përfundojë me ta një ditë si "fitimtarë" në histori. Sot për sot, pikëpyetje e madhe?!

Porosia: Në këto dalldisje përkujtimore, nuk mund të lëmë anësh pa përmendur realitetin e ditëve tona, që na është ulur këmbëkryq në sofër. Përvojën e aspekteve që dalin nga Epoka e Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti - Skëndërbeu. Asnjëherë më shumë se sot, nuk është paraqitur nevoja për një pajtim të politikës shqiptare, që mjerisht është ndarë e përçarë edhe nëpër katunde. Koha është, që sa më parë të arrihet një pajtim i Lidershipit shqiptar në të gjitha trojet etnike, ashtu siç ka bërë dikur i madhi Skëndërbe. Rilindasit tanë me penë e pushkë. Fjalën, këtu nuk e kam për "Rilindasët" e sotshëm, që u takuan para kamerave televizive, në Prizren. Populli që ka themele lirie gjakun e heronjve kombëtar, ka ardhmëri të sigurt në liri Ditën e Nesërme. Burrat e gratë e Atdheut që niseshin në luftë me këngë: "se me vdek për atdhe, është njësoj sikur me le", nuk ka fuqi në botë që mund t'ua vrasë dëshirën dhe qëllimin e Bashkimit Kombëtar.

Kushtrimi i tyre ishte: Gjithmonë të bashkuar rreth flamurit për liri e bashkim

kombëtar. Ne sot, na mbetet të punojmë nateditë pa u ndal në jetësimin e amanetit të atyre burrave të penës e pushkës. Ne sot, më shumë se kurrë, duhet jetësuar unitetin kombëtar, se vetëm të bashkuar dhe të pathyeshëm mundemi të mbijetojmë katrahurën e zhbërjes kombëtare nga egërsira e armiqve tanë të pangopshëm, që po zgjatë me shekuj.

Veprimet pa krye, që nuk na shpien larg, në ardhmëri t'ia lëmë histirisë. Akademitë përkujtimore të shndërruara në festa dasmash politike me këngë e valle deri në agim. Zënkat partiake mes vete se, cili është më patriot se shoku. Garat fisnore se, cila familje do të shpallë më së shumti dëshmorë e heronj pas lufte.

Ditën e Nesërme e kemi te pragu i Shtëpisë. Derë tjetër, nuk kemi për dalje pas Shtëpisë, të ikim malit. Moti ka vdekur koha e kaçakve kur hynin nga oxhaku. Tashti, nuk kemi as Derë të madhe. Portat i kemi harruar në Katund. E për sa u përket Portave Triumfale e kemi një në Shkup, por ajo është e Gruevskit. Nëna, ende pa dalë drita nuk na e ndez zjarrin. Babai me mauzerrin krahut rrëzë Çukës, nuk ka dalë në mal, po mes varreve. Koçia na është thyer në rrugë. Krushqit me atë këngën e mirënjohur popullore: *Hajdeni, bini djemt e Shalës, përmes Sarajeve të Pashës*, erdhën pa Nuse. Rrugë tjetër duhet gjetur koçisë. Patjetër, kokës t'i biem me të dyja duart me

grushta: O shqiptarë, mos e shihni veten vetëm para kamerave televizive dhe t'u gëzoheni rrahjeve të krahëve para kamerave televizive nga armiku shekullor (shpallin "hero"), lakmoni rrokullisjen "artistike" të Arushës me dajre nëpër Lëmë.

Thirrja historike: Dalja në rrugë pas Çuke, për në Baba Tomor. Nëse na e kanë mbyllur derën, ta hapim dritaren. Fundi i fundit, po të jetë nevoja edhe nga oxhaku. Manifestimet kulturore le të vazhdojnë të shënohen në Vendlindje, atje edhe ku u themeluan për herë të parë si data historike përkujtimore të Skënderbeut dhe dëshmorëve të Atdheut. Edhe atë, pa ngjyra partiake të partive politike shqiptare. Historikisht, duke u pri Skënderbeu në ballë, strategu i luftërave historike pa qëllimet e errta politike partiake për ta nxjerrë veten në sipërfaqe disa politikanë si "shpëtimtarë" të Kombit. Shkaku se, dihet vendi i tyre ku mund ta tregojnë veten si patriotë në politikë me punë e jo duke u fotografuar nateditë para kamerave televizive nëpër manifestime kulturore.

Pragu i Shtëpisë, o burra: Patjetër, duhet pastruar nga kërrocat politike, që me vite na ngatërrohen nëpër këmbë. E kam thënë dhe e përsëris në këtë shkrim: pa i hequr kërrocat politike, kurrë nuk do t'i shkulim ferrat para dere!…

IV LUFTË E ASHPËR POLITIKE PËR PUSHTET ARGATI

PARANOIKU

Skizofrenia si sëmundje "kriza" e shoqërisë moderne, shërohet me vite. Zakonisht, manifestohet me halucinacione akustike, deluzione paranoike. Çrregullim mental, i cili karakterizohet me shkatrrim të procesit mendor dhe përgjigjes emocionale. Deluzionet e madhështisë paraqiten kur ti mendon se je shumë i veçantë, apo ke fuqi e aftësi të veçanta. Paranoiku dëgjon gjëra që të tjerët nuk i dëgjojnë, sheh gjëra që të tjerët nuk i shohin, nuhat gjëra që të tjerët nuk i nuhasin, ndjen diçka që po ia prek lëkurën, pa e prekur fare, shijon diçka që nuk është aty në sofër. E përjeton veten si i huaj, një tjetër njeri, të cilit i mungon aftësia e vënjes të kufirit midis Un –it (vetes) dhe të tjerëve në ambientin rrethues të shoqërisë. Shkaku çrregullimit të të menduarit, i cili ka halucinacione pamore, dhe sidomos dëgjimore: dëgjon zëra, fjali të tëra me përmbajtje të këqia ose të mira të cilat beson se i vijnë nga jashtë për qëllime të caktuara patriotike.

Fatkeqësisht, shqiptarët siç duket këtë sëmundje serioze të shekullit, duan ta heqin qafe brenda një dite. Gabim i madh histroik. Konkurencë shkencore sot për sot i bënë vetëm Facebook. Amerika këto ditë ka zbuluar një bar të ri për shërimin e sëmundjes së shekullit: Facebook. Shërimi nga kjo sëmundje e rrezikshme që e ka pushtuar botën, të cilën shkenctarët e krahasojnë me drogën, hiç më pak kushton rreth katërmbëdhjetë mijë dollarë. Punë tjetër është ajo se, personazhi im Rradakja, nuk vuan nga kjo sëmundje e pashërueshme, po nga paranoja, një sëmundje tjetër e rrezikshme patologjike. Fatkeqësi e shekullit, që sot për sot ende nuk ka ilaç. Prandaj, edhe nateditë rrinë në internet, u ka vënë pusi shkrimeve të mia me komente teknefese. Mirë, do te thoni ju, po nuk di të bëjë punë tjetër si Rradake Bostani?! Jo. Paranoiku ka mëkate mbi samarë që nga koha komuniste, sistem i egër monist që i la edhe pasoja, kur sa herë që ia bënin me gisht argatët e "Vetëshërbimit" në gazetën e "vëllazërim - bashkimit", ai na ndërseheshte me të katra pas shpine. Vite më vonë, Paranoiku me "fajin" tim si kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptar do të na përvidhet edhe në Manifestimin Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: "Ditët e Naimit" (1997), në Tetovë. Gjithë kohën, atëherë kur përpiqeshim të ngrihemi më këmbë si institucion,

nga strofulla e Doktorziut që e ndërsente me gisht pas porte, ai do të leh gjithë jetën me një asht në gojë si Këlysh me zgjebe. Përçajë, krijuesit shqiptar dhe do të na ngatërrohet nëpër këmbë vite me radhë si kulturofag i dalldisur shqiptar. Përderisa, një ditë edhe nga atje nuk do ta përzënë me një shqelm bythëve si një bub i zgjebosur katundi.

Profesionin e lehjes pas shpine, nuk e ka harruar edhe sot e kësaj dite. Zoti ia ka dhënë këtë dhunti natyrore, e jo talentin dhe fantazinë për t'u ngjitur majave të larta me borë. Mendja e rren se, nëse i ndërsehesh pas shpine ndonjë të Madhi, atëherë edhe ti vërtetë je i madh në katund. "Guximin" e mori para disa ditëve kur doli me shkrime teknefese për Adem Demaçin dhe Hashim Thaçin. Provokime rrugaçi me shkrime e

komente i bënë edhe autorit të këtij shkrimi. Askushi, mendon se ndonjëri do të ulet me të në një sofër, ulë veten në nivelin e një kalemxhiu të çajtoreve. Dikur, kur e sheh se askush nuk ia varë "kalemin", merr guximin dhe sulet me emër e mbiemër. Pavetëdije se, i gjithë ai mllef shtazarak do t'i kthehet aty për aty bumerang. Nuk shkon as një ditë, dhe kur sheh se askush nuk i pergjigjet, e injorojnë të gjithë ato që e njohin si kalemxhi, delë me një sqarim, se: dikush e keqpërdorë emrin e tij duke shkruar komente. Merreni me mend, njolloset alamet emri, i burrit me brekët mbi pantollona?! Përsëri, tërbohet si i përçartë plot sharje e fyerje, flet jerm duke e zbuluar veten më në fund se, vetë është autori i atyre komenteve teknefese. Përpiqet, gjith fajin t'ia hudhë tjetrit duke futur kokën si struci në zall me bythën për mejdani palare, në diell. Trusakatit, si nuk i shkon mendja se INA i ruan gjith ato E-maile dhe i di me emër e mbiemër autorët e komenteve. Edhe, e ka për obligim për hir të lexuesve t'i publikojë emrat e tyre, kur "fakiri" autorsinë e atyre komenteve pa asnjëfarë argumenti ia mveshë autorit të këtij shkrimi analitik. Përmëtepër, lexuesi e di stilin e autorit për të cilin dyshon kjo Rradake skizofrenike pa asnjë bërthamë. E njeh origjinalitetin e tij larg me qindra kilometra po të shkruajë edhe vetëm një fjalë, e ku më një fjali ose koment.

Ironia e shekullit, edhe sot e kësaj dite pret t'i përgjigjen ata burra, humbin kohë të merren me këtë këlysh me zgjebe, që t'i shërojë komplekset e veta dhe lëvdohet në çajtoren e katundit se, ka polemizuar me të mëdhenjt e Kombit! Terapia ime shëruese: vetes t'i bie sa më parë përmbrapa te ndonjë mjek – psigolog, në psikiatri. Rreziku i kanoset në tru, ka simptome tërbimi. Nuk e kisha kështilluar të shkojë te Hoxha i Allahut pas ndonjë hajmalie. Mjaftë e ka një të tillë me shkronja arabe nën këmishë: Torbën me taxhi për qafe. Koha është për masa serioze parandaluese, t'ia përzënë xhindet. Sëmundjes skizofrenike me kohë t'ia presin rrënjët. Perndryshe, do të sillet rrugëve me kokën nën sjetull, i sëmurë gjithë jetën duke folur vetëmevete nëpër qytet me xhindet.

Edhe, Rradakja e shkretë nateditë me vite vetëm ka lehur pas Ujk Malit. Herë pas porte, e herë i strukur nën ndonjë ferrë si lepur me frikën në bark. Shkaku se, Natyra ia ka falë për ditëlindje dhuratë frikën. Ëndërr e sheh Autorin e këtij shkrimi edhe në gjumë. Nuk e ka lexuar tregimin *Lepuri me pushkë* (1983), kur shkon te burimi të pi ujë dhe zateket ballë për ballë me Ujk Malin. Përpak nga frika t'i shpëtojë në brekë. Shkaku se, pushka do edhe zemër. Mendimi filosofik vlen edhe për penën. Mësim i mirë ky për Rradaken, si ta përdorë dhe kur lapsin.

Letërsia nuk krijohet me frikë. Mjerë ai kalemxhi, që guximin e tij e rrokullisë gjithë jetën në brekët e partive politike. Gjallë e mbajnë veten nën sjetullat partiake, aqsa janë në pushtet partizanët e tyre në Qeveri. Ditën, që ato vdesin nëpër kabinete, me vete i marrin edhe shërbetorët e tyre besnikë me "veprat" sakate arnë përmbi arnë në varr-piramidë si faraonët e Egjyptit. Ruajna Zot, nëse edhe në Ditën e sotshme të mbanë për krahësh në letërsi Doktorziu!

Lufta me penë ende nuk ka përfunduar në fushën e betejës. Ende nuk i kemi përdorur të gjitha armët luftarake. Fishekun e fundit flakë më flakë si tek ajo kënga popullore kërçovare e Sulë Jetimit: *A more vesh, moj e zeza grue/ me Kaloshin jam fjalue/ Tym për tymi n'atë përrue*... Fusha e mejdanit i njeh vetëm trimat. Frikacakët, zakonisht dalin trima pas lufte. Liria e do luftëtarin, thotë Niçe:

Moskokëçarës, përqeshës,
të egër – ashtu na do Urtësia:
ajo është grua
dhe gjithmonë e do vetëm
luftëtarin…

Robëria martohet me frikacakun. Historia, si fis i kaçakëve na njeh me pushkë dhe armët në brez. Edhe me penë. Atëherë, patjetër duhet të

keni durim, të prisni t'i harxhojmë të gjithë fishekët: Përpara mejdanin, sesa armët.

Honxhobonxhot me këmbëngulje përpara mejdanit, na i kërkojnë t'i dorëzojmë armët e luftës. Strategji e tyre paranoike. Letra "dashurie" anonime më shkruajnë nën shkrimet e mia publicistike gjoja si komente. Në vend që të merren me shkrimin, gjithë kohën merren me fizionominë dhe jetën time private si shkrimtar: mjekrën, kësulën, rakinë e rrushit, shtambat me verë. Miken nën Rrap. Vjellin sharje e ofendime të nivelit më të ulët njerëzor. Flamurin "kombëtar kuqezi" në këtë betejë e mbanë Rradakja, që kur tërbohet nën shkrimet e mia, herë delë anonim duke e fshehur veten edhe në dimi të grave, e herë merr guximin edhe me emër e mbiemër. Papritmas, ndonjëherë shkon edhe aq larg në rolin e mjekut sa më shpallë edhe të sëmurë duke vjellë plot epitete: mediokër, psikopatologjik, smirak, hipokrit, djall i Tanzmanisë… I shkreti, ende e rren veten se do t'i përgjigjem këtij niveli të komunikimit, humb kot kohë me shkrimin e komenteve.

Edhe kësaj radhe, le të mos gëzohet, nuk i përgjigjem atij teveqeli, po lexuesve të mi duke jua sjellur lakuriq e pis një fenomen të çuditshëm shqiptar. Fare nuk i shkon mendja se, unë nuk e urrej, por e dua marrëzisht trusakatin. Tek tashti bindem se, ia kam arrirë, qëllimit si shkrimtar.

Rradakja e ka gjetur veten me shokë këmbekrye si "hero" i pulave partizane nëpër shkrime duke u rrokullisur mes dy shtambave me verë. Tjetër punë se, ai është "hallall" e nuk është "haram", nuk e pi verën e as rakinë. Megjithatë, na pajton Xhadia. Ligjërata e Hoxhës Allahut në YooTube, kur thotë, se: "myslimani" mirë nëse në këtë botë i ka dy, ose tri gra, në atë botën tjetër Zoti i jep edhe 92 të tjera si shpërblim, në Xhehnet. Gjithësejtë do t'i ketë, 95 gra në mesin e luleve. Omar Khajami po të ishte gjallë sot dhe ta dëgjonte ligjëratën e këtij Hoxhe, me siguri librit të tij me Rubaira do t'ia shtonte edhe një rubairë të arrirë artistike: *O burra, t'i sulemi "armikut të pabesë*", *pash më pash t'i biem Xhehnetit*!

Vertetë, Rradakja ma kënaqi Lapsin. Zemra, kurrsesi nuk më thotë ta urrej, por ta dua si personazh trim hipur mbi gomar, të cilin e tërheq për kërpeshi te Pazari Grave Hojdodolja. Dyert e fantazisë, pasmesnate m'i hap krah më krah. Dorën në zemër, "flijimet e tia artistike" për një torbë taxhi, vërtetë më bënë shkrimtar. Krah për krahu me Hojdodolen si trima pas lufte duke i shti edhe nëpër libra, në bibliotekë.

Dhe, Rradaken teknefese, nuk e vrava unë me penë, po ai vrau veten me "plumba" dumdumë mes komenteve teknefese…

PATRIOTI I KANDARIT TË ÇAJUPIT

Vevçani vazhdon ende të tallet me Strugën dhe IRJ të Maqedonisë. Moti e ka shpallë veten si Republika e Vevçanit. Portë Triumfale, nuk ka vetëm Gruevski në Shkup, por edhe Vevçani, në udhëkryqin ku ndahet rruga nga drejtimi për në Dibër dhe Vevçan. Portë Triumfale, që ta bënë me dije se: pas shpalljes së Republikës Vevçanit, së shpejti do të përcaktohen edhe kufinjt politik si shtet më vete, edhe siç duket para IRJ të Maqedonisë do të shkojë në Europë. Pyetje tjetër është ajo se, sa do të jetojë gjatë duke marrë "yrnek" Republikën e Krushevës. Sinjalistikën – udhëtreguesit, i kanë vendosur në aksin rrugor Strugë – Dibër në tri gjuhë: maqedonisht, anglisht dhe shqip.

Udhërrëfyesi i Patriotit të Kandarit të Çajaupit, të cilit mund t'ia "shash" të gjitha me rend me emër e mbiemër, por jo edhe Lopën e Katundit. Dashnoren e Koperativës Bujqësore, që gjatë "ndryshimeve demokratike" na polli vetëm viça të palëpi për zgjedhë, e asnjë mëzat me brirë për të bytry në mes të Livadhit. Dheun me këmbë ta hudhë mbi shpinë. Zgjedhën ta bëj copë-copë në mes arave pas Çuke. Qerren me katër rrota, më

të mos e tërheq si viç i palëpi, që ka lindë në grazhd të Mushkës. Tambël ka pi te Njerka.

Patriotizmi i deputetit të BDI –së, Hajrulla Misini nuk do t'ia ndalë hovin këtij fenomeni shqiptar, që në mes të Athinës i doli zot emrit Kushtetues të Maqedonisë. Përpak, të shkaktojë skandal politik në mes të dy shteteve, po të mos kishte ndërhyrë Ministri i Jashtëm grek, Venizelos. Deputeti i BDI -së Hajrulla Misini, i cili ngriti shumë pluhur në opinion me paraqitjen e tij "bejlere" të "vëllazërim-bashkimit" në Parlamentin grek një ditë më parë, pasi kishte përmendur emrin Kushtetues të atdheut "përbashkët", theksoi se: qëllimi i tij nuk ka qenë t'i lëndojë ndjenjat e kolegëve të tij grek. Megjithatë, Misini sqaroi se fjalimin kishte arritur ta përfundonte vetëm pas ndërhyrjes së Ministrit të Jashtëm grek, Venizelos. Edhe pse, Kryetari ia ka bërë me dije se, "mjafton kaq", Misini ka ngulur këmbë se ka ende kohë, atëherë ndërhyn Ministri i Jashtëm i Greqisë, Venizelos që të vazhdojë me fjalimin deri në përfundim të mendimit.

Mjetet e informacionit në gjuhën maqedonase, posa e dëgjuan "heroizmin" e deputetit të BDI –së, Hajrulla Misini, turr me shkrime duke e shpallur "hero". Vetëmse, Komandant Shpati nuk do të jetë "hero" vetëm i një populli shumicë, po edhe i popullit që e

zgjodhi me vota demokratike, e uli krah për krahu me "vëllezërit" si deputet në Parlament. Syrin ia mëshel Televizionit Nacional Kombëtar ALSAT M, për një intervistë "shpëtimtare" para syve të popullit shqiptar. Dhe, përderisa për veprimin e tij "patriotik" në Greqi, Misini u quajt "hero" nga mediat dhe opinioni maqedonas, deputeti i BDI-së sot ndërmori një akt tjetër, edhe atë të "heroit" historik tek popullata shqiptare. Dallimi nga të gjithë kolegët e tij të BDI-së, Misini refuzoi që deklaratën për ALSAT M ta japë para pano-s në këtë sallë ku mbishkrimi është vetëm në gjuhën maqedonase. Misini tha se këtë e bën në shenjë revolte ndaj kryetarit të Kuvendit maqedonas që nuk e respekton gjuhën shqipe. "Unë nga kjo sallë jam i përjashtuar nga kryetari i parlamentit i cili është penguesi më i madh i zbatimit të dygjuhësisë në Parlament. Kështu që unë ju ftoj për intervistë në zyrën time", u shpreh Hajrulla Misini, deputet i BDI -së. Fat i gazetarëve, që Komandant Shpati nuk i ka ftuar mes maleve, në Karadak.

Kamerat, që për kësi rastesh të porositura nga lartë, i kemi të shkathta në ngjarje, e regjistruan rastin historik dhe e dhanë si "ekskluzive" në lajmet qëndrore satelitore. Duartrokitje, në stilin e asaj këngës popullore, alla Mic Sokolçe: *Gjithë shqiptarët janë Mic Sokola.* Dhe, përgjigja e poetit disident Qerim

Arifi në atë kohë para gazetarëve të Zërit të Rinisë, në Prishtinë: Nëse, edhe Kryeredaktori im, Mustafa Rushiti është Mic Sokol, atëherë unë nuk jam shqiptar. Realitet i hidhur ky, që populli shqiptar, me vite e bën jetën e peshkut në hurdhë, mashtrohet edhe vetëm me një krimb në grep. Punemadhe, që pastaj përpëlitet në zall, në mes të vapës madhe. Ditën festive, përfundon në tigan dhe në sofër para politikanëve duke ngritur dolli për "fitore me çaj" rusi. Njëzetë vjet e sa, ëndrron të hajë bar, por gjithë jetën partitë politike shqiptare i qesin në grazhd vetëm kashtë. Interesant, e gëlltiti lajmin si vepër patriotike. Hajrulla Misini u shpallë "hero" nga të dy popujt "vëllezër" të shtetit të përbashkët "demokretik".

Çmenduria e Vevçanit, para disa ditëve filloi me muzikë dhe aktivitete intersante për vizituesit e të gjitha moshave me qëllim që të ndjejnë shpirtin e "Vasilikës" dhe të jenë pjesë e madhe e ngjarjes së karnevalit. Intersante ishte tribuna e identitetit maqedonas: "Në mbrojtje të emrit maqedonas dhe identitetit maqedonas", ku debatues ishin emra të njohur të skenës politike. Vetëm se, edhe më interesant do të ishte Patrioti i Kandarit të Çajupit (Viçi i palëpi), krah për krahu me Hajrullah Misinin si hero i dyfisht, i shpallur nga të dy popujt "vëllezër" shumicë, po të kishte ndodhur pak më herët, para Karnevaleve të Vevçanit. Me siguri, do ta kishte tejkaluar Bariun e

Sharrit Plak, Farizin me gunën e ogiçit krahëve, hipur mbi xhip mes flamurit amerikan e atij shqiptar kuqezi duke i pri kopesë së deleve të Sharrit Plak përmes Republikës së Vevçanit.

Bariu me kërlug mbi xhip, udhëton përmes "Republikës Vevçanit" me gjithë Kopenë e deleve për në Europë…

Mirë do të ishte në këtë karneval ta thirrnin si mysafir edhe Ali Ahmetin e maskur si komandant i UÇK –ës me Nënën Shqiptare për dore, në Zajaz. Shpëtimtarin e vetëm të IRJ të Maqedonisë. Gazetarët e Oborrit duke e ndjekur përmbrapa, si dhelpra dinake dashin me këmbonë, mos i bien udhës. Ose, Musa Xhaferin, Zv/kryeministrin e Maqedonisë për implementimin e plotë të Marrëveshjes së Ohrit, deputetët dhe ministrat shqiptar që me çekiç të këpucëve para kamerave televizive i sulen Car Dushanit mbi "Urën e civilizimeve" krah për krahu me aktivistët e dalldisur partiak në Qeveri.

Kohë kjo, kur Qeveria e IRJ të Maqedonisë i bashkon ambasadat me Serbinë e Struga heq tabelat e ish Jugosllavisë. Përçudi, partitë politike në pushtet punojnë për rikthimin e Jogosllavisë përmes ambasadave të pëbashkëta nën një çati, Komuna e Strugës filloi me heqjen dhe ndryshimin e tabelave treguese dhe shenjave të komunikacionit, që kanë mbetur në këtë komunë që nga periudha e Ish Jugosllavisë si gozhda e Nastradin Hoxhës në mur, kur e ka shitur shtëpinë.

Shkaku, se: Shenjat e komunikacionit, semaforët dhe disa nga tabelat jofunksionale ishin disa nga gjërat që qytetarëve struganë ua përkujtonin ish sistemin komunist. Edhe pse, që nga viti 1991 IRJ e Maqedonisë fitoi pavarësinë e saj nga ish federata Jugosllave, deri në ditët e sotme ende ekzistojnë shenja komunikacioni të

shkruara në gjuhën maqedonase dhe atë sërbo-kroate, të "harruara" në vend prej më shumë se dy dekadash. Shenja të tilla ka pasur dhe ka ende në të gjithë territorin e IRJ të Maqedonisë.

Dhe, me vendim të kryetarit të komunës së Strugës, Ziadin Sela, ditëve të fundit janë larguar të gjitha shenjat, shtyllat, semaforët jofunksionalë dhe të vjetëruar si dhe tabela të ndryshme, të cilat qytetarëve të Strugës e sidomos qytetarëve shqiptar i'u përkujtonin një periudhë të hidhur kohore të egër komuniste. Këto shenja përveç se pengonin dhe cënonin ndjenjat e qytetarëve të Strugës, poashtu vënia e tyre nëpër vende të papërshtatshme pengonte edhe qarkullimin e qytetarëve nëpër trotuaret e qytetit, theksoi shërbimi për informim i kësaj komune.

Në këtë rajon ishin të pranishme edhe tabela treguese që akoma njihnin shtetin shqiptar si Republika Popullore e Shqipërisë. Poashtu, jo më larg edhe Republikën e Vevçanit ku u mbajtë Karnevali tradiconal i provokimeve nacionale dhe politike. Pjesmarrësit, kur vitin e kaluar si "patriotë", në baza fetare i fyen myslimanët duke i krahasuar me Kandarin e Çajupit.

Festivali i radhës, u mbajtë me mbështetjen e Minsitrisë së Kulturës në Republikën e Maqedonisë dhe shumë firmave tregtare. Vevçanasit në mënyrë simbolike e shënuan vitin e kaluar me ngjarjet që atyre më së shumti u kanë

lënë përshtypje nga politika dhe ngjarjet kulturore. Fatkeqësisht, kësaj radhe pa Viçin e palëpi të Koperativës Bujqësore të Katundit (Patriotin e Kandarit të Çajupit), krah për krahu me Heroin e dyfisht të Njerkës.

Karakteristikë e këtij festivali tradicional ishte se, për çdo vjet bënë përpjekeje t'i ofendojnë edhe kësaj radhe shqiptarët. Maskat dhe veprimet ofenduese ndaj shqiptarëve nuk munguan edhe këtë vit në Festivalin e karnevaleve të Republikës së Vevçanit. Megjithatë, kulminacionin artistik do ta arrinin me Patriotin e Kandarit të Çajupit dhe Heroin e dyfishtë të shpallur nga të dy palët "konfrontuese" në Parlament, që Ali Ahmeti mezi është duke i bërë Shtet "demokratik" në mes të Ballkanit. Portën Triumfale të Gruevskit, në Shkup ua ka hapur krah më krah si popuj të "barabartë" me shqiptarët përmes vijës ajrore me aeroplan t'i shpie në Evropë…

KOHA ËSHTË SI "VËLLEZËR" T'I DALIM ZOT SHTËPISË

Vite më parë në Strugë (1997), në një Akademi përkujtimore për Mehmadali Hoxhën, organizuar nga Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptar, ku merrnin pjesë shkrimtarë nga të gjitha trojet etnike shqiptare, humoristi nga Shqipëria Niko Nikolla në bisedë e sipër në një tavolinë miqësie tha: nuk ka popull shqiptar, po ka popull shkrimtar.



Kohën e fundit habitem me shqiptarët, nuk qëndron ajo thënia e Niko Nikollës se, jemi popull shkrimtar. Mehmedali Hoxha, edhe sot e

kësaj dite nuk ka një përmendore mbi "Urën e civilizimeve" në Shkup, krah për krahu me shokët e tij të penës me më pak merita luftarake e letrare. Ballë për ballë t'i rri Car Dushanit, si vizionar me shishen e konjakut "Skënderbeu" në dorë: Koha do të vijë një ditë, kur ju "vëllezërit" e mi do t'i fshini rrugët e Tiranës. Parashikimin e tij të asaj kohe, sot e kemi këmbëkryq para dere. Babai i revistave për fëmijë: "*Gëzimi*" dhe "*Fatosi*", sot ndiqet mes varreve edhe më zi se në kohën komuniste. Edhe atë, nga shokët e tij të penës që dikur i mori nga rruga në redaksi duke i bërë gazetarë e shkrimtarë. Tekefundit, edhe ku të ishte e vërtetë ajo thënie historike e Niko Nikollës se, jemi popull shkrimtar. Fatkeqësisht, sipas listave të publikuara në mjetetet e informacionit, po dalim popull "spiun". Faqe të tëra të gazetave, pas Pavarësisë së Kosovës u mbushën me emra të spiunëve dhe pyetje marramendëse policore: pesëqind e sa në numër. Pyetje banale, që vështirë se ta mbushin mendjen se janë reale në Ditën e sotshme historike. Fajin kolektiv si shqiptarët më, gjatë një dite e shpallim hero e brenda një nate tradhtar, ia mveshim dështimet vetëm një personi. Gurë e dru mbi të si "tradhtar" e. "spiun" i Serbisë. Punemadhe, që deri dje i këndonim për së gjalli këngë me çifteli. Realitet, që flet ndryshe me fakte: Personi i sulmuar ka kryesi, ministra, deputetë e këshilltarë. Qesharake, vetë me duart

tona ia japim votën e lirë demokratike dhe pushtetin rresht disa mandate. Spiunët shqiptar nuk duhet futur të gjithë në një thes. Edhe pse, dikushit si ujk i ka pasur hije të jetë "spiun", por jo edhe këlyshëve me zgjebe gjithë jetën duke u përjagur rrugëve të Bit – Pazarit me një asht në gojë.

Akuzat e pabaza jashta institucionale në shpalljen e spiunëve po na e zënë frymën. I hurit e litarit, shkon aq larg sa që e shpallë spiun edhe Adem Demaçin. Burrin, që për Çështjen shqiptare i hëngri hiç më pak se 29 vjet burg, në Goli Otok. Presidentin e parë të Republikës së Kosovës, Ibrahim Rugovën. Shkrimtarin me famë botërore, Ismail Kadare, Rexhep Qosjen, Hashim Thaçin e Ali Ahmeti që zbritën nga malet. Nuk do t'i shti në këtë vagon politik edhe partizanët e sistemit komunist me poste të larta politike në Prishtinë e Beograd: Fadil Hoxha, Veli Deva, Xhavit Nimani, Sinan Hasani (shkrimtarin e romanit të parë në Kosovë "*Rrushi ka nisë me u pjek*" dhe presidentin e parë shqiptar të Jugosllavisë), Mehmet Maliqi, Xhevdet Hamza, Agim Zatriqi e Azem Vllasi. Popull i çuditshëm jemi ne shqiptarët, ndoshta edhe i vetmi në botë, që në ballë na prinë "spiunët"?! Dhe, jo rastësisht për ne si popull, gjatë pushtimit e kanë thënë gjarmanët: kudo nëpër botë kemi paguar për spiunim shuma të mëdha parash, këtu në vendin e

shqiponjave spiunët qenkan pa para. Popull, që sot kënaqemi edhe me një president kosensual të IRJ të Maqedonisë me më pak se dy miljonë banorë (aqsa ka një lagje e Stambollit), në vend që të ngulim këmbë politike, korkojmë presidenti i Shtetit të "përbashkët" të jetë shqiptar.

Rrufjanët, nuk lanë shqiptar të vdekur e të gjallë pa e shpallur spiun. Tjetër punë është ajo se, këta aktivistë për zgjidhjen e Çështjes shqiptare kanë dosje politike në Beograd, Tiranë, Prishtinë e Shkup. Mos të flasim për shërbimet tjera informative sekrete nëpër botë. Përçudi, sot me shumicë e pakicë spiunë me të madhe shpallin serbët, spiunë shpallin shqiptarët përmes "pëllumbave" të tyre postier duke na i hudhur nëpër oborre e lënë pas dere. Spiunë me qerre në Shqipëri, spiunë në Kosovë, spiunë në IRJ të Maqedonisë. Punë tjetër është ajo se, spiunët e Shqipërisë kanë dallime nga spiunët e Kosovës dhe IRJ të Maqedonisë e Malit të Zi. Shqiptarët e Shqipërisë, edhe nëse kanë qenë spiunë, kanë qenë në shërbim të Shtetit Shqiptar. Por, shqiptarët e Kosovës, IRJ të Maqedonisë dhe Mlit të Zi, në shërbim të cilit shtet kanë qenë si "patriotë" shqiptar?! Djemtë e të cilëve, menjëherë në prag të ndryshimeve demokratike do të turren të themelojnë Paritnë e "vëllazërim-bashkimit", UJDI -n, që ta shpëtojnë Jugosllavinë. Parti politike e cila në Kosovë nuk

do të ketë jetë të gjatë, përballë LDK –ës me në krye Ibrahim Rugovën. Edhe pse, në këtë parti politike Serbia do të arrijë t'i shti elemenetet e veta të UDB -ës jugosllave. Argatë shqiptar të shkolluar e stërvitur mirë në Beograd, Shkup e Prishtinë, që më vonë kokëulur do të tërhiqen pas sulmeve të dështuara ndaj Ibrahim Rugovës. Populli shqiptar i di mirë këto emra në Kryesinë e LDK –ës, që vite më vonë me veprimet e tyre antishqiptare do të dalin si kunguj mbi ujë, në sipërfaqe. Dhëndri, njeriu nr. 2 pas Ibrahim Rugovës, që sa herë Presidenti i Kosovës shkonte në Shqipëri për takime miqësore politike, do ta strehonte në "besë" në Shkup te një familje e njohur UDB –ashe dibrane për ta përcjellur të nesërmen në Shqipëri. Familje, të cilën më vonë përmes kamerave televizive, pas Luftës së 2001 –shit, Dhëndri në një emison dokumentar televiziv të MTV (Redaksia në gjuhën shqipe) ia paraqiste opinionit shqiptar si familje patriotike që e ka strehuar Ibrahim Rugovën sa herë që ka shkuar me punë zyrtare në Shqipëri. Merita propaganduese për "flijimeve patriotike" në LDK, pas të cilave do të përfundojë si "hero" lufte në Kabinetin e Kiro Gligorovit.

Shqiptarët janë të radhitur në vendin e tretë si spiunë dhe bashkëpuntorë të shërbimit sekret të UDB –ës jugosllave gjatë periudhës së socializmit, sipas një shkrimi të së përditshmes

maqedonase "Dnevnik". Radhiten qafë për qafe në vendin e tretë pas serbëve dhe kroatëve të ish – Jogosllavisë. Faktin e ndërlidhin me të dhënat e fundit të Komisionit Lustrues në IRJ të Maqedonisë, ku nga 23 funksionerët e lustruar, tetë prej tyre kanë dalë shqiptarë.

Populli shqiptar, sot për sot është popull i mbetur në gjysëm të rrugës, pa shoqëri përparimtare, gazetarë të "stërvitur" nëpër Universitete të Qendrave Sekrete Informative dhe Shqipëri Etnike. Anë e kënd botës turren se, kush do të shpallë më shumë spiunë në mesin e popullit shqiptar. Nuk e them se ky popull nuk ka pasur spiunë, nuk ka dhe nuk do të ketë edhe në të ardhmen si e gjithë bota përparimtare Por, e ngrej zërin: jo aq thellë deri në palcë, siç përpiqen ta shpallin disa qarqe të errëta antishqiptare.

Puna e gazetarit nuk është e lehtë, e shtruar me lule. I duhet aftësi dhe punë intelektuale, të shoh larg edhe pas kodre. Interesant, punën e spiunit që në atë kohë e bënin individë profesionist të shkolluar nëpër qendra sekrete të ish Jugosllavisë, sot e bëjnë gazetarë me diploma universitare të partive politike. Fatkeqësia, emërimi i tyre nëpër Komisione Lustrues e punësuar nëpër institucione të shtetit e partive politike si argatë të huaj, të cilët me të madhe kohën e fundit na i rehabilitojnë spiunët e vërtetë

nga "spiunët" e shpallur pas lufte, janë për studim shkencor nëpër Universitetet botërore.

Askushi, sot merr guximin dhe të shpallë spiun, që ti si familje e ke përjetuar në kohë të egër atë spiunim të paparë komunist. Edhe atë, në Kërçovë, Shkup, Prishtinë dhe përsëri në Shkup. Individë të përshtatshëm, që në atë kohë punonin nëpër redaksi e institucione të Shtetit si "shqiptarë të ndershëm", e ti ishe i detyruar të punosh si mësues nëpër male, sot të shpallin "spiun" pa pasur në dorë asnjëfarë dokumneti të nënshkruar nga dora yte, së paku edhe për një vend pune. Pse?! Shkaku se, në atë kohë, kur ato ishin më shumë spiunë, sesa: gazetarë, shkrimtarë e intelektualë, ti refuzoje me çdo kusht ta pranosh si bashkëpuntor i sigurimit policor, postin e redaktorit të revistës për fëmijë "*Fatosi*", në "*Flakën e Vëllazërimit*", në Shkup. Ende, edhe sot e kësaj dite nuk mund ta harrosh "bisedën informative" në polici: ti je i dërguar nga Kosova që të veprosh në këto anë. Përmëtepër, ti je kryesori (i madhi), ti ke ndejtur në "Menada" me një "irredentist" të rrezikshëm, i cili me një këmbë të thyer na ka ikur nga burgu. Përfundimi i "bisedës informative": ti Çështjen shqiptare do ta zgjidhësh me luftë.

Inspektori maqedonas, pas gjithë këtyre pyetjeve provokative edhe të thotë: a, do ta shohësh akuzën kundër teje me njëzetë

nënshkrime? Jo, i përgjigjesh me buzëqeshje. I marr me mend se kush janë ato "burra" me brekët mbi pantollona. "Patriotë" shqiptar me vende pune nëpër redaksi komuniste të "vëllazërim-bashkimit" dhe kabinete të Qeverisë. "Intelaktualë" të shitur me një torbë taxhi për qafe ose një banesë të shtetit, që i tremben punësimit tim si krijues në atë redaksi policore.

Përderisa, ti ngjitesh maleve në punë Dimër e Pranverë, jo për bukën e gojës, por për qëllime të tjera personale "artistike", partizanët e "vëllazërim – bashkimit" të ndjekin nëpër redaksi si shkrimtar i një familje nacionaliste balliste. Herë pas here, edhe të suleshin me shkrime mes atyre faqeve të asaj gazete me ideologji komuniste. Shkrimet e tyre me emra e mbiemra dhe pseudonime edhe sot e kësaj dite rrinë kokë më kokë si dëshmi mes faqeve të asaj gazete policore në Bibliotekën Universitare, në Shkup. Kohë ajo (1980), kur ti shkaku kushteve të vështira malore ke shkuar në punë me motor, "xhip" e më vonë edhe me "Pezho 309", që asaj kohe i gjithë Shkupi, a i ka pasur dy ose tri makina të këtyre firmave më të njohura botërore. Edhe atë, falë trashëgimisë të Babait, e jo pagës dhe shpërblimeve të Partisë Komuniste. E sot, përsëri askushët me të njëjtat metoda policore të ndjekin si shkrimtar i "familjes komuniste". "Irredentist", që nuk mund t'ju thuash mysafirëve

të rastit në kafene, mos u uluni në tavolinën time me vende të zbrazura në karrike! Tjetër, ia përplas në fytyrë Inspektorit policor: pasi ai ka qenë aq i "rrezikshëm" si shqiptar, pse mua nuk ma keni tërhequr vërejtjen si individ i painformuar në shoqëri? E fundit, unë dua të jem ai "kryesori" që paramendoni ju në "ndreçjen" e këtij sistemi, në doni ta dini edhe më vjen mirë dhe krenohem, por fatkeqësisht nuk jam Ai "kryesori", që Çështjen Shqiptare dua ta zgjidhë me luftë.

Brengosja, byku shqiptar si spiunë i atij sistemi të egër komunist, në vend që të izolohet e gjykohet për krime ndaj popullit shqiptar, vazhdojnë të struken edhe sot e kësaj dite nën sjetullat e partive politike shqiptare, mos them me bindje të plotë: i marrin në gji në mbrojtje si "patriotë" shqiptar. Fishekë qorra, të cilët i përdorin qarqe të errëta antishqiptare nateditë, të kërcnohen me të gjitha metodat kriminele e policore, që ta lëshosh Shkupin. "Xhipit" tënd, pak para agimit ia vënë flakën. Zjarr, të cilin mezi e shuan me "djemtë e Shalës", në mes të "Çairit", në Shkup.

Vazhdimi: Babait tim i faleminderohem për së gjalli: E para: që më la trashëgim pasuri, që të kenë çka të djegin këto dudumë më mes të Dimrit. E dyta: Gjithë jetën më kështillonte e ma tërhiqte vërejtjen të mos bie në provokime të

rrumaducëve, grackën e tyre policore. Bir, mos i beso askujt, edhe këmishës tënde që e ke të veshur me vite në trup! Shkurt, as familjes të oxhakut, miqve e shokëve! UDBA jugosllave i ka shti rrënjët aq thellë në popullatën shqiptare, sa që ti nuk mund ta marrësh me mend edhe gjatë kohë mes atyre librave me kapakë të trashë, në bibliotekë.

Porosia e Babait, dha frute. E vetmja arsye, që unë nuk rash në duart e tyre kriminele dhe nuk bëra asnjë ditë burg. Zoti im i vërtetë ishte dhe do të jetë: Babai, që sot pushon i qetë mes varreve, rrëzë Çukës. Kulminacioni i hakmarrjes me penë: E dini, pse sot do t'i ndjek deri në varr si shkrimtar?! Jo, nuk e dini si spiunë dhe kriminelë. Shkaku se, më keni ndjekur këmba - këmbës gjithë jetën me shpifje e etiketime edhe maleve. Ditën e sotme, më kërcnoheni edhe me rrezik jete. Shktarrim të pasurisë së Babait duke ia vënë flakën. Problemi kryesor: Këmbekrye, pse e gjeni veten si personazhe nëpër shkrimet e mia publicistike. Nesër, edhe nëpër libra, në bibliotekë. Porosia: Nuk do të ketë Komision Lustrues që do t'ju shpëtojë në këtë jetë edhe në atë jetë si bërllok Bit - Pazari me "gunën patriotike" hedhur krahëve nëpër xhepat e partive politike ose policore. Pamarrë parasysh, kujt nacionaliteti i takoni apo besimi fetar. Arsyeja, ju flisni me thashetheme, shpifje dhe "kuzhina"

policore antishqiptare, e unë me fakte nga jeta e përditshme shqiptare. Shembull, pse sot jeni edhe më të zëshmit si spiunë të asaj kohe?! Ende mendoni dhe e rreni mendjen se do t'i gëzoni të njëtat definicione qytetare: vende pune, taxhi të Shtetit dhe poste politike.

Realiteti shqiptar, deri mës sot nuk e di se cili shtet në botë ka shpallur më shumë spiunë sesa vetë shqiptarët?! Fatkeqësia, gjithë këtë zhurmë "patriotike" e bëni si partizanë të partive politike për pushtet pa pushtet në Qeveri. Ose, për të ardhur me dhunë nga rruga në pushtet. Medjat në gjuhën shqipe të shitura për një asht, u japin hapsirë duke manipuluar me këtë popull të përndjekur nëpër shekuj. Dyert ua hapin krah më krah pykave të spiunimit në mes të popullit shqiptar. Huti dhe frikë përhapni në popull, nuk e mer vesh qeni të Zotin nga cila anë i vjen guri duke fshehur dorën. Nuk dihet cili është spiun e cili patriot. Përfundimi: Çmenduria, sipas këtyre akuzave të Sërbisë, populli shqiptar na qenka popull "spiun"?!... O burra binu, spiunëve të djeshëm të pabesë! Edhe sot, para syve të botës po na shpallin popull "spiunë"! Rrezik i madh, për një popull!...

Shqiptarëve, gjatë gjithë këtyre viteve të "ndryshimeve" demokratike, "vëllezërit" vetëm na qesin diçka në grep, dhe ne merremi gjithë kohën me vetëveten, në vend që të merremi me

fenomenet politike para pragut të Shtëpisë. Punëkoti, që ai është vetëm një krimb (president kosensual). Momenti është, populli shqiptar: "shapin ta ndajë nga sheqerit". Politikanë të papërgjegjshëm, harrohen me vite nëpër kabinete dhe poste politike. Njëzetë vjet me radhë si politikanë merreni me ndarjen e lugëve dhe enëve. Moti jua kam thënë këtë te libri: *Trumbetat e Tellallit* (1992), që në kohën e PPD - së. Libër i cili në atë kohë më dërgoi edhe në një "bisedë informative" në polici. Helmime dhe një shpërthim zjarri pasmesnate në banesë. Përndjekje të papara deri më sot nga Policia letrare. Tashti, pas kaq viteve me gjithë këto "parti politike shqiptare" që i kemi në skenë (dy shqiptar – pesë parti), vetëm e përsëris si parashikim për Nesër. Shtëpinë ia kemi lënë "Vëllait të Madh". Pasurinë e tundshme e të patundshme në Shtetin e "përbashkët" demokratik. Arat, livadhet dhe pyjet me lisa të gjatë, që siç thotë Naim Frashëri: *Ju kam ndërmend ditë e natë*.

Koha është, në vend të lugëve dhe enëve, t'i dalim zot si "vëllezër" Shtëpisë…

POROSIA ANONIME

Shteti i "përbashkët" IRJ e Maqedonisë, hë për hë është një ndër shtetet më të pasigurtë në Ballkan për intelektulët që e ngrenë zërin për fjalën e lirë. Askund nuk ke siguri, në rrugë, shtëpi e punë. Në mes të ditës delë dudumi fizikisht t'i qëroj "hesapet" me ty para syve të policisë Shtetit "demokratik" me metodat më të ulëta njerëzore. E, sidomos në gjumë, cilit t'i teket vjen e t'i shkrep dy-tri plumba në kokë. Ose, ta djeg makinën para shtëpisë. Policia që e ka obligim të të ruaj si qytetar i këtij Shteti, dalësh në rrugë pa frikë, pish një kafe me miq në tavernë, është e pafuqi të të sigurojë rehati "artistike". Jetën tënde e kanë në dorë partizanët e partive politike në pushtet. Historia vazhdon të përsëritet: Gomarit i zbret Nastradini me 60 kg mbi samarë, i hipë Nastardinica me 120 kg mbi shpinë. Dudumët, kur t'i e prek fenomenin e rrezikshëm në tel, do të arsyetohen poshtë shkrimeve të tua se: ti "përsëritesh", i shkruan këto ngjarje edhe mbi "njëzetë herë" në mjetet e informacionit. Ndonjërit, ose ndonjërës që do t'i dhëmbë (digjet) më së shumti bishti i dhelprës dinake në Katund, do të dalë me emër e anonim

krah për krahu me Hojdodolen duke të shpallur "spiun".

I kam përballuar përndjekjet e mëdha si "irredentist" shqiptar, bisedat informative" në polici, pritat në rrugë, helmimet, zjarret në banesë, vdekjen klinike në Voskopojë, Ringjalljen në Korçë, aksidentin e komunikacionit në Qafë Thanë, flakën e xhipit përpara banesës në "Çair" të Shkupit, nuk ia vlen më të ballafaqohem edhe me sulme të tjera të papara të këtij niveli kaq të ulët njerëzor në këtë mesbërllok shoqëror të "vëllazërim-bashkimit". Shkaku, se: Përsëri, pas hetimeve policore unë mbetem fajtori në këtë shoqëri "demokratike", që pretendon me gjithë këto kalorës të arratisur të shkojë në Europë. Vështirë e ke në këtë shtet ta vazhdosh luftën me penë, kur "miqtë" tu shiten shumë lirë, mos them pa pare. Përmëtepër, edhe të ndërsehen tinëz pas shpine. Fjalën e kam për "intelektualët". "Gazetarët", që nuk u shpëton nga syri e veshi as edhe një pordhë e politikanëve në pushtet, por nuk do të mund ta shohin e dëgjojnë xhipin tënd të ndezur flakë në mes të Shkupit. Hë për hë, unë Veten ende nuk e kam nxjerr ta shes në Bit - Pazar, si plaçkë lufte. Vetëm se, shkrimet, librat e mi dhe intervistat, që nga dita e sotshme nuk do t'i keni falas, pa para. Përfundimisht, kam vendosur të vdes i qetë mes dudumëve me librat e

mi mbi kokë, i përcjellur në Shtëpinë e fundit rrëzë Çukës nga familja e ngusht e gjakut, pa fjalime "patriotike" mbi kokë, lotët e rrejshëm të "miqëve" dhe lotët e krokodilit të "patriotëve kuqezi" mbi varr për karrierë politike.

Dhe, dihet ceromonia e varrimit: prania e një qeni besnik dhe një maceje. Grave azgane me dajre e këngë dhe valle mbi varr me atë këngën e njohur popullore të Katundit tim "problematik" rrëzë Çukës: *Në ta jap moj nëne, si s'ta japë -jo.*

Tekstin e kësaj kënge popullore, ndoshta e mbani mend, me siguri edhe këtë jua kam përsëritur e shkruar mbi "njëzetë herë": Gruaja e do shumë burrin. Edhe, nateditë i thotë: Nuk e di ti bre burrë sa të dua unë si grua besnike. Një, dy, tre ditë përsëritet "dashuria". Burrit një ditë i vjen te hunda. I thotë vetes: po, sikur ta provoj

dashurinë e gruas?! Në kojshi si rrallëherë bëhet një dasmë e madhe me dajre e lodra. Burri shtrihet në shtrat: Grua, vdiqa! Aman, ore burrë mos vdis sot! Jo, vdiqa. Dhe, burri vdes, jep shpirt.

Gruaja bie në hall, e thirrë një plakë që ta ruaj xhenazen (kufomën). Pazarin e bëjnë pa probleme, dy shtëllunga leshi për gjithë natën. Vrik e vrik, gruaja vishet bukur si kukull, ndreçet e pispiloset dhe shkonë në dasëm. Plakën e la që ta ruaj xhenazen.

Plakës, dikur nga mërzia rastësisht i shkojnë sytë lartë në tavan. O Imzot, pastërmani i deles, i rrinte mbi kokë. Vetmevete, tha: po, sikur të marr një copë, nuk do të bëhet nami. E mori një shkam me tre këmbë, nxorri thikën nga brezi dhe hipi të presë një copë pastërma. Papritmas, i rrëshqet këmba nga shkami dhe rrëzohet si cung shelgu mbi barkun e xhenazes. Tëëërrt, pordhi xhenazja. Plaka u tremb, prandaj edhe tha me vete, do të shkoj ta pyes Nusen në dasëm, a pordhë xhenazja?!

Nusja në ato momente e hiqte vallen me dajre e këngë. Gratë brez për brezi, duke u përdredhur e përkundur, herë më njërën anë, herë në tjetrën anë ia kishin dhënë me dajre flakën. Plaka ngadalë iu afrua te veshi: Nuse, a pordhë xhenazja? Nusja duke hequr vallen pa e ndalur

këgën i përgjigjet: *Pordhë, moj nën -e, si nuk pordhe –jo.*

Plaka, përsëri kthehet në shtëpi ta ruaj xhenazen. Dikur, i shkrep një dyshim i papritur në kokë. Mirë, po a do të m'i japë Nusja shtëllungat e leshit? Pse të mos shkoj edhe njëherë ta pyes për shtëllungat e leshit?! I përmbledhë të gjitha forcat: ngrihet nga shkami, e lidhë shaminë pas koke, shtrëngon dizgën e pashterkës dhe shkonë te dasma, në mesin e grave. Nusja në ato momente, ende nuk kishte dalë nga vallja. Plaka merr guximin dhe i afrohet tinëz Nuses: Po, a do të m'i japësh shtëllungat e leshit? Nusja, nuk e ndalë vallen e as këngën, po i përgjigjet: *Në t'i jap moj nën -e si s'ti japë – jo.*

Pasmesnate, dikur pak para agimit dasma merr fund. Nusja kthehet në shtëpi dhe ia jep plakës shtëllungat e premtuara të leshit. Burri çohet nga shtrati i vdekjes, merr një shkop thane pas dere dhe e bënë gruan siç themi ne në Katund, "bukë xhypi". A, kaq shumë më paske dashur, oj grua?! Mëkot e lutë gruaja besnike për mëshirë, burri ia jep hakun e dashurisë. Mos them se, e rrahu bythëve deri në mëngjes me atë shkopin e atij Dijetarit mysliman, shtatë herë në ditë.

Rastet e këtilla kurrë nuk zbulohen, ose nëse kapen kriminelët nga policët e rendit, partitë politike në pushtet intervenojnë dhe i lëshojnë partizanët e tyre si të "pafajshëm" në liri. Punë

tjetër është ajo se, kriminelët shëtisin më lirshëm se intelektualët: Pararoja e një shoqërie demokratike, Balli i Kombit Shqiptar. Mos them edhe se, jetojnë më mirë si mishi në dhjamë mes bollëkut dhe parave të partive politike në këtë shtet "demokratik". Kriminelët dhe spiunët për këtë shoqëri shembullore janë qytetarë të "ndershëm", intelektualët ua ngatërrojnë punët në këtë shtet "demokratik".

Unë, nuk jam shqiptar "i ndershëm", partizan i ndonjë partie politike e as "patriot kuqezi" me brekët mbi pantollona. Shaminë e pionierëve, ende nuk e kam lidhur përqafe me stemën e Shokut Tito nën jaknën e setres. Përmtepër, as Mic Sokol që e rrok topin për fyti. Që, nga dita e sotshme, nuk do të mirrem me trimat pas lufte të partive politike, po me vetëveten si shkrimtar: Librat, shtambat me verë nën Rrap. Dhe, Miken.

Kalosh Çeliku me këtë shkrim u jep fund shkrimeve të tija satirike dhe kritike në jetën publike, që moti kohë në shoqërinë tonë shqiptare na kanë mbi si ferra te pragu i derës përpara Shtëpisë, nga koha e komunizmit dhe na kanë rrokur me të dyja duart për fyti, na e kanë zënë frymën si popull. Shkaku, se: jam i pafuqi si shkrimtar dhe pa mbrojtje nga Njerka e partitë politike "demokratike". Organizatat Joqeveritare

"Humanitare" në këtë shoqëri para këtyre dukurive negative, i mbyllin sytë e veshët dhe ngrohin duart rreth flakës të zjarreve rreth oxhakut. Politikanët që i kemi zgjedhur vetë me "votën e lirë demokratike", dhe prapë do t'i zgjedhim edhe disa mandate që të na prinë për në Liri, kanë truproje, shoferë të vetët dhe para të popullit. Makinat më luksoze, që askush nuk guxon t'ua vë zjarrin në mes të Shkupit (lagjes shqiptare, Çairit). Unë jam vetëm një Ujk i përndjekur me vite në mes të fushës, nuk kam truproje, shofer personal e as shuma marramendëse materiale që ta vazhdoj luftën me penë. Pasurinë e Babait ta harxhoj kotnasikoti për libra e budallaki shqiptare që haramët t'i ngrohin duart në mes të Dimrit. Edhe, atë: Përderisa, ju si politikanë e shtoni përditë e më tepër pasurinë në emër të popullit shqiptar: ndërtoni vila luksoze, firma private në emër të grave, dashnoreve dhe fëmijëve edhe të pas pesë brezave. Paratë i siguroni nëpër bankat botërore para syve të popullit që vdes përditë edhe për bukën e gojës.

Porosinë e mora: xhipin e ndezur flakë nën dritare para shtëpisë pasmesnate (12 shkurt 2014), në ora 04:15 para agimit kur i gjithë Çairi i Shkupit është në gjumë. Ngjarja ka ndodhur, kur disa persona të "panjohur" kanë hedhur benzinë paraprakisht mbi xhipin përderisa ai ishte i parkuar nën dritare të banesës para garazhës, dhe

pastaj ia kanë vënë flakën, ende, Hoxha i Allahut pa e thirrë "sabahun" në minare. I pari ngjarjen e heton djali i vogë, i cili më zgjon nga gjumi bashkë me të vëllain, ku pas pak kohe në ndihmë na vjen edhe një kojshi dhe me kofa me ujë mezi e shuajtëm zjarrin. Interesant, pas largimit të kontenierëve me të cilët kriminelët e kishin bllokuar rrugën, menjëherë në vendngjarje erdhën zjarrfikësit dhe policia. Zoti Madh, për fat të mirë përveç dëmeve materiale nga zjarri i automjetit nuk u lëndua askush.

Vërtetë, më paskeshit dashur shumë, si ajo gruaja besnike - burrin. Humbje kohe është edhe në të ardhmen të mirrem me këto qyqe Bit – Pazari me kokat nën sjetulla, t'i muros mes faqeve të librave si kalorës të arratisur dhe hipë mbi Kandarin e Çajupit, strehojë në bibliotekë. Publikisht, them: Nuk do të mirrem t'i shpallë heronj mbi gomarë: as doktorzinjtë, as dhëndurët, as haxhi deputetët, as miniminisrat e kulturës, as kimçet, as car dushanët, as hajricat, as hoxhallarët e Allahut e as "vëllezërit" e Njerkës… Edhe, as këlyshët me zgjebe, që gjithë jetën më janë ndërsyer pas shpine me një asht në gojë. Por, për inatë: do të mirrem me shkrime satirike dhe dashuri hyjnore deri në varr. Gruan besnike, që e do aq shumë burrin.

Larg qoftë ajo, ta rreni veten se: Unë e kam dorëzuar armën e Çajupit (Kandarin)…

TEKI DËRVISHI I PËRNDJEKUR EDHE NË PARAJSË

(Shkak: Përurimi i librit Individualitete 2 – Teki Dërvishi i autorit Nehas Sopaj, botim i Lidhjes të Shkrimtarëve Shqiptar – Shkup).

Teki Dërvishi (1943 – 2011)

Teki Dërvishi, njëri ndër shkrimtarët disident më të përndjekur në sistemin komunist, i cili gjithë jetën për së gjalli nuk do t'i përvidhet as burgut më famëkeq të Goli Otokut, edhe pas ikjes fizike nga mesi ynë në një mënyrë të përçuditshme (në "heshtje"), nuk do do t'i shpëtojë as përndjekjes të Policisë sekrete letrare edhe në Parajsë. Shkrimtari duke i ditur "miqtë" e

tij në jetë, punë, varrime dhe rivarrime para kamerave televizive, do ta lë me testament (amanet), që varrimi i tij të bëhet në mesin e ngushtë familjar, pa "miq" e pa ceremoni mortore. Vërtetë, përveçse shkrimtar i madh, ishte edhe Profet. E dinte se kush do ta vajtonte nesër mbi varr me lotë krokodili dhe fjalime patetike për karrierë policore letrare e poste politike. Rrufjanët e djeshëm, "patriotë" të sotshëm të arratisur nëpër parti politike. Ose, siç thotë Filip Shiroka te vjersha e tij antologjike "*Një Ander vjershë e kushtueme trathtorëve tonë",* në të cilën i "shanë" të gjithë me rend, paj edhe babën Adam:

……..

-Ç'ke bre bir – m'thotë – Ç'ke me mue,
Qi m'ke sha e m'ke trazue?... –
-m'ndiei, o plak – thaçë, gabim ke!-
-Nuk t'kam sha as s'di kush je!-
Nuk po m'njeh – tha – m'shiqo mirë:
Jam Adami plak, bre birë!-

……..

-Po baj çudë – tha – me t'vërtetë
S'po di, Eva ku i ka gjetë,
Kta tradhtorë të patynzonë
Qi turpnuene emnin t'onë;
E… me idhnim briti tue thanë:
"Farës s'ime kta nuk janë!"
Se… me kenë t'ont – tha – tue qa

Gruen kisha tash m'e nda!...
Por kta njerz kanë le ma vonë
Prej Kainit t'patynzonë,
Qi ka mbytun vllan e vet,
Vret mallkimi i Perëndisë,
Qi turpnon para njerzisë!

Populli thotë: Uji fle, por hasmi nuk fle. Edhe përndjekësit e Teki Dërvishit në kohën e sotshme nuk i merr gjumi. Natë e ditë shohin ëndrra të tmerrshme. Frikë kanë se, Shkrimtari do t'u ngritet nga varri dhe do t'u kërkojë përgjegjësi morale e politike për gjithë ato përndjekje të papara deri më sot për së gjalli. Që nga ditët e vuajtjes së dënimit si i ri me burg të rëndë në Goli Otok e deri te punësimi i tij në gazetën "*Flaka e vëllazërimit*", në Shkup. Vite ato, kur ai në këtë redaksi do të ndiqet këmba – këmbës nga "krijuesë" e "gazetarë" Oborri të asaj kohe. Përderisa, një ditë do të provokohet nga "policë - redaktorët" cenzurëkuq në redaksi, që të dalë me shkrime edhe kundër Ismail Kadaresë. Shkrimtari nuk do të bie në këtë provokokim politik, prandaj edhe policët "letrar" të redaksisë do ta përzënë nga puna, hedhin në rrugë Shkrimtarin si "irredentist, separatist e nacionalist i rrezikshëm për Shtetin".

Mezi do të gjejë strehim në NGBG "RILINDJA", në Prishtinë. "Miqtë" e tij të penës,

të cilët sot e përkujtojnë kokë më kokë pa fije turpi e morali me vajtime e përkujtime patetike, që dikur dolën me shkrime edhe kundër shkrimtarit të madh shqiptar, Ismail Kadare në vazhdime do t'i derdhin lotët e rrejshëm rrëke nëpër faqe. Njeri i gjallë nuk do të gjendet t'i qetësojë pak, rroki për krahu t'ua fshi lotët e rrejshëm me faculetë.

Teki Dërvishi më nuk është në mesin tonë krijues, po rrufjanëve sot u turret dhe i ndjek hija e tij përmbrapa edhe në gjumë me gjithë atë bagazh të librave: *Shtëpia e sëmurë* (1978), *Zbutësi i njerëzve me sy prej zumryti* (1979) *Thashë* (1981), *Herezia e Dërvish Mallutës* (1981), *Bregu i pikëllimit* (1985), *Pranvera e librave* (1990), *Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit* (1990), *Palimpsest për Dush Kusarin* (1993), *Kufiri me atdhe* (1996), *Nesër nisem për në Parajsë* (1999), *Ku është populli* (2003) etj. Nuk i lë rehat kulturofagët, prandaj nguten disi ta rehabilitojnë veten me shokë, shpëtojnë nga shpirti i tij rebel prej krijuesi Profet. Shkas: Libri (studim) i autorit Nehas Sopaj, Individualitete 2 – Teki Dërvishi, botim i Lidhjes të Shkrimtarve Shqiptar, në Shkup. Libër i cili do të përurohet edhe nga Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar, në kuadër të Manifestimit Kulturor Tradicional Ndërkombëtar: Takime nën Rrap, në Kërçovë (2013) dhe nga Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar të

Kosovës (2014), në Prishtinë. Poashtu, Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptar, në Shkup, Shkrimtarit dhe Mikut Profet do t'ia përkushtojë edhe një numër special jubilar të revistës letrare "STILI 97". Revistë letrare, që ky soj i Evës, për të cilin e pyet veten edhe Adami, se: Nuk e di Eva ku i ka gjetë, do të përpiqet me të gjitha forcat "krijuese" e politike ta ngulfasë si zë i ri kryengritës në letërsinë shqipe, pas këtij numri të botimit nuk do ta ndihmojë Ministria e Kulturës. "STILIN 97", Instuticion shqiptar, të cilin soji i dalldisur e tërbuar i Evës (Njerkës) e lufton edhe sot e kësaj dite me të gjitha metodat "kulturore" e policore nga pusia pas shpine.

Megjithatë, "miqtë" e Teki Dërvishit në këto përurime të lartëpërmendura nuk do të kenë hapsirë për të derdhur lotë krokodili dhe "përkujtime" për Shkrimtarin - Profet. Prandaj, këtyre kalorësve të arratisur do t'u duhet edhe një përurim tjetër i librit të Nehas Sopaj. Livadh kulturor, ku ato do të rehabilitohen dhe përurojnë veten para kamerave televizive si "miq dhe bashkpunëtorë" të Shkrimtarit. Tyrbja e "odëvajtimit" të këtyre vajtocave të "*Flakës së vëllazërimit*", gjëndet sa mëshelë e çelë sytë: Shtëpia e Kulturës "Koço Racin", në Shkup. Merreni me mend, një Shtëpi Kulture me pagëzimin e një emri të një poeti partizan maqedonas, autorin e poezisë "Duhanvjelësit".

"Vlerë artistike", të cilën nxënësit shqiptar në plan-programet dhe lektyrat shkollore e kanë pasur dhe e kanë gjithë jetën si "rrugë artistike" në sistemin komunist nga ajo kohë "demokratike".

Vendlindja e Teki Dërvishit – "Gjakova e kuqe" ngutet, Fadil Hoxhës t'i vendosë, ngrejë në mes të qytetit përmendore?! Vendlindja e Bajram Currit, Plakut të maleve?! Qyteti, që ka dhënë plot trima atdhetarë, që sipas deklaratës së një qytetari të "Sofrës gjakovare" para kamerave televizive në MTV (Programi në gjuhën shqipe) e ka "ngritur" edhe flamurin kombëtar kuqezi para Isamil Qemalit, në Shkup?! Vendlindja e Teki Dërvishit, që këtë vit shënoi 50 vjetorin e Mitungut jubilar të poezisë në Gjakovë, dhe nuk e di a lexoi dikush në sallë ndonjë varg të poetit, apo ia përmendi së paku dikush nga miqtë emrin si krijues rebel. Larg qoftë, ta ngrejë zërin për t'i ngritur një përmendore Shkrimtarit disident në vendlindje, rrëzë Çabratit.

Ftesat i shpërndajnë përmes postës elektronike e në dorë në të katër anët e Bit – Pazarit duke thirrë aty - këtu edhe ndonjë emër "autoritativ" për ta mbuluar "qëllimin kulturor – patriotik letrar" të këtij përurimi, në mesin e tyre edhe Redaktorin letrar të librit, Kalosh Çeliku si botues dhe Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar, në Shkup.

Kalosh Çeliku si redaktor letrar dhe botues i librit, edhe pas shumë lutjeve të autorit të librit Nehas Sopaj, nuk do të marrë pjesë në kërë rivarrim "kulturor" të Teki Dërvishit. Arsyeja, e para: Veten nuk mund ta shti në një thes me përndjekësit e pamëshirshëm të Teki Dërvishit. E dyta: shkaku veprimeve "kulturore" dhe mjerimit të këtyre kalorësve të arratisur. Dhe, e treta: Nuk do në emër të Teki Dërvishit t'i rehabilitojë këto kalorës të arratisur në letërsinë shqiptare. Krah për krahu, të gjithë "miqtë" e Shkrimtarit do të jenë prezentë në numër kokë më kokë si dhentë e nënkryeme kur turren pas kripës te Përroni i Thanës nën dardhën gorrice: Ahmet Selmani si promotor i librit, Ali Aliu, Eshref Aliu, Xhabir Ahmeti, Resul Shabani, Halil Zendeli edhe ndonjë partizan i vogël me pushkën në krah (Hoxha i Allahut me trutë dhe këmbët në legen). Përçudi, mungonin kolegët tjerë nga *Flaka e vëllazërimit*: Rexhep Zllatku, Abduladi Zylfiqari, Fejzi Bojku, Neset Emini, Naxhi Osmani, Daut Dauti, Sami Ibrahimi, Emin Azemi, Kim Mehmeti, Zekirja Krasniqi e Mustafa Spahiu. Dhe, shokët e artit skenik në Teatrin e pakicave (Dramës shqiptare), në Shkup: Muhamet Sherifi, Bajrush Mjaku, Selman Jusufi, Sefo Bejtë Krasniqi, Sefedin Nuredini, Xhevat Limani, Zejadin Murtezi e Refet Abazi.

Kulminacioni "artistik" si në kohën e "artë" komuniste: Njëri – tjetrin duke e shtyrë me bërryla, kush i pari do të hipë rrëmbejë nga duart mikrofonin në foltore, derdhë më shumë lotë krokodili për "mikun" e penës dhe punës, shpalosë më shumë kujtime para kamerave televizive dhe popullit shqiptar.

Përfundimi artistik: Frikë të kesh sot, edhe të vdesësh në këtë kohë qorre, në mesin e kalorësve të arratisur me kokat nën sjetulla e palarenë në polici, ose tek partitë politike. "Miqtë" e penës dhe punës nuk do të lënë rehat as edhe në mesin e varreve. Mëkot t'i e lë me testament (amanet) varrimin: Vetëm familja e ngushtë, një qen, një mace dhe grave besnike me dajre e valle të të përcjellin në mesin e varreve.

"Miqtë" e penës do të gjejnë kohë, vend dhe hapsirë të të vajtojnë pas vdekjes, mu si në kohën e "artë dhe të lumtur" komuniste. Natën do të të vrasin, e do të të qajnë ditën. Varrin do të ta mbulojnë me lule. Lotë rrëke do të derdhin mbi kokë "miqtë" e penës me "vajtime" e fjalime patetike nëpër përurime të librave dhe Akademive përkujtimore. Honoraret marramendëse, Çmimet e ashtuquajtura letrare, pensionet shtetërore dhe përmendoret madhështore, dihet do t'i rrëmbjenë për vete si veteranë lufte të "vëllazërim-bashkimit", dje

komunistë, sot neokomunistë në Shtëpinë publike.

Ndihmë, o Zot! Turru, e na shpëto dhe na ruaj nga ky soj pakurrizorësh të pangopshëm, që siç thotë Adami te vjersha e Filip Shirokës: Nuk e di Eva (unë them: Njerka) se, ku i ka gjetë rrumaducët me kokën në grazhd e palarenë në Livadh!...



PULAGJELI

Pulagjeli, që gjithë jetën kishte bërë furrikë nëpër kasollat me kashtë të kojshive duke kakarrisur tra më tra, një ditë iu tek të bëhet gjel, hipi në gardhë me këngët e tia të korbziut, thirrë agimin. Ama, pasi i kishte shëtitur të gjitha lëmët e huaja nëpër Katund. E shkreta, e kishte harruar thënjen e Nënës sime, se: pula, kur këndon si gjel, patjetër duhet vënë thikën në qafë, therë për darkë.

Lëmës tonë gjithmonë ka kënduar gjeli kryengritës dhe e ka thirrë agimin në gardh. Kurrë pula duke i përplasur fletët mbi pleh nuk është çjerrë si këngëtare majë plehu pas Shtëpisë. E sot, shumë pula e thirrin agimin me këngë patetike. Fatkeqësi kombëtare, që Nëna ime nuk është ende gjallë në Katund. Thikën t'ua vë në qafë, heshti qyqet.

Shkaku i këtij shkrimi: Përsëri, manifestimet kulturore dhe kalorësit e arratisur nëpër parti politike. Ende nuk e kanë të qartë, ose nuk duan të kuptojnë se: politizimi deri në palcë i këtyre manifestimeve kulturore është kancer vdekjeprurës në Shoqërinë shqiptare. Partitë politike vijnë e shkojnë në pushtet, arsimi dhe kultura shqiptare (themelet e një shoqërie, shteti), janë përgjithmonë majat e një populli. Individë të

papërgjegjshëm pa bagazh kulturor e ltarar, fare pa pikë turpi dalldisin dhe përhapin deziniformata në opinionin shqiptar. Politizojnë manifestimet kulturore shqiptare për interesa personale, grupore e politike. Lëmsh i bëjnë themeleusit e këtyre manifestimeve, përdhosin para syve të popullit shqiptar fytyra të mirënjohura e ndritura të kulturës shqiptare. Trusakatët, harrojnë se, ende nuk kemi vdekur të gjithë në luftën me penë, jemi gjallë siç thotë Naimi i madh te vjersha antologjike "Fjalët e qiririt: Ne jemi në mesin tuaj, mos na merrni për të huaj!" Realitet shqiptar, që kulturofagët sa herë dalin si kau nga vija e ugarit mes arës, t'ua përpalsim në sy përmes mjeteve të informacionit. Vërtetë, i kemi dururar mjaft si popull duke na krrokatur mbi kokë me vite sorrat e zeza. Vite e vite i kemi pritur që, të heshtin, mbyllin gojën. Por, me që nuk heshtin dhe nuk e mbyllin gojën, jemi të detyruar t'ua përpalsim deri në vdekje të gjitha të palarat në fytyrë.

Klubet e Shkrimtarëve Shqiptar në IRJ të Maqedonisë nuk janë themeluar kujt si t'i teket kokë më vete, deklarojë para mysafirëve dhe dashamirëve të poezisë dezinfromata kulturore e artistike. Klube letrare në atë kohë mund të kenë pasur disa shkolla fillore dhe të mesme nën petkun e "vëllazërim-bashkimit", por jo edhe Klube të Shkrimtarëve Shqiptar. Nuk them për

Klubet e Shkrimtarëve Shqiptar në Dibër dhe Tetovë, por në Shkup, Kumanovë dhe Kërçovë i ka themeluar Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptar, me iniciativën dhe prezencën time si nënkryetar i atëhershëm i Shoqatës me shokë.

Pulagjeli kulminacionin e fotografimit para kamerave televizive e arrin, pasi i ka shëtitur disa parti politike e "organizata humanitare" me referatin e tij "famëmadh", se: "Në fillet e pluralizmit, në vitin 1991 (1992), disa artdashës, të gdhendur me idenë fisnike të zhvillimit e përparimit kulturor të kësaj shoqërie, themeluan Klubin e Shkrimtarëve Shqiptar. Merreni me mend (ndërhyrja ime), artdashësit në atë kohë kanë qenë të "gdhendur", prapë shtojë unë autori i këtij shkrimi: cungje, ose pyka shelgu.

"Në krye të klubit u vu shkrimtari Fadil Bekteshi, për të renditur më pas një varg veprash dhe suksesesh. U themelua revista e parë e pavarur shqiptare në Maqedoni për art, shkencë dhe kulturë 'Doruntina', dhe prej atëherë e deri më sot janë botuar dhjetëra e qindra libra mjaft me vlerë nga anëtarët e klubit". Burri i botës harron, ose nuk e di se në cilat kushte është botuar ajo revistë letrare dhe si është shpërndarë, jo vetëm nëpër qytetet e trojeve shqiptare, po edhe në Sërmnovë të Gostivarit falas para syve të Policisë letrare.

Budallaki e çuditshme shqiptare: "ardashës të gdhendur", pse ato të pagdhendurit sipas Pulagjelit ishin cungje, apo pyka shelgu?! Klubi i cili ka botuar me "dhjetra e qindra libra mjaft me vlerë". Qesharake: nëse janë botuar dhjetra, ose qindra libra, por jo edhe "dhjetra e qindra libra". Dhe, kush ishin ato "artdashës të gëdhendur me idenë fisnike të zhvillimit e përparimit kulturor të kësaj shoqërie"?!

Fatkeqësia kombëtare, që këtë Orë letrare e hap poeti dhe studiuesi i letërsisë (???!!!...), dëshmitari (vetë i treti) i themelimit të Klubit të Shkrimtarëve Shqiptar, pa e pyetur veten se ku janë themeluesit e vërtetë të këtij Klubi të shkrimtarëve, së paku ndonjë anëtar i familjes ngushtë në këtë Orë letrare?! Përmëtepër, edhe disa krijuesë mjaftë aktivë, poashtu bashkëthemeluesë me emra të mirënjohur anembanë trojeve etnike në letërsinë shqiptare?! Nevojë nuk ka t'i përmendim në këtë shkrim me emra e mbiemra, i di lexuesi shqiptar. Përjashtim bënë Poeti i ndjerë Fadil Bekteshi, shkaktari kryesor i këtij manifestimi kulturor, që kulturofagët edhe atje, nga mesi i varreve nuk i len rehat, dhe me një emërim të një çmimi letrar duan ta heqin qafe nga Historia e Letërsisë Shqiptare. Përbaltin emrin e tij pas vdekjes, edhe pas disa shkrimeve duke ua tërhequr vërejtjen se, e kanë harruar Poetin miqtë e tij më të ngusht që

mezi në ato kohë të vështira i bëri shkrimtar, së paku ta pagëzojnë Klubin e Shkrimtarëve Shqiptar me emrin e tij si parashikues i Ditës së Nesërme. Rrezik, që këtë manifestim kulturor me një karakter mbarëkombtar ta shndërrojnë në një manifestim lokal katundi. Shembull konkret për duartrokitje, krijuesit dibranë, që pas ikjes së papritur të gazetarit dhe aktivistit kulturor Lutfi Turkeshit, Klubin e shktimtarëve shqiptar e pagëzuan me emrin etij, "Dr. LUTFI TURKESHI". Vërejte publike për Klubin e Shkrimtarëve të Tetovës (Klubi 94), që ende nuk kanë guxim për të vendosur për këtë dukuri negative te pragu i derës, që përsëgjalli para syve na i përbaltë penat e dëshmuara historike.

Poetët me shokë, kur i themeluan këto manifestime kulturore, nuk i shpalosën në opinion si manifestime partiake e lokale, po kulturore shqiptare. Asaj kohe në këto manifestime kulturore merrnin pjesë poetë madhështor nga të gjitha trojet etnike shqiptare: Tirana, Prishtina, Shkupi, Tetova, Struga Dibra, Kërçova e Gostivari. Publikisht, i pyes organizatorët e këtyre manifestimeve kulturore: Qëllimi i tyre kulturor, është përçarës apo i bashkimit të shqiptarëve?! Vërtet, më vjen keq, që jam i detyruar t'ua them me plot gojën: shumë larg jeni qëllimit kultoror-artistik dhe patriotik të atyre burrave të penës që me plot mund e djersë i

themeluan këto manifestime kulturore. Prandaj, ndeleni turrin "patriotik kuqezi" partizan! Përvishnju punëve kulturore e leni anash përçarjet politike për interesa personale në dëm të kultures shqiptare. Sidomos, në këtë kohë, para zgjedhjeve presidenciale e parlamentare. Kohë kjo, kur këto manifestime kulturore duhet t'u prinë për bashkim Partive Politike Shqiptare. Mjaftë më e përçatë popullin shqiptar për një vend pune, banesë shoqërore, post politik, një torbë taxhi!

Trusakatët, me manifestime kulturore "shkel e shko", nguten të ma mbyllin gojën e heshtin lapsin, vrik e vrik duke veshur ferexhenë e zezë kulturore, edhe cilit: bashkëthememeluesit që i ka ndjekur me vite hap pas hapi se si rriten këto manifestime kulturore duke lëshuar shtat nëpër çerdhet e strukura shqiptare. Pulagjelas, ndani një çmim letrar sa për sy e faqe me emrin e Fadil Bekteshit para kamerave televizive. Gabim historik, Poetit i ka hije të barti emrin e Klubit të Shkrimtarve Shqiptar, të cilin e themeloi vetë i dyti me shokë dhe i doli zot sa qe gjallë me punë dhe djersë personale. Nuk e di, dhe as kam njohuri nga mjetet e informacionit, a i keni bërë deri më sot vizitë me poetët pjesmarrës mes varreve me nga një tufë lule, së paku kur i vizitoni varrezat e dëshmorëve. Mos e them dhe teproj se, keni vendosur në atë manifestim kulturor tradicional me emrin e tij të emroni

ndonjë shtëpi kulture, shkollë fillore ose të mesme. Pse jo, të ndërtoni edhe ndonjë përmendore për Poetin e Atdhedashurisë, në vendlindje.

Jo, o të arratisur e dalldisur nëpër parti politike! Dje, në Partinë Komunsite, sot nëpër të gjitha partitë politike shqiptare. Poezia është dhunti e Natyrës dhe do talent, tru e të tjerë burra mejdani. Nuk jeni ju ato burra të penës, por trima pas lufte me brekët mbi pantollona, siç thoshte shpesh një poete e asaj ane nëpër takimet letrare. Prandaj, mirë do të ishte t'u ktheheni deleve dhe lopëve në katund. Këngës së mirënjohur të këngëtarit popullor: "Dhentë e mia kush i do, se nuk jam më i zoti për to". Nevojë për të cilën më së shumti ka sot për sot populli shqiptar i nëpërkëmbur nga pjella e tij në mes të Lëmës.

Inati të vjen sot, që këto Manifestime Kulturore janë mbajtur shumë më në nivel artistik në kushte edhe më të vështira dhe rrethana më të rrezikshme me emra të mirënjohur të dëshmuar krijuesish nga të gjitha trojet etnike shqiptare. Vallë, nuk keni sy e veshë, apo me qëllim doni t'i përbaltni manifestimet kulturore shqiptare që me shumë mund dhe vështirësi i kemi themeluar në atë kohë edhe para syve të Dexhallit.

Thesin e keni mbushur plot me speca djegës të arratisur, të cilët nuk i njeh as nëna e vet, e ku më katundi. Nuk ka vend më për të hyrë në një

thes me ju edhe ato pak emra që kanë mbetur gjallë e kanë kaluar nëpër pusi, plumba, përndjekje policore e burgje. Natën e kanë bërë ditë. Pasurinë e trashëguar e kanë shkrirë për arsimin, kulturën dhe Çështjen shqiptare, kur ju turreshit me të katra pas librezave të kuqe të Partisë Komuniste, posteve politike, vendeve të punës, banesave konforme dhe parave. Çmimeve shtetërore.

Pulagjeli, sot për sot kotnasikoti i përplas fletët mbi pleh pas Shtëpisë, nuk bënë asnjë furrik në kotec e as hip në gardh ta thirrë me këngë Diellin. Vështirë, e ka sot ky popull liridashës me këto pulagjela dalë në dritë, kur nateditë në vend të agimit pulagjelat e thirrin Natën me ferexhenë krahëve…

TËRBIMI I KULLTUKOFAGËVE ME KOKA NËN SJETULLA

Vetëvrasja është e njohur si fenomen shoqëror nëpër botë. E kanë bërë artistë, politikanë dhe njerëz të sëmurë psikik për shkaqe mendore. Kohën e fundit, vetëvrasje bëjnë edhe partitë politike shqiptare për një "president koncensual". Veten e vënë në rolin e peshkut, "shehid" shkojnë vetëm për një krimb. Nami u bë në mjetet e informacionit. Mendja ta thotë, se: shqiptarët nuk kanë probleme të tjera kombëtare, përveçse "presidentit konsensual". Këmbë ngulin, që presidenti patjetër duhet të jetë "konsensual". Ose, e gjithë puna është si jorgani i Nastradin Hoxhës, kur ia vjedhin hajdutët. Jakup Kalliri i Al Pazarit do të thoshte: "pak rëndësi ka". Edhe, unë pajtohem. Shqiptarët në ish Jugosllavi kanë pasur president të gjashtë republikave e dy Krahinave Autonome (Kosovës dhe Vojvodinës), Sinan Hasanin. Punemadhe, që tashti do të kenë një president "konsensual" të një IRJ të Maqedonisë me dy miljonë banorë, aqsa ka vetëm një lagje e Stambollit. Përditë e vrasin veten me zgjedhje të parakohshme lokale, parlamentare e presidenciale. Fatkeqësisht, mbi njëzetë vjet me radhë në politikën "madhore" pa ndryshime deri

më sot për Çështjen shqiptare. Herë i hipin e herë i zbresin gomarit të Nastradin Hoxhës. Barrën më të rëndë në shpinë, dihet e ka Nastradini. Edhe, atë: zakonisht para zgjedhjeve lokale, presidenciale ose parlamentare. Ndonjëra, më "patriotja", në prag të zgjedhjeve ngritet nga varri lugat për vetëvrasje të dytë në jetën politike. Tjetra "kuqezi", ngutet në mënyrë vullnetare vetë ta vë litarin në qafë në një degë të thatë lisi, në "kryeqytetin" e shqiptarisë. E shpallë Presidentin "konsensual" Iljaz Halimin, e provokon Partinë shqiptare politike në pushtet.

Menduh Thaçi, kësaj radhe na delë edhe "profet" i madh, pas Pejgamberit të fundit Muhamedit a. s.: "PDSH –ja pjesë e qeverisë pas zgjedhjeve, unë do jem zv/ kryeministër! Gruevski, s'është aq i fortë, sa është i ligë Ali Ahmeti. E pyes Aliun, a ka Allah, ai thotë jo, Marksi është Allah! Estagfurullah, shumë ka e prapa. Në këto zgjedhje kam një dëshirë të flaktë, do ta shpalosi në formë të mesazhit: Ta shkelim Marksin, Engelsin e Leninin, dhe njëherësh, ta ngrisim lartë Zotin, kombin, PDSH –në dhe Iljaz Halimin." Them unë: pse jo të bëhesh edhe kryeministër, o Menduh Thaçi?! Shqiptarët, a gjithë jetën do të kënaqen me zv/ drejtorë e zv/ ministra?! Tekefundit, e kënaqën zv/ ministrat e BDI –së, tashti i ka mbetur gomarit t'i hipë edhe Nastradinica me ferexhenë e zezë krahëve, cofi

në mes të rrugës. Kryetari i RDK –së Rufi Osmani, pas BDI –së turr edhe ky në Zvicër në përurimin e kandidatit për deputet në diasporë të kësaj partie, në vend t'i mobilizojë forcat partiake në Gostivar. Pak u duket përçarja politike në vendlindje, prandaj nguten edhe atje t'ia rrasin pykën e shelgut vëllazërisë shqiptare. Gabim politik, që ka gjasa shqiptarët si në zgjedhjet e kaluara të mbesin pa asnjë deputet në diasporë. Shkaku se, rrema e tyre politike përcjellë ujë në tjetër mulli.

Gurë e dru hudhin mbi njëra-tjetrën para vdekjes me pak shpirt në jetën politike: Korrupsioni me të dyja duart i ka rrok për fyti. Edhe atë, para syve të botës u vdesin intelektualët edhe për bukën e gojës. E këta burra mejdani, partizanëve të tyre me dy-tri vende pune e poste qeveritare u shprëndajnë edhe honorare me shuma marramendëse materiale mbi nivelin e pagës mujore të mësuesëve. Ryshfete marrin për vende pune, tenderë e firma private. Kohë kjo, kur shumë shkrimtarë enden rrugëve pa vende pune. Fatin e tyre e kanë në dorë kulltukofagët e dy partive politike më të mëdha shqiptare, që moti kanë lëshuar rrënjë dhe bëjnë luftë politike si Dy dhitë kryeneçe mbi vig të lumit te Abetarja, cila do ta fitojë postin e argatit e jo të pronarit të Shtëpisë. Vite me radhë gomarit i hipë e i zbretë

Nastradini (60 kg.), përpiqet t'i hip Nastardinica (120 kg.).



Hë për hë, vërtetë shqiptarët nuk kanë opozitë të fuqishme politike, ose një kalorës të Ri për ndryshime politike. Njëzetë vjet me radhë, individë të njëjtë rrotullohen në skenën politike shqiptare. Gati të gjithë liderët e partive politike shqiptare opozitare i dogji Menduh Thaçi. Gomarit, pse mos t'i hipë pak edhe Xha Deralla?! Parashikim për Nesër, guxim politik të cilin patjetër një ditë do ta përqafojnë shqiptarët si rrugë qiellore. Shkaku se, nuk kanë rrugë tjetër për freski politike. Arsye, që më në fund pajtohen me fatin, gomarit t'i hipë përsëri në shpinë Nastradini. Nuk e di pse e kanë frikë Nastradinicën?! Veprime politike këto, që për

momentin më së shumti i konvenojnë dhe ia zgjasin jetën Njerkës të Babait. Livadh u lënë kulturofagëve të bëjnë kërdi në popull: arsimin duke e shti për së gjalli në varr pa prift e hoxhë, kulturës shqiptare moti ia thirrin "ezanin" përmes altoparlantëve në minare. Përditë, mbeturinat e tyre partizane partiake ngulfasin dhe varrosin manifestime kulturore tradicionale ndërkombëtare, libra e revista letrare që i kemi mbajtur gjallë deri në Ditën e sotshme me plot mund, pasuri e djersët rrëke deri në fund të këmbëve mes dy zjarreve.

Shqiptari, historikisht gati gjithë jetën është duke ecur me kokën e "fshehur" nën sjetulla. Pavetëdije, apo nga frika me dhunë e ka strehuar nën struke. Ndoshta, edhe ka menduar se e ka "fshehur" në vend të sigurtë para syve të Dexhallit. Rrugës ka ecur pa kokë, ose me kokën e huaj në qafë. Kundërshtari historik si burrë legjitim i Njerkës me sëpatën nën setre e ka ndjekur hap pas hapi nëpër histori. Herë duke ia treguar bishtin e sëpatës nën setre, herë çykën e herë prerësen e mprehtë gjoja të mbështjellur me gazetë nëpër Qytet. Pykën e shelgut, dihet e ka pasur në xhep. Dhe, sa herë që ka pasur nevojë e ka nxjerrë nga strofulla politike, gjoja se e lusin Partitë Politike Shqiptare për deputet.

Ditë për ditë e natë për natë është trembur nga ferra që i ka dalë para si "armik" i papritur në

rrugë. Duaji i grurit më këmbë si njeri, që ia kanë nxjerrë bashkëfshatarët rrëzë Çukës ta provojnë sa është trim. "Armiku" i pabesë, nga frika e ka shti kaçakun e malit të nxjerrë "nagantin" dhe me nëntë plumba në ballë e ka ndezur flakë pasmenate "tradhtarin" në errësirë, në prag të agimit.

Ditën e nesërme, përsëri ka ecur me kokën nën sjetulla e "nagantin" në brez. Bombat nëpër xhepat e strukes krahëve. Kësulën e bardhë, në kokë. Arat i ka lëruar me pllug e me qetë asht e lëkurë. Livadhet i ka kositur me kosë. Ferrat i ka krasitur me kizë rreth oborrit të Shtëpisë. Pazarin, ditën e shtunë e ka bërë me kalë me shalë.

Përçudi, përsëri nuk ka bërë gjumë të rehatshëm me kokën e tij nën sjetulla. Gjithë natën është rrotulluar në shtrat. Edhe pse, dritaret i ka mbyllë me kapakë druri. Shulin ia ka vënë pas derës. Qenin besnik, Murgo e ka zgjidhur nga zingjiri nëpër Lëmë. Parashikues ka qenë se, dikush e pret në pusi në fund të livadhit, mund t'i vijë tinëz pasmesnate edhe në dritare. Përmes shtambës me ujë t'ia shkrepë në dritën e zbehtë të qiririt, nëpër errësirë dy-tre plumba mu në lule të ballit. Palojë sa gjërë – gjatë në mes të dhomës, pranë oxhakut të ndezur me dru lisi, shuaj tymin mbi çati.

Fakt historik, që kaçaku i malit ende është gjallë në mesin e "patriotëve kuqezi". Vetëmse,

tashti është kohë tjetër me të tjera armë e zakone. Kokën duhet ta nxjerrë nga sjetullat dhe vë në qafë. Anash t'i lë thirrejt parazgjedhore të partive politike për "fitore". Theshethemet e tyre nëpër fushata parazgjedhore. Sharjet, fyerjet, shpifjet dhe etiketimet e njëri-tjetrit para zgjedhjeve për "pushtet". Rrugës të eci pa frikë. Votën e lirë t'ia jap atij personi që e meriton si kandidat serioz, e jo partive politike. Matanë malit, në pusi nuk e pret "hasmi", siç e kanë trembur gjithë jetën, po Fitorja historike. Përfundimisht, t'i thotë jo, kokës së huaj në qafë! Dhelprës dinake duke hequr valle me pulat qafërjepura t'ia këpusë bishtin, edhe kokën mbi cung në mes të Lëmës. E dini pse, shkaku se: nuk duhet më të ecë me kokën nën sjetulla, po në qafë. Vetë t'i dalë zot kokës së tij e jo "probatimi", që me shekuj e mbanë nën zgjedhë me argatë politik e masha shqiptare.

Koha është, shqiptari si pasardhës i Rilindasëve (jo i rilindasëve të Edi Ramës), edhe në këto zgjedhje presidenciale e parlamentare të dalë, ose të mos dalë me kokën e vetë në qafë, e jo të "fshehur" nën sjetulla. Kokën e huaj në qafë ta flukë në përrua. Thirrjeve përçarëse të partive politike t'u japë një mësim të mirë politik e historik. Nuk ka nevojë as shoqatat "joqeveritare" ta "mësojnë" e thirrin derë më derë: të dalë, apo të mos dalë në zgjedhje presidenciale. Populli shqiptar e ka kokën e vet në qafë, që e ka

dëshmuar nëpër shekuj, në histori. Fatmirësisht, sot për sot është mbi nivelin patriotik të politikanëve. Shqiptarët, sot nuk kanë nevojë për matrapazë e profiterë politik, që me vite na kanë shitur me pare e pa pare nëpër pazare politike te 'vëllezërit", na e kanë zaptuar ajërin, ujin, bukën dhe gjelbërimin. Livadhet na i mbushën me beton politik, në vend të çerdheve të fëmijëve dhe shkollave në gjuhën shqipe.

Frikë kam se, në momentet më të vështira vendim-marrëse historike, popullit shqiptar i prinë në ballë të sëmurë psikik. Vështirë e ka edhe mjeksia t'ua përcaktojë diagnozën shkencore. Ndodhë të kenë simptome tërbimi. Shembull i freskët, Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama me Rrotën e K****. Gratë e burrave dhe nënat e fëmijëve duke i përgojuar nga foltorja e Kuvendit si "viagër" të kundërshtarëve politik. Dashuri publike duke i shpallur njëri-tjetrit para kamerave televizive përmes Kandarit të Çajupit.

Populli i dalldisur shqiptar, symbyllazi u bie duarve shuplakë, sikur para tyre të vallëzonte Arusha me dajre në Katund. I pafuqi për momentin ta ndryshojë situatën para hazdisjes të liderëve politik me pak shpirt në mes të Ballkanit. Ndoshta, edhe i pëlqen kjo gjendje agonie para "fitores" historike. Kutadi unë, i duket si ëndërr. Sytë për ndihmë i ka hapur në qiell. Varka e Noes për shpëtim nuk duket në horizont. Rrugë nuk ka

për shpëtim nga Përmbytja e madhe: shiko lartë, larg. Shiko poshtë, thellë. Hip se të vrava, zbritë se të vrava! Përsëri si popull me traditë dhe vetëdije të lartë politike, prej dy të këqijave mbi tavolinë, duhet të zgjedhë atë më të mirën: Porosinë e madhe të Naim Frashërit. Votën e shejntë demokratike, më në fund mos t'ua jepë hiç pa menduar fare "bashibozukëve". Kurrë, mos e "shesë" me pare nëpër pazaret e partive politike. Turret me të katra si pakokë në rrugë, kur Dexhalli me trumbeta delë Tri ditë para Kiametit t'ua vë nga një vulë në ballë të arratisurve politik.

Ditën e gjykimit, Xhebrahili kur i merr në pyetje dhe kërkon ta zbulojnë ballin, mbesin si huj gardhi në mes të Livadhit. I ka mashtruar Dexhalli me trumbeta kur doli Tri ditë para Kiametit nëpër Bit - Pazar.

Dënimi i merituar dihet, bythekrye në Xhehnem (Ferr). Gojën plotë do t'ju thotë: Palarenë mjaftë e keni përdredhur nëpër instutucione të Shtetit "përbashkët", kisha dhe xhamia! Koha është t'i përpëlisni pak, piqni ato të shkreta edhe në shpuzën e zjarrit të Xhehnemit (Ferrit). Flaka t'ua pastrojë, lëpijë me gjuhë nga mëkatet.

Profeti më veç e ka hapur krah më krah portën e Xhehnetit (Parajsës). Lumë ato gra e burra, që do ta shohin veten në mesin e luleve. Malin e Perëndive: Baba Tomor…

"PRESIDENTI MUSLIMAN"

Sapuni është "lodra" e parë e fëmijëve me të cilin ballafoqohet hutaçi që ditën e parë të lindjes, kur vjen duke qarë në jetë. Gëzohet familja, katundi, dhe e gjithë shoqëria. Shqiptarëve, këtë dhuratë hyjnore nga qielli ua ka sjellë lejleku. Ju, si lexuesë të mi besnik do të pyesni: pse lejleku, e jo qyqja e lagur në shi pa fole?! Përgjigje e lehtë: Shqiptarët, vetëm lejlekut i kanë ndërtuar çerdhe mbi oxhak, lisin e madh pranë Shtëpisë e jo qyqes e cila na i ka lënë vetë nëpër çerdhet e huaja, t'i sjukin sorrat e zeza. Tjetër punë është ajo se, ai kur rritet burrë me mustaqe vesh më vesh, ikë "i lumtur" me këngë vaji nga Shtëpia. Babai këtë produkt natyror origjinal, pastrues të trupit dhe shpirtit, nevojë e asaj kohe që na mungonte me të madhe, kur na cofte ndonjë kafshë shtëpiake e bënte vetë sapun, në mes të Lëmës.

Gëzim i madh për familjen e Katundin, gjithë vitin kishim sapun. I lanim sytë me të dyja duart për çdo mëngjes. Fytyrën, këmbët dhe duart. Edhe trupin dy-tri herë në javë. Problem kishim ne fëmijët, sa herë që Nëna kur na fuste me zor në govatë, nuk e donim ujin e pusit nën hijen e ftonit. Zëri na shkonte për qielli nga shkuma e sapunit që na i digjte sytë. Marrëzisht, tek tashti fillonim ta duam ujin. Shkaku kryesor,

ky që në atë kohë e urrenim sapunin dhe e çuditnim Katundin, kur na fusnin me zor në govatë.

Megjithatë, pas larjes e bukur ishte ajo ninulla e nënës që na e këndonte tek posa na fuste në djep mbi kokë: *Nina nana, more bir/ flej se gjumi të ban mirë/ Të ban mirë e po të rehaton në djep druri/ bashkë me vëllain e motrën të përkundi/ nana ty do të të baj Plak katundi*! Titulli më i lartë dhe posti i asaj kohe të cilin na e këndonte Nëna plot gëzim, ishte: Plak Katundi. Post të cilin disa partizanë të partive politike edhe sot e dëshirojnë dhe e mbajnë plot krenari. Partitë Politike "demokratike" shqiptare të sotshme, nateditë para zgjedhjeve lokale, presidenciale e parlamentare na këndojnë ninulla të thata patetike: "Tani gjendemi para shtëpisë së kryetares së Tetovës Teuta Arifi, edhe pse ajo tanimë nuk jeton në këtë shtëpi, sepse ka katër banesa në Shkup dhe një banesë në Tetovë, prandaj nuk e dimë saktë se ku jeton. Se zonja Arifi gënjen dhe mashtron, kjo nuk paraqet lajm, por lajmi është se ajo rri në xhami (siç shihet në foto) pa mbulesë shami dhe me frizurë, gjë me të cilën i shkelë parimet themelore të fesë islame", ka akuzuar sekretari i forumit rinor të PDSH-së dhe njëherësh kandidat për deputet në Njësinë numër 6, Bujar Afrimi. Punemadhe për deputetin e popullit, që "xhemati" në xhami hyn pa kësulën

e bardhë në kokë. "Myslimani" më i madh, pas Muahmedit a. s. i thirrë hoxhallarët ta ftojë "xhematin" të votojnë për kandidatin e parë "musliman" për president, Iljaz Halimin. "Xhahilët" të cilët nuk do ta votojnë kandidatin e vetëm "musliman" për president, nëse fitojmë ne në këto zgjedhje, të gjithëve me rend do t'ju vë nga një kryq në ballë. Plotësimi im: E, kur hyri Teuta Arifi në xhami me shami e me "papuçe me take" në diasporë, çka thatë për këtë dukuri politike-fetare?! Asgjë, përveç duartrokitjeve frenetike. Atëherë, do të prisni "gropat që ua shënoi para një viti" t'ua mbulojë nesërmëngjes me "lule xheneti për Bajram", përpara shtëpisë moti të braktisur në Tetovë?! Pse jo, edhe me ndonjë "ilahi" në prag të zgjedhjeve "demokratike, në xhaminë e madhe mes Sheshit të Tetovës, të cilën ua premtuan "vëllezërit" si kompenzim në vend të Burmali Xhamisë krah për krahu me Nënën Parti.

Që ato ditë të fëmijërisë, nuk e di pse edhe sot e kësaj dite kur dalin politikanët tanë në ekranin televiziv me "Din e Iman" në gojë, mua më duken si sapunë të Babait. Fjalimet e tyre të "zjarrta" patetike para zgjedhjeve. Sharjet dhe kacafytjet e Dy gjelave me një gardh thuprash në mes të Lëmës, matanë Oborrit. Rrenat e pabesueshme me të cilat duan të më fusin në govatën plot me ujë. Përjashtim, këtu bën Zijadin

Sela me shokë, kur është në pyetje Çështja e pazgjidhur shqiptare. Burri i botës, ashtu siç e bëri bashkë Strugën pa ndarje të partive politike gjatë zgjedhjeve lokale, edhe kësaj radhe e ngriti zërin e politikanit: shqiptarët gjithmonë duhet të jenë bashkë për punë të mbara kombëtare historike. Punemadhe, që "presidenti musliman" (Iljaz Halimi) në këto zgjedhje presidenciale i thirrë në ndihmë edhe mysliamnët turq, romë e torbeshë. Publikisht e deklaron haptas veten si president "kosencual". Gabim politik i Partisë më të madhe shqiptare (BDI) në pushtet, që nuk e pranon për kandidat "konsensual" presidentin e vetëm "musliman". Vite me radhë në jetën politike, nuk i pastroi institucionet e "përbashkëta" të shtetit nga mbeturinat e harruara partiake nëpër zyra e kabinete, që edhe sot e kësaj dite nuk na lënë të ngrejmë krye si shqiptarë. Presidenti i parë "musliman", ashtu edhe ashtu, kurrë nuk do të bëhet president i Shtetit të "përbashkët" pa Kryqin e madh të Gruevskit në Vodno. Krah për krahu me Metropilitët e Beogradit në breg të Vardarit. Car Dushanit, që gjatë natës u ngritë lugat dhe me çekiç përpak para kamerave televizive ia ngritëm këmbët në lumë ta përcjellim për në Greqi. Frikë kam se, përsëri Nëna me zor do të më shti jo në govatë, po në "banjon publike". Shkumojë mirë sytë me

sapun t'i shoh "patriotët kuqezi". Zëri të më shkojë për qielli.

Ditën e sotshme, qesh vetmevete me sapunin e Babait dhe atë të Partive Politike Shqiptare. Mjetin pastrues, që m'i përkujtojnë padashtas politikanët e dalldisur të partive politike

shqiptare. Vallë, si nuk janë sapun edhe këta burra mejdani, nuk u harxhuan më për kaq vite një ditë, në skenën politike: nga "fitorja në "fitore". Ose, të lodhen nga puna "patriotike", popullin shqiptar të mos e marrin si dhenë. Fjalimi i Menduh Thaçit në një fushatë parazgjedhore: 5.000 delet e Ali Ahmetit, varfëruan Tetovën. Plotësimi im: E kullotën gjithë Sharrin Plak. O burra, binu deleve të Ali Ahmetit, t'i fusim në vathë! Thikën t'ua vëmë në qafë, therim përgjatë fushatës zgjedhore. "Vëllezërit" të kenë meze për të ngritur dolli pas fitoreve presidenciale. Edhe deshëve me brirë rreth veshëve me nga një këmbonë përqafe! Fije bari nuk na lanë nëpër "livadhet" e Tetovës. Këlyshët me zgjebe nuk kanë ku të përjagen, e mos të flasim për qentë e Sharrit?! Vazhdimi i Menduh Thaçit me mikrofon në dorë në mesin e shqiptarëve: "Fukarallëk, që i serviret Tetovës, ka një përgjegjës, këto gropa, mungesa e ujit të pijshëm, mungesa e investimeve në infrastruktrën e shqiptarëve, ka një çmim, "e çmimi është dhentë (delet) e Ali Ahmetit, 5000 dhenë (dele)", e kjo do të thotë, 5000 ndihma sociale më pak për shqiptarët. Delet e Naim Frashërit te "Bagëti e Bujqësia" t'i therim sot, që na japin tambëlin, qengjin, djathin dhe leshin për ta veshur veten për Dimër?! Studentët e dy Universiteteve, në Tetovë t'i lëmë sot e mot me gishta në gojë. Kurrë, mos e

thashtë dhe dhëntë Zoti! PDSH – ja do ta çojë në hava Car Dushanin"?! Jo, o Menduh Thaçi! Frikë kam se, përsëri folë jerm në gjumë, pasmesnate. Shqiptarët Car Dushanin nuk e çojnë në "hava" me këtë kapacitet politik shqiptar, po kryengritësit shqiptar nesër do t'ia vëndojnë dy brirët e përkrenares të Skënderbeut në kokë dhe do ta zbresin në tokë.

Problemi shqiptar: nuk është Car Dushani për ta çuar në "hava", por si me e hipë Car Dushanin para kalit me shalë, në prehër të Skënderbeut në Bit-Pazar?! Fatkeqësia kombëtare: me Menduh Thaçin dhe kandidatin "musliman" Iljaz Halimin, kurrë nuk hipet Car Dushani para kalit të Skënderbeut! Shkaku, se: "patriotëve kuqezi", moti u ka ikur treni. E, Ali Ahmeti me shokë, Ditën e sotshme i kanë hipur vagonit të fundit të trenit në stacionin hekurudhor të cilin dikur moti mezi na e ndërtoi shoku Tito. Lokomotiva është nisur plotë fishkëllimë (pordhë e piskamë) përmes fushës të Pollogut. Punë tjetër është ajo, se: a, është nisur binareve për në Beograd, apo për në Tiranë?!

Përsëri, ndërhyrja ime: E gjithë kjo bëhet në "Kryeqytetin e Shqiptarisë" të Iljaz Halimit me dy Universitete?! E, ku i ka qentë e Sharrit Menduh Thaçi ("Sharr pllaninskit"), së paku të shpëtojë ndonjë copë lëndine, dele rudë?! Qëngji të butë lara-lara me një zile në qafë varë. Bariu të

mos i ndjellë sot pas kripës te Kasapi, po kullosave andej nga "Sytë e Sharrit". Mrizojnë nën hije të dardhave gorrice me fyellin e Bariut. Qentë e Sharrit si roje, mos t'u bie natën Ujku Nateditë, para zgjedhjeve njëri-tjetrit mos ia nxjerrin sytë dhe të palarat politike. Votave "demokratike" sot u ka rënë çmimi. Përderisa, dikur një votë shiteshte 50 – 100 euro, sot shitet gati pa pare: një çaj rusi, një kafe turke, një thes miell, një litër vaj, 1 kg. sheqer, një kg. kripë. Turpi Zotit! Çmimin gjatë këtyre viteve na e keni ulur te pala politike maqedonase. Imzot, si nuk është ende Nëna ime gjallë, t'i marrë kopilat shti me zor me gjithë tesha t'i lajë në govatë. Sapunojë mirë e mirë me sapunin e Babait. Mjaftë i lamë sytë, duart, fytyrën dhe këmbët. Koha është, pak ta lajmë edhe kokën. Trurin.

Fatkeqësi kombëtare, që Babai ende nuk është gjallë, kafsha që na ka cofur në mes të Lëmës, mos na shkojë kotë në Ditën e sotshme parazgjedhore të "presidentit musliman", brenda një dite ta bëjë sapun. Dhe, lajë politikanët e arratisur dhe të shashtrisur "kuqezi" nga pisllëku me ujë në govatë, që llomi dhe harami ua ka mbuluar sytë. Shtatë sahat larg u vjen era. Qelben…

LUFTË E ASHPËR POLITIKE PËR PUSHTET ARGATI

Burrat e Kombit i janë lutur Zotit ashtu siç u ka pasur hije: edhe në kishë, edhe në xhami. Rilindasët tanë jo të gjithë, edhe kur e kanë arritur kulminacionin e zemrimit e kanë sharë Zotin: Filip Shiroka, që hidhërohet me Adamin e Evën, shkaku tradhtorëve tonë, Çajupi, kur ia rrëmben Evgjeninë. Ose, pse e lindi Sulltanin, egërsirën me fytyrë prej njeriu. Vetëmse, qesharake është lutja e Menduh Thaçit në mesin e varreve për Arben Xhaferrin. Vetë Arbër Xhaferri, nuk i besonte gjithaq Zotit. E kush është ky "mysliman" i madh, që sot te këmbët e varrit të Arben Xhaferrit bënë homazhe. I lutet Zotit për mëkate politike, apo për "presidentin mysliman"?! Haptas i thirrë në ndihmë jo në xhami, ose si në zgjedhjet e kaluara në Bit – Pazar me "Allahu Ekber", kur i humbi edhe zgjedhjet parlamentare. Besimtarët mysliman, i duken si dhnetë e Ali Ahmetit dhe mendon t'i mashtrojë me një homazh para varrit të Arben Xhaferrit.

Arben Xhaferri për së gjalli, vërtetë ka bërë disa shkrime parashikuese politike e fetare. Dorën në zemër, meriton edhe duartrokitje. PDSH –ja si

parti politike, për sa qe gjallë Arben Xhaferi edhe ishte faktor i rëndësishëm politik për të Nesërmen Shqiptare. Kohë e rrezikshme, kur edhe nuk ishte aq lehtë të merret shqiptari me politikë. E, sidomos kur në mesin tonë partiak i ke me shumicë e pakicë të filtruara elementet antishqiptare. Vendimet partiake sekrete janë përcjellë para kohe në polici. "Ilirida" si projekt i dështuar, Afera e armëve, listat me emra e mbiemra për ndihmë popullit të Kosovës. Provokimet e Bit- Pazarit, Flamurit Kombëtar në Gostivar, "Republika e Tanushës", "Kryengritha e Brodecit", Protestat politike me veshje fetare, në Shkup.

Shqiptari në çdo hap ka qenë i provokuar nga vetvetja, mashat shqiptare që i ka pasur dhe i ka në mesin e partive politike shqiptare. Kurrë, deri më sot nuk ka bërë politikë madhore për shtet shqiptar. Shkaku se, çdo gjë është përcjellur me besnikëri te "vëllezërit", kundërshtari politik. I mençuri, edhe kur i ka ndihmuar aksionet e partrive pilitike dhe individëve, i ka ndihmuar, por i ka ikur rrezikut, nuk ka dashur t'i përmendet emri, nuk është nënshkruar në listë, e cila që të nesërmen është përcjellur në polici. Gjithë veprimet politike, aktivitetet kultuore e "humanitare" dhe rruga për zgjidhjen e Çështjes shqiptare, nuk ka qenë e panjohur për UDBA Jugosllave. I kanë ditur demonstratat e studentëve

të '81 –shit, në Prishtinë. E kanë ditur përgaditjen e Luftës së fundit të Kosovës dhe atë të fundit në IRJ të Maqedonisë (2001), që në vitin 1993. Akuzë me të cilën më fajsonin mua se , jam i dërguar nga Kosva që të veproj në Shkup. Dhe, çështjen e shqiptarëve dua të zgjidhë me luftë?!

Arben Xhaferri vërtet ishte koka e Partisë Demokratike Shqipyare. E. mbi të gjitha edhe politikan i mençur. Mu si sot më kujtohet një takim i "intelektualëve" (partizanë të PDSH –ës) në Teatrin e Kombësive, në të cilin mora pjesë edhe unë si Kryetar i Shoqatës të Shkrimtarëve Shqiptar të Maqedonisë. Shumica bashkëthemeluesë të PPD –ës, sot anëtarë të PDSH –ës, drejtorë e redaktorë në Redaksinë "Flaka e vëllazërimit". Në atë takim historik, kërkohej dorëheqja e Arben Xhaferit nga posti i Kryetarit të Partisë Demokratike Shqiptare, gjoja se ishte i sëmurë dhe u mungonte përkrahja dhe pëlqimi i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptarë, në Shkup. E pash qëllimin e këtyre argatëve politik, në Prizren pritej së shpejti të realizohet takimi politik historik i Ali Ahmetit me Arben Xhaferrin. "Intelektualët" e atëhershëm dhe të sotshëm si masha shqiptare ishin të ndërsyara që mos të realizohet ai takim. Dihet, nuk u pajtova me një propizim të këtillë dhe dështoi qëllimi i këtyre "intelektrualëve" shqiptar. Qëllimisht, nuk i përmendi emrat dhe mbiemrat, i di unë, e dinë

edhe ato vetë në atë takim vendimtar për popullin shqiptar. Me siguri, edhe kur do ta lexojnë këtë shkrim, do t'u kujtohet ajo kohë që përpak po të ishte tërhequr nga skena politike e asaj kohe Arben Xaferri, do të na merrnin në qafë si popull. Përçudi, po ato "intelaktualë", sot janë strehuar nëpër partitë tona politike dhe nderohen me çmime të Shtetit "pëbashkët" për "flijime artistike"..

Arben Xhaferri në një emision televiziv ka thënë edhe një të vërtetë politike dedikuar Ali Ahmetit: Unë do të përfundoj në politikë si Mithat Emini, ndërsa ti si Nevzat Halili. Nuk shkoi shumë kohë, dhe vërtetë Arben Xhaferri, papritmas iku nga mesi ynë si Mithat Emini (sekretari i PPD –ës). Ali Ahmeti, ende pritet të përfundojë si Nevazt Halili.

Koha do ta dëshmojë së shpejti edhe këtë profetizëm të Arben Xhaferrit. Vetëm se, kurrë nuk i ka shkuar mendja për së gjalli ta parashoh Thaçin në prag të zgjedhjeve presidenciale dhe parlamenatre duke iu lutur Zotit në mesin e varreve. Përdhos një fytyrë të ndritur patriotike shqiptare, që nëse vazhdon edhe në të ardhmen me këtë demagogji politike fetare, ndodhë t'i çohet me shpulla nga varri.

E vërtetë se, PDSH –ën vetë i treti në një aktivitet politik prej 15 ditësh (1994)) nëpër disa qytete të Zvicrës e sollëm në pushtet me vagonin

e fundit të asaj kohe: Themelimin e Universitetit të Tetovës. Megjithatë, pas ngjarjeve të Flamurit Shqiptar në Gostivar dhe Tetovë dhe burgosjen e kryetarëve të komunave: Rufi Osmanin dhe Alajdin Demirin dhe për shkak të përçarjeve me Ditët e Naimit, nuk e kam dashur Arben Xhaferrin si politikan. E sidomos, kur si Parti Politikke hoqën dorë edhe nga Universiteti I Tetovës. Papritmas u pajtuan me themelimin e një Universiteti tjetër privat të Europës Juglindore (Shtulit) me qëllim që ta mbyllin këtë Universitet, themelet e të cilit I shtiu populli shqiptar me gjak. Histori tjetër më vete është ajo se: unë jam nënshjkruar me emër e mbiemër në emër të Shoqatës s Shkrimtarëve Shqiptar, e jo PDSH –ja, vendi I së cilës në atë listë historike edhe sot e kësaj dite ka mbetur I zbrazët. Pasojat e atij nënshkrimi të asaj kohe, unë I barti mbi shpinbë edhe sot, e jo PDSH –ja që ende bën luftë për pushtet argati. Fajtori kryesor i këtyre përçarjeve intelektuale dihet, ishte "vojvoda" Menudh Thaçi, por Arben Xaferri ishte kryetar i PDSH -ës. Arsye kjo, që në atë takim të "intelektualëve" (2001), reagova ashpër me një mospajtim hisatorik. Thashë: Tashti, kur ju nuk e doni Arben Xhaferrin, unë e dua si politikan dhe nuk e jap pëlqimin për dorëheqjen e tij nga kreu politik i PDSH -ës.

Qëllimi i "intelektualëve" trusakatë, dështoi atë ditë. Nuk shkoi asnjë javë dhe Ali Ahmeti u takua me Arben Xhaferrin në Prizren. Marrëveshja e Ohrit u nëshkrua mes palëve në konflikt: asaj maqedonase dhe shqiptare. Marrëveshje historike të cilën e nëshkruan në prezencën e amerikanëve kryetarët e partive më të mëdha politike: Lupço Georgievski dhe Branko Cërvenkovski nga ana maqedonase dhe Arben Xhaferri me Imer Imerin nga ana shqiptare.

Punë tjetër është se ajo Marrëveshje në "liri" eci me këmbë të breshkës. Shqiptarër I ndjek i njëjti fat historic: fitojnë në luftë maleve, por humbin në tavolinë, paqe. Marrëveshja e Ohrit, edhe pas trembëdhjetë viteve në skenën politike të "bashkëvetëqeverisjes" me partite politike shqiptare në Shtetin e "përbashkët", nuk është realizuar plotësisht edhe sot e kësaj dite.

Shkaku: shqiptarët edhe sot si dje me palën maqedonase i ndajnë lugët e enët. Shtëpinë dhe arat ia kanë lënë "Vëllait" të madh (pales maqedonase). Turren me të katra pas poste politike dhe interesave personale në kurriz të popullit shqiptar. Asgjë nuk ka ndryshuar nga politika e djeshme shqiptare: Partitë Politike Shqiptare ulen gju më gju me popullin shqiptar vetëm kur u duhet vota e tyre e lirë "demokratike". Vite me radhë e blejnë dhe e shesin si mall fushe, në Bit – Pazar.

Luftë e ashpër bëhet me të gjitha "armët" luftarake mes partive politike shqiptare për të ardhë në pushtet, e jo për t'ia rrëmbyer pushtetin pales kundështare politike maqedonase. Jetën e argatit ta vazhdojnë në Qeveri, here njëra parti politike shqiptare e herë tjetra si "çlirimtare".

Fatkeqësisht, siç duket shqiptarët bëjnë luftë për të qenë argatë të përjetshëm e jo pronarë të Shtëpisë. Vite e vite vazhdon kjo ngjarje politike historike, kur do t'u dale gjumi shekullor, një Zot e di këtë përsëritje të histories: gjithë jetën argatë të pushtuesve.

Dhe, duke iu lutur Zotit mes varreve: politikanin e vdekur ta zgjojnë nga varri, që edhe këtë luftë të ashpër politike mes shqiptarëve ta "fitojnë" për jetë argati në Shtetin e "përbashkët". Padashtas, ta përkujtojnë Skënderbeun, të cilët me shekuj I luten shqiptarët të zgjohet nga varri dhe t'I çlirojë nga Robëria…

Menduh Thaçi homazh pranë varrit të Arben Xhaferrit.

V RREZITJE PA BREKË
TE KODRA E DIELLIT

DASHISHYTI

Vërtetë, keq të vjen kur e sheh Dashishytin se, si i lutet Zotit me "rraçet" e Dexhallit në dorë në Shtëpinë e Zotit (Xhami). Përmëkeq, kur ti je përpjekur këtë Dashishyt në kohët më të vështira ta sjellësh me mish e shpirt në "Din e Iman". Zotit t'i lutet në Xhaminë shqiptare. Edhe, i ke dhënë guxim të botojë libër si Redaktor letrar, gjoja "profetik", në kohët më të vështira shqiptare. Thënien e Muhamdit a. s. ta vësh në praktikë: "pa Vatan, nuk ka Iman". Kot, e ke humbur kohën para Përmbytjes Madhe (Ditës së Kiametit). Mëkot, humb kohë edhe Ali Ahmeti me sojin e këtyre "myslimanëve", kur tha: me mjekra e fustane, nuk shkohet në "Xhehnet". Unë them: me dimi, Shall arab përqafe, kësulë "partall" e shapkë në kokë, nuk i dilet zot Atdheut. Aspak, nuk pajtohem me apelin e disa politikanëve shqiptar, se: shqiptarëve në Maqedoni nuk u duhen më shumë se dy - tri, katër ose pesë parti politike. Shkaku se, shpërndahen votat, përçahen nëpër kuti votimi. Nevojë, gjoja për një frontë shumë më të fortë politik, dy parti le të jenë në skenën politike, njëra

që kryen rolin e pozitës dhe tjetra një opozitë e mençur por jo opozitë që merret me theshetheme dhe shpifje të politikës ditore.

Gabim politik, i politkianëve me setret krahëve para kamerave televizive. Shqiptarëve, vërtetë nuk u duhen me dhjetëra parti politike në IRJ të Maqedonisë, por as edhe dy parti politike: Nastradini dhe Nastradinica. Gomarit për në Pazar, njëzet vjet me radhë, herë t'i hipë mbi samarë Nastradin Hoxha e herë Nastardinica. Shqiptarët në Shtetin e "përbashkët" mund t'i kenë edhe tri, katër e pesë parti politike, por kurrësesi mbi pesë parti politike. Edhe atë, sa herë që të jetë nevoja, kur është në pyetje dhe rrezik Çështja shqiptare, të bëhen bashkë në një

Parti Politike Shqiptare. E, jo të përçahen pikë e pesë, siç thotë populli: njëra t'i bie thumbit e tjetra patkonit. Realiteti historik, shqiptarët as edhe që kanë pasur deri më sot më shumë se dy parti në skenën politike gjatë këtyre njëzetë vjetëve të "ndryshimeve demokratike". Partitë tjera politike shqiptare kanë qenë minore në "politikën madhore" shqiptare. PPD- ja është ajo kurva politike, që i polli të gjitha partitë politike shqiptare në IRJ të Maqedonisë. Kopila politik nga të cilët edhe sot e kësaj dite, shqiptarët nuk mund të ngrejnë krye si popull autokton në trojet e veta shqiptare. Vetëm, hidhnu një sy Partive politike shqiptare, gati thuaj të gjitha janë pjellë e PPD-ës. Politikanë të "pazavendsueshëm" në jetën politike shqiptare. Përjashtim bënë Ali Ahmeti me shokë, që zbriti nga malet me kruengritësit e UÇK -ës, por jo edhe BDI si parti politike. Edhe ajo, si forcë "rebeluese" i ka në gjirin e vet partizanët e PPD-ës, sot për sot që ende i besojnë "ringjalljes": i vdekuri çohet nga varri dhe vjen në shtëpi. Fatkeqësi shqiptare, që hë për hë duhet zgjedhur nga dy të këqijat, atë pak më të mirën si rrugëdalje nga politika qorre e katundeve. Thirrje historike: koha është, shqiptarët sot më të mos votojnë për Parti politike, por për individë, burra e gra të cilët nuk do t'i shesin për pak pare, por do t'i dalin zot Atdheut në Kuvendin shqiptar.

Dashishyti është edhe imam pa xhami, edhe analist, edhe shkrimtar edhe haxhi, edhe turist, edhe profiter politik, edhe … me katra pesë pasaportë udhëtimi nëpër botë. Qabja e tij, nuk është Meka, po Londra, Beogradi dhe Moskva. Vetë i ka publikuar këto të dhëna autobiografike në YouTube dhe Facebook. I ka shëtitur deri më sot me rend si "aktivist" politik "mysliman" me tespi "kuqezi" në dorë të gjitha partitë politike shqiptare. Edhe, organizatat joqeveritare e "humanitare", brenda kufijve politik dhe në Diasporë. Fatkeqësisht, edhe i ka "bekuar" me urdhër të Daxhallit, në emër të Allahut. Përherë, kur kemi pasur zgjedhje demokratike lokale, presidenciale e parlamentare ua ka varë shqiptarëve mysliman nga një hajmali përqafe. Nateditë rri në YouTube dhe Facebook me këmbët dhe trutë në legen.

Ditën e sotshme merr guximin t'u vardiset edhe liderëve politik. E politizon krah për krahu me "vojvodën" edhe Fenë Islame. Tinëz pas shpine me tespihe "kuqezi" në dorë i ndërsehet pas shpine Shkrimtarit rebel, shkaku një shkrimi profetik për "presidentin musliman". Shkrimin e tij duke u përpjekur ta lexojë edhe mes rreshtave e "deshifrojë" për policinë sekrete partiake të "vojvodës". Pavetëdije se, shkrimet e këtij kalibri për Nesër, nuk di t'i lexojë me këmbët dhe trutë në legen. Këmbadoras me vite përpiqet të dalë në

ballë të popullit shqiptar si “imam - lider”, gjoja për “ndryshime” politike, në Bit - Pazar. Reklamë politike me pak pare për t’u hyrë në qejf gati për çdo dy – tre vjet u bënë fushatave zgjedhore të partive politike shqiptare e u turret me të katra shkrimeve të mia parashikuese publicistike për Nesër. Ndoshta edhe i falen “xhunahet”, grazhdi i vetëm nga ku e nxjerrë një krah kashtë ta kalojë Dimrin, dali me shokë në “Pranverën arabe”. Dashishyti i shkretë me kokën nën sjetulla, harron se Shkrimtari rebel shqiptar përpara tij e di se, kur doli Dexhalli me trumbeta në rrugë nëpër Bit – Pazar: Tri ditë para Përmbytjes Madhe (Kiametit). Pak veta dolën në “sokak” nga shtëpitë e tyre e xhamitë, të argëtohen e heqin valle krah për krahu me muzikën e tij dhe e fituan vulën në ballë. Shqiptarëve, burra të tjerë u prinë në ballë për në Parajsë (Xhehnet): Rilindasët Shqiptar me penë e pushkë nëpër libra, kokë më kokë në bibliotekë.

Prandaj, koha është sot: Dashishyti të kthehet në Shtëpi te familja, rrisë fëmijtë pranë Njerkës! Nuk i them në xhami, edhe pse me profesion është imam. Shkaku se: nga xhamia moti e kanë përzënë besimtarët besnik të Muhamedit a. s. Nuk i ka mbetur asnjë lëkurë dashi ogiç për ta falur “Xhumanë e Madhe” përpara këmbëve të hoxhës. “Pranverën e tij arabe” ta thirrë edhe në Shkup duke manipuluar

rininë shqiptare me flamuj turko-arab në "protestat qytetare" (2013), që ende i kemi të freskëta nga ekranet televizive. Faj, nuk i kanë as shqiptarët e as "vëllezërit" e Njerkës, Dashishytit me të cilët e falë "Xhumanë" me tespi "kuqezi" në dorë mbi qilimat e Persisë, nateditë në Bit – Pazar me çaj rusi, që deri më sot nuk zuri vend në asnjë Parti politike shqiptare. I ka shëtitur të gjitha me rend deri tek e fundit për interesa personale (Bardhyl Mahmudit), të cilin edhe e mori më qafë. Iu vardis edhe asaj të Rufi Osmanit (RDK), por atje para tij kishte vënë pusi në "istikam", miku i tij gjoja për ndryshime politike i "PYKËS", Kim Mehmeti i cili e "refuzoi" publikisht postin e deputetit të popullit.

Ditët e fundit i është qepur për bishti asaj me pak shpirt para vdekjes (PDSH –ës), të Menduh Thaçit. Liderëve politik shqiptar, që deri dje u shkruante letra "dashurie" duke i shpallur si "kodoshë" qafë për qafe me fotografi të montuara plot "nishane", në Facebook. Në prag të zgjedhjeve presidenciale për "president musliman", delë me thirrje publike si "imam" në emër të një shoqate joqeverfitare anonime me pesë-gjashtë veta të nënshkruar si anëtarë nga Diaspora: Dashishyti me tespi "kuqezi" u bënë thirrje myslimanëve të votojnë për "presidentin shqiptar", Iljaz Halimi!!!??? Mjerisht, i cili humbi

në këto zgjedhje presidenciale si hajduti mes errësirës, në mes të Lëmës.

Bythekrye i vardiset edhe asaj të "kundërzbulimit", Dexhallit. Votën e "fshehtë" të lirë "demokratike", publikisht thotë se, do t'ia japë "Vëllait" të madh në këto zgjedhje presidenciale. Fatkeqësisht, shqiptarët ende nuk kanë themeluar parti të tjera politike shqiptare, ku mund të strehohet Dashishyti me shokë në ndonjë birë mini të "vëllezërve" të Njerkës. Shkak ky kryesor, që Dashishyti i është kthyer me të gjitha fuqitë e fundit para vdekjes partisë politike shqiptare (PDSH –ës.), të cilën dje e pështyu publikisht, sot e lëpi për një torbë taxhi në çajtore, përpara gotave të çajit të rusit mbi tavolinë. Edhe, ia fërkon si "mysliman besnik me abdes" nateditë "dardhat" e qullta Dexhallit me trumbeta nëpër Bit-Pazar. Shejtanit të Allahut.

E rren mendja se shqiptarët mysliman ende hanë bar nëpër livadhe. Dhenë të nënkryeme janë të Ali Ahmetit dhe lopë pa brirë të Menduh Thaçit, që turren kope - kope pas kripës te Kryqi Madh i Gruevskit, në malin "Vodno". Partia neokomuniste, që u dha çutek deri më sot të paparë para kamerave televizive për flamurin shqiptar, në Gostivar.

Dhe, mund t'i shesë si dje për pak pare Dashishyti te kasapi… Dexhalli me trumbeta me këngë e valle nëpër Bit - Pazar…

BORË NË PRISHTINË DHE SHKUP

Moti pritej në mes të Pranverës shqiptare, borë në Prishtinë dhe Shkup pas Luftës së fundit (1999) dhe asaj në Tanushë (2001). Ose, siç thotë populli te Ditët e plakave: Prill bre vëlla/ nam tri ditë hua/ ta shuej plakën me gjithë çka ka! Shqiptarët e fituan luftën me Serbinë, por e humbën paqen mes vete me shqiptarët. "Liria" i dalldisi pas Luftës për pushtet, posteve politike dhe interesave personale (pasurisë materiale individuale). Vite me radhë për të ardhur në pushtet, filluan ta hanë njëri - tjetrin si politikanë. Partitë politike shqiptare, filluan përditë e përnatë të pjellin kopila duke na i lënë pas dere. Lehtë e kishim pasur dje të merremi vesh me serbët, por shumë vëshirë e kemi sot me vëllezërit shqiptar. Përedrisa, në kohën e Turqisë vriteshim për një grua, kufi në arë, përrockë uji, në ditën e sotshme filluam t'i nxjerrim armët nga brezi për një karrike, poste politike në Qeverinë e "vëllazërim-bashkimit". Shembull konkret: Menduh Thaçi, takohet kokë më kokë me Gruevskin: "Kryetari i PDSH-së, Menduh Thaçi në tubimin e mbajtur në Debresh të Gostivarit mbrëmë ka folur për takimin e tij të djeshëm me kryeministrin dhe

liderin e BDI-së, Ali Ahmeti: "Çe raketën sot, e keni pyetjen pse u takova me Gruevskin? U takova për ti thënë se ti je gazda i tyre, ndali në kërpesh se më 27 do bëhet belaja e madhe, dhe kjo ishte arsyeja e këtij takimi. Prapë vazhdojnë të pyesin do të jemi ne në qeveri? Prej ditës së diel u jepnin infuzione hordhive të veta, se do jemi ne s'do jeni. Nuk do të jeni, dikush tjetër do të jetë në qeveri. PDSH-ja që ka mandatin e popullit, që e ka mbështetjen e popullit. Po flisni budallallëqe. 40 mijë që kanë dalë më 13 prill nuk janë votues. Ukraina ka 40 milion banorë, po në protestë dalën 40 mijë njerëz dhe e rrëzuan pushtetin", theksoi Thaçi.

Ai porositi qytetarët që më 27 prill të dalin pa frikë e ti thonë Ali Ahmetit se edhe përskaj të gjitha kërcënimeve, shqiptarët do t'i tregojnë atij se çfarë mendojnë për qeverisjen e tij antishqiptare.

Qesharake, kjo politika shqiptare. Për çka "belaja, për t'u bërë Menduh Thaçi zëvendës kryeministër?! Kurrë, më ti në Qeveri me "vëllezërit" e Njerkës! Partnerin strategjik. "Belasë" tënde i vjen era e asaj "Pranverës arabe" të dështuar në Shkup (2013). Edhe, Ali Ahmeti pas këtij mandati, nëse ia jep edhe kësaj radhe populli shqiptar me besa - besë. Problem kam me vetëveten, deri kur ky bërllok politik shqiptar do

të na ngatërrohet nëpër këmbë i arratisur me vite nëpër poste e parti politike?!

Ndërsa, për moton e BDI – së "u tha u bë", Thaçi ka thënë, se: të vetmen gjë që ka bërë BDI e Ali Ahmetit është sjellja e Car Dushanave në Shkup.

Shkronjën RR të madhe dhe rr të vogël nga Abetarja e vë në përdorim në Ditën e sotshme. Rrezik! Rrezik bërtiti Rrahmani: Ujku na ra ndër dele. Katundarët kush me sfurk, kush me lopatë, kush me hu gardhi e kush me shkop u turrën t'i dalin në ndihmë. Rrahmani qeshej në kokërr të shpinës në mesin e deleve. Ogiçëve, kokë më kokë me kumbona përqafe. Herën e dytë, Rrahmani përsëri bërtiti: Ndihmë, Ujku na ra ndër dele! Katundarët, përsëri u turrën t'i dalin në ndihmë me çka patën nëpër duar e mjete bujqësore: shat, kazmë, lopatë, kizë e sopatë. Rrahmani, përsëri me gojën duke qeshur vesh më vesh, zgërdhihej se: i ka mashtruar katundarët. Herën e tretë, më kotë bërtiti Rrahmani se, Ujku i ka rënë me të vërtetë ndër dele! Asnjë katundar nuk lëvizi këmbën nga vendi t'i dalë në ndihmë bariut. Ujku, ia hëngri delet.

Republikën e Kosovës të fituar me luftë dhe gjak, filluam ta bëjmë copë – copë nëpër parti politike. Gati gjithë popullin shqiptarë e shpallëm "spiunë dhe kriminelë lufte". Kosova, përpak na mbeti pa shqiptar në duart e armiqve shekullor,

serbëve. Popull, i cili edhe sot e kësaj dite nuk gjeti kohë dhe hapsirë t'u kërkojë falje shqiptarëve për krimet e luftës fundit të Kosovës (1999). Ose, publikisht të shpallet para syve të botës: Republika e spiunëve. Përsëri, pas gjithë këtyre sakrificave për Liri, duhej t'i kthehej prapë si "plaçkë lufte" Sërbisë. Përderisa, në kohën e Turqisë, Kosovën e kishte shitur Perandoria Osmane, sot e shesin me pare e pa pare vetë shqiptarët. Padashtas, ma kujtojnë këngën e Xha Derallës të Kërçovës, që sa herë e takonim me shkopin me kërrabë në dorë te porta e xha Mazllëmit "Ureja", na e këndonte atë këngë historike antoligjike ne fëmijve me brekët arnë përmbi arnë, hipur mbi kuaj shelgu nëpër livadhe: ***Turku e ka shitur këtë Rumeli/ shtatë xhemi me alltan/ e ka ble ç'aj Moskovi Zi…***

Punë tjetër është ajo këngë, dhe histori më vete shqiptare, pse nuk këndohet edhe në Ditën e sotshme historike?! Ende ka mbetur gojë më gojë të këngëtarve pleq dhe çiftelive me dy tela nëpër odat shqiptare. Nesër, në harresë. Shqiptarët sot për sot janë populli më i "lumtur" në botë. Vetëm hapni kanelet televizive shqiptare, në Shqipëri, Kosovë dhe IRJ të Maqedonisë: Gjithë ditën e natën e lume, këngë dhe valle. Herë duke u përdredhur më një anë, herë në tjetrën anë me përplasje të duarve shuplakë. Popull i dalldisur dhe shashtrisur pas "lali xhanëve, sheqerave,

llokumave e vagabondëve". Qejfit me gra lakuriqe mes parave dhe Zdravko Çoliçit, shundit komunist jugosllav. Dorën në zemër, të dalldisësh pas vlerave të arrira muzikore jugosllave në atë kohë: Josipa Lisac, Misho Kovaç, Tereza Kesovija, Indexi, Pro arte, Korni Grupa, Xhani Marshan e Meri Cetiniç, është për duartrokitje. Ose, legjerndave botërore: The Beatles, Led Zeppelin, The Rolling Stones, Jimi Hendix, Mireille Mathieu, Johnny Holiday, Janis Joplin e Tina Turner.

Ama, të presësh një "xhani xhan" jugosllav si mbretin në Shqipëri, vërtetë me këtë popull nuk është diçka në rregull. Përmëkeq, kur këta artistë nuk i kanë kërkuar ende falje publike popullit shqiptar edhe sot e kësaj dite për genocidin serb, në Kosovë. Patjetër, shpejt e shpejt duhet t'i gjëndet terapia kësaj sëmundje vdekjeprurëse të shekullit. Edhe atë, në bazë të simptomeve sipas një interviste "bombastike" në gazetën beogradase "Veçernje Novosti" të datës 16 prill (2014). Këngëtari i adhuruar aq shumë në Shqipëri, që as vet nuk e kishte imagjinuar dot si serb, Zdravko Çoliq ka deklaruar se "Shqiptarët më pritën në Tiranë si Mbretin!"

Vërtetë, e pritën dhe e përcollën si Mbretin???!!!

Këngëtari serb në prononcim për gazetën beogradase, pos paraqitjes në televizionet

shqiptare, kënaqësisë së Pandi Laços, Salvador Kaçajt, është takuar edhe me ish presidentin e Shqipërisë z. Bamir Topi???!!!

Zdravko Çoliq ka thënë: Kisha shumë fansa në Tiranë, sa që nga ora 7 e mëngjesit e deri në ora 10:15 janë mbledhur mijëra femra dhe për tu fotografuar me mua dhe për autografe… Prandaj, planifikoj në të ardhmen një koncert në Tiranë, por akoma nuk e kam përcaktuar se ku do të mbahej; në "Pallas" ku e ka mbajtur koncertin e tij Goran Bregoviqi, fituesi i çelëçsit të Tiranës nga Edi Rama, apo diku tjetër… por planifikoj koncert edhe në Shkodër!!!...

Organizatorët e koncerteve dhe dalldisjeve të ndryshme muzikore, asnjëherë nuk i kanë hapur dyert krah më krah dhe shprehur gatishmëri, që ndonjë këngëtar shqiptar ta presin si Mbretin, shkaku se, siç duket për organizatorët e koncerteve muzikore, po edhe për publikun e arratisur e shastrisur, pritjet mbretërore i kanë të rezervuara për Goran Bregoviqa, Zdravko Çoliqa, ndoshta një ditë edhe për Vojisllav Sheshelin nëse delë nga Haga, në vend të kitarës me "kallashnik" në dorë.

Goran Bregoviqi, vite më parë u bë Qytetar Nderi i Tiranës. Zdravko Çoliqi, sot u prit si Mbret dhe u takua edhe me Bamir Topin, kush e di se në çfar cilësie… e mbase, tashti radhën e ka Vojisllav Shesheli të shpallet Mbret!!!???

Durtrokitje për ato parti politike me vite në skenën politike shqiptare. Bagazhin e tyre politik për liri gjatë këtyre viteve plot afera politike, burgosje e vrasje në mes të Ditës Madhe. Mjerë shqiptarët, kush u pri në ballë për Liri. Vallë, edhe në Ditën e sotshme duhet lënë gjallë në skenën politike këta kalorës të sëmurë politik për pushtet argati t'i prinë në ballë popullit shqiptar me parulla demagogjike?!

Zoti siç duket, kohën e fundit u hidhërua me shqiptarët, kështu do të thoshte Hoxha i Allahut nëpër shkrimet e tia "profetike" në YouTube, Facebook dhe Bota sot me këmbët dhe trutë në legen. Prandaj, edhe i dënoi Zoti shqiptarët e "pafe" me borë. U tha: Nuk e meritoni Lirinë, rrini në Robëri!… Dimër…

O burra, bini "haramit" me votën e juaj të lirë demokratike!...

"DEBAT" PËR LIBRIN SHQIP NË PRAG TË ZGJEDHJEVE

Përmes telefonit tim personal celular gjatë Panairit të librit të 26 – të, në Shkup (2014) dhe zgjedhjeve presidenciale edhe parlamentare të parakohshme, mora një ftesë: "Të premten në orën 11:30 në komunën Çair do të mbahet një debat mbi sfidat kulturore me shkrimtarë eminent nga shqipëria: Besnik Mustafaj, Flutura Açka, Moikom Zeqo etj. Ju ftoj për pjesmarrje aktive." Thashë: edhe, pse nuk kam shumë kohë të merrem me këto "flijime artistike" të kalorësve të arratisur në Ditën e sotshme, kur shqiptarëve u digjet zjarr mbi krye, vendosa të shkoj në atë "debat" për librin në prag të zgjedhjeve të një "Presidenti musliman" dhe atyre të parakohshme parlamentare. Shkaku se, në atë debat për librin, shumica edhe ishin miq të mi të penës të ardhur nga Shqipëria: Skënder Rusi, Flutura Açka, Besnik Mustafaj, Moikom Zeqo, Yrjet Aliçka e Demir Gjergji. Përmëtepër, të ndihmuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë në bashkëpunim me Komunën e Çairit dhe "Librarinë e Çarshisë", në Shkup. Punë tjetër është ajo se, debatet për librin mbahen nëpër institucione kulturore shtetërore: biblioteka

universitare, shkolla e panaire të librit. Kulminacioni "artistik kulturor": grupit të krijuesve shqiptar i printe në krye Akademiku Dr. Ali Aliu, krah për krahu me një ish deputet socialist nga Shqipëria pa prezencën e krijuesve shqiptar nga Kosova, Mali i Zi, Presheva me Bujanovcin dhe Diaspora. "Akademiku" i tre Akademive shqiptare i njohur në jetën publike për kësi veprimesh "patriotike paralele" në emër të kulturës shqiptare. Personalitet, i nevojshëm për kohën qorre dhe "këshilltar" i të gjitha partive politike shqiptare deri më sot, sa herë që hipnin ato të "bekuara" e rehatoheshin në pushtet, në kokërr të shpinës. Autori i shumë letrave publike deri më sot postuar personaliteve të jashtëm e të brendshëm dhe partive politike për "ndihmë të zgjidhjes" së krizës politike të "vëllazërim-bashkimit". Gjithmonë në krye të detyrës. Përçudi, me vete përveç baxhanakut do t'i marrë edhe pesë-gjashtë kalorës të arratisur historik. Turren me të katra pas postit të një kryetari parlamenti (spikeri), e harrojnë se: në kohën e ish Jugosllavisë kanë pasur kryetar shteti (Sinan Hasani). Edhe, më pyesin në YouTube "hoxhallarët" besnik të Allahut, kur do të bëj vetëvrasje?! Puna më e lehtë e një shkrimtari të kalibrit Kalosh Çeliku për të vendosur përkundër porosive të Kur'anit: Ditën që do të zgjidhet Çështja shqiptare. Megjithatë, politika është artë i

së mundshmes, të cilën nuk e bënë populli, por politikanët e aftë me besimin e tyre në zgjedhjet demokratike. Probleme të tjera kanë shqiptarët, jo të posteve politike, po të zgjidhjes së Çështjes shqiptare.

"Shpëtimptari kulturor e politik" (A. A.), dihej ishte ky burrë mejdani me këlyshët e tij me zgjebe përreth, që siç thotë Shkrimtari i mirënjohur shqiptar disident Teki Dërvishi në një dramë satirike të vënë në skenë gjatë ndryshimeve demokratike në Teatrin e Kombësive në Shkup (Nesër nisem për në Parajsë), na printe si "myslimanë ehamdurila me Din e Iman" për në "Xhehnet". Kultura shqipare, sikur t'i takonte vetëm një ose dy partive politike shqiptare, e jo mbarë popullit shqiptar.

Edhe, e di pa më pyetur fare si lexuesë besnik, u intereson çmimi im i shitjes si Kalosh Çeliku?! Publikisht, e them: Hiç më pak se një miljonë euro. Përsëri, duhet të bisedojmë për pazarin e shitjes të Emrit familjes kaçakëve. Ende nuk e kam ulur çmimin e shkrimtarit në këtë "botë përparimtare kulturore artistike" për një të Nesërme shqiptare. Mund të ma digjni xhipin e dhjetë mijë eurove kur të doni përpara dritareve të shtëpisë, por do t'ju besojë se punoni për popullin shqiptar dhe Atdheun, vetëm atëherë kur do të filloni t'i digjni flakë para vilave të politikanëve xhipat e mbi njëqindmijë eurove: Gruevskit,

Cërvenkovskit, Ali Ahmetit dhe "vojvodës" Mendyh Thaçi.

I vetëdijshëm isha se, do të ballafaqohem me fytyra gërditse të partizanëve të politikës shqiptare, kulturës dhe librit shqip, të cilat do t'i vjellë me gjithë zorrë në ndonjë shkrim timin të ardhshëm publicistik, vendosa pas gjithë asaj kohe të gjatë mungese nëpër këto takime "artistike - kulturore" të shkoj në atë "debat" për librin. Edhe, nuk më doli keq, e përfitova këtë shkrim publicistik për librin shqip në Shtetin e "përbashkët". Dhiaret nëpër të cilat ecë kjo "armë" e vetme besnike e Rilindasëve tanë me shekuj. Fjalën nuk e kam për "Rilindasët" e sotshëm të Edi Ramës. Nëna Parti, përveçse në Ministrinë e Kulturës edhe në këtë "debat" për librin në Shkup, krah për krahu me partizanët e Edi Ramës do të m'i nxjerrë para syve kulturofagët e emëruar nëpër poste politike e komisione kulturore që nuk kanë "haber" nga kultura shqiptare, përveçse prodhimit të tollumbave me shumicë e pakicë në tepsinë e Nënës Parti në pushtet.

Parashikimi im, ishte i saktë: armiqtë e librit shqip erdhën grupe – grupe dhe i zunë vendet e tyre në sallen e Komunës së Çairit, në vend të Panairit të librit (Shkupi 2014) atje, ku maten forcat politike e kulturore të "bashkëjetës" me dy shoqata "joqeveritare" botuese shiptare në letër të

librit shqip: ndonjë bibliotekë, Teatri Shqiptar, institucioni tjetër kulturor. Dashamirët e flaktë të librit shqip dhe shkrimtarët në sallë, patjetër tashti sipas portokolit politik të organizatorëve duhet ta presin edhe Kryetarin e Komunës z. Izet Mexhiti me disa minuta vonesë. Kandidatja për deputete e popullit, zonja Ermira Mehmeti e veshur kuqezi falë Zotit madh erdhi para kohe. Shprehi kjo e zakontë e të gjithë politikanëve, përderisa kanë dele të buta në vathë mes ujqërve të "vëllezërve" të Njerkës. Kope, të cilat nën hijen e dardhave gorrice nuk i mjelë me kusi në dorë Bariu i maleve, por argati i Shejtanit e Dexhallit në Qeveri. Falë Zotit, më në fund mezi erdhi edhe kryetari i Komunës me duartokitje frenetike në sallë. Mikpritje e "përzemërsi shqiptare", sipas traditës të të parëve tanë me mustaqet vesh më vesh, struken hedhur krahëve, sahatin me qystek përqafe e "koburen" në brez. Miqësi sipas traditave shqiptare të cilën nuk e patën krijuesit mysafir nga Shqipëria.

Personazhet e shkrimeve të mia publicistike nëpër libra, i kisha ballë për ballë në numër (kope): Doktorziu si gjithmonë në rolin e "akademikut", në ballë krah për krahu me krijuesit nga Shqipëria. Intelektualët nga Kosova, poashtu e kanë përzënë këtë eksponent unikat të "vëllazërim - bashkimit" nga Prishtina. Strehim ka gjetur ende në Shqipëri dhe IRJ të Maqedonisë

si "azilantë" i përndjekur politik, nga "politikani strategjik" numër dy i LDK –ës të Ibrahim Rugovës, përfundon në Kabinetin e Kiro Gligorovit. Diku, nga mesi sallës edhe këlyshët e tij me zgjebe si "truproje artistike".

Fatkeqësia "artistike": e gjithë kjo "ngjarje kulturore" ndodhte në kohën kur mbahet Panairi i Librit (2014) në Shkup me pesë - gjashtë Shtëpi Botuese Shqiptare si pjesmarrëse sa për sy e faqe, nën nivelin e kohës së komunizmit. Kohë kjo, kur partitë politike në IRJ të Maqedonisë bëjnë luftë të ashpër për pushtet. Libri shqip në Shkup, përsëri mbetet nën hijen e fushatës zgjedhore të partive politike, që bëjnë luftë politike fytas me pak shpirt: jetë ose vdekje. Dhe, pak gjë në jetën e tyre si ministra të kulturës e deputetë kanë bërë për librin shqip. Fjalën nuk e kam vetëm për librin shqip, por për librin si miku më i mirë besnik në përgjithësi nëpër botë dhe "armë paqe". Urën e afrimit të popujve të armiqësuar e përgjakur nëpër shekuj. Shkrimtarët, që prej kur ekziston bota, politikanët i kanë marrë për shërbetorë të Oborreve dhe "armiq" të Shtetit. Njerëz të marrë që shkruajnë edhe poezi. Shumica kanë vdekur edhe për bukën e gojës: Asdreni, Lasgush Poradeci, Frederik Rreshpja, Pano Taçi, Teki Dërvishi, Anton Pashku, Mirko Gashi, Sadudin Gjura, Mehmedali Hoxha, Abdylazis Islami, Shaqir Sadiku, Fadil Bekteshi

me shokë, që edhe sot e vazhdon lufën matanë gardhit në mesin e varreve.

Megjithatë, shkrimtari si misionarë për të përhapur dashuri dhe paqe nëpër botë, ndonjëherë edhe ka qenë i dalldisur nga politikanët në ballë të popullit. Partizanët e tyre, si krijuesë Oborri. Rrufjanët, që pa fije turpi vazhdojmë t'i shohim krah për krahu përballë nëpër "organizime kulturore". Shembull i freskët unikat është Shkupi. Panairi i librit (2014), ku njëra palë (maqedonase) me të gjitha "nishanet" e Shtetit të "përbashkët" bënë propogandë artistike zyrtare për librin dhe pala tjetër shqiptare me kalorës të arratisur, shtihet se gjoja bënë jetë artistike paralele politike dhe kulturore. Veprimet e tyre i kemi të njohura edhe me Mbrëmjet e Poezisë në Strugë. Panaireve tjerë të librit, në Shkup ku këtyre aktiviteteve "paralele kulturore" gjithmonë u pri një partizan i "përjetshëm" (A. A.), që nga koha e shokut Tito duke i "strehuar aktivitetet kulturore" nëpër skuta të errta të çajtoreve, gjoja se bënë "politikë madhore kulturore" për t'i hyrë në qejf liderit partiak në pushtet, të cilin deri më sot e mori më qafë si shumë liderë të tjerë shqiptar. Honoraret marramendëse nëpër komisione politike-kulturore të shtetit të "përbashkët", pensionet e tre shteteve dhe Akademive shkencore, botimin e kompleteve të

librave, ose të ndonjë libri të tyre "historik" me vlera të "arrira artistike".

"Kritikun" e ri letrar (Këlyshin me zgjebe), gjithmonë e kanë me vete, vetëm Nëna Parti t'ia bëjë me gisht dhe ai mezi pret t'i ndërsehet, lehi pas shpine ndonjë krijuesi shqiptar disident. Moti e kam thënë këtë fenomen të çuditshëm shqiptar, dhe e kam rrahur me çekiç në zjarr si farkatari pykën e hekurit. Tjetër punë është ajo se, ky nuk është pykë hekuri, por pykë druri, edhe atë: shelgu. Edhe, e di se për lexuesin bëhem banal nëpër shkrimet e mia parashikuese publicistike. Vetëmse, nuk kam faj unë si shkrimtar. Faji është i përgjithshëm kulturor mbarëshqiptar, që këto kulturofagë me vite, edhe sot e kësaj dite i ngatërrohen nëpër këmbë popullit shqiptar.

Dorën në zemër, në atë "debat" për librin kanë qenë në nivel "kulturor" të diskutimit, se ato dinë të dalin në foltore me diskutimet e tyre dhe të harrohen me orë, të mos dinë të zbresin nga skena "kultuore" patriotike. Përjashitm bënë këtu një "lexuese" e flaktë e librit, që hyri jashta portokolit të "debatit". Këmbë nguli që të thotë disa fjalë në këtë "debet" për librin shqip. Organizatori edhe pse nuk e kishte paraparë me program "debatin", i la hapsirë si femër shqiptare "pa të drejta të barabarta të grave." Edhe e dini çka ndodhi: diskutantja iu dalldis pas një shkrimtari prezentë aty në sallë. Librin e tij e

kishte lexuar së bashku me ish të dashurin e saj në një plazh jashtë Atdheut dhe i kishte lënë shumë përshtypje artistike. Shkrimtari në fjalë sipas saj ishte edhe më i madh se Ismail Kadare?! Shkaku i "frymëzimit" të këtij shkrimtari, ajo i kishte shkruar mbrëmë një letër dashurie edhe ish të dashurit të saj, që e kishte braktisur moti para këtij "debati kulturor" për librin shqip. Haptas, në prani të publikut i vardisej si "lexuese", ose e provokonte shkrimtarin "problematik" të Nënës Shqipëri. Edhe, patjetër me të kjo "lexuese e flaktë" e librit duhej të pi një kafe intime, sy më sy brenda katër mureve. Merreni me mend, edhe me cilin: shkrimtarin, që para pak kohe e kishte bërë një shkrim autobiografik në superlativ për Ali Ahmetin?!

Kalorës të arratisur nëpër partitë politike shqiptare që i kemi me qerre, deri kur do t'i lëmë të bredhin rrugëve me krijusit shqiptar të Atdheut: për pak pare dhe një dreke e një darke të varfër të shiten gjithë jetën tek politikanët e pandërgjeshëm në shërbim të politikës ditore shqiptare?! Krijuesë të cilët i kënaqi Atdheu (Shqipëria), tashti kanë mbetur të provojnë edhe bukën e "hidhur" dhe mëshirën e partizanëve politik shqiptar të IRJ të Maqedonisë (kurbetit). "Dashamirëve" të librit, që përshëndesin me duartrokitje frenetike hyrjen e politikanëve në sallë para kamerave televizive e jo poetët dhe

poezitë e tyre të shkruara me shpirt e gjak, gjatë netëve të pagjumë para syve të Dexhallit me trumbeta nëpër Bit - Pazar. Fushatës së tyre parazgjedhore pa krye për pushtet t'u bashkohen me poezi e libra, e ato kur do të hipin nesër në pushtet do t'i shpërblejnë si "veteranë lufte" të hedhur në rrugë pa bukë. Krijuesë me Kakademikun në krye t'u pri në arsimin bashkëkohor dhe kulturën mbarëkombëtare shqiptare… Nesër?!...

QINGJI VOGËL

Këngët për fëmijë, që rrotullohen natediditë nëpër radiostacione televizive dhe libra të këndimit anembanë Atdheut, shumica janë nën nivelin artistik të këngës për fëmijë: ***Qingji vogël***. Këngë për fëmijë e cila është kënduar plot "gëzim" para shtatëdhjetë vjetëve. Qamil Guranjaku një poet i mirënjohur për fëmijë me vjershat e të cilit nëpër librat e këndimit isha rritur në vendlindje pa e ditur se kush është autori i atyre vjershave. Vite më vonë, në Prishtinë do të më bie në dorë edhe libri i tij: ***Xixëllonjat e vogla***, botim i Rilindjes si lektyrë e obligueshme shkollore.

Qingji vogël, tekst shumë i fuqishëm i të gjitha kohërave, dhe shumë i thellë për nga mendimi dhe vlerat e arrira artistike e pedagogjike, që i bënë ballë kohës edhe sot e kësaj dite. Këngë për fëmijë me të cilën janë rritur nëpër beteja me libra në dorë e lapsa në brez me vite shkollarët shqiptar në shi e borë:

Qingji vogël rri mendushëm
Be be ban.
Pse m'shikon ashtu trishtushëm
Be be ban.

Eja eja bashkë në arë
Tring tring tring.
Unë m'bledh lule ti ha bar
Tring tring tring.

Shif n'livadh Fatos i dashtun
Be be ban.
Shokt e mi n'tufë janë mbledhur
Be be ban.
Unë i vetëm u mërzita
Tring tring tring.

Babi mu më ka premtue
Qingji im.
Në koperativë me t'que
Qigji im.
Do bëhem baresh e fshatit
Tring tring tring.
Do t'kullos n'brigje t'shpatit
Tring tring tring.

Mendimi im: asnjë Abetare, asnjë libër i këndimit deri në klasën e tretë fillore nuk duhet të dalë në dritë pa këtë këngë për fëmijë. Publikisht e them: asnjë orë e edukatës muzikore, nuk duhet të fillojë pa këtë këngë për fëmijë. Përderisa Himni i flamurit shqiptar është me tekst të Asdrenit, Qingji vogël duhet të jetë Himni i fëmijëve shqiptar.

Ditën e sotshme, kujt t'i teket shkruan vjersha për shkollarë dhe tekste për këngë të fëmijëve. Vetëm, duhet t'i kesh njëqind euro për tekstin dhe pesëqind për kompozimin e muzikës të një kënge. Ditën e nesërme merr pjesë në fastivalin e fëmijëve të cilët i kemi me bollëk në Shqipëri, Kosovë e IRJ të Maqedonisë, gati në çdo qytet nga një festival për fëmijë, por nuk kemi vlera aq të arrira artistike që mund të maten me nivelin dhe fantazinë e fëmijve të shkollarëve, që sot lindin para televizorit, kompjuterit. Malli i ka marrë fëmijët e qytetit për livadhe me lule. Qëngja, viça e mëza nëpër lëmë, pula e gjela që i zgjojnë me këngë në mëngjes. Dashit me brirë t'i hipin në shpinë. Fyellin e bariut te Lugu i Ymerit nën hijen e Drdhës gorrice.

Nënat dhe baballarët të gjithë fëmijët e tyre duan t'i bëjnë këngëtarë. E, asnjëri bari të deleve, bujk, mjeshtër të ëmbëlsirave, këpuctar, rrobaqepës, berber, mekanik. Punë tjetër është ajo se, kanë apo nuk kanë talent për muzikë. Fjalën e fundit e ka thënë nëna si qafa e shtëpisë: fëmiu i saj do të bëhet këngëtar. Babai i shkretë me copën e bukës në dorë duhet të shkojë në punë. Para të sigurojë për familjen dhe fëmijët e nënës, që patjetër nesër duhet të bëhen këngëtarë, mos më shumë së paku i nivelit të "nanit xhan", sheqerave e Xhemile llokumave.

Ankohemi, se, fëmijët tanë rrinë gjithë ditën e natën me lojëra kompjuterike përpara ekranit të kompjuterit në Facebook. Librin si dikur nuk e kanë shok. Mikun më të mirë në jetë. Edhe, do të rrinë gjatë kohë, përderisa shqiptarët do të kenë këtë nivel të poetëve dhe kompozitorëve për fëmijë.

Përderisa, bëjnë marrëveshje politike me Gruevskin dhe Cërvenkovskin për poste politike, mirë do të ishte këto liderë politik të popullit shqiptar të bëjnë marrëveshje me popullin shqiptar: ne t'ua japim atyre votat e "lira demokratike" pa gjithë këto shpenzime materiale e propaganda parazgjedhore politike me një kusht: Paratë e harxhauara për fushatat parazgjedhore t'i derdhin në llogaritë rrjedhëse të shkollave shqipe për fëmijët shqiptar, për tekste shkollore, lektyra shkollore dhe revista për fëmijë.

Dhe, në Ditën e sotshme Qingjin e vogël nuk e çojnë më në Koperativë, po në vathën e "vëllezërve" të Njerkës, te "Vojvodë" Kasapi t'ua therin partizanëve të vonuar gjatë fushatave parazgjedhore për "fitore historike".

Sofrën e "Vojvodës", i cili në kualicion qeveritar me Gruevskin hy edhe me një deputet në emër të popullit shqiptar…

POLICIA SEKRETE LETRARE

Vargu poetik shqip, kur ka hyrë për herë të parë në Bit – Pazar, partizanët e sotshëm që ngrejnë krye si "gjela kryengritës" të Koço Racinit në perëndimin e "duhanvjelësve", dhe hiqen si "patriotë kuqezi" pas lufte e përurojnë kulturë "mbarëkombëtare" në Shkup, dje strukeshin nëpër zyrat e redaksive të "vëllazërim - bashkimit", me shumicë e pakicë të shitur për një post redaktori, vend pune. Përmëtepër, shkolloheshin, flisnin dhe shkruanin plot gëzim e krenari në gjuhën zyrtare të "perspektivës" dhe deklaroheshin si shkrimtar maqedonas (sot "shqiptar"). Burra të grave, që gërhasin nëpër biruca institucionale të Shtetit "përbashkët" si mbeturina të zjarrta veteranësh lufte mes partive politike shqiptare. Partizanë me "pushkën" në krah të ish miniministrit Kulturës të zënë robër "lufte" në ministri, si këshilltarë, shefa Kabineti e Hajrica. Përmëkeq, edhe sot si dje i sulen tinëz pas shpine nga pusia kulturës shqiptare. Krah për krahu me gjysmanalfabetë si anëtarë të komisioneve kulturore të emëruar nga partia politike shqiptare në pushtet pa asnjfarë bagazhi letrar. Tollumbaxhi, që përveç limunadës dhe bozës nuk dinë tjetër zanat, "art popullor" me të cilin dikur e pushtuan edhe Jugosllavinë e shokut

Tito. Masha shqiptare, që si rriqërat i janë ngjitur kulturës shqiptare dhe nuk e lënë të marrë lirshëm frymë edhe në Ditën e sotshme, kur bota më veç ia ka hapur dyert krah më krah. Lirë, mos them pa pare e shesin krijuesin shqiptar te "vëllezërit" e Njerkës. Pamëshirë e sakatojnë me gërshërët politike librin shqip, ngulfasin revista letrare dhe manifestimet kulturore, që i themeluam dikur me djersë, shpirt dhe gjak. Vite me radhë kulturën shqiptare po e qepin struke për ta hedhur krahëve partizanët e partive "demokratike" gjatë fushatave zgjedhore për poste politike në Qeveri.

Publikisht, të shitur për ta sharë dje në gazetë Ismail Kadarenë si shkrimtar "nacionalist dhe irredentist". Rast, për të cilin Tek Dërvishi për mosbindje të "politikës" së Redaksisë edhe do të përjashtohet nga puna krijuese në gazetën "*Flaka e vëllazërimit*". Shkaku, se: nuk pranoi një urdhër të tillë komunist antishqiptar me direktiva nga policia sekrete letrare kundër Ismail Kadaresë. Soji i këtillë "patriotik" i Nënës Parti, edhe i ndiqte shkrimtarët disidentë shqiptar këmba – këmbës, në kohën e "artë" komuniste të "vëllazërim – bashkimit". I ndjek edhe sot, më zi se dje me porosi sekrete partiake. Tekefundit, nuk e di unë: si mund Askushi të marrë guximin të vendosë për vlera artistike kulturore në Shkup për një Lasgush Poradeci, Ismail Kadare, Frederik Rreshpja, Pano Taçi, Dritëro Agolli, Xhavair

Spahiu, Bardhyl Londo, Teki Dërvishi, Musa Ramadani, Hida Halimi, Gani Xhafolli, Sadudin Gjura, Mehmedali Hoxha, Abdylazis Islami, Murat Isaku, Nexhat Pustina e Vahit Nasufi me shokë?!

Përçudia, cicërroni edhe sot si dje "cic-mic" nën ferrë. Bërllok shqiptar, që në mes të ditës do ta hidhni gurin dhe do të përpiqeni ta fshihni dorën. Lëmsh do t'i bëni projektet kulturore shqiptare, vetëm e vetëm që ta dëmtoni Letërsinë shqiptare. Artistët i ndani sipas "arshinit" tuaj familjar e klanor nëpër parti politike. Pavetëdije se, ato nuk i takojnë vetëm një partie politike, po mbarë popullit shqiptar. Punë tjetër është ajo se, në mesin e tyre mund të gjeni edhe ndonjë trusakat me vulë partiake në ballë, të cilin Nëna Parti duhet ta tërheqi për dore rrugës krijuese, turret me të katra pas çmimeve letrare. Pensioni jetësor të "merituar" me një këmbë në varr. Ose, ndonjë kalorësi të arratisur me kokën nën sjetulla e palarenë në Livadh përkarshi Diellit.

Fatkeqësia kombëtare: Lepuri fshihet nën ferrat e partive politike shqiptare. Shembull konkret: Instituti i Trashëgimisë Kulturore "Pjetër Bogdani", në Shkup. Vërtetë e themeloi PDSH – ja (me kryetar Arben Xhaferi), por e mbanë gjallë BDI – ja me Ali Ahmetin. Duartrokitje, ia vazhdon jetën shkencore. Gabimi historik, nuk

duhet ta veshi me petka "kombëtare" njëpartiake. Dëmi: Partitë Politike Shqiptare sa herë që vijnë në pushtet, më së keqi e pëson arsimi shqiptar dhe instucionet kulturore, që këto "Nëna shqiptare" nuk arrijnë t'i kenë në xhepin partiak, prandaj i përkund Njerka në djep me ninulla frike mbi kokë. Arsimi dhe kultura shqiptare kanë plot shembuj konkret: tekstet shkollore, lektyrat shkollore. Manifestimete kulturore dhe e vetmja reviste letrare STILI 97 që i përballoi të gjitha kohërat e partive politike, por jo edhe asaj të BDI –së. Policia sekrete letrare "guerile" e paritve politike përpiqet ta heshti këtë reviste letrere e vetmja dritare që i hapi dyert krah më krah për të rinjtë dhe një zë i ri me vlera artistike në Letërsinë shqiptare. Revistë letrare, që disa numra jubilar ua ka përkushtuar fytyrave më të ndritura letrare të popullit shqiptar: Lasgush Poradeci, Frederik Rreshpja, Xhevahir Spahiu, Pano Taçi, Sadudin Gjura, Mehmedali Hoxha, Abdylazis Islami, Murat Isaku, Teki Dërvishi, Anton Pashku, Mirko Gashi, Hida Halimi, Fadil Bekteshi etj. Zërin, sot ngrej lartë deri në qiell: Duart larg nga arsimi dhe kultura shqiptare. Copë – copë po të doni bëni veten te Policia dhe Ushtria e Shtetit të "përbashkët" t'i vishni këmbekrye me rroba partiake. Edhe pse, sipas standardeve botërore edhe këto institucione të shtetit nuk duhen të jenë të politizuara deri në

palcë nga partitë politike. Shkaku, se: partitë politike vijnë e shkojnë, ndërsa arsimi dhe kultura shqiptare, nuk vjen lehtë e as nuk shkon nga zemra e një populli. Punemadhe, që unë i pres nën Rrap si partizanë "kuqezi' shqiptar me brekët nëpër këmbë e rraçet në dorë për mejdani. Përpiqeni me të gjitha "armët" politike t'i injoroni haptas shkrimtarët shqiptar anë e mbanë Atdheut?! E keni gabim, zëri i tyre është dëgjuar dje (2001) në kohë edhe më të vështira duke i ulur me poezi edhe tytat e tanksave, dhe do të dëgjohet edhe Nesër si varg kryengritës nën Rrap, në Shkup.

Përçudi, sot mu ato masha shqiptare pa asnjëfarë bagazhi kulturor letrar, vëndosin për vlerat e arrira artistike dhe propagandojnë vlera kulturore shqiptare në Shkup nën sjetulla të partive politike. Ndonjëri herë pas here edhe më ndërsehet pas shpine. Kulturofagët, harrojnë se kulturën e kanë krijuar dhe e mbajnë gjallë artistët dhe jo partizanët e partive politike për interesa personale dhe përfitime materiale të Shtetit të "përbashkët" Njerkës, që shkaku tyre krijuesit shqiptar vdesin edhe për bukën e gojës. Manipulojnë me vlerat artistike krijuese të autorëve shqiptar, që nuk ka kush nga ikja e kësaj bote t'u vë as edhe një gurë nën krye në varr, rrëzë Çukës. Rrufjanët komunistë, që ende i kemi nëpër këmbë edhe sot e kësaj dite. Zhurmë

kulturore bëjnë nëpër skutat e errëta të Çarshisë Shkupit, kur Dexhalli me ndihmën e tyre moti e ka "pushtuar" me trumbeta, shund-kulturë këtë Çarshi shqiptare. Dhe, harrojnë trusaktët se: pa trurin (Trungun) shqiptar me gjithë degë anembanë Atdheut, nuk ka Shtet Etnik Shqiptar e as kulturë mbarëshqiptare që mund të rri krah për krahu dhe bëjë ballë asaj botërore.

Faj nuk kanë krijuesit shqiptar, me të cilët bredhin "cic-mic" këta matrapazë të sëmurë për

karrierë politike e të shitur lirë: një vend pune në ministri të kulturës, anëtar komisioni ose për pak pare, por Partitë Politike Shqiptare që i kanë emëruar me vite si "kuadër deficitar" shqiptar nëpër institucione kulturore të Shtetit të "përbashkët" si "tru" unikat shqiptar për studim shkencor. Fatkeqësisht, aty – këtu edhe ndonjë fundërrinë partiake katundi, bashkorganizatore e këtij striptizi kulturor me "karvane të librit' të improvizuar nëpër disa qytete e përurime sakate nëpër Shkup si vlera të "arrira artistike" me botuesë shqiptar: auto shkolla, shtypshkronja, librari e tregtarë libri?!

Turp, i Shekullit! Vallë, është qorre kjo "ajkë" partiake shqiptare me sytë në ballë, apo nuk e di se kush e ka futur i pari vargun shqip në Çershi të Shkupit?! Revistën letrare STILI 97, si një zë i ri në Letërsinë shqiptare, që këto kulturofagë përpiqen ta ngulfasin me të gjitha forcat "artistike" në mes të Shkupit. Shkaku se, me vite nuk arritën ta shtinë si plaçkë lufte në xhepin e partive politike. Kurrë, Shkupi nuk pa pasur në jetën e vetë historike aq shumë poetë nga Atdheu. Edhe, me djersën e kujt mbahet gjallë kultura shqiptare në Çarshinë e Shkupit, që hë për hë partizanët e partive politike shqiptare me brekët mbi pantollona e kanë bërë një kontenjer kulturor bërlloku përpara Vetësherbimit, në Bit - Pazar. Fundi fundit, së paku, të kenë turp si

"artistë me famë" partiake Oborri, po ku ka turp ky bërllok shqiptar?! Poezi "patriotike" lexon dhe bën "art madhor" mes dudumëve, në Shkup. Këmba – këmbës i ndjek krijuesit shqiptar.

Poetët nga Shqipëria, shumicën i kam miq dhe shumë manifestime kulturore i kemi organizuar dhe i mbajmë gjallë së bashku edhe në kohët më të vështira: në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi e IRJ të Maqadonisë. Nuk e di se si e ndjejnë veten si poetë miqtë e mi poetë mes këtij mjerimi kulturor shqiptar kur lexojnë poezi patriotike për Atdheun, në Shkup krah për krahu me krijuesit shqiptar nga Kosova, Mali i Zi, Presheva e Bujanovci dhe poetëve shqiptar të mirënjohur nga Maqedonia?! Ditë "festive poetike", kur për fatin e tyre dhe vlerat artistike vendosin trusakatët e partive politike.

Politikanët, siç duket për inatë të poetëve i do edhe vetë Zoti. Nevojë për poetët, politikanët kanë vetëm para fushatave zgjedhore. I blejnë një drekë ose darkë dhe një honorar simbolik sa për sy e faqe. Fushatës parazgjedhore t'i bashkangjiten me "aktivitete kulturore": karvani librit, "debate" për librin, përurime e ndonjë ore letrare me partizanë të partive politike. Paratë e popullit kotnasikoti i harxhojnë për reklama dhe propagandë të shashtrisur zgjedhore. Dyluftime të ashpra partiake. Vetëm një darkë partiake miqësore ministri, kushton sa një manifestim

kulturor tradicional ndërkombëtar. Një pllakat i kryetarit të partisë për ta veshur pallatin lakuriq nëpër sheshe, sa gjithë buxheti i programit të Ministrisë së Kulturës i ndarë për botime të librave në gjuhën shqipe. Fishekzjarret e shkrepura të panumërta në qiell nëpër sheshe, aqsa do të na kushtonte botimi i lektyrave shkollore dhe revistave për fëmijë. Faji nuk është i politikanëve, por i krijuesëve që u shkojnë përmbrapa si dhelpra dashit, mos i bien udhës.

Zoti i dërgoftë në Parajsë ose Xhehnet (siç thonë myslimanët), këta kalorës të arratisur! "Fitoren" e tyre historike shqiptare. Shkupi nuk ka nevojë për partizanë të dalldisur "istikamesh" në Ministrinë e Kulturës dhe atë të Arsimit të veshur fundekrye me petka partiake, që mu si dje edhe sot me gjysmanalfabetë e nëpërkëmbin për vdekje kulturën dhe arsimin shqiptar para syve të popullit. Polici sekrete letrare, që i ndjek nga pusia krijuesit shqiptar me sulme "guerile" pas shpine...

REKLAMAT E "GRISURA" TURISTIKE NË SHKUP

Haxhi Rrenci nëpër Bit – Pazar me tri kësula – leckë në kokë, të zeza e të bardha: një në kokë, e dy nën sjetulla. Asnjë shqiptare (kësulën e Bajram Currit), sot nuk i hipë më gomarit si dikur te vjersha e Mark Krasniqit nga Prishtina për në Mekë, por avionit (Shejtan Arapit) nëpër qiell, nga Shkupi për në Londër, Stamboll, Damask e Moskë. Edhe, gomari i tij asht e lëkurë me gjithë samarin me plaçka në shpinë, nuk cofë rrugës ende pa mbërri në Kaçanik, po i thyhet këmba (rrota), rrëzohet papritur në Divjak (Shqipëri), ose selitë e Partive Politike "Demokratike" Shqiptare, në Tetovë.

Haxhi Rrenci, pothuajse i ka shëtitur me rend të gjitha Partitë Politike Shqiptare, përderisa ato nuk e kanë përzënë si "hoxhë analist - politikan vizionar" me shqelma, jo nga Dera e madhe e Shtëpisë, por për dritare bythekrye në rrugë mes kontenierëve të bërllokut. Punë tjetër është ajo se, a kanë nevojë Partitë Politike Shqiptare për këtë soj të Haxhi Rrencit?! Edhe populli shqiptar, pa i hudhur nga samari këto haxhi rrenca me shumicë e pakicë, kurrë nuk do të ngrejë krye si popull me tradita historike. Haxhi rrencat në Ditën e sotshme nuk i kemi

vetëm në xhami, po edhe në arsim, kulturë dhe politikë. Përçudi, kohën e fundit e kemi në skenën politike edhe haxhi rrencin e sojit të kritikut të dalldisur letrar me brekët mbi pantollona me një kordhë kanapi përqafe. Shkrimtarin, që e përfundoi karrierën e tij "artistike" vetëm me "iniciativa" gjithë jetën, në prehërin e partive politike. Personazhin e kalorësit të arratisur, që bëjnë vetëm zhurmë kulturore nëpër Çarshi dhe institucione gjoja "shqiptare shkencore", veshur këmbekokë me petka partiake, të "tarshigimisë kulturore" me përurime të librave dhe dy "revistave shkencore", që dalin sot me direktiva dhe porosi sekrete letrare partiake. Kohë shterpë kjo sot, kur bota mezi e nxjerrë vetëm një revistë shkencore. Pikëpyetje, për nesër?! Ditën me diell, ku do ta fusin kokën, në xhepin e cilës partie politike?!

Revistën letrare "STILI 97", një zë i ri në Letërsinë Shqiptare pas ndryshimeve demokratike, përpiqen ta marrin nëpër këmbë me të gjitha forcat e errëta policore politike. Zëri, që krah më krah ia hapi dyert vargut krynegritës në letërsi dhe e shtiu i pari poezinë shqipe në Bit – Pazar, nën Rrap. Organ kulturor letrar i Lidhjes të Shkrimtarëve Shqiptar në Shkup për Ditën e Nesërme, që kulturofagëve me brekët mbi pantollona do t'u duhen edhe njëqind vjet punë policore sekrete, që ta fshijnë nga historia

kultuore shqiptare. Shkaku se, faqeve të tij anekënd botës përparimtare, jetojnë dhe u dëgjohet zëri kryengritës fytyrave më të ndritura rebele të popullit shqiptar.

Populli shqiptar, vetë është aq i mençur saqë, unë nuk kam nevojë t'i rri me këshilla dhe përralla arabe nateditë mbi kokë. Gjumë të rehatshëm të bëjë në djepin që e përkund me vite Njerka. Patjetër, në këtë shkrim duhet ta them edhe një të vërtetë si ngjarje historike kombëtare: Rilindjes Demokratike Shqiptare me në krye Rufi Osmanin, në prag të zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare, nuk i duheshin reklamat e "grisura" turistike në Bit – Pazar: "lutja - kandidimi" në mjetet e informacionit e një kalorësi të arratisur (harxhuar) politik për deputetet të popullit, gjoja se ai më në fund nuk e pranoka si "intelektual i pavarur". Dhe, mu ai përmes kanaleve sekrete politike policore e propozon si kandidat të mundshëm, një komandant lufte. Kandidat, të cilin e "ndjek" maleve edhe ligji, e në anën tjetër, ai plasi edhe për së dyti herë të bëhet deputet i këtij Shteti "demokratik"?! Shkak kryesor ky, për të cilin edhe i humbi këto zgjedhje parlamentare (2014) Rilindja Demokratike Shqiptare. Forca e vetme politike, në të cilën edhe i kishte populli shqiptar shpresat për ndryshime politike në IRJ të Maqedonisë. Hap i gabuar politik parazgjedhur, që më në fund pas humbjeve të zgjedhjeve e shtiu

Rufi Osmanin të jap dorëheqje nga posti i kryetarit dhe tërheq kandidatin e vetëm të deputetit të fituar në këto zgjedhje parlamentare. Guximi nuk ishte i Rufi Osmanit me Partinë e tij të Rilindjes Demokratike, po i popullit shqiptar, që e di rrugën e vetë për në Baba Tomor. Malin e Shenjtë të Perëndive Shqiptare. Tyrben, ku pihet vera, shkruhet poezia me shpirt dhe gjak. Dhe, bëhet dashuri për fitore në Tyrbe.

Kohën e fundit, Haxhi Rrenci nuk shkruan hajmali, po me këmbët dhe trutë në legen, nateditë rri në YouTube si "analist politik". Komente "dashurie" anonime më shkruan nën shkrimet parashikuese publicistike për Nesër. Misionin e haxhillëkut e ka përfunduar në Londër, Stamboll, Damask, Moskë e Shkup. Përçudi, merret edhe me "politikë madhore". Kokën tek Partitë Politike Shqiptare, e palarenë tek ato të Njerkës, përpara Vetëshërbimit, në Bit-Pazar, mos them: në polici. Çaj rusi pi dolli me "bardake" e bri dashi të cofur nëpër çajtore, dhe shetë mend "pejgamberi" të vonuar me "diplomë hoxhe" arabie tek Partitë Politike Shqiptare. Nuk e do Njerkën me pashterkë të kuqe, por Njerkun me herdhet e dëkome të Hadumit nëpër këmbë. Publikisht, edhe ia premton votën e "lirë demokratike". Shkaku se, ai ia jep vizën, e hip në aeroplan për në Londër dhe Mekë. Haxhi Rrencit, nuk i duken "myslimane" edhe nuskat

shpëtimtare që ia shkruan Shkrimtari në mjetet e informacionit duke e thirrur të bie në "Din e Iman".

Ooo Haxhi Rrenci, kthehu në Shtëpi te gruaja dhe fëmijët! Burra të tjerë kanë qenë ata që kanë dalur maleve kaçakë për Liri. Kësulën e bardhë të Bajram Currit, nateditë e kanë pasur në kokë. Tirqi me dymbëdhjetë gajtana e xhamadanë me sumbulla. Struken hedhur krahëve. Mauzerrin në dorë e nagantin në brez me nëntë fishekë. Kurrë, nuk e kanë shitur veten nëpër Bit – Pazar një çaj rusi. Nuk ka mbetur në rrezik Njerka e "Babait" (Tatkoto) për burra të sojit tënd "mysliman" pa herdhe në mes të këmbëve me qallmë turku në kokë nateditë në xhami.

Tinëz, si përgjigje: Haxhi Rrenci përpiqet ta spiunojë Shkrimtarin tek Njerka dhe liderët politik për një torbë taxhi. "Pejgamberi", siç ka qejf ai ta thirrë veten gjoja se, vetëm ai ditka t'i lexojë shkrimet profetike të Shkrimtarit edhe mes rreshtave?! Jerm, flet edhe në një analizë politike për Ali Ahmetin (Abazin), që bashkë me "patriotin" e tij melez deri dje e kishin "mik" lufte e sot armik "pushteti". Publikisht, i shpallnin "dashuri" politike në mjetet publike të informacionit në gjuhën shqipe. Interesi personal për poste politike e fetare: njëri, të emërohet zv/drejtor i MTV -së (Redaksia në gjuhën shqipe) e tjetri hoxhë në xhaminë "Isa Beu", në Shkup.

Shtëpinë e Zotit, ku Haxhi Deputetin e grushtuan mu si Shejtanin e Allahut në Qabe me gurë para kamerave televizive. Punë tjetër është ajo se, nuk ishin të aftë si kalorës të arratisur vendit të punës t'i dalin zot, prandaj sot edhe me gjithë "brigadën ushtarake", gurë e dru hedhin mbi Ali Ahmetin. Lotët rrëke u shkojnë fytyrës, e kërkojnë Abazin e Malit për shpërblime si "trima pas lufte", e nuk e dinë se: Abazi djeshëm i malit, sot është Ali Ahmeti i fushës.

Haxhi Rrenci shkruan për "ndarjen" e popujve, e harron se nën këtë çati: kurrë, nuk ka pasur ndarje në baza nacionale dhe fetare mes këtyre banorëve të këtij nënqielli, por ka pasur ndarje sipas propogandës parazgjedhore për pushtet të partive politike e fetare. Shekuj me radhë, këto popuj jetojnë bashkë nën një çati qiellore. E ndihmojnë njëri - tjterin në çdo rrezik, qoftë natyroror që u vjen nga qielli, ose njerëzor nga toka. Fakte ka me thasë, që këto popuj gjatë luftërave ballkanike edhe ia kanë shpëtuar jetën fqiut si mik. Kurrë, nuk e kanë parë veten në rrugë si armiq, as dje e as sot, por si miq krah për krahu nëpër shekuj. Edhe në lindje, edhe në dasma, edhe në vdekje.

Haxhi Rrenci, në Ditën e sotshme përpiqet të na rrëfejë edhe përralla arabe të "njëmijenjënetëve" me qilima fluturues nëpër qiell: "Titulli i këtij shkrimi është nga fotografia

kur një grup protestantësh shqyen një poster të madh të kërçovasit, liderit të BDI-së, Ali Ahmetit, nga fasada e një ndërtese në Bit Pazar. Pamja e parë që u paraqit pas mënjanimit të parë të këtij afishi elektoral, që ishte vendosur aty para afatit ligjor për fillimit të fushatës, ishte një reklamë tjetër: Përshëndetje Shkupi!

Gjithsesi, lirisht dhe ndaras, mund të lexohet edhe titulli i këtij shkrimi duke e pasur parasysh edhe atë se LSDM-ja që moti kishte vendosur të mos bëjë politikë në Kërçovë, por kështu, etnikisht të veprojë. Shumë më përpara se sa t'i kujtohet kjo DPMNE-së edhe në atë kohë, para 24 dhjetorit, atëherë kur edhe sipas LSDM-së kishte shtet. Kurse tani, sigurisht për shkak se Shkupit do t'i mungojë "Sinan Sakiçi", LSDM-ja u kthye edhe në Kuvend, sigurisht me dëshirë muzikore të vetporositur nga ndonjë këngë e tij…Deri në lexim të ardhshëm, në prill."

Shkrim teknefes, "mish –mash". Fundekrye, hajmali hoxhe. Haxhi Rrenci, siç duket nuk di shkrim - lexim, mos e them gjuhën shqipe. Ose, kur i shkruan "hajmalitë" e tia politike, truri ia dikton në gjuhën amnore të shkollimit me "prospektivë", mezi i hedhë mendimet me plotë shterëzime në gjuhën shqipe. Edhe unë, nuk e dua Ali Ahmetin si politikan, ama nuk mund t'ia mohoj veprimet pozitive politike dhe disa thënie profetike: "***me dimija dhe mjekra, nuk shkohet në Xhehnet***". Larg qoftë, të mendoj se nuk ka

gabime në "politikën e tij madhore" shqiptare. Njerëz jemi, dhe bëjmë gabime në jetë, përderisa e kemi kokën në qafë e jo nën sjetulla si Haxhi Rrenci. Tjetër, trimit kija inatin, ama mos ia ha hakun: Ali Ahmeti Shkupin e bëri ta ndjej veten dhe marrë frymë sadopak si qytet shqiptar. Deri dje, kjo popullatë e "nemur" nga turku dhe përndjekjet e mëdha politike e dhuna, u arratisë nga vatrat shekullore të ripushtuara jugosllave, iku për ta shpëtuar kokën në Turqi. Pakica shqiptare, mbeti ende pa nënshtetësi në Shkup deri dje me lindje e vdekje, si "turk e ehamdurila", pa e ditur së paku edhe një fjalë në gjuhën turke. Punemadhe, që ndonjëri me gjithë familje edhe pse vinte nga Kaçaniku, Presheva e Bujanovci në trojet e tyre etnike, në Shkup për shpërngulje në Turqi. Punë tjetër, është ajo se: Ali Ahmeti pas vitit 2001, ua mundësoi shkupjanëve flamurin kombëtar kuqezi ta nxjerrin kur t'u teket nëpër dritare e mbi çati, zvarrisin nëpër dasma si leckë dimijash dhe fustanesh me "lule lale", e jo si simbol kombëtar të Shtetit Shqiptar. Flamur shqiptar, për të cilin ne vetëm pse e kemi mbajtur me vite fshehurazi në shtëpi, ose nën jakën e setres, i kemi hëngër më së paku dhjetë vjet burg në Goli Otok. Përmëtepër, edhe ta harrojnë gjatë fushatave zgjedhore të kalbet nëpër bandere. Vallë, aq shpejtë e harruan shqiptarët kohën e "*Trumbetave të Tellallit*"?! "*Kalin e Trojës nëpër Bit – Pazar*", kur në prag të "ndryshimeve

demomratike" e nxirrnin me frikë flamurin kuqezi kombëtar me marrëveshje politike të "vëllazërim – bashkimit": vetëm dy sahat të valojë në sallën e Teatrit të Pakicave Kombëtare, në Shkup?! "Armikut", mos ia shih gunën, por punën.

Hë për hë, në këtë kohë qorre, nuk merrem me thashethemet dhe shpifjet e Haxhi Rrencit në emër të Kur'anit. "Pejgamberit të fundit", pas Muhamedit a. s. Shëtitjet e tij "misionare" me pare e pa pare nëpër parti politike dhe nëpër botë, i veshur me petkun e pelegrinit "mysliman". Feleminderit, për reklamën propagandistike. I lezetshëm dhe i dashur është për shkrimet e mia profetike publicistike, ma kënaqi Lapsin. Vërtetë, ta them të vërtetën: e dua marrëzisht si "mysliman"! Rrugës rrezikshme nga kemi ecur si udhëtarë, kemi lënë gjurmë aq të thella, saqë nuk i fshin dot asnjë stuhi, borë e madhe. Xhebrahili për të gjitha këto "zullume", siç thotë një lider "mysliman" përpara fushatave zgjedhore, i arratisur me shpatën e Hazreti Muhamdit a. s. në dorë nëpër Bit – Pazar do të vëndosë Natën e gjykimit në varr: cili do të shkojë në Xhehnet (Parajsë) e cili do të digjet si mëkatar në Zjarrin e Xhehnemit (Ferr).

Haxhi Rrenci, hiqet se rrugën e Zotit (Allahut) gjoja ua tregon myslimanëve me gisht për në xhami, e i dërgon si kope të deleve pa Dashin me brirë në krye tek Dexhalli me

trumbeta, kur dalldiset e shashtriset nëpër çajtoret e Bit-Pazarit. Pavetëdije me shokë i shkonë përmbrapa se, gjoja do t'i bien dikund udhës. "Xhematin" duke e mashtruar me trumbeta, këngë e valle, kur delë në rrugë me muzika "tallava" nëpër Bit- Pazar, Tri ditë para Kiametit (Përmbytjes Madhe). Vrik e vrik e hip, jo në varkën e Nout (Hazreti Nuhit) për shpëtim nga Kiameti, por në anijen e një partie politike që me vite është duke u fundosur me gjithë udhëtarë në fund të oqeanit.

"Xhemati" shkretë që i beson Zotit, mashtrohet lehtë me sojin e haxhi rrencave "myslimanë me Din e Iman", delë në rrugë, se: e do muzikën popullore, Xhaminë shqiptare, në Shkup me flamurin kuqezi në minare. Punë tjetër është ajo, se: ai i thirrë me muzikë turko-arabe me ferexhenë hedhur krahëve në vallen "Teshkoto" shqiptare, që moti ia kanë vjedhur popullit shqiptar "vëllezërit" nga hija e Lisit midis Livadhit, rrëzë Çukës. Traditën e të parëve tanë me sahatin me qystek të argjentë përqafe dhe "nagantin' në brez. Kurrë, nuk i ka shkuar mendja se, para se të dalë në rrugë, e fton në valle Dexhalli me trumbeta. Natën e varrit, kur do t'i marrë "shehitët" si mëkatarë. Edhe, do t'u thotë te sheshi Skënderbeu, në Shkup: o burra e gra, erdhi koha ta zbuloni ballin!

Përfundimi, e dini?! Hi-hii-hiii, qesh unë vetë autori i këtyre "budallakive" të arratisura shqiptare… "Iniciativat" e haxhi rrencave me honorare marramendëse dhe pensione shtetërore. Përinatë, nga zemra e plasur e ngrej zërin: O Dexhall i Allahut, bjeru sa të mundesh trumbetave në rrugë nëpër Bit - Pazar! Po të duash, hynë edhe nëpër çajtore, ngrejë dolli me çaj rusi! Muzika yte nuk më tërheq, ama hiç nuk më shti në valle ta hedhë hapin. Këmbët e lidhura me zingjirë në Shtëpi, nuk mund t'i luaj nga vendi me ato tinguj të teneqeve shurdhuese, hipi në lodër. Vallen e kaçakëve të malit ta heq me shokë, krah për krahu në Lëmë. Shaminë hedh lartë mbi kokë për "fitore historike", pas brezi. Kotnasikoti, unë deri më sot kam humbur kohë me shkrime e këshilla të ju rri mbi kokë. Rrugën t'ua tregoj me shkrime profetike. Dhiareve të ju nxjerrë matanë malit. E dini pse?! Shkaku, se: ju më shumë i keni besuar Shejtanit të Allahut, sesa mua si Shkrimtar. Veten e paçit më qafë, edhe në këtë jetë dhe në atë jetë!

Vërtetë, vështirë e kam pasur të ju shpëtoj nga Zjarri i Xhehnemit. Gjithë mëkatarët e dalldisur me këngë e valle nëpër Bit – Pazar me vulën e Dexhallit në ballë, që i përcjellë pa proçese gjykimi Dexhalli me trumbeta në Xhehnem. Përshëndetje, jo Shkupit, por xhamive shqiptare nëpër katunde e qytet, në Kërçovë!

Erdha, dhe ju pash në vepër: Flamuri kuqezi shqiptar me shqiponjën dykrenare valonte lirshëm nëpër minare. Dhashtë Zoti, nësër të valojë lirshëm edhe Shqiponja dykrenare nëpër të gjitha minaret e trojeve shqiptare! Tekefundit, pse jo edhe nëpër minare të xhamive shqiptare, në Shkup?!

Haxhi Rrenci, sipas një paralajmërimi në faqen e tij Facebook, më në fund "tërhiqet nga gara për postet e partive politike… Edhe, nga Meka. "Revolucioni i Pranverës arabe", në Shkup. I mori më qafë të rinjtë shqiptar me provokime dhe protesta antishqiptare. Edhe pse, publikisht votoi për Dexhallin, e tradhtoi "vojvoda" në Parlament: në vend të "Presidentit musliman", votoi për Ivanovin dhe Veljanovin ("shkijet", siç thotë ai nëpër analizat e tia profetike). "Përkrahje të fortë" politike për në Bashkimin Evropian, i dha edhe Ali Ahmetit dhe BDI –së.

Zoti Madh (Allahu), Haxhi Rrencit me gjithë gomar ia faltë mëkatet, Xhehnetin (Parajsën) e merituar në Botën tjetër qiellore! Unë, sa për vete si Shkrimtar nuk ia falë as çajin e rusit, që ia kam paguar në Bit – Pazar. Amen (Amin)!…

THAÇI E "DOGJI" NË SHKUP EDHE ZIJADIN SELËN

Moti e kam thënë se, Thaçi deri më sot ka një aftësi të paparë politike: "djegëjen" e kundërshtarëve politik. I "dogji" gati të gjithë ato aktivistë, që mendonin se janë më të aftë si politikanë duke u nisur që nga "legalizimi" i flamurit kombëtar kuqezi nëpër komunat shqiptare në Gostivar dhe Tetovë: Rufi Osmanin dhe Alajdin Demirin. Vetëm, pak të kishin qenë më parashikuesë si politikanë ata kryetarë komunash të asaj kohe, sot do të ishin vërtetë liderë historik, që do t'i prinin guximshëm në ballë popullit shqiptar. Pakujdesia, mençuria e tyre ishte sakate dhe e dalldisur "sot për nesër". Shteti "juridik", vetë nuk e mbanë flamurin republikan gjatë ditëve festive më shumë se tri ditë, e këta burra mejdani donin ta mbanin të valojë nëpër komunat shqiptare me muaj. Përmëtepër, edhe të tregohen trima, provokojnë policinë maqedonase: "ecni vetë ta zbrisni nga shtiza flamurin shqiptar"! "Trimëria" u pa edhe para kamerave televizive, në ngjarjet tragjike të 9 korrikut të vitit 1997, ku Rufi Osmani arrestohet dhe dënohet me 14 vite burg, gjegjësisht 7 vite burg në instancën e dytë gjyqësore. Pas miratimit të Ligjit për amnisti, në vitin 1999 lirohet nga

burgu duke kaluar afërsisht dy vite në burgjet e IRJ të Maqedonisë. Kurrë në jetën e vet ai popull nuk ka hëngër më shumë dajak se, atëherë kur shkoi Cërvenkovski në Gostivar edhe ua bëri para kamerave televizive shqiptarëve me gishtin e madh të dorës teposhtë, bythekrye në përrua si "nacionalistë" shqiptar.

Rufi Osmani me Alajdin Demirin, në atë kohë vetëm pak të kishin qenë politikisht të mençur: vetëm tri ditë ta valonin flamurin shqiptar para komunave në Gostivar dhe Tetovë! E, pas tri ditëve ta zbrisnin vetë nga shtiza, nuk do t'i lenin hapësirë Cërvenkovskit me polici ta nëpërkëmbë Flamurin kombëtar shqiptar kuqezi dhe popullatën e pafajshme të asaj ane shqiptare. Hap pakrye ky, edhe i Arben Xhaferrit si politikan me përvojë politike dhe Menduh Thaçit me shokë, që i "dogjën" bashkëpartiakët e tyre besnik si politikanë me perspektivë të një Dite të Nesërme.

Arsye kjo, që Rufi Osmani: edhe, pse do ta fitojë për së dyti herë komunën e Gostivarit (2009), do të themelojë edhe parti të veten politike (Rilindja Demokratike Kombëtare), por kurrë nuk do të ngrejë krye si politikan vizionar. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013, ai do ta humbë edhe Komunën e Gostivarit. Shembull konkret, gabimi i fundit në këto gara politike presidenciale dhe parlamentare (2014), që e shtyri edhe të jap

dorëheqje dhe ta dorëzojë mandatin e kryetarit dhe të deputetit. Edhe Alajdin Demiri, pas disa emërimeve në postin e diplomatit do të përfundojë si "analist" i ndonjë televizioni lokal ose "nacional kombëtar" me pak krunde politike në grazhd.

Menduh Thaçi, nuk mund të lëvdohet si politikan i sukseshëm dhe vizionar, por ama për t'i "djegur" kundërshtarët e tij politik nuk e ka shoqin në skenën politike. Ikja e papritur e Arben Xhaferrit e dëmtoi mjaftë këtë politikan dinak "mysliman". Përderisa ishin të dy së bashku, si dy qe në vijë nën zgjedhë, mes arës rrëzë Sharrit plak: njëri në vijë e tjetri në lëndinë, bënin edhe ugare politike.

Strategjia e tyre politike do t'ia rrëmbejë edhe shokët më të ngushtë të luftës Ali Ahmetit: Bardhyl Mahmutin, Fadil Sulejmanin, Harun Aliun, Lekën, Komandant "Hoxhën", Abedin Zymberin, dhe Fatmir Hasanin. Komandantë lufte, që brenda pak kohe edhe këto do t'i "djeg" në jetën politike, hudhë në harresë nëpër katunde. Ndonjëri edhe do ta paguaj me jetë. Poashtu, do t'i "djegë" edhe Imer Selmanin, Fatmir Etemin, Sulejman Rushitin e Flora Kadriun.

Intersant është, rasti i fundit me Zijadin Selën. Kryetarin e komunës të Strugës, që para zgjedhjeve lokale dhe presidenciale, ngriti krye si "rebel politik". Xixë shprese për ndryshime

politike në IRJ të Mqaedonisë, hodhi ide për shtegdalje në hapsirën politike shqiptare. Papritmas, në prag të zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare e rrezikoi "vojvodën", që ai e shpalli edhe si "tradhtar" të asaj ane. Ngriti krye për t'ia rrëmbyer postin e kryetarit të Partisë Demokratike Shqiptare. Ose, u përpoq me "demokraci" partiake, që Thaçi të jap "dorëheqje" vullnetare pas humbjeve presidenciale dhe parlamentare nga skena politike.

Përçudi, grepin politik ia lëshuan nga Kumanova, përmes Forumit Ndërkombëtar për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (IGFM), dhe asaj të OVL - UÇK –ës. Organizatë e dalë nga Lufta e vitit 2001 duke u mbështetur edhe nga disa "organizata studentore" në protestat e fundit për rasitn e familjes Zeqiri nga Radishani. Shoqata "joqeveritare", që mezi i tubuan në protesta me dhjetra aktivistë. Protesta të dështuara që në fillim, kush ka sy, veshë dhe tru në kokë, ishin nën nivelin e protestave të "Pranverës arabe", në Shkup (2012). Që, siç duket edhe të shtinë në dyshim, a kanë pasur për qëllim dhe kanë qenë të organizuara vetëm e vetëm, që ta "djegin" Kryetarin e Komunës së Strugës, Zijadin Sela?! Protesta, në të cilën do të dëgjojmë edhe deklaratën "patriotike" për medie nga kreu i IGFM: "Ne do të mundohemi ta ruajmë paqen.

Mirëpo nëse nuk ndërprehet dhuna do të ketë edhe luftë. Kjo do të jetë luftë më e madhe e jo si lufta e Ali Ahmetit". Deklaratë politike, sikur ta kishte hedhur një pulë e therur nga maxhatorja pa kokë me pak shpirt duke kërcyer nëpër lëmë në Katund, e jo një kryetar i një Forumi Ndërkombëtar për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (IGFM). "Plumb qorr", në Ditën e sotshme me të cilin politika shqiptare me Luftën për "Liri dhe të drejta kombëtare", moti i ka larë duart, ka përfunduar nëpër libra: Që, me Luftën e Kosovës (1998 – 1999) dhe me Luftën e fundit të 2001 – shit, në IRJ të Maqedonisë. Puna e luftërave të shqiptarëve për Liri, siç e kanë zakon t'i këndojnë edhe nëpër këngët popullore me çifteli: Ne shqiptarët për çdo vjet e nisim nga një luftë përvjet, herë me Krajl e herë me Mbret, në shekullin e XXI ka përfunduar në histori. Shqiptarëve u ka mbetur edhe Lufta me penë, shkencë, dije dhe dialog politikë në tavolinë. Askushin, mos e rrejë mendja më se, do të bëjë edhe një luftë, popullin shqiptar ta nxjerrë në male! Qoftë në Shqipëri, Kosovë ose në IRJ të Maqedonisë për liri. Shtet Etnik Shqiptar. Koha e luftërave shiptare me pushkë ka përfunduar moti. Sot për sot, është koha e dialogut politik, penës dhe trurit.

Fatkeqësia kombëtare: Shqiptarët e IRJ të Maqedonisë i kanë me dhjetëra parti të përçara

politike, dy-tri e ku ta di unë me sa organizata "joqeveritare". Ose, siç thotë populli shqiptar: dy shqiptar, tri parti politike. Realiteti, nga një luftë e përbashkët dolën me dy organizata "joqevritare" të dalë nga Lufta e 2001 –shit (SHVL - UÇK dhe OVL - UÇK). Organizata "joqevritare" që gjithë kohën mbetën nëpër varre me vajtime për të vdekurit dhe invalidët e luftës, hiqen sikur populli shqiptar sot për sot nuk ka problem më të madh politik: Pushtetin në Qeveri. Nateditë mbetën në rolin e lypësit te Ura e Gurit, kërkesa politike e protesta qytetare kur t'u teket në rrugë. Shoqata "joqeveritare" që ende thirren në "dorëzimin e armëve", veprim unikat shqiptar, që nuk besoj se ndodhë me ndonjë tjetër popull në botë. E këndej, nateditë kërkon dhe vajton për Liri, barabarësi kombëtare me "vëllezërit". Shtet Etnik Shqiptar.

Alarmuese është rasti në Ditën e sotshme, kur Rreziku na troket te dera. Individë të arratisur dhe shoqata "joqeveritare", si nuk e kanë kuptuar ende porosinë historike të Rilindasëve shqiptar (nuk e kam fjalën për rilindasët e Edi Ramës), se: Populli shqiptar nuk shkon më pas gomarit. Dalldisjeve dhe përçarjeve politike plot huti familjare të interesave personale, klanore me protesta dhe deklarata teknefese.

Menduh Thaçit, nuk duhet pasur lakmi në politikëbërje atdhetare, ama në zbulimin e rrufjanëve dhe në "djegëjen" e kundërshtarëve të

tij politik, nuk e ka shoqin në shtatë krajli. Vërtetë, e humbi politikanin strategjik Arben Xhaferrin, por siç duket kohën e fundit e ka zëvendësuar me atë të udhërrëfyesit, Ali Ahmeti.

Dhe, nuk është çudi, Nesër këto dy kalorës të arratisur me mbi njëzetë vite përvojë në skenënën politike, me këtë kapicitet politik që kanë shqiptarët në arenën politike, edhe gjatë kohë do ta mbajnë njëri – tjetrin për krahu në "Pushtet" si Don Kishoti me Sanço Pançon duke luftuar me mullinjtë e erës për Dylqinenë e Tobozës…

VËLLAI IM I MADH E DONTE SHIUN

Vëllai im i madh, Ramë Çeliku dhe i vetmi krah në familje, e donte shiun. Krahu i djathtë i Babait edhe me penë e armë në brez. Djaloshi i stuhive, që e ndiqte Babain maleve këmba - kmbës. Edhe në shtëpi, edhe në livadh, edhe në arë, edhe në qytet me kësulën e bardhë të Bajram Currit në kokë. Edhe, kur duhej t'i masi forcat me armiqtë e tërbuar historik, brez pas brezi nëpër prita pas lufte. I donte armët e luftës, që shpeshëherë me Babain i provonin netëve të gjata të Dimrit tymeflakë nëpër dritare, në Katund. Mauzerrin përpiqeshin ta fshehin nga unë si fëmijë, edhe pse unë një ditë i zura në befasi në dhomë duke i pastruar me armë në dorë. Frikë kishin se, mund të më shpëtojë ndonjë fjalë goje me fëmijët e Katundit, t'i marrë më qafë si "armiqë të Shtetit". Që nga ajo ditë, më nuk e fshihnin nëpër hatulla mauzerrin, por nën shtrat. Armë e asaj kohe, që unë e mora si lodër dore nëpër Lëmë. Bombat i gjeja vetë, kur kërceja me shokë nga trari lisit i kasollës bythekrye dorë për dore në kashtë. Shumica ishin bomba të kuqe italjani (molla të kuqe). Vetëm ajo, që e mbante gjithmonë me vete Babai, ishte "kashikarë" serbi, që unë asaj kohe e thirrja "dardhë turke".

Vite me borë ishin ato, kur Ujku zbriste nga malet dhe na hynte tinëz në vathë. Delet i therte pasqafe si kasapi, dhe vetëm njërën e hidhte mbi shpinë, të tjerat i shkonin vetë pas deri te Lugu i Ymerit. Vallai ishte ai që krah për krahu me Babain shkrepnin pushkë pas Ujkut kur na biente ndër dele, e ndiqnin matanë Përronit të Thanës. Përderisa, ne në shtëpi bënim gjumë të rehatshëm në shtratin me kashtë. Unë me librat e Vëllait të këndimit, që na kishin mbetur kujtim nga koha e Ministrit shqiptar të Arsimit Ernest Koliqi, rritesha me vjershat e Rilindasëve nën hijen e Lisit midis livadhit. Vjersha, të cilat do t'i lexoja me zë mbi bar, mësoja përmendësh, rrëzë Çukës. Mes atyre faqeve për herë të parë e gjeta edhe vjershën e Asdrenit, *Kosovës.* Vjershë, të cilën më vonë gjatë studimeve në Prishtinë, edhe pse e bleva kompletin e librave të Asdrenit, botim i "Rilndjes" të Prishtinës, nuk e gjeta mes atyre faqeve atë vjershë të zjarrtë patriotike. Vargje, që më ndoqën gjithë jetën: *O shqiptarë, rrokni huj e shpatë, ta shpëtojmë Kosovën e ngratë. Nuk dum gjë tjetër – nukë, / vetëm ca armë dhe ca bukë!/.* Porosi e Rilindasëve të saj kohe, që më ndjek edhe sot e kësaj dite nëpër vite edhe përtej varrit. Rrugën, ata burra të penës dhe pushkës ma treguan me gisht. Dhiareve t'u ngjitem maleve. Dorën në zemër, armë me të cilat krenohem dhe më kanë mbajtur gjallë në mesin e ujqërve.

Përndryshe, moti do të kisha përfunduar në varr me fjalime patetike e "vajtime": një gur te këmbët, një te koka. Traditës "myslimane" me një cërpkë te koka për ujë në atë "dynja", në vend të dy shtambave me verë.

Zoti deshi, ose fati që unë të mbetem gjallë mes këtij bërlloku. Babashehu, Dervish Nurja i Llagjeve, një mik besnik i Babait mezi ma shpëtoi jetën. Plaku i mençur i asaj ane me mjekrën e bardhë deri në fund këmbëve. Fryma e tij ujore e qiellore si burim mistik i Lumit të Zajazit, që ende më ecë si lumë malor përmes fushës nëpër damarë. Gjak. Trup. Vite me radhë e kam bartur hajmalinë e tij përqafe mes xhindeve, që përnatë deri në agim më hudhnin dorë më dorë majë lisave. Shkaku se, mjekesia e asaj kohe hoqi dorë. Mëkot, Nëna me mua si dyvjeçar për shpresa jete, ndejti në spital dy vite me radhë në Shkup. Spitali, një ditë më lëshoi si të pashpresë për jetë. Dervish Nurja, qe ai që unë mbeta gjallë. Vërtetë, xhindet ende më hudhin gjithë natën dorë më dorë majë lisave mbi çati, por përsëri në mëgjes më kthejnë mes Babait dhe Nënës në shtrat.

Netët e gjata ishin të tyre, por ditët me Diell ishin të miat me të cilat më tërhiqte rrugës pas bishti Sagjini, kau i zgjedhës i Babit. Delet ruda, më vonë më dhanë gji si Zanat e maleve kreshnikëve te dardhat gorrice, pranë Çiflikut të

Xha Derallës, të cilat me sharrë në dorë i shartonte vetë plaku mjekërbardhë me kësulën e Bajram Currit në kokë. Fuqi kreshnikësh, që shtatë sahat larg sot ta flug vargun. Dashi me dy brirët dap e dap, më ushtronte për luftë heroike në trap te Lugu i Ymerit. Vetëmse, me brinja nuk më hudhte në përrua si shok, prandaj edhe sot e kësaj dite ecim Dimër e Verë të dy tok. Krah për krahu mes këtyre rreshtave për në Baba Tomor. Shiu nuk na lagte nën dardhat gorrice. E as bora kur zbriste para Diellit nga Çelëvjollca.

Rufeja, edhe në atë kohë shtinte pandërprerë në lisa e jo në ferra, por ne nuk e kishim frikë. Vëllai im i Madh e donte shiun. Shtambat e tij që i lanin me ujë fushat dhe malet me borë Verë e Dimër. Barin dhe lulet. Kafshët e egra dhe të buta me dy e katër këmbë. Insektet, po jo edhe grerëzat hutaçe. Natyra na përkundte në djep, ishin ninullat e saj që na rrisnin e na bënin burra. Gjokut t'i kërcejmë mbi shpinë. Armën e mejdanit ta nxjerrim nga brezi. Shtatë sahat larg ta flugim vargun.

Vëllai pas disa viteve pune si mësues në Vrutok të Gostivarit, do të kthehet si mësues në fshatin Zajaz, e më vonë në vendlindje, Cërvicë. Vite ato të vështira, kur arsimi shqip nuk shikohej më sy të mirë dhe ndiqej nga partizaanët komunistë këmba - këmbës. Librat e këndimit nga Shqipëria, i lexonim tinëz kokë më kokë e

dorë më dorë, Kërçova kur nuk kishte ende gjimnaz në gjuhën shqipe. Vëllai me shokë, i përveshën duart për hapjen e paraleleve të para në gjuhën shqipe pranë gjimnazit maqedonas "Mirko Mileski" në Kërçovë (1967). Asaj kohe, plot vështirësi si nxënës i shkëlqyeshëm, mezi u regjistrova në shkollën normale "Zef Lush Marku", në Shkup, por për shkak të numrit të ulët të nxënësve për hapjen e paraleve në gjuhën shqipe në Kërçovë, Vëllai në dobi të arsimit shqip me pajtimin tim si vëlla sugar, më tërhoqi nga Shkupi në dy paralet e posahapura të para në gjuhën shqipe në gjimnazin e parë të Kërçovës.

Paralelet e posahapura historike, vetëm emrin e kishin në gjuhën shqipe. Shkaku se, i gjithë procesi mësimor zhvillohej në gjuhën maqedonase me përjashtim të lëndës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Nxënësit shqiptar, për dallim nga ato maqedonas kishin si "shpërblim" edhe një lëndë plus në gjimnaz, si "nacionalistë dhe irredentistë" shqiptar: Gjuhën dhe Letërinë Shqipe.

Nxënës nga të gjitha katundet e Kërçovës, kush më këmbë, gomarë e kush me biçikleta: pranverë, vjeshtë e dimër për çdo ditë i suleshim për dije Kërçovës. Shaqir Sadiku, miku im i bankës asaj kohe me një shkatrraçe me dy rrota, edhe ai hynte në klasë. Kohë e egër ajo, kur shovenizmi maqedonas ishte në kulminacion.

Kuadri arimor në gjuhën shqipe mungonte me të madhe, e profesorët maqedonas atë vit na sharruan, rrëzonin pamëshirë si lisat në livadh, nga dy paralele pranë këtij gjimnazi sa ishin në gjuhën shqipe me mbi 70 nxënës, mezi e kaluan klasën pesë – gjashtë veta. Përpjekje kjo, dhe qëllim i tyre tinzar për t'i mbyllur dy paralelet e para në gjuhën shqipe.

Veteranët e arsimit që i hapën paralelet e para në gjuhën shqipe (1967), filluan të ndiqen në çdo hap, të cilët nga përndjekja dhe presionet nëpër vendet e punës, u detyruan i gjithë grupi i arsimtarëve, papritmas një ditë të ikin në Francë. E nga andej u shpërndanë nëpër botë e Amerikë. Vëllai mbeti me punë mbi 15 vjet në Paris. Krahu i vetëm i familjes që i mbante fëmijët e vet në shkollim dhe mua si vëlla në Shkup e Prishtinë.

Vite më vonë, kur u kthye në vendlindje e fitoi shpërblimin komunist: mbeti edhe pa punë. Armiqtë e arsimit shqip, përsëri deshën ta përzënë nga vendlindja. Inati e bëri të veten, nguli këmbë. Mezi gjeti punë pak vite para pensionit si ofiçar në një fshat të malësisë Kërçovës. Vëllai im i madh, që punoi dhe jetoi me vite në Paris. Qytetin e kulturës, ku gjysma e banorëve krijonin e gjysma kritikonin veprat krijuese artistike.

E unë pas kryerjes së Normales, pas arratisjes në Paris (1970), pas tre muajve u ktheva në Prishtinë me studime. Dhjetë vite me gjithë

studime i kalova në këtë Kryeqytet Shqiptar Universitar, ku dy vite e gjysëm edhe punova si arsimtar i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Drenas (Gllogovc) të Drenicës. Vitet e 80 – ta, pas ushtrisë jugosllave, mezi u punësova në fshatrat e thellë të malësisë së Shkupit, ku punova si mësues 15 vjet me radhë mes atyre maleve. Shkollave të para shqipe, që i kishin hapur plot vështirësi të parët tanë me pushkë e laps në dorë. Vende, në të cilat nuk kishte shkelur ende këmba e turkut, as edhe ajo komuniste sllave, por kishte shkelur këmba e shqiptarit. Përçudi, shkollat shqipe i gjeta të pagëzuara me emra të Rilindasëve dhe patritoëve shqiptar: Skënderbeu, Vaso Pashë Shkodrani, Naim Frashëri, Faik Konica, Sami frashëri, Fan Noli, Liria etj. Katunde shqiptare, që me dhunë me gjithë familje ishin shpërngulur në Turqi dhe pas një muaji, përsëri ishin kthyer në trojet e veta shqiptare.

Vitet e ashpra të arsimit shqip në këto anë, dhe përndjekjet e mëdha politike më detyruan me dhunë që të largohem nga arsimi. Punën ta vashdoj si shkrimtar me profesion të lirë, në Shkup. Ende, më mbanin gjallë arat e Babait. Herë pas here ikja edhe në vendlindje. Fati im, i kisha gjallë prindërit: Nënën dhe Babain, që gjithë pasurinë e tyre e vunë në shërbim të arsimit dhe kulturës shqiptare. Edhe, Vëllai i Madh. Kohë që nuk zgjati shumë ato vite me borë. Njëri

pas tjetrit fillova t'i humbë, së pari Babain nga i cili nuk mbajë mend asnjë shuplakë për gabime, e pak më vonë edhe Nënën, në vendlindje. Vëllai im i Madh, pas një sulmi në zemër erdhi në spitalin e Shkupit për shërim një ditë me shi (1997). Ditë, kur erdhi me mercedes dhe shofer personal nga Tirana në Shkup me "djemtë" e tij edhe poeti i madh shqiptar, Frederik Rreshpja. Vëllai, atë natë e hapi edhe dritaren krah më krah, që ta shohi se si biente shiu litar në Shkup.

Ditën e nsërme, papritmas iku nga mesi ynë dhe u arratisë me nderime familajre rrëzë Çukës. Katundi e mori në gji ta përkund në djep për Ditën e Nesërme. Farën, që e mbolli dikur me shokë mes atyre arave, dha frute.

Vëllai im i Madh, tek tashti e kuptova pse e donte shiun…

"RREZITJE" PA BREKË TE KODRA E DIELLIT

Përditë e shoh Dudumin e "ndryshimeve" të mëdha historike nëpër debatet politike krah për krahu me analistë të tjerë të "pavarur" nëpër ekranet televizive. Qafë për qafe me "vëllezërit" e Njerkës. Dolli ngre për "fitore historike". Kohën e drekës, në kafene vetëm me një grua (ilegalen). Patjetër, një torbë duhet ta ketë përqafe. Arsyeja, ashtu e do nevoja për ta bindur opinionin rreth e pëqark tavolinave, ashtu mu si debatet e "nxehta" parashikuese politike si "analist" i shekullit. Ndonjëherë, edhe dëshprohet kur lexon ndonjë shkrim publicistik për realitetin e politikës shqiptare në trojet e tyre etnike. Zemërohet, pse autori i shkrimit nuk mendon dhe nuk e parashikon politikën shqiptare për Nesër, si ky "analist" i lehjeve të kota televizive, sa herë që del te porta. Zakonisht, kur nëpër shkrimet publicistike e zhveshin lakuriq, e lënë cullak pa brekë. Palarenë si kulaç, ia nxjerrin në "rrezitje" për mejdani te Kodra e Diellit. Dhëmbët nëpër "emisione debative" i bënë copë-copër për t'i mbrojtur "vojvodën" dhe ngjyrat partiake, ku e ka futur kokën me dy këmbët e para në grazhd. Mbarë e prapë i lexon shkrimet publicistike. Shpeshherë, edhe i erren sytë, nuk di t'i lexojë

mes rreshtave. Ose, i lexon për së prapthi. Tekefundit, edhe nuk ka faj, shkollimin nuk e ka kryer në gjuhën shqipe. Rradakja e tij mendon me kokën e huaj në qafë, përpiqet të shkruaj në gjuhën shqipe. Duartrokitje për këtë hap "patriotik", por jo edhe t'i shesë mend popullit shqiptar.

Trusakati u është vënë pas shkrimeve të mia me një këmbë sakate duke çaluar nëpër rreshta. Patericat nën sjetulla. Torbën me taxhi përqafe. I lexon qorramëshehtas si ato dy vëllazërit e verbër, kur hanin petulla me kos ballë për ballë në sofër. Papritmas, kur njëri vëlla i thotë tjetrit: pse ti, o vëlla i hanë nga dy petulla? Vëllai tjetër aty për aty, i përgjigjet: nga e di ti se unë ha nga dy petulla, kur ne që të dy jemi qorra me të dy sytë në ballë?! Shkaku se, se unë i ha nga dy petulla, i përgjigjet vëllai.

Dudumi, kritikën e merr si lëvdatë. Vështirë e kupton qëllimin e shkrimit publicistik, kodër pas bregu. Rrezikun, që e paralajmëron autori për lexuesin nga disa profiterë politik, që shkojnë parti më parti politike, si kurva burrë më burrë, gjoja si "patriotë" për ndryshime politike. Dalldisje, që Dudumi herë pas here edhe paraqitet me komente anonime plot sharje, shpifje e etiketime: sulmit, i përgjigjet me kundërsulm. Armën më të dobët luftarake për ta mundur kundërshtarin e mendimit Ndryshe. Heroike, do

të ishte ky Dudum ta dorëzonte para mejdanit armën (penën). Rrok në dorë paqen. Armëpushimin. Autori i shkrimit nuk i paska dalë "patriot". Merreni me mend, truri i tij sakat, ende te shqiptarët kërkon "patriotë" dhe tradhtarë, në vend që të merret me fenomene në politikën dhe shoqërinë shqiptare.

Politikanët e arratisur, sot si "analistë politik" të këtij soji e niveli "artistik" duke pirë kafen e mëngjesit me pagesa partiake nëpër institucione shtetërore e restorante, i japin "para pampurrit" me lëvdata: Alamet "analisti' politik, na qenka Dudumi. Emrat, nuk ua përmend kësaj radhe si kalimtar rasti i kafeneve. Ndoshta ndonjëherë tjetër, kur të zbresë Dielli me rreze nga Çelëvjollca. Shkaku se, frikë kam mos më zë goja qelb. Listat e tyre si "gazetarë, akademikë dhe intelektualë", paraqiten sa herë që i merr nën sjetulla Qoftëlargu për ta shpëtuar Njerkën nga "përdhunimi i nacionalistëve shqiptar".

"Pak rëndësi ka", thotë Jakup Kalliri, në AlPazar, a është shoqëria bullgare, maqedonase, serbe, turke, apo rome… Larg qoftë, të jetë shqiptare. Ringjallet urrejtja dhe frika e lepurit në bark te "vëllezërit" e Njerkës. Argatët e tyre të zgjedhës politike, që i mbajnë gjallë në jetë me pak shpirt. Problemi është, se: Dudumi në Ditën e sotshme ma përkujton kohën e Partisë komuniste. Funksionarëve shqiptar të asaj kohe, kur përveç

gruas legjitime që e kishin në Katund me fëmijë, ua jepnin edhe nga një grua "ilegale" partiake. Qëllimi dihej, që funksionarët t'i mbajë nën kontrollë të rreptë partiake. Punë tjetër ishte ajo se, këto shqiptarë lindën fëmijë edhe me ato gra "ilegale" të Nënës Parti. Shqiptarë, "vëllezër" në të katër anët e botës.

Problemi, lindi më vonë gjatë Luftës së fundit në Kosovë (1998 / 99), kur serbët na përdhunuan, na vranë dhe përzunë si "vëllezër" në Shqipëri dhe nëpër botë. Edhe ne, nuk na vranë vetëm serbët, por "djemtë" tanë që i patëm me ato gra "ilegale" nëpër katundet e qytetet e Jugosllavisë. Shumicën në Beograd: "O vëlla, me sharrë në krah". Poezi e mirënjohur kjo, e Esad Mekulit, të cilën e kemi pasur edhe nëpër librat e këndimit dhe e kemi mësuar përmendësh në atë kohë, në shkollë. Zoti deshi, që falë miqëve amerikan, përsëri të kthehemi në trojet etnike të të parëve. Kosovën, më në fund ta shpallim: Republikë shqiptare. Hapi parë historik. Edhe pse, shumica e popullatës mbeti e shpërndarë si Kashta e Kumbarës nëpër ato shtete demokratike.

Koha e sotshme, seç ma kujtoi padashtas sistemin komunist. Sistemin, në të cilin unë linda, erdha në jetë duke qarë në djep. Fatkeqësisht, si shkrimtar. Aspak, nuk ka ndryshime të mëdha në veprimet politike. Nëna Parti edhe sot si dje, i mba nënë kontrollë të rreptë shqiptarët. Vetëm

një grua partiake jepi shqiptarit, dhe gjithë jetën e ke në shërbim të Shtetit të "përbashkët demokratik". Edhe Dudumit i ka dhënë një grua "ilegale", "fuqi" për luftë "patriotike", në fushën e mejdanit.

Dudumi për interesa personale e kthen gunën nga të fryejë era: i shkruan letra "dashurie": Sali Berishës, Edi Ramës, Menduh Thaçit, Albin Kurtit, Ali Ahmetit, Jozefina Topallit… Menduh Thaçin, punemadhe që e shau dje?! Sot, i turret përmbrapa si dhelpëra dinake dashit me brirë, mos i bien udhës. Partizan interneti, që deri dje në YouTube "luftoi" për ndryshime politike e fetare krah për krahu me Nevzat Halilin, Rufi Osmanin, Bardhyl Mahmutin, Hysni Shaqirin, Harun Aliun… Edhe, me Sulejman Rexhepin e Bshkësisë Fesë Islame, për aq kohë sa zgjaste fushata zgjedhore. Ditën e nesërme, kur ato humbin në zgjedhje, përpiqet me të katra të themelojë ndonjë shoqatë "joqeveritare të pavarur", ose, "parti politike". Grazhd të ri, ku do ta fusë kokën si bufi i verbër në stinën e Dimrit. Pritet, kohën e fundit t'i vardiset për herdheve edhe Ziadin Selës, nëse themelon ndonjë parti politike. Tërbohet, kur e gjen veten në ndonjë shkrim profetik për Nesër si kalorës i arratisur me një Sanço Pançio përmbrapa hipur mbi gomar në luftë me mullinjtë e erës për Dylqinenë e Tobozës, dhe e shanë si shkrimtar

oborri Kalosh Çelikun e " mahallës të marksistit Ali Ahmetit, me tapi të nënës Rusi".

Dudumi, ende leh nateditë pas Ujkut të malit. Përjaget, si një këlysh me zgjebe me shokë pas porte me bishtin ndër këmbë. Gurë e dru mbi autorin e shkrimit, vetëm e vetëm që t'i pëlqejë "vojvodës" (përsëri, ta mashtrojë në politikën "madhore"), hudhi ndonjë asht "veteranit" për dritare para fushatës zgjedhore si një këlysh me zgjebe.

Shkrimtari, ose është shumë trim, ose di t'u përballojë provokimeve të trusakatëve me një asht në gojë. Partizanëve të partive politike. Larg e sheh rrezikun, përtej maleve. Shenjat e paralajmërimit të Përmbytjes madhe. Hyu, ia dërgon Porosinë e Madhe të Nisjes për në Baba Tomorr, pasmesnate përmes ëndrrave. Feleminderit. E kaloi testin e 'komisionit" të policisë letrare. Falë gjakftohtësisë dhe aftësisë krijuese që e ka dhunti nga Natyra dhe Zoti, nuk i dolën shenja të papritura komunikacioni për ndalesë në Rrugën e shenjtë të Rilindasëve shqiptar. Pengesa klimatike: shi me breshër. Përmbytja e madhe (Kiamaeti) sipas Kur'anit, në Shkup.

Rrufeja nuk shti në ferra, po në lisa…

VI POPULLI NË BREZ ME 'DY ALLTIA"
LODRËS I BIEN PARTIA

SHKRIMTARI "DISIDENT" MAQEDONAS NË "MËSHIRËN" E NJË LIBRARIE

Interesant është rasti, për të hyrë në Librin e Genisit me shkrimtarin "disident" maqedonas Luan Starova, që në vend librat e tij t'i botojnë institucionet shtetërore dhe shqiptare në IRJ të Maqedonisë: Akademia e Shkencave të Maqedonisë, Shoqata e Shkrimtarëve të Maqedonisë e ndonjë institucion tjetër kulturor, ku ai me vite ka derdhur mund dhe djersë, i boton një librari e posathemeluar çarshie, në Shkup. Librari, pa asnjëfarë bagazhi kulturor e artistik në shpinë. Haptas, mohohen Institucionet e pakta kuklturore shqiptare në këtë shtet "demokratik", që shkaku këtyre argatëve politik, nuk mund të ngrejë krye kultura shqiptare, merren nëpër këmbë nga partitë politike dhe Shteti i "përbashkët demokratik". Vërtetë, jeta e tyre zgjatë, aqsa zgjatë jeta e partisë tyre në pushtet, por dëmet dhe pasojat për kulturën shqiptare janë katastrofale.

Akademikun maqedonas, që deri dje pas tij qëndronte Shteti jugosllav e maqedonas, sot nuk e duan edhe "vëllezërit", edhe pse dikur i festonin

"fitoret" partizane qafë për qafe nëpër darka e festa shtetërore para kamerave televizive. Tekefundit, për t'i ngritur "namin" akademikut si shkrimtar, së paku librat e tij t'i botonte një institucion shqiptar në Kosovë, ose Shqipëri. Mos më tepër, ndonjë Shtëpi botuese e mirënjohur dhe e dëshmuar në publikimin e librave të shkrimtarëve shqiptar. Shkrimtari, që gjithë jetën i shëtitur nëpër poste politike me gjithë familje në kohën komuniste jugosllave, i arratisur nëpër redaksi të "vëllazërim - bashkimit", institucione e poste politike shtetërore si ambasador në Paris e nëpër Botë, profesor universitar i "Shën Kirili dhe Metodi" e antëtar i rregulltë i Akadimsë të Shkencave të Maqedonisë, sot delë dhe e "rrezikon" tinëz pas shpine me "vlera të arrira artistike" edhe shkrimtarin me famë botërore, kandidatin e vetëm sot për sot shqiptar për çmimin Nobel, Ismail Kadere?! Krah për krahu me akademikun tjetër të arratisur të tri akedemive shkencore Ali Aliu, nën sjetulla si kungull Stambolli edhe me një Sanço Panço tjetër shqiptar në pelena, që tutullin shkencor mezi e fitoi me një najlon kese speca në dorë tek një miku im profesor univeristar në "Shën Kirili dhe Metodi, në Shkup. Dhe, një papagalli politik të "pavarur" të dalldisur e shashtrisur me diplomë universitare në Qafë Thanë nga kjo anë shqiptare, emëruar nga Kryeministri shqiptar Edi Rama,

gjoja për "kordinimin" e kulturës mbarëshqiptare, merr rrugën të përurojë një shkrimtar në mes të Tiranës. Kryeqytetin e Shqipërisë, ku shumë shkrimtarë dhe artistë kanë vdekur dhe vdesin edhe sot, për bukën e gojës. Njeri të gjallë nuk kanë pasur kush t'i shti edhe në varr me një cërpkë kopshti te koka e një vorbë te këmbët për ujë në atë botë të amshueshme, matanë varrit. Akademiku, jetë "kaçaku", përpiqet të bëjë me ndihmën e kalorësve të arraisur të kësaj ane në "Shtëpinë e Shkrimtarëve dhe Përkthyesëve Letrar" në Tiranë, ku Kryeqendra shqiptare sot për sot nuk e ka edhe një Lidhje të Shkrimtarëve Shqiptar, Shtëpi të shkrimtarëve shqiptar me çati mbi kokë në qiellin e hapur me Diellin mbi male, të cilën qysh moti me vite në kohën e komunizmit e ka pasur edhe me çati dhe oxhak në mes të Tiranës.

Publikisht, para syve tanë si shqiptarë, "harrojnë" me qëllim një personalitet gjigand të arsimit dhe kulturës shqiptare të kësaj ane, që ka vepruar me vite deri në vdekje, në Shkup: Poetin e madh shqiptar për fëmijë, Mehmedali Hoxha. Babain e dy revistave për fëmijë: *Gëzimi* dhe *Fatosi*. "Kobure" e dytë, pas Libër Këndimit të nxënësve shqiptar, Ministrit arsimit të asaj kohe, Ernest Koliqi. Që, shumë shkollarë anembanë Atdheut u rritën në personalitete dhe e mbanin në gji, shtëpi, çantë e mbi banka në shkollë si armë

me dy tyta për dije, në Ditën e Nesërme. Personalitet madhor i Letërsisë Shqiptare, që rri krah për krahu me poetin tjetër vëlla revolucionar, Esad Mekuli. Atë, që e bëri Esad Mekuli për letërsinë shqipe në Kosovë, Mehmedali Hoxha e bëri në Maqedoni. Emrin e të cilit sot, plot krenari mund ta mbajnë me nderë institucione arsimore e kulturore. Rrugë të këtij qyteti, rrëzë kalasë Dardane e në vendlindje. Profeti shqiptar, që në atë kohë të egër komuniste me një shishe konjak "Skënderbeu" në dorë, mori guximin, e hapi dritaren e SHGB "Nova Makedonija", në Shkup t'u thotë "vëllezërve": Koha do të vijë, kur ju një ditë do t'i fshini rrugët e Tiranës. Parashikim historik i shekullit, për të cilin i hëngri edhe disa vite burg. Krijuesi pati të drejtë, ajo kohë erdhi një ditë me koçi përmes maleve. Vetëmse, ai burrë i pushkës dhe penës, nuk e pa vetë me sy për së gjalli.

Dhe, nuk është çudi, që nesër ndonjë Tokmak shelgu vadhe, si përfaqsues i ndonjë "institucioni" kulturor e shkencor shqiptar, ose shoqate të "pavarur joqeveritare", i arratisur nga Kosova me gjithë dele në Shipkovicë të Tetovës për të ikur në Turqi, më vonë si "hoxhë" arabie në Shkup, delë dhe e propozon si kandidat për çmimin Nobel, sojin e këtillë të "vëllazërim-bashkimit", i shëtitur gjithë jetën nëpër poste politike partiake. Shkrimtarin, që deri dje nëpër

intervista publicistike haptas deklaroheshte si shkrimtar maqedonas, i cili nuk e fliste dhe i dilte zot si sot gjuhës shqipe. Librat e tij i publikonte me të madhe, me shumicë e pakicë në gjuhën maqedonase. Shkrimtarit, që me porosi partiake komuniste të asaj kohe mezi ia përkthenim me plot vështirësi "veprat" edhe në gjuhën shqipe në Shkup e Prishtinë.

Fati njëjtë e ndoqi edhe një shkrimtar tjetër të përkëdhelur nga sistemi komunist i Hoxhës Allahut, mikut të tij të ideologjisë revolucionare të "Pranverës arabe", në Shkup (K. M.), që në atë kohë dha një intervistë "eksluzive", po të këtij "niveli artistik" si shkrimtar maqedonas dhe librat e tij i shkruante dhe botonte në gjuhën e "perspektivës" të Shtetit komunist, i cili vite më vonë e pa gabimin, nisi ta mësojë gjuhën shqipe dhe doli me "thirrjen revolucionare", ferexhenë e zezë krahëve për bashkimin e shqiptarëve në një shtet shqiptar: Shqipëri Etnike. Përgëzime "revolucionarit të ndryshimeve politike", nëse është i sinqertë për zgjidhjen e Çështjes shqiptare, nuk është Pykë shelgu! Edhe pse, deklaratat e tia publike - politike, unë nuk e di. pse i marr me rezervë.

Poet dhe akademik maqedonas me prejardhje shqiptare është edhe Mateja Matevski. Akadamiku, ndoshta edhe më i madhi maqedonas, që edhe sot nuk e ka harruar gjuhën

shqipe, po kurrë nuk e shkruajti dhe botoi një libër në gjuhën e Nënës shqiptare. Populli, thotë: bunar të ri bë, por kurrë te i vjetri mos pështy. Ose, i yti nëse ta hanë mishin, eshtrat t'i ruan në arkë për Nesër. Realitet historik, që ndodhi edhe me këto shkrimtarë maqedonas. Nama e Nënës i zuri këta djemë të arratisur e dalldisur, që e mallkoi të birin, kur ia ktheu shpinën. Tambëli i së cilës, i ndjek nateditë gjithë jetën deri në varr. Kohë ajo e egër "artistike", kur shkrimtar shumë më i madh në Letërsinë Shqipe ka qenë dhe mbetet përgjithmonë Sterjo Spase. Autori i romanit *Afërdita*. *Pse*, dhe *Zgjimi*.

Çmimin Nobel, nuk e kanë marrë për së gjalli shumë pena të mirënjohura shqiptare të djeshme dhe të sotshme: Gjergj Fishta (kandidat), Ernest Koliqi, Lasgush Poradeci, Fredrik Rreshpja, Ismail Kadare, Martin Camaj, Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu, Pano Taçi, Teki Dërvishi, Adem Demaçi, Ymer Shkreli e Anton Pashku. Edhe, ndonjë tjetër personalitet shqiptar, për të cilin hë për hë nuk më kujtohet emri. Çmimi Nobel, është Çmim të cilin e kanë marrë edhe parsonalite botërore nën nivelin e vlerave të arrira artistike të këtyre artistëve shqiptar. Dorën në zemër, artistët shqiptar jo se nuk e kanë merituar, por edhe Çmimi Nobel, siç duket është politizuar deri në palcë në Ditën e sotshme. Punë tjetër është ajo se, shqiptarët nuk e kanë një Zhan-

Pol Sartër, që ta kthejë prapë Çmimin Nobel. Sartri, e ktheu se, i kishte donatorët e popullit të vet liridashës që i qëndronin me tru e para përmbrapa në luftën artistike për Liri (ia dhanë gjeniut dyfishin e parave), ndërsa shkrimtari shqiptar, i harruar nga politikanët e vetëbegenisur të Shtetit Shqiptar, sot vdes edhe për bukën e gojës.

Shkrimtari i "arratisur" pas Luftës Dytë Botërore nga Shqipëria me gjithë familje, dhe i përpunuar nëpër institucione policore jugosllave me të gjitha dyert e hapura krah më krah për veprime "shkencore-kulturore", mirë është në Ditën e sotshme të presë pak pas dere!. "Durim", thoshte presidenti i parë i Republikës së Kosovës, z. Ibrahim Rugova. Edhe populli shqiptar, si e gjithë bota i ruan dhe kultivon zakonet dhe traditën shqiptare, kujt duhet hapur derën si mik, e kujt përplasur me forcë në fytyrë. Cili në odën e burrave e ka vendin te oxhaku, e cili te dera. Raste ka, kur derën ia kemi hapur edhe armikut, por ato janë përjashtime historike, në momente rreziku kur na ka trokitur në derë për ndihmë. Imzot, po ky popull ende, edhe në Ditën e sotshme këmbekokë do dhe plasi të përpëlitet në bërllok?! Derën e madhe, si nuk e gjeti deri më sot për dalje, pas shtëpie matanë malit me lisa kokë më kokë në Qiellin e hapur, Liri?! Dritare pas Shtëpie, për të ikur si i "çmendur" me mendtë

në kokë, hipi me shokë në Baba Tomor me gjithë këta "studjuesë" letërsie e "kritikë" letrar me thasë të rrasur me të dyja këmbët nëpër institucione?!



Faji, përsëri u mbetet shqiptarëve. Ende mbeturina komuniste, përpiqen ta "nxjerrin" këtë popull historik nga qorrsokaku, në Liri. Fatkeqësia, ky bërllok shqipar që i është ngatërruar popullit shqipar dje nëpër këmbë, e them me plotë gojën: sot, nuk e nxjerrë dot nga bataku, po me të katër këmbët edhe më thellë e rrasë në batak deri në fyt. Gabimi dihet, është i partive politike shqiptare, që ende në Ditën e sotshme i mbajnë gjallë me pak shpirt

eksponentët e "vëllazërim-bashkimt", në shoqërinë shqiptare.

E pyes veten, si shkrimtar "i çmendur", sipas diagnozës së tyre policore letrare: Çfarë shkrimtari është ky akademik me "famë botërore"?! Dyert, që dikur ia ka hapur krah më krah Partia Komuniste Jugosllave, sot ajo Neokomuniste "demokratike", së fundi edhe ajo e ashtuquajtura "Rilindja kombëtare" e Edi Ramës. Kryeministër, që e kënaqi Shqipërinë, tashti i ka mbetur edhe "lulëzimi kulturor" i IRJ të Maqedonisë me autorin e disa librave kalorsiak: profesor universitar, ish ambasador jugosllav e maqedonas nëpër disa vende të botës dhe anëtar Akedemie i Shkencave të Maqedonisë, që lejon dhe pajtohet famën "krijuese" t'ia sjellë një librari çarshie?! "Institucion" partiak biznesi familjar, që lidh bashkëpunim kulturor me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë?! E, për sa di unë, bashkëpunim politik e kulturor, lidhin institucionet e të njëtit niveli shtetëror (Ministritë e Kulturës të dy shteteve). Vështirë, e kam t'i përgjigjem si shkrimtar kësaj "çorbe artistike- kulturore". Dhe, pyetjejeve provokative policore - politike (dukurie të këtillë "profetike"), që na e kanë shtruar kulturofagët me shokë, qysh moti në sofër.

Koha (Dita e Nesërme), si gjithmonë do t'ia vë në ballë vulën historike…

TAMBËLI MË KA DJEGUR I FRYEJ KOSIT

Plasa duke u bërë thirrje shqiptarëve përmes shkrimeve publicistike në Shkup: mos shkoni pas gomarit, por pas Ujkut të maleve. Ujku, vërtetë e ka hëngër Qengjin te lumi pse ia turbulloi ujin, po ku ta dimë ne, ndoshta Qengji do që ta hajë Ujku?! Njësoj si personazhi im "hero" mbi gomar, që më shkruan nateditë "letra dashurie" nën shkrimet e mia profetike. Takime "ashikie" më cakton para selive të partive politike. Poezi erotike më lexon Natën pa Hënë. Përfundimisht, dua t'ju them: ecni pas Ujkut të maleve! Punë tjetër është ajo, se: a, do të më dëgjoni mua si shkrimtar, apo Dexhallin me trumbeta kur delë nëpër Bit – Pazar, në Shkup.

Zemërohem, kur "miqtë" e mi besnik ecin pas gomarit me samarin në shpinë. Veshët kur i ngre përpjetë në mes të rrugës dhe pëllet me të katra këmbët në batak. Dhelprës dinake, që gjurmët i fshin me bisht. Edhe atë, "miqëve" që dua t'ua lë samarin në shpinë. Barrën ta nxjerrin përtej Lumit. Dëshprohem, kur i shoh se ecin pas gomarit.

Vallë, ende duhet të ju rri mbi kokë me shkrime publicistike, se: Gomarin dhe Dhelprën dinake nuk duhetë lënë që ta na pri në ballë për

Ditën e Nesërme?! Arsye, do të na shti në ndonjë kotec të pulave në Katund, ose nxjerrë pas barit në Livadh. Ujkut, përsëri t'i thotë te përralla popullore: lëshoe rrënjën, rroke këmbën!

Popullit shqiptar i besoj, por jo edhe Gomarit dhe Dhelprës dinake, që edhe sot si dje, i fshin gjurmët me bisht. Pulat vetëm i shikon nën pemë, e ato njëra pas tjetrës i bien para këmbëve. Korbit që rrinte në degë me një cop djathi në gojë, kur dinakja i tha se këndon bukur?! Trushkreti, hapi gojën të këndojë, i ra djathi nga goja dhe ia rrëmbeu dinakja. Njëjtë, siç i thashë unë personazhit tim paronoik se, ma kënaqi Lapsin. Turrevrap nisi të më shkruaj poezi "patriotike". Publikisht, më shpalli "dashuri" romantike.

Nëna ime vepronte ndryshe, pulën që këndonte si gjel, e therte në mes të Lëmës. Biro, kënga e saj ndjellë kob. Thikën duhet vënë në qafë, ta shtrojmë në sofër për darkë. Babai, kur dinakja vinte si mysafire në Katund, e nxirrte mauzerrin nga hatullat. Punë tjetër është ajo se sot, shumë pula hipin në gardh duke i përplasur fletët dhe këndojnë si gjel. Edhe atë, merreni me mend: pula të therura pa kokë, që kërcejnë nëpër Lëmë, në Ditën e sotshme, kur Mbreti i këngës që e paralajmëron agimin, është Gjeli.

Zemërohem, kur dëgjoj për themelimin e partive të reja politike shqiptare si pulat e therura

pa kokë kur kërcejnë nëpër Lëmë. Përditë po më ngulitet në tru dhe më godet si tokmak vathe ajo thënja e popullit: Dy shqiptar, pesë parti politike. Qorrsokak, nga i cili edhe sot e kësaj dite, shqiptarët nuk mund të dalin tek qëllimi historik. Forca politike shqiptare, nuk matet me numrin e partive politike, por me kokat që u prijnë atyre partive politike. Kalorësit e arratisur i rrenë mendja se, mund të vijnë në politikën shqiptare në Shkup, si Ali Ahmeti nga Zvicra përmes maleve. Gabim e keni, o burra fushe! Ali Ahmeti nuk erdhi nga Zvicra kokë më vete si kalorës i arratisur. E, sidomos, kur pas dy-tri ditëve, merret vesh se kush janë themeluesit e atyre partive politike si kalorës të arratisur, dështoni si "lëvizje" politike që në start, pa dalë me të dyja këmbët ende nga pargu i Shtëpisë. Shkaku se, këtyre "bajraktarëve" (burrave të mejdanit), që i kanë shëtitur me rend të gjitha partitë politike shqiptare, nuk u shkon njeri i gjallë përmbrapa me kokën në qafë, as për një çaj rusi, nëpër çajtoret e Bit – Pazarit, në Shkup.

Ali Ahmetin për ta rrëzuar nga "pushteti", duhet të dalin në skenën politike të tjerë burra mejdani me tirqi e xhamadan. "Nagantin" në brez. Sahatin me çystek përqafe. Fatkeqësisht, ju ende i mbani tespihet kuqezi në dorë, shallvaret e turkut si veshje kombëtare nëpër Qytet e dasma familjare. Këmbët dhe trutë në legen. E di, ju vjen

inati se ua them në sy realitetin: ato burra nuk duhet të jenë me mjekra dhe dimi të grave. Patjetër. duhet të jenë burra mejdani, që ju nuk i keni parë me sy deri në Ditën e sotshme, përveçse në fotografi me dy kobure në brez. Përndryshe, me këto burra me dimi të grave nëpër këmbë, edhe gjatë kohë Ali Ahmetin dhe Menduh Thaçin do t'i kemi në ballë si politikanë në skenën politike shqiptare. Jo, pse i do populli shqiptar, por nuk ka të tjerë më të mirë si politikanë në Ditën e sotshme. Dhe, përderisa ju pasi t'u ketë "djegur" Menduh Thaçi, hedhi në treg si zarzavate të kalbura kopshti në pazar, për çdo vjet do të themeloni nga një parti politike, gjoja për ndryshime në politikën shqiptare, e ato si liderë partiak me votën e juaj "demokratike" edhe njëqind vjet do të rrinë rehat në "pushtet". Partitë e juaja politike "demokratike", që lindin ditenatë si këpurdhat pas shiut, ua zgjasin jetën, i bëjnë të pavdekshëm si politikanë në histori.

"Guxim" nuk kam ta them, se: janë të njëjtit individë të arratisur, edhe themeluesit e partisë re politike shqiptare. "Rilindje" kjo politike shqiptare, që sipas ardhjes në skenën politike, shumë i ngjanë "PYKËS" Shelgut të para disa viteve. E dini pse, individë të papërgjegjshëm (partizanë invalidë sistemi ideologjik), që e kanë vendin nëpër Qendra rehabilitimi e jo në politikë, u rreken themelimit të partive politike dhe

ëndrrojnë të merren me "politikë madhore". Pavetëdije, marrin më qafë rininë shqiptare, popullin shqiptar me dështime të njëpasnjëshme në politikë për interesa dhe përfitime personale e familjare. Fatkeqësia, që ende nuk e kuptojnë pykat politike "shqiptare" se, mashtrimit të popullit shqiptar me vite, duhet vënë pikë. Fund. Mjaftë e kanë mashtruar "vëllezërit" e Njerkës këtë popull të përvujtur e heroik, nuk ka nevojë edhe këta "patriotë" trusakatë t'i ngatërrohen me vite nëpër këmbë edhe në Ditën e sotshme!

E thashë njëherë, vetëm e përsëris për dudumët: nuk e di, pse i kam frikë protestat e tyre politike të veshura me petk politik e fetar në Shkup pa dhiare, sidomos kur pas tyre nuk qëndron asnjë organizator, ose u pri Gomari në krye që pas nuk i shkon rrugës as edhe gomarica. Edhe, themeluesit e partive politike shqiptare duhet t'i kenë në krye burrat me emra e mbiemra në krye si veprimtarë të dëshmuar për zgjidhjen e Çështjes shqiptare në Ballkan. Patjetër, duhet t'i marrin mbi vete (shpinë) dështimet dhe "fitoret" e këtyre organizimeve politike. Nuk mjafton vetëm, ajo: e themeluam një Parti Politike Shqiptare me një emër bombastik, iniciator në krye për "ndryshime". Turr mjetet e informacionit, kush më e para ta publikojë lajmin "exclusiv": u themelua edhe një parti e re politike shqiptare. Fare pa e ditur se, kush janë burrat tjerë ose gratë

që qëndrojnë pas atij emri?! Populli thotë: Trimi i mirë me shokë shumë. Vallë, mos edhe ketë "hero" mbi gomar që i kemi me thasë nëpër botë e kanë dalldisur kalorës të arratisur, që "vdiqën" të themelojnë parti të reja politike duke e përçarë këtë popull, gjoja për ndryshime politike?! Vetmevete, them: me siguri po, ma thotë mendja.

Koha do ta tregoj një ditë realitetin, përplasi në fytyrë: Defilimi dhe dalja në skenën politike e këtyre partizanëve të harxhuar e dështuar, është i rrezikshëm për popullin shqiptar. Vështirë me kësi kalorësish të arratisur bëhen ndryshime politike në Shkup. Rrufjanët e djeshëm, sot siç duket u ringjallën lugetër. Përsëri, na ndërsehen pas shpine me një asht në gojë. Profesionin e dikurshëm policor ende nuk e kanë harruar, mu si dje edhe sot: e hudhin gurin dhe e fshehin dorën. Komente anonime e në emër të "miqëve" të mi të dikurshëm e të sotshëm më shkruajnë nën shkrimet e mia profetike publicistike. Zanatin e vjetër, metodat policore dhe hujin e djeshëm pas dere, nuk e kanë harruar as sot duke e përçarë popullin shqiptar. Kotnasikoti, ende vazhdojnë të më provokojnë me metoda të njohura policore, merrem me ta t'i shti si "heronj" (trima pas lufte) nëpër libra, kur unë sot më nuk merrem me individë, por me fenomene shoqërore. Alamet emrash "patriotësh", që më kanë spiunuar dje, vazhdojnë të më spiunojnë edhe sot. Dje, më kanë

ndjekur si djalë ballisti, e sot po të njëjtit këlyshë me zgjebe më ndjekin si djalë partizani (komunisti). Dje, më shpallnin si "nacionalist e irredentist" shqiptar, i "rrezikshëm" për Shtetin. E, sot si spiun të "serbo-sllavise qe sulmon simbolet islame". Vetëm e vetëm, që dje të shpërbleheshin si trusakatë me poste redaktori nëpër redaksi në rolin e policit letrar, e sot me poste politike partiake në Qeverinë e "vëllazërim – bashkimit".

Hë për hë, unë që i njoh mirë këto këlyshë me zgjebe endacak rruge (rrufjanë) të librave të mi artistik e publicistik, të cilëve ua kam hequr maskat e rrejshme patriotike edhe matanë varrit, i kam zhveshur lakuriq para syve të popullit shqiptar, ashtu siç janë pisa e të pabesë, mendoj, shkruaj dhe di kështu si shkrimtar, me kokën time në qafë. E shoh në sy realitetin, në Shtetin e "përbashkët demokratik". Bërllokun shqiptar, që na e ka zënë frymën. Dhashtë Zoti të jem gabim, dhe na delë Ndryshe si shqiptar.

Nuk i dihet, të presim edhe ndonjë ditë. Sot për sot, ende i kanë gjallë miqtë e tyre të "veprimeve patriotike" (policore) nëpër parti politike, polici, komisione lustruese. E Nesërmja, do ta thotë fjalën përfundimtare, cili ka qenë "spiunë" e cili "patriot".

Tambëli më ka djegur, i fryej kosit…

SHKUPI MES SËPATAVE FETARE E POLITIKE

Parku i Grave, ku ne si nxënës të shkollës së mesme normale e kalonim natën nën pishat dundushore me vajza maqedonase, ka ndryshuar mjaftë nga ajo kohë. Azganet, në atë kohë ishin më të "lira" për ahengje, sesa cucat shqiptare që me rënjen e territ mbi Qytet, prindërit i mbyllnin në shtëpi. Ditën e kishin për në shkollë, por jo edhe natën për t'u dalldisur nëpër parqe e lokale nate. Vite ato, kur duhej të ndërronim për "mashtrime" dashurie, emër e mbiemër si shqiptar. Punë tjetër ishte ajo se, pak kishim nevojë për veprime të tilla strategjike. Shkaku se, shteti komunist moti e kishte bërë këtë me kohë: shumicës së mbiemrave të shqiptarëve te ofiçari maqedonas ua kishte shtuar vetë në fund nga një "oski", ose "viç". Përndryshe, vajzat maqedonase të asaj kohe, posa të dëgjonin se je shqiptar, iknin me të katra nga sytë - këmbët. Ndoshta, më vonë pajtoheshin me fatin se, edhe pse kanë qenë të "mashtruara", mund të lidhin bashkëjetesë me një "shiptar", por kjo më nuk mvarej prej tyre si "viktima" shkaktare, por famaljes dhe shoqërisë. Edukata e tillë ishte familjare, njësoj si me vajzat shqiptare, nëse martoheshin me një burrë të një feje tjetër dhe nacionaliteti. Edhe pse, propoganda

politike komuniste, përpiqej t'i afrojë si popuj nën një çati me parullën e "vëllazërim-bashkimit". Pak martesa të "përziera" u bënë në atë kohë, ku shumica përfumduan të pasukseshme.

Pishat e asaj kohe, sot me kokat në qiell janë rritur pa mua me shokë të gjeneratës sime revolucionare. Fundviti shkollor, gati të gjithëve na shpërndau si Kashta e Kumbarës në Shkup, Prishtinë e nëpër botë. Shumicën në kurbet. Ndonjërin, edhe në burg. Bibliotekën më të pasur me libra, në Idrizovë. "Universitetin" shqiptar, nga ku pak veta dolën me diploma të zanateve, piktor e shkrimtar. Nuk e di sot, a strehohet natën ndonjë shqiptar mes atyre pishave kokë më kokë te Parku i Grave. Arsyeja, nuk e kanë më atë sigurinë dhe "bukurinë" e tyre të atëhershme natyrore si dëllinja. Shtat kanë lëshuar dhe gati me kokë prekin qiellin mes reve. Korzon e famshme, në Bit-Pazar. Netët hirstorike, kur i gjithë Qyeteti me gra e burra pa dallim feje e kombësie, dyndeshte në këtë anë të Vardarit, sokaqeve të kësaj Çarshie shqiptare deri në agim. Vërtetë, Shkupi në atë kohë merrte frymë përmes këtij damari natyror, rrëzë Kalasë Dardane.

Ditën e sotshme, fatkeqësisht Shkupi pas gjithë këtyre përpjekjeve politike - "demokratike" mbi njëzetë vjeçare, mezi merr frymë artificiale me zemër betoni plot plagë e "operacione"

kirurgjike në trup. Partitë politike, përpiqen ta shpëtojnë nga vdekja klinike. Pak rëndësi ka se, cila parti politike do t'ia kthejë shpirtin, ringjallë përsëri në jetë: ajo maqedonase, apo shqiptare. Dorën në zemër, që të dy palët përpiqen dhe i dalin zot si Kryeqytet i tyre historik. E kanë ngulfatur me beton deri në fyt, në vend të gjelbërimit edhe me përmendore antike (hipur në kalë e më këmbë me armë në dorë): bullgare, serbe e aty - këtu edhe me ndonjë shqiptare sa për sy e faqe me strehime "ilegale" partiake: Skënderebeun dhe Hasan Prishtinën, në Bit – Pazar. Dhe, ndonjërën që e pret radhën me vite mbi "Urën e civilizimeve". Kryeqyteti me vështirësi merrë frymë mes sëpatave fetare e politike. Kryqave gjigant majëmaleve dhe drapërhënave nëpër minare, në vend të shqiponjave dykrenare. Gjelbërimin e ka mbuluar bërlloku. Drunjt, përditë i rrëzon mbi bar sharra elektrike dhe sëpata. Ndërtesat dhe shtëpitë e Zotit, mbijnë brenda një nate nëpër parqe e livadhe si këpurdhat pas shiut.

Vështirë e kanë politikanët e arratisur, sot të na e fshehin realitetin me sytë në ballë, ne të pagjumëve. Hutaçëve, që natën e kalonim qafë për qafe me femra mes tingujve të muzikës vendit dhe asaj botërore nëpër diskoklube nate deri në agim, nga ku të nesërmen me një fletore në xhep përfundonim në bankat shkollore. Vite, kur

kujdestari i klasës, na merrte si shembull, sesi nuk duhet të jetë nxënësi. "Armën" e tij primitive e nxirrte nga xhepi brendshëm i setres, këmbëkryq na priste në orën e parë të kujdestarisë: krah për krahu nëpër qytet na kishte parë me ndonjë mike, ishim veshur me xhins (farmerka, vajzat me minifunde), Padashtas, e kishim ngacmuar shoqen e shkollës, rrokur përqafe gjatë pushimit mes orëve të mësimit. Ruajna Zot, nëse flokët pak na i kishin mbuluar veshët. Pantollonat e këmishat i kishim stolisur me emrat e këngëtarëve dhe grupeve legjendare të muzikës botërore: The Beatles, Jimi Hendrix, The Rolling Stones, Janis Joplin, Led Zeppelin… Ose, gishtat e dorës me unaza argjendi: kafkë njeriu (simbolin e Zonjës Vdekje), gjarpër kulaç me kokën përpjetë, kokë tigri gojëhapur, ose ujku. Mos e dhëntë Zoti të na e gjenin portretin e Skënderbeut të fshehur nënë jakën e setres, ose simbolin e flamurit kuqezi kombëar me shqiponjën dykrenare. Gjithë klasën e merrte lumi. Kujdestari i klasës, kur ti arsyetoheshe të dalësh nga "rrethimi" luftarak i sulmeve "artilerike" nga të katër anët, se: nuk ke para në xhep, është fundi i muajit, i nxirrte nga xhepi paratë dhe të përcillte te berberi. Dënimi dihej: aty - për aty hapej ditari. Përdreq, ditari gjithmonë hapej te "viktima" para gjygjit te dërrasa e zezë. Tri pyetjet e kujdestarit të klasës rafal, si tre plumba dum-dum "naganti" në mes të

klasës të qëllonin mu në ballë. Përfundimi, i dyluftimit në klasë me "fitore": njëshi me karrige në ditar.

Megjithatë, ne ishim para "gjykimit" të kohës egër komuniste, përballë kujdestarit të klasës: edhe kur i dinim pyetjet, për inatë vetëm me një lëkundje koke i përgjigjeshim "komandantit" se, nuk i dimë pyetjet. Kujdestarit të klasës ia plotësonim dëshirën e "fitores" luftarake në klasë, ia "zbutnim" pak zemërimin. Përçudi, edhe ne gëzoheshim, kur e shihnim sesi ai krenohej e fryhej përpara klasës si biban mes lëmës se, ia ka arritur qëllimit edukativo - arsimor. Njëshi, kurdiseshte në ditar. Përditë, kujdestari i klasës, kur na shihte në qytet, ose kishim bërë ndonjë bela në klasë, na pyeste me notë, armën e vetme luftarake. Shpërblimi dihej, njëshi në ditar me gjithë karrike.

Një ditë, kujdestari gati përpak u çmend, i zemruar u ngritë nga tavolina duke e goditur me grushta: nuk kishte rubrikë të zbrazët në ditar, ku mund ta vëndonte njëshin e radhës "me karrige", aq të dashur e proferuar si armë ndëshkimi për ne "kryemgritësit" e shkollës. E pa se, ia kishim hedhur me mjeshtri pa e shkrepur asnjë "plumb" nga pusia. Klasa qeshi atë ditë me këta hutaçë, që gjithë natën e lume e kalonin nëpër disko klube me një fletore në xhep, dhe të nesërmen, na hynin në klasë si "banditë" shkolle.

Intersant, është rasti i profesorit të gjuhës maqedonase (Boge), një artist i asaj kohe që vinte mes nesh nga teatri maqedonas, të cilin Partia Komuniste e kishte dënuar si "armik" të Shtetit me ndërrimin e vendit të punës në një shkollë shqipe. Bindjet e tij edukativo-arsimore, që kishte për nxënësit shqiptar. Fjalinë e parë, që e nxirrje nga goja, ta përplaste notën në fytyrë para syve të gjithë klasës. Diturinë dhe mendimet, pa e hapur fare gojën, aty për aty t'i lexonte në sy e kokë. E, sidomos Filin, që e kisha shok klase, por edhe banese në një barakë humanitare pas tërmetit (1963) në veri të Shkupit. Boshnjaken Hajrën, pronaren e banesesë që sa herë kthehesha nga diskoklubi pak para agimit, i trokisja në dritare të ma hapë derën, ia prishja gjumin e Shejtanit. Zjarr e flakë nxirrte nga goja, se: kurrë më, nese i vija edhe njëherë në këtë kohë në dritare, nuk do të ma hapte derën. Megjithatë, "çmenduria" rinore vazhdonte nëpër diskoklubet e natës, e ajo kurrë nuk më la pas dere me një fletore në xhep.

Një ditë, kur profesorit i erdhi te hunda me "diturinë" e Filit, i tha para klasës: Shiko ti Fili, mos e shiko Loshin! Vërtetë, Loshi nuk mëson, por ai di. Ti, as mëson dhe as që di. Prandaj, ulu dhe nxeje mirë karrigen! Njëshin ia përplasi atë ditë me gjithë karrige në ditar përpara klasës. Fili e humbi edhe vitin shkollor. Ishte tip tjetër i nxënësit, aq dhunti qiellore i kishte falë Zoti e

Natyra, nuk e kalonte natën nëpër disko klube e as mbi libra. Mosmëkeq, o Zot kujdestari im i klasës të shihte në mesin tonë ndonjë nxënëse me shami e veshje turko – arabe. Qindpërqind, jam i bindur se si i çmendur duke uluritur me duart pas shpine, të gjithëve një nga një do ta na pëzente nga klasa. Reklamat e huaja të modës propagandistike të sotshme, që ne i kemi nëpër shkolla, universitete, emisione televizive, kurrë nuk do ta shkelnin pragun e derës të shkollave shqipe, që me plotë vështirësi në atë kohë i kishin hapur Rilindasit tanë edhe fshatrave nëpër male.

I shalova këto fjali dhe mendime në këtë shkrim për të dalur te qëllimi. Shkupin, për çdo njëqind vjet e shkund (zgjon) nga gjumi tërmeti katastrofal. Përçudi, ai edhe në Ditën e sotshme përkundet me ninulla shoveniste mes feve dhe partive politike. Trusakatët me këmbët dhe trutë në legen, nën shkrimet e mia më sulmojnë pa argumente me komente teknefese. Fare nuk merren me shkrimin publicistik. Fenomenin e çuditshëm, që na është ulur këmbëkryq në sofër, por me mua si autor. Gjoja e dua Gruevskin e Cërvenkovskin, politikën "madhore" të Ali Ahmetit e Menduh Thaçit. Fotografitë e të cilëve i mbaj në dhomën e punës. Verën, se e pi me nga dy shtamba. Rakinë me ibrik. Herë më shpallin spiun serb e herë rus pa fakte. Veten, gjoja e paskam shitur për pak para.

Jo, o trusaktatë! Ditën, kur unë do ta shesë veten do ta marrë vesh e gjithe bota. Sot për sot, ende jam i shtrenjtë, nuk blehem me pak para të pista, nuk e kam ulur çmimin e pazarit. Ende ngulë këmbë për një Shtëpi të shkrimtarëve shqiptar në Shkup, buxhet shtetëror vjetor me tri-katër vende pune, Statutin e merituar të shkrimtarit dhe dy-tri manifestime tradiconale ndërkombëtare. Çmime shtetërore shqiptare. Institucion, pra shqiptar i barabartë me Shoqatën e Shkrimtarëve të Maqedonisë. Fatkeqësisht, deri më sot partitë politike shqiptare nuk kanë qenë të interesuara për shitblerjen e këtij "malli" kulturor me firmë shqiptare. Anda më shumë ua ka akademikët e "vëllazërim-bashkimit", "profesorët" universitar me diploma e tituj shkencor të blerë në Qafë Thanë e nëpër universitete private dhe shtetërore me ngjyra partiake. "Inteketualëve dhe analistëve" politik, këmbekrye të strukur nën sjetullat e partive politike si partizanë të arratisur nëpër institucionet e Shtetit të "përbashkët" me një torbë taxhi përqafe.

Moti e kam thënë se, këta gjysmanalfabetë nuk dinë t'i lexojnë shkrimet e mia profetike për Ditën e Nesërme. Nateditë, përpiqen t'i lexojnë përsëprapthi, devijojnë, japin karakter tjetër politik e lokalist vëllavrasës. E kanë kotë dudumët, shkrimet që i shkruaj unë me kokë, e jo

me trutë dhe këmbët në legen, nuk mund t'ua lëvizë askushi një tullë, një gur nga kulla shqiptare. Shkrime parashikuese, që na e rrëfejnë me gisht rrugën për në Baba Tomor. Punë tjetër është ajo se, "miqtë" e mi një ditë do të cofin me përpjekjet e tyre tendecioze me simptome tërbimi, shkrimeve të mia t'u japin karakter antikombëtar. Urrejtje personale, lokaliste, fetare e nacionale. Edhe atë, sidomos kur e gjejnë veten këmbekrye të zhveshur lakuriq, ashtu siç janë pisa nëpër shkrime publicistike duke ua përplasur realitetin në sy e fytyrë me argumente. E di, dhemb shkrimi ironik i këtij zhanri artistik, po ky është hë për hë realiteti i sotshëm shqiptar. Nesër, dhashtë Zoti dalim not matanë bregut, nuk mbytemi në hurdhë. Dhe, është tjetër punë, nëse mund t'i fusim edhe një sy gjumë nën hijen e shelgjeve, matanë lumit.

Edhe, IRJ e Maqedonisë mua më duket si Fili, shoku im i bangës dhe klasës. Vite me radhë të cilin profesori Boge e ngelte në klasë. Njësoj, siç e lë pas dere Bashkimi Eavropian IRJ të Maqedonisë, e cila Sheshet e Kryeqytetit i mbushi me beton dhe përmendore. Mjaftë, sipas meje do ta kishte Aleksandrin e Madh të Maqedonisë me Olimpinë. Edhe Filipin e Maqedonisë me grushtin te koka si xhaxhi Enver. Përmendoret tjera historike, që na e kanë zënë frymën, qiellin dhe Diellin, janë pa nevojë, në të cilat edhe zogjtë e malit mbi to sot për sot nuk

bëjnë çerdhe. Ndoshta, ndonjë gëlasë fluturimthi ua lëshojnë nga qielli mbi kokë, por vetëm kaq. Pakgjë, politikanët tanë "demokratik" bënë për të dalur nga qorrsokaku politik. Me siguri, po të ishte gjallë profesori i gjuhës maqedonase (Boge), i Shkollës Normale "Zef Lush Marku" në Shkup, do t'i mbante vite me radhë si ngelës këta politikanë vite me radhë në të njëtën klasë. Shkaku, se: Shkupit nuk i mungojnë kishat ortodokse me kryqin e madh në Vodno, e as xhamitë me drapërhëna në minare, po institucionet arsimore dhe kulturore.

Ndoshta një ditë, Shteti "demokratik i përbashkët" e kalon klasën si Fili i bangës sime duke e "ndezur" flakë nateditë karrigen nga mësimi. Edhe pse, frikë kam, se: kjo kohë qorre nuk e ka në Ditën e sotshme profesorin e gjuhës maqedonase (Boge), por Nikolla Karevin përpara Kuvendit me kalë shale përballë Parkut të Grave...

"OPOZITARI" QË E "SFIDOI" ME ÇAJ RUSI FARAONIN

Ramazani për këtë vit, siç i ka hije e bënë të veten si festë fetare tradicionale myslimane. Gjysmën e Qytetit me katunde, përreth Shkupit e paralizuam, nuk do të marri frymë për një muaj. Tregun e madh të Bit - Pazarit në mes të Shkupit, që i mbanë gjallë me bukë e mallëra mijëra familje shqiptare e lamë pa "myslimanë" me "Din e Iman" në Ditën e sotshme. Nuk them: pa shqiptarë. Edhe tregun e Çairit, që në vend të një shkolle shqipe, e fitoi një xhami në mes të parkut (gjelbërimit), që dita-ditës po e mbytë bërlloku.

Muajin e Ramazanit (Natën), e kalojmë me çaj rusi deri në "syfyr", e Ditën e Nesërme në gjumë. Nesër, pas një muaji presim ta festojmë edhe Bajramin e Madh me përurimin e moçëm festiv të popullit shqiptar, shtëpi për shtëpi: Për shumëjetë Bajramin! Zoti ua bëftë kabull besimtarëve mysliman! Me siguri, edhe ua falë mëkatet?!. Tridhjetë ditët e Ramazanit, sipas kangës popullore shqiptare: "as kam hëngër, e as kam pi/ bashkë me lalën do të shkojmë në xhami/ bashkë me lalën do të pimë raki!

"Opozitari" shqiptar, herë pas here delë në YouTube dhe pasi e thirrë herët "sabahun" në minare pa flamurin kuqezi edhe këtë Ramazan në

shekullin e XXI, me siguri pas një muaji edhe Bajramin, i bie krahërorit me grushta si Tarzani në mes të Xhunglës maqedonase: Unë e "sfidova Faraonin"! E shpallë: "Shqipëri Etnike". Provokime dhe grep për popullin shqiptar, që e ka tejkaluar gropën të mbuluar me kashtë, qysh në kohën e Turqisë dhe serbisë. Përmes YouTube i thirrë shqiptarët në protesta të "qeta" qytetare. Përderisa, dje i thirrte dhe dilte në protesta në rrugë me flamurin turko-arab dhe "Allahu Ekber", sot e maskon veten me dy tre flamuj kuqezi shqiptar sa për sy e faqe. Fundekrye janë të manipuluar nga qarqe të fshehta sekrete antishqiptare. Përpiqen t'i shtinë në valle edhe partitë politike shqiptare në këtë shtet "demokratik", shoqata joqeveritare, Shtetin e Kosovës dhe atë të Shqipërisë. E, sa di unë, shqiptarët kurrë nuk kanë dalë në protesta e revolucione historike për Liri e të drejta kombëtare nga xhamia turko-arabe (Shtëpia e Zotit, "Shtet" të vetëshpallur "mysliman" mes Shkupit) përpara syve të "vëllezërve", siç e kishte Tirana zyrtare me vite para syve të policisë shqiptare Lazaratin, në Shqipëri.

Protestat dhe revolucionet në botë, gjithmonë janë nisur nga Universitetet kombëtare të popullit. Historikisht, këtë e dëshmon edhe koha e të gjitha revolucioneve shqiptare e botërore. Revolucionet, nuk i kanë bërë rrugaçët

pa brekë në bythë, por nxënësit dhe studentët krah për krahu me liderët e tyre në krye (ballë) të popullit. Historia, edhe sot me kreanri na flet për ato lëvizje kombëtare shqiptare. Padashtas, ose me qëllim e politizojnë edhe Bashkësinë e Fesë Islame në IRJ të Maqedonisë. Qëllimin e kanë te Univeriteti i Tetovës, që shqiptarët e themeluan dhe e ngritën me sakrifica e gjak para tytave të pushkës. Nevojë kam të ndalem këtu pak, marrë frymë mes këtyre rreshtave profetik, pyes veten dhe popullin shiptar: çka ngritën këto dumdumë të "hajrët" deri mës sot në dobi të popullit shqiptar?! Përgjigja ime është: Asgjë. E dini vetë, nuk ua përmend "flijimet e tyre fetare" në këtë shkrim. Punë tjetër është ajo se, Patrioti i vonuar përpiqet t'i arsyetojë këto protesta të dhunshme qytetare, si Nusja sëpatën në thes pas dere: "Gazetarët më pyesin pse rinia shqiptare shkupjane protestat e veta i fillon nga oborret e xhamive! Po pse, u them atyre, mendoni se do u lejonte dikush, për shembull, që ata të grumbulloheshin të papenguar përpara godinës së Universitetit të Tetovës në Shkup, që e kontrollon BDI-ja, apo te sheshi i Skënderbeut që është bërë pronë e kësaj partie shqiptare, si dhe nëpër sheshet tjera me përmendoret e Car Dushanave në to, e që janë vendgrumbullim vetëm për protestuesit maqedonas!?

Andaj mos pyetni, por shkruani se rinisë më progresive të shqiptarëve të Maqedonisë, asaj

shkupjane, i është ngushtuar hapësira aq sa i janë lënë vetëm lagjet e ngushta të pjesës së vjetër të Shkupit, ku jetojnë shqiptarët, se atyre qëllimisht u janë lënë vetëm oborret e xhamive, ku ata e ndjejnë se vetëm aty ende nuk është zgjatur gjithaq dora policore!"

Hi-hii-hiii… Gabim i madh trusakati. Përmëtepër, që e heq veten edhe si shkrimtar "shqiptar". E pranoj, edhe thirrjen e tij "patritoike muslimane", që t'i përgjigjem e shkruaj me trurin tim në kokë. Prandaj, edhe ia plotësoj dëshirën teknefese: Kurrë, nuk hoqi dorë nga huji i tij policor antishqiptar. Rinia shqiptare ende nuk ka

dalë masovikisht në rrugë. Rininë në të cilën ti thirresh si dudum "shqiptar", është vetëm një pjesë e manipuluar e rinisë shqiptare. Ditën, që Rinia shqiptare do ta ngerj zërin, nuk do të dali në rrugë, po maleve dhe do ta shkundë gjithë IRJ të Maqedonisë e Ballkanin, po edhe gjithë botën, atëherë duhet vënë gishtin kokës politikanët e sotshëm shqiptar. Edhe, sipas Dudumit u paska mbetur për protesta dhe "revolucione të Pranverave arabe", vetëm një xhami e Shkupit: ajo e Jahja Pashës. Xhami të cilën, nuk e ka nënë kontrollë edhe Bashkësia e Fesë Islame në IRJ të Maqedonisë, falë ndihmave sekrete të shërbimeve të fshehta antishqiptare, mos them Shtetit "demokratik" maqedonas. Jo, o dudumë "shqiptar"! Historikisht, populli shqiptar nuk e ka pasur xhaminë ose kishën për kryengritje revolucionare (Shtëpitë e Zotit), po malin e Baba Tomorit. Heronjëve syptrembur dhe Rilindasëve shqiptarë, që edhe sot e kësaj dite u prehen eshtrat në qetësi mes atyre lëndinave e shpellave të Dragobisë.

Shtetit "demokratik" të IRJ të Maqedonisë, dikur i konvenonin këto "revolucionarë" turko-arab për ta nxirë para syve të botës popullin shqiptar, por kur këto "shehitë" një ditë iu sulën edhe vetë Shtetit maqedonas, Instutucioneve legjitime, i nxorrën dhëmbët e Luanit. Përndryshe, për sa u përket shqiptarëve, nuk do ta

lëviznin as këmbën nga pragu i Shtëpisë. Çita e Tarzanit, nga gëzimi duke u zgërdhi, e di: kërcen degë me degë me një banane në dorë. I komenton shkrimet e mia publicistike të kësaj natyre me emra e sulme anonime. Fjalën e vetme që e di, është "munafik" (spiun) sllav, serb, ose rus. Prapë, ku ta di për sa të radhës herë e përsëris: ma kënaqi Lapsin. Rreziku më i madh është ky, që hë për hë i kanoset sot për sot popullit shqiptar. Fare nuk ia vlen të merresh dhe humbësh kohë me këtë soj të kalemxhive (intelektualëve) të Bit – Pazarit pa "Din e Iman". Dudumët, që nateditë thirren në emër të Allahut me këmbët dhe trutë në legen. Përmëtepër, t'i padisësh në gjygj për shpifje, etiketime e dhunë fizike. Shkaku se, nuk ke çka t'u marrësh këtyre "fakirëve" nga pasuria e patundshme dhe e tundshme në Shkup, nuk kanë tru e as brekë me arna në bythë. Shkrim – leximin e kanë mësuar me shkronja arabe te hoxha i katundit.

Dudumi, me këmbët dhe trutë në legen, ende mendon se shqiptarët hanë bar si lopët "sallmadi" nëpër fusha e livadhe. Ende i rren mendja se mund t'i mashtrojnë shqiptarët përmes "misionarëve" të Fesë Islame, fusin në një thes me dudumët. Grykën t'ua lidhin nyje me një kordhë kanapi. Ndihmë të kërkojnë nga të katër anët, që t'i përkrahim në këto veprime pakrye antishqiptare. Keqpërdorin fatkeqësinë e

familjarëve të rastit gjykimit "Monstra", që kanë probleme me drejtësinë dhe ligjet e një shteti "demokratik". Përditë, fotografohen me shokë me tri-katër kësula-lecka në kokë nëpër çajtoret e Bit – Pazarit si Haxhi Rrenci, të cilit moti i ka cofur gomari ende pa mbërri në Mekë, në Grykën e Kaçanikut. Fushëbetejën historike, ku kryengritësit shqiptar"*shtatë sahat janë therë me thika. E, nuk kanë ditur se çka është frika."*

Përgjumshëm, turren me të katra pas partive politike. Liderve politik, mos u bien diku udhës. Edhe atë, për një torbë taxhi. Qëllimi parimor: Kokën, së paku ta fusin në ndonjë birucë të selive të tyre partiake, në Tetovë, Shkup e anembanë Atdheut. Gurë e dru hudhin pas atyre të "pafeve", që nuk u shkojnë përmbrapa si dhentë e nënkryeme ta ngrisin flamurin me hënëdrapër nëpër minare të xhamive, në trojet etnike shqiptare. Protesta politike bëjnë në Shkup me flamuj turko – arab e "Allahu Ekber". Parti politike myslimane Erdogane, përpiqen të themelojnë në Shkupin Dardan. Qytetin historik, që denbabaden nëpër shekuj ka bërë luftë fyt pët fyti, herë me Krajl e herë me Mbret. Dalldisin rininë shqiptare, nxjerrin në rrugë me pankarta në duar, gjoja për liri e të drejta kombëtare shqiptare. Jetën e tyre duke vënë në rrezik për qëllime të ulëta personale e profiterike në shërbim të ndonjë partie politike antishqiptare për të ardhur me

ndihmën e shqiptarëve në pushtet përmes dhunës, të cilës i vardisen si kope e deleve që nga koha komuniste pa bari me vite. Larg qoftë, ta ngrisin flamurin kombëtar kuqezi me shqiponjën dykrenare nëpër minare të xhamive shqiptare. I madh e i vogël t'u turren përmbrapa në misionin e tyre të shenjtë. Thirrje, t'i bëjnë popullit shqiptar t'u sulen xhamive shqiptare. Xhehnetit me lule. Pesë "vakte" t'i falin në ditë ashtu siç i ka hije myslimanit shqiptar. Shejtanin e Allahut ta përzënë nga qilimat e Persisë në mes të Shkupit historik shqiptar. Oborrin e xhamisë shqiptare ta shtrojë me qilima kuqezi.

Pasmesnate, t'i dalin ballë për ballë Lugatit me një këmishë të bardhë deri në fund të këmbëve. Xhenazes, që pasmesnate ngritet nga varri lugat, hip te Guri Zi i Çukës dhe gjithë natën e gjatë deri me lindjen e Diellit, na e përplasë derën: kusi e tepsia i rrokullisë nëpër dhomë. Tinarin me tëlyen na e hanë pas Derës madhe.

Problemi, ai i viziton për çdo natë edhe vejushkat, gjoja se burri i tyre "shehit" i vdekur është ngritut nga varri lugat. Raste ka plot, kur ai me to bënë edhe fëmijë. Theshetheme të plakave, se filjana ka bërë fëmijë me Lugatin. Punë tjetër, është ajo se ne, në Ditën e sotshme nuk e kemi atë kreshnikun trim shqiptar të vejushkës, që ia ngriti këmbët hoxhës nga minarja e xhamisë, bythekrye në tokë.

Shkak ky, që Lugati kur t'i teket si mysafir me një këmishë të bardhe deri në fund të këmbëve, i paftuar me rraçet për mejdani para syve të grave "besnike" na shëtitet nëpër Shtëpi. Rezen e derës ende na e luan si rrakashtrake shelgu. Lëmsh na e bënë Shtëpinë e Babait. Fëmijët i tremb ta fusin kokën nën jorgan. Frymën ta ndalin, presin agimin.

Pasmesnate, me gratë tona "besnike" na pjellë edhe fëmijë. Kopila, që të nësërmen ende pa dalë drita, e vrasin në gjumë Nënën dhe Babain. Atdheun. Dudumi "shqiptar" i Shkupit, me çaj rusi kështu e "sfidon" Faraonin.

Edhe, do t'i presim zgjedhjet e ardhshme, parlamentare, që Dudumi "shqiptar" i Shkupit me shokë e kumbara shtëpie te "Kulla" (ende e papagëzuar shqiptare) , të ngritet përsëri nga varri lugat. Koçinë me katër kuaj ta shalojë nëpër Çarshi pa Nuse, në Shkup. Këmishën e bardhë deri në fund të këmbeve ta veshi Natën e Madhe. "Xhematin" ta nxjerrë në rrugë në protesta të "Pranverave serike arabe", e jo në xhami t'i lutet Zotit për mëkate. Hallvë (dajak) Natën e Mdhe të na shpërndajë për "sevapë" nëpër Çarshi të Shkupit për Ramazan. Një Zot e di, çka do të na shpërndajë për Bajram. Përsëri si dje, me çaj rusi e këmbët dhe trutë në legen ta "sfidojë" Faraonin.

Hi-hii-hiii, me kësi soji "opozitarësh" nuk bëhen ndryshime politike…

SHËTITJE "PATRIOTIKE" RRUGËVE TË SHKUPIT

Moti e di, falë Rilindasëve shqiptar se, kush janë halldupët në Ditën e sotshme të Motit Madh. Punë tjetër është ajo se, gjoja "nuk i di" Shteti maqedonas i "përbashkët". Edhe, kënaqen nëpër "fitore" sesi, i dalin zot "Vatanit", turren me të katra pas pushtetit. Gurë e dru duke hedhur mbi njëri - tjetrin vetëm për një karrige lideri argati. Karrierë të sëmurë politike. Përfitimeve materiale e politike: personale, familjare, klanore e grupore. Aspak, nuk jam nervoz me "vëllezërit" e Njerkës, po inati më vjen me dudumët e Shkupit historik. Krijesa të Zotit dhe Natyrës me kokat garroçe nën sjetulla, këmbët në krah, duart në xhepa dhe palarenë e kungullit Stambollit karshi Diellit me rreze. Pusia e fundit pas ferre, siç duket kishte qenë qëllimi, "atentat" zgjidhjes së Çështjes shqiptare në Ballkan, sipas këtij soji krijese të Natyrës e Zotit. Vetëm, çuditem me veprimet e tyre pa kokë, pse nuk dalin haptas në fushën e mejdanit me emër e mbiemër si organizatorë të protestave "paqësore" qytetare?! Edhe, t'i shohi populli shqiptar "burrat" e mejdanit me emër e mbiemër, gjithë bagazhin e tyre "patriotik" në shpinë, kush janë në ballë të

luftës, cili u shkon përmbrapa me kokën e Shejtanit në thesin e kanapit arnë përmbi arnë.

Shembull konkret Kumanova: Protestat e fundit i merr nën sjetulla "Rinia shqiptare" e Kumanovës. Duartrokitje. Përsëri, pa organizator të protestave qytetare. Pyetja lind, cila rini shqiptare kokë me vete delë sot në rrugë: ajo shkollore, universitare, apo e partive politike?! Edhe pse, duhet thënë haptas: nuk ishte e gjithë rinia kumanovare shqiptare në rrugë. Dalldisjet si gjithëmonë pas euforisë, individëve ose grupacioneve politike e fetare dhe flamujve gjigant kuqezi mbi kokat e protestuesve, kësaj radhe ishin vetëm maskime të rrejshme për ta fshehur veten organizatorët e qorrsokakut para syve të shqiptarëve dhe botës përparimtare. Kohë, kur duhet më tepër punë nëpër shkolla, Universitete dhe institucione, e më pak fjalë, lutje në xhami e dalldisje "patriotike kuqezi" plot eufori në rrugë si kope e deleve pas kripës pa bari te Përroni i Thanës.

Përçudi, kësaj radhe më në fund, ujku e ndërroi qimen për veprime tinzare antishqiptare, por jo edhe hujin e vjetër nëpër shekuj. Ardhja e çunave kuqezi të Prishtinës dhe Tiranës në ndihmë, na e përkujton kohën e Zogut kur mbëlidhte vullnetarë shqiptar nëpër Jugosllavi për ta rrëzuar Qeverinë e parë demokratike në Ballkan të Fan Nolit, në Shqipëri. Sytë, edhe në

Ditën e sotshme na e shohin Don Kishotin Shqiptar me Sanço Pançon mbi gomar sesi, të gjitha betejat e "përgjakshme" i bënë për Dylqinenë e Tobozës. Bagazhin e tyre "patriotik" mbi samarë, lehtë ua lexojmë në sy, para fushëbetejave të "zjarrta" "patriotike". Parashikimet e tyre për Ditën e Nesërme Shqiptare. Punë tjetër, është ajo se, ato protesta qytetare pa organizator i njollosi edhe kësaj radhe kalorësi i arratisur me shokët dudumë, partizan partiak i harxhuar si argat politik ("miku" i Abazit malit dhe armiku i Ali Ahmetit të fushës), që nuk la institucion shtetëror, parti politike maqedonase e shqiptare pa e futur kokën me gjithë palare në grazhdin e Njerkës. Pak nevojë dhe bagazh patriotik ka ai mbi samarë t'u drejtohet si "patriot kuqezi" me megafon protestave qytetare shqiptare, që e kanë nisur marshin ditëve të premte dhe pikërisht pas faljes "Xhumasë" nga oborri i xhamisë me flamuj shtetëror të Arabisë Saudite, flamuj të zinj me shpatën e Aliut të Xhihadit islamik, me flamuj të Turqisë, me brohoritje "Allahu Akber" e me pankarta dhe parulla në duar fundamentaliste rrugëve të Shkupit, që të përfundojnë me shpalosjen e një flamuri gjigant kombëtar kuqezi në Kumanovën heroike.

Ditën e Premtes Madhe, vazhdojnë protestën, pas faljes së "Xhumasë" nga oborri i

xhamisë Jahja Pasha. Oborri i vetëm, që u ka mbetur shqiptarëve të "organizohen" për "Shqipëri Etnike", sipas publicistit dhe analistit teknefes (K. M.), ngase: sheshet dhe institucionet ua kanë uzurpuar maqedonasit dhe BDI, partia në pushtet me PDSH – në, "opozitë"?! Provokime tinzare antishqiptare me të cilat e nxjerrin rininë shqiptare në rrugë mes rrezikut si kope pa bari. Populli thotë: Kopenë e malluar shullanit dhe lëndinave pa bari, e hanë ujku. Provokim i ulët për qëllime politike, i cili do ta nxjerrë në Facebook si kundërpërgjigje edhe palën shoveniste maqedonase dhe japi hapësirë për veprime dhe dënime shoveniste me parullat e njohura antishqiptare: "vdekje shqiptarëve", "shqiptarët e mallkuar", "dhoma gazi për shqiptarët"… Hendeqe vëllavrasëse të hapi mes partive politike shqipatre, që populli shqiptar edhe në kohën e Turqisë i ka pasur prijësit e vet në ballë, nuk janë fshehur në dimi të grave, po u kanë pri kryengritjeve shqiptare dhe kanë dalur në ballë të luftës.

E, "Mic Sokolat" e sotshëm, që e kanë rrokur Çështjen shqiptare për fyti, fshihen nëpër çajtore të Shkupit dhe bëjnë politikë "madhore" duke e nxjerrë rininë shqiptare në rrugë, në vend të institucioneve të Shtetit "përbashkët". Përgjaken me policinë maqedonase, në vend të rroken fytas me librin, vendet e punës nëpër

institucione shtetërore, fitojnë dënime me burg të përjetshëm, në Idrizovë. Ferexhe maskimi e kanë proçesin gjyqësor "Monstra", dënimin e të rinjve me burg të përjetshën, e në anën tjetër i hapin rrugë themelimit të një partie politike myslimane edhe në Shkup. Mendja duke i rrejtur se, në fund të verës do ta korrin grurin që e kanë mbjellë të tjerët fushën pjellore shqiptare: me drapërin nën ferexhe, në "Pranverën arabe". Haramët e Baba Dovletit, që nuk e kanë lëruar arën me kohë, ende pa lindur Dielli, në përfundim të Pranverës shqiptare, mbjellin me farë, vadisin me ujë e as i kanë bërë roje nga sorrat e zeza. Drapërin, sot e rrokin për ta korrur fushën shqiptare pa pikë djerse, rrëzë Kalasë Dardane.

Jo, o dudumë shqiptarë! Gruri nuk korret para kohe pa derdhur djersë dhe mund në arë me hebet në krah. Djersët të ju shkojnë rrëke në fund të këmbëve. Ujë, mos ketë kush të ju japë me shtambë nën hijen e Rrapit. Tekefundit, gratë azgane me tepsi në kokë e vorbat e qumështit në dorë t'ua sjellin drekën. Porosia histotike: Përveshni mëngët e këmishve, edhe të pantollonave deri në gjunj, dhe hyni me shatin krahut mes arave. Toka do punë, hapur ugare, farë dhe ujë të maleve. Frymën ia jep Natyra. Sipas dudumëve, edhe Zoti. Dihet, me vete merrni edhe të gjitha mjetet bujqësore që i

posedon bujku: pllug, qerre, kosë, shat, kizë e drapër.

Vjeshta me brymë, është ajo stina që e mbledh bereqtin për Dimër. Ftoni mes kopshtit mbi bunar është zverdhur me degët përtokë. Vaj halli për ju si "patriotë kuqezi", që e keni pritur Dimrin me çaj rusi nëpër çajtore. Kalorës të arratisur, trima pas lufte që kërkoni këshilla organizative, kur sot zjarr na digjet mbi krye si popull shqiptar?! Kërkesa politike, kokë më vete pa harmonizimin e pikave, në çdo qytet shqiptar nga një kërkesë më vete sipas "organizatorëve". Hoxha tjetër i arratisur, as në xhami e as në rrugë me kokën te partitë politike shqiptare e palarenë te ajo Neokomuniste, turret me të katra me deklaratën e publikuar në mjetet e informacionit, se: "Shqiptarët në Maqedoni nuk kanë problem me maqedonasit, por me Shtetin". Deklaratë teknefese, që nuk përputhet fare me realitetin politik. Ende, nuk e di halldupi se, kush udhëheq me këtë shtet dhe i kujt është momentalisht Shteti?! Kutadi unë, ndoshta i shkreti mendon se, Gruevski dhe Jankullovska nuk janë maqedonas, po shqiptar?! Dudumi "shqiptar", për të arritur kulminacionin "profetik" ngutet dhe delkaron haptas në Shtetin e "përbashkët" demokratik: Ashtu pamë se komuna Çair u mbrojt denjësisht nga policia që nuk qe rasti me Komunën Qendër kur u demolua vitin e kaluar nga protestues

kishtarë pro qeveritarë", thekson për Lajm "analisti" me këmbët dhe trutë në legen. Thirrje publike bën që turma t'u sulet atyre institucioneve të pakta shqiptare në Shkup: Komunës së Çairit dhe selisë së BDI –së. Xhamat e të cilave në protetat e kaluara i bënë copë - copë, por nuk arritën dot të hudhin asnjë gur në xhamat e Gjyqit se, kërsiti dajaku. Mos e dhëntë Zoti, ndonjë gurë të hudhin në partinë opozitare shqiptare PDSH. Parti politke shqiptare e cila në këto protesta qytetare është dashur të jetë në ballë të ngjarjeve politike. Pavetëdije, Dudumi heq ferexhenë e zezë dhe e zbulon veten njësoj si Don Kishoti i tij shqiptar se, këmbekokë është në shërbim të Partisë Neokomuniste. O Imzot, përshesh i mendimeve dhe veprimeve në sofër! Lugë e as pirunë, nuk ka nxjerrë nga luganiku. Vaj Vatani e mjerë mileti, po të ishte gjallë Noli i Madh do ta ngriste edhe sot zërin nga Amerika. Jo, me ato vargjet e tij antologjik: hidhni, hidhni tok dollarë, të mos mbeteni të sharë! Por, me tjerë vargje: hidhni, hidhni tok tru, se na mbytën dru!

Shqipëria Etnike, sot për sot ka mbetur në duart e hoxhallarëve të rrejshëm të Bit - Pazarit?! Dexhallët me trumbeta që kanë dalë nëpër Bit – Pazar, krah për krahu heqin valle me muzika, mashtrojnë kalimtarët e rastit t'ua vënë nga një vulë në ballë. Edhe, atyre të Tiranës e Prishtinës. Njëzet vjet me radhë, kush u ka penguar këtyre

"shehitëve" të Allahut për këto thirrje "patriotike" historike "shqiptare"?! Rehabilitojnë dudumët, "njerëz të sotshëm me tru të moçëm" (F. P.), që me shekuj i ngatërrohen nëpër këmbë popullit shqiptar. Argatë të lindur brez pas brezi, denbaden pas dere në këtë nënqiell shqiptar. Bërllok halldupësh, që populli shqiptar moti e ka hudhur nga pragu i Shtëpisë nëpër kontejnerë të hedhurinave, në Bit Pazar. E, "komandantët" pas lufte pa ushtarë dhe të dështuar me tespihe "kuqezi" me "bardaket" e çajit rusit në dorë nëpër Çarshi, gjoja se i ndjek ligji i Shtetit nëpër male, përpiqen me pak shpirt të ngriten nga varri, përsëri t'i kthehen jetës politike shqiptare si dudumë të arratisur në gjirin e Partisë Neokomuniste. Gabim i madh historik, moti kanë vdekur këto kalorës të arratisur. Publikisht nëpër varre, një gur ua kemi vënë te koka e një te këmbët me atë thënjen antologjike: ju jeni mirë atje, ne jemi këtu. Ju rrini atje, se jeni mirë, ne do të rrimë këtu se, edhe ne jemi mirë! Varret e këtyre "shehitëve" në historinë shqiptare nuk kanë as "nam", e as "nishan".

Dhe, lufta për zgjidhjen e Çështjes shqiptare në Ballkan, nuk është e vështirë me Gruevskin e as me Cërvenkovskin, përmëtepër edhe me serbët që sëpatën e kanë varë në krahët e këtij soji të arratisur argati në Shtëpinë e Zotit. Frutin e papjekur, ende përpiqen me dhunë ta

këpusin nga dega majë peme pa pikë djerse me argatë "shqiptar", sipas Esad Mekulit: O, vëlla me sharrë në krah! Dudumë, që gjithë jetën i janë ngatërruar dhe vazhdojnë t'i ngatërrohen nëpër këmbë edhe sot e kësaj dite popullit shiptar.

Aspak, nuk është shpresëdhënese deklarata e patriotit të vonuar përmes Facebook se, tashti edhe ai do t'iu bashkangjitet protestave "revolucionare" të nisura nga oborri i Xhamisë:

Jahja Pasha. Pamarrë parasysh se, kush qëndron pas tyre si organizator. Qesharake, pas gjithë kësaj kohe. Trusakatit, që për protesta demokratike i është ngushtuar hapsira shqiptare, i ka mbetur vetëm oborri i xhamisë (Jahja Pasha), në Shkup?! Deklaratë teknefese, të cilën shqiptarët do ta hudhin që të nesërmen me fakte në kokërr të shpinës me protestat paqësore në Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë, Kumanovë, Prishtinë, Tiranë e nëpër botë. Protesta paqësore, që nuk do të nisen nga oborri i xhamive, po nga sheshi "Iliria", "Skënderbeu" , "Nënë Tereza" e gjimnazi "Sami Frashëri".

Heroike, do të ishte ky patriot i vonauar të dalë në ballë të protestave qytetare si orgranizator me shokë. Pse jo, edhe t'u pri në ballë protestave "paqësore" si Mic Sokoli, rroki topin, kësaj radhe jo turk, por atë maqedonas për fyti?! Rininë shqiptare, mos të lë në mes të rrugës në mëshirën e dajakut, mes organizatorëve bashibozukë të dyshimtë, që e fusin rininë shqiptare në zjarr, e veten e mbajnë larg flakës, nëpër çajtore. Edhe doli një ditë, nuk e zgjodhi Tanushën, po qytetin e Kumanovës.

Unë, them: Edhe gomari me dy veshët kryengritës përpjetë mes livadheve, pakënaqësinë e tij e shpreh në rrugë me të katër këmbët në batak. Zërin e ngre për të drejta qytetare. Arsye e plotë, shkaku se: partitë politike nuk e fusin me

gjithë samarë nëpër instirucione të Shtetit "përbashkët". Vetëm se, jo edhe Patrioti vonuar me shokë e shoqe, që deri dje dilte në krah të Partisë Neokomuniste në foltoren e improvizuar, përpara Qeverisë në mes të Dimrit për "ndryshime" politike. Lotët i shkonin rrëke për Nënën Parti, (aty ku e ka edhe sot zemrën) në opozitë me vite. Fotografoheshte nateditë qafë për qafe me "vëllezërit" para kamerave televizive përpara Qeverisë në mes të dimrit me gjithë një aktiviste partiake të Nënë Parti në pushtet. Përçudi, sot vetëm i përkrah me megafon këto protesta "demokratike". Mendja e rren se, kësaj radhe Nënën Parti Neokomuniste me dhunë nga rruga, jashtë institucioneve të Shtetit me ndihmën e këtyre pykave "shqiptare" do të kthejë përsëri në pushtet. Përmendoren e Alaksandrit të Madh ta heqin nga Sheshi i Shkupit e në vend të tij ta vëdosin përmendoren e Shokut Tito. Mirë do të ishte ky dudum shqiptar, nesër ta veshi petkun e tij partiak, ferexhenë e zezë krahëve dhe të dali haptas si partizan me yll të kuq në ballë në skenën politike, mos e mashtrojë më dhe manipulojë rininë shqiptare për interesa të sëmura personale të "liderit" politik shqiptar nën sjetullat e Partisë Neokomuniste.

Shqiptarët me këto "revolucionarë" të dështuar që në lindje me firmë Dexhalli, edhe gjatë kohë do ta presin te pragu i derës Lirinë.

Ndryshimet politike në shoqëri, Shtetin e "pëbashkët" nën këtë nënqiell. Zgjidhjen e Çështjes shqiptare në Ballkan. Shkaku se, ende i shkojnë përmbrapa (ose ai vetë u vardiset) dhe e dalldisin gomarin e Haxhi Rrencit si politikan të livadheve. Kafsha e zbutur shtëpiake, që u pri në ballë shqiptarëve për "Liri", përveç samarit arnë përmbi arnë, torbës me taxhi përqafe dhe dajakut të pronarit, asgjë nuk ka më të mençur në shpinë si bagazh lufte, veç garroçes kokëboshe me dy veshët përpjetë dhe katër këmbëve të rrasura deri në bark mes batakut. E ka nemur, siç duket Baba Dovleti: Dimrin e Madh ta presë me çaj rusi nëpër Bit – Pazar. Kurrë, të mos ngrejë krye si "lider" i kopeve të deleve, por gjithëmonë të jetë në rolin e argatit. Shërbetor besnik i sunduesve shekullor. Kukull, që armiku historik sipas nevojës ia tërheq penjët: kokën, dorën, këmbën. Edhe bythën, para kamerave televizive për dalldisjen e shqiptarëve në shëtitje "patriotike" rrugëve të Shkupit.

Grep, të cilit shqiptarët, më nuk i sulen vetëm për një krimb, Pykë Shelgu…

SKIZOFRENI

Skizofrenia, është sëmundja dhe dukuria e radhës që i është hudhur popullit shqiptar në "magazinë" për provokime politike. Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe e shpjegon kështu këtë fjalë: Skizofreni, A f. mjek. Sëmundje e rëndë mendore, që shfaqet me dyzim të botës së brendshme të të sëmurit për shkak të çrregullimeve në bashkërendimin e proceseve psikike dhe që sjell rënien e veprimtarisë psikike e paaftësinë për të vepruar në përputhje me realitetin. Skizofreni kronike. Skizofreni e pleqërisë. Vuan nga skizofrenia. Fat i yni si popull shqiptar, që na ka përfshirë pjesërisht e jo në përmasa masovike.

Skizofrenin, si personazh të këtij shkrimi publicistik e njeh i gjithë Shkupi, por shumë pak Prishtina dhe Tirana. Prandaj, Skizofreni pas disa rrotullimeve akrobatike nën sjetullat e partive politike nëpër Tetovë e Shkup, një ditë do të marrë në sy rrugën e "kurbetit" si shpëtim nëpër botë. Nuk shkruaj këtu, sesi dhe përmes cilëve kanaleve e kaloi kufirin. Ose, themeloi ndonjë Shoqëri civile të "pavarur" si "klinikë" mjeksore për rehabilitim të shpirtit, fushëveprim "ilegal" nga pusia pas ferre. Vendstrehim, ku nuk e njeh rrethi si "patriot kuqezi" shqiptar, dhe nga andej

me një torbë taxhi përqafe, do t'i sulet përsëri Shkupit me çetën e tij "kryengritëse" për veprime dhe "ndryshime" politike. Punemadhe, që bota përparimtare haptas nuk i përkrah këto "pranvera arabe" në mes të Ballkanit, por votën e lirë demokratike si armë paqësore për të ardhur në pushtet si faktor politik me vullnetin e popullit. Mendja ende nuk i mbushet, edhe pas dështimit të disa "pranverave arabe" e Parti - Pykave në Shkup se, populli shqiptar nuk është ai i djeshmi me kokën nën sjetulla, kujt t'i teket dhe kur t'i teket me një thirrje anonime përmes Facebook ta nxjerrësh në rrugë. Qëllimi, për përfitime personale, familjare, grupore, klanore e partiake, marrë më qafë një pjesë të rinisë shqiptare që i shkojnë përmbrapa Askushit me të dy sytë në ballë. Populli shqiptar, moti është në rrugë, vështirë është këtë popull si ta shtimë nëpër institucione të Shtetit. Dhe, një ditë i bie maska e mashtrimit si përkrahës i protestave qytetare "paqësore" nga oborri i xhamisë para kamerave televizive dhe policisë të Shtetit "përbashkët", dhe syve të popullit. Punë tjetër është ajo se, nuk e sheh par syve dhe nuk di asgjë policia e Shtetit "përbashkët për këtë "shehit", mjafton që e di populli shqiptar strategjinë politike të këtij "patrioti kuqezi" të vonuar me çallmën e turkut nën setre, një në kokë dhe tri - katër të tjera nëpër xhepa.

Pajtohem, të ishte vetëm një skizofren rruge, por populli shqiptar hë për hë ka skizofrenë me qerre, saqë mund t'i shesë me shumicë e pakicë edhe Evropës. Konkurencë pazari hë për hë u bëjnë vetëm kungujt e Stambollit. Skizofren i këtij soji, u printe në ballë edhe protestave qytetare "paqësore" në Tetovë, që pas pak kohe doli në anën e forcave policore, edhe i sulmoi me gurë protestuesit shqiptar. Ditën e nesërme, pas "bisedave informative", doli se kishte qenë i "çmendur"?!

Ndoshta një ditë, edhe këto dy skizofrenët e protestave qytetare në Shkup, që përpak desh u vranë mes veti se cili të dalë i pari në ballë të turmës para kamerave televizive si "patriotë kuqezi" shqiptar, policia pas një "bisede informative" do t'i shpallë të "çmendur". Nuk e di faktorin "natyror", virusin e shkaktimit të kësaj sëmundje kolektive shqiptare. Edhe pse, ma merr mendja shkaktarin: rrethanat natyrore dhe shoqërore e politike me të cilat përballet me shekuj populli shqiptar. Përmbi të gjitha e them publikisht, është zgjidhja e Çështjes shqiptare në Ballkan. Secili shqiptar më patriot se shoqi. Shembull konkret, rasti i fundit "Monstra" me protestat e manipuluara paqësore në Shkup. Qytetarë të cilët për shkak të halleve dhe problemeve sociale e politike kanë "ikur" nga shtëpia dhe kanë dalur në rrugë. Dy skizofrenë u

prinë në ballë, njëri pranë – tjetrit, krah për krahu me "veprime organizative", gjoja për ta qetësuar turmën përballë policisë Shtetit të "përbashkët" e armatosur deri më dhëmbë. E, asnjëri me njëri - tjetrin nuk kanë asgjë të përbashkët si "organizatorë", qoftë nga veprimet "ilegale" patriotike, qoftë nga strofullat partiake nga i sulen Shkupit shqiptar me këmbët dhe trutë në legen. Përçudi, edhe ia arrijnë qëllimit: e qetësojnë turmën e paorganizuar të protestave qytetare, që janë nisur dhe sulen me të vetmin qëllim, çdo gjë që u delë përpara: lule, pemë, kontenjerë bërlloku e xhama, ta vënë nën këmbë dhe flakë. Guxim "patriotik", që skizofrenët të nesërmen t'u kundëvihen shkrimeve publicistike parashikuese me komente anonime plot shpifje e etiketime. Dorën në zemër, nuk duhet hëngër hakun: Talent kanë për sharje e ofendime duke e fshehur veten në dimi të grave.

Skizofreni, përpilon edhe "lista të zeza" në rolin e Rrufjanit si në kohën e Millosheviqit, pse nuk i shkojnë gomarit përmbrapa me të katra këmbët e rrasura deri në bark mes batakut, dhe përmes Facebook ia dërgon "Vojvodës" për "flijime artistike". Skizofreni me kokën në xhami e palarenë në polici. Vese negative, të cilat i bartin në zemër e samarë me vite, përpiqen t'ia mveshin tjetrit si autor i shkrimeve publicistike, pse i ka zhveshur lakuriq pisat e sokakut para

syve të popullit, ua ka nxjerrë për mejdani rraçet majë një kodre për rrezitje në Diell. E di, çifti i tyre do të thotë edhe se, "klloshari" është kundër ndryshimeve politike. Përralla arabe të Njëmijenjënetëve i rrëfen Shkrimtarit, që gjithë jetën ka qenë, është dhe do të vdesë në opozitë. Gabim e keni si "myslimanë ehamdurila" të Allahut. Shkrimtari moti është për ndryshime politike, por jo me këtë mall të mykur e kalbur politik, që na e shkarkuan "vëllezërit" para dere. Poashtu, i përkrah edhe Lëvizjet qytetare që u pri në ballë truri, por jo edhe protestat e dhunshme të cilave u pri bytha si komandante. Bërllok shqiptar, që e ka shitur veten me pare e pa pare: dje, sot dhe do ta shesë edhe Nesër. Jashtëqitje partiake pas shtëpie, që me vite si kërrocë fushe i ngatërrohet popullit shqiptar nëpër këmbë.

Fushëveprimi "strategjik" i skizofrenëve, kurdisja e tyre për provokime politike ndërsehen nga qendra të njohura nëntoksore antishqiptare. Vetëm një gjë nuk e kam të qartë: Partitë politike shqiptare (nuk e kam fjalën për ato maqedonase), si rrinë duarkryq para këtyre veprimeve "patriotike kuqezi" dhe ngjarjeve historike të kësaj natyre, nuk ua presin udhën qorre. Punë tjetër është ajo se, ndonjëri delë në rrugë me parulla e pankarta partiake e fetare në protesta 'kombëtare kuqezi", marrë vulën e Dexhallit në ballë. Kulminacioni ironik i shekullit: autorë të

panjohur të videos, edhe kur tallen në YouTube me përbaltjen e flamurit kuqezi kombëtar, duke ua veshur dy qenëve sesi e shqyejnë flamurin maqedonas. Them unë: Mungon qeni i tretë me zgjebe me bishtin ndër këmbë. Storie filmike jocivilizuese, që i shpërndajnë partizanët nëpër botë, në Facebook. Veprim i ulët njerëzor, që aspak, nuk na ka hije dhe bënë nderë si popull me traditë e kulturë Ilire nëpër shekuj. Shqiptarët, sipas këtyre autorëve anonim, qenkan qenë me flamurin kombëtar kuqezi në shpinë, që e shqyejnë flamurin e Shtetit të "përbashkët" maqedonas para syve të botës. Ose, me ata dy qentë e veshur me flamurin kombëtar kuqezi, kanë dashur t'i paraqesin në vepër dhe fshikullojnë me thupër thane ato dy "revolucionarët" në ballë të protestave qytetare, sesi e "disiplinojnë" turmën e zemëruar para kamerave televizive, mos ta kalojë "kufirin" politik, dalin matanë Vardarit, në anën maqedonase. Përmëkeq, edhe disa shqiptarë shkurtpamës, që nuk shohin më larg se para këmbëve të tyre në legen, u duartrokisin çmendurive të këtilla provokative si "fitore" historike shqiptare. Ndoshta, edhe kanë të drejtë "regjisorët" e filmit "Spaghetti Western": "vëllezërve" ua përcjellin porosinë e protestave të fundit paqësore në Bit – Pazar, kur dy "patriotë kuqezi" përpiqen ta qetësonjë turmën e zemëruar,

mos dalin matanë Urës Gurit te Aleksandri i Madh, që i bëjnë roje luanët duke vjellur nateditë ujë, në vend të zjarrit.

Mjerim kombëtar shqiptar, për ta vajtuar nateditë me gra Zajazi. Protesta qytetare, falë këtyre dy skizofrenëve, kësaj radhe përfundoi e "qetë", pa dhunë. Akrepët e orës, Dikushi ("Vëllai i Madh") që ua kishte kurdisur dje, sot ua ktheu përmbrapa, bythëprapë te kufiri ("26 korriku"), në Bit-Pazar. Porosi, që populli shqiptar duhet ta di dhe shohi larg jo me sy, por me dylbi, që mos t'ua hapë rrugën e as derën krah më krah këtyre dy kalorësve të arratisur, të cilët i njeh mbarë Shkupi për veprime teknefese "patriotike".

Presidenti i parë i Kosovës, Ibrahim Rugova ka thënë: durim, o popull shqiptar! Edhe unë them si parashikues i Ditës së Nesërme: durim o "patriotë kuqezi" të Bit - Pazarit! Amani, mos e rrokni topin e Mic Sokolit për fyti në Ditën e sotshme! Shkaku se, i keni përzi shekujt lëmsh, të cilin Macja e zezë ua rrokullis nëpër Lëmë: nuk është koha e Turqisë, nuk kemi ku të gjejmë sot këngatarë me çifteli, edhe dyluftimeve të jauja heroike "fytas" me armikun shekullor t'i fusim në këngët tona popullore, copë - copë t'i bëjmë çiftelitë nëpër emisione televizive me "oda shqiptare" e dasma familjare. Përmëtepër, kur sot populli shqiptar, nuk i do më ato këngë patriotike,

po muzikën tallava: plotë Xhemile, Lali Xhan, Llokuma, Sheqera, Vagabonda e djemë azgana që shtëpinë e "kallin me alltie" nëpër dasmat shqiptare. Nateditë, hidhen e përdridhen nëpër dasma familjare e ahengje partiake në rolin e arushës me dajre: herë më një anë e herë në tjetrën anë duke u rënë duarve shuplakë mes livadheve, maleve e salloneve dhe hedhin me thasë euro e dollarë amerikan mbi nusen pa koçi me krushqit (këngëtarët) e shashtrisur të shekullit.

Momentalisht, jemi populli më i lumtur në botë! Vetëm, hapni pak kanalet televizive shqiptare në Tiranë, Prishtinë e Shkup: Non – stop, ditenatë me këngë e valle. Pakgjë, përmes atij ekrani televiziv: arsimore, shkencore e kulturore. Heroizëm patriotik i dalldisur me këngë e valle. Dhe, Skizofreni, më mirë e ka të rri në xhami me këmbët dhe trutë në legen, sesa të merret me politikë "madhore"! E kënaqi xhaminë, tashti i ka mbetur ta "nxjerrë" në dritë edhe politikën shqiptare. Pesë vakte, "sevap" është t'i fali në Shtëpinë e Zotit. Allahut t'i lutet për mëkate. Ndoshta, ndonjë këngëtar i muzikës tallava, me siguri një ditë merr guximin, e shti si "shehit" në këngë me tarabuka…

PROTESTAT POLITIKE ME PETK FETAR QË I PRINË RASTIT "MONSTRA"

Ditën, kur e publikova në mjetet e informacionit një shkrim parashikues në lidhje me Protestat politike me petk fetar (13. 05. 2012), kur turma fundamentaliste rrugëve të Bit-Pazarit vërshoi me pankarta dhe parulla të shkruara me alfabetin arab, flamuj shtetëror të Arabisë Saudite, flamuj të zinj me shpatën e Aliut të Xhihadit islamik, "bajrakun" e Turqisë dhe me brohoritje "Allahu Akber" për një "Pranverë arabe" rrëzë Kalasë Dardane, pakushi ia vuri veshin atij paralajmërimi për rrezikun që i kërcnohej Shkupit shqiptar. Shkrimi tjetër, gjashtë ditë më vonë po i kësaj natyre rreth rastit "Monstra": Përralla e përgjakshme maqedonase (19. 5. 2012), e tërboi Hoxhën e Allahut dhe mu turr me një shkrim qorr plot shpifje e etiketime në ato paçavuret e tij në Facebook me këmbët dhe trutë në legen, se: unë ende plasa pas poetes serbe Desanka Maksimoviç. Vetëm e vetëm, pse si autor në atë shkrim kisha bërë një krahasim mes poemës së autores serbe dhe rastit "Monstra". Poemën, që dikur pa vullnetin e shqiptarëve e kishim nëpër librat e këndimit dhe planprogramet shkollore, të cilën në kohën komuniste e mësonim përmendësh me shumë vështirësi. Një Zot e di

edhe sa nota të dobëta kemi marrë në ditar për atë poemë aq të gjatë patetike, të cilën kurrë nuk e mësum varg për varg deri në fund. Shkaku, se: sa herë na dilte te porta ndonjë qen duke na u turrur përmbrapa, gjysmën e harronim rrugës plot me gropa për në shkollë.

Poema, si poemë e ka historikun e vet të asaj kohe. Populli serb, kur nuk dilte me armë në dorë të luftonte kundër gjermanit. Serbët, historiksht të njohur për kësi montimesh të proceseve politike, vishen me uniformë ushtarake gjermane dhe i pushkatojnë më oborrin e shkollës nxënësit serb me gjithë profesorë, në Kragujevac. Ditën e nesërme, i gjithë populli serb çohet në kryengritje kundër gjermanëve. Procese të këtilla serbët kanë montuar edhe pas Luftës së Dytë Botërore, në Bosnje e Kosovë. Rasti freskët politik, ai i Martinoviçit me shishen e birrës. Kohën e fundit, një proces të tillë për të ardhur në pushtet brenda një nate, forca të errëta kriminele e montuan edhe në Shkup. Përçudi, pas një kohe të Protestave politike me petk fetar, ndodhi rasti "Monstra". Fajin e ekzekutimit duke ua hedhur shqiptarëve. Vallë, a nuk i prinin procesit të montuar "Monstra", Protestat politike me petk fetar?! Ndoshta. Ngjarjet e këtij soji dhe karakterin e montuar politik, patjetër duhet t'i analizojë Shteti juridik dhe partitë politike shqiptare ende në gjumë nëpër selitë e tyre partiake, në Tetovë.

Familjarët si "kundërpërgjigje, gjykimit të montuar politik, ku gjashtë shqiptarët u dënuan me burgim të përjetshëm për rastin "Monstra", iu përgjigjën me protesta qytetare. Protesta, që në fillim do të dalin pa këshill organizativ, të organizuara përmes Facebook -ut dhe do të nisen rrugës përmes Bit-Pazarit, pas faljes së "Xhumasë" nga Xhamia e Jahja Pashës. Protesta qytetare, që më vonë manifestuan edhe dhunë: përmbysën kontenierët e bërllokut, shkretuan parqet me lule, thyen xhamat e Gjygjit, selisë së BDI –së dhe Komunës së Çairit. Selinë e PDSH –ës në Shkup, nuk e prekën fare, nuk i hodhën asnjë gur, së paku t'ia thyenin një xham sa për sy e faqe. Barazojnë me xhamat e selisë së BDI –së dhe Komunës së Çairit, që i bënë copë-copë, xhama të cilët ende nuk i kanë vënë në dritare. Me siguri presin edhe gurë të tjerë dhe nuk duan të bëjnë kotnasikoti shpenzime materiale. Pakënaqësi qytetare, që më vonë do të përhapet edhe në Kumanovë, ku turmës me magafon në dorë do t'i pri në ballë Kim Mehmeti. Protestuesit me flamuj kuqezi e pankarta në gjuhën shqipe do të shpalosin edhe një flamur gjigant kuqezi kombëtar.

Protesta e radhës, përsëri do të niset pas faljes së "Xhumasë" nga oborri i xhamisë Jahja Pasha. Shtëpia e Zotit, ku Kim Mehmeti sipas pyetjeve të gazetarëve do të dalë edhe me

deklarata teknefese, se: Rinisë shqiptare i është ngushtuar hapsira nga partitë politike, prandaj edhe ato dalin në protesta qytetare nga oborret e xhamive e jo nga Sheshi Skënderbeu, dyert e shkollave e Universiteteve në gjuhën shqipe. Deklarata trusakate, që më vonë do t'u bie ferexheja e zezë me gjithë brekë në fund të këmbëve. Kim Mehmeti dhe Musa Lamallari do t'u prinë protestave në ballë krah për krahu duke u bërë "thirrje" që të jenë te qeta deri te kufiri shqiptaro-maqedonas ("26 korriku"), në Bit-Pazar. Përpak, edhe të vriten mes veti se cili t'i përvetsojë këto protesta për qëllimet e tyre të karrierës sëmurë politike. Themelimit, edhe të ndonjë Partie Politike Myslimane, në Shkup. Tashti, edhe do të fillojë rivaliteti mes tyre si kalorës të arratisur (njëri mbi kalin asht e lëkurë si Don Kishoti i Mançes me një gjysëm kungulli Stambolli në kokë, e tjetri mbi gomar si Sanço Pança) me "protesta paqësore", intervista dhe shkrime publicistike. Familjarët, do të jenë ato që edhe do t'i qetësojnë gjakërat: Protestat paqësore, kësaj radhe do t'i marrin në duart e tyre dhe formojnë këshill organizativ. Trimat pas lufte si kalorës të arratisur, më në fund do t'i nxjerrin jashtë loje. Njëri nga ta, më i dalldisuri do të dalë edhe me një thirrje publike: Ditën e premte të mos dilet në protesta! Mendja i thotë dudumit se kjo ditë është e shqiptarëve, e në protesta

"paqësore" duhet të dilet patjetër nga oborri i xhamisë, ditën e "Xhuma" (myslimane). Thirrje teknefese, të cilën nuk do ta dëgjojnë shqiptarët. Protestat i morën në dorë familjarët e të burgosurve "politik" dhe dolën me kërkesa qytetare.

Populli thotë: E drejta vonon, por një ditë fiton. Edhe rasti i montuar "Monstra", ditët e fundit hedhë në dritë shenja pafajsie. Babai i peshkatarit të vrarë te liqeni në Smilkovë, Borçe Stevkovski, ka thënë se dihen autorët e vrasjes së djalit të tij, dhe se ato nuk janë shqiptarë. Publikisht, ai ka thënë se e dimë kush i ka vrarë djemtë tonë dhe do vijë koha e do të zbardhet rasti një ditë.

Parashikimi im i asaj kohe doli në sipërfaqe. Hoxha i Allahut që mu ndërsye si këlysh i tërbuar pas shpine, nuk e di si e ndjen sot veten në rolin e profetit të rrejshëm apo Rrufjanit?! I vetëquajturi "elvija" si "parashikues" i ngjarjeve politike. E, asnjë parashikim i tij deri më sot, nuk doli si ngjarje reale profetike. Jerm, ende vazhdon të dërdëllis e zvarritet këmbadoras në Facebook. Ëndrra të karrierës së tij të sëmurë politike sheh në mes të Ditës Madhe. Përpak, desh plasi deri sa doli t'u pri protestave politike, dje me petk fetar i fshehur në dimi të grave, sot në ballë si Don Kishoti i Mançes të veshura me "flamurin kombëtar

kuqezi" për ta kthyer përmes rrugës një parti Neokomuniste "demokratike" në pushtet. "Fakiri" me nënshtetësi maqedonase i lagjes "problematike" pa nënshtetësi si lagje e "egër" në Shkup, që mbi pesëdhjetë vite lindin e vdesin në këtë shtet, dhe ende nuk e di dudumi i Dexhallit se, është me mijëra kilometra larg me tru t'i pri popullit shqiptar për liri me këmbët dhe trutë në legen. Vdiq pas pushtetit të argatit, e nuk e mori në dorë deri më sot asnjë parti politike shqiptare. Përmëkeq, i futën nga një shqelm të mirë bythëve duke e përzënë në xhami me këmbët dhe trutë në legen. "Vëllezërit" e Njerkës e marrin "revolucionarin" e vonuar, por jo në rolin e komitit, por të këlyshit me zgjebe me bishtin ndër këmbë të lehi pas porte.

Nastradin Hoxha, kur kanë dashur ta varin e ka lënë një porosi: I drejti më në fund shpëton, por i laget bytha. E ka fjalën për litarin, që i këputet nga dega dhe bie në ujë. Edhe, të akuzuarit e "Monstrës" do të shpëtojnë nga burgu, por u është lagur bytha. Përpak, falë këtyre kalorësve të arratisur, bytha t'i laget edhe popullit shqiptar.

"Revolucionarët" e vonuar, të cilët sot i dalin zot me protesta "paqësore" popullit shqiptar dhe thirren plot gojën në Rininë shqiptare, qëllimin e kanë për përfitime personale, familjare, klanore e partikake. Kurrë, këtyre viktimave të

pafajshme nuk mund t'ua hapin derën e burgut, nxjerrin në liri. Fatkeqësisht, ato edhe punojnë për moszbardhjen e rastit "Monstra". Dyshimi lind, mos edhe këto i kanë shti duart në këtë "qull" politik?! Aqmëpak, popullit shqiptar t'i sjellin ndryshime politike. Arsye: Dudumët, momentalisht, shfrutëzojnë përçarjen e partive politike dhe popullit shqiptar për të ardhur te qëllimi "patriotik": rrëmbimi i pushtetit me dhunë, e nuk e kanë "gajlen" e popullit. Hë për hë, ujë dërgojnë në mullirin e armikut duke i dalldisur shqiptarët t'i fusin mes dy gurëve të mullirit, bluajnë krunde. Edhe atë, në Ditën historike, kur populli shqiptar për Liri më nuk e përdorë pushkën, por penën dhe votën e lirë si armë demokratike për t'i realizuar qëllimet e tij Rilindase.

Përsëri, do të kthehem tek një anekdotë e Nastradin Hoxhës. Plaku kthehej nga pazari me një jorgan të blerë në duar për në shtëpi. Rrugës i sheh disa të rinj sesi rrihen mes veti me grushta. E len jorganin anësh dhe u hy në mes që t'i ndajë trimat e kacafytur si gjelat majë plehit. Njëri nga ato, shkëputet dhe ia vjedhë jorganin. Burri i botës, pasi i ndau "belaxhinjtë", u kthye ta marrë jorganin. Përçudi, jorganin sikur e kishte përbi toka. Plakut të mençur, tek tashti iu kujtua, belbëzoi plot inatë nëpër dhëmbë: e gjithë puna

paska qenë për jorganin tim sesi të ma vjedhin hajdutët.

Edhe protestat e sotshme "paqësore", gjoja për rastin "Monstra" dhe liri e të drejta të barabarta kombëtare për shqiptarët, i përngjajnë jorganit të Nastradin Hoxhës. Hajdutët e djeshëm, sot partizanë të shitur këmbekokë të partive politike, nuk e kanë gajlen e të burgosurve politik e as të popullit shqiptar, por të vetin, sesi të krijojnë huti dhe mjegull mes popullit shqiptar për të rrëmbyer ndojnë "jorgan" politik nga selitë e partive politike. Kokën duke e mbuluar me të në polici, por u ka mbetur jashtë bytha, truri dhe këmbët në legen. Që, vërtetë e kanë vështirë në Ditën e sotshme ta mashtrojnë një popull historik që është rritur me anekedotat e Nastradin Hoxhës dhe Xha Derallës, rrëzë Çukës.

Populli shqiptar, sot për sot është mbi nivelin e partive politike. Larg i sheh shpëtimtarët e Ditës së Nesërme: Burrat e pushkës dhe penës, që zbresin nga malet me kuaj të bardhë në Shkup. Vështirë e kanë këto hajdutë të "soçëm me tru të moçëm" e këmbët dhe trutë në legen, ta provokojnë, nxjerrin në rrugë me protesta "paqësore" pa organizatorë e "Pranvera arabe" nën sjetulla për "ndryshime" politike.

Dhe, pranë rrugës si hajdutë, tinëz t'ia vjedhin "jorganin" me pupëla…

KRISMA PARTIAKE ME PLUMBA QORR

Përderisa, shqiptarët do të bëjnë arsim, kulturë dhe do të shpallin qytetarë nderi nëpër lagje të Shkupit e katunde, nuk ka kërcim gardhi matanë livadheve. Faji është mbarëshqiptar, e shumë pak i artistëve pa sherr e të lënur pas dore nga shoqëria dhe Shteti i "përbashkët" maqedonas. Historikisht, politika ditore ka manipuluar me këtë shtresë të pambrojtur të artistëve shqiptar. Partizanët e partive politike, i kanë manipuluar dje, i manipulojnë sot, do t'i manipulojnë edhe nesër krijuesit si "viktima artistike" të pakrah rrugës tyre qiellore. Në emër të tyre organizojnë Akademi përkujtimore, çmime letrare shtetërore, "vera kulturore" e shpallin qytetar nderi nëpër katunde e lagje të Qytetit. Përbaltin për çdo vjet arsimin dhe kulturën shqiptare edhe më zi se ish Partia Komuniste. Partizanët e tyre gjysëmanalfabetë, që nuk kanë haber nga arsimi dhe kultura, nuk bëjnë arsim dhe aktivitete kulturore, por zhurma kulturore për t'u dukur para kamerave televizive, sa herë që partia e tyre vjen në pushtet. Nxjerrin gazeta e "revista kulturore" duke u përpjekur t'i shuajnë ato tradicionale (Stili 97), që për kohën kanë sjellë një zë të ri në Letërsinë Shqiptare. Manifestimet

tradicionale kulturore ndërkombëtare i marrin nëpër këmbë, gjoja se edhe ato dinë dhe janë të aftë të organizojnë manifestime kultuore, bindin Nënën Parti me "dasma kulturore" të improvizuara familjare. Poetë anonim, që nuk i njeh as nëna e tyre e ku më katundi, i shëtisin rrugëve dhe nëpër varre si "Nova Godina" (Viti Ri), vajzën e saj të vogël nëpër Qytet gjithë ditën e gjithë natën përdore.

Gjithë kjo zhurmë kulturore, zgjatë për aqsa është partia e tyre në pushtet. Vetëm Mbrëmjet e Poezisë Strugane kanë jetë të gjatë në këtë shtet të "përbashkët", pa marrë parasysh se cila parti politike maqedonase vjen në pushtet. Aspak, nuk e vrasin mendjen se, shqiptarët me forcat e veta manifestimet kulturore tradicionale i kanë mbajtur dhe i mbajnë gjallë plotë vështirësi me vite, që nga koha e egër komuniste. Trurin dhe pasurinë e kanë vënë në shërbim të arsimit dhe kulturës shqiptare. Qesharake është, në Ditën e sotshme me shqiptarët, zhurmë bëjnë edhe për Mbrëmjet e Poezisë Strugane (2014). Manifestim Kulturor Tradicional Ndërkombëtar, që falë edhe shqiptarëve këtë vit shënon 53 vjetorin e mbijetesës artistike. Mbrëmje të Poezisë Strugane, në të cilat: kurrë, deri më sot nuk ka qenë i ftuar dhe s'ka shkelur këmba e Ismail Kadares. Patjetër, kësaj radhe, kur manifestimin kulturor do ta bojkojtojë Komuna e Strugës, do të

gjëndet ndonjë poet anonim të cilin vështirë e njeh nëna e tij, e ku më katundi nga Shqipëria, Kosova, ose IRJ e Maqedonisë, i cili do ta prezentojë në "nivelin e arrirë artistik" mbi urë edhe poezinë mbarëkombëtare shqiptare. Njollosin vargun shqip të Naim Frashërit me shokë, Gjergj Fishtës, Lasgush Poradecit, Frederik Reshpjes, Dritëro Agollit, Teki Dërvishit, Azem Shkrelit, Rrahman Dedajt, Ali Podrimes, Sadudin Gjurës, Mehmedali Hoxhës, Abdylazis Islamit, e Murat Isakut. Manifestim Kulutror Ndërkombëtar, në të cilin Partia politike shqiptare në pushtet ka pasur të emëruar edhe Drejtor shqiptar të manifestimimit, por kurrë deri më sot gjuhën shqipe nuk e ka nxjerrë në dritë si gjuhë të barabartë në Shtetin e "pëbashkët". Punë tjetër është ajo se, gjuha shqipe në këtë qytet të poezisë me shumicë shqiptare, nëpërkëmbet vite me radhë nga organizatorët, gati një gjysëm shekulli e përçudi, shqiptarëve sot u ka dalë gjumi?! Manifestim kulturor, që sivjet e bojkoton edhe Kryetari i Komunës Strugës, z. Zijadin Sela, por nuk e bojkotojnë "poetët" shqiptar. Hap historik, të cilin duhet ta bëjnë krijuesit shqiptar anembanë Atdheut. E pamundur, më përgjigjesh ti si shqiptar mes këtyre rreshtave: kur, "akademikë" shqiptar e poetë oborri i ke gati për çdo vjet në këtë "manifestim kulturor" me fjetje, darka e honorare marramendëse. Miljona euro

derdhen për këtë "manifestim kulturor" edhe nga djersa e shqiptarëve, kur në Shtetin e "përbashkët" shqiptarëve për një manifestim të këtij niveli kulturor ndërkombëtar nga Ministria e Kulturës në IRJ të Maqedonisë, u mbyllet goja me një "ndihmë sociale" prej 70.000,oo den. (rreth një mijë euro).

Imzot, kujt i them dhe i çaj dërrasa në Ditën e sotshme, kur zjarr na digjet mbi krye si shqiptarë: Cungut të shelgut në livadh. Dru, të cilit më lehtë e ke t'ia vësh zjarrin, sesa sëpatën ta gëdhendësh tra shtëpie, mbajë mbi shpinë nëpër shekuj çatinë me tjegulla e baxhë dhe oxhakë që e përcjellin tymin drejtë qiellit, matanë mjegullave. Pykës së tij sakate të shelgut, që më shumë e ka për t'u dukur dhe bërë zhurmë politike e kluturore, për përfitime personale, familjare e klanore, sesa për ta çarë cungun me nyje në mes të Lëmës. Prirje ka për t'i ngulfatur Manifestimet Kulturore Tradicionale Shqiptare me themelimin e atyre "nëpër ferra" të dasmave politike, sot për nesër" e të veshura me petka njëpartiake. E, sidomos kur nuk arrijnë t'i fusin dot në dorë këto Manifestime Kulturore Tradicionale nën kthetrat e tyre "ushtarake" partiake. Rast konkret, psh: "Flaka e Janarit". Manifestim Tradicional Kulturor, të cilin dikur mezi e themeluam me shokë para syve të policisë letrare, sot e kanë uzurpuar e politizuar deri në palcë partizanët e

partive politike. Organizatorët nderojnë me mirënjohje e çmime letrare edhe djemtë e komunistëve, por kurrë nuk u teket të ndajnë ndonjë çmim letrar për krijuesit që i kanë kaluar kufinjt e Atdheut. Risi kulturore sjellin si organizatorë, herë pas here edhe rrufjanët i stolisin me këto çmime letrare. Pavetëdije, e kanë banalizuar e nëpërkëmbur këtë manifestim kulturor historik duke themeluar gati në çdo qytet nga një "Flakë Janari". Nateditë i shpërndajnë mirënjohje e çmime letrare të hurit e litarit. Partizanëve të partive politike, familjarëve dhe klaneve të tyre që vijnë pasmesnate në shprehje, pse jo edhe t'i "zbulojnë" këto dudukë të artit dhe stolisin edhe me kurora artistike. Punemadhe, që jeta e tyre ka jetë "patriotike - artistike", aqsa është në pushtet partia e tyre politike, ose kryetari i komunës shqiptare nga radhët e tyre partiake. Interesant është, kohën e fundit: gati të gjitha komunat shqiptare merren me organizimin e "Javëve e Verave kulturore", e pak vlera të arrira nxjerrin në dritë, sipërfaqe. Nateditë u kënaqën me koncerte muzikore, përurime të librave, "Tinguj Çarshie" e fishekzjarre nëpër rrugë e livadhe me bërllokun deri në fyt para dere. Përmëkeq, këto "Javë e Vera kulturore", zgjasin aqsa zgjatë jeta politike e Nënës Parti në pushtet argati, ose Kryetarit të Komunës shqiptare.

Nesër, vjen Tata e Madhe. Nëna tjetër e stolisur me lulelale e duvak në kokë. Cucat dajren e bëjnë copë-copë në Lëmë. Gratë brez për brezi hyjnë në valle me këngë: *Nusja jonë me limona,/ a ma mirë te na a te Nona*. Babai, hudhë struken krahëve në mes të oborrit, e nxjerrë mauzerrin nga hatullat. I biri alltinë nga brezi. Lodraxhiu çmendet në dy gjunj mes Lëmës e këndon alltia. Fisheku i zbrazur kushton sa një libër. Merreni me mend, sa fishekë harxhohen në një dasëm familjare, kur i zoti i dasmës nuk e ka as edhe një libër për farë në shtëpi, së paku një libër këndimi për fëmijët. Eurot e dollarët fluturojnë mbi kokat e këngëtareve si fluturat mbi livadhe. Partizanët e Nënës Parti, kur i shohin kaq të përmalluar për Atdhe (Mëmëdhe), ndizen zjarr, i përveshin duart deri në bërryla t'u ngrisin përmendore "dëshmorëve" të Nënës Parti, në Katund. I vizitojnë partizanët partiak dhe familjarët e tyre me kurora të luleve duke u fotografuar krah për krahu para kamerave televizive. Fjalime maratonike e lotë krokodili duke derdhur mbi varre. Gojën plot demagogji, pothuajse shqiptarët vetëm në kohën e tyre "çlirimtare", kanë dhënë dëshmorë e heronj lufte. Historia shqiptare, fillon dhe mbaron me këta kalorës të arratisur. O Imzot, po ku të lë ty ore Skenderbeu, Bajram Curri, Ismail Qemali, Shotë Galica e Kalosh Zajazi me kaçakë ta bësh Histrinë Shqiptare

livadh me ferra?! Naimi me Rilindasët shqiptar. Fishta me Lahutën e malëcisë e Mrizin e Zanave.

Shekuj më parë, shqiptarët sipas tyre kanë qenë të vdekur, nuk e kanë bërë asnjë luftë historike?! Fjalën, tashti do t'ua japin atyre "akademikëve" e dudumëve, që për sa kanë qenë gjallë artistët, jo vetëm që nuk i kanë përkrahur si krijuesë shqiptar, por edhe i kanë përndjekur me rrufjanët e tyre këmba – këmbës duke i luftuar si të "rrezikshëm" për Shtetin e "përbashkët" dhe Zotin e Madh, që ende nuk e mësoi Gjuhën Shqipe.

Interasant, përndjekësit e djeshëm, sot i dalin zot edhe artistit të "vllazërim - bashkimit" dhe piktorit me famë botërore, Omer Kaleshit. Përmëtepër, e shpallin publikisht pa fije turpi para mjeteve të informacionit se, babën e ka pasur shqiptar e nënën "maqedonase" nga Sopi, afër Kërçovës. Fshat, i djegur dhe zhdukur sot me themele nga forcat shoveniste serbe. Cuca e vogël asaj kohe, mezi shpëton gjallë me dy-tre bashkëfshatarë dhe e merr në mbrojtje si viktimë lufte, e më vonë si grua hoxha i Katundit, babai i Piktorit. Fare, "burrat e kombit" nuk merren me vlerat artistike të Piktorit, por me përkatsinë nacionale e fetare të nënës tij dhe babait.

Mosdija, apo individë partiak për karrierë politike, edhe sot si dje bredhin dhe manipulojnë me personalitete shqiptare. Nëse, është dashur dikushi të flasë për nivelin e këtij kalibri të piktorit me famë botërore, ai ka qenë Ismail Kadare edhe si mik i Piktorit. Dihet, rruga e tij artistike nga Tirana deri në Shkup kushton si personalitet i letrave shqipe me famë botërore dhe kandidat për Çmimin Nobël. E jo, Luan Starova si ambasador i ish Jugosllavisë socialiste që në këto trumbetime njëpartiake kulturore të politizuara deri në palcë, vjen për rehabilitimin e vetes edhe pa pare. Ngushëllime "në pamje" shqiptarëve, që sot më së paku ka nevojë populli i përndjekur shqiptar me shekuj. Që, ma merr

mendja se, në atë kohë si ambasador jugosllav dhe shkrimtar maqedonas nuk ka pi as edhe një kafe me Piktorin shqiptar, në Paris.

Shpallja e piktorit si Qytetar nderi i një lagjeje të Çairit, vetëm ia ka ulur nderin dhe famën një piktori të madh shqiptar, i cili mezi e fitoi nëpër botë dhe ia nëpërkëmbi vendlindja. Faji, nuk është i Piktorit, por i këtyre partizanëve të dalldisur pas karrierës politike, që për ta shpëtuar veten nga hurdha e Lumit të Zajazit, manipulojnë personalitetet kombëtare për një post politik. Mendja i rren se, do të dalin mbi sipërfaqe të ujit me pak shpirt si "shpëtimtarë" të arsimit dhe kulturës shqiptare. Djersën e popullit shqiptar do ta harxhojnë për biznese private: shtëpi, banesa familjare, makina luksoze e libreza kursimi nëpër bankat e vendit dhe atyre botërore. Padashtas, ma përkujtojnë atë anekdotën popullore shqiptare: Burri dhe gruaja, ditën e shtunë kur shkojnë në Pazar. Rrugës, mes fushës e shohin një arë të kositur me dertelinë (jonxhë). Gruaja i thotë burrit: Sa bukur e paskan kositur gratë me gërshërë jonxhën! Jo, i përgjigjet burri. E kanë kositur burrat me kosë. Budallai, ia pret gruaja plumb: unë them e kanë kositur gratë me gërshërë, e ky mjerani burrat me kosë?!

Zënka vazhdon rrugës për në pazar mes gruas dhe burrit: jo e kanë kositur me gërshërë gratë - gruaja, jo me kosë burrat - burri.

Mosmarrëveshja arrin deri te ura e lumit në hyrje të qytetit. Burri, dikur nervozohet dhe ia ngrenë këmbët në "hava" gruas, bythekrye nga ura e hudhë në mes dallgëve të lumit. Përsëri, gruaja duke u fundosur mes valëve të rrëmbyeshme me dy gishtat e dorës lartë mbi ujë imiton gërshërët, ngulë këmbë se: Arën e kanë kositur gratë me gërshërë.

Burrit, dikur i dhimbëset xhadia, delë disa metra mbi urë dhe e pretë të dalë në sipërfaqe. Kalimtarët e rastit e shohin dhe e pyesin: çka bënë, o burrë në breg të lumit? Përgjigjet burri: e fluka gruan nga ura dhe e pres të dalë mbi ujë. Mirë bre burrë, i thotë një kalimtar rasti, po ti e hudhe nga ura në ujë dhe e pret të dalë në anën e kundërt të rrjedhës së lumit?! Lumi ecën teposhtë për në qytet, e nuk shkon përpjetë shtratit?! Eheheee, i përgjigjet burri: Nuk e di ti çfarë xhindihallje ishte ajo xhadi, ti e hudhë nga ura në ujë ta bartin me vete dallgët, e ajo delë në rrjedhën e kundërt të lumit. Ngjarja, gati e njëjtë si mospajtimi im në shkrimet publicistike me Hoxhën e Allahut.

Gabimi më i madh tragjik, ende nuk është berë me Omer Kaleshin. Komuna e Çairit ditë më parë e shpalli qytetar nderi të Çairit. Javë, muaj ose vite me radhë do t'ia themelojë edhe një Galeri Artistike Kombëtare në emër të Piktorit, në Bit- Pazar. Përgëzime, ideatorëve! Kërçova, edhe

ajo do t'ia themelojë një Shtëpi - Galeri Piktorit me famë botërore në vendlindje. Problemi është se, ende nuk mund të merren vesh partizanët e Nënës Parti, a do t'ia ngulin themelet kësaj shtëpie artistike në Zajaz te "Nëna Shqiptare", apo te një odë e Shtëpisë së Kulturës, në Kërçovë.

Edhe atë, në Ditën e sotshme: kur shtegdaljen, shqiptarët e kanë para dere. Punë tjetër është ajo se, a e shohin Portën e Madhe të hapur krah më krah, apo jo në mes të Kërçovës: ish Shtabin ushtarak me ndërtesa moderne e pishinë turistike, në mes të Qytetit. Garnizonin e dikurshëm ushtarak, që me tërheqjen e Ushtrisë jugosllave në këtë kohë ka mbetur i shkretë e pa zot, në mëshirën e krimbit të kohës. Ditë historike, kur shqiptarët nuk kanë shtëpi kulture, institucione kulturore, bibliotekë moderne e as seli të shoqateve kulturore - artistike me çati të përhershme mbi kokë. Hera e dytë gjatë një shekulli, që Kërçova e ka Kryetarin e Komunës shqiptar. Momenti është, t'i lënë anësh dalldisjet e "verave kulturore", por t'i përveshin duart deri në bërryla dhe t'i futen punës. Pasurinë e patundshme, që na e la si trashëgim sistemi komunist, sot ta përvetsojnë për vete dhe strehojnë shoqatat kulturore - artistike nën çati.

Problemi artistik: partizanët e partive politike nuk i kanë këto rrugëdalje të kaçakëve të malit nga oxhaku, baxha mbi çati, ose

"kapixhiku" pas Shtëpie, po si ta grabisin djersën e popullit shqiptar. Fundekrye janë kaçakë fushe me një mauzerr përqafe pa fishekë. Ditëve të verës me partizanët e tyre të na organizojnë edhe "kënaqin" popullin me: "Vera kulturore", fundekrye të veshura me petka njëpartiake e fishekzjarre. Shpenzime të panevojshme, para me të cilat do t'i sigurinin daljen e revistave për fëmijë në dritë, lektyrat dhe tekstet shkollore të fëmijëve të tyre këmbëzbathur, të cilët pritet edhe këtë shtator ta shkelin pragun e shkollës me çantat e zbrazura pa libra mbi bangë.

Amani, së paku e leni rehat sot arsimin dhe kulturën shqiptare! Gati një shekull e nëpërkëmbi Partia Komuniste, tashti edhe ju duhet t'ia jepni hakun?! Në vend t'i bini me thupër samarit, i bini gomarit. Krismat partiake me plumba qorr, sot janë larg majave malore me borë, nën nivelin artistik të "kohës artë" të Partisë Komuniste. Sharri plak, është larg. Baba Tomorri i Çajupit, edhe më larg.

Dhe, kurrë me këto mendë në kokë, nuk do të na nxirrni si popull shqiptar matanë gardhit politik. Livadhin me lule duke e rrethuar përditë me thupra shelgu…

POPULLI NË BREZ ME "DY ALLTIA" LODRËS I BIEN PARTIA

Historikisht, shqiptarët problemin më të madh e kanë pasur me veten si popull. E kanë edhe sot këmbëkryq te pragu i derës. Brez pas brezi i kanë dalldisur armiqtë, siç thotë populli para "pampurrit": trima që e rrokin për fyti topin e Mic Sokolit, shkaun e vrasin me çifteli dhe e kanë derdhur gjakun deri në gju për Liri Grykës së Kaçanikut, sa që është mbytur edhe kali me gjithë shalë. Armikut i kanë dalur ballë për ballë edhe në Londër me dy kobure në brez. E kam fjalën për Isë Boletinin, e jo për misionarët e sotshëm fetar me këmbët dhe trutë në legen, që bien "shehitë" në Siri. "Kurbanë" therin me thika para syve të botës si kasapë Ballkani.

Përçudi, ky popull kaq trim me Shqipërinë Etnike në gojë, si nuk bëri ende një Shtet shqiptar, copë – copë i ndarë me kufinj politik?! Shtet, për të cilin me shekuj është duke ia vënë flakën Ballkanit. Ose, siç thotë tek ajo kënga popullore: për çdo vjet e nisim nga një luftë. Herë me Krajl e herë me Mbret. Dhe, kurrë vetes nuk ia këputi prangat e robërisë. Fatkeqësisht, popull që ka mbetur edhe sot e kësaj dite nën nivelin e Rilindasëve shqiptar. Ende, që nuk ia shohim

tymin zjarrit të tyre në oxhak mbi çati, e këndej në kokërr të shpinës e presim flakën në qiell mes reve.

Dalldisja e tyre "patriotike" vazhdon edhe në Ditën e sotshme. Vetëmse, i kanë ndërruar armët e luftës heroike. Përderisa dje, e kishin penën dhe pushkën, sot e kanë rrokur lodrën dhe cinganën nëpër dasmat shqiptare. Çiftelinë, e kanë varur në mure të "Odave shqipatre", ose e kanë hudhur në tavan si instrument "haram". Vallen e heqin krah për krahu me shokë. Alltia e pushka, nateditë na këndon nëpër kulla. Copë – copë gratë i bënë dajret. Vallen për inatë të burrave e heqin brez për brezi edhe me lodra. Shaminë duke hedhur lartë mbi kokë e pas shpine. Dollarët e eurot edhe këtë verë si gjithmonë përfundojnë në ballin e gojën e lodraxhinjve. Cingana piskat, në dy gjunj e herë në kokërr të shpinës me eurot e dollarët në ballë. Dhëndri me tirqi e xhamadan, me "nagantin" në brez, hyn në valle si burrat. Babai e nxjerrë mauzerrin nga hatullat. Katundit ia bënë me dije, se: më në fund erdhi Nusja e maleve me koçi. Fundekrye e veshur me ari e franga përqafe si në kohën e Turqisë. Nuse, që këtë verë të zbresë nga malet na kushtoi, hiç më pak: rreth pesdhejtë mijë uro. Familjarëve që presin në rend, përcjellur me këngë ua jep nga një copë ëmbëlsirë nga tepsia.

Cucave, po t'u teket përmes këngës me dajre t'i japin edhe dy - tri copa të tjera në gojë.

Viçat herët pa lind dielli rrotullohen në hell mes livadhit. Pronari i dasmës ka vendosur t'i bëjë dy dasma: një në katund e një në restorant. Dasma e katundit do të mbahet mend sipas traditës shqiptare. E, ajo e restorantit si dasëm e ndryshimeve shoqërore: me këngëtarë e muzikë tallava, që kushton mbi njëzetëmijë euro. Çmim letrar, që shumë poetë të mirënjohur shqiptar anembanë Atdhuet, nuk do ta shohin as në ëndërr. E di, ju do të thoni: kush u ka faj, pse edhe ato nuk u bënë këngëtarë dasmash, por poetë. Vërtetë, këtu keni të drejtë si partizanë të partive politike në pushtet. Dasma, patjetër, duhet t'i ketë mbi pesqind dasmorë. Nata duhet kaluar me këngë e valle. Këngëtarët me ato vargjet e "zjarrtë", "sonte do ta kallim flakë shtëpinë": plot llokuma, sheqera, tollumba e gurrabia. "Halla e Madhe" ka hyrë në valle. Cucat copë-copë e bëjnë dajren. Konkurencë e madhe u bëhet "javëve kulturore", që i organizojnë komunat shqiptare për kurbetçarët, mes tyre edhe me ndonjë aktivitet islam me ilahi sa për ilustrim për sy e faqe të zezë si "myslimanë" shqiptar. Punemadhe, që nuk kanë me shtëpi asnjë institucion klturor, bibliotekë me libra. Larg qoftë, në këtë kohë të mendojnë për tekste shkollore, lektyra shkollore, revista për fëmijë.

"Artistët e popullit" e presin verën tjetër edhe më të nxehtë "kulturore", shkaku se këtë verë nëpër këto sofra "kulturore" partiake janë ulur këmbëkryq partizanët e Nënës Parti. Vështirë e kanë artistët e "opozitës" të afrohen, ulen krah për krahu në ndonjë shkam me tri këmbë. Rrënjët i kanë shti në vendlindje, po degët i kanë lëshur nëpër qytetet tjerë për "javët kulturore". Manifestimet tradicionale kulturore i kanë rrokur për fyti partizanët e partive politike, tashti nuk bëjnë manifestime poetike institucionet kulturore, por argatët e tyre në Ministritë e Kulturës. Partitë politike i kemi "revolucionare" e organizatore, perveçse me politikë "madhore", ato merren edhe me kulturë mbarëkombëtare shqiptare. Populli e heq vallen me "dy alltia" në brez: "flakë le të kallet sonte shtëpia". Lodrës, me tupan i bie Partia.

Armikun e vranë dhe e mbytën edhe këtë verë nëpër koncerte partiake, klanore, miqësore dhe familjare. Nuk e di, a ka mbetur gjallë edhe ndonjë "armik" i popullit shqiptar. Mezi i presin kurbetçarët, që të bëjnë "javë kulturore", krah për krahu me dasmat familjare. Në një thesë ta shtinë kulturën shqiptare me "aktivitete kulturore" Islame. Poezinë e bëjnë lëmsh me ilahinë. O Imzot, sa bukur e qajnë nëpër vera kulturore! Partizanë të partive politike, që kitarën e kanë varë në mur si "haram", dhe u janë përveshur

verave kulturore shqiptare me ilahi si "shpëtim" nga armiku shekullor. Plan - programe kulturore, përpilojnë sipas arshinit të turkut. Historinë shqiptare duhet ta rishikojnë, përsëri ta marrin nëpër duar "historianët", patjetër duhet ta zhveshin nga "falsifikimet". Artistët shqiptarë i ndajnë në "myslimanë" dhe shkje. Anësh, lënë emra të mirënjohur të kulturës shqiptare. Legjendat e letërsisë dhe muzikës shqiptare, vështirë i shtinë në program "artistët" e dasmave shqiptare me të cilët bëjnë pazare kulturore.

Edhe, po t'u hedhësh një sy vlerave të tyre kulturore, janë nën nivelin e dasmave shqiptare. Dallimi është, dasmat shqiptare i bënë i zoti i shtëpisë me paratë e veta, ndërsa verat kulturore nën ombrellën e kryetarëve të komunave me paratë e popullit shqiptar. I hurit e i litarit bën programin e "Javës kulturore". Përmëtepër, kur komuna ka përgjegjës të kulturës, i cili merr edhe rrogë për këtë punë. Partizanët e partive politike, që gjithë vitin turren komunë më komunë për të bërë "Javë kulturore", si ajo grerëza që shkon lule më lule të pjellë mjaltë, futet dhe organizon vera kultutore aty pas shtëpie, ku nuk e ka vendin. Verë për verë po na shurdhojnë me zhurma kulturore, e shumë pak me vlera të arrira artistike të këtyre trevave shqiptare, që deri dje i mbante nën këmbë turku e serbi, sot me të dyja këmbët i shkelë partizani partiak shqiptar për përfitime

materiale, interesa personale e familjare. Krye më vete fut "artistë" nga të katër anët e botës, e i lë anësh artistët e dëshmuar të vendlindjes. Talentët, që janë mbi nivelin e këtyre "dasmave" të katundeve dhe mezi presin t'i shohin në skenë mërgimtarët.

Verë kultuore të bësh sot, e të mos kesh asgjë nga vlerat e arrira artistike dhe tradita shqiptare e këtyre qyteteve, për mua është të heqësh valle si Arusha me dajre nëpër katundet e "Vilajetit". Maxhupi t'i bie dajres për pak lekë ose një torbë drith, e Arusha përdore e heq vallen për fëmijë me pak para në Katund. Artistët më të mirë të vendlindjes t'i lësh jashtë "Javës kulturore", e këndej t'i përkrahësh matrapazët e kulturës myslimane, që nuk kanë asgjë të përbashkët me kulturën shqiptare, për mua organizatorët i meritojnë shtatë lapsa (plumba) në lule të ballit. Vërtetë, është vetëvrasje e paralajmërur t'ia bësh para syve një populli historik. Padashtas, ma kujtojnë një thënje antologjike të humoristit dhe satiristit Niko Nikolla: Nuk ka popull shqiptar, por ka popull shkrimtar.

Përfundimi: "Artistët e popullit", gati të gjithë në numër për çdo vjet si delet kokë më kokë i ke në vathë, nderohen me nga një "Mirënjohje" nga kryetarët e komunave, përfaqsuesit e Ministrive të Kulturës. Çmim

"kulturor" për të cilin, sot për sot kanë më së paku nevojë. Çmim, të cilin ndonjëri e ka "harruar" edhe në hotel. Shkaku se, nuk ka nevojë për gjithë ato "salltanate" kulturore: mirënjëhje, fletore të mbështjellura me imitime të lëkurës, lapsa propagandistik të prodhuar me shumicë për fushata zgjedhore të partive politke e ndonjë pllakate "përkujtimore", kur artistin tonë sot këto partizanë kulturor e kanë lënë pa punë dhe bukën e gojës. Tekefundit, t'i japin një honorar modest për poezinë e lexuar para këmbëve të heronjëve të Atdheut, t'i mbulojë shpenzimet e rrugës. Dasma kulturore, në të cilat më nuk merr pjesë Gani Xhafolli dhe i ka vënë vetes një Çmim letrar: Njëqindmijë euro, aq kushton një poezi e imja e lexuar nëpër këto "dasma kulturore" të shqiptarëve, thotë plot ironi Gani Xhafolli. E, puthjet e peoteshave pjesmarrëse në faqe nëpër këto "dasma kulturore" t'ia bëjnë Gani Xhafollit, e pyesim ne me kurreshtje. Qeshet, poeti: kushtojnë shumë më pak, pesëdhjetë mijë euro.

Përjashtim bënë këtu, regjisori i mirënjohur i filmit shqiptar "*Njeriu prej dheut*" – Fadil Hysaj, i cili ishte tërhequr në një katund të braktisur malor Kukaj të Kosovës, dhe atje ishte vendosur me Shtëpi. "Larg rrëmujës dhe rrëmetit", siç thotë Fan Noli. Katundin e braktisur nga shqiptarët, e kishte ringjallur me frymën e traditës dhe kulturës shqiptare plot vepra artistike.

Shtëpiza të thurura me gardhiçe, rrota të qerreve, sofra, puti e oxhak katundi. Strehim për artistët që kërkojnë "azil politik" mes maleve. I mungonte vetëm rruga e asfaltuar plotë këthesa të rrezikshme, të cilën e ka për obligim në mënyrë solemne ta hapë dhe përurojë në të ardhmen gjatë fushatës zgjedhore Qeveria e Kosovës. Përndryshe, po të mos ishte K. Cufa me dy - tri "melaqe" si përforcim t'i "ndihmojë" shoferit në errësirë, kësaj radhe të gjithë do të përfundonim në greminë. Nesër, me siguri do të na shpallnin dëshmorë të poezisë. Amani, kush do t'i duronte edhe gjithë ato poezi patetike pa shpirt e gjak përkushtuar ne kaçakëve të poezisë. Dorën në zemër, nata e fundit shqiptare në këtë fshat kulturor, që posa i kishte shti rrënjët e mbuloi maltertimin e një nate të gjatë me "përshëndetje e urime" të njëqind krijuesve nga Mërgata dhe Diaspora Shqiptare e Atdheu me poezi patetike: që nga ministrat, përfaqsuesit e tyre me gjithë shoferë e deri te dëshmorët e kombit që preheshin në vendlindje. Fati ynë, që ato heronj nuk u zgjuan nga varret, se po t'i hapnin sytë atë natë poetike, shumë poetë patetik me nga një plumb në ballë do të na vrisnin para këmbëve të tyre si derra të kulturës shqiptare, që ua prishim qetësinë edhe mes varreve.

Dalje nga kjo dalldisje "kulturore": shqiptarët, koha është më të mos shkojnë pas

partizanëve të fushës, por pas ujqërve të malit. "Artistët" e këtij soji, që turren me të katra për përfitime materiale klanore, familjare e partike me një shqelm bythëve duhet'i përzëmë nga kultura shqiptare. Larg, shumë larg t'i shohim profetët e Ditës Nesërme. Arsimi dhe kultura janë themelet e një shqoqërie demokratike, Shteti shqiptar. Artistët duhet t'i prinë këtij populli në ballë. Askushi nuk mund t'i pri kulturës shqiptare në Ditën e sotshme nëpër beteja të përgjakshme për Liri, po zemra e truri.

Populli në brez me "dy alltia", Lodrës me tupan i bien Partia…

VII "ARMIKU" I SHTETIT DHE ZOTIT

"UNIVERSITETI" I SHQIPTARËVE

Burgu i Idrizovës se ka qenë i vetmi "Universitet" i shqiptarëve, këtë e di gati e gjithë bota. "Universiteti" me bibliotekën më të pasur në ish Jugosllavi. Librat e "ndaluar" që i gjeje nëpër raftet e kësaj biblioteke, nuk mund t'i lexoje në asnjë bilbiotekë në Prishtinë e Shkup. Fatkeqësisht, që burgu është shtëpi përmirësimi e jo Universitet, e kam thënë shpeshherë nëpër shkrimet e mia publicistike, se: nga dyert e tij kanë dalë pak veta me mendtë në kokë në Liri. Shumica nga ato biruca urithi nëntokësor kanë dalë të vdekur, çmendur, homoseksualë e spiunë. Shembull konkret, Dudumi me tri – katër kësula leckë në kokë. Ndonjëri edhe piktor, shkrimtar e muzikant. Përçudi, kurrë nuk më kishte shkuar mendja se, burgu mund të nxjerrë edhe "musliman me Din e Iman".

Vitet e mëvonshme ma zbuluan edhe një profesion të "Universitetit" Idrizovës: atë, të "muslimanit me Din e Iman". Përveç artistëve dhe "deputetëve të popullit", që rrihen me grushta vëllai me vëllanë në Parlament, në vend të vriten me njëri – tjetrin me tru, ai institucion "edukativo - arsimor" kishte prodhuar edhe "muslimanë me

Din e Iman". "Artistë", që pasi të rehabilitoheshin në shoqëri, kur të vijë koha dhe nevoja për veprime guerile antishqiptare, të aktivizohen me direktiva policore. Shembull interesnat, kësaj radhe është një Dudum politik, që pas vuajtjes të dënimit doli si "patriot" shqiptar. Raste të këtilla në shoqërinë shqiptare ke me qindra. Një numër nga ato "patriotë kuqezi", pas ndryshimeve demokratike u aktivizuan edhe nëpër partitë politike shqiptare. Ndonjëri, më "i zgjuari" arriti edhe në postet më të larta politike qeveritare deri te kryetari i partisë "nacionaliste" shqiptare: zv/ krymenistri, ministri, deputeti e drejtori. Shkak kryesor ky, që edhe sot e kësaj dite nuk mund të ngrejmë krye si popull shqiptar.

Shoqëria shqiptare "patriotin" e këtij soji e priti krah – hapur, dhe ia hapi të gjitha dyert në vendlindje. "Artisti" me diplomë "universitare" të burgut, themeloi edhe një grup muzikor "Banda shqiptare". Vërtetë, për nga fama nuk i kaloi kufinjt e vendlindjes, ama e mbante veten gjallë me muzikë patetike. Tekste shkruante e kompozonte muzikë shqiptare "patriotike". Vite më vonë shkruante dhe kompozonte edhe tekste për fëmijë. Herë pas here për këto tekste me "vlera të arrira artistike", merrte edhe shpërblime.

Ferexheja e zezë, papritmas një ditë do t'i bie në fund të këmbëve, kur ai me shokë një Teatër amator shqiptar, që mezi do ta themelojmë

dhe pagëzojmë me emrin e humoristit dhe satiristit të madh kërçovar Xha Deralla, tinëz do t'i sulet pas shpine. Ende, pa e vënë në skenë premierën e parë, ai do të aktivozohet nga "Qendra policore", që Teatrit të parë shqiptar t'i ndërrohet emri. Edhe do t'ia arrijë qëllimit: Teatrit të parë në Kërçovë, sa çelë e mëshelë sytë i ndërrohet emri brenda një nate. Fatkeqësia, që ky emërim i ri: "Uskana" si institucion amator kulturor, me emrin e një garnizoni ushtarak romak, nuk solli edhe sot e kësaj dite asgjë në dritë në Dramën shqiptare.

Vite më vonë "i burgosuri politik", Miken më të mirë (kitarën), që e kishte pasur në qeli me vite, do ta vari në murin e dhomës ditës si "haram" dhe shpallë pjellë Shejtani. Heqë dorë edhe nga muzika shqiptare. Brenda një nate do të bëhet edhe "musliman me Din e Iman". Pesë vakte do t'i falë në xhami para këmbëve të hoxhës. Kohë nuk do të ketë të merret me muzikë dhe tekste për fëmijë. Vërtetë, shpëtoi muzika dhe fëmijët shkollar, por jo edhe populli shqiptar mes dy zjarreve. Shkaku se, ai tashti me shokë do të vendosë për arsimin dhe fatin e kulturën shqiptare si këshillitar i komunës. Në "Verën kulturore shqiptare" do të shti në program edhe kulturën islame. Lëmsh do ta bëjë poezinë me Ilahinë. Ditët e Humorit dhe Satirës: XHA DERALLA, një Manifestim Kulturor Tradicional

Ndërkombëtar do ta përzë nga kultura shqiptare. Arsye teknefese e "muslimanit me Din e Iman": Satiristi shqiptar për së gjalli është marrë me shartimin e dardhave gorrice dhe është tallur haptas me hoxhën e Katundit, i ka lënë thesarit popullor një pasuri të patundshme me disa anekdota antologjike.

Metodë e njëjtë kjo policore, kur dikur të rinj shqiptar hidheshin matanë kufirit, në Shqipëri për spiunim. Dhjetë vite me radhë e kishin të mos veprojnë në atë vend, e pas dhjetë viteve te merren me aktivitetin "patriotik". Shumicën nga ato "patriotë" i zbuloi Shteti shqiptar dhe i rrasi përsëri në burg. Pak veta dolën gjallë nga ai burg i Burrelit.

Hamid Hamidi, një i burgosur politik që mezi arriti të dalë i gjallë nga ato burgje famëkeq, u kthye një ditë edhe në Kërçovë. Shpërblimi dihej, e punësuan si gazetar në Radio Kërçova. Plaku, këtu priste një post më të lartë shoqëror. I dëshpruar një ditë edhe vdiq në heshtje. Askushi nuk i shkruajti për të as dy - tri rreshta në gazetë.

Rrëfime interesante tregonte ai burrë për këto "patriotë kuqezi", që i kishin kryer me sukses "Universitetet" jugosllave. Edhe, për "Universitetin" e Idrizovës, në periferi të Shkupit. Institucion "edukativo – arsimor" nga i cili shumë shqiptarë dolën me "diploma universitare":

politikanë, shkenctarë, piktorë, shkrimtarë, gazetarë, mjekë, hoxhallarë…

Propozimi i MAS –it dërguar Qeverisë Shqiptare, pavarësisht prapaskenave që e shoqërojnë, ishte i domosdoshëm, edhe pse i vonuar me vite. Në shoqërinë shqiptare, në Ditën e sotshme prodhohen diploma me thasë. Universitet private, që përditë lindin si këpurdhat pas shiut, më nuk janë vatra arsimi, por fabrika për prodhimin e diplomave serike universitare të gjysëmanalfabetëve me shumicë e pakicë në tregun shqiptar anembanë Atdheut. "Kryeqendra" politike e kulturore shqiptare, Tetova heroike: sot ka profesorë universitar e doktorë me tituj shkencor me kamionë, por nuk ka barinj të deleve maleve të Sharrit Plak. Maestro të tollumbave. Imzot, mos më keq: nuk mund t'i gjejmë mjeshtërit e bozës, limunadës e akulloreve fantastike. Specialitete unikate, me të cilat dikur e pushtuam ish Jugosllavinë dhe botën qytetare.

"Kryeqendra kulturore" e dy Universiteteve, që sot i zëvëndsoi tollumbat me diploma universitare, biznesin e vet po e përhap edhe nëpër katunde. Hapi i "Rilindasit" të fundit Edi Rama, për marrjen e licencave të 17 univeriteteve në Shqipëri, është për duartrokitje. Hap të tillë kthjellimi duhet të marrë edhe Prishtina, Tetova dhe Shkupi. Shoqërisë shqiptare sot për sot, nuk i mungojnë universitet, por vlerat e arrira arsimore,

kulturore dhe shkencore. Fatkeqësi kombëtare, që sot Shqipëria nuk e ka një ministër arsimi të nivelit intelektual Ernest Koliqi, si dikur "Shqipëria e Madhe".

Universitetet private "mbinë" dhe "lulëzuan", kryesisht pas ndryshimeve "demokratike": në Tiranë, Prishtinë, Tetovë dhe Shkup. Shkollat private të arsimit, i gjen me shumicë e pakicë si fabrika komerciale në çdo qytet duke konkuruar sot padrejtësisht shkollat tradicionale shqipe dhe "Universitetin" e Idrizovës.

Hapi i parë i një shoqërie demokratike për ta kapërcyer "malin" e problemeve arsimore, kulturore e politike para dere, patjetër duhet të nisë nga arsimi dhe kultura. Vetëdija e një populli. Shkaku se, arsimi dhe kultura janë themelet e një shoqërie, Shteti demokratik. Heqja dhe pezullimi i licencave për disa universitete, kryesisht private, është guxim dhe meriton përgëzime, edhe pse hap fronte lufte mes partive politike, që i themeluan ato Universitete biznesi për interesa familjare, klanore, miqësore e partiake. Universitete, që arsimuan me diploma universitare e tituj shkencor partizanët e tyre me shkolla fillore dhe i bënë doktora shkence. Shembull intersant (për studim shkencor), Universiteti i Tetovës (1994) dhe Fakultetit Pedagogjik, në Shkup. Luftës së tyre arsimore -

politike në emër të popullit shqiptar. PPD –ja me "vëllezërit" në pushtet (LSDM -në) për ta shuar Universitetin e Tetovës, hapi Fakultetin Pedagogjik, në Shkup (1997). Veprimi politik i "foshnjes që lindi e vdekur", sipas profesorit universitar dhe Ministrit të atëhershëm të Punëve të Brendshme (L. F.), nuk dha frut politik. PDSH –ja, kur erdhi në pushtet (1998), përsëri me "vëllezërit" (VMRO-DPMNE), e hapi Universitetin e Evropës Juglindore (Shtulit, 2001), po në të njëjtin qytet, në Tetovë. Edhe ky Universitet politik dështoi në praktikë. Universiteti i Tetovës, pa asnjë ndihmë morale e materiale shtetërore dhe me ndërkëmbëzat e partive politike shqiptare për "pushtet" argati, por me ndihmën e fuqishme mbarëkombëtare të popullit shqiptar e mbijetoi stuhinë politike antishqioptare. BDI –ja (Partia në pushtet), siç duket e "gjeti" shtegun politik: Universitetin e Tetovës e pagëzoi me Universiteti Shtetëror i Tetovës duke e legalizuar për fillim me disa fakultete (2004). Përçudi, shqiptarët falë politikës ditore të partive politike shqiptare dhe asaj shoveniste të "vëllezërve" në Shtetin e "përbashkët", u pasuruan me "ndihmën e vëllezërve" edhe me një fakultet pedagogjik dhe dy universitete.

Tinëzisht, arsimi dhe kultura shqiptare, jo vetëm në Shkup, por edhe në Prishtinë e Tiranë u

politizua deri në palcë dhe u pushtua nga partizanët e partive politike shqiptare. Luftën e ashpër kundër arsimit dhe kulturës shqiptare, që dikur e bënte pushteti komunist sllav, tashti e bënin edhe shumë më mirë partitë politike shqiptare. Arsimin dhe kulturën shqiptare e ngulfatën me aktivistët e tyre gjysëmanalfabetë. Aparati burokratik sllav u tërhoq anësh në punën e tyre për krijimin e shtetit maqedonas, dhe pataten e nxehtë ua la në dorë shqiptarëve. Shkaku se, punën më mirë se maqedonasit filluan ta varrosin argatët e tyre shqiptarë nëpër institucionet e Shtetit të "përbashkët". Partizanëve të tyre partiak me diploma universitare e tituj shkencor t'u gjejnë vende pune nëpër institucionet arsimore dhe kulturore të "përbashkëta". Kancerin ia shtinë në gjak, zemër e shpirt shqoqërisë shqiptare. Vetëm hidhnu një sy aktivistëve të tyre partiak, shumica përveç pasurisë materiale, u pajisën edhe me diploma universitare e tituj shkencor. Mjerim kombëtar, që sot na dalin edhe si politikanë dhe "analistë" politik para kamerave televizive si Dy dhitë kryeneqe mbi vig të lumit t'i shesin mend popullit shqiptar.

Alarm publik: Shqiptarëve, sot nuk u mungojnë si dikur shkollat shqipe dhe Universitetet, por nxënësit dhe studentët. Shqiptarët, sot nuk kanë nxënës dhe studentë për

këto shkolla shqipe dhe Universitete. Problem më vete është ajo, e vendeve të punës.

Partitë politike shqiptare i kanë mbushur radhët e tyre me partizanë, edhe administartën shtetërore me thasë. Vendeve të punës nuk u kanë gjetur punëtorë profesionistë, por partizanëve partiak - punë. Arsye e plotëfuqishme kjo, që deputetët e tyre në Kuvend mbyten si qentë edhe për një asht. Ushtria e të diplomuarëve nëpër këto universitete shqiptare, nuk ka rrugë tjetër shpëtimi, përveçse asaj të kurbetit. Katastrofë kombëtare se, po na ikë truri e na mbetet bërlloku te pragu i derës, përpara Shtëpisë.

Fati i shqiptarëve: Rrofshin e qofshin këto parti politike që i kemi në Ditën sotshme, në mos bënë "politikë madhore", tekefundit na pasuruan me shkolla shqipe dhe Universitete, edhe pse ne sot nuk kemi nxënës dhe studentë! Dhe, duhet të gëzohemi që pjellat e tyre kopila pas porte, nuk i kanë forcat e Nënave të tyre xhadia, nuk mund të themelojnë më institucione arsimore dhe kulturore pas shiut si këpurdha. Dukuri pozitive kjo natyrore, që ndoshta nesër i shpëton nga katastrofa politike shqiptarët.

Edhe, në fund: Siç duket sot për sot, konkurencë arsimore dhe shkencore Universitetit Shtetëror të Tetovës, i bënë "Universiteti" i Idrizovës, në Shkup…

POROSIA "POLITIKE" NGA XHAMIA E ÇIKAGOS NË AMERIKË

Ditën e sotshme, kur shqiptarëve u digjet zjarr mbi krye, të dalësh me porosi "politike" nga xhamia e Çikagos, për mua është çmenduri e shekullit. Tek tashti e shoh se, pse si popull shqiptar me shekuj nuk mund të ngremë krye, hudhim zgjedhën nga qafa në mes të Ballkanit. Ende na rren mendja se, nga ky hendek historik shekullor ku kemi rënë këmbekokë si popull, do të na shpëtojë nga gremina xhamia me gjysëmhënën në minare: pesqind vjet me radhë që na ka mbajtur robër nën Turqi e me shekuj nën Serbi. Gjtihmonë, u kemi besuar "miqëve" dhe "vëllezërve" duke i gostitur me dreka e darka se, një ditë do të na e zgjidhin Çështjen shqiptare. Nateditë i jemi lutur Zotit në xhami. E kemi thirrë, dhe ende e thirrim nga minaret për ndihmë. Aspak, vargjeve të Çajupit nuk u kemi hyrë në shpirt dhe gjak nëpër damarë, qoftë edhe për një "Bajram" në Katund: *Burrat nën hije,/ lozin, kuvendojnë,/ pika që s'u bie,/ se nga gratë rrojnë*!

Para me thasë kemi derdhur nëpër botë duke menduar se, të tjerët do të na e sjellin Lirinë, punojnë më shumë se ne shqiptarët për zgjidhjen e Çështjes shqiptare në Ballkan. Kurrë, nuk na ka shkuar mendja se, ai të cilin e paguajmë sot ne me

djersën e popullit, nesër do të dalin ta paguajnë tregtarë të tjerë politik edhe me shuma më të mëdha parash si mall tregu në skenën politike dhe do të na e kthejë shpinën si dikur në Londër.

Joe DioGuardit, shqiptarët e Amerikës i kanë dhënë para si ish kongresist dhe president i Ligës Shqiptaro - Amerikane. Ndoshta, edhe kanë lëvizur ndonjë tullë në politikën shqiptare. Feleminderit, Jo DioGuardit. Arsye, për të cilën edhe ka rënë nën ndikim nga qarqe "patriotike" fetare myslimane. Vetëmse, punëtorët tanë emigrant të krahut që i janë përgjigjur thirrjes së Nolit:

Ç'thot' ajo e ve e gjorë,
-Mbretëreshë pa kurorë-
Faqe-çjerrur, lesh-lëshuar,
Shpirt e zëmër përvëluar;
Gjysm' e vdekur: "O Shqiptarë,
Nënës mos ia bëni varrë!"
Mbahu, Nëno, mos kij frikë
Se ke djemtë n'Amerikë.

……
Sa kërkon e sa të duhen?
Burrat nga detyra s'ndruhen!
Trim i mirë do të japë,
S'kursen jetën as paratë;
Hithni, hithni tok dollarë,

Të mos mbetemi të sharë.
Mbahu, Nëno, mos kij frikë.
Se ke djemtë n'Amerikë.

Kurrë nuk kanë menduar se, ai që punon sot me para për shqiptarët, nesër edhe mund të shitet te armiku shekullor dyfish me çmim shumë më të lartë. Shkaku se, ai Shqipërinë e do për para, e shqiptari është ai që e do me shpirt e zemër, dhe ne vetëm ia kemi rritur çmimin e pazarit. Rasti ma përkujton Sartin, që në vitin 1964 e fitoi Çmimin Nobël për letërsi dhe e ktheu prapë me arsye, se: gjithmonë, i ka kthyer shpërblimet zyrtare dhe nuk dëshiron të barazohet me institucionet. Punë tjetër, është ajo se tre-katër ilntelaktualë shqiptar kanë marrë çmime lypësish te Ura e Gurit me pagëzime sllave, në Shkup. Alemet burrash do të thoni ju, "patriotë shqiptar" të shëtitur nëpër redaksi komuniste e instiutucione shtetërore, asnjëri nuk mori guximin që ta kthejë një çmim të tillë ofendues për popullin shqiptar. Nesër, të hyjë heroikisht si burrat në histori. Zërin ta ngrejnë lartë deri në qiell, popullit shqiptar në këtë shtet të "përbashkët" i duhen çmime arsimore dhe kulturore me emërime artistike shqiptare. Merreni me mend, nëse këtyre "patriotëve kuqezi" të sotshëm, "gabimisht" u ndahet çmimi Nobël, dhe këta e kthejnë prapë, me siguri do të bëhet

"Kiameti". Përmbytja e madhe, në Shkup. Përmbyset bota. Me siguri e dini edhe realitetin e shekullit: Sartri e ktheu se, mecenarë çifut ia dhanë dyfishin e parave të atij çmimi filosofit. E, përderisa shqiptarët ende nuk kanë mecenarë shqiptarë të këtij niveli patriotik, edhe gjatë kohë do të zvarriten rrugëve të botës në rolin e lypësit me ëndrra historike për Bashkim kombëtar dhe Shqipëri Etnike.

Aspak nuk pajtohem me DioGuardin se, porosia: Shtetit maqedonas për dështimin e realizimit të Marrveshjes së Ohërit dhe rastit "Monstra", duhet t'i jepet nga xhamia. Shtëpia e Zotit, edhe pse ende nuk është shqiptare të politizohet në këtë kohë të rrezikshme. Gati të gjitha protestat qytetare, u nisën nga xhamia "Jahja Pasha", në Shkup. Përçudi, nuk ua pamë hajrin, po sherrin. Protesta qytetare paqësore, shqiptarët kanë organizuar edhe pas ndryshimeve demokratike në sheshin e kryeqytetit (në kohën e Nevzat Halilit), kur nga të katër anët rrugëve drejtë Sheshit "Makedonija" marshonin grupe – grupe shqiptarët me kësula të bardha në kokë, parulla, pankarta në duar dhe flamuj kombëtar kuqezi. Kurrë më, shqiptarët nuk do të jenë në gjendje të organizojnë një protestë të tillë aq masive mbarëkombëtare. Fatkeqësisht, për organizatorët e fshehtë të sotshëm, ato protesta nuk kanë pasur asnjë parullë, pankartë e flamur të

huaj t'u pri në ballë si Lëvizje Kombëtare Shqiptare. E, mua si shkrimtar, më ka marrë malli për një protestë të tillë gjithëpopullore. Shkaku se, po më villet nga protestat e sotshme pa organizatorë, ose me petka partiake e fetare. E dini, pse?! Shqiptarët në Ditën e sotshme nuk janë peshk, që përpëlitet për një krimb në zallë, në breg të Lumit. Përmëtepër, edhe sot mu si dje të na vrasin e burgosin si terroristë dhe fundamentalistë islam nëpër oborret e xhamive me simbole turko-arabe.

"Joe DioGuardi, përzgjedhjen që të mbahet mitingu në objektin e xhamisë e ka bërë për të "sfiduar" stigmën e krijuar që protestat në Maqedoni kanë prapavijë fetare, njofton express." Mendimi i tij, gjoja se me këtë hap "politik" do t'ia bëjmë me dije botës se, protestat qytetare "paqësore" në Shkup nuk janë fetare, po kombëtare. Amani, na kënaqën "xhamitë tona" me gjysëmhënën në minare: në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup. Tashti, ka mbetur edhe ajo e Çikagos të na dalë zot si shqiptarë. Gabim i madh për një politikan me përvojë i kauzës shqiptare, ish kongresist dhe president i Ligës Shqiptaro - Amerikane, të cilin e kanë paguar dhe e paguajnë edhe sot shqiptarët me para të thata për zgjidhjen e Çështjes shiptare në Ballkan. Tek tashti, legalizohen para syve të botës se, ato protesta fundekrye janë fetare. Nuk do të ishin fetare, po

t'i jepeshte botës porosia nga Kisha Shqiptare e Fan Nolit, në Amerikë. Populli shqiptar hë për hë, ende nuk e ka Xhaminë Shqiptare me flamurin kombëtar kuqezi me shqiponjën dykrenare të valojë lirshëm në minare anembanë Atdheut.

Gojën plot e them: Arabia Saudite, sot para të mëdha derdhë për t'i blerë shqiptarët si dje turku me dy-tri franga në marrëveshje me Serbinë për t'i shpëngulur në Turqi. Serbia tashti e pa gabimin: shqiptarët nuk zmbrapsen me luftë, por me hoxhallarë të rrejshëm duke e shti si popull me këmbët dhe trutë në legen. Historikisht, hoxhallarët kanë qenë ato ma të cilët ka bashkëpunuar dje dhe sot Serbia, dhe e ka mbajtur përmes Fesë Islame rob këtë popull me shekuj. Kohën e fundit përmes kanaleve nëntoksore kriminele të errëta duke e dërguar edhe në luftë vullnetare në Siri. Pamje tmerruse duke shpërndarë në mjetet e informacionit me ato "shehitë" të arabizuar me thika në duar duke shokuar botën si "shqiptarë". Kohë qorre, kur përpiqen Shejtanin me "gurë" ta përzënë nga oborret e kojshive, e Dexhallin me miq e shokë e kanë këmbëkryq në Shtëpi.

DioGuardit, kësaj radhe si shembull, vetëm do t'ia përmend një patriot shqiptar nga Kërçova heroike: Osman Ballin. Politikani me siguri e njeh, nuk them se ka marrë para nga ai patriot i zjarrtë i vargjeve të Fan Nolit, por me siguri ka

pirë me të edhe ndonjë kafe. Pasurinë që e krijoi gjithë jetën me familje në Amerikë, e shkriu për zgjidhjen e Çështjes shqiptare. Gjithë politikanët shqiptar dhe artistët i ka mbajtur në Amerikë me javë e muaj me dreka e darka dhe strehim, çati mbi kokë. Patriot shqiptar, që vështirë se e lind edhe njëherë Nëna shqiptare. Unë nuk e kam pasur rastin që të shkoj në Amrikë dhe të jem mysafir i tij në shtëpi. Megjithatë, kam pirë kafe me të në Kërçovë e Prishtinë. Burrit të botës kija inatin, por hakun mos ia ha, thotë populli. Vite me radhë, rreptësisht iu ndalua kthimi në vendlindje si "armiku rrezikshëm" i shtetit. Pas ndryshimeve demokratike (1990), sigurimi i Kërçovës i dërgoi një shkresë pajtuese "armëpushimi": Osman Ballit, i thuani se e kemi falë si shtetas të IRJ të Maqedonisë, mund të vijë lirisht në vendlindje, nuk e ngasim e as nuk e shtimë në burg.

Osman Balli, një patriot i madh shqiptar i përgjigjet sigurimit shtetëror nga Amerika: Faleminderit, ato vertetë më kanë falur, por unë nuk i kam fal ende horrat.

Ditën e sotshme, përsëri do të kthehem te porositë e Rilindasëve tanë, vargjet e Vaso Pashë Shkodranit, nëse duam të shpëtojmë nga robëria shekullore si popull shqiptar historik i shpërndarë nëpër botë si Kashta e Kumbarës (Kumtrit), e jo tek porosia e DioGuardit nga xhamia e Çikagos,

që historikisht ia kemi parë dhe po ia shohim ende sherrin si Shtëpi e Zotit:

Shqyptar', me vllazën jeni tuj u vra,
Ndër nji qind çeta jeni shpërnda;
Ca thone kam fè ca thonë kam din;
Njeni: "jam turk", tjetri:"latin"
Do thonë: "Jam grek", "shkje"-disa tjerë,
Por jemi vllazën t'gjith more t'mjerë!
Priftnit e hoxhët ju kanë hutue,
Për me ju damun me ju vorfnue!
Vjen njeri i huej e ju rri n'votër,
Me ju turpnue me grue e motër,

…….
Çoniu, shqyptarë, prej gjumit çoniu,
Të gjithë si vllazën n'nji besë shtërngoniu,
E mos shikoni kisha e xhamia:
Feja e shqyptarit asht shqyptaria!

Porosia historike: Shqiptarët sot nuk duhet të dalin në protesta qytetare paqësore, as nga kisha e as nga xhamia, por nga institucionet arsimore e shkencore shqiptare: Shkollat, universitet dhe bibliotekat kombëtare. Themele shqiptare, që me shumë vështirësi i hapi në atë kohë historike Ministri i parë i arsimit në Shqipëri: Ernest Koliqi. Tekefundit, shqiptarët e kanë institucionin kombëtar në mes të Shkupit: Protestat shqiptare

duhet të nisin nga Sheshi Skënderbeu, në Shkup. Edhe atë, para këmbëve të Kalit të Skënderbeut shpalosin flamujt kuqezi kombëtar dhe kërkesat e tyre qytetare e politike.

Fatkeqësi kombëtare, që "revolucionarët" e këtij soji melez, protestat qytetare në Shkup i nisën nga oborri i Xhamisë Jahja Pasha. Ndonjëri, edhe u priu në ballë këtyre protestave me petk fetar me megafon në dorë. Vetëm, që edhe nuk hipi në ndonjë dru si majmuni, imitojë demonstrat e vitit '81, në Prishtinë. Natyra e ka fajin, ose dora e njeriut që për këtë "revolucionar" të vonuar nuk kishte mbjellë së paku një bli pranë rrugës. Përgjumshëm u përpoq t'i arsyetojë shëtitjet "patriotike" se, në këtë shtet u kanë mbetur si vendtubime të lira vetëm oborret e xhamive. Rrenë e madhe me këmbët dhe palarenë në "hava" përkarshi diellit me rreze. Besimtarët e Allahut të "revolucionarëve" të vonuar, sot më të afërt i kanë sulltanët dhe pashallarët e Turqisë, sesa Skënderbeun e Shqipërisë. Heroi legjendar shqiptar për to, edhe sot e kësaj dite është tardhtar, armik i Turqisë.

Kërkesat politike teknefese që vijnë nga kishat edhe xhamitë myslimane, në Ditën e sotshme janë të dëmshme dhe të rrezikshme për popullin shqiptar…

"ARMIKU" I SHTETIT DHE ZOTIT

Përnatë, kur e hap postën elektronike: me del para syve Dudumi. Shajkaçën, si gjithmonë në kokë. E di se, i ka edhe dy-tri të tjera nën sjetulla, mbuluar me setre. Vetëm këmbët e bardhë të Bajram Currit nuk e ka në kokë Dudumi. "Tybeistifa". Mysliman jam edhe unë, por me këtë hibrit "mysliman", nuk shkoj as në hale, e jo më në xhami me flamurin e huaj në minare. Sojin e këtillë e njoh moti, mos them se e kam mbajtur edhe me bukë. Nuk ka rëndësi për lexuesin. E rëndësishmja është se, këtë soj të "patriotit kuqezi" shqipatërët duhet ta kthejnë përgjithmonë në hale mes gjirizit. Përsipër, t'i hudhim edhe një rrum kungulli si shpërblim për vepër jetësore, në vend të gurit të varrit mbi kokë. Një cërrpkë t'i vënë te këmbët. Vorbën te koka, sipas traditës së varrimit të "xhenazes". Shtëpi më të merituar nuk besoj se meriton halldupi. Vendin e ka në Xhehnem. Punë tjetër është ajo, nëse Allahu përveç Xhehnetit dhe Xhehnemit e ka paraparë edhe halenë, një Parajsë tjetër të nevojshme për "myslimanin" e Allahut.

Megjithatë, ne shqipatarët kemi edhe një kategori të tjerë të njerzëve për në hale. Parajsë, të cilën na e ka legalizuar Vaso Pashë Shkodrani.

Kategorinë e postit të Rrufjanit. Dudumi pash më pash duhet t'i bie këtij "Xhehneti". Shkaku se, i spiunon krijuesit te "Vojvoda" për një torbë taxhi përqafe. Shkrimet publicistike të krijuesve dhe ato hajmalitë e tij me alfabet arab, ia dërgon "Vojvodës" si dëshmi për shpërblime. Torbën e taxhisë, mos t'ia heqin si "dënim" nga qafa, në grazhd.

Dudumi, kurrë nuk ka punuar nëpër instuticione të Shtetit. Nateditë, në xhami e ka spiunuar xhematin te "Vojvoda" dhe në polici. Pak kohë, këtë zanat e ka ushtruar edhe në Shqipëri. Shqiptarët e diktojnë Dudumin, mu si në atë kohë qorre, kur hidheshin me shumicë e pakicë spiunë nga UDBA jugosllave matanë kufirit. Besimtarët e Zotit e zbulojnë Dudumin dhe e përzënë bythëprapë në Çarshi. Dudumi me petk fetar, u përpoq profesionin e tij ta ushtrojë edhe në Londër, por edhe nga atje e përzunë me gjithë plaçka. Dudumit, më nuk i mbeti rrugë tjetër përveçse, përmes protestave qytetare të themlojë edhe ndonjë "shoqatë joqeveritare" me pretendime të një partie politike. Natë për natë e sheh ëndërr veten në pushtet. "Opozitar", që me çaj rusi do ta "sfidojë Faraonin"?! Në konferencë për shtyp, para të pranishmëve delë edhe si lider i Shoqatës joqeveritare nga Diaspora me katër - pesë anëtarë, përpara laptopit në rol edhe të përkthyesit. Gjuhën maqedonase e "hanë" si

kashtën mëzati në stallë. Përpiqet t'i bindë të pranishmit se e di edhe gjuhën angleze. Fjalët e huaja i përtryp si lopa barin në grazhd. Gjuhën shqipe, në këtë konferencë për shtyp, shumë pak e përdorë, ngase nuk ka pasur kohë ta mësojë duke u endur rrugëve të Shteteve Arabe dhe xhami.

Edhe, plotë "vështirësi" Dudumit i dalin në rrugë, vetëmse jo nga policia e Shtetit "demokratik", por nga shqiptarët si themelues të partive të reja politike shqiptare me seli në Çajtore. E themeloi me shokë dikur Pykën e shelgut. Hapi politik, që në start i dështoi si parti politike e Ditës së Nesërme. Dudumi si dele e nënkryeme, iku në Londër për të marrë frymë dhe strehim. Vite më vonë, u kthye me një "shoqatë joqevritare" gjysmake, në Bit - Pazar. Aktivetietin e tij politik e nisi përmes protestave "paqësore" me pankarta, flamuj e petk arab. Ferexhenë e hedhur krahëve, pavetëdije e hoqi gjatë fushatës zgjedhore duke e shitur veten një torbë taxhi tek një "Parti opozitare". Ferexhenë e zezë e ndërroi duke hedhur flamurin kombëtar kuqezi krahëve. Përgëzime, Dudumit! Edhe, Buçës Katundit, që na i pjellë kopilat dhe pasmesnate na i fluk pas porte.

Koha do të tregojë, sesa e fuqishme do të jetë kjo "parti politike kombëtare" me themeluesit e saj "shehitë", nateditë me këmbët dhe trutë në

legen. Fatkeqësisht, mbeturina të Perandorisë Osmane me gjak të huaj nëpër damarë në shërbim të asaj policore - sllave me thirrjen fetare: "Allahu Akber".

Skënderbeu, e ka sot edhe më vështirë se në kohën e Perandorisë Osmane, përderisa shpatën në mes të Çarshisë Shkupit e mba në brez për paqe, nuk e nxjerrë si dikur për luftë. Mëkot, Filipi i Maqedonisë te Ura e Gurit e ka ngritur dorën lartë si Xhaxhi Enver, ndaluni, o burra: këtu është kufiri shqiptaro – shqiptar! Luanët vjellin zjarre uji në këtë vapë të madhe, përballë Olimbisë me fëmijë në gji e prehër. Aleksandri i Maqedonisë, hipur në kalë me dy këmbët e para në qiell e dy të mbrapmet në tokë mes sheshit "Makedonija", e ka nxjerrë shpatën për luftë. Presidenti i posazgjedhur turk i Turqisë, Erdogan mu si në kohën e Perandorisë Osmane, përsëri i do më shumë "vëllezërit", sesa shqiptarët si "muslimanë arnautë". E ka thirrë kryeministrin maqedonas Gruevskin me gjithë familje dhe trupëroje t'i kalojë pushimet në Turqi. Ali Ahmetin dhe Menduh Thaçin i ka lënë në Tetovë t'ia "ruajnë" Maqedoninë.

Hoxha i Allahut e mallkon në YoTube Adem Demaçin (Mandelën shqiptar) se, kurrë nuk ka shkelur në xhami, as për "Bajram". Mjerani kujton se, duke shkelur në xhami je mysliman me "Din e Iman". E, në anën tjetër i

regruton të rinjtë shqiptarë për në Siri të bien në luftë si "shehitë". Trumbeton "xhihad" ta "çlirojnë" Sirinë. Kosova, Dudumi mendon se është Siri. Përgjakë Tokën e shejntë shqiptare të Skënderbeut. Kurbanë të therë për "Bajram" para kamerave televizive edhe në mes të Prishtinës. Qytetin universitar me Bibliotekën Kombëtare e 99 kësula të bardha në kokë. Mirë, t'i thuash ti këtij "myslimani", e ti kur ke shkelur në Bibliotekën Kombëtare?! Me siguri do t'i rrudhë krahët. Shkaku se, nuk ka pasur kohë duke iu lutur Zotit në xhami t'i falë të pesë "vaktet" për mëkate, dhe e ka harruar librin e shenjtë shqiptar të Çajupit: *Baba Tomorri*. Vjershën e tij antologjike: *Mëmëdheu*, në Librin e Këndimit.

Kohën e fundit në emër të Allahut dhe xhematit, përmes protestave qytetare në Shkup, përpiqet të themelojë edhe një Parti Politike Myslimane. Sokak më sokak i bie Çarshisë për të gjetur haxhilerë ta "vrasin" me gurë Shejtanin e Allahut në mes të Shkupit. Edhe, atë: merreni me mend, kur ky vetë është Shejtani më i madh me dy brinja në kokë. Haxhilerët më, nuk do të kenë nevojë të shkojnë deri në Mekë ta vrasin me gurë Shejtanin, kur e kanë përditë nëpër çajtoret e Bit –Pazarit, në Shkup.

Policia maqedonase veprimet e tyre i përshëndet me ndonjë "aksion policor" me vonesë disavjeçare në Katund, se i ka zënë në

gjumë disa hajna dhe trafikantë droge. Ende nuk i gjen halldupët që të kanë dalë në mes të ditës në rrugë dhe duan me ty t'i qërojnë fizikisht "hesapet". Ende, nuk e kanë gjetur se, kush ta dogji makinën. Ende "nuk i di" se kush të kërcnohet me komente anonime nën shkrimet publicistike?!

Hi-hii-hii… I di, por përderisa nuk rrezikohet pragu i tyre i Shtëpisë, ato edhe i nxisin, t'i ndërsejnë pas shpine. Pasaporta u japin dhe i nxjerrin në "kurbet" në rolin e Shejtanit të Allahut. E nga andej me komandë i kthejnë në vendlindje, për ta nxirë faqen e shqiptarëve para syve të botës me pankarta në gjuhën arabe e flamuj të Arabisë Saudite.

Përgëzime Shtetit të Kosovës, që këtyre qafirëve më në fund ua gjeti xhaminë e Allahut. Mekën shqiptare. Shajtanin ku do ta vrasin me gurë. Këmbët dhe trutë, kurrë më të mos i nxjerrin nga legeni. Veprim ligjor si Shtet demokratik të cilin duhet ta bëjë edhe Shqipëria, IRJ e Maqedonisë e Mali i Zi. Qilima persie t'u shtrojë haramëve mbi të cilët do t'i falin pesë vakte në ditë për mëkate para këmbëve të "hoxhallarëve" të burgut.

Pragun e shtëpisë nga bërlloku, nëse nuk e pastron vetë si zot Shtëpie, kojshia kurrë nuk e rrok në dorë fshisën. Edhe pse, e sheh se të ka mbuluar bërlloku deri në fyt, ferrat të lulëzojnë në

oborr. Probleme ka me shtëpinë e tij, që sa herë bie shiu me shtamba, kanalizimi e nxjerrë gjirizin në sipërfaqe. Lumi i Zi vërshon rrugëve duk hyrë nëpër padrume, garazhe e banesa. Askushi, që nga koha komuniste psëdhjetë vjeçare, nuk është marrë me këtët problem qytetar. Përmëtepër, gjatë kësaj kohe i kanë prerë drunjt për të ndërtuar ndërtesa të reja biznesi dhe xhami nëpër parqe, në mes të gjelbërimit. Verë për verë, punën e tyre të "sukseshme" e kanë përgëzuar me "Javë kulturore". Ndonjë përurim libri. Shënime të ndonjë date historike duke u lëkundur e përkundur deri në mengjes, herë më një anë e herë në tjetrën anë duke u rënë durve shuplakë me "Tingujt e Çarshisë". Monotoninë e prishin pak dasmat fmailjare me djare e lodra dhe flamurin kombëtar, që e zvarrisin rrugëve e mbi makina nëpër Shkup. Allti duke shkrepur gjithë natën e gjatë e harxhuar fishekë me thasë. Kohë kjo, kur fëmijët e tyre nuk kanë bukë e tekste shkollore.

Mëkot, ti e ngre zërin me shkrime publicistike, ato me këto shkrime zgërdhihen nëpër çajtore me gotat e çajit të rusit dhe të ndërsehen pas shpine, sa herë që ua bënë me gisht policia sekerete e Dexhallit. Forcë dhe dhunë ushtrojnë mbi popullin para syve të policisë maqedonase. Përmëtepër, edhe kur i denoncon në polici, ti je fajtori. Shkaku se, i ke provokuar me shkrime publicistike halldupët. Padashtas, të

kujtohet thënia antologjike e popullit: Shteti kur do, lepurin e zë edhe me qerre. Kokës fillon t'i biesh me grushta: kush është Shteti e kush është lepuri që fshihet nën ferrë?!

Djersët, pasi të shkojnë rrëke në fund të këmbëve, bindesh se ti je lepuri, e ato janë Shteti. Strukesh mes librave në biliotekë dhe vazhdon Luftën me penë. Përderisa, ato në xhami para xhematit dhe në YooTube të shpallin "armik" të Shtetit dhe Zotit...

"BURRË" ME LETRA

Pajtohem deri diku me ty si Mike e hazdisur me xhinde. Lëmsh m'i ke bërë trutë. Qerren artistike me gjithë rraçe ma ke shkarkuar në Lëmë. Vertetë, jeta është shumë e çmuar në Ditën e sotshme. Edhe, e them këtë publikisht se: ai, që nuk e do veten, nuk i do të tjerët si njerëz. Imzot, mos thuani se i doni kafshët?! Kotnasikoti m'i shurdhoni veshët si "internacionalistë", nëse nuk jeni nacioanlistë, kurrë nuk mund të jeni internacionalistë. Përtej çdo kufiri të çmendur. Arratisur mes poezive. Pikësëpari, mësohuni ta duani veten, e pastaj të tjerët, "vëllezërit". Jetën e ushqen dhe e mbanë gjallë dashuria. Kurrë, urrejtja. Atdhu, që ti aq shpesh e përmend në poezi. Edhe, Nënën: Mëmëdheun e Çajupit. Nuk ma merr mendja se, fjala jote mund të lëshojë helm. Shkaku, se: ti nuk je gjarpërushkë. E, sa di unë, Boa e shullanit nuk lëshon helm, kur të lidhë këmbeduar mes livadheve, rrëzë Çukës. E, për sa i përket besnikërisë, edhe me këtë pajtohem pjesërisht gjoja si burrë i poezisë. Shkaku, se: mvaret ndaj kujt je besnike si mike.

Përçudi, nga ku kjo filosofi "atrtistike"(?!): "Trupin se japë (e kursej, se ia kam dhënë besën dheut, të ma tretë, etj..." Habitem, nga ku ky terr artistik, pesimizëm në kokën tënde si poete, aq e re me perspektivë dhe jetën përpara në dorë, kur

duhet t'i nxjerrësh për mejdani armët e Zanave të maleve për luftë?! Dalldisesh, humbësh veten pas "dashurisë", Dexhallit me trumbeta dhe famës rrejshme për së gjalli. Pavetëdije, se: rruga poetike është me gropa dhe e rrezikshme për në Baba Tomor. Pusi, që armiku i pabesë pas porte e shkrep armën me dy tyta të "gjahtarit" si në Arushë, edhe pse ti i delë lepurushkë e strukur nën ferrë. Hapi gabuar, mund të të përcjellë në theqafje të historisë shqiptare. Hiqe shaminë e zezë me të cilën t'i kanë lidhur me shekuj sytë. Trurin, nuk kam guxim të them se, e ke në thesin me arna ngarkuar në qerre. Grykën të cilit ia kanë lidhur "vëllezërit" me kordhë kanapi. Faji nuk është i yti, po i atij mëzatit të tredhur pa brirë. "Burrit" me brekët mbi pantollona, që është në gjendje të bëjë çdo gjë "patriotike" për t'i kënaqur epshet e tia personale të hamshorit, vetëm e vetëm ta shpëtojë veten nga stuhia politike, nxjerrë me pak shpirt në sipërfaqe mbi ujë në breg. Dhashtë Zoti, trurin tënd nuk e kanë sulmuar krimbat komunist! Vetëm, atëherë do arrish ta shohësh rrugën e Diellit në qiell për në Baba Tomor. Dhiaret për të hipur majave, përmes shkurreve në Vendin e Perëndive. Hë për hë, mal në të cilin ka hipur deri më sot vetëm Çajupi si poet. Tyrben, ku pihet vera me shtamba, lindë poezia. Dhe, bëhet dashuri mbi varrin e Babashehut brez pas brezi me Zana të maleve.

Lulja është dorëdhënme, edhe pse e ka nënë Dheun. Erën dhe bukurinë ua jep dashamirëve (miqëve) të Rrugës Diellore malore. E bukura ka vlerë, atëherë kur shijohet, i jep gji një Poeti profetik për luftë, por jo edhe një mëzati të tredhur pa brirë. Larg mendjes se, Profeti i fundit është, Muhamedi a. s. në këtë botë. Profetët tjerë pas tij janë të rrejshëm. Edhe, Dexhalli me trumbeta kur delë rrugëve para Përmbytjes madhe (Kiametit) nëpër Bit-Pazar, në Shkup. Ose, siç them unë nëpër biseda të lira nën Rrap: Poetit gjeni më Ditën e sotshme i duhet një Muzë e maleve me dy shtamba verë. Zanë e kreshnikëve të Jutbinës: Mujit dhe Halilit, që i ka dhënë dhe i jep gji mes maleve me dy shtamba verë. Fuqi për luftë heroike flakë më flakë. E poetes azgane një mëzat i patredhur me tirqi e xhamadan me dymbëdhjetë gajtana. Struken hedhur krahëve. Sahatin me qystek pëqefe. Mundësisht, "naganitn" ta ketë në brez me nëntë fishekë...

E, jo: "Ujk që s'shqyen... musliman – agjëron". Nuk e kuptoj, ku e ke fjalën. E ke për mua, ose për veten si "grua besnike"?! Nëse e ke për veten, atëherë duhet të jetë: Ujkeshë. Ose, Ulkojë e egër që hanë e shqyen gjithë natën pamëshirë "viktima" të pafajshme në shtrat. Trup e shkurt, "mbaj Ramazan", nuk e dua "haramin". Mezi e pres Bajramin me ndonjë tollumbë me pashterkë të kuqe mbi sofër. Punemadhe, që në një manifestim kulturor, ti nuk pate guxim as të

përshëndetesh me mua si poet. Tri ditë rreshtë, ne jemi të "panjohur" në atë manifestim kulturor poetik. Fuqi të jep Zoti t'i nëpërkëbësh Netët e përgjakshme mbi bregliqe. Dallgët e tërbuara, që gjithë natën e gjatë të hidhnin në breg. Mëkot, e thirrje Hënën e plotë në qiell për ndihmë, edhe ajo u mbytë mes dallgëve në fundliqe, matanë kufirit ujor në Poradec.

Lufta, qe një sy gjumë. Tërmeti ra në dhomë. U përmbysën shtamba me verë. Rrokullisje në shtrat. Thirrje për ndihmë. Dielli na trokiti në dritare. Dita e nesërme na zgjoi për rrugë: mua për në shtëpi te gruaja azgane me dy shamia lidhur për brezi, e ty për te burri besnik në prehërin Shemrës Parti. Rrugës, mes maleve të Dibrës edhe ku e volle dashurinë. Përpak, edhe ku desh të lash mes maleve. Shkupin e pushtuam në gjumë.

Përçudi, edhe sot e kësaj dite më kundërshtojnë "miqtë" e mi të penës. Përditë me këmbëngulje kërkojnë që të bëj vetëvrasje, pavetëdije ma zgjasin jetën. O Imzot, po ku të lënë të bësh vetëvrasje këto Zana Mali, ku nateditë më rrinë me gji mbi kokë. Fuqi më japin për luftë. "Miq" të penës dhe politikës, sot për sot nuk kam kohë për vetëvrasje, përveçse kujdesin ndaj maceve të mia besnike: Cucit, Baxhit ("rahmet" pastë), Llontos, Zonjë Kitit ("rahmet" pastë), Banditit dhe Gaçit Madh dhe Gaçit Vogël me mustaqet vesh më vesh. Nesër, nuk e di,

vështirë e kam ta them në këtë shkrim. Ndoshata, në shtrat me ndonjë Zanë të maleve me dy shtamba verë mbi kokë. Propogandës tyre se, më "shumë pi raki rrushi sesa ujë". O Imzot, për inat të atyre ("miqëve") e kërkoj dënimin, sot më mbytni me dy shtamba verë të Mikes nën Rrap! Varrin e kërkoj mes atyre dy gurëve, rrëzë Çukës mbi kokë. Trupëroje, që do të më kalojnë mbi Urën e Xhehnemit sa një qime floku. Asgjë mos shkruani në ato dy rrasa varri, përveç dy vargjeve: Mikja e mbyti nën Rrap me dy shtamba verë. Shkaku se, për së gjalli nuk e pranoi vetëvrasjen si "haram". Raki rrushi nuk pati me vete se, dy ibrikët lara-lara ia theu Mikes Dexhalli te Burimi. Mëkate nëse kemi, le të na lëshojë buthekrye Ura në Zjarrin e Xhehnemit. Kohërat në Ditën e sotshme kanë ndryshuar mjaftë në dobi të shqiptarëve: nuk kërkohet më si dikur një nuse me letra nëpër botë, po një "burrë" me letra. "Burri" me letra, sot nuk është më ai kurbetçari i arratisur nga Atdheu, por politikani me kollare që e keni para dere. Nuk ka nevojë të shkohet pas një "burri" me letra, ose nusje deri në Bosnje, Zvicër, Gjermani e Amerikë, kur i keni me thasë në Qeveri.

Shqiptarët, kohën e fundit i do edhe vetë Zoti: më shumë kemi gra, sesa burra. Moti dikur, e kemi shitur edhe arën, bukën e gojës për ta blerë një grua. Motrën e kemi dhënë, siç thotë populli me të "marrmedhënje" pas shtatë maleve për një

grua. Gojën plot e them, pas një gruaje kemi shkuar edhe deri në Bosnje. Punë tjetër është ajo se në kohën e komunizmit, në Beograd si punëtorë krahu me sharrë në krah, i kishim edhe pa pare. Kohë e "artë" ajo komuniste, kur shqiptarët i kishin nga dy e tri gra ilegale. Fëmijë bënin me qerre për vete e për "vëllazërit". Vetëm e vetëm, që të na tymojë oxhaku në Katund e Beograd. Histori më vete është ajo se, në Kosovë gjatë Luftës fundit (1999), ne nuk na përzunë me gjithë familje serbët, por na dhunuan e na vranë djemtë tanë që i patëm me ato gra "ilegale". Edhe, këtë sot nuk e dini si shqiptar?! Jo, mos e thuani këtë fjalë. Populli shqiptar, gjithë jetën ka qenë, është dhe do të jetë në luftë për Liri. Pikësëpari me vetveten si popull, e pastaj me "vëllezërit" për nderjen e Shtëpisë. Problemi kryesor është se, ne deri më sot me "vëllezërit" i kemi ndarë enët dhe lugët, e kurrë arat, livadhet, melet dhe Shtëpinë. Burrat kanë rënë nëpër beteja të përgjkashme për Atdhe. Gratë e kanë mbajtur Shtëpinë. Kutadi unë, provuan me shekuj burrat me pushkë e penë ta bëjnë Shqipërinë Etnike, ende nuk e nxorrën në dritë. Ndoshta, për tri ditë e tri netë e bëjnë gratë azgane me pashterkën pala-pala. Shejtanin e Allahut e fusin në shishe.

Përsëri e nxjerr penën nga brezi, të kthehemi te fillimi i këtij shkrimi, mes këtyre rreshtave të vazhdoj ta kërkoj varrin tim me libra. Jo, u përgjigjem publikisht. "Miq" të mi besnik,

ju mund të më vrisni kur të doni me dy shtamba verë dhe një Mike nën Rrap. Përditë, më keni në Shkup. Nuk kam truproje e as para për t'i blerë vrasësit e mi profesionistë që m'i ndërseni pas shpine. Larg qoftë ajo, të makinave luksoze blinduese me shoferë personal. Raki kam, por asnjë pikë nuk ua jap juve si dudumë, mjaftë e keni ujin e Xhehnetit. Lulet. Zjarrin e dua unë marrëzisht! Zjarrin. Pash më pash dua t'i bie Xhehnemit! Problmi nuk është i imi, por i juaji si politikanë qeveritar. Frikë keni se Nesër, mund të më shpallni hero kombëtar. Aspak, nuk e vras mendjen e Kryngritësit të strukur mes pantollonave që i turret me të katra pas fiqit. Përkundër, asaj thënies popullore: Hëngër fiq, dhe vdiq. Zot, mos më keq: Dalldisjet e juaja "patriotike t'i dëgjoj mbi varr. Fjalimet e gjata patetike mbi kokë se, ne jemi mirë në varr mes gjarpërinjëve, ju jeni mirë në shtëpi luksoze dhe Qeveri. Porosinë banale, që ne të rrimë atje ku jemi mes varreve, ju të rrini këtu ku jeni mes begatisë qeveritare. Guximi dhe pena ju mungon juve si kalorës të arratisur. Guximi dhe pena! Talenti, që nuk ua ka dhënë Zoti. Kotnasikoti bërtitni dhe kërkoni të bëj vatëvrasje. Zoti nuk e ka thënë, e ju nuk keni guximin ta shkrepni armën. Kutadi unë, ndoshta edhe nuk keni armë, jeni hadumë.

Përmëtepër, unë kurrë edhe nuk mund të bëj vetëvrasje. Mund të iskenoni vetversjen në

dhomën time të punës me libra. Ose, në ndonjë hotel lukzoz. Fatkeqësi komunikacioni. Dhashtë Zoti, mes grave! Vetëm këtë hap "patriotik" jua fali si Poet. Para të paparishikuara mund të derdhni në llogari rrjedhëse anembanë botës, për shuma të cilat mua nuk ma merr mendja, të m'i shkrepni dy plumba në lule të ballit. Vetëvrasje do të bëj vetëm atëherë kur dua Unë si Poet. Mundësiht, mes dy shtambave me verë. Mikes dhe poezisë nën Rrap. E ju, vazhdoni ta kërkoni vetëvrasjen time publikisht nëpër Bit-Pazar. Përgjigja ime është, jam për dialog paqësor: Pajtohem. Mund të bëjmë "marrëveshje paqësore politike" në tavolinë, përmes dialogut. Edhe, atë: Nëse, antetati bëhet nën Rrap, mes dy shtambave me verë para syve të Mikes dhe Poezisë.

Nuk e di, a i keni ju këto kushte që të mi plotësoni si Poet shqiptar në Ditën e sotshme, kur zjarr na digjet mbi krye si popull?! Këmbëkryq, të ulemi kokë më kokë në sofër si dikur burrat e mejdanit?!

Përsëri, i përgjigjem vetes: nuk e di. Imzot, mos shkruaj dhe flas jerm?!...

VARREZAT POLITIKE

Xha Cuti, ky personazh i historisë shqiptare të cilin nuk e kanë vërejtur deri më sot partitë politike duke u turrur me të katra pas posteve politike, përpak të më shpëtojë nga pena edhe mua si shkrimtar "problematik". Jo, o Xha Cuti Madh, të them: pusho i qetë mes varreve! Rehat bë gjumë, nuk ka kush të ngre sot ty përmendore, përveç meje në këtë shkrim përkujtimor. Vështirë e ke të shpëtosh nga pena ime me dy tyta. Njerëzit e mëdhenj, vështirë i shpëtojnë kësaj "arme paqësore" historike. E, sidomos një burrë si ti shqiptar, që ke lënë "name" nëpër Kërçovë. Punë tjetër është ajo se, halldupët nuk kanë pasur veshë, nuk kanë pasur sy t'i shohin ato shenja historike. Shkrimtari i ka ndjekur këmba-këmbës, dhe herë pas here i ka hedhur në letër si fenomene të shoqërisë. Përmëtepër, është ulur me ty në një tavolinë, ka pi kafe, ose e ka rrotulluar ballë për ballë "këmbë për tërma në hava" ndonjë groshë pas Çuke. Dihet, nuk ka mundur t'i rrokullisë dy grosha në thesin e grisur, ngase nuk e ka pasur aftësinë mendore e intelektuale të nivelit tënd jetësor. Barkun e ka pasur plot me "drekat dhe darkat" e popullit shqiptar. Megjithatë, është ulur në tavolinë, të shohi sesi ti i hanë dy grosha gjatë një dreke mbretërore. Larg qoftë, të rrokullisësh

ndonjë këmbë qëngji, ose viçi. Vërtetë, nuk do të të kishte hije, drekat dhe darkat e këtij soji, janë "salltanete" politikanësh.

Kërçovarët e mi i di, nuk ka nevojë për ta të më flasësh asnjë fjalë, qoftë për të mirë apo për të keq. Vite me radhë kam hëngër sheqer edhe kripë me thasë në një sofër. Pena ime sot e ka shenjën te ti si personazh unikat ende i pazbuluar në Letërsinë shqiptare: Hijen e Pemës në oborr, vendin e punës dhe dy groshave mbi tavolinë. Që, dje Miniministri shqiptar ua hapi Portën Triumfale krah më krah në Shkup, sot politikanët shqiptar u duartrokisin "mbjelljeve" të përmendoreve nëpër Shkup, kur populli vuan edhe për bukën e gojës. Ujin ia ka falë Natyra. Ose, Zoti Madh. Shtatoret brënda një nate mbinë si këpurdha pas shiut me shikim nga Çairi me armë në dorë: thika, pushkë e bomba. Përballë Skënderbeut me shpatën në brez për paqe dhe Hasan Prishtinës, i çarmatosur me duar në xhepa. Sot për sot, Shkupi më shumë ka përmendore, sesa banorë. Personalitetet shqiptare: Pjetër Bogdani, Josif Bageri dhe Nexhat Agolli presin në radhë, siç kanë pritur edhe dikur për së gjalli për dy metra varr në Perandorinë Osmane e sistemin e egër komunist. Punemadhe, që në pagesën e tatimeve shtetërore, jemi të barabartë si popull shumicë: pushtetin dhe përmendoret ua kemi lënë popullit pakicë "vëlla" në krizë

identiteti, pjellës komuniste që pak gjurmë kulturore e qytetare ka lënë rrugës në histori. Rrezik i madh, kur ta shohësh nga njëra anë për një popull, që historinë përpiqet ta ndryshojë me ngritjen e përmendoreve të së kaluarës: heronj antik, serb, bullgarë e shqiptarë. Komplekset historike, që në Ditën e sotshme përpiqet t'i shërojë përmes përmendoreve me armë në dorë, thirrjeve për luftë "vëllavrasëse"?!

Pushteti dhe përmendoret janë të përkohshme, i ndërtojnë pushtuesit dhe partitë politike në pushtet, nuk kanë jetë të gjatë. Nesër, vijnë partizanë të tjerë fitimtar në Shkup, dhe gjithë këto përmendore me leje e pa leje t'i hudhin bythekrye në Vardar. Historia njeh plot ngjarje të këtilla pushtuese. Prandaj, edhe shqiptarët nuk duhet shumë ta vrasin kokën rreth përmendoreve që u lindin brenda një nate në Shtetin e "përbashkët", që sot për sot janë vetëm një grep politik i provokimeve hedhur në një lumë pa ujë, në të thatë kundër veprimeve të tyre historike. Koha, nuk është sot të merremi me përmendore, por me shtrirjen e dorës pajtimit, rimëkëmbjen e Atdheut. E di, dudumët si rrufjanë të shërbimeve të huaja sekrete antishqiptare, përpiqen ta shpallin "Iliridën", një autonomi shqiptare të "harxhuar" e djegur kahmoti komuniste. Pavetëdije, u prinë ngritjeve dhe legalizimit të këtyre përmendoreve në prag të

festës me rastin e 8 Shtatorit (1991), Ditës së pavarësisë të IRJ të Maqedonisë në mes të shqiptarëve dhe Ballkanit. Dalldisin popullin shiptar për veprime politike pakrye, Hapin e Motit Madh të sotshëm strategjik ta kthejnë në fillim të rrugës malore. Ose, fusin shqiptarët në qorrsokak historik.

Populli shqiptar, kur ka pasur civilizim, Mbretëri, Shtet, Universitet, histori dhe përmendore, populli i sotshëm artificial bënte jetë argati, herë si serb, herë si bullgar e herë si turk "ehamdurila". Shqiptarët janë ato që e pavarësuan dhe e mbajnë gjallë këtë Shtet të "përbashkët". Haxhi Deputeti qafë për qafe me "Tatkoto" (Babain), në atë kohë qorre "fluturoi" si Azreti Isai nga minarja e xhamisë jo në qiell, po në Amerikë. Miniministri "shqiptar" i Kulturës me shokë. Doktorziu, Rrumaduci, Dudumi e ndonjë tjetër "hero" i "vëllazërim-bashkimit", vendin e kanë edhe ato mes atyre përmendoreve. Gabim i madh historik, sot u bëhet "shehidëve" të mejdanit mos t'u ndahet një copë livadh, një kamion beton dhe dy-tri fjalë miradie mbi kokë si "krushq" të Njerkës me dy shamia të kuqe lidhur për brezi. Duartrokitje partizane. Rrugë t'i hapin Ditës Nesërme, që është nisur me qerre dhe nuk vjen me kuaj e armë në dorë, por me penë, libër e dije.

Kohë, mos humbëni kot me ndërtimin e përmendoreve (varrezave politike), por përveshni mëngët dhe futjuni punës historike (Ardhmërisë)! Përmendoret dhe historia i duhen një populli që nuk i ka sot në jetë, për ta mashtruar veten me përralla arabe të "Njëmijenjënetëve", vë në gjumë. Populli shqiptar historinë e ka ndërtuar me luftë dhe gjak nëpër shekuj. Edhe, përmendoret historike nëpër sheshe. Ndonjërën, gjatë ndryshimeve demokratike edhe e ka rrëzuar, tërhequr zvarrë me litar. Rrezikun e zhdukjes, moti e ka tejkaluar si popull liridashës, që në kohën e Turqisë. Shqiptarët janë si fara e hithës, mbinë kudo që ta hedhësh në rrugë, edhe mes shkëmbinjëve. Prandaj, ky popull heroik i nemur nga turku edhe nuk zhduket aq lehtë nga faqja e Dheut, siç ëndërron me vite armiku historik shekullor.

Shkupit, verë e dimër i sulen kushtet atmosferike me shi, breshër e borë. Përmbytja e madhe, ujërat e zeza kur dalin mbi tokë si lumenj rrugëve në mungesë të kanalizimeve. Vërshime, që hyjnë edhe oborreve e shtëpive familjare. Kryeqytetin shqiptar çdo njëqind vjet e sulmon edhe tërmeti katastrofal, e rrafshon me tokë. Faj, askushi nuk na ka ne shqiptarëve, që në vend të shkollave dhe përmendoreve në mes të parqeve (gjelbërimit), ngrisim xhamia me dy e katër minare. Dasmave tona "kulturore" si popull "i

lumtur", u mjafton Bit-Pazari dhe Parku i Çairit, dy - tri ditë t'u bijmë lodrave e cinganave, këndojmë këngë patriotike me çifteli e heqim valle popullore. Gara bëjmë me kojshiun se, kush më shumë do të shkrepë fishekë në ahengun familjar gjatë një nate, aqsa do të na kushtonin lapsat, fletoret dhe librat e fëmijëve tanë gjatë një viti shkollor. Protesta politike me petk fetar të organizojmë për çdo "Xhuma" (premte) nga oborret e xhamive, që më vonë me flamuj kuqezi kombëtar ta vëndosim vetë kufirin shqiptar te Qendra Tregtare "Mavrovasja". Hapsirë luftarake t'u lëmë përmendoreve partiake. Edhe pse, shumicën e ndërtaseve dhe përmendoret e sotshme më këmbë e mbi kuaj, nesër nuk do t'i keni në këtë Qytet as për farë mes gjelbërimit. Përsëri, Nesër do lindë një Shkup i Ri me ndërtesa institucionale e përmendore kokë më kokë me penë e libra në dorë. Armët e luftës do t'i strehojmë në muze, lëmë për kujtim historisë. Pasardhësve të nesërm të këtij kryeqyteti shqiptar, nuk do t'u interesojnë përmendoret me armë në dorë: pushkë, bomba e thika për luftë, por paqeja dhe libri si armë e dijes dhe shkencës.

Lexuesi shqiptar, e di se plasi t'i zbulojë këto fshehtësi të Xha Cutit Kërçovës. Mendja, mos ju rrejë se, edhe unë kam fjetur dhe flej rehat: Pakgjë, i vodha Xha Cutit për së gjalli në këtë shkrim profetik për Nesër. Shkaku, se: Jeta

është dinamike në shoqërinë politike, problemet familjare e kombëtare. Lufta me "miq" e armiq flakë më flakë mes dy zjarreve. Xha Cuti, shumicën e fshehtësive i mori me vete në varr. Inati më vjen sot, pse nuk i vodha së paku edhe një mençuri më tepër në Librin për Nesër. Fatkeqësisht, Xha Cuti jetoi i pasur dhe vdiq i varfër në mesin tonë si enigmë. Faji, ndoshta pak është edhe i yni si popull shqiptar. Veshin, nuk ua venim atyre mençurive që ai i hudhte ditenatë rrugëve, nëpër Kërçovë. E kishim shpallur të marrë. E, në realitet, ne kishim qenë ato të marrët me barkun plot e kokën e zbrazët garroçe. Xha Cuti kishte qenë i meçur.

E them këtë, se dua t'ua pëmend sot mençuritë e tij me rend. Pak rëndësi ka ajo, që Xha Cuti kur zbriste më këmbë nga Katundi në Kërçovë, i porosiste nga dy grosha në restorant. Dreka të cilat ia paguanin njerëzit humanitar kërçovar, pa bujë e reklama si sot në mjetet e informacionit. Mëngjesin dhe darkën i bënte bashkë gjatë një dite. Javë të tëra, ndodhte pastaj të mos shti gjë në gojë. Punemadhe, kamarieri kur e shihte vetëm në tavolinë përballë dy groshave dhe e pyste: po, këtë groshën tjetër?! Eh, i përgjigjej me buzëqeshje Xha Cuti: është për një mik timin që do të vijë pak më vonë nga rruga. E pasi e hante njërën groshë, dikur i futeshte edhe tjetrës groshë plot gëzim me këngë: nuk erdhi ai

miku im, me siguri i ka dalë ndonjë punë kombëtare udhës.

Qëllimi i këtij shkrimi është te Hija e Pemës në mes të oborrit përpara Shtëpisë. Vëllazërit kur zgjoheshin nga gjumi në mëngjes, Xha Cuti i thonte vëllait: vëlla, shko futu ti i pari nën Hijen e Pemës që më vonë të mos kemi probleme familjare! Veprim politik, që sot nuk e ke te politikanët shqiptar. Hijes së Pemës të gjithë i turren si kope e tërbuar duke e shqyer me dhëmbë, bërryla e shqelma vëllai - vëllanë, kush i pari të ulet nën hije të Pemës (pushtet argati) mes Oborrit të Shtëpisë.

Xha Cuti ka thënë edhe një mençuri, që sot vlen shumë për punësimet administrative

qeveritare: Miku i tij, kur i gjeti punë si roje në Termoelektranën e Oslomesë (Kërçovë). E, ky si burrë mejdani iu përgjigjë: a, nuk është më mirë në atë vend pune ta punësoni një tjetër punëtorë, e rrogën ne të dy ta ndajmë përgjysmë?! Xha Cuti e zgjidhi qysh moti edhe problemin e udhëtimit të nxënësve shqiptar me të cilin sot ka probleme Komuna e Kërçovës. Herët i parapa problemet e udhëtimit të këtyre banorëve dhe nxënësve: trakën si te Termoelektrana e Oslomesë. Udhëtarët nuk kanë nevojë të hipin në qerre e autobusë urban, por në një trakë që do të ndërtohej nga Kërçova drejtë atyre fshatrave të largët malor. Asnjë minutë nuk do të humbënin kohë në pritje, ajo trakë do të qarkullonte non-stop përmes fushës, nateditë drejtë shtëpive të tyre dhe shkollave shqipe. Edhe pse, e kishte edhe një kërkesë specifike për udhëtarët, në vendin e arritjes të ketë edhe një dyshek të butë me pupëla, që kur të zbresin mos vriten si udhëtarë.

O Imzot, po cila parti politike, cili lider shqiptar u muarr aq shumë me votuesit e tyre pas fushatave zgjedhore, përveç Xha Cutit me dy grosha mbi tavolinë?! Asnjëri. Prandaj, shqiptarët edhe gjatë kohë do të presin që të lind një Xha Cut shqiptar. Parashikues, që t'i shpëtojë shqiptarët nga kalorësit e arratisur të partive politike…

POROSIA HISTORIKE

Imzot, vërtetë është humbje kohe të merresh sot me dudumët. Edhe pse, dudumi nateditë të provokon në YoTube! Skizofreni me një kësulë shajkaçë në kokë dhe tri të tjera nën sjetulla në protestat qytetare me flamuj të huaj në ballë përmes Bit – Pazarit deri te "kufiri Mavrovasja" në Shkup, gjoja për "ndryshime politike". Edhe, ti je i detyruar t'i tregosh halldupit, se: Teatrin Shqiptar e ka ndërtutar me shokë edhe Babai, jo për propogandë fetare, por për kulturën shqiptare. Shtetin Shqiptar. Në do të dish pak më tepër si halldup me një kësulë leckë në kokë e tri të tjera nën sjetulla: Babai ka qenë edhe ballistë. Bashkëmendimtar i Mithat Frashërit me shokë. Familjes patriotike të bejlerëve. Punë tjetër është ajo se, gjatë sistemit komunist, unë jam përndjekur si djalë ballisti, e sot ndiqem si djalë komunisti. Babai, ka pasur pasuri: ara dhe male, dhe i ka paguar tatime këtij Shteti "demokratik". Babai yt, dhe koka jote fanatike me këmbët dhe trutë në legen, i ka dhënë para të vjedhura me thasë nga populli serbit, vetëm për një vizë për t'u shpërngulur me gjithë familje në Turqi. Përmëkeq, me shokë pas luftës "nacional - çlirimtare" (1945) edhe është nënshkruar në emër të popullit shqiptar, se: Populli shqiptar nuk do që

t'i bashkohet Shqipërisë, por dëshiron që të mbetet brez pas brezi nën Jugosllavi. Fatkeqësia, ti pas gjithë atyre parave për të ikur nga Atdheu, pas prishjes së marrëveshjes historike mes Turqisë dhe Serbisë (1938 dhe 1953), ke mbetur në Shkup si turk "ehamdurila". Hoxhë me "Din e Iman", t'i ngatërrohesh popullit shqiptar me vite nëpër këmbë edhe në Ditën e Sotshme Historike.

Konventa jugosllavo - turke e vitit 1938 dhe marrëveshja Jugosllavi - Turqi - Greqi e 28 shkurtit 1953 e njohur si "Pakti Ballkanik" i nënshkruar në Ankara, në bazë të hulumtimit sistematik të dy shërbimeve konzullare (sektorit të pasaportave) jugosllave dhe turke, dëshmon se në periudhën 1951 - 1968 nga Jugosllavia në Turqi janë shpërngulur 414.500 shqiptar**ë**... Ndërsa, gjatë periudhës në fjalë (bazuar në statistikat sekrete jugosllave), në Kosovë ishin sjellur në heshtje 63.000 kolonistë sllavë, prej të cilëve, pas rënjes së Rankoviçit (1966) duke mos duruar njëfarë "barazie të vëllazërim - bashkimit" me shqiptarët, shumica prej tyre udbashë e kriminelë marrin ikën për në Serbi. Ndërkaq sipas statistikave të publikuara më vonë delë në sipërfaqe se, në periudhën 1952 - 1965 për në Turqi janë shpërngulur: 452.371 shqiptarë. Vite, kur me dhunë detyrohen të shpërngulen edhe mijëra shqiptarë, kryesisht nga Mali i Zi (Hoti,

Gruda, Plava, Gucia, Vuthaj, Ulqini, Tivari, Triepshi, Shpuza, Kraja etj.)

Në dimrin e vitit 1955/56 u organizua aksioni për mbëledhjen e armëve dhe gjatë këtij procesi të dhunshëm politik u keqtrajtuan me metodat më mizore më se 30.000 shqiptarë "nacionalistë". Në këtë ekspeditë policore, nga rrahjet dhe torturat politike u vranë 103 shqiptarë, ndërsa u gjymtuan për jetë rreth 10.000 të tjerë...

Hulumtimet shkencore për zbardhjen e një ngjarje historike siç është, marrëveshja "Xhentëllmene" turko - jugosllave e vitit 1953, ndërmjet shokut Tito dhe Kypreliut, sado që janë jo të mjaftueshme, prapë na japin një pasqyrë shumë të mirë për ta kuptuar këtë marrëveshje antishqiptare. Vlen të përmenden veprat e historianëve të kombit shqiptarë siç janë: Fehmi Pushkolli në vepren *"Fronti Popullor - Lidhja Socialiste e Kosovës*", Jusuf Osmani në vepren *"Vendbanimet e Kosovës - Gjilani"*, *Hakif Bajrami "Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës 1844 - 1995"*, Sabile Basha "*Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës 1877 - 1995"* dhe në shumë hulumtime të punimeve shkencore të cilat e kanë për objekt të studimit këtë temë shumë të ndishme për popullin shqiptar. Të gjitha këto vepra dhe shumë dokumente tjera të cilat do t'i përmendim në këtë shkrim janë të lidhura me marrëveshjen e Splitit

ndërmjet Titos dhe Kypriliut. Në këtë marrëveshje gojore, edhe pse askush nuk diti se çka përmbante, pasojat e sajë u panë menjëherë, pas fillimit të zbatimit policor. Në vitin 1953, filloi dëbimi masiv i shqiptarëve për në Turqi, gjë e cila e zbardhi këtë marrëveshje. Represioni serb u përcollë nga instrumentet shtetërore policore dhe në mënyrë të organizuar nga vetë shteti serbo - jugosllav. Paraprakisht ishte një marrëveshje në mes Jugosllavisë dhe Turqisë e njohur si "Konventa jugosllavo - turke e vitit 1938", e cila parashikonte dëbimin e shqiptarëve për në Anadoll. Çështja e shpërnguljes së shqiptarëve pothuaj se u heshtë, ndërsa u shkrua dhe u propagandua nga qarqet serbe, gjoja për shpërngulje serbo – malazeze, që në të vërtetë nuk ishte asgjë tjetër "historike", veçse migrime të vogla, të vullnetshme të popullsisë me probleme sociale e politike.

Thirresh në "Din e Iman". Nuk ka problem, vazhdo të thirresh në "Din e Iman" deri në varr, por mua nuk do të më kesh kurrë në xhami. Me siguri atje, të presin 70 gra në Xhehnet si "shehit" në Shtetet Arabe. Unë i kam mjaftë Tri në Shqipëri: Njëra të më pri para e Dy të tjerat më mbajnë për krahu për në Baba Tomor. Vendin e Perëndive. Ditën, që ti do ta shpallësh Xhaminë Shqiptare (?!), dhe do ta valosh flamurin kombëtar kuqezi anembanë Atdheut me

shqiponjën dykrenare në minare, ndoshta do t'i lutem Zotit para këmbëve të tua në xhami. Hë për hë, ne nuk jemi vëllezër e motra, por jemi armiq shekullor edhe përtej varrit, në Xhehnem.

Duartrokitje, Qeverisë së Republikës Kosovës: Mish i egër jeni në shoqërinë shqiptare. Kancer i rrezikshëm, që përditë tinëz lëshoni rrënjë në Shtetin Shqiptar. Veprim historik të cilin duhet t'i marrë masat për pastrimin e Shpirtit dhe Trurit, edhe Shteti Shqiptar. Nuk pres nga

IRJ e Maqedonisë. Momentalisht, këtij Shteti Njerkë edhe i duhen këto halldupë pët ta mabjtur veten gjallë edhe ndonjë ditë në mes të Ballkanit.

Kanceri është i rrezikshëm për një shoqëri qytetare përparimtare, shtet demokratik. Shqiptarët kanë fuqi dhe energji për ta hequr këtë sëmundje të rrezikshme nga shpirti dhe trupi. Vetëm u duhet guximi dhe fuqia Rilindase për të mbetur gjallë në jetë mes Ballkanit. Sëmundja, moti i ka lëshuar rrënjët, por i duhet terapia e mjekimit. Papa Gjon Pali i II, posa zbriti në Shqipëri e dha Porosinë Historike: E puthi Tokën Shqiptare. Porosia Naimiane, të cilën moti e kanë dhënë Rilindasit Shqiptar. Punë tjetër është ajo se, halldupët nuk kanë sy e veshë, nuk janë rritur me vargjet e Rilindasëve Shqiptar. Vallë, shqiptarët, a kanë mjekë specialistë për ta shëruar këtë sëmundje të shekullit?! Mendja ma thotë se, po një Ditë Historike. Vetëm, ju duhet guximi dhe burrat e mejdanit si në Kohën e Naimit dhe Çajupit për të hipur në Baba Tomor. Vendin e Perëndive. Tyrben ku pihet vera e lindë poezia. Dhe, bëhet dashuri.

Sëmundjet Natyrore dhe politike janë të shërueshme, nëse bënë luftë për jetë. Armën (penën) e nxjerrë nga brezi. Përndryshe, të pret varri…

NUSEN ME GJITHË FRANGA ARI E MORI "VËLLAI" I MADH

Shqiptarët, ende vazhdojnë të shpallin "Ilirida" nëpër katunde, qytete e Facebook. Vite më parë e shpallën edhe me referendum në Gostivar. "Guxim", pas një kohe morën ta shpallin edhe në Tetovë. Armët i nxorrën nga brezi kësaj radhe, e shpallën për së treti herë te "Kali' i dudumëve. Qytetin e qyqeve, ku Xhaxhi Kuqezi gjatë një fushate parazgjedhore hipur mbi një karrocë hamalli me megafon e shpalli "Shqiprinë Etnike".

Përçudi, shqiptarët ende merren me lugët dhe enët. Shtëpinë ia kanë lënë "Vëllait të Madh". Punemadhe, që e djegin edhe letrën e fundit në këtë lojë politike ("pishpirik"). "Xhandarët" i nxjerrin jashtë loje si bixhozxhi në Kazino. Fatin e zgjidhjes së Çështjes shqiptare e kanë vënë mbi tavolinë. Nguten, kush i pari të shpallë nga një shtet shqiptar në katund. Sot për sot, nesër do të nisin të shpallin "republika shqiptare" edhe nëpër lagje.

Merreni me mend, sikur Nevzat Halili me shokë të shpallte Shqipëri Etnike, para këmbëve të Skënderbeut?! Sheshi nuk do t'i nxente shqiptarët. E gjithë IRJ e Maqedonisë do të ngrihej më këmbë. "Vëllezërit", gurë e dru do të

hidhnin mbi shqiptarët se, nuk janë për "vëllazërim – bashkim" (bashkëjetesë). Policinë e Shtetit të "përbashkët" do ta nxirrnin në rrugë me shkopinj gome, armë të lehta e autoblinda.

Ilirida në Sheshin "Skënderbeu" u shpallë "republikë" pa asnjë polic me njëzetë – tridhjetë veta. Çfarë republike është kjo xhadi, ku nuk shkrepet së paku një fishek në ajër, nuk derdhet një pikë gjaku në fushën e mejdanit?! Ngjarje e këtillë historike, nuk ka ndodhur as në kohën e Turqisë, kur nga ballkoni në Vlorë e shpalli Pavarësinë e Shqipërisë Ismail Qemali. Ilirida, sot shpallet para këmbëve të Kalit të Skënderbeut pa luftë para kamerave televizive. Tekefundit, Kryetari i Iliridës të kishte hipur në një karrige. Burrit të botës së paku t'i kishin dhënë një megafon në dorë ta dëgjonte edhe Dudumi, në xhami. "Namazin" ta braktiste përgjysmë, thirrjes të Kryetarit të Iliridës t'i bashkoheshte me "xhematë për Vatan, Din e Iman". Nuk kërkojmë "salltanate" me lodra si e gjithë bota, që "Republika e Iliridës" të shpallet nëpër institucionet e Shtetit të "përbashkët" (Kuvend). Ose, siç thoshte Xha Cuti, kur e pyesnim ne hutaçët: pse nuk martohet, nuk e merr një grua në shtëpi?! Përgjigjen na e kthente plumb: shkaku se, kur u martua vëllai im me dasëm, edhe unë dhashë pak pare, kam hise. Njëjtë si me Pavarësinë e Shtetit të "përbashkët", në Amerikë.

Shqiptarët, vërtetë dhanë para me thasë, por mbetën pa grua. "Vëllai" i Madh e mori Nusen me gjithë franga ari dhe e futi në dhomë, Vëllain e vogël e la pas dere me gishta në gojë.

Gjysëm ore më vonë, pasi organizatorët e shpallën "Republikën e Iliridës" dhe u fotografuan krah për krahu para kamerave televizive, dolën dy policë nga qendra tregtare "Mavrovasja" dhe kaluan aty pari mos kanë hudhur "patriotët kuqezi" ndonjë pankartë ose letër të farave e kikirikave. Asnjë gjurmë nga "Republika e Ilirdës" para këmbëve të Kalit të Skënderbeut mes parkingut të makinave.

Shqiptarët, vërtetë janë të "dhunshëm" në protestat qytetare, ama në shpalljen e "republikave" janë paqësor, mos them pula. Nuk ua prishin qetësinë dhe rehatinë "vëllezërve" të Njerkës. "Vëllazërim - bashkimin" e kalitur tradicional, që nga koha e "artë" komuniste. Rrugës për në shtëpi, nuk shkulën asnjë dru, nuk shkelën asnjë lule, nuk kapërdisën asnjë kontenier bërlloku, nuk thyen asnjë xham. Gurë nuk hudhën as tek selia e BDI –së, në Serovë e as te Komuna e Çairit.

Porosia e "vëllezërve": O shqiptarë, dilni sa herë të doni dhe shpallni republika nëpër katunde e Facebook! Kufirin e dini, deri te "Mavrovasja". Asnjë ferrë nuk do t'ju hyjë në këmbë. Mund të dënoheni për thyerjen e xhamave të Gjygjit me

katër vjet burg dhe me mjete materiale, por jo edhe për shpalljen e "Republikës së Iliridës".

Punë tjetër është ajo se, nëse e shpallni Shqipëri Etnike, ku do të përfundoni si "patriotë kuqezi". Dihet, në burgun e Idrizovës. Ndoshta atje, do të mësoni edhe ndonjë zanat, merrni një diplomë universitare. Kutadish, ndoshta dilni si kuadër i ri i partive politike me përvojë pune disavjeçare. Rrufjanë me përgaditje të lartë akademike - policore. Ose, deputetë të popullit. Boksierë të kategorisë së rëndë, që kur të dilni në ring (Kuvend), nokautoni vëllain për një post në Qeveri, një torbë taxhi përqafe.

Dhe, do të mirreni gjithë jetën me "gjykime penale" se, gjoja e keni rrezikuar Shtetin e "përbashkët". Në Kuvend, jeni mbytur si qentë, përderisa "vëllezërit" u bijnë duarve dhe bëjnë Shtet, ju u mjafton një asht i hedhur në Qeveri. Herë pas here, u nxjerrin në rrugë me proçese të montuar e provokime policore. Nuk i djegin duart, kur i kanë mashat shqiptare në mesin tuaj familjar e parti politike. Kohën e fundit, "vëllezërit" e kanë ndërruar edhe metodën dhe stilin e provokimeve politike. Përmendore u ngrejnë në Shkup pa emra e mbiemra. E, këndej në anën tjetër ua ndërsejnë këlyshët e tyre me zgjebe duke i shpallur si përmendore shqiptare. Rasti i fundit me përmendoren e Nexhat Agollit, aqsa është ironik, është edhe tragjik për një popull

historik. Grep të cilin e gëlltitën pa përtrypë shqiptarët si peshku krimbin në hurdhë. Përmëtepër, edhe bëtë "selfie" me "heroin kombëtar" Sharllo Shatarov. Prapë një punë, kur emrin e tij nuk ia përplasët në ballë ndonjë shkolle shqipe, ose rruge në Bit – Pazar. Për së dyti herë e vratë Nexhat Agollin, në Shkup. Duartrokitët legalizimin e përmendores të "vëllezërve". Edhe njëherë dëshmuam para syve të botës se sa e njohim historinë shqiptare, dëshmorët dhe heronjt kombëtar. Nuk është çudi, kështu siç e kanë nisur "vëllezërit", që një ditë të na e hipin në kalë edhe Goce Dellçevin, t'i vënë një përkrenare në kokë dhe t'ia japin shpatën namëmadhe në dorë. Turr ne shqiptarët me të katra ta festojmë mirëseardhjen e "Skënderbeut" në Shkup për së dyti herë me mustaqet e Goce Dellçevit.

Interesant, seç ma kujtoni edhe një histori të dhimbshme të vendasëve të mi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Punëtorët që thyenin gurë me dinamit në Bigor – Dolencë të Kërçovës. Shpërthimet e njëpasnjëshme mes maleve, që i dëgjuam për sherr si gjyle të topave. Xha Deharin, që e përhapi nëpër Katund se, vjenë Shqipëria. Trimat rrëmbyen armët dhe e shkatrruan Komunën e atëhershme në Oslome, ia vunë flakën. Papritmas, hordhitë barbare të armatosura deri më dhëmbë, iu sulën fshatit si

hakmarrje, i zgjodhën rreth njëzetë burra të pafajshëm dhe i masakruan në mesin e dëllnjave. Vendi edhe sot e kësaj dite, thirret "Te të vramët". Xha Deharin, ne fëmijët kur e takonim në rrugë i thirrnim pas shpine: Xha Dehar, "Luftë du"! E, ai i zemruar me atë ngjarje shtazarake na përgjigjej: Pritni aty, he nënën e nënës t'ua tregoj qejfin plaku! Hë, plasni: "Luftë du"! Shkopin e ngrente në dorë duke bërtitur rrugës si i çmendur, na trembëte të ikim mos na zë dhe na ndiqte deri te porta, ku ne nga frika strukeshim në lëmë, pas gardhit.

Ditën e nesërme e shihnim Xha Deharin duarlidhur në mesin e dy xhandarëve drejtë stacionit të policisë, në Kërçovë. Kokat i nxirrnim pas portave dhe i jepnim guxim: Xha Dehar, "luftë du"! Plaku, kësaj radhe nuk na ndoqi me shkop, por me buzëqeshje, atë thirrjen e tij kryengritëse: "Luftë du"! Hë, plasni hutaçë! E dinte, se pasi ta fusnin në podrum dhe t'i jepnin një dru të mirë plakut, përsëri do ta lëshonin në shtëpi.

Shpallja e "rebublikave" nëpër katunde, sot sa u gjason atyre ngjarjeve historike?! Metodave dhe provokimeve policore të asaj kohe qorre. Aferave të armëve. Ngjarjeve të Bit –Pazarit. Heqjen e flamurit, në Gostivar. Rastin "Monstra"… Dje me dy sy në ballë, e sot me një

sy na ndjek Qoftëlargu, siç e ndiqte dikur Ismail Qemalin historia.

Dhe, përderisa shqiptarët shpallin "Ilirida" edhe nëpër katunde, "Vëllai" i Madh e mori Nusen me gjithë franga ari përqafe në shtëpi. Vëllain e vogël e la pa hise (pasuri të tundshme) pas dere me gishta në gojë…

"BAJRAM" ME GOCE DELLÇEVIN DHE NIKOLLA KAREVIN

Lopës i ka hije t'i kërcejë në shpinë mëzati në livadh. Vetëmse ,jo, edhe Xhadisë kur e lëvizë bishtin, posa delë matanë portës, në rrugë. E sidomos, kur kokën e ka ende në grazhd. Përmëtepër, kur e heq veten si shterre në Facebook. Nateditë shëtitet livadheve, dhe viçat e palëpi pasmesnate na i flukë pas porte.

Edhe, viçat e palëpi pëllasin në kupë të qiellit për tambël gjiri. E kërkojnë taxhinë. Zgjedhën në qafë. Qerren ta tërheqin nëpër Katund. Bujku nuk ngutet, para se t'ua hedhë zgjedhën në qafë, i tredhë. I bënë qe zgjedhe, kafshë të buta. Arat t'i lërojnë me pllug. "Vendasi im" anonim, përpiqet t'u qesë kashtë në stilin tim satirik me të njëjtin fjalor "artistik". Kafshëve të buta, që ato plasën pas barit të kositur në Livadh. Papritmas, tërbohet dhe më ndërsehet pas shpine me lehje këlyshi me zgjebe te porta:

Kërçova në 02/10/2014 11:35:06

Eh Kalosh trapi e trusakati,
S'di më se ç'po flet i ngrati

Bën bajram me vetveten
Budallëqet s'po i treten

E rren veten se është dikush
Por ama shkon si qeni në rrush

Publikisht, kërcnohet Viçi i palëpi. Fajin, nuk e ka mëzati i tredhur, por kau me zgjedhën në qafë, që nuk mund t'i kërcejë si dje në shpinë shterres. Tekefundit, pak ta përlagë, rrokullisë bythekrye matanë gardhit. I shkreti, gjithë ditën e gjatë lëron arat me pllug rrëzë Çukës, dhe kur kthehet në shtëpi e merr gjumi. Gërhet dhe sharron gjithë natën e gjatë shelgje në livadh. Xhadisë, tek tashti i delë gjumi dhe i kërcen mëzatit tredhur në shpinë me dy këmbët e para te pragu i derës. Shkaku se, gjithë ditën e lume është rrokullisur në grazhd mes krundeve. E kërcen gardhin. Dhe, hazdiset nëpër botë pas barit. I harron viçat e palëpi livadheve. Ndonjërin me kokën në grazhd. Tjetrin, me një torbë taxhi përqafe duke pëllitur nëpër Bit - Pazar.

Populli shqiptar e ka një thënie antologjike: Lopa kur hiqet në mes të livadhit, e kërkon mëzatin. Papritmas, i kërcen në shpinë, e provokon t'i dalë në dyluftim. Punë tjetër është ajo se, a kemi ne mëzetër ende të patredhur me herdhet si vorba deri në fund të këmbëve. Ose, kush e kullotë këtë shterre të hazdisur te Çifliku i

Xha Derallës?! Mëzatin pas shpine ia ndërsen te Përroni i Thanës. Hë për hë, si shterre qyteti me rruza përqafe e për këmbe, ta palojë këmbekrye bashkë nën hijen e Lisit midis Livadhit. Shterre, që pasi e ka kapërcyer gardhin me thupra shelgu, qetë me shqelma. Përditë e përnatë i thotë mëzatit se, e do shumë si burrë azgan livadhi. Përderisa, një ditë ai nuk e provon dashurinë e shterres në një dasëm me lodra e dajre në kojshi.

Shterrja e këtij soji, edhe gjatë kohë do ta përdredhë bishtin pas mullarit me barë, përderisa nuk delë një mëzat katundi, kokën t'ia rrasë në kashtë. Rraçet t'ia nxjerrë për mejdani në qiellin e hapur mbi kokë. Natën hëna t'i bëjë dritë e ditën dielli t'ia rreshkë "bereqetin" mes fushës me tërfojë nën një Dardhë gorrice. Djersët t'i shkojnë në fund të këmbëve. Palojë si një pashterkë të kuqe me pala në arkë mbi varrin e Baba Shehut në Tyrbe. Këmishën e bardhë deri në fund të këmbëve t'ia hudhë mbi kokë. Vit për vit të lënurë lesh arapi te mulliri në breg të Lumit Zajazit. Nateditë t'ia përzë xhindet në Tyrbe. Zëri nga thirrjet për ndihmë t'i shkojë për qielli.

Çajupin e Ri të arratisur në Baba Tomor, Malin e Perëndive. Tyrben ku pihet vera, lindë poezia… Dhe, bëhet dashuri, ta thirrë në ndihmë me një poezi:

"Gratë" nën hije, lozën kuvendojnë

Pika që s'u bie, se nga burrat rrojnë.

Duartrokitje frenetike. Xhadia tashti, më nuk do ta kërkojë një mëzat me brirë në Facebook, po një ka zgjedhe, ulë bishtin mes Livadhit. Krah për krahu me Lopën e Katundit edhe kullosë bar rrëzë Çukës. Zekthin mos ta ketë frikë, kur i turret përmbrapa ditëve të verës me vapë. Bishtin në krah ulë nën hije të Mollës verore. Nënës Madhe, kusinë ia mbushë plot me tambël në mes të Lëmës.

"Bojrum", provoni kulloshtrën time për "Bajram". Nusja e Kaut tim kullotë bar te Livadhi i xha Nefruzit. Vëllai im te Çifliku i Xha Derallës. Motra ime i bie dajres dhe e ruan Xhenazen për dy shtëlluga leshi, përderisa Nusja me pashterkë të kuqe e heq vallen në dasëm me këngë e dajre: *Në ta jap, moj nane/ si s'ta jape - jo.* Kulminacioni i dasmës*:* Edhe, *pordhë Xhenazja moj nane/ si nuk pordhe – jo…*

Kryevepër artistike me të cilën do të kreneheshin edhe "artistët" e dalldisur të Tun Batunit. Nuk e kam fjalën këtu për "maxhatoret" e Bit – Pazarit nga Shkupi, që si gjithmonë edhe këtë "Bajram" ndanë "bakllava" me tepsia në kokë për "vëllezërit" te sheshi "Maqedonia" para këmbëve të Kalit të Aleksandrit Madh, i rrethuar me luaj që nateditë vjellin ujë, e jo para këmbëve të Kalit të Skënderbeut pa asnjë shtambë uji, si

"tradhtar". "Bajram" edhe këtë vit nuk bënë me Skënderebun, por me Goce Dellçevin e Nikolla Karevin (Gruevskin). Skënderbeut, në parkingun e makinave i kanë shpallë luftë krah për krahu me "vëllezërit". Rrugë nuk ka për në male ta shpërthejë rrethimin. E vetmja dhiare i ka mbetur ajo te Shadërvani, pas Rrapit në Kala.

Skënderbeu është burrë legjendar i kalave. Politikanët shqiptar, nëse ende nuk e hipin në kala, një ditë ndodhë ta nxjerrë shpatën nga brezi. Kokat si cungje shelgu t'ua flukë kalorësve të arratisur para këmbëve të kalit. Hë për hë, Skënderbeu e ka futur shpatën në brez për paqe në mes të makinave, përderisa komitët më këmbë e mbi shpinë të kuajve me këmbët në "hava", i kanë nxjerrë thikat dhe pushkët për luftë para institucioneve të Shtetit "përbashkët". Në prag të "Bajramit" e festuan edhe ardhjen e përmendores të Sharllo Shatarovit. Pasmesnate, fshehurazi shqiptarëve e shtinë në qytet si Kalë Troje. Portën Triumfale ua hapi krah më krah politikanëve të shashtrisur, që në emër të popullit përmes tenderëve blejnë place qeveritare për ndërtimin e hoteleve luksoze në stilin barok. Tinëz e pushtojnë Kalanë Dardane jo si politikanë, por si biznesmenë, përderisa shqiptarët dalldisen ta luftojnë me gurë ndërtimin e Kishës në Kala para kamerave televizive. Car Dushanin, në breg të Vardarit ta "rrëzojnë" me çekiç shelgu. Gojën

plot them, mirë e kanë "vëllezërit" e Njerkës: Dudumëve sa më shumë t'u japësh dajak, ato aq më tepër të duan si kojshi gardhi, gostisin me ëmbëlsira. Sofrën e "Bajramit" ta shtrojnë me 'bakllava" te Sheshi "Maqedonia".

Përgëzime "xhematit" të Kodrës Trimave (Prishtinë), që këtë "namaz të Kurban Bajramit" e falën me kësula të bardha në kokë dhe veshje kombëtare sipas traditës shqiptare. Kësulë të bardhë të cilën e kishte në kokë edhe Hoxha i veshur me kostum tradicional shqiptar. Hoxha ishte ai që bëri thirrje: "xhemati" të kujtojë traditën shqiptare në festën e Kurban Bajramit. Shembull, të cilin duhet ta ndjekin hoxhallarët shqiptar anembanë Atdheut, shpallin Xhaminë Shqiptare me flamurin kombëtar kuqezi në minare.

Viçin e palëpi na e polli Xhadia në grazhd të Kalit: "***Çohu Rexho, çohu djalo/ se, nuk ka Nana tjetër –o! Çohu ma i miri Nanës –o***!…

SHPALOSJA E FLAMURIT HISTORIK NGA "NIPI" XHA DERALLËS

Përderisa, Partitë Politike Shqiptare në pushtet luajnë rolin e Arushës me dajre, populli ende gjatë kohë do të përpëlitet në pelena. Vaji në djep do t'i shkojë për qielli. Nënës do t'i shteret gjiri. Tambël nuk do të ketë t'ua ndali lotët rrëke nëpër faqe. Përditë, pas zgjedhjeve lokale e parlamentare do të shpallim "fitore e Republika të Iliridës", para këmbëve të Skënderbeut me shpatën në brez. Vit për vit do të organizojmë manifestime kulturore sipas "arshinit" të partive politike në pushtet. Emërojmë anëtarë të komisioneve nëpër ministri, partizanët e tyre gjysmanalfabetë. Nëpërkëmbim manifestimet kulturore tradicionale ndërkombëtare, që kanë lënë gjurmë në kulturën shqiptare. Arsimin shqiptar, që të parët tanë nëpër shekuj kanë hedhur farë ugareve me hebet në krah.

Rrugaçët "kuqezi", i hurit dhe litarit do të merret edhe me kulturë dhe arsim shqiptar. Përbaltin arsimin dhe kulturën shqiptare deri në palcë. Ditenatë do të enden rrugëve të Bit – Pazarit, dalldisen pas Arushës me dajre. Maxhupi e heq me litar për dore dhe i bie dajres. Arusha heq valle duke i përdredhur vithet para Kalit të Skënderbeut. Kryengritësi përgjumshëm me

gjithë "vorba", gati i ka hyrë në bark. Krah për krahu si "dëshmorë" lufte fotografohen para kamerave televizive.

Përçudi, kohën e fundit as fëmijët më nuk i turren përmbrapa plot pordhë e piskamë. Duartrokisin për "vallen kombëtare" nëpër Bit - Pazar. Mëkot, Maxhupi i bie dajres. Përpiqet publikun ta mashtrojë me muzika. Përdridhet e hidhet me shami me vallen e mirënjohur popullore të "vëllazërim – bashkimit". Sokaqeve t'i mashtrojë me bozë e qofte te "PÇELA" (BLETA) e bozë te "Libraria e Çarshisë". Asnjë fëmij kurreshtar nuk i turret nëpër Çershi duke i mbajtur brekët me dorë. Duartrokitë në rrugë Arushës me dajre. Vallen e këtij soji e njohin moti kohë. Arusha me dajre i la pa brekë. Tekste shkollore. Lektyra shkollore. Revista për fëmijë.

Problemi: Arusha me dajre nuk sjellë risi në vallet populllore shqiptare. Përmëtepër, vazhdon t'i heq vallet popullore të "vëllazërim – bashkimit", porositë pioniere të "harxhuara" të shokut Tito. Veprat "artistike" e pedagogjike të trusakatëve. Poashtu, të njëjtët vallëtarë me tirqit nëpër këmbë, që mezi i lëvizin këmbët e bythët në politikë. Shumica edhe nuk kanë "haber" nga vallja popullore shqiptare. Maxhupi i bie dajres, e ajo hidhet e përdridhet si "hojdodole" nëpër Bit - Pazar. Përfundimi: Maxhupi e mbush torbën me miell, e fëmijët mbesin me gishta në gojë te pragu

i derës. Edhe këtë vit shkollor ta nisin pa çati mbi kokë: derë, dritare pa xhama e dru zjarri në Dimër.

Punemadhe. Rilindasët tanë moti janë ulur këmbëkryq te pragu i derës Shtëpisë. Ali Asllani për çdo vit në Manifestimin Kulturor Tradicional Ndërkombëtar, Ditët e Humorit dhe Satirës: XHA DERALLA me poezinë satirike: ***Hani, pini dhe rrëmbeni***:

Që nga Korça gjer te Shkodra mbretëron një errësirë,
nëpër fusha, nëpër kodra, vërshëllen një egërsirë!
Pra, o burra, hani, pini, hani, pini or' e ças,
Për çakallin, nat' e errët, është ras' e deli ras'!

Hani, pini dhe rrëmbeni, mbushni xhepe, mbushni arka,
të pabrek' ju gjeti dreka, milionier' ju gjeti darka!
Hani, pini e rrëmbeni, mbushni arka, mbushni xhepe,
gjersa populli bujar t'ju përgjigjet: peqe, lepe!

……

Po një dit' që nis e vrëret do mbaroj' me bubullimë,
ky i sotmi zër' i errët, benet vetëtimë
dhe i bije rrufeja pasuris' dhe, kësi lloj,
nuk ju mbetet gjë në dorë, vetëm një kafshit' për goj'!

A e dini që fitimi brënda katër vjet mizor'
nuk ësht' yti, nuk ësht' imi, është i kombit arbror,
ësht' i syrit në lot mekuar, ësht' i vëndit djegur, pjekur,
Ju do thoni si të doni… po e drejta dermon hekur!

Dhe, me këto vargje satirike të poetit Ali Asllani, populli shqiptar një ditë do ta përzë nga Bit - Pazari Arushën me dajre. Krah për krahu me poetin Pano Taçi me poezinë nën Rrap: ***Na bashkoi Rrapi***. Lufta vazhdon me penë. Poetët, që ju mendoni se i keni marrë nëpër këmbë, një ditë do t'ju varrosin të gjallë me vargje në histori. Njeri rruge nuk do të gjëndet të ju shpie as në varr, përveç Hoxhës Allahut i dehur me çaj rusi e tespihe kuqezi nëpër Bit - Pazar. Nateditë duke bërtitur për "ndryshime" politike si Dexhalli me kokën në xhami e palarenë në polici.

Lufta vazhdon me penë e poezi në Shkup e Kërçovë. Poetët anë e mbanë Atdheut dhe bota përparimtare i kanë nxjerrë vargjet nga brezi. Tymeflakë e shkrepin penën me dy tyta. Ora simbolike letrare me poezinë e "egër" tradicionale të Manifestimit Kulturor Tradicional Ndërkomtar: TAKIME NËN RRAP e shkrep vargun. Him Koça me poezinë e Pano Taçit *Na Bashkoi Rrapi*. Xhelal Tosku me dy "sejmenë" përmbrapa: Sami Velçanin e Pëllumb Mane të armatosur deri në dhëmbë me poezi. Plumba, që "xhihadistët" nuk duan të vriten nga dora e një gruaje, vdesin si jo "shehit".

Armë shkrepin edhe: Rushit Ramabaja krah për krahu me Avni Deharin e Nebi Bunjakun. Dashnor Selimi me Michel Dërvishi nga Selaniku. Fatmir Minguli, Jokida Mati, Nikolla

Spathari e Vladimir Muça nga Durrësi. Vahit Nasufi me çetën e tij nga Drinia: Besnik Lena e Xheladin Muça. Behare Rexhepi e Reshat Sahitaj nga Prishtina. Fadil Curri me dy kaçakë të penës nga Shkupi: Sami Sherifi e Rexhep Bajrami. Remzi Salihu, Rami Kamberi e Bujar Plloshtani nga Tetova. Delvina Kërluku e Nuri Koleci nga Dibra. Dhimitër Orgocka me Edmond Xhaxhollin e Skënder Demollin nga Korça. Mariana Shkurti me Festim Tomorrin e Ilir Shytën nga Poradeci. Istref Haxhillari e Bujar Balliu nga Lini, në breg të Liqenit. Nehas Sopaj, Sermet Sulejmani e Arben Ibrahimi u vjen në ndihmë nga Kumanova. Xhelal Ademi nga Zajazi, krah për krahu me Him Koçën, Adem Xheladinin, Xhevdet Ukallin, Ahmet Morën, Begzat Rrahmanin e Xhemile Adilin me gra e burra u bënë konak. Vesel Xhaferri - Çeliku me kësulën e bardhë të Bajram Currit erdhi vetë i dyti nga Zvicra.

Rrethimi poetik, u bë në Kërçovë (Kalanë e dytë të Skënderbeut). Vendlindjen e kaçakëve të Zajazit. Mauzerri i dikurshëm, kur sot është zëvendsuar me penë. E shkrep vargun në Lepurushkë, e ajo le të dali Arushë. Alarmin e jep kantautori Ferid Abdiu: *Të pret Poeti*. Dervish Dervishi me të Birin me këngën e mirënjohur të këngëtarit kërçovar Rexhep Zajazi: *Në bahçe na ka ra bryma*. Armët i nxjerrin nga brezi poetët

duke e pritur agimin me poezi, këngë e valle në mes të Kërçovës.

Ditën e Nesërme, poetët dhe dashamirët e artit nisen për te Muzeu i Luftës Dytë Botërore, rrëzë Kalasë të Kërçovës. Pusi u ka vënë me ekspozitën figurative *Ballkanika*, mësuesi dhe piktori kërçovar Ramadan Ramadani - Ballazhi. Sofrën e ka shtruar si shqiptarët: me bukë, kripë e zemër. Padashtas, ma kujton një vetaran tjetër të arsimit shqiptar, mikun e tij Hajrullah Ukallin, që një pjesë të jetës e kaloi edhe në Amerikë. Kohën, kur fëmijtë e tij në Kërçovë i kërkojnë para që të hyjnë në shtëpinë e re si shkiet. E ai, u përgjigjet nga Amerika: unë nuk kam para, por ju hyni si shqiptarët!

Rruga poetike vazhdon për në fshatin Cërvicë, vendlindjen e Xha Derallës. Katundin, ku njëqind vjet është ruajtur i fshehur në arkë flamuri shqiptar plot plumba në gjoks me të cilin mësuesi i fshatit Lajq Prençi nga Shqipëria, krah për krahu me nxënësit e tij, në Ditën e flamurit (28 Nëntor, 1942), u nisën me lodra, cingana e valle duke kaluar nëpër fshatin Strellcë e vazhduar nëpër Shutovë për të festuar Ditën e flamurit në fshatin Premkë, rrëzë Çelëvjollcës. Mësuesi atë ditë eci me guxim heroik drejtë zyrës së togerit të policisë italiane dhe me duart lakuriq sulmoi togerin duke u munduar t'ia rrëmbejë revolen nga brezi. Dyluftim heroik, ku si vetëtimë

nga qielli, mësuesit trim i vjen në ndihmë një fshatar nga fshati Shutovë me thikë në dorë duke e lënë togerin të vdekur përtoke. Mësuesi me "nagantin" e togerit në dorë, sa herë qëllonte nga një karabinierë e rrokulliste të vdekur në tokë. Ditë historike, kur mësues e nxënës me ndihmën e fshatarëve e shkatërruan stacionin e karabinierëve, në fshatin Premkë dhe me flamurin kuqezi shqiptar në gji me gjithë nxënës u kthyen krenarë në fshatin Cërvicë.

Pronari i lokalit, Feto Dauti për mikpritje e nxorri nga arka flamurin kuqezi shqiptar dhe e shpalosi për herë të dytë para poetëve. Plaku i katundit, Skender Xhaferri, por jo ai plaku i Katundit që në kohën e Xha Derallës i shëtiti gjithë natën nëpër Katund xhandarët e serbit, e duke zbardhur agimi mbi Çelvjollcë më në fund i dërgoi te porta, rrëfen për historinë e flamurit që është ruajtë me frikë në arkë gati një shekull.

Sofrën poetike në fshatin Cërvicë me anekdota, barcoleta e poezi e përcjellë matanë malit, "nipi" i xha Derallës, Skënder Demolli nga Korça. Xhelal Tosku, dihet me dy "sejmenë" përmbrapa. Nikolla Spathari me barcoleta. Avni Dehari me një "vëlla" tjetër të Xha Derallës nga Kumanova. Rushit Ramabaja nga Kosova.

Poetët deri te porta i përcjellë pronari i lokalit, Feto Duti krah për krahu me Kryetarin e Bashkësisë Lokale të fshatit Cërvicë, Skënder

Xhaferri - Çeliku me një porosi: Burra, bini rrugës të Xha Derallës nga i shëtiti gjithë natën xhandarët e Serbisë për të dalë nga fshati në Kërçovë. Karavanit poetik, i pri Him Koça dhe na shpie te simboli i Pavarsisë Shqipërisë, në fshatin Garanë. Poetët pasi u fotografuan, u nisën për në Kërçovë, restrorantin hotel "Kiçevo", ku më u ishte "ftohur" moti dreka.

Natën e Madhe, poetët dhe dashamirët e fjalës shkruar anembanë Atdheut i përshëndeti duke u dëshiruar mirësesrdhje edhe Kryetari i Komunës Kërçovës, z. Fatmir Dehari, ku mes të tjerave edhe tha: miq të nderuar poetë, përfundoi koha e kryengritjeve me pushkë. Luftën duhet ta vazhdojmë me penë! Shqiptarët sot duhet t'i rreken arsimit dhe kulturës! Themeleve të një shoqërie. Shteti. Dhimitër Orgocka, regjisor i

mirënjohur shqiptar lexoi poezi të "egra" nga Kalosh Çeliku dhe Xhelal Ademi. Edmond Xhaxholli me kitarë një "mishmash" me poezi e serenada korçare. Dikur, u bë edhe përurimi i librave: *Zjarr e flakë* (poezi) i Shaqir Sadikut, *Pretenca* (roman) i Istref Haxhillarit, *Çapini* (dramë) e Nehas Sopaj, *Lirika me Hënë* (poezi) i Vahit Nasufit dhe Venela 2 (dramë, për heroinën Sulltanë Qafa) e Vesel Xhaferrit. Për librat në fjalë shprehën vlerësime artistike: Fatmir Minguli, Sermet Sulejmani, Ilir Shyta e Rami Kamberi.

Pasmesnate, nën përcjelljen e tingujve të kitarës, juria profesionale e përbërë nga Fatmir Minguli (kryetar), Fadil Curri dhe Kalosh Çeliku (anëtar) i ndau edhe çmimet letrare: Çmimi letrar *"RRAPI"* për vepër jetësore i takoi shkrimtarit nga Kosova Reshat Sahitaj, *"E përcolla Natën"* për vepër erotike botuar gjatë dy takimeve poetike, Dashnor Selimit, dhe *"Ulu mal të dalë Hëna"* për poezi, Sami Sherifit nga Shkupi. Juria ndau edhe dy çmime speciale letrare: *"Mikja e Rrapit"* i takoi poetes kërçovare Xhemile Adili dhe "Miku i Rrapit", Xhelal Toskut: Dy shtamba me verë.

Përgëzime, në një sofër të shtruar miqësore kërçovare! E pritëm agimin me poezi, këngë e valle. Dielli me rreze mbi Çelëvjollcë zbriti më këmbë maleve…

VIII HESHTNI SE UJKU TROKET PAS DERE

PËRFUNDIMI I "NDESHJES SPORTIVE" ME "DRON" PËRTOKE NË TIRANË

Duartrokitje për shqiptarët! Mund të themi se, më në fund u mësuan të bëjnë politikë madhore. Edhe atë, zbresin topin ("Dronin") në tokë. Nuk ka rëndësi se, kush i mësoi në Ditën e sotshme historike: koha, nevoja apo historia që u rri mbi kokë nateditë. Realiteti është se, grepin e hodhën në lumë vetëm me një krimb. Peshku i "artë" (Serbia heroike) e gëlltiti dhe doli vullnetare në sipërfaqe të përpilitet në zall pranë bregut lumit të rrezitet në diellin me rreze. Pashkatari ia hoqi grepin nga goja dhe e shtiu në strajcë t'ua shtrojë shqiptarëve për darkë.

Aspak, nuk mund të pajtohem me disa "analiza" të shqiptarëve se, "karremi i serbëve (përfundoi) në gojën e shqiptarëve". E gjithë bota e pa çmendurinë e tifozëve të tërbuar serb me brohoritje fashiste: "Vritni shqiptarët, edhe vëllazërit e tyre kroat!" Askushit, nuk i shkoi ndërmend se, në stadium nuk ka qenë i gjithë populli serb. Gjithë populli serb nuk ka marrë pjesë edhe në dëbimin, përdhunimin dhe masakrimin e shqiptarëve nga Kosova (1998/ 99), por politika e tyre shoveniste shkurtpamëse, që

nuk ka parë asgjë më larg se në Lëmë. Prandaj, shqiptarët duhet të marrin frymë, ulen në një cung lisi te pragu i Shtëpisë. Koha është, të ecin me kokën në qafë e jo me këmbët në krah ugareve. Tjetër punë është ajo se, sot edhe koha punon në favor të shqiptarëve. Patjetër, të ulen në tavolinë për bisedime me serbët. Mosmarrëveshjet historike t'i zgjidhin me dialog dhe bisedime politike. Vërtetë, ndarja "vëllazërore" është e dhimbshme: Kosova Republikë, por këtë e imponojnë ligjet e Natyrës në Ditën e sotshme. Nuk ka fuqi asnjëri popull, që t'i ndalë në vend këto proçese të lindura natyrore. Shkaktarin e tyre strategjik: Amerikën dhe Bashkimin Evropian. Tekefundit, Kryeministri i sotshëm, z. Edi Rama si ish Kryetar Bashkie i Tiranës ka bërë mjaftë "vepra patriotike" për serbët si kojshi. E meriton "Çelësin e Beogradit". Shkaku, se: "Çelësin e Tiranës" (2006), vite më parë ia dha këngëtarit serb Goran Bregoviç. Në një Panair të librit në Tiranë, serbët na "gostitën" edhe me "tymin" dhe çofte Beogradi. Kohën e fundit, këngëtari serb Zdravko Çoliç u pritë në Tiranë si "Mbreti Dytë" i Shqipërisë. Edhe borxhe të tjera, që i ka Kryeministri "shqiptar" serb z. Aleksandër Vuçiç, Kryeminstrit të Shqipërisë z. Edi Rama. Shqiptarët, kudo nëpër botë kanë vëllezër e motra. Shumicën e politikanëve edhe me prejardhje shqiptare. Moti kohë, me prejardhje

shqiptare, "patriotët kuqezi" e shpallën edhe Sllobodan Millosheviqin. Kasapin e Ballkanit, që shqiptarët e Kosovës pasi i përdhunoi me gjithë familje i shpërnguli në IRJ të Maqedonisë, Shqipëri dhe nëpër botë. Mijëra të tjerë i masakroi në Kosovë e Serbi, të cilëve edhe sot e kësaj dite nuk u dihet as varri. Ku ta di unë, ndoshta, edhe ai ka merita për Ditën e sotshme historike shqiptare?!

Vëllezër janë të lindur të një nëne e babe nga gjaku, por një ditë vjen koha që të ndahen si familje. Shtëpinë, edhe pasurinë ta ndajnë përgjysmë sipas zakonit e traditës brez pas brezi. Mosmarrveshje, nuk duhet të kenë për lugët dhe enët. Përmëtepër, kur me shekuj kanë prëzier edhe gjak si "vëllezër" nën një çati. Nuse kanë dhënë e marrë me lodra e muzika në shtëpi. Dasëm të madhe kanë bërë në kohën e "artë" komuniste të "vëllazërim – bashkimit". Fjalën nuk e kam këtu për dashnoret politike serbe e shqiptare, që i merrnin si dhuratë e shpërblime funksionerët shqiptar e serb, dhe as për djemtë e vajzat e tyre në Beograd e Shkup, por për punëtorët e krahut në Serbi. Sharraxhinjtë e Esad Mekulit: "O vëlla me sharrë në krah". Shqiptarët, që përveç gruas legjitime në Katund, e merrnnin edhe nga një grua ilegale serbe. Fëmijë bënin në Katund, fëmijë bënin edhe nëpër Jugosllavi. Dhe, ne shqiptarëve nuk na vranë, dhunuan e përzunë

nga Kosova serbët, por djemtë tanë që i "mbollëm" si kanabis Llazarati nëpër Serbi.

Ngjarja politike që ndodhi në Beograd, trumbetoi sesa e brishtë është paqja e arritur në Ballkan dhe se, sa pak i duhet për ta rikthyer në pozicione të shekullit të kaluar e në retorika të një kohe qorre. Zgjimi i "djemëve" tanë në stadiumin e Beogradit. "Dronin", që ndoshata ndonjëri prej tyre e ateroi në mesin e lojtarëve, në fushën sportive të futbollit. Pamëdyshje, ishte hapi i Pajtimit historik mes dy popujve, që pritet të ndodhë pas 100 vjetësh, qysh prej fillimit të Lufëts së Parë Botërore në Ballkan, duke e bërë që 2014 – ta të jetë viti i parë i historisë sonë të përbashkët pa kufinj politik në konflikt, i cili është shumë herë më i madh se incidenti i një ndeshje futbolli. Arene sportive, ku tridhjetë mijë vetë ulurinin papushim me brohoritje: "Vritni shqiptarët! Vritni vëllezërit e kroatëve!" Ndoshta, edhe me arsye, ku ta dimë ne si baballarë të kombit shqiptar e serb?!

Fatkeqësia e një populli, Presidenti dhe qeveria serbe u sollën si tifozët e tyre përmes retorikës së vjetër çetnike ndaj shqiptarëve. Dhe, pavetëdije e hëngrën karremin politik. "Dronin" e ateruar në stadiumin e Beogradit me hartën e "Shqipërisë Madhe". Gogolin, me të cilin politika serbe herë pas here e tremb popullin e vet, sa herë

që është në krizë politike. Qebesa, edhe Evropa e përdorë këtë kartë si "rrezik" për Ballkanin.

"Shqipëria e Madhe" nuk është projekti i shqiptarëve, njësoj siç nuk është as pëlhura e ngarkuar me simbole kombëtare shqiptare e prapavijë të zezë, që papritmas u shfaq mbi stadiumin e Beogradit si flamur shqiptar. Aspak nuk është faji i shqiptarëve, që jetojnë në trojet e tyre etnike në kaq shtete të Ballkanit, por i politikës së dikurshme të superfuqive botërore, që i coptoi pamëshirshëm si me sëpatë duke i lënë jashtë Nënës Shqipëri. Gabim historik, që në Ditën e sotshme pritet ta përmisojë Evropa paqësore në Bruksel, ose fshijë përgjithmonë nga faqja e Dheut me gomën politike.

Shqiptarët, kurrë nuk kanë qenë shkaktarë të luftës e të pastrimive etnike, apo të ksenofobisë, por kanë investuar për paqen e stabilitetin në Ballkan. Edhe në Shqipëri, edhe në Kosovë, edhe në Mal të Zi, edhe në Luginën e Preshevës, edhe në Çamëri. "Shqipëria e Madhe" është një përrallë patetike serbe, që e përdorin armiqtë e popullit shqiptar, sa herë që duan ta trembin popullin e tyre kryengritës për pushtet: Heshtni dhe rrini urtë se, Ujku me këmbën e lyer me miell, troket pas dere!

Populli shqiptar ka nevojë për Bashkimin Evropian, e jo për Ballkanin si një bure baruti i mbytur në urrejtje e gjak deri në fyt. Shtegu i

vetëm për të dalë nga kriza politike shekullore, sot mund të tejkalohet me dialog politik, biseda miqësore kokë më kokë pa hartën e copëtuar të Europës përpara mbi tavolinë dhe gërshërët (thikën) e Kasapit të Ballkanit. "Droni" i vogël simbolik, që nisi të zukasë në stadium mes Beogradit, qe vetëm një paralajmërim i kohës Nesërme. Poshtë tij me një copë pëlhure të zezë me hartën e Shqipërisë Madhe", mes dy baballarëve të Pavarësisë të Shtetit shqiptar: Ismail Qemali dhe Isë Boletini. Shqiponjës dykrenare si pararoje.

Punemadhe, që në Ditën e sotshme edhe shqiptarët kanë plotë "patriotë nacionalistë kuqezi" me thasë, dhe u turrën kush i pari ta marrë mbi vete lëshimin e "Dronit" në stadium, kryeqytetin e Serbisë. Përpak, edhe të vriten me grushta mes vete si "patriotë kuqezi" para kamerave televizive. Përçudi, analistë shqiptar dhe botëror ende merren me këtë "fenomen shqiptaro - serb", moti të harxhuar pa varr, kopilin që dikush në mes të ditës ua la pas dere. Kohë humbin dhe dalldisin duke mbushur hapsirat e emisioneve televizive nateditë. Pavetëdije se, qëllimi politik është arrirë, pak rëndësi ka se, kush e hudhi karremin: "Ballisti" i Kosovës, "Shferceri" i Shkupit, apo vëllai i Edi Ramës?! Edhe, nga cili vend e kurdisën "lodrën artistike politike": këmbana e kishës apo hoteli

"Feriti", në Beograd. Fitorja historike "sportive" është shumë e rë**n**dësishme: serbët pa vetëdije e gëlltitën grepin vetëm me një krimb të shqiptarëve. Pavetëdije, e zhveshën veten lakuriq para syve të gjithë botës. Dhe, e përsëritën njëzëri atë thënien e tyre historike shekullore, se: Serbët historikisht fitojnë në luftë, por humbin në ditë paqe.

Politikanët shqiptar, edhe nuk duhet të merren shumë me këtë "Dron" që fluturoi me "flamurin shqiptar" mbi stadiumin e Beogradit, por me bisedimet që do të zhvillohen kokë më kokë mes dy kryministrave, atij shqiptar dhe serb, në Beograd. Përmetëpër, humbin kohë edhe kush e lëshoi "Dronin" të fluturojë në qiellin e hapur pa mjegulla e me diell me rreze: "patrioti" shqiptar apo "nacionalisti" serb?! Ose, ndonjë i tretë nga Evropa për t'i matur si politikanë "probatimat" në peshojë.

Qëllimi i fluturimit dhe aterimit të "Dronit" u arritë në stadiumin e Beogradit. Shqiptarët dhe e gjithë bota e përcollën fillimin e "ndeshjes sportive miqësore" përmes ekraneve televizive. Fishkëllimin e himnit shqiptar. Zgjidhja e Çështjes shqiptare zbriti në tavolinë. Nuk shëtitën më maleve e as fluturon në qiell për të ateruar me komandë nga kisha ose hoteli "Feriti" në mesin e lojtarëve nëpër stadiume sportive.

Përfundimin e kësaj "ndeshje sportive miqësore" me "Dronin" përtoke do ta shohim më vonë, kësaj radhe jo në Beograd, po në mes të Tiranës para këmbëve të kalit të Skënderbeut…

RAMA E TUNDI "RRJETËN SPORTIVE" NË MES TË BEOGRADIT

Ditë më parë kur nga qielli i Beogradit në stadiumin "Partizani" zbriti "droni" me simbolin e flamurit shqiptar dhe me dy Baballarët e Kombit: Ismail Qemali dhe Isë Boletini, lojtarët e të dy skuadrave sportive kundërshtare, iu sulën "dronit" e jo "topit" të Mitroviq që e kapi për fyti me të dyja duart "patrioti" serb. Edhe kamerat televizive u përqëndruan te "droni sportiv", topi mbeti në mes të fushës si kungull Stambolli. "Patriotët kuqezi": "Ballisti" i Prishtinës, "Shferceri" i Shkupit dhe "vëllai" i Edi Ramës (sipas mjeteve të informacionit të Beogradit) u turrën me të katra se, kush e zbriti i pari "dronin" pa pilot me baballarët e kombit shqiptar në stadiumin e Beogradit?!

Analistët e dy shteteve "mike", gjatë kohë u morën me "dronin" politik, që ateroi papritmas në satadiumin e Beogradit. Ndonjëri duartrokiti, falë Zotit që droni nuk zbriti një "bombë atomike" në mes të stadiumit. E pak veta u morën me vizitën e kryeministrit shqiptar, z. Edi Rama. Askushi nuk e parashikoi "skandalin politik", që mund ta bënte ky kryeministër me "vëllain" tjetër për nga babai para kamerave televizive në Beograd: Shpallë Pavarësinë e Kosovës: "Kosova e pavarur është

tashmë një e vërtetë e pamohueshme.” Deklaratë e cila u cilësua si provokim nga kryeministri serb, Aleksandër Vuçiç, i cili në fund të konferencës nuk ia dha dorën kryeministrit shqiptar.

Arsye e plotë kjo e një “kurbani” politik, për të cilën pati të drejtë Edi Rama për pajtimin e të dy shteteve të armiqsuara me shekuj. Realitetin e hidhur, që ua përplasi në sy serbëve. Politika nuk ka moral, sinqeritet e as besë. Moti kohë. politikës shqiptare i ka munguar eksponenti i politikanit “guximtar”, Edi Rama. Ende i kemi të freskëta storiet filmike të Luftës së fundit në Kosovë (1998/99), dhe dëbimin e një popullate, masakrimin e mijëra të tjerëve dhe dhunimin e grave dhe vajzave te pragu i Shtëpisë. Kafshatë e mykur serbe të cilën me zgjatjen e dorës të dy kryeministarve duhej t’i mbyllë sytë dhe ta kapërdijë populli i Kosovës. Shteti i pavarur, që deri më tani e njohën 108 vende të ndryshme të botës, dhe e mbështeti edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, por ja që ende nuk do ta njohë Serbia. Xhadia, që ende i ka duart e përlyera deri në bërryla me gjak shqiptari. Përmëtepër, edhe ende nuk do t’i lajë para syve të botës me “sapunin” politik, në mes të Ballkanit. Popullit të Kosovës t’i kërkojë falje publike. Veprim politik, të cilin vështirë se do ta pranonte ndonjë popull tjetër historik, përveç popullit shqiptar. “Armëpushim” të cilin Ballkanin ende e

mbanë të qëndrueshëm, nuk ia ka vënë flakën. Vite e shekuj duke e pritur Europën ta përmisojë veprën më të rëndë historike ndaj popullit shqiptar, atë që nuk e bëri deri më sot lufta, së paku ta bëjë politika.

Përmëkeq, deklaratën e Edi Ramës e mori si provokim?! Eksplodoi para kamerave televizive me parulla të vjetra shoveniste e nacionaliste: "Unë nuk do t'ia lejoj askujt që ta ulë Serbinë këtu në mes të Serbisë. Më vjen keq që zoti Rama ka shfrytëzuar këtë rast që të flasë për tema që nuk kemi rënë dakord se do të flasim. Serbinë nuk duhet ta ulë askush." Përgjigje e cila nuk do të vonojë edhe nga kryeminstri shqiptar, z. Edi Rama: "Për sa i takon Kosovës, unë besoj se realiteti mbetet një dhe një i pandryshueshëm, pavarësisht përcaktimeve të ndryshme dhe mosdakordësisë së plotë që kemi lidhur me këtë realitet. Ne nuk mund të na pengojë që me njëri-tjetrin të bashkëpunojmë sepse rruga e secilit prej nesh, Shqipërisë, Serbisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, Bosnjës është një korsi në rrugën e përbashkët të Integrimit Europian. Sa më seriozë të jemi ne, aq më seriozisht do të na marrë Europa dhe kjo është një sfidë e përbashkët mes nesh." Padashtas, zbuloi nën hi shpuzën e Vuçicit, se: "Qëndrimi ynë ndaj Kosovës është i pandryshueshëm, që Kosova është pjesë e Serbisë. Por është e bukur që të flasim, në ato që

t'i themi njëri-tjetrit, sy më sy se çfarë mendojmë.”

Takimi politik kokë më kokë në Pallatin “Serbia”, mes kryeministrit të Shqipërisë dhe Serbisë, që ishte parashikuar të zgjasë 30 minuta, por në fakt zgjati 40 minuta, përfundoi pa asnjë shenjë buzëqeshje mes dy liderëve, madje pa e parë as në sy njëri-tjetrin si politikanë. Takim i cili paralajmëroi një dimër të ashpër politik në Ballkan, që i duhet edhe gjatë kohë këto dy popuj t’ia shtrinë njëri – tjetrit dorën e pajtimit.

Padyshim, përsëri qe një “fitore” e Edi Ramës. Vërtetë, “Çelësin e Beogradit”nuk ia dha Serbia, por “Qytetar nderi” njëzëri e shpalli Presheva. Populli shqiptar e duartrokiti për “guximin” në mes të Beogradit. Thaçi i Tetovës e ndjeu veten “krenar me qëndrimet e Ramës në Beograd”. Adem Demaçi ia rrahu krahët: “ I lumtë Edi Ramës!” Qosja: “Rama u dëshmua në Beograd si lider i rajonit”. Punemadhe, që Presidenti i Republikës Serbisë Nikoliq e shpalli të “papërgjegjshëm” dhe nuk deshi të takohet me të si politikan dhe “ëndërrues i Shqipërisë Madhe”. Deklarata politike e Ramës e hidhëroi edhe ministrin e jashtëm serb, Ivica Daçiç, por i gëzoi shqiptarët anembanë Atdheut dhe miqtë ndërkombëtar. Deputeten e Parlamentit Europian, Tanja Fajon, që vizitën e kryeminstrit Rama e

përgëzoi si, "hap të guximshëm për të ardhmen e rajonit".

Vallë, a nuk ishte kjo ajo "bomba atomike", që e parashikoi presidenti i UEFA -s Michel Platini?! Me siguri se, po. Dallimi, përderisa ende nuk dihet se kush e zbriti "dronin" nga qielli në stadiumin "Partizani": "Ballisti" i Kosovës, "Shferceri" i Shkupit, apo "vëllai" i Edi Ramës, "dronin me bombën politike" në mes të Beogradit e lëshoi Edi Rama. Kryeministrat e të dy shteteve, as nuk ia zgjatën dorën e pajtimit njri - tjetrit si politikanë, por i frynë zjarrit edhe më tepër në Luginën e Preshevës. Vizita e Edi Ramës në Preshevë u pritë me arrestimin e pronarit të kompanisë "Rrufeja", punëkryesit e kësaj kompanie dhe nga Këshilli Organizativ i Komunës të Preshevës, Ilir Sadriu, që ishin të angazhuar për vendosjen e flamujve shqiptar nëpër rrugët e qytetit.

Arrestime për të cilat ka reaguar edhe kryeministri shqiptar, Edi Rama: "Të kapesh me flamurin e tjetrit do të thotë të mos çlirohesh dot nga hija jote". Edhe pse, goli që duhet dhe pritej që ta japë Edi Rama në Tiranë, kësaj radhe ndodhi në Sheshin "Liria" (Pallatin e Kulturës), në Preshevë. E tundi "rrjetën sportive" të Serbisë.

Thashë: Rama "dronin" e Beogradit do ta zbresë në Tiranë…

BOMBA "POLITIKE" ZAEVIT I PËLCITI NË DORË

Dihet, si zakonisht "ilaçet" e mia i marrë nën Rrap, "Tivoli", "Firenca" dhe "Gjino". Ose, te "Pirini". Ballë për ballë Olimbisë, me fëmijë në gji e prehër. Karshi i kam Mitropilitët e Beogradit: Shën Klimentin dhe Naumin krah për krahu me Shën Kirilin dhe Metodin me kryqa e bibla në duar. Karposhin, ende turqit nuk e kanë ngulur në hu dhe hudhin në Vardar. Vetëm ia kanë ndërruar vendstrehimin, ia kanë zgjidhur duart, e kanë hipur në kalë pa shalë. Ndërtesat e vjetra me ato të rejat si institucione shtetërore njëra përmbi tjetrën ia kanë zënë frymën Sheshit në të dy anët edhe diellin. Xhamitë me minare, kokë më kokë në Bit – Pazar pa asnjë petkë shqiptar. Kishat në çdo park mbijnë si këpurdha. Kryqat maleve si parullat e dikurshme ideologjike të shokut Tito e xhaxhit Enver. Vite tranzicioni, kur më shumë janë ndërtuar kisha e xhamia sesa shkolla. Universitete shtetërore e private, gati në çdo legje e katund. Punemadhe, që ne nuk kemi studentë për ato universitete. Histori më vete është ajo, sesi t'u sigurojmë vende pune. Tekefundit, së paku të kishin kësulën e bardhë të Bajram Currit në kokë.

Edhe pse ato "ilaçe", ende deri në ditën e sotshme nuk më kanë shëruar, por siç e kanë nisur, një ditë do të më shtrojnë në shtrat. Varrit nuk i trembem, është spitali im rrëzë Çukës. Mëkot përmes E –mailit tim më dërgoni viagër. Falemimderit. Hë për hë, falë Natyrës dhe Zotit nuk kam nevojë. Kryengtitësin ende e kam me dy kobure në brez. Mundëshisht, nëse më doni aq shumë si shkrimtar, ma dërgoni ndonjë cucë të re, ose grua azgane te Mulliri Arapit ta kaloj Natën matanë malit! Tek atëherë, do të shihni sesi shkruhet poezia, bëhen tërmete në letërsi, fitohet Liria.

Matanë Vardarit, e kam Aleksandrin e Madh i rrethuar me roje nderi: luaj e komita më këmbë e kuaj shale. Gati që të gjithë në duar kanë shpata dhe kobure, janë të armatosur deri më dhëmbë. Pothuajse, përgaditemi për luftë e jo për paqe mes dy popujve të armiqsuar me shekuj. Ende nuk trokasim në dyert e Europës. Isë Boletini po të ishte gjallë, derën do ta thyente me shqelma dhe do t'u hynte brenda me dy kobure në brez. Në këtë anën shqiptare, Filipin e Maqedonisë që i përshendet shqiptarët me grusht si xhaxhi Enver me shpatën në brez. Hë për hë, mungon Edi Rama që e tundi "Rrjetën sportive" në mes të Beogradit, ta shpallë Shqipëri Etnike edhe në Shkup. Ose, "shfercerët" me "Ballistin" e Tetovës të lëshojnë ndonjë "dron" edhe në Bit –

Pazar me Baballarët e kombit: Ismail Qemali dhe Isë Boletini. Gostivari ndonjë tollumbë në vend të "bombës" të Zaevit. Hakmerren Cërvenkovskit, lajnë borxhin e vjetër për heqjen e flamurit kombëtar kuqezi mbi derë të Komunës. Lojtarët politik të rroken fytas, jo për topin e Mic Sokolit në fushën sportive, por për "dronin" e Edi Ramës që ateroi nga qielli në Beograd. Megjithatë, e kanë lëshuar një "dron" edhe me "Babain" e tretë të Kombit, Rexhep Qosja, po kësaj radhe jo nga qielli, por nga Prishtina në IRJ të Maqedonisë: në Tetovë, Gostivar dhe Shkup. Përçudi nuk e kanë lëshuar në Kumanovë, Manastir, Prespë, Ohër, Strugë, Kërçovë dhe Dibër, ku për kryetar komune e kanë me profesion edhe një hoxhë. Larg qoftë dhe mos e dhëntë Zoti të paragjykoj se, këto qytete nuk i takojnë Shqipërisë Etnike. Zot, kësaj radhe nuk i del "Shferceri" i Bit-Pazarit e as "Ballisti" i Tetovës dhe Gostivarit, por ai i Komunës Çairit. Krah për krahu me një shtëpi botuese nga Tirana dhe një librari nga Çarshia, bëjnë biznes familjar me Letërsinë shqipe.

Skenderbeu, rri gati mes makinave në parking si komandant lufte me shpatën në brez. I vetmi hero lufte në ditën e sotshme me shpatën në brez, kur nga të katër anët e kanë rrethuar komitët me thika, bomba e armë në dorë. Përmëtepër, Zaevi edhe i kërcnohet me bombën "politike" nën setre se, do t'ia hudhë në mes të këmbëve të

Kalit. Edhe atë, kur Gruevski flet shqip (gjuhën jozyrtare) në Universitetin e Europës Juglindore (Shtulit). Përinat, kur e dëgjoj Sheshelin që posa e kanë lëshuar nga burgu i Hagës sesi çirret në mjetet e infromacionit: "Rroftë Serbia e madhe!". Përçdudi, nuk e di se si më vjen mu në këtë shkrim publicistik të bërats në kupë të qiellit: Rroftë Shqipëria e "vogël" Etnike! Baba Tomorri, vendi i Perëndive. Mali i shenjtë, ku pihet vera, shkruhet poezia. Dhe, bëhet dashuri me Hënën e plotë në Tyrbe.

Kamarieri saora më vjen mbi kokë me rakinë e rrushit: u bëftë mirë, zotëri. Faleminderit i përgjigjem. Edhe, atë: e di se është "hallall", po çka t'i bëj realitetit shoqëror mes dy zjarreve, unë jam shkrimtar dhe "prodhim" i kësaj "fabrike ekonomike". "Haxhilerët" e pinë "haramin" nëpër çajtore. Hoxha i Allahut çajin e rusit. Patjetër, duhet t'i marr "ilaçet" e mia të mëngjesit para buke. Përmëtepër, ara nuk lërohet vetëm me një ka, i duhet edhe një shoq në zgjedhë. Qerrja me katër rrota nuk tërhiqet vetëm rrugës pë në Baba Tomorr. Kamerieri buzëqesh, dhe pas pak kohe ma sjellë edhe "kaun" tjetër me gjithë brirë, arën me dy qe ta bëj ugare. Tashti, i them me plot gojën: mund të lëroj, jo vetëm një arë, por gjithë fushën e Shkupit dhe Pollogut me katunde përreth maleve.

Padashtas, sytë më ikin te permendoret e Gruevskit. Olimbia ka mbetur pa çikë uji mes këmbëve. Fëmijët në prehër e gji, qajnë për një gotë ujë mes shkretirës politike. Filipi i Maqedonisë, edhe ai e shoh ka mbetur pa asnjë shtambë verë me dy vegë. Aleksandri i Madh, nuk e ka as një ibrik me dy çepa nën struke me raki rrushi. Luanët e kuajt, edhe ato ulërijnë e hingëllojnë për ujë në prag të Dimrit Madh. Qielli, kur nateditë na sulmon me shi, rritet niveli i ujit të Vardarit të dalë nga shtrati. Herë pas here na godet edhe me rrufe. Pasmesnate, na sulet me përmbytje. Rrugët, shtëpitë të na i mbulojë me ujëra të zeza. Bora edhe ajo na kërcnohet nga majat e maleve, ende nuk ka zbritur në fushë. Vetëm Tetova heroike, rrëzë Sharrit Plak me gurrat nateditë mbi kokë, në mes të Dimrit digjet e piqet për një pikë uji mes ajërit të ndytë të Jugohromit dhe bërllokut.

Vetmevete them: Epo, kështu është kur Gruevski e Zaevi nuk e lërojnë "arën" e Babait, Gligorovit. Tërhiqen mes ugareve si dy qe nën zgjedhë: njëri në vi e tjetri në lëndinë. Nateditë presin arat e tyre t'i lërojë Ali Ahmeti, burri botës që arat e veta i ka lënë djerrë në Zajaz, ia kanë mbuluar ferrat. "Droni" tjetër i ("Rilindasit fundit") si "Baba" i tretë i kombit nga Prishtina. Interesant, mungon edhe një "dron" ("Baba i katërt i kombit", DoktorZiu. Kutadish, ai nuk do

të zbresë nga qielli e as nga toka, por nëntoka "artistike". Copë – copë janë duke e bërë zgjedhën për një grazhd politik. Mëkot, përpiqet Ali Ahmeti t'i tërheqi për kërpeshi, nxjerrë nga grazhdi plot me taxhi ta lërojnë arën rrëzë Çukës me lisa e në Pollog, shpie në Europë. Dhe, vështirë e ke sot të bësh arsim dhe kulturë, kur partizanët e partive politike merren me këtë profesion biznesi familjar. Përpiqen ta fshijnë Lëmën e kojshisë, kur të veten ua ka mbuluar bërlloku: "Ditëtë e Kulturës Shqiptare" i organizojnë në Maqedoni e jo në Shqipëri?! Punemedhe, që ato nuk kanë "haber", as nga arsimi e as nga kultura, e rëndësishmja është: bëjnë zhurmë kulturore politike. Lugetërit komunist zgjohen nga varri për çdo Nëntor historik. "Fitorja", plot festivale teatrore në çdo qytet shqiptar pa teatër profesional e dramë shqipe. Tekefundit, të bënin një manifestim të hajrët në një qytet shqiptar. Kokës t'i bien me të dyja duart me grushta: Mjaftë më me trumbetime politike, vetëm me Urën e Rozafatës, që ditën ndërtohet nga ustallarët e kombit, e natën rrënohet nga hajdutët e partive politike. Nuk bëhet artë kulmor me rrugaçë politik, por duhet gjetur shtegun tjetër matanë malit, fluturojmë në qiell matanë mjegullave. Diellin ta rrokim për qafe. Konkurencë artistike t'u bëjmë yjeve që e kanë pushtuar Qiellin dhe i vardisen Hënës mbi

mal. Koha është, mëzatit të tredhur mos t'i qepemi si rriqëra për herdheve.

I lumtur me siguri është Skënderbeu, që nuk mvaret nga politikanët e sotshëm ta stërpikin me ujë 'Xheneti" për Ditë vere. Kalin t'ia kamxhikojnë me thupër thane. Ibrikun e ka futur me kohë nën sjetull. Vetëm në këtë Shtet "demokratik", deputetët e popullit dhe partizanët e partive politike pa punuar fare marrin rroga qeveritare dhe rrinë në shtëpi. Kohë kjo, kur shumë artistë vdesin edhe për bukën e gojës. Rrugën e kanë zgjedhur për "dilog politik", në vend të Parlamentit. Kafenetë, vendtakime politike. Shtepitë publike për rehabilitime patriotike. Shtet, që më shumë nëpër sheshe ka përmendore luftarake ideologjike, sesa misionarë paqe e banorë. "Bomba" kërcnuese të politikanëve që luftojnë për pushtet.

Shtet, të cilin me pak shpresa e mbanë gjallë me infuzione ende politika ndërkombëtare. Shtëpitë publike përplot me mëzetër të tredhur për zgjedhë. Përgjumshëm e pret Borën e madhe të zbres nga Sharri Plak e ta mbulojë bërllokun, pastroj qytetin nga ndotjet ekologjike partiake. Dimrin e Madh, jo atë të Kadares, por të Çajupit. Armën e ftohtë të paqes: Kanarin. Pashterkën e kuqe Xhadisë t'ia flukë mbi kokë. Nateditë t'ia përzë xhindet, lënurë lesh Arapi në Tyrbe. Ose, pret tërmetin katastrofal që e kemi pas dere, çdo

gjë ta rrafshojë me tokë. Përsëri të nisim nga fillimi si "vëllezër" të Njerkës, dalim në Pranverë. Padyshim, jo te ajo arabe, por te Pranvera shqiptare…

Bomba "politike", Zaevit i pëlciti në dorë…

DUARTROKITJE 20 % TË BUXHETIT PËR KULTURËN SHQIPTARE

Ministria e Kulturës në R. e Maqedonisë e shpalli Programin nacional në web faqen e vet zyrtare. Përçudi, mes atyre menifestimeve kulturore, nuk e pashë Xha Derallën. Plakun me mjekër të bardhë e kësulën e Bajram Currit në kokë, që këtë "grua" teknefese me siguri në mes të Dimrit Madh do ta nxirrte pas Çuke ta dërgojë nuse Përtejzalli te prindërit si mysafire, që të shoh një "ditë të bardhë". Edhe revistën letrare Stili 97, një zë i ri në letërsinë shqipe, e cila krijuesve të rinj ua hapi dyert krah më krah. Sidomos, femrës krijuese shqiptare. Revistë letrare, që deri më sot kishte dalë në kohë lufte, ditë edhe më të vështira (58 numra). Ballinave të së cilës i kishte sjellë portretet e Letërsisë Shqiptare duke ua përkushtuar numrin personaliteteve historike letrare: Naim Frashëri, Asdreni, Gjergj Fishta, Fan Noli, Lasgush Poradeci, Mehmedali Hoxha, Sadudin Gjura, Frederik Rreshpja, Anton Pashku, Pano Taçi, Xhevahir Spahiu, Abdylazis Islami, Murat Isaku, Fadil Bekteshi, Mirko Gashi, Flora Brovina etj. Tunbatunët e Minisitrisë Kulturës, përpiqen t'ia zënë frymën, e ngulfasin në mes të Ditës Madhe para syve të lexuesve. Asgjë befasuese, edhe nga Programi nacional 2015 i

Lidhjes të Shkrimtarëve Shqiptar të Maqedonisë. Mes atyre emrave nuk i hasa edhe emrat e disa krijuesve të mirënjohur shqiptar, por të partizanëve partiak me brekët arnë përmbi arnë nëpër këmbë.

Shkrimtarët e "vëllazërim-bashkimit", kur e kishin parë sesi katundarët e tyre me libra të arrirë artistik nën sjetulla e "pushtojnë" Ministrinë e Kulturës, turr me të katra të bëhen shkrimtarë e doktorë shkence. "Tefterët" e tyre të hallvaxhinjëve t'i nxjerrin nëpër tezga në Tun Batun para lexuesve. Kulminacioni "artistik", t'i botojnë edhe si "bestseller" të "Letërsisë maqedonase". Sytë filluan të më dhëmbin nga emrat e sojit anonim të Katundit Madh të "shkrimtarëve". Anëtari i komisionit, përsëri kishte qenë nga Katundi Madh i tyre dhe e kishte mbushur programin e Ministrisë Kulturës me "vepra artistike" të arnuara arnë përmbi arnë nga letërsia botërore si në "bahçen" e babait pas shtëpie (hale), dhuratë nga "Pashai" i Perandorisë Osmane. Që, po ua hoqe emrat nga ballina, të duket se librat e tyre i ka shkruajtur vetëm një autor.

Realiteti, bota sot për sot njeh vetëm vlera të arrira artistike dhe kërcime në letërsi. E, jo "kalemxhinjtë", që me përjashtim të dy - tre emrave, ende janë nën nivelin e krijuesve të mirënjohur shqiptar: Sadudin Gjura, Mehmadali Hoxha, Mustafa Laçi, Nexhat Pustina, Abdylazis

Islami, Murat Isaku e Daut Gurra. Nuk u zemrova me argatin anonim të Tun - Batunit, aqsa u zemrova me Ali Ahmetin, mu si Filip Shiroka me Babën Adam:

NJI ANDER
VJERSHË E KUSHTUEME TRATHTORVE TONË…

Nji natë, n'javën, rash në shtrat me fjetë,
Zembra, m'ish helmue, gjumi m'kishte tretë,
Mejtoshe ç'po vuejnë tash burrat e Shqypnisë
Prej disa halldupve n'sherbim t'qeverisë.

Prej tradhtorve t'kombit, qi për me fitue,
Kuntr' atdheut veprojnë, Shqypninë me shëmtue;
E kështu i helmuem nuk dijta se ç'them,
Shava t'anë njerzit 'dhe babën Adam!

N'ket idhnim gjumi m'kishte ardhë,
E… nji plak me mjekër t'bardhë
Erdh, me petka porsi borë
Edhe me nji shkop në dorë:

- Ç'ke bre bir - m'thotë - Ç'ke me mue,
Qi m'ke sha e m'ke trazue?... –
- M'ndiei, o plak - thaçë, gabim ke,
- Nuk t' kam sha as s'di kush je! -
Nuk po m'njeh - tha - m'shiqo mirë:
Jam Adami plak, bre birë! -

Sa e njoha Adamin t'drejtën i diftova,
Se me njerëzit e botës shum keq u zemrova,
Qi Shqypnin po e hupin këta njerz t' kqij,
Kta tradhtorë t' kombit qi janë fares s'tij.

- Farës s'ime? Mos xen besë!
Gruen kisha tash m'e nda!...
Tha - j'u ngrehne flokt e kresë.
- O babë - thaçë - bota nji tjetër
Nuk ka pasë, se ti ma t'vjetër…

- Po baj çudë - tha - me t'vërtetë
S'po di, Eva, ku i ka gjetë,
Kta tradhtorë të patynzonë
Qi turpnuene emin t'onë;
E… me idhnim briti tue thanë:
" Farës s'ime kta nuk janë!"
Se… me kenë t'ont - tha - tue qa
Gruan kisha tash me nda!...
Por kta njerz kan le ma vonë
Prej Kainit t'patynzonë,
Qi ka mbytun vllan e vet,
Vret mallkimi i Perëndisë,
Qi turpnon para njerzisë!

Dhe, thashë me vete: Ecejaket në Minsitrinë e Kulturës paskan edhe përfitime. Faleminderit, Tunbatunit. Përndryshe, nuk do të kishte lindur

ky shkrim i gatuar me kaq zjarr artistik krah për krahu me Filip Shirokën.

Sekretari shtetëror, në vend që të vë rend dhe rregulla në Minstrinë e Kulturës, delë në mjetet e informacionit me deklarata teknefese për "vlerat" e përkrahura nga kjo ministri me shifra bombastike qesharake: "Kultura shqiptare në Maqedoni do të marrë 4% më shumë nga buxheti i Ministrisë së Kulturës gjatë vitit të ardhshëm.

Sipas sekretarit shtetëror Behixhudin Shehabi, projektet shqiptare në Ministrinë e Kulturës do të financohen me 720 milion denarë apo 20% të buxhetit të përgjithshëm të Ministrisë." Punemadhe, që shqiptarët zyrtarisht thirren se janë 25 % në IRJ të Maqedonisë. Punë tjetër është ajo se, shqiptarët në numër e tejkalojnë edhe 40 % -shin, por kur është në pyetje buxheti i Shtetit të "pëbashkët", ato do të pajtohen edhe me 20 % -shin si "pakicë kombëtare" në një thes me serbët, turqit dhe romët.

Zërin e ngre me masat që ka marrë kjo ministri për t'i ndëshkuar "kryengritësit": "Me pak përkrahje në 2015 do të gëzojë veprimtaria botuese dhe folklori, pikërisht sektorë këta që më së shumti shkaktuan reagime në opinion kohë më parë." Përkundrazi realitetit, që flet vetë Programi i Ministrisë Kulturës për vitin 2015, ku shihet qartë se me disa tituj më shumë janë ndihmuar mu ato "shtëpi botuese" dhe individë që

manipulojnë me të dyja Shoqatat botuese shqiptare të librit. Ose, "institucione" kulturore me të cilët udhëheqin partizanët e Partisë Politike në pushtet. Mjerisht, bie në sy edhe themelimi i "Institucioneve" të reja kulturore partiake, revistave kulturore njëpartiake duke ngulfatur revista letrare me një traditë të gjatë disavjeçare. Shkurt, Partia Politike Shqiptare në pushtet, përveçse me "politikë madhore", merret edhe me "kulturë kombëtare patriotike".

Kulminacionin "artistik" do ta arrijë me përmendjen e shifrave: "Në përqindje në 2014, mesatarja ka qenë 16 % kurse në 2015 pa ankesa mesatarja është 20 %. Përqindja është shtuar në pjesën e dramës dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar." Pyes veten unë si shkrimtar: Ku kanë teatër dhe dramë shqiptarët, kur të gjithë aktorët janë shkrimtarë, regjisorë dhe drejtorë të festivaleve të dramës?! "Kemi një ulje në veprimtarinë botuese dhe në folklor sepse kriteret kanë qenë më të ashpra. Është kërkuar që një ansambël të marrë pjesë në minimum 20 manifestime, ndërkaq me kriteriumet që sivjet kemi filluar në veprimtarinë botuese, aplikacionet individuale nuk janë pranuar por vetëm shtëpitë botuese", ka thënë Shehabi.

"Hallall" u qoftë! Vërtetë, paskëshit bërë shumë për kulturën shqiptare. Përqindjen e keni rritur për 4%. Dorën në zemër, e "meritoni" edhe një mandat nga populli shqiptar. Unë, si Kalosh

Çeliku sa për vete, nuk u kisha lënë as një ditë. Vetëm ju, do ta nxirrni kulturën shqiptare nga bataku, ku e keni rrasë deri në fyt vite me radhë me "aktivitete kulturore". Vitin tjetër me siguri do ta rritni pak më shumë buxhetin klanor familjar, miqësor e partiak edhe për 5 %, që si pakicë kombëtare të arrimë 25 % -shin e buxhetit në këtë Shtet të "përbashkët".

Edhe fundi i sukseseve sipas mjeteve të informacionit arrin "qëllimin" partiak: Ai (Shehabi), u zotua që gjatë vitit të ardhshëm do të përfundohet edhe projekti për bibliotekën e shumëpërfolur të Tetovës: "Sipas dinamikës së paraparë, nëse të gjitha këto aktivitete rrumbullakohen, puna fillon në mars. Domethënë projekti "Biblioteka në Tetovë" nuk është një ëndërr, është një realitet, faza e parë është kryer, faza e dytë është kah përfundimi dhe mendoj se kah viti i ardhshëm afër kësaj periudhë kohore, do ta kemi objektin karabina", ka thënë më tutje Shehabi. Përsëri, patjetër duhet të ndërhyj unë në këto premtime boshe disavjeçare: Shqiptarët duhet të presin 25 vjet në "demokraci", kur përmendoret e Shkupit 2014 u lindin pas mesnate për çdo ditë si këpurdha, që më në fund, mezi ta ndërtojnë një bibliotekë. Kohë qorre kjo në Ditën e sotshme, kur kemi libra me thasë e nuk kemi lexues. Unë, nuk i besoj, ju po të doni i besoni, veten e paçit më qafë!

Shkrimin, e "syrgjynosur" e përfundon gazetari pa sherr e "sehirxhi": Buxheti i Ministrisë së Kulturës sivjet peshon 3.6 miliard denarë. Patjetër, duhet të ndërhyj unë autori i këtij shkrimi: Pasi të përfundojë proekti Shkupi 2014. Car Dushani u ngritë lugat në breg të Vardarit. Shqiptarët, para kamerave televizive u përpoqën më kot ta rrëzojnë me çekiç druri. Ditën e nesërme i dolën zot heronjtë tjerë "maqedonas" me pushkë e thika në duar përpara institucioneve shtetërore të arsimit dhe kulturës, në Bit - Pazar. Qoseto ose Kasapi, përmendorja e paraqitur me pushkë dhe thikë në dorë qëndron para pallatit të Gjykatës në Shkup. Ironia më e madhe është se një vrasës me pagesë qëndron para një institucioni që duhet të ndajë drejtësinë (përballë Hasan Prishtinës në dy pëllëmbë park dhe Skënderbeut në parkingun e makinave.

Duartrokitje 20 % - shit të buxhetit për kulturën shqiptare! Deklaratë fundekrye qesharake në prag të Vitit Ri (2015). Babadimëri këtë Vit të Ri, si "i dërguari i Shejtanit" nuk pati guxim të dalë në Bit - Pazar. Burri botës, nuk merret me vlerësimet artistike dhe kriteret profesionale, që njëherë e përgjithmonë në këtë Ministri të Kulturës të vëndoset një rend e rregull me kulturën dhe letërsinë shqiptare, po merret me shifra matematikore politike. Thashetheme. Premtime boshe, që popullit shqiptar nuk i interesojnë fare, por argatëve partiak pa asnjëfarë

bagazhi artistik shqiptar, të cilët vazhdojnë ta vlerësojnë dhe sakatojnë kulturën dhe Letërsinë shqiptare. Përkrahin dhe stimulojnë klane familjare, miqësore e partiake me vlera nën nivelin e hartimeve të nxënësve të shkollave fillore.

E kam thënë njëherë në një shkrim vitin e kaluar (2014), tashti e përsëris: Fajin nuk e ka Ministrja e Kulturës (Kançevska), po Ali Ahmeti ("Abazi" i fushës) me shokët partizanë krah për krahu me argatët e Shoqatës të Botuesve Shqiptar dhe Lidhjen të Botuesve Shqiptar, që këtyre të arratisurve ua ka hedhur nga një asht derri para këmbëve, që të mbyten me vite njëri me tjetrin si qentë me zgjebe në mes të Dimrit Madh. Goditja pas shpine, kulturës dhe Letërsisë Shqiptare nuk i vjen nga pala maqedonase, por nga mashat e djersitura tinëzare shqiptare. Metodë e njohur kjo historike, siç thotë populli: hidhe gurin dhe fshihe dorën! Vite me radhë duke nëpërkëmbë kulturën dhe librin shqip. Herë me hoxhë, herë me tollumbaxhi, herë me rrugaçë Bit-Pazari (askushë) e herë me këshilltar anonim të kryetares Komunës të Tun Batunit, që në jetën e vet nuk kanë hedhur në letër ndonjë varg të hajërit, as rresht shkarravine në fletore. E, në anën tjetër si për inatë, Partitë Politike shqiptare në pushtet u japin guximin "bashibozukëve", qoftë si ministra, qoftë si sekretarë shtetëror e anëtarë komisioni të vendosin për kulturën dhe Letërsinë Shqiptare.

Turp si nuk kanë të ulen në një tavolinë ballë për ballë me artistë të palës tjetër maqedonase?! Kulminacioni i ironisë: Përderisa dje, njëra shoqatë botuese e "sulmonte" Ministrinë e Kulturës (nxirrte më gjygj), e tjetra i dilte në mbrojtje në mjetet e informacionit, sot që të dyja krah për krahu do të marrin pjesë në Panairin e librit në Stamboll?! Vërtetë do ta kënaqin prezentimin e librit, kulturës dhe letërsisë shqiptare. Fenomen i çuditshëm shqiptar, që ndodhë vetëm në mesin e këtij populli të nëpërkëmbur me vite nga partitë politike shqiptare. Përndryshe, për nga veprimet kulturore të këtyre shoqatave botuese, populli do të thoshte: kape njërën dhe bjeri tjetrës sa të mundesh me të dyja duart nateditë deri në vdekje. Shkaku se, fajin janë duke e kërkuar te pala tjetër maqedonase, e jo te vetëvetja që vite me radhë janë duke organizuar vetëm pazare e "karavane të librit". Përçajnë botuesit shqiptar në dy shoqata botuese, kur ne sot në IRJ të Maqedonisë nuk kemi shtëpi botuese as për një shoqatë. Tri - katër shtëpi botuese më në zë i kanë shqiptarët në këtë Shtet "demokratik", të tjerat dalin në skenë vetëm kur partia e tyre vjen në pushtet si këpurdhat pas shiut. Ose, kur ndonjë anëtar komisioni nga Auto Shkolla, libraria, shtypshkronja, xhamia emërohet si anëtar komisioni në Ministrinë e Kulturës. Kabineti i Kryetares të Komunës të Tun Batunit

edhe ajo turret t'i dalë në "ndihmë" kulturës shqiptare, që hë për hë e ka mbuluar këmbekrye bërlloku. E ka rrokë për fyti, ia ka zënë frymën. Jetë të gjatë kanë, aqsa Partia e tyre është në pushtet.

O Imzot, Katundin e Madh ("Kryeqendrën Kulturore Shqiptare") me gjithë këto "shkrimtarë, poetë e doktorë të shkencave", vazhdon ta mbulojë pa mëshirë ende bërlloku?! Zoti, siç duket nuk ka mëshirë. Natyra poashtu, i ka ligjet e veta: I dënon dhe shpërblen mëkatarët sipas veprave që kanë bërë për njerëzimin. Sekretarit shtetëror në Ministrinë e Kulturës po i përsëritet përralla e ujkut dhe dhelprës, kur që të dy bien në greminë. Dhelpëra, kur i thotë Ujkut: lëshoje rrënjën, kape këmbën!

Kohë qorre kjo, kur sot më së shumti kemi nevojë për tollumbaxhinj e barinj të deleve, sesa për "doktorë shkence e shkrimtarë" të partive politike…

PËRGËZIME

Vite me borë ato, kur me strajcat e kanapit plot libra, herët në mëngjes dilnim nga porta dhe ktheheshim me natë në shtëpi. Kohë, kur në pritë na dilte sistemi komunist, por edhe Natyra. Zoti e shikonte punën e vet në xhami. Hoxha i Çelëvjollcës nuk na joshte me ilahi e as nuk na detyronte t'i falim të pesë "vaktet" në ditë. Kurrë, nuk përziheshte në punë të shkollës. Përmëtepër, ai nuk na kërcnoheshte me Xhehnem. "Xhuma për xhuma", komunikonte me ne në gjuhën shqipe. "Qerbelanë" e Naim Frashërit e mbante nën sjetull. Kësulën e bardhë të Bajram Currit mbështjellur me "çefin" në vend të "çallmës", në kokë. Aspak, nuk i gjasonte hoxhës të sotshëm të Filip Papajanit: "Njeri i sotshëm me tru të moçëm". Shumica, thonin edhe se, është hoxhë rumunie. Byrek kishte hëngër me Asdrenin në Bukuresht. Përçudi, vetë Asdreni në atë kohë bashkë me Hoxhën kishin ardhë edhe si mysafirë në Kërçovë me një thes plot me abetare në shpinë.

Përroni i Garanës, që vjeshtë e dimër tërbohej dhe zbriste nga mali me egërsi, na sulej si shkollarë. Rrugën na e priste, urën na e rrëmbente me vete si një anije pa udhëtarë. Edhe

ato pak libra, që na mbetën nga "Shqipëria e Madhe", ministrit arsimit të asaj kohe (Ernest Koliqi), na i rrëmbenin nga duart dhe na rrasnin në burg si "nacionalistë e irredentistë". Megjithatë, ne perësëri gjenim ndonjë libër për ta lexuar kokë më kokë nën hijen e Lisit midis Livadhit. Ishin Librat e këndimit të asaj kohe plot poezi të Rilindasëve tanë me shokë: Naimi, Çajupi, Gjergj Fishta, Asdreni, Vaso Pashë Shkodrani, Ndre Mjeda, Filip Shiroka, Hil Mosi, Ali Asllani e Prej Shkëndisë. Pseudonim letrar i asaj kohe, që edhe sot e kësaj dite nuk e di se, kush ishte autori i atyre poezive të zjarrta mes faqeve të Librit të këndimit.

Dorën në zemër, vërtet më ka marrë malli për mësuesit e Ernest Koliqit, e jo këto të sotshmit të Ministrisë Arsimit e partive politike, që kurrë nuk kanë kapur ditar në dorë. E sot emërohen drejtorë shkolle e ministra të arsimit. Mësuesë të politizuar deri në palcë me trumbetime partiake dhe me pak aftësi arsimore – edukative, plot patetikë patriotike. Partizanë, që ditarin e arsimit e kanë shndërruar në libreza partiake. Kryetarë të komunave shqiptare, që ato pak mjete materiale në disponim t'i shpenzonin për lektyra shkollore e revista për fëmijë. Aftësi "heroike" kanë për propogandë partiake, sesa për mbajtjen e orës së mësimit në klasë para nxënësve. Mezi presin 28 Nëntorin, që të zgjohen

nga gjumi dimëror dhe para këmbëve të Kalit të Skënderbeut me flamurin kombëtar kuqezi krahëve t'i detyrojnë fëmijët të lexojnë poezi patetike për Atdhun. E, vetë si sulltanë të sotshëm strehohen te "Tivoli" dhe restorantet përreth në Çarshi të Bit – Pazarit Shkupit me rrugaçët "kuqezi", kokë më kokë për kafe festive: (parulla "nacionaliste" përballë "Ilindenit").

Punemadhe, që fëmijët dridhen nga i ftohti, së paku ta kishin krahëve gunën e Çobanit Sharrit (Farizit). Askushi nuk mendon për të nesërmen,

që shumica e këtyre fëmijëve do të përfundojnë në spital. Flamurit mund t'i këndohet edhe në shkollë pa eufori patetike. Vetëmse, në shkollë nuk janë partizanët e partive politike, që t'u duartrokisin mësuesve "patriotë". "Pishtarëve" të arsimit, që patriotizmin e shohin në rrugë e jo në klasë, sesi mbahet ora e mësimit, në çfarë gjendje i kanë shkollat, tekstet shkollore. Dhe, a kanë revista për fëmijë dhe lektyra shkollore?! Edhe, seç ma kujtuan kohën e "artë" komuniste. Atëherë, kur dorë më dorë ia dorëzonim shtafetën shokut Tito për ditëlindje, mbillnim pisha e shkruanim parulla politike maleve. Po, cili mësues i artit figurativ, sot hynë në klasë me poezinë e Çajupit: ***Sulltani***?! Askushi.

Jam sulltan, mbret i vërtetë,
shok të tjerë s'kam në jetë;
gjakëtor e zemërderr,
nga frika me bëjnë nder!
Dola nga fund' i Azisë
si rrebesh' i perëndisë:
Vrava, preva e shkretova,
botën me gjak e mbulova!')
Kur zotova Anadollë,
erdha mora dhe Stambollë,
njerezit i shkova në thikë,
dhe, kush mbeti, rron me frikë!...

……
Egërsirë si ariu,
me fytyrë si njeriu,
më dërgoi perëndia,
që të vuaj' njerëzia!
…….
Prisha, vrava, preva, hera!
Bëra, po ç'nukë kam bërë?
Prisha botënë të tërë!
Mysliman' e të krishterë
Kam dërguar n'atë jetë,
më tepër se ç'vdiqnë vetë!
Jam i zoti, rroj me pallë,
s'dua te shoh njerëz të gjallë!
Nat' e ditë gjak kërkoj,
pa pirë gjak s'munt të rroj!
Dhe tani q'u bëshë plak,
nukë munt të fryhem gjak!
Ata që kam nënë zgjedhë,
të mundije tok t'i mbledhë,
me dorë time t'i vrasë,
të pijë gjakn' e rajasë!
Pse s'u be nga perëndia
me një kokë njerëzia,
që ta presë menjëherë,
të mos mbeteshin të tjerë!
…….
Qajnë! Po kush nukë qa?
Qajnë burra, qajnë gra,
qajnë maletë për pyje,

qajnë fushatë për lule!...
Kudo shkela u tha bari,
ç'la pushka e dogji zjarri!...
……
Me punëra që kam bërë,
më duken armiq të tërë,
mysliman' e të krishterë;
sa dhe trimat shqipëtarë
zun' e më punojnë varrë!
…….
Keshë kombn' e Shqipërisë,
direk i gjithë Turqisë;
pse s'më priti sa të vdesë
pa të më dil i pabesë!
Me Shqipëri të leftonem,
kam frikë mos turpëronem;
kam frikë nga Skënderbeu
mos dalë prapë nga dheu!...

Fat i yni ishte ky historik, që kishim në ballë ato mësuesë të rritur me poezitë e Rilindasëve shqiptar. Mësuesit e sotshëm u lindën në sistemin komunist me poezinë e Koço Racinit: *Duhanvjelësit* dhe poezitë e shokut Tito. Librat e këndimit, ku në ballë të klasës i priste fotografia e shokut Tito. Revistat për fëmijë, ku nateditë i këndohej shokut Tito dhe "vëllazërim-bashkimit" të sistemit komunist jugosllav.

Shqiptarët e vegjël, që nga bangat shkollore përgaditeshin për duhanvjelës, e jo për mësuesë,

shkrimtarë, mjekë, inxhinierë e shkencëtarë. Ose, siç e ka thënë moti që në kohën komuniste poeti i madh Esad Mekuli: *O vëlla, me sharrë në krah*. Drutë e sulltanëve të Beogradit duhej t'i sharronte shqiptari për Dimër. Përçudi, askujt nuk i ka shkuar në mend asaj kohe se, ai i cili sharron drutë e sulltanëve për Dimër, një ditë do ta sharrojë edhe vetë Sulltanin. Zjarrin ta ndezi me flakë në oxhak, tymi t'i shkojë mbi çati plotë xixa për qielli mes yjeve.

Dhe, ajo ditë erdhi me struken krahëve. Tregimin e Pemës me fruta të atyre librave të këndimit që e kishim asaj kohe mes atyre faqeve mbi bangë*:* **Mbollën të tjerët hëngra unë… Dhe, tash mbjellë unë, të hanë të tjerët,** dhanë fruta.

Mësuesi im i atëhershën i artit figurativ, Ramadan Ramadani – Ballazhi, i cili në atë kohë të egër hynte në klasë me vjershën e Çajupit: *Sulltani*, sot në historinë artistike shqiptare po lë gjurmë edhe më të thella, përveçse si mësues edhe si piktor. Përderisa, dikur vargjet e Çajupit e dridhnin klasën, sot brusha e tij shkund nga pluhuri historinë.

Ngjarjet historike shqiptare, Ditën e sotshme po përjetësohen edhe në pëlhurë. Shpirt marrin t'i bëjnë ballë Ditës Nesërme me Kalë të bardhë nëpër botë.

Përgëzime!...

ERDHI ME PRANVERË
DHE IKU ME DIMËR

(*Përkujtim artistit: Agim Ramadani*)

Përderisa Kërçova fotografin e parë kërçovar Emin Kallnaga e përcolli me dhunë në Turqi, pas një burgosje policore, artistin e dytë Agim Ramadanin e percolli rrëzë malit në sydiell me respekt dhe nderime. Shtëpinë e përjetshme, nga ku me fotoapartin e tij vazhdojë t'i regjistrojë ngjarjet historike dhe gjurmët e vendlindjes me rreethinën e Kërçovës. Syri i tij magjik hyri në çdo shtëpi dhe shkollë. Vepra e tij artistike gëzoi shumë shkollarë, fotografitë e të cilit edhe sot ruhen me xhelozi.

Fotoaparati i tij regjistroi edhe bashkfshatarin e tij Xhelko Makasutin, në Bukuresht me të bijën e tij Kristina Maksutin me veshje kombëtare kërçovare. Omer Kaleshin, piktorin e madh kërçovar me famë botërore. Gjyshin e tij Hoxhë xha Nazimin, që nga Bukureshti e solli në fshatin e tij Novosell (Katundi Ri) edhe poetin e madh shqiptar, autorin e Himnit kombëtar Asdrenin. Babain e tij piktor dhe veteran të arsimit i ndoqi hap pas hapi në karrierën e tij artistike. Fotoaparati i tij regjistroi

edhe shumë personalite të tjerë kërçovar e mbarëshqiptar, që Nesër do të na rrëfejnë histori.

Agim Ramadani (23.08.1957 – 11.02.2015)

E patëm krah të djathtë gjatë ngjarjeve arsimore, kulturore e politike në Kërçovë. Syri i të cilit do të na mungojë edhe për gjatë kohë. Edhe pse, ai jeton në kujtimet tona, shtëpitë tona, shkollat shqipe. Po, jo edhe një ekspozitë e fotografive artistike të cilën me siguri në të ardhmen do t'ia organizojnë kërçovarët në vendlindje.

Agim Ramadani ishte edhe aktivist i madh dhe anëtar i këshillit të shkollës mesme "Drita" në Llapkidoll me drejtor Ilmi Veliun. Djali i veteranit të arsimit shqip në Kërçovë, Mësues Danit, i cili në popullatë ka qenë dhe është i

njohur si Dani i Novosellit (Katundit Ri), ku vendlindjen me brushë në dorë e përjetësoi edhe në pëlhurë.

Novoselli (Katundi Ri), edhe pse fshat shumë i vogël i malësisë së Kërçovës, është përmendur që moti si vendlindje e patriotit të madh Rexhep Novosella, pastaj vendlindje e Bakes së Novosellit, Danit të Novosellit dhe profesorit të respektuar dhe nderuar Sula i Novosellit. Emra të cilët kanë lënë gjurmë të thella në histori nga një fshat i vogël, e sidomos emri i Rexhep Novosellës (Katundit Ri), i cili në vjeshtën e vitit 1912 e priti dhe e gostiti në Bukuresht babain e Shtetit shqiptar – Ismail Qemali.

Edhe, Agim Ramadani është pasardhës i këtyre burrave që i përmendëm, dhe në qytetin e Kërçovës është i njohur si fotografi i parë shqiptar dhe i vetmi deri në ditën e sotshme. Para Agimit, gjatë Luftës Dytë Botërore e deri më 1948 si fotograf shqiptar ka punuar Emin Kallnaga, i cili burgoset dhe dënohet me 6 vjet burg me akuzën se i ka shërbyer Ballit Kombëtar, që pas burgut detyrohet të ikë për në Turqi.

Emri i Agim Ramadanit është i pranishëm dhe shënuar në të gjitha fotografitë e shkollave fillore e tetëvjeçare të rrethit Kërçovës, punë të cilën ai e bënte me përkushtim dhe dashuri të

madhe. Agimi ka mbetur në kujtesën e të gjithë nxënësve tonë, sepse ai ishte artisti që fotografonte dhe përjetsonte kohën dhe ditët më të vështrira të arsimit shqip, në Kërçovë. Fotografi i palodhur me fotoaparat përqafe merrte pjesë rregullisht edhe në protestat kundër mbylljes së paraleleve shqipe të gjimnazit të Kërçovës. Poashtu edhe si anëtar i këshillit të shkollës po edhe si fotograf, ku i ka përjetsuar të gjitha aktivitetet arsimore e kulturore. Agimi ka bërë edhe fotografinë – tablo të gjeneratës së parë të kësaj shkolle. Shumë kujtime që na kanë mbetur nga ajo punë aq e madhe e asaj kohe janë fotografuar dhe përjetësuar nga dora e syri i Agim Ramadanit.

Agim Ramadani do të mbetet në kujtesën e kërçovarëve si njeri shumë i urtë, shumë konstruktiv, dhe i gatshëm për t'u shërbyer nxënësve, mësuesve, studentëve, intelektualëve, gurbetçarëve po edhe popullatës tjetër, në çdo kohë dhe moment.

Erdhi me pranverë… Dhe, iku me Dimër…

AMANI ZBRITNI PAK GOMARIT T'I HIPË NASTRADINICA

Kohën e fundit, nuk merrem si "analistët" teknefesë me "Bombat" politike të Zaevit, e as me "Puçin" dhe përmendoret e Gruevskit me thika dhe pushkë në duar, më këmbë e mbi kuaj gati për luftë. Pallatet disakatëshe, që na mbinë brenda natës në mes të parkut si këpurdha në vend të barit dhe luleve. Ndërtimet e "egra", që na e kanë zënë frymën dhe diellin. Bërlloku, i cili na ka mbuluar këmbekokë në mes të Dimrit Madh, krah për krahu me analistët e arratisur të partive politike, që i shkruajnë letra të hapura "dashurie" Zaevit. Mendja i rren trusakatët se, Zaevi do t'i shpëtojë nga Përmbytja e madhe në Shkup, e jo Varka e Noit (Nuhit) në mes të Vardarit.

Reagimet e "heshtura" politike të Ali Ahmetit dhe Menduh Thaçit në mjetet e imformacionit. Përgjimet telefonike, që për mua janë lodra fëmijësh në pluhur përpara Shtëpisë. Aty shahen, aty pajtohen në Lëmë për një bonbone. I kanë përzi kukullat fustankuqe. Copën e kulaçit me pekmez. Shkaku se, e kam thënë moti në shkrimet e mia publicistike: ***Zaevit, "bomba" politike ende pa e hedhur i ka pëlcitur në dorë.***

Fatkeqësia është se, populli ende u duartrokitë këtyre "arushave" politike në valle para kamerave televizive. Shaminë e pionierëve ta hedhin mbi kokë në Sheshin "Makedonija", para këmbëve të kalit të Aleksandrit Madh. Edhe, atë: Hamdi Bajrami sa herë që i bie dajres. Zaevit, siç duket pritet publikisht t'ia ngopë me dorë na, para kamerave televizive mu si dikur Cërvenkovskit. Arsye: Grupi parlamentar i tyre jashtë Kuvendit, gati një vit marrin paga mujore pa asnjë ditë pune, kur populli i pafajshëm vdes edhe për bukën e gojës. Dhe, këngëtari popullor me plis të bardhë në kokë, përditë në mes të Bit - Pazarit ua këndon këngën popullore të Hafsa Zyberit me çifteli:

Çohi djema shaloni atin
Besa atin e kam shalu
Cili djal o po vjen o me mu?

Cili djal o po vjen o me mu
Po thot Mema po vij unë.
Ja pret Stafa ma i parë jam unë.

Ti bre Stafë o Staf o Delia
Sot po t'njifet o burrënia
Me qitë pushk o ke zotnia.

T'kishe pasë o nji djal o si Mema

Paç me i hy o vezirit mrena
Paç me ia le oxhakun me femna.

Paç me ia le oxhakun me femna…

Dhe, përkarshi kësaj kënge popullore, burrat e mejdanit merren me përgjime telefonike, gjoja se përpiqen të "bëjnë ndryshime politike". Duartrokisin para kamerave televizive inçizimet e fshehta të kryetarëve të partive politike, ministrave, deputetëve të popullit, "armiqëve" të Shtetit "përbashkët" dhe aktivistëve partiak me "besë". Skenare politike dhe luftë të madhe bëjnë për të ardhur në pushtet. E imitojnë partizanin e vogël Boshko Buha duke hedhur bomba italjani mbi "armikun" gjerman. Dalldisin Plenumin Studentor me pankarta në duar e parulla në "okupimin" e fakulteteve pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" duke i shpallur si "Zona Autonome", në vend që t'u sulen me dije e libra profesorëve dhe arsimit të politizuar nëpër kabinete.

Fat i tyre, që ky popull nuk është si populli i Kosovës: Shtetin e Ri t'ua lë në dorë si patate të nxehtë politikanëve, e veten me gjithë familje ta arratisin maleve, ikin nga sytë këmbët nëpër botë. Rrugëve ilegale të varrosen në borë mes Dimrit Madh. Nata e dita t'u pri matanë Atdheut, që kësaj radhe nuk ikin nga serbët, po nga shqiptarët.

Shqiptarët krah për krahu me "vëllezërit", vërtetë edhe ato rebelohen si në kohën e Babadovletit, dalin në mes të Dimrit Madh në protesta për pushtet argati, e thirrin "pranverën arabe" me flamuaj të huaj e një haxhuxhe në mes të Shkupit, i "pushtojnë" dhe shpallin para kamerave televizive si "Zona Autonome" fakultetet, po megjithatë nuk e braktisin si shqiptarët IRJ të Maqedonisë.

Durim, o pilitikanë të dalldisur e arratisur me vite nëpër poste e kulltuqe politike. E keni gabim: Pushtet nuk u sjellin "bombat" politike të Zaevit të hedhura para kamerave televizive, po Lufta heroike dhe votat e popullit. Punë tjetër është ajo se ju, a jeni aq trima që ta nisni edhe një luftë "çlirimtare", si ajo e 2001 –shit për të ardhur në pushtet, ose me metoda demokratike t'i fitoni votat e popullit në zgjedhjet e ardhshme parlamentare?! Komandantë pas lufte t'i shpallni familjarët, miqtë dhe shokët pa e shkrepur edhe një plumb për liri. Dëshmorëve duke u ngritur përmendore me flamurin kuqezi mbi kokë.

Rreziku: Në emër të popullit jeni ngjitur shumë lartë, mirë do të ishte të zbrisni pak më poshtë, në mesin e vegjëlisë. Këmbëkryq të uleni në sofër. Kulaçin ta ndani së bashku si "vëllezër". Kokës t'i bini me të dyja duart me grushta. Pushteti në Ditën e sotshme nuk merret me dhunë, po me tru, punë dhe politikë madhore.

Moti vdiq koha e armëve (kobureve), lufta sot bëhet me libra dhe penë. Punë tjetër është ajo se, ju penën e luftoni me armë nëpër përmendoret e Gruevskit dhe "bombat" e Zaevit. Thikat dhe pushkët e dudumëve. Shkopin e Car Dushanit. Fatkeqësisht, edhe me politikë të katundeve.

Zoti mos e dhashtë me barrën e vjetër politike, përsëri t'i hipni gomarit të Nastradinit në shpinë me të katra këmbët e rrasura në batak. Herë i hipë Nastradini, e herë Nastradinica me njëqind kg. peshë rrugës për në pazar. Mëkot, u thonë kalimtarët e rastit, që t'i zbrisni pak gomarit, t'i hipë Nastradinica. Edhe, ta shihni vetë me sy, bindeni se: gomarin nuk e cofë Nastradini me 50 kg. peshë mbi samarë, po Nstradinica me njëqind kg, barrë mbi shpinë. Veshë nuk keni ta dëgjoni edhe zërin e popullit, po me këngë e fyell vazhdoni të lumtur rrugën përmes fushës. Punemadhe, që bereqeti juaj vonohet me vite udhës për te Pazari drithit. Problem tjetër është ai se, a do të keni blerës për këtë mallë me afat të skaduar katundi?! Bota e përcakton çmimin e vlerave.

Shekulli i Ri, di të t'i mbylli edhe sytë në ballë, nëse nuk ke tru në kokë, duar dhe këmbë. Nuk më trembin "bombat" e hedhura partizane të Zaevit para kamerave televizive, po një plis i bardhë në Shkup dhe njëqind ferexhe. Zingjirët ende i kemi nëpër këmbë. Shaminë e zezë mbi

kokë e fytyrë. Sytë e mbyllur në ballë. Ferexhenë e zezë hedhur krahëve si një xhadi qytetare.

Amani, zbritni pak gomarit t'i hipë në shpinë edhe Nastradinica!…

Agim Ramadani: Zana e Malit në breg të lumit…

HESHTËNI SE UJKU TROKET PAS DERE

Gjallë është Kulltugofagu i Fan Nolit. Dudumi, po të mos ishte gjallë, shqiptarët sot nuk do të ishin në këtë gjendje politike, ekonomike, arsimore e kulturore. Copë – copë të shpërndarë në disa shtete si Kashta e Kumtrit. Haxhuxhet, edhe sot e kësaj dite, t'i dalin zot me theshetheme politike popullit shqiptar. Edhe, dalldisen me "ilahi" politike në themelimin e partive të reja politike "shqiptare": "Pyka", "Besa" dhe"lëvizje" të tjera qytetare me trutë dhe këmbët në legen.

Besa shqiptare, çka ka lidhje me partitë politike?! Tekefundit dudumët, a e dinë se në politikë, nuk ka besë e as sinqeritet. Politika i do vrasësit, hajdutët dhe mashtruesit. Hidhnu një sy politikanëve historik të mbarë botës: vrasës, hajdutë, mashtrues dhe diktatorë për të ardhur në ballë të popullit e mbajtur në dorë pushtetin. Populli, gjithmonë ka qenë dhe është si ato delet e buta, që si turmë shkojnë pas bariut. Një dele të kërcejë në lumë, të tjerat njëra pas tjetrës hidhen në hurdhë. Dudumët, a e dinë çka ka qenë Besa shqiptare për shqiptarët me shekuj?! Atëherë, ende shqiptarët këto dudumë do t'i lejojnë ta mashtrojnë popullin shqiptar me kësi "ilahish" neokomuniste?! E kënaqën Partitë Politike Shqiptare: me plis të bardhë (PPD), shqiponjën

dykrenare kuqezi (PDSH) dhe "brumi" i arratisur i tyre duke përvetsuar vlerat e UÇK –ës në themelimin e një partie të re politike BDI pas Lufte (2001). Fatkeqësi kombëtare! Dudumi ynë është rritur haleve të huaja. Kurrë, nuk ka dalë arave shqiptare, rrisë, shalqinin, kungullin, ose lakrën shqiptare.

Qerren, bujku shqiptar ta ngarkojë nga ara dhe t'ua dërgoj fëmijëve për Dimër. Shkarkojë në lëmë kungujt, që nuk janë rritur me rrëfangë gjirizi. Barkun lakuriq nga gëzimi dhe kënaqësia ta fërkojnë me duar. Në mes të lëmës të brohorisin: Më në fund erdhi bereqeti shqiptar në Lëmë. Fjalën e kam për vizitën e Ilir Metës (kryekuvendarit të Shqipërisë), në Shkup. Politikanin të cilin e priti në kufi dhe i printe komandant Mësuesi, që pas takimeve me Velanovskin në Kuvend dhe Ivanovin në Rezidencë, zbriti edhe para Univeristetit të Europës Juglindore në Bit –Pazar, për ta vizituar "Librarinë e Çarshisë". E jo, te Sheshi "Skënderbeu", përshëndetet me Heroin kombëtar të shqiptarëve. Vendtakim nga ku, IRJ e Maqedonisë më parë mund të shkojë në Europë, sesa nga Universiteti i Shtulit mbi urë, rrëzë Kalasë Dardane. Krah për krahu me Izet Mexhitin dhe partizanët e Bit – Pazarit kaloi pranë përmendores të Skënderbeut pa e kthyer as kokën, sikur Kryeheroi legjendar kombëtar të ishte një gur varri. Punë tjetër është ajo se, para

këmbëve të Kalit të vëndosnin edhe ndonjë kurorë me lule. Nuk them, kurora me lule të vëndosnin te përmendoret e Aleksendarit Madh (Leka i madh), siç e thirrë një këshilltar i BDI –së në Komunën e Shkupit, Olimbia me fëmijë në gji e prehër, e as te Filipi i Maqedonisë, që i priti dhe në hyrje të Çarshisë dhe përshëndeti me grushtin lartë në kokë si xhaxhi Enver.

Kutadi, Meta ndoshta u tremb nga përmendoret e "vëllezërve", matanë e në këtë anë të Vardarit, që e pritën para institucioneve të Shtetit "përbashkët" me pushkë e thika në duar më këmbë e hipur në kuaj me shalë të gatshëm për luftë, pushtojnë Çarshinë e Shkupit. Përkarshi te këmbët e Urës Gurit Mitropolitët e Beogradit: Shën Klimenti dhe Naumi krah për krahu me Kirilin dhe Metodin me kryqa e bibla në duar. Përderisa, Skënderbeu që e kaloi "ilegalisht" kufirin shqiptaro - shqiptar hipur mbi kalë e ka shti shpatën në brez, në Bit - Pazar. Ose, nuk deshi ta shoh përmendoren e Skënderbeut sesi e kanë mbuluar varrezat e automobilave. Shkak ky, që sipas agjendës së takimeve, më në fund i kishte lënë për tekime liderët shqiptar. Takimi me Ali Ahmetin, që ishte paraparë në hotelin Holidey Inn, në Shkup, u realizua në Klinikën e Tetovës, shkaku "aksidentit" në komunikacion, përpara pikës së pagesës rrugore në autostradën Gostivar - Tetovë. Frytdhënëse në këtë takim, ishte përkrahja e kryetarit të PDSH –së, z. Menduh

Thaçi i cili deri dje trumbetonte se, Marrëveshja e Ohërit është e vdekur, paritmas pas 14 viteve kërkoi "realizimin e plotë dhe të përshpejtuar të Marrëveshjes së Ohrit". E harroi Marrëveshjen e re në letër të PDSH –së. Edhe pse, Meta para se të vij në Shkup ishte takuar me liderin e pakicës "maqedonase" në Pustec, Kryetarin e Komunës z. Edmond Temelko me të cilin kishin biseduar për një mbështetje më të madhe që duhet t'i japim integrimit të mëtejshëm të pakicës "maqedonase" në Shqipëri.

Mesazhet e Ilir Metës, që do t'i jap plot pas 14 vjetëve mbështetje MO, në Shkup, aqsa janë serioze, janë edhe qesharake: "Kemi ardhur sot në Shkup për të dhënë mesazhin e qartë të miqësisë sonë të sinqertë, dhe t'ju rikonfirmojmë se Shqipëria, si fqinji juaj dhe si një vend anëtar i NATO-s, e mbështet plotësisht e në mënyrë të pakursyer Maqedoninë në rrugëtimin e saj të integrimit euro-atlantik, të bindur se e ardhmja jonë e përbashkët gjendet në Bashkimin Evropian dhe me një Maqedoni të anëtarësuar plotësisht në NATO".

O Imzot, ku ka miqësi të sinqertë në politikë, përveçse te shiqptarët?! Besë në politikë, kanë vetëm shqiptarët. Kohën e fundit edhe Lëvizje Politike: "Besa". Në emër të popullit shqiptar, ne "kemi nxënë mësimet e hidhura të historisë së Rajonit tonë dhe se i përkasim një gjenerate, që dimë të shohim në mënyrë

evropiane, të ardhmen tonë realisht evropiane. Ne jemi të bindur, që kjo rrugë, rruga e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit pozitiv, është një shprehje e vullnetit të popujve që ne përfaqësojmë. Dhe popujt kanë dashur dhe duan, paqe, bashkëpunim dhe mirëqenie".

Popujt po, por jo edhe politikanët. Kuvendi, ku nuk janë të barabartë si "vëllezër". Nëpërkëmben të drejtat kombëtare: Institucionet "paralele" të shqiptarëve, gjuha shqipe, flamuri, arsimi dhe kultura. Vëllai Madh, ku i hanë nga dy petulla në sofër. Kurrë, nuk i teket t'i hudhë një kafshatë edhe Vëllait Vogël, i cili gjithë jetën mbeti duke fërkuar me dorë barkun cullak për mejdani. Edhe, e dini pse?! Shkaku se, Vëllai Vogël është i sinqertë dhe ka Besë në politikë.

Dhe, vazhdon politikani i arratisur me "mesazhet" historike: "Gjykoj se veçanërisht gjatë 14 viteve të fundit është bërë një progres i ndjeshëm. Sot, jemi më mirë se ç'kemi qenë dje. E them këtë nga pozitat e një politikani optimist për të ardhmen tonë të përbashkët evropiane dhe i ndërgjegjshëm se ne nuk jemi thjesht fqinj dhe nuk duam thjesht të jemi fqinj, por mbi të gjitha vëllezër që jetojmë në një hapësirë të përbashkët ekonomike e sociale".

Hi-hii-hiii, "Rilindje" e vërtetë në politikën shqiptare… Realiteti, sot nuk jemi më mirë se dje. Përçudi, historikisht ne shqiptarët kishim pasur edhe shumë vëllezër, motra e baballarë:

vëllezërit serb, Babadovletin, vëllezërit kinez, Motrën Kinë… Në sistemin komunist jugosllav ishim shtetformues, kishim gjuhë shqipe, lirshëm e valonim flamurin kombëtar, kishim arsim dhe kulturë. Edhe politikanë me poste të larta shtetërore: Sinan Hasanin, kryetar shteti të gjithë Jugosllavisë. Në Shtetin e "përbashkët", vetëm zv/ kryeministra, nënkryetar të Kuvendit, ministra, drejtorë e zv/ drejtorë. Njëzetepesë vjet me radhë nuk e patëm një kryeministër shqiptar, kryetar të Kuvendit. Mos e dhashtë zoti kryetar shteti të IRJ të Maqedonisë. Kosova, pati edhe Universitet, polici shqiptare, mjete të informacionit e poste të larta krahinore e shtetërore në Prishtinë e Beograd. Vetëm se, asaj kohe nuk kishim kaq shumë politikanë të pasur dhe hajdutë. Dorën në zemër, edhe atëherë gati të gjithë vidhnin krah për krahu me popullin, por ishte e pasur Jugosllavia komuniste. Tashti vjedhin vetëm politikanët, edhe atë: popullin e vet dhe Shtetin pa brekë në bythë. Pacientin e sëmurë, që me infuzione (ndihma sociale) e mbajnë gjallë ndërkombëtarët.

"Popujt tanë janë të famshëm në Ballkan, si mjeshtrat e projektimit dhe ngritjes së Urave të Gurta, që qëndrojnë në këmbë prej shekujsh. Klasat tona politike, duhet të ndjekin më me pasion dhe më me modesti, këto dhurata të historisë sonë të përbashkët". Fantastike! Nuk e luan as topi i Mic Sokolit. Ditën i ndërtojmë e

natën, i rrënojmë me shekuj duke murosur Nuse të reja me nga një gji jashtë për politikanët.

Vazhdon retorika politike patetike: "Më lejoni që në emër të miqësisë sonë të sinqertë, të shpreh bindjen e thellë për domosdoshmërinë e zbatimit të plotë të Marrëveshjes së Ohrit, dhe për jetësimin e saj integral". Qeshje me bark: 14 vite kjo marrveshje zvarritet në Qeveri, Kuvend dhe selitë e partive politike. Koha më në fund, sipas Metës i erdhi të rrokulliset edhe po kaq vite nëpër institucionet e 'pëbashkëta". "Vëllezërit" për njëzetë vjet ndërtuan Shtet, e shqiptarët gjatë gjithë kësaj kohe u morën me enët dhe lugët: gjuhën shqipe, flamurin, arsimin, kulturën, lektyrat dhe tekstet shkollore. Shtëpinë e mori "Vëllai" Madh: arat dhe malet. Marrëveshjes Ohërit, për zbatim të plotë i janë dashur shumë, shumë pesë vjet.

Ditën e nesërme, pas kthimit të Ilir Metës në Shqipëri, vjen edhe zëvendësministri dhe ministri jashtëm i Kosovës Hashim Thaçi. Përveç takimeve me qeveritarët, Thaçi i Prishtinës në agjendën e vet do ta parshoh pas tetë vjetëve edhe një takim me Thaçin e Tetovës. Ecejaket e tyre në Shkup, njëri pas tjetrit me përcjellje të përforcuar sigurie gjatë kohës të bojkotimit të Kuvendit nga LSDM –ja (gati gjysëm viti) dhe protestave të studentëve për ndryshimin e Ligjit në arsim, gazetarëve për fjalën e lirë dhe Sindikatës të Arsimit Shkencës dhe Kulturës, të shtynë të

mendosh se përveç "bashkëpunimit" fqinjësor, kanë edhe prapavijë politike. Padashtas, na i kujton nënat tona, kur bënim ndonjë bela ose nuk na merrte dot gjumi, i bienin dërrasës të shtratit me dorë: Heshtë, flej se pas dere troket ujku! Interesant, sot sa shumë u gjasojnë edhe vizitat e politikanëve shqiptarë "ujkut" të fëmijërisë sonë pas dere. Gruevski, mu si nënat tona që na trembnin me ujkun, sot e tremb popullin e vet me shqiptarët: LSDM –së, kthehuni në Kuvend, studentëve dhe profesorëve, rrini urtë në Universitet, gazetarëve, mbylleni gojën dhe Sindikatës së Arsimit Shkencës dhe kulturës, kthehuni nëpër vendet e punës! Heshtëni, se pas dere, troket ujku (shqiptarët)!

Kulminacioni i Shekullit: Hoxha i Allahut i ka të gjitha liritë. Përmëtepër, edhe qiellin me gjysmëhënë. Përgjumshëm i dehur me çaj rusi në Bit - Pazar, publikisht thërret në minare: Gjallë është Dudumi. Gjallë. Dolli me çaj rusi ngre me shokë partizanë për "fitore" historike. Hi-hii-hiii… Haxhuxhja, që ende nuk e nxorrëm nga haletë tona shqiptare t'i plehërojmë arat pas Çuke për kunguj Stambolli. Dudumi, që ma përkujton porosinë e Babait: Rrufjanin, ta mbani sa më larg Shtëpisë! Sot, Dudumi sipas Hoxhës Allahut do të bëhet edhe zot Shtëpie.

Jo, o Hoxhë i Allahut! Dudumi, kurrë te shqiptarët nuk ka qenë Zot Shtëpie! Fëmiu i sotshëm nuk trembet më nga nëna me ujkun.

Shkaku se, ai sot vetë i bie dërrasës të shtratit me grusht e këmbë: Heshtë nënë, se ujku është pas dere. Nuk është ai fëmiu i kafshëve shtëpiake të livadheve, po hutaçi me laps e libër në dorë që ka linduar para televizorit, kompjuterit. Tekefundit, Dudumi ka jetuar me shqiptarët, por e kemi mbajtur sa më larg pragut të Shtëpisë. Dorën në zemër, e kemi përdorë si plehër bagëtie, por vetëm në rolin e kafshës shtëpiake. Kurrë Dudmi nuk i ka pri Shtëpisë shqiptare! E, prej nga ku sot Dudumi duhet t'i pri në ballë popullit?!

Koha e turkut (Baba Dovletit) moti ka përfunduar në Ditën e sotshme. Edhe, e "vëllezërve" neokomunist. Kot e keni të gjeni ndonjë dele të zezë që ta hudhni në hurdhë. Delet tjera vetë të kërcejnë njëra pas tjetrës ta mbysin veten në lumë.

Populli shqiptar sot për sot, nuk janë dele të zeza e as dele të bardha, po ogiçë me brirët e përdrdhur shtatë herë rreth veshëve mes livadheve. Bythekrye si kungull Stambolli të hudhin në përrua…

LAVDI "HERONJVE" TË XHADISË

- O plak, pendohu për të gjitha ato që i fole pas "teravisë" në xhami!

- Kush je ti tani, që më urdhëron natën, para se të dalë agimi?! Përgjumshëm në vend të Allahut, e thirrë nateditë Shejtanin në minare. Edhe, atë: në Ditën e sotshme të Motit Madh (2014) ma përmend "Ezanin e Sabahit", do të më përzësh me dhunë në Turqi?! Në protesta qytetare del me "Allahu akbar" dhe flamur turko-arab. Kësulë - leckë të zezë në kokë. Ose, "shajkaçë" sllave.

- Unë?

- Po, ti me ferexhenë e zezë krahëve.

- Unë jam Shejtani i Allahut. Ose, me "veprimet artistike-patriotike": Hoxha i Allahut. Bindu dhe lutu përpara këmishës së bardhë me oja e xixëlla deri në fund të këmbëve, kur dal natën me trumbeta nëpër Bit - Pazar!

- Jo, or Shejtan i Allahut! Jo. Frikë kam mos më rrahin me dru kur të dalë drita! Vulën e Dexhallit të ma vënë në ballë pas Përmbytjes Madhe (Kiametit). Shkaku se, ti në faqen tënde të Facebook –ut si "pejgamber i fundit" mysliman pas Muhamedit a. s. mu si dje ma ke paraparë edhe fundin tim, vdekjen solemne. Edhe atë, ma përmend pa fije turpi të ndjerin Ardian Klosi. I mjeri ti me këmbët dhe trutë në legen. Ende nuk e di gjakun tim që më ec nëpër damarë. Karakterin

që më ndjek si hije brez pas brezi me shekuj. Kurrë, nuk mund ta vras veten si qen në mes të rrugës. E di, ju mund të më helmoni, vrisni kur të doni në çdo hap. Vetëm e keni gabim si dje edhe sot se, unë vetë mund t'ia heq këmbëzën e revoles vetes në kokë?!... Veprimin e këtillë nuk e lejon as edhe Kur'ani në të cilin ju thirreni si "myslimanë ehamdurila". Haram sipas Kur'anit është ta vrasësh veten si qen. Kush je ti o Hoxhë i Allahut, që thirresh në "Din e Iman" e këndej më rrëfen përkundër dëshirës Zotit rrugën e vetëvrasjes?! Përmëtepër, edhe thirrë në ndihmë: "apelon te ndonjë shqiptar musliman në Shkup, në mungesë tonën atje, të padis Shkrimtarin për "shpifje" që ia bënë "hoxhës"… Paçavurja "revolucionare" i merr mbi supe të gjitha shpenzimet gjyqësore. Imzot, ky është kërcnim klasik?! E në anën tjetër trumbeton se, unë kurrë nuk kam pasur kërcnime e as sulme fizike. Edhe, ju u thoni këtyre dudumve myslimanë, që thirren nateditë në "Din e Iman"?! Përbaltin Fenë Islame tradicionale me thirrje terroriste për hakmarrje.

- Mos u tremb, o plak! Unë dal edhe ditën. Thuaj, atë ditë isha i marrë kur fola marrëzira në xhami! Lotët e Shën Mërisë Virgjër më mashtruan nën hije të Rrapit. Cuca Boheme me dy shtamba verë mes poezive.

- Ti thua që del edhe ditën, por ditën del pa këmishën e bardhë. Lugatin ditën pa këmishë të bardhë deri në fund të këmbëve, nuk e kanë frikë njerëzit.

- O plak! Unë aq sa jam i rrezikshëm natën, jam edhe ditën.

- Të besoj, por kam frikë… Frikë… Ditën nuk ke këmishë të bardhë, por çallmë turku, shajkaçë në kokë në vend të kësulës së bardhë të Bajram Currit.

- Plak, ti duhet të më kesh frikë mua, të kap për fyti, ta nxjerr shpirtin me thonj.

- Jo, or Shejtan i Allahut! Jo. Të marrët, asnjëherë nuk frikohen nga ata të rrezikshmit! E, as nga Bajlozi Zi që del nga deti, po nga të urtët…

- Plak, do të pendohesh një ditë. Mos u përzi në punë të kojshive!...

- Kurrë! Eci pas një Ëngjilli (Melaqeje) me dy shtamba verë.

- Ai Ëngjëll (Melaqe) të çon në varr. Plak, hiq dorë nga zbulimi i mëkateve! Mendohu edhe një ditë! Nesër, do të vij të bisedoj prapë një natë. Edhe të tjerët janë njerëz.

- Mos eja kurrë! Të mëshoj me shkop aty ku lidhet Sagjini, në lule të ballit. Vështirë e ke të më

hipësh mua në tren për në Turqi. Ose, të më shtish me hajmali të bëj vetëvrasje. Edhe atë, kush më ndërsehet pas shpine: Buça e Katundit me Këlyshin me zgjebe. Bërlloku shqiptar, që e fsheh veten nën ferexhe dhe dimi të grave. Halldupi, që mezi e njeh nëna e vet, e ku më Katundi ose lexuesi shqiptar. Pavetëdije e zbuloni veten si autorë të komenteve ofenduese, kërcnuese dhe gjysëmanalfabete nën shkrimet e mia publicistike. Frikë keni të dilni me emër e mbiemër si burrat në fushën e mejdanit. Ferexhenë dhe shaminë e zezë nëpër shekuj me të cilën e fshihni fytyrën me gjithë sy ta hidhni në përrua. Flamurin kuqezi kombëtar në këtë Njëqindvjetor të pavarësisë të Shqipërisë ta nxirrni të valojë nëpër minare të xhamive. Publikisht, para botës këmbëkryq ta shpallni Xhaminë shqiptare.

Hoxha i Allahut, që harron se unë vij nga Katundi i xha Derallës. Burri i mençur, që gjithë jetën është tallur me "hoxhën", kur i është kërcnuar pse nuk shkon në xhami me zjarr të Xhehnemit. E dini si i është përgjigjur plaku i mençur Hoxhës Allahut? Jo, nuk e dini. Hoxhë, harron ti se nëntë muaj janë dimër, e vetëm tre muaj verë. Acari madh kur do ta kaplojë Xhehnetin tënd me lule do të vish të më lutesh në Xhehnem për pak zjarr, por jo nuk do të të jap, do të të përgjigjem: rri mërdhiu në Xhehnet! Pastaj, përderisa unë të arrij në Xhehnem, ti më me gjithë ato mëkate në shpinë veç ke shkuar para meje me shokë. E ke shuar zjarrin e Xhehnemit.

Katundi im, vjet për vjet ka nxjerrë në mal nga një kaçak ta luftojë pushtuesin osman, u ka ra stacioneve të policisë serbe e fashsite me armë në dorë. Nuk do t'i përmendim kësaj radhe emrat e kaçakëve të maleve, ata i di e gjithë bota. Mjafton kësaj radhe të përmendim mësuesin patriot e ardhur nga Shqipëria Llaqi Prenqi, që me nxënësit e Katundit dhe flamurin kuqezi kombëtar në ballë e sulmoi stacionin e karabinierve në fshatin Shutovë të Kërçovës (1944). Flamur, që edhe sot e kësaj dite ruhet me xhelozi si kujtim në një familje patriotike të fshatit Cërvicë. Përmëtepër, vij nga Katundi i xha Dulit i Riu, që në lokalet e xhamisë Katundit na furnizonte për "ilaç" me Lotët e Shën Mërisë Virgjër. Dhe, të nesërmen krah për krahu me shokë edhe në kohën e egër komuniste me lodra e muzika veshur me tirqi, xhamadan e këmbëza të bardha i binim me këngë e valle përmidisi Çarshisë Kërçovës. Edhe, gjatë ndryshimeve demokratike, kohë kur ti vite me radhë je deklaruar si sllav e je regjistruar turk "ehamdurila", unë me poetë nga të gjitha trojet etnike shqiptare në kohë lufte (një autobus me targa TR.) përmidisi me poezi e këngë qytetare i kemi rënë Çarshisë Shkupit nën Rrap. Të gjithë nuk jemi njerëz me koka të huaja në qafë!... Rrugës nga kemi ecur, kemi lënë gjurmë të thella që nuk i fshin dot asnjë stuhi. Shtrëngatë. Borë e madhe.

Vështirë është të të bindin se si duhet të ecësh, kur ti ecën me vite e vite. Lirinë e sheh edhe pas maleve. Askushi nuk e sheh në mes të Ditës

Madhe, as edhe para syve. Rrugës ke thyer këmbë… Duar… Kurrizin… Qafën… Falë Zotit, nuk e ke thyer kokën… Ke ecur para… Përmbrapa… Lartë… Poshtë… Nëpër bar… Ferra… Apo, cilin ta duash… Ta urrejsh… Vrasësh… Të gjitha i ke mësuar një nga një. I ke futur në gji. U ke rënë me këmbë. Ose, cili është i mirë. Cili i keq. Të gjitha i di ti. Të gjitha. Mu për këtë nuk dua të të rri mbi kokë me këshilla. Se, ti di vetë ta ndajsh bykun nga gruri në mes të Lëmës. Ec rrugës! Ec! Vetëm kjo rrugë të shpjer në Baba Tomor. Malin e Perëndive. Të gjithë nuk kemi merituar t'u marrim erë luleve. Dikush do të shtrihet në bajga… Kalbësira… Plehëra… S'i kemi hapur të gjithë sytë cilës rruge ecim nëpër errësirë. Na janë përzirë rrugët… Na janë lidhur nye… Na janë bërë lëmsh… Disa nga ne fare s'e kanë kërkuar rrugën. Kanë hyrë kanaleve. Podrumeve. Këtë e kanë bërë pse s'kanë ditur apo me dëshirë, është krejtë njësoj. Vonë, shumë vonë kanë parë se një ecje e tillë symëshelë i ka qitur në gjiriz. I kanë rënë atij deti të zi me krimba kryemëshehtas, për t'u larë lakuriq. Por, në vend që të lahen, janë çuditur kur kanë parë se si fytyrës u kanë ecur krimbat. Xhepat u janë mbushur me xhiriz. Teshave teposhtë nga këmbët u ka rrjedhë ujë i zi…

- Tungjatjeta, plak-o! Tungjatjeta!

- O ti qenke, zoti Shkrimtar! Tungjatjeta!

- Plak, sot më duket, si herët ia ke nisur të flasësh rrugëve?

- Herët sot, zoti Shkrimtar, ka lindur Dielli…

- Po, ç'është plak, Ditë apo Natë?

- Ditë, zoti Shkrimtar… Ditë… Dritë… Diell me rreze mbi Çelëvjollcë.

- Plak, e ka marrë edhe gazeta!

- Zoti Shkrimtar, mos ka pjellë Buça këlyshë me zgjebe?!

- Po, plak! Përmëtepër, edhe qorra me katër sy pas porte… Hoxhën e Allahut e ka hipur në minare. Dexhalli me trumbeta u pri nëpër Bit – Pazar.

- Mirë, o Plak! Po, kush do t'ia ngrejë këmbët nga minarja Hoxhës Allahut? Zoti. Populli, te ne thotë: Hu më hu, huni në bythë…

- Ore, lere gjithë e gjithë, po ai i paska pasur edhe thikat e operimit. Mirë që u zbulua me kohë, se do të na bënte të gjithëve një popull sallatë… Burra… Gra… Fëmijë…

- Budallai. Nuk i kanë mjaftuar hajmalitë, tabletat, injeksionet, por ka dashur t'i përdorë edhe thikat e Kasapit të Ballkanit. Përmëtepër, në Shkup e ka thirrë me shokë edhe "Pranverën arabe"!

- Plak, paskemi qenë ditëgjatë. Shpëtuam edhe kësaj radhe nga thikat e Kasapit.

- Zoti Shkrimtar, edhe nga thikat e Kasapit edhe nga hajmalitë e Hoxhës Allahut…

Është kënaqësi e madhe të ecësh i lirë. T'i fusësh duart në xhepa dhe të dalësh si kaçak mali në rrugë. Por, jo të ecësh me frikë. Të shikosh kush të vjen prapa… Anësh… Para… Ose, t'i trembesh çdo porte… Ferre… Lisi… Guri… Se, të jetosh gjithë jetën me frikë, është njësoj sikur nuk jeton fare. Po, a mundemi të çlirohemi nga frika? Jo. Nuk mundemi, se edhe

frika është një lloj trimërie më vete që i ka hipur kalit me shalë nëpër Bit - Pazar…

Vrapoj rrugëve të gjata, herë me njërën këmbë, herë me të dyja këmbët. U turrem rrezeve të diellit si xhenazja varrit. Shkopin me kërrabë e kam ngritur lart në dor. Ndaleni! Heu, ndaleni! Juve ju bërtas, më kuptoni?! Ndaleni! Dua të ju them dy fjalë në vesh! Afrohuni mos na dëgjojnë sorrat me ferxhetë krahëve! Ë, ju dridhen këmbët? Keni frikë! Mos e lëshoj si lopa bajgën në mes të Lëmës. Jo. Hiqni nga koka ato marrëzira! Unë u tregoj si ecet rrugëve. Nga sa shkallë t'i kapërceni përnjëherë me dy-tri hapa. Në cilën torbë e keni çelësin e Derës Madhe të Shtëpisë… O Zot, si më plakët para kohe. Po, deri kur unë do të vrapoj para jush me kokën në torbë? Mos mendoni se nuk më duhet koka? Gabim. Dikushi kokën e ka si veksh me dy vegë. Po, ç'të duhet një kokë e tillë në qafë? Aq e trashë, aq e varfër. Aq e mjerë. Ikni! Ikni nga kokat e tilla, o njerëz! Mirrni nga sytë këmbët! Rrezik është të të turret një kokë e tillë rrugëve të Qytetit. Rrezik!... Po, ç'duhet bërë, e pyes veten në mes të këtyre rreshtave? Duhet të ecni rrugës me mend në kokë. T'i shihni gropat… Kodrat… Egërsirat… Mos e lakoni rrugën! Vazhdoni! Ecni! Vazhdimi është fitore. Në fund do të bindeni edhe vetë, se ditët e lumtura fitohen me luftë në fushën e mejdanit. Edhe Liria, që nuk e sheh Hoxha i Allahut me brekët nëpër këmbë. Dhe, asgjë nuk ka bërë në jetën e vet për Lirinë, por edhe sot e kësaj dite e ka rrokur me të dyja

duart për fyti. Mjerë ai që është shtrirë të cofë në mes të udhës si qen me zgjebe…

- Plak, a të thash se Hoxha i Allahut do ta gjejë nga Allahu?

- Po, zoti Shkrimtar. Vetëm se, edhe unë i ndihmova Allahut.

- Plak, mos m'i nxirr edhe këto pak mend që më kanë mbetur në kokë! E pabesueshme, si i ndihmove ti Allahut?!

- Zoti Shkrimtar, Hoxhës Allahut ia ngrita këmbët nga minaraja e xhamisë…

- Mos u huto, plak!

- Vetëm i ndihmova Allahut, zoti Shkrimtar.

- Po, Rrufjani si dual në hekururdhë para trenit Shkup - Beograd?!

- Allahu, zoti Shkrimtar.

- Allahu, po kush i ndihmoi, plak?

- Ai e lidhi veten me litarë për qafe dhe e tërhoqi si qen në hekurudhë, para trenit…

Tani, më në fund mund të më bindni edhe mua plakun se jetoni mirë nëpër shtëpi… Ecni rrugës pa frikë… U këndoni ditëve të reja… E doni Lirinë… Keni bukë… Ujë… Por, kurrë nuk jeni aq të sigurt për vdekjen e Hoxhës të Allahut… Përbindshit me dy kokë… Qikllopit me një sy… Bajlozit Zi që herë pas here del nga deti… Shejtanit të Allahut me ferexhenë hedhur krahëve. Ata vërtet vdiqën ose cofën, thuaj si të të vij ty më së miri. Po, ku ta dijmë ne? Ndonjëri ndodh ka mbetur ende gjallë. Apo ngrihet lugat. Ose, lind. Më shkurt, nuk jemi gjithmonë të sigurt këtyre vrapimeve maratonike për në Baba Tomor. Me rëndësi është të ecet përpara. S'do të thotë

gjë, nëse ndonjëherë biem poshtë, shtrihemi përdhe. Armët nuk duhet lëshuar nga dora. Përsëri duhet të ngrihemi më këmbë. Të ecim përpara… Përpara… Përpara…

- Mirë thua, o plak! Përpara! Vetëm përpara! Po. ç'bën aty në përrua?

- I varros sorrat e zeza me ferexhetë hedhur krahëve:

HOXHA I ALLAHUT – LUGATI I KOÇAJVE

Lindi në vitin kaq e kaq.
Njeri.
Vdiq në vitin kaq e kaq. Lugat.
Lugat me ferexhenë krahëve.

- Po, ky tjetri o plak?

- Edhe ai zoti Shkrimtar, ka emër dhe mbiemër mbi varr.

RRUFJAN RRUFJANI
Lindi në vitin kaq e kaq. Këlysh.
Cofi në vitin kaq e kaq.
Qen me zgjebe…

Lavdi "heronjve" të Xhadisë!... Amen…

Dhe ja, o Hoxhë i Allahut me ferexhenë krahëve në mes të Shkupit ta plotësova dëshirën: po qesh pas varrimit të sorrave me ëndrrën tënde "revolucionare" plot pordhë e piskamë: "Pranverën arabe", në Shkup. Shkaku, se: E shoh Lirinë, edhe prapa maleve… Krushqit e lirisë përmes maleve e sjellin Nuse në koçi me këngën popullore: **Hajdeni bini djemtë e Shalës, përmes Sarajeve të Pashës!...**

Dhe në fund

LUFTA VAZHDON ME PENË

Krijuesi rebel shqiptar, nuk ka pasur fat në kohën e sistemit komunist të marri lirshëm frymë, shalojë lapsin tymemjegull në libër. Majemalit ta përqafojë Diellin. Individë të paktë kanë qenë ato, që i kanë përgëzuar këto "shpërblime" të Oborrit. Patjetër, është dashur të jesh i sojit të tyre, ose t'u biesh duarve shuplakë para këmbëve të politikanëve të shitur me pak pare. Nateditë t'u thurrësh hymne prijësve të partisë "shpëtimtare" në pushtet. Ose, këndosh këngë patriotike me çifteli në stilin e Hashim Shalës: "Zogun e Tunës, ne ndryshe e kena pa". Zëra të shumtë kryengritës shqiptar i kanë rrasur papritur në burg. Shumica kanë përfunduar edhe në mesin e varrezave kolektive, që nuk u dihet as nami e nishani edhe sot e kësaj dite.

Pak veta në atë kohë të egër komuniste kanë pasur fatin të studjojnë në Prishtinë dhe t'i kënë si mësuesë të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe: Anton Çetën, Latif Berishën, Fehmi Aganin, Hasan Mekulin, Enver Gjerqekun, Shefqet Pllanën, Hilmi Aganin, Gjyltekin Shehun e Gani Lubotenin. Dhe, miqtë e penës: Frederik Rreshpjen, Pano Taçin, Mehmadali Hoxhën. Abdylazis Islamin, Hida Halimin, Ymer Shkrelin,

Musa Ramadanin, Teki Dërvishin, Beqir Musliun, Mirko Gashin, Qerim Arifin, Gani Xhafollin, Fadil Bekteshin e Shaqir Sadikun.

Mësuesë të penës që edhe sot nga ecin rrugës së tyre plot pusi politike pas ferre bëjnë dritë matanë malit. Dje, i ndiqte për së gjalli "shkau", sot i ndjek edhe mes varreve "shqiptari". Fati krijues, që fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite i ke në arenën politike. Luftën për pushtet. Tjetër punë është ajo se, shqiptarët kurrë nuk kanë pasur pushtet, por kanë qenë brez pas brezi argatë historik të qeverive të huaja në Ballkan. Edhe, atë: argatë të tmerrshëm që për poste politike e kanë "hëngër" të gjallë edhe vëllain.

Populli shqiptar edhe gjatë kohë do të ketë probleme me vetëveten si ngatërraçë nëpër këmbë në Shtëpinë e Babait. Shkaku, se: edhe sot e kësaj dite është duke plaçkitur artistët e gostitë rrufjanët dhe partizanët e partive politike. Publikisht, nën shkrimet e tia publicistike t'i thonë Shkrimtarit, se shkruan: "budallalliqe dhe gënjeshtra". Gjithë këtë e bënë për "famë dhe lavdi". Halldupët, siç i ka pagëzuar publicisti, harrojnë se Shkrimtari ka edhe famë edhe lavdi. Gjithë jetën e ka kaluar në mesin e librave në bibliotekë. Salloneve aristokroate dhe nën Rrap me Miken me dy shtamba verë mbi tavolinë, që i ka dhënë gji për luftë. Kokë më kokë me poetët që nuk ikin nga Atdheu. Kurrë, nuk e ka arratisur veten mes

"bardakeve" të çajit rusit. Tri Mike i kanë dhënë gji për luftë nën Rrap. Njëra i ka pri para e Dy të tjerat e kanë mbajtur për krahu rrugës për në Baba Tomor. Arusha me dajre, o dudumë Bit - Pazari nuk fshihet në thes. E, as sëpata e Nuses pas dere. Kotnasikoti e provokoni Shkrimtarin se, edhe u ka dalë bashkëpuntor i sigurimit të shtetit– Kodosh. Njëfarë Hilmije Hanmi i porositë lexuesit: "Merni dosien e ketij dhe do shifni edhe emrin tim qe ka spiunuar ky kodosh. A e dini se sa njerëz ka mare ne qafe. Dhe tani shitet patriot. Urdhno le ta jap deklaraten ne kmision dhe do e shofim si do i del puna.." Askushi anonim, Ilmije Hanmi që mezi e flet dhe e shkruan gjuhën shqipe, e rren mendjen se Shkrimtari do të merret me theshetheme. Anonimus në familje, katund dhe jetë me të cilin Shkrimtari në jetën e vet nuk ka pi as edhe një kafe, dhe nuk ka pasur nevojë ta spiunojë këtë alamet "patrioti kuqezi". Bukuroshja, kërcnohet dhe vazhdon me provokimin: E "këshillon" Shkrimtarin që të bëjë kërkesë te Komisionmi Lustrues se nuk është spiun – Kodosh, e pastaj do të shohim ku do t'i dalë puna. E mjera haxhuze, e "meson" Shkrimtarin (autorin e mbi pesëdhjetë librave) si duhet të veprojë në jetë, "rehabilotojë" veten para dudumëve, a ka qenë apo nuk ka qenë spiun - kodosh. Pavetëdije se, askush nuk e di më mirë këtë "aktivitet patriotik" sesa Shkrimtari.

Haxhuzja, që harron se Shkrimtari: ka lindur në komunizëm, është rritur në komunizëm, është shkolluar në komunizëm (Kërçovë, Shkup dhe Prishtinë), ka punuar dhe jetuar në komunizëm dhe jo rastësiht i ka shpëtuar pa asnjë ferrë në këmbë këtij bërlloku shqiptar, në Shkup. Kurrë nuk ka qenë i shpërblyer me vende pune, banesa "sindikati", çmime shtetërore e poste politike. Koha erdhi, tashti një qyqe e skubitur Bit-Pazari me dy-tri pupla në shpinë e zorrët nëpër këmbë, që gjithë jetën vezët i la nëpër çerdhet e huaja, sot ta provokojë me kësi metodash të njohura policore ish komuniste të këtij niveli kaq të ulët njerëzor e "humanitar" nga strofullat e shoqatave "joqeveritare". Kot e keni, o "patriotë kuqezi" me kokën në xhami e bythën në polici (siç thotë Shkrimtari nëpër shkrimet e tia publicistike)! Njëqind vjet është përpara jush si "patriotë kuqezi" me kokën në grazhd e palarenë për mejdani në livadh. Veç më, që nuk i thoni: edhe xhipin nën dritare para banesës në Çair të Shkupit e ke djegur vetë, ia ke vënë flakën pasmesnate për "famë dhe lavdi".

Arsyeja dihet, për interesa të ngushta personale, familjare e politikë "madhore". Kurrë, nuk ka ndodhur që ky bërllok shqiptar t'i plaçkisi politikanët, po gjithmonë artistët kryengritës, e ka ngulfatur fjalën e lirë. Mos e dhashtë Zoti t'i djegi makinat e tyre qeveritare, para dritareve të

banesave të Shtetit, zjarrin t'ua vë shtëpive të ndërtuara me parat e popullit. Prandaj, ky popull është i nemur nga turku, ende e mbytë veten në hurdhën e lumenjëve që e kanë krijuar shirat gjatë Dimrit Madh. Kurrësesi të dalë mbi sipërfaqe të ujit me dorën lartë për ndihmë. Dorën nuk ia ka shtri intelektualëve profetë, po rrufjanëve dhe patizanëve të partive politike. Moti e kam thënë: një popull për të dalë nga gremina ku ka rënë bythekrye që nga Perandoria Osmane dhe ka vazhduar "lumturinë" me pushtuesit sllavopronar, në ballë duhet t'i ketë njerëzit e ditur, pastaj të pasurit dhe në fund popullin. E, a i ka sot populli shqiptar këto tre faktorë kryesor në ballë?! Fatkeqësisht, ende jo për në Liri.

Frika historike: Popullit shqiptar në ballë po i pri byku e jo koka. Ofenduese është për një popull, që Ditën e Re e nis me "Allahu Ekber", e jo me Tungjatjeta Tiranë, Prishtinë e Shkup në gjuhën shqipe. Flamurin turko-arab në minare, e jo me flamurin kuqezi në xhamitë shqiptare. Lutje drejtuar Muhamedit a. s. (Pejgamberit të fundit) e jo Skënderbeut (Profetit të shqiptarëve). Dënim të cilin ia kanë përcaktuar pushtuesit, e jo ai vetes si popull me tradita të lashta kombëtare. Tjetër punë është ajo se, ai si popull vetë e ka zgjatur robërinë mbi kokë shekuj me radhë me bërllokun e vet mbi shpinë, që i ngatërrohet edhe sot e kësaj dite nëpër këmbë si kërroca të gardheve mes Katundit.

Pavetëdije, brez pas brezi e zgjatë nëpër shekuj Robërinë.

Populli, që vetë nuk e pastron bërllokun nga pragu i Shtëpisë, kurrë nuk mund ta pastrojë oborrin e kojshisë matanë gardhit. Përçudi, populli shqiptar me vite përpiqet ta pastrojë lëmën e kojshive duke e lënë të veten ta mbulojnë ferrat. Askund në botë nuk ndodhë një dukuri e këtillë e Shoqatave "humanitare". Tjetrin ta duash më shumë se veten në Ditën e sotshme. Ose, pa qenë nacionalistë, nuk mund të bëhesh internacionalist. Ligje të Zotit Madh janë këto, dhe rregulla të Natyrës. Ferra nuk bënë kumbulla. Dardha – mollë. Ose, kërroca – rrush. Përfundimisht, siç thotë populli shqiptar: Ferra bënë ferra. kumbulla bie nën kumbull, molla nën mollë e dardha nën dardhë. Kurrë, nuk ka ndodhur që ferra të bëjë kumbulla, mollë, dardha ose rrush.

Rruga e vetme kjo, nga e cila duhet të eci populli shqiptar për në Baba Tomor: Patjetër, krah për krahu me Natyrën. Krijuesja e vetme e përkryer në vepra artistike para së cilës ka rënë në të dy gjunjtë Njeriu. Pse nuk e them me Zotin?! Shkaku se, Zotin e krijuan njerëzit njësoj si partitë politike për t'u ikur përgjegjësive. Mëkateve, që përditë i ngarkojnë në shpinë. Ndonjërin e krijoi të verbët me sytë në ballë, shurdhmemec, tjetrin trusakatë. Rebelët të flasin

vetmevete rrugëve. Përpjekje të dështuara për ta imituar Natyrën. Përmëkeq, në emër të Zotit fshihen dhe veprojnë "misionarë" të shitur me pare e pa pare. Krah për krahu me lidershipët e partive politike të vetëshpallur "fitues" para e pas zgjedhjeve presidenciale e parlamentare, që nateditë bëjnë luftë për pushtet në emër të popullit shqiptar, ashtu si dy deshët mbi vigun e drurit mbi lumë te Abetarja.

Koha është, kokës t'i bieni me të dyja duart me grushta si shqiptarë, pasardhës të Skënderbeut dhe Rilindasëve. Herët në mëngjes t'i lani sytë me të dyja duart, krah më krah t'i hapni dritaret, mirë ta shkundëni veten nga ëndërrat e rrejshme. Premtimet e Dexhallit. Atëherë, do të arrini te Liria. Maja e Shenjtë, në Baba Tomor. Malin e Perëndive. Tyrben e Babashehut, ku pihet vera me shtamba, lindë poezia. Dhe, bëhet dashuri.

Lufta vazhdon me penë…

Në vend të pasthënies

OMAR KHAJAMI, LA FONTAINE,
FAN S. NOLI, ALI ASLLANI, AHMET SELMANI, FAIK KONICA, MUSA DHE KALOSH ÇELIKU
(Poezi – komente nën shkrimet e mia të publikuara publicistike).

Omar Khajami në 27/12/2013 11:50:53

Natën kur flija, më tha shpirti: "Pi!
Në gjumë dhe në Varr s'ka lumturi.
Ngrehu Kalosh! Sa rron, zbras Kupa e puth çupa;
se ke shekuj që të flesh në qetësi".

Në ëndërr, kur Agimi zbardhëllonte,
Një zë që nga Taverna po gjëmonte:
"Çohuni, djema, e Verë sillnani,
Se Kaloshi na e thau lëngun sonte".

Dhe posa në tavernë këndoi gjeli,
Dudumët jashtë thirrën "Portat çelni!
E shkurtër është jeta, Kalosh, u mplakmë
Dhe mbretmë si kofini pas së vjeli".

La Fontaine në 28/12/2013 07:28:36

Nga shkëndija një zjarr u ndez, vezulloi mbi tokë të zezë.

Të parët tanë e quanin Iliri, emrin sot as një Zot s'ia di.

Një mjekërrbardhë thotë për habi: "S'rroj dot më në Arabi,
E dua tokën e Teutës, ku burrat i bijnë lahutës".

Armë e tij një laps i zi, që lë gjurmë në histori.
Frymëzimin e ka nga vera, ngre dollitë si ngahera.

Lart nga qielli plot safirë, Zeusi plak po bën sehir.
Në Ilirinë e pushtuar, plaku ynë shkruan e shkruan.

E qëndis me laps e verë, siç e bëjnë njerëz me vlerë.
E lëvdon perëndinë tuaj, s'duron dot zotin e huaj.

E do Shkupin e Isë Boletinit, jo të Ahmetit e Abedinit.
E do plisin e bardhë si borë, që Ilirët e kanë kurorë.

Radhiti fjalët o shkrimtar, se nderi s'blihet në pazar.
Mprehe penën nip Teute, faqezinjëve tmerr i fute.

Mos u zmbraps ore Kalosh, se Dea të pret në Tarabosh.
Aty ku zanat e Malsisë, i këndojnë Gjergj Elez Alisë.

Në jug Baba Tomorri plak, e mallkon të ndyrin gjak.
Sojin e ndyrë të Azisë, që helmon dejt e Ilirisë.

Thonë e zotëruam Ilirinë, e sot shitemi për tagjinë.
Jo, ata nuk janë Ilirë! Janë pjellë djalli, por pa brirë!

La Fontaine në 04/01/2014 02:55:28

Në një vend në mugëtirë, rronin njerëz me dy brirë;
Hanin bukën e miletit, bënin duanë e Dovletit.

I mjeri popull kish ngritur duar, se e kishin përdhunuar;
Shpresë i dhanë ca djem azgana, që i kishte lindë Sulltana.

Kur dolën çukave në Malësi, brohoritnin veç për liri;
Bënë betimin për Shqipëri, sot e bëjnë për Maqedoni!

Thanë luftojmë për barazi, komb, atdhe dhe shqiptari;
Por sapo tjetrit ia shtinë tutën, u mjaftuan me Kushtetutën.

Armët i dorëzuan 'në besë', thanë Europa s'do të na shesë;
Dhe u turrën në kolltuqet, si bletët në lulekuqet.

Veç një herë vërshuan sheshin, kur agai s'ua vu veshin;
Kishte shërbetorin e vjetër, ndaj s'i duhej ndonjë tjetër.

Me popull në gojë janë dit' e natë, por me mëndje tek paratë;
Sa ulën trupin në kolltuk, iu duk vetja si Mbreti Faruk.

Por Farukut i kish hije, se s'bënte krushqi me shkije;
Thoshte se ka gjak shqiptari, e jo shpirt të hyzmeqarit.

E këta hyzmeqarët tanë, me dybrirëshit sejmenë pranë;
Kthyen prapa historinë, shitën popullin për tagjinë.

I zbuti pushteti për mesele, hynë si ujq e dolën si dele;

Thonë kur jevgu e sheh paranë, edhe bythët i lyen me dhjamë.

La Fontaine në 06/02/2014 17:58:04

I kuptoj mirë shqetësimet e autorit për protagonistin, por kam rezerva mbi mënyrën e zgjidhjes së problemit. Në rastin konkret gjykimi nuk ndihmon sepse sëmundja ka arritur në fazën kritike. Prandaj, më shumë se kurdoherë nevoitet terapia e duhur, sepse është koha që pacienti të shërohet. Jam kundër metodave të hajmalive që i sugjeron z. Çeliku sepse në shek. XXI koha e tyre ka perënduar. Sot është kohë e shkencës dhe nevojitet qasje shkencore.
Para disa ditësh më tërhoqi vëmendjen një metodë mjaft interesante dhe e thjeshtë që është zbatuar me shumë sukses nga Instituti Mbretëror i Suedisë. Bëhet fjalë për metodën "7x7"; një terapi 7-ditëshe, gjatë së cilës pacienti në mënyrë vetë-sugjestive lirohet nga paranoja, apo xhindet siç i quan autori.
Metodologjia është si vijon:
Pacientit ia veshin shtatë palë brekët mbi pantallonat, dhe i thonë që çdo ditë të zveshë nga një palë brekë.
Të hënën, pacienti i heq brekët e para. Të martën i zvesh brekët e dyta; të mërkurën të tretat; të enjten të katërtat, të premten të pestat, të shtunën të gjashtat; dhe të dielën i zvesh brekët e shtata dhe të fundit që i ka

përmbi pantallonat. Të nesërmen, pra në krye të javës bëhet kontrolli. Nëse pacienti pushon së zveshuri pasi t'i ketë hequr shtatë palë brekët, ai konsiderohet relativisht i shëruar. Por nëse ai nisë t'i heqë edhe pantallonat, atëherë pacienti konsiderohet rast i rëndë dhe terapia vazhdon me metodat klasike, si psh. ajo këmisha me mëngët e lidhura. Përqindja e rasteve të shëruara në Suedi është mjaft e lartë: nga 1014 pacientë, vetëm në një rast terapia ka dështuar. Disa thanë se ka qenë një emigrant nga trojet tona, por kjo nuk është vërtetuar...

La Fontaine në 21/02/2014 17:55:01

T'a kam thënë një herë qartë,
këta kokëboshë janë të përçartë.
Janë bërë dorë e zgjatur krimi,
por s'i shpëton gjë nga mallkimi.

I ka pështyrë vetë Perëndia,
sot s'i lan kisha e as xhamia.
Kot që falen natë e ditë,
e të vetit i nxjerrin sytë.

Po ti mirë që nuk vjell vrer,
se fjala jote na bën nder.
Mprehe penën dhe më shumë,
dhiti gjithë ata dudumë.

Janë qyqarë dhe shumë tinzarë,

shesin dhe nënën në pazar.
Rrojnë sa për sy e faqe,
kanë gojët veç për mustaqe.

Do ishim nën zgjedhë dovleti,
pa ndihmën e këtij mileti?
Jo Kalosh, kurrë asnjëherë,
i paudhi s'di ç'është nder.

Por ç'ti bësh që ka rastis,
në çdo fis të ketë një pis.
Gjaku i shprishur i ka tërbuar,
vëllanë e vet e kanë harruar.

Ke rreth vetes shumë të liq,
por a rrohet pa armiq?!
Jo, më tha një mik një herë,
jeta pa ta s’ka pikë vlerë.

Janë armiqtë që na mbajnë gjallë,
e s'na lënë kurrë pa një hall.
Na bëjnë shumë më të vyer,
e na hapin më shumë dyer.

Flakët e xhipit janë ishareti,
se bythëshiturve u erdh' kijameti.
Ty Kalosh gjë nuk të bëjnë,
veç më shumë të lartësojnë!

Fan S. Noli në 13/03/2014 17:25:20

Rent or Marathonomak

Rent, or rent, rent e u thuaj
Se u çthur ordi e huaj,
Se betejën e fituam
Dhe qytetin e shpëtuam!
Rent, or rent,
Rent, or Marathonomak!

Kap një degë prej dafine
Dhe vërtitesh ndaj Athine,
Nëpër fush' e brek mi brek
Këmba tokën as t'a prek,
Hip' e zbrit,
Petrit, Marathonomak!

Ke një plagë, po s'e the,
Djers' e gjak pikon për-dhè;
Do që ti të jesh i pari,
Për triumfin lajmëtari
Flamur-gjak,
Kuqo, Marathonomak!

T'u tha gryka, po s'të pihet,
T'u mpi këmba, po s'të rrihet,
Se mileti po të pret,
Ankthi zëmrat ua vret,
Vrer e tmerr,
Shpejt, or Marathonomak!

Kurrë kaqë s'dogji djelli
Dhe si plumb s'rëndovi qjelli,
Kurr' aq ëmbël' e bukur s'ftoj

Hij' e lisit edhe kroj;
Turru tej,
Tutje, or Marathonomak!

Vapa mbyt e pluhri nxin
Ferra çjerr e guri grin
Afsha gjoksin përvëlon
Syrin avulli verbon;
Ur' e prush,
Furr', or Marathonomak!

Gryka si gjyryk të çfryn
Prej Vullkani flag' e tym
Se ç'vëngon e se ç'gulçon,
Zëmra brinjët t'i çkallmon
Me tokmak,
Mbahu, or Marathonomak!

Nëna, motra, nusja dalin,
Ngrehin krahët të të ndalin,
Mos, se s'janë veç Najada
Magjistrica dhe Driada;
Lark, or lark,
Lark, or Marathonomak!

Hajde, ja Akropolia,
Ja qyteti e njerëzia
Që të pan' e që të çquan
Dhe fuqinë t'a rishtuan
Ha dhe pak,
Hajde, or Marathonomak!

Ja, arrive, ua the:

Ç'gas e ç'helm qe kjo myzhde!
"E fituam!", brohorite
Dhe për tok' u përpëlite;
Vdiq, or vdiq!
Vdiqe, or Marathonomak!

Rent kudo, dyke bërtitur,
Nëpër shekuj faqe-ndritur,
Se i vogli shtrin viganin
Dhe i shtypuri tiranin,
Veç e tok,
Tok, or Marathonomak!

Ali Asllani në 03/04/2014 16:33:02

Hani, pini dhe rrëmbeni, mbushni xhepa, mbushni arka;
të pabrekë ju gjeti dreka, milionierë ju gjeti darka!

Hani, pini dhe rrëmbeni, është koha e çakenjve;
hani, pini e rrëmbeni, është botë e maskarenjve!

Kurrë ju nuk keni pasur as nevojë e as të keqe;
por më para nga të gjithë, ju i thatë armikut: "Peqe!"

Që të zinit një kolltuk, aq u ulët e u përkulët;
sa në pragun e armikut vajtët si kopil u

ngulët!

As ju hahet, as ju pihet, vetëm titulli ju kihet...
Teksa fshat' i varfër digjet, kryekurva nis e krihet!

Edhe ju të robëruar, rob në dorë të metelikut, fshini sofrat e çdokujt, puthni këmbën e armikut!

Që ta kesh armikun mik e pandehni mençuri; mjafton bërja pasanik, pasanik dhe "bej" i ri!

Dhe u bëtë pasanikë, me pallate, me vetura, kurse burrat më fisnikë, japin shpirtin në tortura!

La Fontaine në 24/04/2014 12:40:32

Viçi i vogël rri mendueshëm,
muu, muu, ban
Pse m'shikon ashtu trishtueshëm,
mu, mu, ban,
Eja ti o bir i lopës lum medet,
Se të bën ty nëna lope deputet.

Shif n’livadh o Viç i dashtun
Muu, muu, ban.
Krejt partia si tufë janë mbledhur
Muu, muu, bajnë.
Ti i vetëm u mërzite, viçi im,

Veç Gruevski t'i heq brengat, viçi im.

Babi ty të ka premtue
Viçi im.
Në Kuvend në Shkup me t'çue
Viçi im.
Do të bëhesh kryeplak i fshatit
Viçi im.
Q t'ja dhitësh popullit fatin,
Viçi im.

La Fontaine në 08/06/2014 19:53:44

O Kalosh, Kalosh Çeliku, ta kish frikën gjithë armiku.
Kur me penë vije në kartë thumbat e gjuhës së zjarrtë.

Por ama me këtë Alinë e ke trashur pak taxhinë.
Rri mënjanë nga politika, mos u merr me ato klika.

Se të blejnë e të shesin, e pastaj s'ta varin veshin.
Të përdorin për hajgare, e në fund s'ta rrasin fare.

Qëndro larg Baba dovletit, mbaju afër me miletin.
Ti i mirë je kur shan, e jo kur lëvdon dynjanë!

Punët hapur si në shesh, asnjë mjegull s'mund t'i fsheh.
Bëj detyrën me namuz, fshati që shihet nuk do kallauz.

A s'i sheh këta tanët që e dhitën në të katër anët?
Merru pak punë të vogla, e mos na shit dushk për gogla.

Dhimbia e Madhe D. on 09/08/2014 19:47:10

Le ta kuptojmw ATE(poetin) se s'wshtw pa gjw !
Nuk di c'tw them, po Celik Kaloshi,gja t'madhe po na ndjen....
Mw shume sw c'shkruan e frazon
Mua fotoja e tij mw bwn ta BESOJ !
Mos qoftw e thwnw, c'mw tregon!(brengw)
A thua tw jete pavertetwsi?!
S'mw besohet,teksa e shoh,se POETI;
Flet e LIGESHTOHET.

Le ta kuptojmw jo lexojme ATE !
Se s'ashtw pa gjw.

Dhimbia e Madhe D

La Fontaine në 09/08/2014 17:25:55

E ke qëlluar në shenjë o Kalosh poeti;
Nuk e luan topi, na mbyti salltaneti.
Teksa popujt tjerë kulturën e synojnë,
instiktin e moçëm ne ende kremtojmë.

Dasma është e tëra që bënim e bëjmë,
vetëm epshet tona që t'i lartësojmë.
Thuajse po bëjmë një punë kombëtare,
kur i biem lodrës apo heqim valle.

I bëjmë të njëjtat siç bënte shpellari,
që kur çiftëzohej hedhte gurë nga mali.
Ulërinte thellë t'a dëgjojnë kafshët tjera,
kur e merrte plaçkën dhe e fuste te shpella.

Kur dilte nga shpella, krekosej më shumë,
si dhëndurrët tanë me paratë lumë.
I ati me hostenin i skuqur si furrë,
u mburrej të tjerëve: m'u bë djali burrë.

Shpellarët e familjes, gurët i trokëllinin,
thoshin kemi dasëm, e martojmë nipin.
Çmimin më të lartë e paguante hajvani,
që vritej e piqej për qejf të insanit.

Sot s'dallojmë shumë nga këta bandillë;
Ata kishin shpellën, ne kemi shtëpitë,
S'u biem më gurëve, e kemi muzikantin,
Kafshën më s'e pjekim, e bën restoranti.

Ata hedhnin gurët, sot hedhim paranë,
Ata çudisnin malin, ne çmendim dynjanë.
Shpellat s'kishin libra, mu si shtëpitë tona,
Nuset s'varin kocka, por veç medaljona .

Shpellarëve s'u hante palla për art e poezi,
rronin në botë epshi, ku rrojmë unë e ti.
Qëllimin e kishin veç sojin t'a shtojnë,

mu si në dasmat tona kur dikë martojnë.

Por, atë që bënin shpellarët dhe bën çdo njeri,
kryeshpellarët e partive e zgodhën si strategji!
Thonë se veç me numra mund të kalojmë lumin,
mirë na ecin punët, ndaj e vazhdojmë gjumin.

Por harrojnë këta komisarë të partive,
se për të moçmit, sot flet arti i tyre.
U harruan shpellarët që trokëllinin me gurë,
Kujtohet veç njeriu që vizatoi në mur...

Ahmet Selmani në 06/09/2014 00:37:11

MIKUT TIM

Kalosh Çeliku o djale azgani,
s'te ben gje Cari e as Sulltani.

Ngriti shtambat me raki,
Per Khajamin ngre dolli.

Harroi dudumet e Bit Pazarit,
Muza pret ne hije te Rrapit.

Shtrengo vithet e mikes sate,
dridhja tulin kate-kate…

Faik Konica në 24/09/2014 01:28:13

Mjaft më o Kalosh me këto kashë e lashë,
bëju më i qartë se ka dhe kokëtrashë.

Nuk e ndajnë dot as kashtën nga gruri,
keq i ka mbështetur skllevëria tek muri.

Kudo kthejnë kokën shohin veç mërinë,
u pengon qerpiku, s'e shohin taxhinë.

Kur të shkruash ti o Kalosh i zjarrtë,
bëj dhe vizatime, të jesh më i qartë.

Ka alamet burra që nuk të kuptojnë,
e pastaj shqetësohen e të denoncojnë.

Thonë "ky Kaloshi na e prish qetësinë",
rrënon bashkëjetesën, e helmon taxhinë.

Faik Konica në 02/10/2014 01:49:12

Eh Kalosh ç'të bëjë ky popull i ngratë,
që për çdo perime thotë emrin sallatë.

I ka rrjedhë truri fare nga politika
ku të kthesh kokën shpall republika.

S'i mbeti lezet as shtetit e vatanit,
shyqyr që ka mbyll' sytë Ismail Qemali.

Kështu siç bëjmë si gomerë të harlisur,
edhe 28 Nëntorin do t'ia kishim shpifur.

Musa në 25/11/2014 00:11:06

O Kalosh, Kalosh Çeliku,
ta ka friken krejt armiku

Kalosh Çeliku në 26/11/2014 11:30:55

AUTOPORTRET

Jam Kaloshi, e jam bataku
Bëj ç’të dua s’më ze haku

Mendjen e kam sa një dele
Por inatin sa një hergele

S’di ta kaloj kohën ndryshe
Sadoqë është lojë pa finishe

Gjithë ditën me shtrëngime

1+1=11 në 27/11/2014 03:21:08

Jam Kaloshi, s'jam bataku
Kur hy unë, dridhet konaku.

Mjekrrën e kam sa dy male

E inatin sa shtatë hale.

S'di të kaloj kohën ndryshe
Veç të zbraz shishe pas shishe.

Në hale më rrjedhin mendime
kapsllëku më jep inspirime.

Jam nip Kërçove e bir Zajazi
Nën mustaqe s'më ndalet gazi.

Gjithë jetën kam bërë sehir
Ku kam gdhirë e ku jam dhirë…

Faik Konica në 10/01/2015 02:20:59

O Kalosh o burrë trimosh,
Hiqu atij viçi kokëbosh.

Aq ua pret rradakja e shkret,
Ndaj s'dalin dot në selamet.

Hajvanati tjetër punë s'ka,
Gdhihet viç e ngryset si ka.

Bythpalarët që lëpinin pushtetin,
Sot u erdh dita të shohin lezetin.

Shënime për autorin

Kalosh Çeliku lindi më 13 shkurt l951 në fshatin Cërvicë të Kërçovës (IRJ e Maqedonisë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Shkollën e mesme normale në Shkup, ndërsa studimet e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Prishtinës (Kosovë). Çeliku shkruan poezi e prozë për fëmijë e të rritur dhe gjer më sot ka botuar rreth dyzetë libra: ***Zogu erdhi me një këngë*** - vjersha (l982), ***Lepuri me pushkë*** - tregime (l983), ***Shtëpiza e xixëllonjave*** - tregime (1984), ***Ferexhja e zezë*** - dramë (1985), ***Arusha pa bisht*** - tregime (l986), ***Dielli zbret maleve*** - novelë (l986), ***Varrimi i sorrave*** - roman (1988), ***Vite me borë*** - roman (l990), ***Trumbetat e Tellallit*** - satira (l992), ***Imzot, lehin qentë*** - drama (1993), ***Trimi shihet në vepër*** - poemë (l994), ***Çohuni trima shaloni lapsin*** - rrëfenja (1994), ***Sorraku i Qytetit*** - pjesë teatrore (1994), ***Kali i Trojës nëpër Bit - Pazar*** - satira (1994), ***Loja e syve*** - poezi (1995), ***Babi ka dy nuse*** - roman, (1995), ***Vjellja e zorrëve*** - poezi (1996), ***Qyteti i qyqeve*** - roman (1997), ***E përcolla Natën*** - poezi (1998), ***Mbrëmë fjeta me Vjeshtën*** - poezi (1999), ***Kopeja me zgjebe ndjek Autorin*** - drama (2000), ***Shtëpia publike*** - roman (2000), ***Si u ndava me Gruan time***" - satira (2001), ***Gratë e mia besnike*** - roman (2001), ***Lamtumirë bërllok*** - nëntë drama (2002, 2007), ***Me tre varre*** - roman (2002), ***Vdekja më deshi më pak se Ti*** - poezi (2003),

Edhe Ajo nuk ishte xheloze - poezi (2004), ***Repriza e vëllazërim - bashkimit*** - dramë (2005), ***Atdheu ky burrë pa Grua*** - poezi (2006), ***Kulturofagu*** - antiroman (2006), ***Burrat i përzë me burra e Mua me gra*** - poezi (2007), ***Engjëlli im është Grua*** - poezi (2007), ***Dimri, s'vjen me lule*** - 5 poema (2007), ***Ujku e di një lojë*** - poezi (2007), ***Kur bërtet "vojvoda" e pjell Kurvë Partia*** - satira (2008), ***Dac Poeti i shkruan poezi Mamit*** - poemë humoristike (2008), ***Ehu*** - poezi (2008), ***Gruaja besnike*** - roman (2009), ***Djemnusha*** - roman (2010), **Atdheu burrë pa Grua** - poezi (përzgjedhje, 2010), ***Xhadia*** - piblicistikë letrare (2011), ***Cuca Boheme u jep gji poezive të mia*** - poezi, përzgjedhje në gjuhën gjermane (2012), ***Plaga e dhjetë e Babait*** - roman (2012), ***Rrufjani*** - publicistikë letrare (2012), ***Qengji më tha ha bar*** – roman (2013), ***Plaga e dhjetë me Hënën*** - poezi, përzgjedhje në gjuhën greke (2013), ***Gruaverë*** - përzgjedhje, poezi (2013) ***Imzot, lehin qentë*** – dhjetë drama (2013), ***Lavdi "heronjve" të Xhadisë*** – publicistikë letrare (2014), ***I fshehur pas hënës*** - poezi, përzgjedhje në gjuhën rumune (2014) etj. Që nga viti 1992 ai drejton Shtëpinë Gazetare - Botuese ASDRENI, në Shkup dhe është kryeredaktor i të vetmes revistë për humor dhe satirë **ZEKTHI**, që **del kur t'i teket** në IRJ të Maqedonisë. Dhe, që nga viti (2009) mbarëkombëtarë si revistë për humor dhe satirë.

Kalosh Çeliku është fitues i disa çmimeve të konkurseve letrare në poezi, tregime dhe pjesë teatrore. Njëherit, edhe i çmimeve letrare:

PERENDESHË E BUKURISË, në Netët e Poezisë Korçare (2003), në Korçë, Çmimin AS për letërsi (2007), në Kërçovë, "SYRI I KALTËR" (2007), në Sarandë, "SEREMBE" (2008), në Laç, "FLAKADANI I KARADAKUT" (2009), në Viti, Çmim special për vëllimin poetik: EHU nga Simpoziumi Ndërkombtar "MUZA POETIKE", "PEGASI" (2009), në Gjirokastër, "JEHONA E KARADAKUT" (2010), në Kumanovë, "SKAMPINI" në Festivalin Ballkanik të pozisë (2010), në Elabasan, Kurora e poezisë "KORÇA 2012", në Korçë, Çmimin e parë për poezi të vitit (2014) "PAVARËSIA" e Kosovës nga Unioni i Shkrimtarëve dhe Kritikëve Shqiptar, në Prishtinë, METAFORA II (2014) nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Çmimin "Urat në vargun poetik" (2014) nga Klubi i Shkrimtarëve "Vorea Ujko", në Klinë (Kosovë) etj.

Drama ***Ferexhja e zezë*** është vënë në skenë nga disa teatro në Kosovë e IRJ të Maqedonisë dhe është mirëpritur nga publiku e kritika letrare. Edhe satira ***Ndihma e shpejtë*** u përgatit për t'u vënë në skenë me mjaft sukses nga Trupa teatrore "Aleksandër Moisiu" në Kumanovë dhe çoi pluhur nëpër kuluaret e oborrtarëve. Drama tjetër ***Zorra qorre*** dy herë me radhë u përgatitë për skenë, një herë në Kumanovë dhe herën tjetër në Strugë, po i ranë në gjurmë kulturofagët dhe nuk u shfaq para publikut.

Një fat të këtillë kanë pasur edhe pjesët teatrore për fëmijë të shpërblyera me çmime letrare duke u luajtur në skenë dhe duke u

emetuar përmes valëve të radiotelevizionit të Prishtinës (Kosovë) dhe Tiranës (Shqipëri).

Krijimtaria e tij letrare është përkthyer në disa gjuhë: maqedonase, gjermane, turke, bullgare, rumune, greke etj. Që nga viti 1992 – 1997, ishte nënkryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptar dhe kryetar 1997 – 2001. Momentalisht është kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë në IRJ të Maqedonisë. Dhe, themelues i disa manifestimeve kulturore tradicionale ndërkombëtarë: Ditët e Naimit, në Tetovë, Takime nën Rrap, në Shkup (poezi erotike) dhe i Ditëve të humorit dhe satirës: XHA DERALLA, në Kërçovë. Poashtu është edhe themelues dhe kryeredaktor i revistës letrare **STILI 97**, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar në IRJ të Maqedonisë.

Çeliku gjer më vitin 1995 punoi si mësues i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Drenicë të Kosovës dhe Malësinë e Shkupit. Vitet e fundit punon dhe jeton në Shkup, tashmë në profesionin e lirë të shkrimtarit.

Lufta vazhdon me penë...

Përmbajtja

Në vend të parathënies
LIBRI "RRUFJANI", SAGË QË NDERON
LETËRSINË SHQIPE **/ 7**
Prolog
PYKË shelgu / 15
I ATDHEU NGA SHIU
RA NË BRESHËR
Shkupi historik i shqiptarëve/ 21
Hajduti "hallall" / 27
Atdheu nga shiu ra në breshër / 36
Shërbetori / 45
Dy breshkat e Kryeministrit shqiptar
në Tiranë/ 50
Dalldisje Partizane / 56
Dexhalli i Arapit / 62
Çifliku i Xha Derallës / 73
Nastradinica / 83
Hutat cofin duke kënduar / 93
II DITË ZIE PËR GOMARIN
E HAXHI RRENCIT
Kunguj Stambolli / 101
"Patriotët" dhe spiunët / 111
Ulu mal të dalë Hëna / 120
Dasëm "allafranga" me Nuse mbi gomar / 125
Shejtanarapët / 132
Nesër do ta shpallim edhe një Shtet Shqiptar / 138
Teknefesi / 145
Edhe ky 28 Nëntor në minare
pa flamurin shqiptar / 153

Ditë zie për gomarin e Haxhi Rrencit / 161
III DOLLI FESTIVE ME "TË DËRGUARIN E SHEJTANIT" NË SHKUP
Qerrja e Diellit iku në Qiell / 173
Car Dushani në Shkup u ngritë lugat / 178
"Shehiti" / 183
Haxhuze / 190
Babadimri grushtohet në Shkup
si "i dërguari Shjetanit / 199
Gëzuar Vitin e Ri 2014 / 206
Partia ty do të të bëjë Plak katundi / 213
Dolli festive me "të dërguarin e Shejtanit"
në Shkup / 217
Dushk për gogla / 225
Hajrica / 231
IV LUFTË E ASHPËR POLITIKE PËR PUSHTET ARGATI
Dasmat politike / 240
Paranoiku / 255
Patrioti i Kandarit të Çajupit / 263
Koha është si "vëllezër"
t'i dalim zot Shtëpisë / 271
Porosia anonime / 283
Teki Dërvishi i përndjekur
edhe në Parajsë / 291
Pulagjeli / 300
Tërbimi i kulltukofagëve me koka
nën sjetulla / 308
"Presideni musliman" / 317
Luftë e ashpër politike për pushtet argati / 325
V "RREZITJE" PA BREKË TE KODRA E DIELLIT
Dashishyti / 332

Borë në Prishtinë dhe Shkup / 339
"Debat" për librin shqip
në prag të zgjedhjeve / 346
Qingji vogël / 356
Policia sekrete letrare / 360
Reklamat e "grisura" turistike në Shkup / 369
Thaçi e "dogji" në Shkup
edhe Zijadin Seleën / 381
Vëllai im i Madh e donte shiun / 388
"Rrezitje" pa brekë te Kodra e Diellit / 396
VI POPULLI NË BREZ ME "DY ALLTIA" LODRËS I BIEN PARTIA
Shkrimtari 'disident" maqedonas
në "mëshirën" e një librarie / 402
Tambëli më ka djegur, i fryej kosit / 411
Shkupi mes sëpatave fetare e politike / 418
"Opozitari" që e "sfidoi"
me çaj rusi Faraonin / 428
Shëtitje "patriotike" rrugëve të Shkupit / 437
Skizofreni / 449
Protestat politike me petk fetar
që i prinë rastit "Monstra" / 457
Krisma partiake me plumba qorr / 465
Populli në brez me "dy alltia"
lodrës i bien Partia / 477
VII "ARMIKU" I SHTETIT DHE ZOTIT
"Universiteti i shqiptarëve / 486
"Porosia politike" nga xhamia e Çikagos
në Amerikë / 495
"Armiku" i Shtetit dhe Zotit / 504
"Burrë" me letra / 512
Varrezat politike / 520
Porosia historike / 529

Nusen me gjithë franga
e mori "Vëllai" i Madh / 535
"Bajram" me Goce Dellçevin
dhe Nikolla Karevin / 542
Shpalosja e flamurit historik
Nga "nipi" i Xha derallës/ 548
VIII HESHTËNI SE UJKU
TROKET PAS DERE
Përfundimi i "ndeshjes sportive"
me "Dron" për toke në Tiranë / 557
Rama e tundi "rrjetën sportive"
në mes të Beogradit / 565
Bomba "politike" Zaevit i pëlciti në dorë / 570
Duartrokitje 20 % të buxhetit
të kulturës shqiptare / 578
Përgëzime / 589
Erdhi me Pranverë. Dhe, iku me Dimër / 596
Amani zbritni pak gomarit
t'i hipë Nstradinica / 600
Heshtëni se Ujku troket pas dere / 606
Lavdi "heronjve" të Xhadisë / 615
Dhe në fund
Lufta vazhdon me penë / 625
Në vend të pasthënies / 632
Shënime për autorin / 651

Cip katoligizimi në publikim Biblioteka popullore dhe universitare « Sv. Kliment Ohridski « , Shkup
821.18 (497.7) - 92

ÇELIKU, Kalosh
LAVDI "heronjve" të Xhadisë: (Dyluftime gjatë rrugës për në Baba Tomor)/ Kalosh Çeliku. - Shkup: Asdreni. 2014. – 660 f.; 23 cm. - (Biblioteka: Xha Deralla)

ISBN 978-9989-174-86-5
COBISS.MK-ID 97325578

KALOSH ÇELIKU
LAVDI “heronjve” të Xhadisë

Botues
ASDRENI

Korrektore
Fitore DERALLA

Formulimi kompjuterik
Ilir EMINI

Tirazhi: 1.000 kopje

U shtyp në shtypshkronjën:
Tringa Design
Tetovë, 2014